KOMBET E
BASHKUARA

	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991	Lënda Nr.:	IT-03-66-T
		Data:	30 nëntor 2005
		Origjinali:	anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: **Gjykatësit Kevin Parker, Kryetar**
Gjykatësit Krister Thelin
Gjykatëses Christine Van Den Wyngaert

Sekretari: **Z. Hans Holthuis**

Aktgjykim i datës: **30 nëntor 2005**

PROKURORJA

kundër

FATMIR LIMAJT
HARADIN BALËS
ISAK MUSLIUT

AKTGJYKIM

Zyrës së Prokurorit:

Z. Alex Whitting
Z. Julian Nicholls
Z. Colin Black
Z. Milbert Shin

Avokatëve mbrojtës për Të Akuzuarit:

Z. Michael Mansfield Q.C. dhe Z. Karim A.A. Khan për Fatmir Limajn
Z. Gregor D. Guy-Smith dhe Z. Richard Harvey për Haradin Balën
Z. Michael Topolski, Q.C. dhe Z. Steven Powles për Isak Musliun

CONTENTS

I. HYRJE 1

II. VËZHGIME LIDHUR ME VLERËSIMIN E DËSHMIVE 4

III. PËRMBAJTJE 17

A. KONTEKSTI POLITIK NË KOSOVË DHE DALJA E UÇK-SË 17
B. ZHVILLIMI I NJËSIVE TË UÇK-SË NË KRAHINA TË NDRYSHME TË KOSOVËS 22
C. MARRJA E LLAPUSHNIKUT NGA UÇK-JA NË MAJ 1998 28
D. RËNIA E LLAPUSHNIKUT NË KORRIK 1998 33

IV. JURIDIKSIONI SIPAS NENEVE 3 DHE 5 TË STATUTIT 35

A. JURIDIKSIONI SIPAS NENIT 3 35
1. Ekzistenca e konfliktit të armatosur dhe lidhja 35
(a) Kuadri ligjor 35
(b) Përfundime 39
(i) Organizimi i UÇK-së 40
(ii) Ashpërsia e konfliktit 54
(iii) Përfundim 64
2. Katër kushtet *Tadiq* 66
B. JURIDIKSIONI SIPAS NENIT 5 68
1. Kuadri ligjor 68
2. Përfundime 72

V. AKUZAT 85

A. KUADRI LIGJOR NË LIDHJE ME KRIMET E AKUZUARA 85
1. Hyrje 85
2. Krime kundër njerëzimit (Pikat 1, 3, 5, 7 dhe 9) 86
3. Trajtim mizor (Pikat 2 dhe 6) 86
4. Tortura (Pika 4) 87
5. Vrasje (Pikat 8 dhe 10) 89
B. PËRFUNDIME 89
1. Ekzistenca e një kamp-burgu në Llapushnik 90
2. Krimet në kamp-burgun e Llapushnikut ose përreth tij (Pikat 4, 6 dhe 8) 110
(a) Kushtet e burgimit 111
(b) Trajtim mizor, torturë dhe vrasje 113
(i) Vojko dhe Ivan Bakraçi 113
(ii) Dëshmitari L07 115
(iii) Dëshmitari L10 116
(iv) Dëshmitari L06 118
(v) Dëshmitari L96 119
(vi) Dëshmitari L04 120
(vii) Dëshmitari L12 122
(viii) Ajet Gashi 123
(ix) Fehmi Xhema (gjithashtu i njohur si Fehmi Tafa) 127
(x) Milovan Kërstiq dhe Miodrag Kërstiq 131
(xi) Sllobodan Mitroviq 133
(xii) Mirosllav Shuliniq 135
(xiii) Zhivorad Kërstiq 136
(xiv) Stamen Genov 139
(xv) Gjorgje Çuk 142

(xvi) Sinisha Bllagojeviq 144
(xvii) Jefta Petkoviq dhe Zvonko Marinkoviq 145
(xviii) Agim Ademi 149
(xix) Vesel Ahmeti 151
(xx) Emin Emini 153
(xxi) Ibush Hamza 156
(xxii) Hyzri Hajrizi 156
(xxiii) Shaban Hoti 158
(xxiv) Hasan Hoxha 161
(xxv) Safet Hysenaj 162
(xxvi) Bashkim Rashiti 163
(xxvii) Hetem Rexhaj 164
(xxviii) Lutfi Xhemshiti 166
(xxix) Shyqyri Zymeri 168
3. Krimet në malet e Berishës (Pika 10) 170
(a) Emin Emini 176
(b) Ibush Hamza 177
(c) Hyzri Hajrizi 179
(d) Shaban Hoti 181
(e) Hasan Hoxha 182
(f) Safet Hysenaj 185
(g) Bashkim Rashiti 186
(h) Hetem Rexhaj 188
(i) Lutfi Xhemshiti 189
(j) Shyqyri Zymeri 191

VI. PËRGJEGJËSIA E TË AKUZUARVE 193

A. KUADRI LIGJOR MBI FORMAT E PËRGJEGJËSISË 193
1. Përgjegjësia në bazë të Nenit 7(1) të Statutit 193
(a) Kryerja 193
(b) Kryerja me anë të pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale 193
(c) Planifikimi 195
(d) Nxitja 195
(e) Urdhërimi 196
(f) Ndihma dhe inkurajimi 196
2. Përgjegjësia në bazë të Nenit 7(3) të Statutit 197
(a) Lidhja epror-vartës 198
(b) Elementi mendor: eprori dinte ose kishte arsye të dinte 199
(c) Masa të nevojshme dhe të arsyeshme 200
B. PËRFUNDIME 201
1. Përgjegjësia e Fatmir Limajt 201
(a) A u identifikua Fatmir Limaj në kamp-burgun e Llapushnikut? 201
(b) A kishte Fatmir Limaj pozitë komanduese dhe kontrolluese mbi ushtarët e UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut? 220
2. Përgjegjësia e Haradin Balës 238
(a) A u identifikua Haradin Balaj në kamp-burgun e Llapushnikut? 238
(b) Alibia e Haradin Balës 256
(c) Roli i Haradin Balës 266
(i) Pjesëmarrje në kryerjen e krimeve konkrete 266
a. Tortura, trajtim mizor dhe vrasje në kamp-burgun e Llapushnikut ose rreth tij (Pikat 4, 6 dhe 8) 266
b. Vrasjet në malet e Berishës (Pika 10) 271
(ii) Pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale 272
(d) Përfundime 274

3. Përgjegjësia e Isak Musliut 275
(a) A u identifikua Isak Musliu në kamp-burgun e Llapushnikut? 275
(b) A kishte Isak Musliu pozitë komanduese dhe kontrolluese mbi ushtarët e UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut? 282
(i) Njësia Çeliku 3 283
(ii) A kishte njësi të tjera që vepronin në Llapushnik? 286
(iii) A ishte Isak Musliu komandant i Çelikut 3 apo komandant i përgjithshëm i zonës së Llapushnikut? 287
(iv) Përfundime 291

VII. FAJËSIA E SHUMËFISHTË 293

VIII. PËRCAKTIMI I DËNIMIT 295

A. PESHA E KRIMIT 296
B. FAKTORËT RËNDUES DHE LEHTËSUES 297
C. PRAKTIKA E PËRGJITHSHME NË GJYKATAT E ISH-JUGOSLLAVISË DHE NË KËTË TRIBUNAL 299
D. LLOGARITJA E KOHËS SË PARABURGIMIT 300

IX. VENDIM 301

X. SHTOJCA I: GLOSAR 303

XI. SHTOJCA II DHE III: HARTA 310

XII. SHTOJCA IV: HISTORIA PROCEDURALE 312

A. PROCESI PARAGJYQËSOR 312
1. Aktakuza dhe paraqitja fillestare 312
2. Historia e Aktakuzës 312
3. Kërkesat për lirimin e përkohshëm 314
4. Çështje që lidhen me mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve 314
5. Shëndeti i të Akuzuarit Haradin Bala 315
6. Fillimi i Procesit Gjyqësor 315
B. PROCESI GJYQËSOR 316
1. Përmbledhje 316
2. Çështje që lidhen me dëshmitarët 316
3. Çështje të provave 318
4. Lirimi i Përkohshëm 319

I. HYRJE

1. Të Akuzuarit, Fatmir Limaj, Haradin Bala dhe Isak Musliu, akuzohen për krime që pretendohet se u kryen prej tyre dhe prej anëtarëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK")[1] prej majit deri rreth 26 korrikut 1998 kundër civilëve serbë dhe civilëve shqiptarë të Kosovës, të cilët konsideroheshin si bashkëpunëtorë të serbëve, në zonën e Llapushnikut në Kosovën qendrore. Në Aktakuzën e ndryshuar për herë të fundit thuhet se të paktën 35 civilë u rrëmbyen prej forcave të UÇK-së, u mbajtën në një kamp-burg në fshatin Llapushnik për periudha të gjata kohore në kushte çnjerëzore dhe iu nënshtruan rregullisht sulmeve, rrahjeve dhe torturave. Për katërmbëdhjetë të burgosur të përmendur me emër thuhet se janë vrarë gjatë burgimit të tyre. Për dhjetë të tjerë thuhet se u ekzekutuan aty pranë, në malet e Berishës më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date, kur forcat e UÇK-së braktisën Llapushnikun, dhe kamp-burgu u sulmua prej forcave serbe që po afroheshin. Këto pretendime shërbejnë si bazë e pesë akuzave për shkelje të ligjeve ose të zakoneve të luftës dhe pesë akuzave për krime kundër njerëzimit, përkatësisht sipas Neneve 3 dhe 5 të Statutit të Tribunalit për burgim, trajtim mizor, veprime çnjerëzore, tortura dhe vrasje.

2. Aktakuza e ngarkon të Akuzuarin Fatmir Limaj, me pseudonimin Çeliku, me përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7(1) të Statutit, duke pretenduar se ai kreu, planifikoi, nxiti, urdhëroi ose në ndonje mënyrë tjetër ndihmoi dhe inkurajoi krimet e lartëpërmendura, ndër të tjera, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Pretendohet se ai mori pjesë personalisht në zbatimin e burgimit të civilëve në kamp-burgun e Llapushnikut, në marrjen e tyre në pyetje, në goditjen, keqtrajtimin dhe torturat ndaj tyre, dhe se planifikoi, nxiti dhe urdhëroi vrasjen e të burgosurve në kamp-burg dhe rreth tij si dhe në malet e Berishës. Fatmir Limaj ngarkohet gjithashtu me përgjegjësi eprore sipas Nenit 7(3) të Statutit lidhur me këto shkelje, e cila pretendohet se buron prej pozitës së tij komanduese dhe kontrolluese mbi anëtarët e UÇK-së përgjegjës për funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut.

3. Aktakuza e ngarkon Haradin Balën, me pseudonimin Shala, me përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7(1) të Statutit, duke pretenduar se ai kreu, planifikoi, nxiti, urdhëroi ose në ndonje mënyrë tjetër ndihmoi dhe inkurajoi krimet e lartëpërmendura, ndër të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Pretendohet se ai mori pjesë personalisht në zbatimin e burgimit të civilëve në kamp-burgun e Llapushnikut, në marrjen e tyre në

[1] anglisht "KLA".

pyetje, në goditjen, keqtrajtimin dhe torturat ndaj tyre, si dhe në vrasjen e të burgosurve në kamp-burg dhe në malet e Berishës. Haradin Bala nuk akuzohet sipas Nenit 7 (3) të Statutit.

4. Aktakuza e ngarkon të Akuzuarin Isak Musliun, me pseudonimin Çerçizi, me përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7(1) të Statutit, duke pretenduar se ai kreu, planifikoi, nxiti, urdhëroi ose në ndonje mënyrë tjetër ndihmoi dhe inkurajoi tetë prej dhjetë krimeve të lartëpërmendura, ndër të tjera, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Pretendohet se ai mori pjesë personalisht në zbatimin e burgimit të civilëve, si dhe në marrjen e tyre në pyetje, në goditjen, keqtrajtimin, torturat dhe vrasjen e të burgosurve në kamp-burgun e Llapushnikut. Isak Musliu ngarkohet gjithashtu me përgjegjësi eprore sipas Nenit 7(3) të Statutit lidhur me këto tetë shkelje, e cila pretendohet se buron prej pozitës së tij komanduese dhe kontrolluese mbi ushtarët e UÇK-së të cilët shërbyen si rojë në kamp-burgun e Llapushnikut. Gjithsesi Isak Musliu nuk akuzohet për dy shkelje për vrasje të pretenduar në malet e Berishës më 26 korrik 1998 apo rreth kësaj date.

5. Tre të Akuzuarit janë vetëdeklaruar të pafajshëm për të tëra akuzat e ngritura kundër tyre.[2]

6. Gjatë procesit gjyqësor fjala "kamp-burg' u përdor si përshkrim i volitshëm, por jo domosdoshmërisht shumë i saktë. Gjithsesi, Prokuroria parashtroi se në muajt maj, qershor dhe korrik 1998 UÇK-ja mbajti ose burgosi persona në një oborr shtëpie në fshatin Llapushnik. Oborri i pretenduar ishte i rrethuar me mure, me një portë të madhe dykanatëshe metalike e cila hapej në një rrugicë të ngushtë që kalonte aty pranë. Brenda ishin dy shtëpi dhe ndërtesa të ndryshme anësore rreth oborrit.[3] Ishte oborri i një ekonomie shtëpiake bujqësore. Prokuroria pretendon se shumica e të burgosurve apo të arrestuarve u mbajtën në bodrumin e një njërës prej shtëpive, i cili quhej fllanik, ose në një stallë të përdorur për lopët, e cila quhej ahur. Disa njerëz u mbajtën edhe në ndërtesën kryesore. Ushtarët e UÇK-së të cilët ruanin burgun mblidheshin në këtë shtëpi dhe shumica e rasteve të marrjes në pyetje dhe të rrahjeve thuhet se kanë ndodhur në këtë shtëpi.[4] Përbri ishte edhe një oborr tjetër, prona e Bali Vojvodës, ku thuhet se u organizua ceremonia e betimit të UÇK-së me pjesëmarrjen e të Akuzuarit Fatmir Limaj.[5] Në anën tjetër të rrugës ndodhet oborri i Gëzim Gashit

[2] Të Akuzuarit Haradin Bala dhe Isak Musliu u paraqitën për herë të parë më 20 shkurt 2003 para Gjykatësit Liu dhe u vetëdeklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat e ngritura kundër tyre. Paraqitja e parë e të Akuzuarit Fatmir Limaj u mbajt më 5 mars 2003 para Gjykatësit Liu dhe ai u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat e ngritura kundër tij. Më 27 shkurt 2004, pas ndryshimit të Aktakuzës, tre të Akuzuarit u vetëdeklaruan edhe një herë të pafajshëm para Gjykatësit Orie së për të gjitha akuzat e ngritura kundër atyre.
[3] Prova materiale P6.
[4] *Shih më sipër* paragrafët 243-446.
[5] Elmi Sopi, T 6767-6768; Ruzhdi Karpuzi, T 3096-3098, 3175; Prova Materiale P128.

ku pretendohet se UÇK-ja kishte ngritur një kuzhinë për të ushqyer efektivin dhe ku disa ushtarë të UÇK-së kalonin natën.[6] Sa herë që në këtë vendim përmendet kamp-burgu apo burgu, është fjala për oborrin e parë të lartpërmendur në fshatin Llapushnik. Sa herë që flitet për të burgosurit apo të ndaluarit, është fjala për ata që thuhet se u mbajtën në këtë kamp-burg në kohë të ndryshme që lidhen me këtë Aktakuzë.

7. Kur përmendet një pikë luftarake ose një pikë, është fjala për një pozicion ku (zakonisht) ishte dislokuar një grup i vogël ushtarësh të UÇK-së. Këto pika ishin zakonisht dhe shpeshherë pozicione mbrojtëse në llogore të cilat u përgatitën për mbrojtjen e ushtarëve të UÇK-së. Shumë prej këtyre ndodheshin në hyrjet e fshatrave për të bërë të mundur që ushtarët e UÇK-së ta drejtonin zjarrin kundër forcave serbe kur u afroheshin fshatrave.

8. Forcat serbe dhe forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë ("RFJ") të dislokuara në Kosovë në vitin 1998 përfshinin forcat e Ushtrisë së Jugosllavisë ("UJ") dhe forcat e Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë. ("MPB").[7] Dhoma do të përmendë forcat e veçanta të përfshira në operacione të caktuara kur identiteti i këtyre forcave dihet nga provat. Mirëpo, kur nuk ekzistojnë prova lidhur me përfshirjen e forcave të veçanta serbe ose të RFJ-së, Dhoma do t'i përmendë këto forca përgjigjësisht si forca serbe. Kjo do të thotë forcat serbe apo forcat e Jugosllavisë.

9. Më tej, kudo në Aktagjykim, Dhoma ka përmendur vende në Kosovë duke përdorur emërtimet e tyre shqip dhe gjuhën boshnjake-kroate-serbe. Pra emri i çdo vendi të përmendur del në tekst shqip/boshnjak-kroat-serb. Për këtë, Dhoma ka shfrytëzuar një listë toponimesh, e cila është pjesë e provave për këtë çështje,[8] megjithëse është e qartë se lista nuk është gjithmonë e plotë dhe se disa vende mund të shkruhen ndryshe në dokumenta të tjera. Së fundi, Shtojcave të këtij Aktgjykimi u janë bashkëngjitur dy harta. Ato tregojnë rajonin e përgjithshëm që ka lidhje më këtë rast, dhe vendndodhjet që kanë lidhje me akuzat e përmendura shpesh në këtë aktgjykim.

[6] Elmi Sopi, T 6729-6733; Ruzhdi Karpuzi, T 3087-3096; Prova Materiale P128.
[7] *Shih më sipër*, paragrafët 93; 164-165; *shih.* edhe Provën Materiale P230, paragrafin 3.
[8] Prova Materiale P219.

II. VËZHGIME LIDHUR ME VLERËSIMIN E DËSHMIVE

10. Në këtë Aktgjykim, Dhoma do të vendosë për pafajësinë apo fajësinë e secilit prej të tre të Akuzuarve lidhur me çdo akuzë me të cilat secili prej tyre ngarkohet në Aktakuzë, d.m.th. nga dhjetë akuza kundër Fatmir Limajt dhe Haradin Balës dhe tetë akuza kundër Isak Musliut. Neni 21(3) i Statutit garanton supozimin e pafajësisë për çdo të Akuzuar. Ky parim e ngarkon Prokurorisë me detyrimin për të provuar fajësinë e të Akuzuarit, detyrim ky që mbetet mbi Prokurorinë gjatë tërë procesit. Standardi që duhet përmbushur lidhur me çdo akuzë kundër çdo të Akuzuari, është vërtetimi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.[9] Rrjedhimisht, në lidhje me çdo akuzë kundër çdo të Akuzuari Dhoma ka përcaktuar nëse, në bazë të provave në tërësi, ajo është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se janë provuar çdo element i krimit dhe format e përgjegjësisë të ngritura në Aktakuzë. Gjatë kësaj pune, ka qenë e nevojshme që lidhur me disa çështje, Dhoma të nxjerrë një apo disa përfundime nga faktet e vërtetuara prej dëshmive. Në raste të tilla, ku nga këto fakte logjikisht mund të nxirrej më shumë se një përfundim, Dhoma ka shqyrtuar me kujdes nëse përfundimi që mund të nxirrej logjikisht nga këto fakte ishte i papajtueshëm me fajësinë e të Akuzuarit. Nëse po, atëhere detyrimi dhe standardi i provës kërkojnë që i Akuzuari të shpallet i pafajshëm për akuzën në fjalë.[10]

11. Në këtë çështje, një i Akuzuar, Haradin Bala, përdor pjesërisht një mbrojtje alibie.[11] Në qoftë se dëshmitë ofrojnë një bazë faktike për alibinë, i Akuzuari nuk ka detyrim të vërtetojë alibinë; është detyrë e Prokurorisë të "përjashtojë çdo mundësi të arsyeshme se dëshmitë e alibisë janë të vërteta".[12] Më tej, siç u vendos nga një Dhomë tjetër Gjyqësore, vërtetimi se një alibi është e rreme, nuk "provon në vetvete të kundërtën e pretendimit".[13] Duhet që Prokuroria jo vetëm të hedhë poshtë vlefshmërinë e alibisë, por edhe të vërtetojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e të Akuzuarit sipas pretendimit të Aktakuzës.

12. Dhomës i është kërkuar të peshojë dhe të vlerësojë provat e paraqitura nga të gjitha palët. Ajo dëshiron të theksojë se pranimi i dëshmisë gjatë procesit nuk ka lidhje me peshën e dhënë asaj më vonë nga Dhoma. Për më tepër, Dhoma vë në dukje se periudha shtatëvjeçare që ka kaluar që prej ngjarjeve në Aktakuzë, ka mjaft të ngjarë të ketë ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e

[9] Rregulla 87(A) e Rregullores parashtron, në tekstin përkatës: "[…] Përfundimi i fajësisë mund të arrihet vetëm kur shumica e Dhomës Gjyqësore bindet se është provuar fajësia jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm."
[10] Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 458.
[11] Më 1 mars 2005, Mbrojtja e Isak Musliut kishte dorëzuar gjithashtu një njoftim për alibi sipas Rregullës 67 të Rregullores.
[12] Aktgjykim *Vasileviq,* paragrafi 15, Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 581.
[13] Aktgjykim *Vasileviq*, poshtëshënimi 7.

kujtesës së dëshmitarëve, dhe kjo është e kuptueshme. Megjithatë, ka patur raste kur dëshmia gojore e dëshmitarit ndryshonte nga rrëfimi i dhënë prej tij në një deklaratë të mëparshme. Njihet se "është në natyrën e procedurave penale që në gjyq dëshmitarit t'i bëhen pyetje të tjera nga ato të intervistave të mëparshme dhe që atij mund t'i kujtohen hollësi të tjera kur pyetet konkretisht në gjyq."[14] Megjithatë, kur është fjala për caktimin e peshës që i takon provave të tilla, këto çështje duhen të shqyrtohen me imtësi.

13. Për rastin në fjalë, disa ish-anëtarë të UÇK-së u thirrën në gjyq në formë detyruese për të dëshmuar para Dhomës si dëshmitarë të Prokurorisë. Gjatë dëshmive të disa prej këtyre dëshmitarëve doli e qartë se për çështje të caktuara, dëshmia e tyre gojore ishte materialisht e ndryshme nga një deklaratë e mëparshme e dëshmitarit. Disa ndryshime u sqaruan nga dëshmitarët gjatë dëshmisë. Disa njerëz pohuan se ndryshimet dolën për shkak të metodikës së pyetjeve në deklaratën e mëparshme, në veçanti në disa raste ku duket se në një pyetje të caktuar kishte paqartësi lidhur me afatin kohor. Dhoma e ka pranuar këtë mundësi për disa raste, por jo për të gjitha. Mirëpo, ndryshimet e tjera nuk u sqaruan plotësisht. Në disa raste, Dhomës iu bë e qartë, sidomos duke marrë parasysh sjelljen e dëshmitarit dhe shpjegimin e dhënë për ndryshimet, se dëshmitë gojore të disa dëshmitarëve ishin sajuar qëllimisht për t'u paraqitur në mënyrë më pak dobiprurëse për Prokurorinë, në krahasim me deklaratën e mëparshme. Dëshmitë e disa ish-anëtarëve të UÇK-së i dhanë Dhomës një përshtypje të qartë se u ndikuan materialisht nga një ndjenjë e fortë lidhjeje me UÇK-në në përgjithësi, si dhe me një apo disa të Akuzuar në veçanti. Dukej se besnikëria mbizotëruse ndikoi në gatishmërinë e disa dëshmitarëve për të shprehur të vërtetën në gjyq mbi disa çështje. Është e pakundërshtueshme se parimi i nderit dhe vlera të tjera kolektive luajnë një rol të veçantë në kulturën e dëshmitarëve me prejardhje shqiptare në Kosovë. Kjo u shpreh në raportin ekspert të Stephanie Schwandner-Sievers:

> Koncepti shqiptar i nderit rregullon të gjitha marrëdhëniet jashtë lidhjeve të gjakut... Solidariteti me ata të një 'gjaku' është i vetëkuptueshëm, por besnikëria ndaj një grupi ose çështjeje jashtë familjes përcaktohet me anë të riteve. Nderi mund të shpjegohet gjithashtu si një model i sjelljes ideale, dhe si zotësi e burrit që të mbrojë paprekshmërinë e familjes ose një grupi të caktuar më të madh (si fisi ose një parti politike) prej sulmeve të jashtme… Besa kërkon besnikëri absolute dhe kërkon që individi t'u përmbahet vlerave të familjes ose të grupit në përgjithësi. Njëkohësisht, ajo justifikon vrasjen e individëve brenda grupit të cilët e shkelin kodin… Mirëpo, anëtarët e grupit mund të zgjedhin shmangjen e dhunës. Përgjigjja ndaj konfliktit, fyerjes, tradhtisë, ose shkeljeve të tjera të normave të grupit varet nga interpretimet e fakteve nga anëtarët dhe ajo mund të jetë e llojllojshme.[15]

[14] Aktgjykim *Naletiliq*, paragrafi 10; Aktgjykim *Vasileviq*, paragrafi 21.
[15] Prova Materiale P201, f. 37-39.

Sipas vlerësimit të Dhomës, disa prej këtyre faktorëve vlejnë gjithashtu për aspekte të dëshmive të disa ish-anëtarëve të UÇK-së, të cilët u thirrën dëshmitarë gjatë Mbrojtjes. Këto çështje janë marrë parasysh nga Dhoma gjatë vlerësimit të besueshmërisë personale të dëshmitarëve të caktuar në këtë rast, vlerësim ky i cili, në shumë raste, ka ndikuar materialisht në pranimin apo mospranimin tërësor apo të pjesshëm të dëshmisë së një dëshmitari, nga ana e Dhomës.

14. Megjithatë, çështja shkon më tej. Filmimet në video dhe transkriptet e intervistave të mëparshme të filmuara në video të dy dëshmitarëve të Prokurorisë, të cilat shfaqën mospërputhje materiale me dëshmitë e tyre gojore në gjyq, me vendim te Dhomës u pranuan si dëshmi provuese në rrethanat e veçanta.[16] Faktorët e shtjelluar më lart padyshim që e kanë bërë më të ndërlikuar detyrën e Dhomës për të përcaktuar se ku ndodhet e vërteta midis këtyre dëshmive mospërputhëse. Në disa raste, Dhoma nuk ka qenë në gjendje të bëjë një përcaktim të tillë dhe i është dashur t'i lërë dëshmitë mënjanë. Mirëpo, megjithëse Dhoma parimisht pranon se deklarata të mëparshme mospërputhëse mund të kenë ndonjë forcë vërtetuese, të paktën nëse ato mbështesin dëshmi të tjera në dukje të besueshme të dëshmitarëve të tjerë gjatë procesit, në lidhje me këtë rast Dhoma nuk është e bindur se deklaratat e mëparshme mospërputhëse të këtyre dy dëshmitarëve mund të shfrytëzohen me bindje si bazë e vetme apo bazë kryesore për të vërtetuar një fakt material. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për rastin e këtyre dy dëshmitarëve, sepse secili dëshmitar gjatë dëshmisë së tij gojore mohoi për çështje tepër materiale atë që ishte deklaruar më parë në intervistë.

15. Dhoma ka dëgjuar gjithashtu dëshmitë e një sërë dëshmitarësh të cilët mund të karakterizohen si "dëshmitarë-viktima". Ngjarjet për të cilat dëshmuan gjatë procesit ishin ngjarje tepër tronditëse, që herë pas here kishin të bënin me mbijetesën apo vdekjen. Në vlerësimin e dëshmive të dhëna prej këtyre dëshmitarëve, Dhoma ka marrë parasysh se çdo vëzhgim që mund të kenë bërë në atë kohë mund të jetë ndikuar nga stresi apo nga frika. Kjo ka kërkuar një kujdes të veçantë nga ana e Dhomës. Dhoma është në dijeni se shumë dëshmitarë-viktima me prejardhje shqiptare kishin lidhje familjare të shkallëve të ndryshme me njëri-tjetrin, ose vinin nga fshatrat afër fshatit të një dëshmitari tjetër apo të dëshmitarëve të tjerë. Gjithashtu dëshmitë e tyre për ngjarjet mund të jenë ndikuar prej faktorëve kulturorë të besnikërisë dhe nderit, të përmendur më lart, prandaj Dhoma është përpjekur të marrë këtë parasysh. Për më tepër, dëshmitarët mund të kenë diskutuar dhe, në disa raste, dëshmuan vetë, se kishin diskutuar për ngjarjet me njëri-tjetrin gjatë viteve që prej ngjarjeve në fjalë. Përveç kësaj, Dhoma ka parë se një numër i dukshëm dëshmitarësh

[16] Vendimi mbi Mocione të Prokurorisë për të Pranuar Deklarata të Mëparshme si Dëshmi Materiale, 25 prill 2005.

kërkuan masa mbrojtëse gjatë procesit dhe shprehën shqetësim për jetën e tyre dhe të familjeve të tyre. Gjatë gjyqit gjendja e frikës ishte tepër e dukshme, veçanërisht te dëshmitarë ende me banim në Kosovë. Dhoma ka dëgjuar dëshmi për dëshmitarë që kishin kërkuar të intervistoheshin prej hetuesve natën për të shmangur mundësinë që intervista të bëhej e njohur, apo të intervistoheshin në një gjuhë të tretë dhe jo nëpërmjet përkthyesve shqiptarë sepse kishin frikë se mund të kompretoheshin.[17] Është gjithashtu e vërtetë se disa viktima erdhën për të dëshmuar vetëm pas një thirrjeje detyruese të lëshuar nga Dhoma. Gjatë detyrës tepër të vështirë të vlerësimit të dëshmive për këtë rast, Dhoma është përpjekur, ndër të tjera, t'u japë këtyre çështjeve peshën e duhur.

16. Me një rëndësi të veçantë për këtë çështje janë dëshmitë për identifikimin pamor të secilit prej të Akuzuarve dhe të të burgosurve dhe viktimave në kamp-burgun e Llapushnikut dhe në malet e afërta të Berishës më 26 korrik 1998 apo rreth kësaj date. Gjatë procesit, Mbrotja ka vënë në provë besueshmërinë e këtyre dëshmive identifikuese si dhe metodat e marrjes së tyre, në veçanti lidhur me të tre të Akuzuarit.

17. Në sistemet shtetërore të së drejtës penale pranohet gjerësisht se dëshmia që lidhet me identifikimin pamor përbën një kategori dëshmie ku mund të ndodhin gabime. Jurisprudenca në këto sisteme pranon se gabime mund të ndodhin edhe me dëshmitarë tepër të ndershëm, të sigurtë dhe në dukje mbresëlënës. Ka raste të dënimeve të gabuara për shkak të identifikimit të gabuar pamor. Si pasojë, dëshmia e identifikimit pamor trajtohet me shumë kujdes.[18] Në këtë Tribunal, Dhoma e Apelit ka tërhequr vëmendjen e nevojës për një "kujdes tepër të veçantë" lidhur me dëshminë e identifikimit pamor.[19] Në lidhje me këtë ajo nënvizoi se vlerësimi i dëshmisë së një dëshmitari të caktuar, dhe i dëshmisë në tërësi, duhet të bëhet duke marrë parasysh pikëpamjet e shprehura në *Reg v. Turnbull.*[20] Dhoma e Apelit ka theksuar nevojën për të "kuptuar dobësitë e perceptimit njerëzor dhe rrezikun tepër të madh të një gabimi të mundshëm gjyqësor nga besimi madje edhe te dëshmitarët më të sigurtë të cilët pretendojnë të identifikojnë një të akuzuar, pa patur mundësinë e mjaftueshme për të vërtetuar vëzhgimet e bëra."[21] Dhoma e Apelit ka identifikuar një

[17] Kaare Birkeland, T 1643; Anargyros Kereakes, T 4934-4937.
[18] *Shih* për shembull, *Reg v. Turnbull*, [1967] QB 224, *Reid v. Reg* [1991] I AC 363, Mbretëria e Bashkuar; *U.S. v. Wade*, 388 U.S. 218 (1967), Shtetet e Bashkuara; Gjykata e Lartë Federale, *ribotuar në* Strafverteidiger 409 (1991); Gjykata e Lartë Federale, *ribotuar në* Strafverteidiger 555 (1992), Gjermani; Gjykata e Lartë, 10 dhjetor 1992, 15 Os 150/92; 4 qershor 1996, 11 Os 59/96, dhe 20 mars 2001, 11, Os 141/00, Austri.
[19] Vendimi i Apelit *Kupreshkiq*, paragrafi 34.
[20] *Reg v. Turnbull*, [1967] QB 224. *Shih* për shembull, *Reid v. Reg* [1991] I AC 363, Mbretëria e Bashkuar; *Auckland City Council v. Brailey* [1988] I NZLR 103, Zelanda e Re; *R v. Mezzo* [1986] I SCR 802, Kanada; *Dominican v. R* [1992] 173 CLR 555 Australi.
[21] Vendimi i Apelit *Kupreshkiq*, paragrafi 34.

sërë faktorësh, por jo të gjithë, të cilët mund të bëjnë të pasigurtë një vendim për përdorimin e dëshmisë identifikuese: "identifikime të të akuzuarve nga dëshmitarët të cilët e kanë parë të dyshuarin kalimthi ose me nje pamje të penguar; identifikime në terr dhe si pasojë e një ngjarjeje traumatike të përjetuar nga dëshmitari; dëshmi mospërputhëse apo të pasakta për tiparet fizike të të dyshuarit në kohën e ngjarjes; identifikimi i gabuar apo një dëshmitar i cili mohon aftësinë e tij për të identifikuar të akuzuarin dhe pastaj e identifikon; ekzistenca e dëshmive mospërputhëse të dëshmitarit; dhe pretendimi i vonuar i rikujtimit prej dëshmitarit për të dyshuarin bashkë me "mundësinë e qartë" nga rrethanat se dëshmitari u ndikua nga sugjerimet e të tjerëve."[22]

18. Gjatë dëshmisë së tyre në gjyq, disa dëshmitarë identifikuan një apo disa të Akuzuar. Pavarësisht nga rrethanat e tjera lidhur me besueshmërinë e identifikimit nga çdo dëshmitar, rrethana këto të cilat do të shqyrtohen më vonë në këtë vendim, Dhoma është mjaft e vetëdijshme se identifikimi i një të Akuzuari në sallën e gjyqit mund të ndikohet papërshtatshmërisht dhe në mënyrë të pavetëdijshme nga vendi ku ndodhet i Akuzuari fizikisht dhe nga faktorët e tjerë që e bëjnë të Akuzuarin qendër të vëmendjes në sallën e gjyqit.[23]

19. Një Dhomë tjetër Gjyqësore ka shprehur rezerva lidhur me peshën që duhet t'u jepet identifikimeve të bëra me anë të fletëve me një numër fotografish.[24] Në këtë rast, Dhoma ka shqyrtuar me kujdes dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes, Profesor Willem Wagenaar. Dhoma ishte e mendimit se dëshmia e tij ishte e dobishme, por jo gjithmonë tërësisht bindëse, veçanërisht kur dëshmia përpiqej të përcaktontë kategori absolute të masës së besueshmërisë së dëshmisë së identifikimit pamor. Një problem i veçantë i identifikimit me fletë me fotografi është se fotografia e të Akuzuarit që përdoret mund të mos tregojë ngjashmëri tipike, megjithëse jep saktësisht tiparet e të Akuzuarit siç duken në një moment të caktuar.[25] Veç kësaj, Dhoma dëshiron të shtojë si faktorë të tjerë me rëndësi, edhe qartësinë apo cilësinë e fotografisë së të Akuzuarit të përdorur në fletën me fotografi dhe kufizimet e natyrshme të një fotografie të vogël dypërmasore në krahasim me një pamje tripërmasore të një personi të gjallë. Gjithashtu me rëndësi është nëse dëshmitari e kishte njohur më parë subjektin e identifikimit, pra nëse ai "identifikon" dikë të njohur apo nëse "identifikon" një të huaj.[26] Megjithëse Dhoma nuk ka qenë e gatshme të hedhë poshtë çdo

[22] Vendimi i Apelit *Kupreshkiq*, paragrafi 40 (pa poshtëshënime).
[23] Profesor Willem Wagenaar, T 7140; Prova materiale DM7; *shih edhe* Aktgjykimin *Vasileviq*, paragrafi 19.
[24] U gjykua se kjo procedurë ishte "në vetvete zakonisht e pasigurtë kur dëshmitari nuk e kishte njohur të Akuzuarin më përpara", duke qenë se një fotografi pasqyron pamjen e një individi në një sekondë të caktuar kur individi mund të ketë qenë duke ndryshuar shprehjen e fytyrës dhe prandaj mund të mos jetë pasqyrim i sigurtë i pamjes së tij të vërtetë.", Aktgjykimi *Vasileviq*, paragrafi 18.
[25] Profesor Willem Wagenaar, T 7140; Prova materiale DM7.
[26] Profesor Willem Wagenaar, T 7136; Prova Materiale DM7.

identifikim të bërë me anë të fletëve me fotografi të të Akuzuarit apo të të Akuzuarve në këtë çështje, e vetëdijshme për kufizimet dhe pasaktësitë e mundshme, ajo është përpjekur të analizojë tërë rrethanat e dhëna në dëshmitë dhe që mund të ndikojnë në identifikime të tilla, dhe ka vlerësuar me shumë maturi dhe kujdes saktësinë e këtyre identifikimeve. Ndër çështjet që sipas Dhomës kanë një rëndësi të veçantë për këtë temë ishtë nëse fotografia ishtë mjaftueshmërisht e qartë dhe përputhej me përshkrimin e të Akuzuarit në kohën e ngjarjeve; nëse i Akuzuari ngatërrohet me të tjerë apo dallohet prej atyre; nëse ka kaluar një kohë e gjatë midis vëzhgimit të parë të të Akuzuarit dhe identifikimit prej fletës me fotografi; nësë identifikimi u krye menjëherë dhe me siguri, apo ndryshe; nëse kishte mundësi që dëshmitari të njihej, qoftë personalisht, qoftë nëpërmjet mediave, me pamjen e të Akuzuarit pas ngjarjeve dhe para identifikimit; dhe nëse procedura mund ta ketë nxitur në një farë mënyre dëshmitarin që të kryente një identifikim pozitiv me gjithë pasigurinë që kishte, ose mund t'a ketë nxitur dëshmitarin që të identifikonte të Akuzuarin në vend të dikujt tjetër [27]

20. Duke marrë veçanërisht parasysh dëshmitë e identifikimit pamor të secilit prej të Akuzuarve nga dëshmitarët e caktuar, duhet të theksohet se, si për tërë elementët e një shkeljeje penale, Prokuroria duhet të provojë identifikimin e çdo të Akuzuari si kryes sipas akuzave, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Megjithatë kjo duhet të vendoset në bazë të tërë dëshmive që kanë lidhje me çështjen e identifikimit, si dëshmive konfirmuese po ashtu edhe dëshmive kundërshtuese. Në një rast të veçantë, kjo mund të përfshijë, për shembull, një alibi apo nëse një dëshmitar identifikues ka një motiv i cili do të mbështetej nga identifikimi i rremë. Dëshmia e identifikimit pamor të të Akuzuarit nga një dëshmitar është vetëm një element i mundshëm i dëshmisë me rëndësi për një çështje të caktuar. Pesha përfundimtare që i jepet çdo elementi të rëndësishëm të dëshmive, duke përfshirë çdo identifikim pamor ku më shumë se një dëshmitar ka identifikuar një të Akuzuar, nuk mund të vendoset ndarazi. Megjithëse çdo identifikim pamor dhe çdo element tjetër përkatës i dëshmive, trajtuar ndarazi, mund të mos jenë të mjaftueshëm për të plotësuar detyrimin e provës që ka Prokuroria, është efekti plotësues i dëshmive, pra tërësia e dëshmive që lidhet me identifikimin e një të Akuzuari, që duhet të vlerësohet për të vendosur nëse Prokuroria ka provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se çdo i Akuzuar është kryes sipas akuzave të bëra.[28]

21. Në disa raste, vetëm një dëshmitar ka dëshmuar për një fakt material për këtë çështje. Natyrisht, nga pikëpamja juridike, dëshmia e një dëshmitari të vetëm për një fakt material nuk ka

[27] Profesor Willem Wagenaar, T 7136-7138; 7187-7190; 7216-7219; Prova Materiale DM7.
[28] *Shih Prokurorja kundër Kunaracit*, Vendim mbi Mocionin e Shpalljes së Pafaësisë, Lënda nr. IT-96-23-T, 3 korrik 2000, ku Trupi Gjykues theksoi: "Një tribunal faktesh kurrë nuk duhet të shqyrtojë dëshminë e çdo dëshmitari ndarazi sikur të ekzistonte në një kuti të mbyllur dhe të vulosur; është tërësia e *krejt* dëshmive për një çështje që duhet të shqyrtohet," paragrafi 4.

nevojë për një vërtetim mbështetës.[29] Megjithatë, strategjia e Dhomës ka qenë që çdo dëshmi e tillë kërkon një shqyrtim tepër të kujdesshëm para se Dhoma mund të ketë besim te ajo.

22. Për më tepër, Dhoma kujton Nenin 21(4)(g) të Statutit i cili parashtron se i akuzuari nuk do të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë. Dy prej të tre të Akuzuarve në këtë çështje, përkatësisht Haradin Bala dhe Isak Musliu, nuk dëshmuan në gjyq. Natyrisht, Dhoma nuk i ka dhënë rëndësi provuese vendimit të tyre. Mirëpo, Fatmir Limaj dëshmoi para Dhomës në mbrojtjen e vetë. Ai e bëri këtë para se të thirreshin dëshmitarë të tjerë të Mbrojtjes, gjë që, në vlerësimin e besueshmërisë, llogaritet në dobi të tij. Ky vendim për të dëshmuar nuk ka krijuar ndonjë detyrim mbi të Akuzuarin për të vërtetuar pafajësinë e tij. Përkundrazi, pavarësisht nga dëshmia e të Akuzuarit, Dhoma duhej të vendoste sa bindëse ishin provat e Prokurorisë sipas standardit të kërkuar për shpalljen e fajësisë.[30]

23. Dhoma urdhëroi masa për të mbrojtur identitetin e shumë dëshmitarëve dhe të anëtarëve të familjeve të tyre. Dhoma u bind se këto masa mbrojtëse ishin të përligjura për shkak të shqetësimeve për sigurinë e tyre personale. Për të njëjtat arsye, shumë dëshmitarë në këtë Aktgjykim përmenden vetëm me numër dhe jo me emër, kurse hollësi të tjera që mund të bëjnë të mundur identifikimin e tyre apo të anëtarëve të familjeve të tyre, janë hequr. [31]

24. Gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën, ishte e zakonshme që anëtarët e UÇK-së të përdornin pseudonime në vend të emrave të tyre. Rrjedhimisht në këtë Vendim ka qenë e nevojshme që personat në fjalë të përmenden gjerësisht me pseudonim. Për më tepër, dëshmitë tregojnë se një sërë dëshmitarësh me prejardhje shqiptare njiheshin me emra të ndryshëm, të marrë zakonisht nga lidhjet e ndryshme familjare. Për fat të keq, dëshmitë kanë qenë herë pas here pështjelluese për shkak të kësaj veçorie kulturore; Dhoma është përpjekur të minimizojë ndikimin e kësaj në këtë Aktgjykim.

25. Dhoma vëren se Mbrojtja ka ngritur disa shqetësime lidhur me besueshmërinë e disa dëshmitarëve në këtë çështje, veçanërisht L96, Dragan Jashoviqi, L64, Ramiz Qeriqi, L04, L06, L10 dhe L12.

[29] Vendimi i Apelit *Aleksovski*, paragrafi 62.
[30] Aktgjykim *Vasileviq*, paragrafi 13.
[31] Kurdoherë që ishte e përshtatshme në këtë Vendim, Dhoma ka përmendur persona të mbrojtur si "të afërm".

26. L96 dëshmoi para Tribunalit për rrëmbimin e vetë, për rrëmbimin e një anëtari të familjes, për burgosjen e tij në kamp-burgun e Llapushnikut dhe për vrasjet e pretenduara në malet e Berishës. L96 dëshmoi se ai ishte njëri prej të dy burgosurve në kamp-burgun e Llapushnikut i cili kishte qenë i pranishëm gjatë vrasjeve në malet e Berishës dhe kishte mbijetuar.[32] Si rezultat, L96 dha dëshmi që ka lidhje me fakte të rëndësishme materiale në këtë çështje, një pjesë e së cilës nuk është vërtetuar nga dëshmitë e tjera. Një pjesë e dëshmisë të L96-ës është e dorës së dytë, një pjesë ishte në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të Prokurorisë, dhe një pjesë doli se kishte mospërputhje të brendshme. Përveç këtyre çështjeve, Dhoma u shqetësua veçanërisht për një aspekt tjetër të dëshmisë të L96-ës. Gjatë tërë dëshmisë së tij gojore L96 pohoi se as nuk bashkëpunonte, as nuk kishte bashkëpunuar aktivisht apo vullnetarisht me autoritetet serbe.[33] Megjithatë ka disa dëshmi të cilat sugjerojnë të kundertën.[34] Gjithashtu është domethënëse se një pjesë e dëshmisë së L96-ës bëhet më e besueshme nëse pranohet se ai ishte bashkëpunëtor me serbët.[35] Gjithashtu, një pjesë e madhe e kundërshtive midis dëshmisë së L96-ës dhe dëshmive të të tjerëve, si dhe mospërputhjet brenda dëshmisë së tij, shpjegohen më lehtë nëse ishte bashkëpunëtor me serbët. Dhoma vëren se L96 mund të ketë qenë motivuar nga dëshira për të mbrojtur vetveten dhe familjen, duke pohuar se nuk u kishte dhënë informacion autoriteteve serbe vullnetarisht.[36] Mirëpo, Dhoma ka përshtypjen e qartë se L96 dha dëshmi të rreme për këtë çështje. Zelli i tij për t'a bërë këtë i shkakton Dhomës një ndjenjë të përgjithshme mosbesimi ndaj besueshmërisë së këtij dëshmitari. Si rezultat, pjesët përbërësë të dëshmisë së tij u shqyrtuan me imtësi dhe u përdorën me kujdes. Dhoma nuk ka qenë e gatshme të pranojë dhe të veprojë vetëm në bazë të dëshmisë së L96-ës lidhur me ndonjë çështje materiale dhe u ka dhënë peshë vetëm atyre pjesëve të dëshmisë së tij të cilat mbështeten në ndonjë element të veçantë material nga dëshmitë e tjera të pranuara nga Dhoma.

27. Dragan Jashoviqi ka dëshmuar në këtë Tribunal në dy procese gjyqësore. Brenda një periudhe të shkurtër kohore, ai doli dëshmitar i Prokurorisë në këtë çështje dhe u thirr dëshmitar për Mbrojtjen në procesin *Millosheviq*. Dragan Jashoviqi u paraqit si dëshmitar i besueshëm i

[32] L96, T 2397-2398.
[33] L96, T 2517, 2519, 2543, 2545.
[34] Për shembull, ka dëshmi se familja e L96-ës kishte marrëdhënie miqësore me autoritetet serbe, Dragan Jashoviqi, T 5305-5306, 5400-5402, 5407-5408; L96, T 2525 dhe se ai iu dha vullnetarisht informacion autoriteteve serbe, T 2426-2427, 5284, 5428; *Shih* edhe Provat materiale DM9 dhe DM15.
[35] Për shembull, sipas L96-ës, pasi u arratis prej vrasjeve në Malet e Berishës, ai eci më këmbë 30-35 km. nëpërmes territorit të kontrolluar nga UÇK-ja deri në Ferizaj, T 2423-2424. Ai bujti te një kushëri dhe pas disa ditëve u arrestua, u çua në SPB-në dhe u mor në pyetje nga Dragan Jashoviqi, T 2389. Dragan Jashoviqi jep edhe një rrëfim tjetër kur thotë se L96 iu dorëzua autoriteteve serbe në Komoran, shumë më afër Maleve të Berishës, gjë që vërtetohet nga një raport i cili, thuhet se u përgatit nga autoritetet serbe, T 2426-2427, 5284, 5428.
[36] Lidhur me faktin se L96 nuk u përmendi hetuesve të CCIU-së /Njësia Qendrore Hetimore Kriminale/ se kishte qenë më parë në Malet e Berishës me autoritetet serbe, L96 deklaroi se "nuk shkonte që t'u tregoja familjes dhe shokëve se serbët në Llapushnik më kishin çuar aty", T 2453.

Prokurorisë në këtë proces kurse, njëkohësisht, hetuesit e Zyrës së Prokurores gjetën material për të diskreditуar Dragan Jashoviqin pak më vonë kur doli dëshmitar i Mbrojtjes në procesin *Millosheviq*. Dhoma ka theksuar më parë se në sjelljen e Zyrës së Prokurores nuk kishte mashtrim.[37] Materiali i mbledhur nga hetuesit e Zyrës së Prokurores iu dorëzua Mbrojtjes në këtë proces sa më herët, madje në kohë për t'u shfrytëzuar gjatë fazës së pyetjeve për Dragan Jashoviqi nga Mbrojtja.[38] Mirëpo, Dhoma është e shqetësuar se këto strategji mospajtuese të Zyrës së Prokurores lidhur me të njëjtin dëshmitar janë të padëshiruara. Detyrimisht dalin probleme të dukshme lidhur me pranimin e dëshmitarit si njeri të ndershëm dhe të besueshëm, dhe lindin shqetësime të rënda për politikën e brendshme të Zyrës së Prokurores. Gjithsesi tani Dhoma ka detyrë që të analizojë besueshmërinë e Dragan Jashoviqit duke ekzaminuar tërë materialin e paraqitur. Në kohën që ka lidhje me Aktakuzën, Dragan Jashoviqi punonte polic për hetimin e krimeve në Sekretariatin e Punëve të Brendshme në Ferizaj. Sipas mendimit të Dragan Jashoviqit, UÇK-ja ishte një "organizatë e paligjshme terroriste"[39] dhe puna e tij kishte të bënte me hetimin e themelimit dhe të veprimtarive të UÇK-së, dhe të udhëheqjes, të shtabit dhe të selive të saj.[40] Shqetësimi kryesor i Dhomës lidhur me besueshmërinë e Dragan Jashoviqit lidhet me mënyrën se si kreu punën e tij dhe, në veçanti, rrethanat e grumbullimit të "informacionit" për të cilin dëshmoi. Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Dragan Jashoviqi u ballafaqua me një sasi të konsiderueshme materialesh, ndër të cilat dëshmi gojore të dëshmitarëve të tjerë,[41] dëshmi dokumentare[42] dhe një sërë deklaratash sipas Rregullës 92*bis*,[43] të cilat përmbajnë akuza për arrestim, marrje në pyetje, keqtrajtim dhe tortura në stacionin e policisë ku Dragan Jashoviqi shërbente. Shumë prej këtyre dëshmive përmendin drejtpërsëdrejti Dragan Jashoviqin, dhe dëshmitë tregojnë një sërë përputhjesh bindëse.[44] Megjithëse Dragan Jashoviqi hodhi poshtë tërë akuzat kundër tij, Dhoma është e bindur se rezultati i tërësisë së këtyre dëshmive të marra bashkërisht, ngre dyshime të rënda për besueshmërinë e tij të përgjithshme. Si pasojë, Dhoma nuk ka qenë e gatshme të pranojë si të besueshme dëshminë e Dragan Jashoviqit e cila bazohet mbi informacion "të nxjerrë" nga personat

[37] Vendimi mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Zbulimin e Vonuar dhe të Paplotë të Materialit, 7 qershor 2005, paragrafët 22-25.
[38] Vendimi mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Zbulimin e Vonuar dhe të Paplotë të Materialit, 7 qershor 2005, paragrafët 22-25.
[39] Dragan Jashoviqi, T 5331.
[40] Dragan Jashoviqi, T 5198-5199.
[41] *Shih* L96, T5420-5422.
[42] Shifrat e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, duke përfshirë një listë prej 371 viktimash të pretenduar të keqtrajtimit në stacionin policor ku Dragan Jashoviqi punoi në vitet 1991-1999, T 5341-5344.
[43] Prova materiale DM 12, Prova materiale DM 16, Prova materiale DM 17, Prova materiale DM 18.
[44] Prania dhe përdorimi i "shkopinjve policorë", L96, T 5420-5422, Dragan Jashoviqi, T 5343; T 5348; Prova materiale DM18; prania dhe përdorimi i shkopinjve të tipit bejzboll, T 5348; Prova materiale DM 16; Prova materiale DM 17; nënshkrimi i detyruar i deklaratave, L96, T 2540-2542; Prova materiale DM 16, Prova materiale DM 17.

që i kishte marrë në pyetje, dhe e trajton pjesën tjetër të dëshmisë së këtij dëshmitari me kujdes maksimal.

28. L64 u shpall dëshmitar bashkëpunues me urdhër të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 16 tetor 2003.[45] Ky Urdhër shfuqizoi akuzat e atëhershme kundër L64-ës për mbajtjen e paligjshme të armëve të zjarrit dhe për posedim të heroinës. L64 u lirua nga paraburgimi në lidhje më këto akuza dhe familja e tij u zhvendos jashtë Kosovës.[46] Mbrojtja sugjeron se L64, i motivuar për të bashkëpunuar prej "joshjeve" të sapopërmendura, e përshtati dëshminë e tij në përputhje me pretendimet e Prokurorisë.[47] Dhoma thekson se kushtet për shfuqizimin e Urdhrit të përcaktuar në atë dokument, veçanërisht dispozita mbi dhënien e dëshmisë së rreme, përbëjnë kundërpeshë ndaj këtij sugjerimi, megjithëse nuk dihet në çfarë mase. Gjithashtu Dhoma thekson se një pjesë e madhe e dëshmisë së L64-ës për Llapushnikun, veçanërisht deklaratat dhënë hetuesve të Zyrës së Prokurores më 25 maj 2003 dhe më 17 dhe 18 qershor 2003, u dha para arrestimit të tij më 13 qershor 2003 dhe para Urdhrit i cili i akordoi statusin e dëshmitarit bashkëpunues. Mirëpo, në vlerësimin e besueshmërisë së përgjithshme të këtij dëshmitari, Dhoma është e mendimit se precedentët penalë të L64-ës[48], sjellja e tij kriminale[49], dhe historia e përdorimit të droges[50] nga ana e tij, ndikojnë shumë negativisht në vlerësimin e besueshmërisë së L64-ës. Dhoma ka marrë parasysh edhe akuzat e bëra kundër L64-ës lidhur me veprimet e tij si anëtar i UÇK-së gjatë periudhës kohore që lidhet me Aktakuzën, dhe në kamp-burgun e Llapushnikut.[51] Këta faktorë në tërësi i japin Dhomës një përshtypje tepër negative për besueshmërinë e këtij dëshmitari. Dhoma nuk ka qenë e gatshme të shfrytëzojë vetëm dëshminë e L64-ës lidhur me ndonjë aspekt material dhe u ka dhënë peshë vetëm atyre pjesëve të dëshmisë së tij të cilat konfirmohen në ndonjë element të caktuar material prej dëshmive të tjera, të pranuara nga Dhoma.

29. Edhe Ramiz Qeriqi, me pseudonimin Luani, ishte anëtar i UÇK-së gjatë tërë periudhës që mbulohet nga Aktakuza dhe në prill 2003 u thirr si i dyshuar nga Zyra e Prokurores.[52] Gjatë kohës së procesit gjyqësor kundër këtij dëshmitari nuk ishin ngritur akuza zyrtare. Dhoma u informua se nuk ishte bërë asnjë marrëveshje formale dhe atij nuk iu imponuan sanksione apo masa të veçanta lidhur me dëshminë e tij. Kur dëshmoi në këtë gjyq, Ramiz Qeriqi tha se besonte që ai nuk ishte më

[45] Prova materiale P166.
[46] L64, T 4688-4692.
[47] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 808.
[48] L64, T 4319-4320; 4690.
[49] Tregti armësh, L64, T 4318-4320; 4622; 4815-4820. Tregti heroini, L64, T 4325-4328.
[50] L64, T 4324-4328; 4427-4436.
[51] L64, T 4832-4834; 4839-4844; 4867-4869.
[52] Ramiz Qeriqi, T 3542.

i dyshuar.[53] Megjithëse Mbrojtja kërkoi që Dhoma t'a ftonte Prokurorinë që të qartësonte pozicionin e saj lidhur me këtë dëshmitar, Dhoma e hodhi poshtë këtë kërkesë.[54] Gjatë procesit gjyqësor u bënë akuza të rënda kundër Ramiz Qeriqit. Mbrojtja pretendon se pjesëmarrja e Ramiz Qeriqit në rrëmbimin e serbëve dhe të bashkëpunëtorëve të serbëve, disa prej të cilëve mund të jenë çuar në kamp-burgun e Llapushnikut, e bëri atë "derëtarin e krimeve të pretenduara në Aktakuzë."[55] Megjithëse Ramiz Qeriqi e mohoi krejtësisht fajësinë, Prokuroria pranon se ka mjaft prova materiale që tregojnë të kundërtën dhe se Ramiz Qeriqi mund të mos ketë treguar të vërtetën mbi përfshirjen e tij në rrëmbimet.[56] Megjithatë, Prokuroria parashtron se Ramiz Qeriqi dha dëshmi bindëse lidhur me zhvillimin dhe strukturën e UÇK-së.[57] Në lidhje me këtë Prokuroria pretendon se Ramiz Qeriqi nuk ka arsye që të gënjejë dhe ai ka krenari të njëmendtë për arritjet e UÇK-së.[58] Sipas mendimit të Dhomës, duket qartë se dëshmia e Ramiz Qeriqit u motivua nga dëshira e tij për të shmangur vetëfajësimin. Mirëpo shtrohet çështja thelbësore nëse motivimi i tij për të shmangur vetëfajësimin mund të ketë çuar në fajësimin e rremë të ndonjërit prej të Akuzuarve nëpërmjet dëshmisë së trilluar. I pyetur për këtë gjatë dëshmisë së tij, Ramiz Qeriqi pretendoi energjikisht se në dëshminë e tij nuk kishte fajësuar askënd: "Nuk kam akuzuar askënd dhe nuk kam parë askënd duke kryer krim. Me sa më kujtohet, s'kam akuzuar askënd; veç kam thënë të vërtetën për UÇK-në, për atë që pashë me sy."[59] Sipas vlerësimit të Dhomës, disa pjesë të dëshmisë së këtij dëshmitari janë ndikuar nga motivi i tij për të shmangur vetëfajësimin. Dhoma nuk i përdor këto pjesë të dëshmisë. Megjithëse duket se besueshmëria e aspekteve të tjera të dëshmisë së tij nuk është cënuar, për hir të kujdesit Dhoma i ka shqyrtuar këto aspekte me vëmendje të madhe dhe rrjedhimisht e ka kufizuar përdorimin e kësaj dëshmie prej saj. Dhoma e konsideron Ramiz Qeriqin si dëshmitar me besueshmëri të pakët.

30. Më tej, Mbrojtja e Haradin Balës parashtron se një grindje familjare mund të ketë ndikuar ngjarjet në kamp-burg dhe besueshmërinë e dëshmive të L10-ës, L06-ës, L04-ës dhe L12-ë. Këta katër dëshmitarë janë secili anëtarë të një familjeje të gjerë. Mbrojtja e Haradin Balës pretendon se disa anëtarë të familjes u përfshinë në një mosmarrëveshje për tokë me anëtarë të një familjeje tjetër.[60]

[53] Ramiz Qeriqi, T 3699.
[54] T 3648-3649.
[55] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 144.
[56] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 29.
[57] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 29.
[58] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 29.
[59] Ramiq Qeriqi, T 3718.
[60] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 653-661.

31. Ka dëshmi për një mosmarrëveshje të tillë si edhe për faktin se kjo mosmarrëveshje nuk ishte zgjidhur në periudhën e mbuluar nga Aktakuza.[61] Megjithatë nuk është treguar dhe provuar ekzistenca e një lidhjeje midis kësaj mosmarrëveshjeje afatgjatë ndërfamiljare dhe ngjarjeve në Llapushnik. Mbrojtja e Haradin Balës parashtroi dy çështje të paprovuara. Parashtrohet se në një deklaratë që iu dha hetuesve të Tribunalit, L10 pranoi se kishte një lidhje.[62] Por ai nuk dëshmoi kështu para Dhomës dhe ajo deklaratë nuk është pjesë e provave. Së dyti, thuhet se ka një lidhje midis një familjeje në konflikt dhe të Akuzuarit Haradin Bala, me pseudonimin Shala.[63] Megjithatë, e vetmja dëshmi për këtë nuk e tejkalon dëshminë e L12-ës, i cili tha se Ramadan Behluli ishte shok i kunatit të Shalës.[64]

32. Megjithëse Dhoma pranon se në kulturën e shqiptarëve të Kosovës lidhjet familjare kanë një rëndësi të veçantë dhe se bashkësia luan një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis familjeve,[65] dëshmitë për këtë rast nuk provuan se Dhoma nuk duhet të pranojë dëshmitë e katër dëshmitarëve të lidhur me një familje në konflikt për shkak të një mosmarrëveshjeje të paraluftës me një familje tjetër me të cilën, më së shumti, thuhet se i Akuzuari Haradin Bala kishte një lidhje për hir të një miqësie të pavërtetuar. Duke marrë parasysh këto rrethana, Dhoma nuk ka dyshim për besueshmërinë e këtyre katër dëshmitarëve.

33. Mbrojtja e Haradin Balës parashtron më tej se dëshmitë e katër dëshmitarëve të cilët kanë një lidhje më familjen në fjalë duhen hedhur poshtë apo nuk duhen shqyrtuar për shkak se banojnë afër njëri-tjetrit dhe kishin diskutuar për çështje që kanë lidhje me këtë proces para se të vinin në Tribunal për të dëshmuar.[66]

34. L10 tha se kishte diskutuar për ngjarjet e kamp-burgut me anëtarë të familjes së tij të cilët ishin në dijeni për të. Mirëpo gjatë pyetjeve nuk u bënë përpjekje për të përcaktuar nëse ndër këta persona ishin L06, L12 dhe L04.[67] L04-ës nuk i kujtohej ndonjë diskutim me L06-ën për përvojën e tij në kamp para se të vinte në Tribunal.[68] Gjatë dëshmive u pranua se, në një kohë të caktuar pas korrikut 1998, L10 kishte kërkuar dhe kishte marrë informacion nga babai i tij dhe nga L96 (jo i

[61] L06, T 986-987; L10, T 2905-2907; L12, T 1786-1788; 1831.
[62] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 654.
[63] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 660.
[64] L12, T 1847-1849.
[65] L12, T 1833-1836.
[66] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 670-672; 704-706; 728-731; 752.
[67] L10, T 3016-3017.
[68] L04, T 1226-1227.

asaj familjeje) për emrin e vërtetë të Shalës.[69] Edhe L04 e kishte mësuar emrin e vërtetë të Shalës nga djali i kushëririt të tij dhe nga një person tjetër (jo i asaj familjeje).[70]

35. Dhoma pranon se ka shumë mundësi që gjatë viteve pas korrikut 1998. katër burrat, të cilët ishin të burgosur, të kenë diskutuar me disa anëtarë të familjes së tyre. Kjo është e natyrshme, megjithëse Dhoma pranon se, siç u tregua në dëshmi, mund të ketë patur edhe ngurrim personal për të diskutuar hollësitë e këtij përjetimi sfilitës. Gjithashtu nuk do të ishte e habitshme që të ketë patur ndonjë bisedë midis njerëzve të thirrur për të dëshmuar para Tribunalit. Mirëpo as dëshmitë, as interpretimi i Dhomës për sjelljen e këtyre dëshmitarëve nuk tregojnë asgjë që mund të shërbente si arsye për të menduar se disa prej katër dëshmitarëve apo të gjithë dëshmitarët komplotuan, trilluan ose shtrembëruan dëshmitë e tyre lidhur me ngjarjet e Llapushnikut ose në malet e Berishës për shkak se ishin të një familjeje. Dhoma nuk është e bindur se ndershmëria e dëshmive të këtyre katër dëshmitarëve për përjetimet e tyre në Llapushnik dhe në malet e Berishës u ndikua nga ndonjë lidhje familjare apo nga ndonjë diskutim.

[69] L10, T 3024-3030.
[70] L04, T 1238-1241.

III. PËRMBAJTJE

A. Konteksti politik në Kosovë dhe dalja e UÇK-së

36. Krimet e pretenduara në Aktakuzë ndodhën në territorin e Kosovës, aktualisht krahinë e administruar prej Kombeve të Bashkuara brenda Unionit të Serbisë dhe të Malit të Zi, e cila kufizohet nga ana veriore dhe lindore me Republikën e Serbisë, nga ana jugore me Maqedoninë dhe Shqipërinë, dhe nga ana perëndimore me Shqipërinë dhe Malin e Zi.

37. Sipas Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("RSFJ") të vitit 1974, Kosova ishte krahinë autonome brenda Republikës së Serbisë dhe njësi përbërëse e RSFJ-së, e cila gëzonte kështu një masë të caktuar vetëqeverisjeje dhe autonomie.[71] Statusi i Kosoves si krahinë autonome brenda Republikës së Serbisë u njoh gjithashtu nga Kushtetuta e Republikës së Serbisë të vitit 1974, e cila, më tej, e shpalli autonominë e krahinës për të rregulluar disa çështje administrative dhe gjuhësore.[72]

38. Në nëntor 1988, Kuvendi i Serbisë propozoi amendamente në Kushtetutën e Serbisë të cilat kufizonin autonominë e Kosovës.[73] Amendamentet e propozuara shkaktuan një reagim të fortë publik, me demonstrata kundër propozimeve, ku morën pjesë një numër i madh personash.[74] Protestat u intensifikuan në shkurt 1989 kur shumë njerëz në Kosovë dolën në grevë apo shpallën greva urie.[75] Më 3 mars 1989, Kryesia e RSFJ-së deklaroi gjendjen e jashtëzakonshme. Disa ditë më vonë, Kuvendi i Kosovës u mblodh në Prishtinë dhe, ndër protesta dhe me një prani të shtuar ushtarake, miratoi amendamentet kushtetuese të propozuara.[76] Më 28 mars 1989, Kuvendi i Serbisë e ndryshoi Kushtetutën e Serbisë dhe kështu efektivisht e hoqi statusin autonom të Kosovës.[77]

39. Në vitin 1990, Kuvendi i Kosovës dhe qeveria krahinore u suprimuan.[78] Në mars 1990, Kuvendi i Serbisë miratoi një sërë masash të cilat çuan në heqjen nga puna të shqiptarëve të Kosovës nga institucionet politike dhe ekonomike dhe nga ndërmarrjet e mëdha ekonomike.[79]

---

[71] *Shih* Nenet 1, 2 dhe 4 e Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974.
[72] *Shih* Nenet 1, 147, 240, 291-293 e Kushtetutës së Republikës së Serbisë të vitit 1974.
[73] Prova materiale P201, f. 17; Fatmir Limaj, T 5862.
[74] Prova Materiale P201, f. 17; Fatmir Limaj, T 5862, 5865. *Shih* edhe Fadil Bajraktarin, T 6888.
[75] Prova Materiale P201, f. 17; Fatmir Limaj, T 5862-5863.
[76] Prova Materiale P201, f. 17; Fatmir Limaj, T 5865.
[77] *Shih* Prova Materiale P201, f. 17.
[78] Prova Materiale P201, f. 17.
[79] Prova Materiale P201, f. 17; Shukri Buja, T 3727-3729; Elmi Sopi T 6713-6715; Dr Zeqir Gashi, T 5665; Fatmir Limaj, T 5866-5868. Prova Materiale P178, f. 1; Prova Materiale DM 12, paragrafët 8 dhe 9.

Arsimimi në gjuhën shqipe, veçanërisht arsimimi i mesëm dhe i lartë, u kufizua.[80] Studentët dhe profesorët shqiptarë të Kosovës nuk lejoheshin të hynin në universitete dhe u detyruan kështu të organizonin një sistem paralel arsimor me klasa në shtëpi private.[81] U shtua numri i shkeljeve të të drejtave të njeriut kundër shqiptarëve të Kosovës.[82] Shqiptarët e Kosovës arrestoheshin dhe keqtrajtoheshin nga policia serbe.[83]

40. Më 2 korrik 1990, delegatët shqiptarë të Kosovës të Kuvendit të Kosovës u mblodhën jashtë ndërtesës së kuvendit dhe deklaruan se heqja e autonomisë së Kosovës ishte e paligjshme dhe se krahina do të mbetej në federatë vetëm nëse i jepej i njëjti status si republikat e tjera.[84] Kjo deklaratë u shpall e paligjshme nga autoritetet serbe,[85] por ajo provokoi një ndjenjë euforike ndër shqiptarët e Kosovës.[86]

41. Gjatë kësaj periudhe dolën në pah disa parti dhe lëvizje politike. Në vitin 1989 u krijua Lidhja Demokratike e Kosovës ("LDK"), një parti politike e cila mbështeste një zgjidhje paqësore për çështjen e Kosovës nëpërmjet dialogut.[87] Kryetari i saj ishte Ibrahim Rugova. Afërsisht në të njëjtën kohë, në vitin 1990, u themelua Lëvizja Popullore e Kosovës ("LPK"), pasardhëse e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës ("LPRK").[88] LPK-ja mbështeste një zgjidhje të çështjes së Kosovës nëpërmjet veprimeve aktive dhe nuk përjashtonte mundësinë e veprimeve të armatosura.[89] LPK-ja vepronte kryesisht ndër bashkësitë e shqiptarëve të Kosovës në vendet e Evropës perëndimore duke qenë se veprimtaritë e saj në Kosovë zhvilloheshin në ilegalitet.[90] Pas daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") në vitin 1997,[91] veprimtaritë e LPK-së u përqëndruan në mbështetjen e UÇK-së, politikisht dhe financiarisht.[92]

42. Në shtator 1991 në Kosovë u zhvillua një referendum për pavarësi, në të cilën popullata serbe nuk mori pjesë. Shumica dërmuese e shqiptarëve të Kosovës votuan për pavarësinë.[93] Në maj

[80] Prova Materiale P201, f. 18.
[81] Dr Zeqir Gashi, T 5598-5560; Fatmir Limaj, 5866-5868. *Shih* edhe Provën Materiale P201, f. 56.
[82] Prova Materiale P201, f. 18.
[83] Ruzhdi Karpuzi, T 3056-3057; Sylejman Selimi, T 2058-2059; Fatmir Limaj, T 5866; Prova Materiale P197, paragrafi 8; Prova Materiale DM12, paragrafe 17-22.
[84] Prova Materiale P201, f. 18; *Shih* edhe Fatmir Limaj, T 5866.
[85] Prova Materiale P210, f. 18.
[86] Fatmir Limaj, T 5866-5867.
[87] Prova Materiale P201, f. 50. *Shih* edhe Jakup Krasniqi, T 3298; Ramadan Behluli T 2653.
[88] Shukri Buja T 3724.
[89] Shukri Buja T 3731.
[90] Shukri Buja T 3731. *Shih* edhe Ramiz Qeriqi, T 3554-3556.
[91] *Shih ndër të tjera,* paragrafi 48.
[92] Shukri Buja, T 3732.
[93] Prova Materiale P201, f. 18; Fatmir Limaj, T 5875-5876.

1992 në Kosovë u zhvilluan zgjedhje dhe LDK-ja, e kryesuar nga Ibrahim Rugova, fitoi shumicën e votave.[94] Por Kuvendi nuk u mblodh kurrë.[95]

43. Ndërkohë, u formuan në mënyrë klandestine grupime ushtarake të veçanta. Në vitin 1991, Adem Jashari dhe një grupim politik i armatosur në Prekaz, komuna e Skënderajt, organizoi aksionin e parë të armatosur kundër forcave policore dhe ushtarake serbe.[96]

44. Pas përpjekjeve të dështuara për të aktivizuar punën e Kuvendit të ri të Kosovës u përforcua opozita politike kundër LDK-së dhe politikës së saj për një zgjidhje paqësore të çështjes së Kosovës.[97] Në periudhën 1991-1993, filluan të përforcoheshin lidhjet midis grupimeve ushtarake në formim e sipër dhe këtyre grupeve politike.[98] Në mars apo prill 1993, në Prekaz u mbajt një takim ku morën pjesë Adem Jashari si përfaqësues i grupimeve ushtarake, si dhe Jakup Krasniqi dhe përfaqësues të tjerë të grupeve politike.[99] Në atë takim u caktuan rolet e ardhshme të grupeve politike dhe ushtarake, dhe u themelua UÇK-ja.[100] Meghithëse krijimi i UÇK-se u shpall në vitin 1994,[101] ajo nuk u bë gjerësisht e njohur në Kosovë deri në 1997.[102]

45. UÇK-ja mbështeti zgjidhjen e çështjes së Kosovës nëpërmjet qëndresës aktive të armatosur kundër regjimit zyrtar.[103] Ajo u ndalua nga autoritetet zyrtare dhe veproi në mënyrë klandestine.[104] Veprimtaritë e saj kishin për qëllim që të përgatisnin qytetarët e Kosovës për një luftë çlirimtare, të mobilizonin popullatën në tërë territorin, dhe t'u jepnin përgjigje të armatosur akteve të dhunës nga autoritetet serbe.[105] Ajo konsiderohej nga autoritetet serbe dhe nga disa vëzhgues si organizatë terroriste,[106] kurse për mbështetësit e saj, UÇK-ja ishte një lëvizje guerilase çlirimtare e cila kishte në shënjestër policinë dhe ushtrinë serbe në Kosovë.[107]

46. Organi kryesor drejtues i UÇK-së ishte Shtabi i Përgjithshëm. Ndër të tjera, Shtabi i Përgjithshëm lëshonte deklarata në emër të UÇK-së për të informuar publikun mbi veprimtaritë e

[94] Fatmir Limaj, T 5876-5877; Prova Materiale P201, f.18.
[95] Fatmir Limaj, T 5881; Jakup Krasniqi, T 3296.
[96] Jakup Krasniqi, T 3293.
[97] Fatmir Limaj, T 5881.
[98] Jakup Krasniqi, T 3294-3296.
[99] Jakup Krasniqi, T 3306-3307.
[100] Jakup Krasniqi, T 3306-3307.
[101] Jakup Krasniqi, T 3296.
[102] *Shih* Rexhep Selimin, T 6592; Shukri Buja, T 3732.
[103] Jakup Krasniqi T 3303-3304. *Shih* edhe Sylejman Selimin, T 2058-2060.
[104] Jakup Krasniqi T 3307.
[105] *Shih* Jakup Krasniqin, T 3297; Fatmir Limaj, T 5884-5886.
[106] *Shih* John Crosland-in, T 1864. *Shih* edhe Fatmir Limajn, T 6200.
[107] Fatmir Limaj, T 6129-6130; 6200-6205; Jakup Krasniqi, T 3430-3431.

saj,[108] autorizonte operacione ushtarake[109] dhe u caktonte detyra individëve në organizatë.[110] Shtabi i Përgjithshëm vepronte në ilegalitet.[111] Në vitet e para të ekzistencës së UÇK-së, vetëm një numër i vogël anëtarësh ndodheshin në Kosovë; shumica vepronte nga vendet e Evropës Perëndimore, nga Shtetet e Bashkuara apo nga Shqipëria.[112] Megjithatë, në vitin 1996, Shtabi i Përgjithshëm i zgjeroi operacionet në Kosovë.[113] Që prej fillimit deri në mars 1998, komandanti i UÇK-së ishte Adem Jashari.[114] Pas vdekjes së Adem Jasharit më 5 mars 1998 apo rreth kësaj date, komandanti i UÇK-së u bë Azem Syla.[115] Në maj 1998, në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së bënin pjesë edhe anëtarët e mëposhtëm: Sokol Bashota, Rexhep Selimi, Lahi Brahimaj, Xhavid Zeka, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi.[116] Shtabi i Përgjithshëm nuk mblidhej rregullisht për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë dhe për faktin se ishte i detyruar të vepronte në ilegalitet.[117]

47. Midis 1994 dhe 1997, gjendja në Kosovë vazhdoi të keqësohej. Shqiptarët e Kosovës vazhduan të hiqeshin nga puna në institucione politike, ekonomike dhe arsimore.[118] U mbajtën demonstrata studentore.[119] Individë të përfshirë në jetën politike u çuan në stacione të policisë për t'u marrë në pyetje apo për "biseda informative."[120] Shumë shqiptarët të Kosovës po arrestoheshin. Thuhet se shpesh u keqtrajtuan nga policia.[121] Shumë prej tyre u akuzuan formalisht për mbajtjen e paligjshme të armëve. Mijëra persona braktisën Kosovën.[122] Përjashtimi i çështjes së Kosovës nga Marrëveshja e Paqes së Dejtonit në vitin 1995 i përforcoi më tej lëvizjet më radikale politike.[123]

48. Në fund të vitit 1997 dhe në fillim të vitit 1998 tensioni në Kosovë u shtua. Në nëntor 1997 gjatë një përleshjeje të armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së në fshatin Llaushë, u vra mësuesi Halil Geci.[124] Gjatë varrimit të tij, ku morën pjesë mijëra persona dhe që u transmetua në

[108] Jakup Krasniqi, T 3314-3315.
[109] Luftimet në Rahovec dhe në Bardhin e Madh për minierën e Obiliqit filluan pa lejen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Jakup Krasniqi, T 3415-3417, një tregues se zakonisht operacione ushtarake të këtij lloji duhej të autorizoheshin prej Shtabit të Përgjithshëm.
[110] *Shih më poshtë*, paragrafët 94-104.
[111] Jakup Krasniqi, T 3305.
[112] Jakup Krasniqi, T 3305-3306.
[113] Jakup Krasniqi, T 3309-3310.
[114] Jakup Krasniqi, T 3309-3310.
[115] Jakup Krasniqi, T 3310-3311.
[116] Jakup Krasniqi, T 3310-3311. *Shih* edhe Rexhep Selimin, T 6587-6588.
[117] Jakup Krasniqi, T 3310.
[118] Shukri Buja T 3727-3729, Prova materiale P197, paragrafi 11.
[119] Jan Kickert, T 659.
[120] *Shih* Shukri Bujën, T 3727.
[121] *Shih* Fatmir Limajn, T 5886-5888. *Shih* edhe Ramadan Behlulin, T 2648-2651, 2874-2876.
[122] Fatmir Limaj, T 5882-5883, Jakup Krasniqi, T 3298-3299.
[123] *Shih* për shembull, Jakup Krasniqin, T 3303-3305; Fatmir Limajn T 5882-5883.
[124] Fatmir Limaj, 6120

televizionin e Kosovës, u shfaqën në publik për herë të parë tre anëtarë të UÇK-së me maska.[125] Paraqitja e tyre bëri që UÇK-ja të njihej më gjerësisht në Kosovë.[126]

49. Më 28 shkurt dhe 1 mars 1998, forcat policore serbe sulmuan fshatrat Qirez dhe Likoshan, dy kilometra prej njëri-tjetrit, në zonën e Drenicës.[127] Gjatë sulmit u përdorën helikopterë, autoblinda ushtarake, mortaja dhe pushkë automatike.[128] Në të dy rastet, forcat policore të posaçme serbe sulmuan pa paralajmërim dhe qëlluan pa dallim mbi civilë.[129] Më 5 mars 1998 apo rreth kësaj date, forcat serbe të sigurisë sulmuan shtëpinë e udhëheqësit të UÇK-së, Adem Jashari, në Prekazin e Poshtëm, një fshat jo larg Likoshanit dhe Qirezit, gjithashtu në zonën e Drenicës.[130] Luftimet, në të cilat u përdorën autoblinda, zgjatën rreth 36 orë.[131] Dëshmitë tregojnë se gjatë sulmeve të shkurtit dhe të marsit 1998 u vranë 83 shqiptarë të Kosovës në zonën e Drenicës.[132] Ndër viktimat e vrara ishin të moshuar[133] dhe të paktën 24 gra dhe fëmijë.[134] Gjatë sulmit në Qirez një grua me barrë u qëllua në fytyrë[135] dhe në Prekazin e Poshtëm u vra një foshnje.[136] Shumë prej viktimave u qëlluan nga shumë afër.[137] Raportet tregojnë se shumë meshkuj u ekzekutuan pa gjyq para shtëpive të tyre dhe se disa viktima u vranë gjatë kohës kur ishin në arrest policor.[138] Gjatë sulmit kundër Prekazit të Poshtëm u vra tërë familja Jashari, me përjashtim të një vajze 11-vjeçare.[139]

50. Sulmet mbi tre fshatrat në zonën e Drenicës shënuan një pikë kthese në krizën e Kosovës. Mbështetja popullore për UÇK-në u shtua shumë. Dhjetra mijëra persona morën pjesë në varrimin e viktimave.[140] Fjalimi u mbajt nga Jakup Krasniqi i cili në atë kohë ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.[141] Shumë njerëz në Kosovë po anëtarësoheshin në UÇK-në dhe mbështetja për të ndër bashkësitë e shqiptarëve të Kosovës jashtë vendit po zgjerohej.[142]

---

[125] Fatmir Limaj, 6120; Jakup Kasniqi, T 3301-3303; Ramadan Behluli, T 2654-2655.
[126] Shukri Buja, T 3732. *Shih edhe* Ramadan Behlulin, T 2654-2655; Ruzhdi Karpuzi, T 3223.
[127] Prova materiale P212, nënndarje 5, f. 18.
[128] Prova materiale P212, nënndarje 5, f. 18.
[129] Prova materiale P212, nënndarje 5, f. 18.
[130] Prova materiale P212, nënndarje 5, f. 18, 27; Sylejman Selimi, T 2063-2064; Rexhep Selimi, T 6592. *Shih* edhe John Crosland-in, T 1858-1860; Prova materiale P92, nënndarje 2.
[131] John Crosland, T 1863.
[132] Prova materiale P212, nënndarje 5, f. 18. Shih edhe Jan Kickert, T 758-760.
[133] John Crosland, T 1863.
[134] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f. 18. Jan Kickert besoi se ndër viktimat ishin 10 fëmijë dhe 18 gra, T 758-759.
[135] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f. 18, 23; Jakup Krasniqi, T 3301-3303.
[136] Peter Bouckaert, T 5555-5556; Prova Materiale P212, nënndarje 5, f. 31.
[137] John Crosland, T 1863.
[138] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f. 20-21.
[139] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f. 18; Peter Bouckaert, T 5516-5517.
[140] Jakup Krasniqi dëshmoi se 200,000 persona morën pjesë në varrimin e viktimave në Likoshan dhe Qirez, T 3301-3303, 3386-3370. *Shih* edhe Peter Bouckaert, T 5516.
[141] Jakup Krasniqi, T 3368-3370; 3305-3306; Prova Materiale P141.
[142] Sylejman Selimi, T 2067, 2198; Rexhep Selimi, T 6592; Ruzhdi Karpuzi, T 3223; Fadil Kastrati, T 2590, 2622, Jan Kickert, T 720, Peter Bouckaert T 5516-5517; Shukri Buja, T 3734-3735; Fatmir Limaj, T 5901-5903.

51. Në mars 1998, një grup prej afërsisht 15 shqiptarësh të Kosovës me banim në Zvicër, ndër të cilët Ismet Jashari, i Akuzuari Fatmir Limaj, Hashim Thaçi, Agim Bajrami dhe Shukri Buja, u nisën për në Kosovë.[143] Ata udhëtuan me aeroplan në Tiranë, Shqipëri, dhe, të nesërmën, kaluan kufirin Shqipëri-Kosovë në këmbë, duke mbartur çanta të mbushura me municion.[144] Ata shkuan në zonën e Drenicës ku në rrethinën e Prekazit po vazhdonin luftimet, dhe, sipas tyre, ishte i vetmi vend ku mund të anëtarësoheshin në radhët e UÇK-së.[145] Në atë kohë po ktheheshin në Kosovë edhe shumë shqiptarë të tjerë të Kosovës.[146]

52. Ngjarjet në zonën e Drenicës në shkurt dhe mars 1998 shënuan një hap të ri në zhvillimin e konfliktit të Kosovës. Pas sulmeve në Drenicë forcat serbe filluan të përdornin pajisje dhe taktika tipike ushtarake.[147] Përleshjet midis forcave serbe dhe UÇK-së u intensifikuan dhe përfshinë zona më të gjera gjeografike.[148]

B. Zhvillimi i njësive të UÇK-së në krahina të ndryshme të Kosovës

53. Pas ardhjes së tyre në Kosovë në mars 1998, anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Shukri Buja, Fatmir Limaj, Hashim Thaçi, Fehmi Lladrovci dhe Agim Bajrami, u takuan në Ticë dhe në një bisedë trajtuan organizimin e UÇK-së. Shukri Buja kërkoi të dërgohej në komunat e Lipjanit dhe të Shtimes, të cilat ai i njihte më mirë.[149] Agim Bajrami u vendos në Kaçanik, kurse Fatmir Limaj në Malishevë.[150] Shukri Buja vendosi të fillonte organizimin e një lëvizjeje gueriljesh nga Mullopolci në komunën e Shtimes. Ai qëndroi aty gjatë marsit dhe prillit 1998.[151] Pas kthimit të tij në Kosovë, Ramiz Qeriqi ndërmori organizimin e një njësie në Kroimir.[152] Ismet Jasharit, me pseudonimin Kumanova, iu kërkua të organizonte një njësi të UÇK-së në Suharekë.[153] Në dëshminë e Shukri Bujës, më vonë Ismet Jashari u vendos në Luzhnicë dhe Kleçkë.[154] Agim Bajrami po organizonte një njësi në komunën e Kaçanikut.[155] Në prill 1998, Shukri Buja shkoi në Ferizaj për të ndihmuar

[143] Fatmir Limaj, T 5908-5909, 5919; Shukri Buja, T 3738-3739.
[144] Fatmir Limaj, T 5907; Shukri Buja, T 3739-3740.
[145] Fatmir Limaj, T 5910-5911.
[146] Shukri Buja, T 3739-3741.
[147] Peter Bouckaert, T 5516-5517.
[148] Peter Bouckaert, T 5516-5517.
[149] Shukri Buja, T 3746-3749, 3751-3751. Për vendndodhjen e toponimeve të përmendura në këtë pjesë, *Shih* Shtojcat II dhe III.
[150] Shukri Buja, T 4092-4093, Rexhep Selimi, T 6593-6594.
[151] Shukri Buja, T 3756; 3761.
[152] Ramiz Qeriqi, T 3563; 3565-3566; Shukri Buja, T 3812.
[153] Shukri Buja, T 3928.
[154] Shukri Buja, T 3794; 3812.
[155] Shukri Buja, T 3768-3769.

Imri Llazin në organizimin e një njësie gueriljesh në komunën e Ferizajt.[156] Në maj 1998, përfundoi procesi i themelimit të njësisë së gueriljeve të Shtimes.[157]

54. Në maj 1998, Ramiz Qeriqi po organizonte njerëz në rrethinën e Kroimirit. Ai kishte ushtarë në pikat e luftimeve në Carralevë, Zborc, Fushticë dhe Blinajë. Në Pjetërshticë kishte kazerma.[158] Ramadan Behluli komandonte gjashtë ushtarë në Pjetërshticë.[159] Anëtarë të UÇK-së hapën llogore në rrugën kryesore nga Carraleva në Pjetërshticë dhe ndërtuan bunkerë.[160] Po pranoheshin ushtarë të rinj. Në fillimin e qershorit 1998, në rrethinën e Kroimirit ishin afërsisht 70 deri 100 anëtarë të UÇK-së.[161] Në fund të majit 1998, njësia e Kroimirit u emërtua "Sokoli" apo "Petriti".[162] Shukri Buja dëshmoi se në qershor 1998, pas krijimit të asaj njësie, një numër personash donin të anëtarësoheshin në UÇK-në, gjë që çoi në krijimin e një njësie tjetër në Pjetërshticë, e cila përfshinte edhe rrethinën e Zborcit.[163] Deri më 17 qershor 1998, u bënë gjithsej 17 ushtarë nën komandën e Ramadan Behlulit.[164] Në fund të majit 1998, Shukri Buja mori përsipër komandën e rrethinës së Kroimirit.[165] Ramiz Qeriqi u bë zëvendësi i tij.[166] Në qershor 1998, u themeluan njësitë e UÇK-së edhe në Fushticë dhe Blinajë.[167] Më tej, siç do të përshkruhet më vonë në këtë vendim, u formuan disa njësi në rrethinën e Llapushnikut.[168]

55. Sylejman Selimi dëshmoi se në fund të majit 1998, ai u emërua komandanti i zonës së parë operative, zonës së Drenicës.[169] Shtabin e kishte në Likoc.[170] Nga maji 1998 e më tej, numri i ushtarëve nën komandën e Sylejman Selimit u shtua nga rreth 200-300 deri në më shumë se njëmijë në fund të vitit 1998.[171] Rexhep Selimi tha se zona operative e Drenicës ishte më e përparuar se zonat e tjera. Mënyra e strukturimit të saj u bë shembull për strukturimin e zonave të tjera.[172]

---

[156] Shukri Buja, T 3768-3769; 3772.
[157] Shukri Buja, T 3777.
[158] Ramiz Qeriqi, T 3577.
[159] Ramadan Behluli, T 2659-2660.
[160] Ramadan Behluli, T 2661-2663; Ramiz Qeriqi, T 3575.
[161] Ramiq Qeriqi, T 3575.
[162] Shukri Buja, T 3777-3778.
[163] Shukri Buja, T 3777-3781.
[164] Ramadan Behluli, T 2659-2660; 2666.
[165] Ramiz Qeriqi, T 3578.
[166] Ramadan Behluli, T 2667.
[167] Shukri Buja, T 3789.
[168] *Shih më poshtë*, paragrafi 702.
[169] Sylemjan Selimi, T 2070-2072. Fjalët "zonë" dhe nënzonë" përdoren me të njëjtin kuptim në këtë vendim në përputhje me dëshmitë e dhëna. Jakup Krasniqi tha se këto dy fjalë kishin të njëjtën kuptim; T 3479.
[170] Sylejman Selimi, T 2072-2075.
[171] Sylejman Selimi, T 2075-2076
[172] Rexhep Selimi, T 6691.

56. Formimi i strukturës së UÇK-së duket se ishte një proces i ngadalshëm i ndikuar nga faktorët të pavarur nga udhëheqësit vendorë. Kishte vështirësi për lëvizjen nga një zonë në tjetrën për shkak të terrenit të thyer.[173] UÇK-ja kishte armatim të pamjaftueshëm. Jo çdo ushtar dispononte armë.[174] Shukri Buja u ngarkua me organizimin e një linje të furnizimit të armëve nga Shqipëria në Kosovë për komunat e Kaçanikut, Lipjanit, Shtimes dhe Ferizajt.[175] Zhvillimi i strukturës së UÇK-së u ndikua gjithashtu nga përleshjet e armatosura me forcat serbe.[176] Më 9 maj 1998 u zhvillua një betejë në rrethinën e Llapushnikut.[177] Më 29 maj 1998, UÇK-ja përsëri luftoi kundër forcave serbe në Llapushnik.[178] Më 14, 17 dhe 23 qershor 1998, pati përleshje midis forcave ndërluftuese në Carralevë.[179]

57. Bislim Zyrapi dëshmoi se në mes të qershorit filluan përgatitjet për strukturimin e zonës së Pashtrikut.[180] Shukri Buja dhe Jakup Krasniqi deklaruan se zona u krijua në korrik 1998.[181] Në dëshminë e tij, i Akuzuari Fatmir Limaj pranoi se zona e Pashtrikut kishte ekzistuar herët në korrik 1998.[182] Mirëpo një komunikatë e UÇK-së në maj 1998 kishte përmendur "nënzonën operative" të Pashtrikut.[183] Rexhep Selimi kërkoi ta shpjegonte këtë duke bërë një dallim midis "nënzonës operative" dhe "zonës". Ai shpjegoi se në atë kohë fjala "nënzonë operative" përdorej nga UÇK-ja në lidhje me një grupim gueriljesh të përbërë nga grupe të vogla që vepronin në disa zona.[184] Në qoftë se ky shpjegim është i besueshëm, atëhere përdorimi i kësaj fjale në komunikatë mund të mos ketë lidhje me "zonën" e mëvonshme dhe më të zhvilluar të Pashtrikut, siç u përshkrua nga dëshmitarët e tjerë. Rexhep Selimi e përcaktoi kohën e strukturimit të zonës së Pashtrikut në fillim të gushtit 1998.[185] Kjo nuk përputhet me dëshmitë e tjera që lidhen me këtë çështje. Në dëshminë e tij, Rexhep Selimi duket se e lidh strukturimin e zonave me krijimin e brigadave.[186] Mirëpo, dëshmitë e tjetra tregojnë se këta dy zhvillime ishin të ndarë prej njëri tjetrit, duke qenë se brigadat u krijuan më vonë se zonat operative.[187] Për këtë arsye, Dhoma nuk e pranon dëshminë e Rexhep Selimit kur thotë se strukturimi i kësaj zone nuk filloi para gushtit 1998.

[173] Shukri Buja, T 3769-3772.
[174] Sylejman Selimi, T 2188.
[175] Shukri Buja, T 3773-3774.
[176] Rexhep Selimi, T 6594-6595.
[177] *Shih më poshtë*, paragrafët 76 dhe 77.
[178] Ramiz Qeriqi, T. 3573.
[179] *Shih më poshtë*, paragrafët 156 dhe 157.
[180] Bislim Zyrapi, T. 6825.
[181] Shukri Buja, T 3989; Jakup Krasniqi, T 3479-3482.
[182] Fatmir Limaj, T 5963.
[183] Prova Materiale P49; përkthim anglisht – Prova Materiale P48, f. U0038573.
[184] Rexhep Selimi, T 6651-6652.
[185] Rexhep Selimi, T 6687-6688.
[186] Rexhep Selimi, T 6599, 6601-6602.
[187] *Shih më poshtë*, paragrafi 64.

58. Fatmir Limaj dhe Shukri Buja deklaruan se komandanti i parë i zonës së Pashtrikut u emërua Musë Jashari.[188] Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi dëshmuan gjithashtu se Musë Jashari ishte komandanti i asaj zone para se të zëvendësohej nga Ekrem Rexha dhe, më vonë, nga Tahir Sinani.[189] Jakup Krasniqi përcaktoi se Musë Jashari komandoi zonën e Pashtrikut midis korrikut dhe nëntorit 1998.[190] Gjatë një interviste paragjyqësore, Ramadan Behluli bëri të qartë se Fatmir Limaj ishte komandanti i zonës së Pashtrikut.[191] Por kur u pyet për këtë gjatë dëshmisë së tij, Behluli mohoi shprehimisht dijeninë e tij se kjo ishte gjendja në qershor dhe korrik 1998.[192] L95 deklaroi se kur e takoi Fatmir Limajn në Novosellë, ai dinte se Limaj ishte komandanti i zonës, territori i të cilës, sipas dëshmitarit, përputhej pak a shumë, të paktën me pjesë të zonës së Pashtrikut.[193] Sipas dëshmive të L95-ës dhe Fatmir Limajt takimi u zhvillua në fund të korrikut 1998.[194] Për arsye të shpjeguara më vonë,[195] del qartë se njohuritë e L95-ës ishin të mjaft të kufizuara në këtë pikë. Rrjedhimisht dëshmia e tij nuk zëvendëson dëshmitë përputhëse se Musë Jashari ishte komandanti i zonës së Pashtrikut.

59. Shukri Buja dëshmoi se në fillim të korrikut 1998, ishin tri nënzona: Pashtrik, Nerodime dhe Drenicë.[196] Pas një takimi me Jakup Krasniqin më 20 qershor 1998, Shukri Buja filloi të organizonte nënzonën operative të Nerodimes.[197] Më 6 korrik 1998, ai u bë komandant i asaj nënzone, e cila përfshinte komunat e Shtimes, Lipjanit, Ferizajt dhe Kaçanikut.[198] Shukri Buja deklaroi se në korrik 1998, nënzonat e Pashtrikut dhe të Nerodimes ndodheshin në të dyja anët e maleve të Berishës.[199] Komuna e Lipjanit ishte e ndarë midis këtyre dy zonave.[200]

60. Në dëshmitë e Shukri Bujës dhe të Sylejman Selimit, një pjesë e vijës ndarëse midis nënzonave të Drenicës dhe të Pashtrikut përputhej me rrugën kryesore Pejë-Prishtinë.[201] Ramadan Behluli vizatoi në një hartë kufijtë e zonës së tij, që, sipas shpjegimit të tij, pasqyronin gjendjen pas gushtit 1998. Kufiri i vizatuar nga Ramadan Behluli në rrethinën e Llapushnikut kalon përgjatë

[188] Fatmir Limaj, T 5963; Shukri Buja, T 4097.
[189] Jakup Krasniqi, T 3479-3482; Rexhep Selimi, T 6687-6688.
[190] Jakup Krasniqi, T 3479-3482.
[191] Prova materiale P121, f. 22-23.
[192] Ramadan Behluli, T 2770-2771.
[193] L95, T 4217-4218; 4286-4287.
[194] L95, T 4203-4212.
[195] *Shih më poshtë*, paragrafi 593.
[196] Shukri Buja, T 3797.
[197] Shukri Buja, T 3795-3796.
[198] Shukri Buja, T 3798; Ramiz Qeriqi, T 3594; Jakup Krasniqi, T 3470-3482.
[199] Shukri Buja, T 3988.
[200] Shukri Buja, T 4153-4155.
[201] Shukri Buja, T 4153-4155; Sylejman Selimi, T 2148-2150.

rrugës kryesore Pejë-Prishtinë.[202] L95 dëshmoi, megjithëse jo pa mëdyshje, se kufiri verior i zonës, shtabi i së cilës ndodhej në Kleçkë, kalonte përgjatë rrugës për në Prishtinë midis Arllatit dhe Komoranit.[203] Bislim Zyrapi dëshmoi se Llapushniku ndodhej në një moment të caktuar në zonën e Pashtrikut. Megjithatë, ai bëri të qartë se njohuritë e tij për organizimin e njësive në atë zonë ishin të kufizuara.[204] Oborri në Llapushnik ku, sipas Aktakuzës, funksiononte kamp-burgu, ndodhej në jug të rrugës kryesore.[205] Rrjedhimisht dëshmitë e këtyre dëshmitarëve tregojnë se kampi ndodhej në zonën e Pashtrikut. Megjithatë ka edhe dëshmi për një zonë tjetër. Jakup Krasniqi hodhi poshtë kategorikisht argumentin se Llapushniku ndodhej në zonën e Pashtrikut. Ai deklaroi se tërë komuna e Gllogocit, duke përfshirë Llapushnikun, ndodhej në zonën operative të Drenicës.[206] Fatmir Limaj e konfirmoi këtë dhe tregoi se kufijtë e zonave përputheshin me kufijtë e komunave.[207] Shukri Buja dëshmoi gjithashtu se zonat ishin organizuar sipas komunave dhe se çdo komunë kishte njësi.[208] Megjithatë duhet theksuar se vetë Shukri Buja dha një shembull të një kufiri midis dy zonave, i cili nuk përputhej me kufijtë e komunës, por e ndante komunën e Lipjanit.[209] Më tej, zonat nuk përputhen fare me komunat në hartën e krijuar në vitin 1998 nga Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar, saktësia e përgjithshme e së cilës u pranua nga Sylejman Selimi.[210]

61. Ka shumë dëshmi që tregojnë se kufiri midis zonave të përgjegjësisë së njësive të ndryshme kalonte përgjatë rrugës kryesore Pejë-Prishtinë.[211] Megjithatë ky nuk është tregues i një kufiri zonal përgjatë rrugës, sepse njësitë në të dyja anët e rrugës mund të ishin në të njëjtën zonë. Nuk është e pamundur që në një kohë të caktuar, kufiri midis zonës së Pashtrikut dhe zonës së Drenicës përputhej me rrugën kryesore. Por dëshmitë janë tepër të rralla dhe kundërthënëse, për të arritur në një përfundim të prerë. Gjithashtu, siç është treguar, në atë kohë struktura e UÇK-së ishte në krijim e sipër, gjë që e vështirëson veçanërisht caktimin e përpiktë të ndarjes territoriale të përgjegjësisë gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të strukturës. Në mbështetje të pretendimit që kufiri kalonte përgjatë rrugës, Prokuroria përmend ceremoninë e betimit në Llapushnik, ku mori pjesë Musë Jashari, komandanti i parë i zonës së Pashtrikut.[212] Mirëpo asgjë nuk sugjeron se në një ceremoni të tillë merrnin pjesë vetëm komandantë të së njëjtës zonë.

[202] Ramadan Behluli, T 2682-2684; Prova Materiale P119.
[203] L95, T 4220-4221.
[204] Bislim Zyrapi, T 6834-6835.
[205] Prova Materiale P4, foto 8; Ole Lehtinen, T 461-463.
[206] Jakup Krasniqi, T 3341-3345; 3471-3475; 3488-3491.
[207] Fatmir Limaj, T 5964-5967; 6575-6576; Prova Materiale DL7.
[208] Shukri Buja, T 3796.
[209] *Shih* paragrafin e mëparshëm.
[210] Prova Materiale 1, hartë 10; Sylejman Selimi T 2178-2179; Prova Materiale 1, hartë 4.
[211] Jakup Krasniqi, T 3403-3404; L64, T 4378-4385; Prova Materiale P170.

62. Gjatë verës së vitit 1998 forcat policore dhe ushtarake serbe nisën një ofensivë kundër njësive të UÇK-së për rimarrjen e kontrollit mbi territorin e "pushtuar" nga UÇK-ja. Më 19 korrik 1998, UÇK-ja luftoi me forcat serbe në Rahovec.[213] Më pas, Rahoveci u bë qyteti i parë nën kontrollin e UÇK-së, megjithëse vetëm për një periudhë të shkurtër sepse u rimor shpejt.[214] Një betejë tjetër midis UÇK-së dhe forcave serbe ndodhi më 25 dhe 26 korrik 1998, përsëri në rrethinën e Llapushnikut.[215] Në të njëjtën kohë, më 25 korrik 1998, ushtarë të UÇK-së nën komandën e Ramiz Qeriqit mbrojtën Carralevën prej një ofensive tjetër serbe. Në fund, serbët u ndalën në Zborc.[216] Ecuria e ofensivës serbe në verë të vitit 1998 shkaktoi ikjen e shumë njerëzve prej vendbanimeve të tyre. Shpërngulja filloi në mes të korrikut 1998, veçanërisht në Rahovec. Në fshatrat e Kishnarekës, Nekocit, Bajicës, Shalës, dhe Kroimirit ishin rreth gjashtëdhjetë ose shtatëdhjetë mijë persona të zhvendosura.[217] Human Rights Watch vlerësoi se në atë periudhë në Kosovë u shpërngulën të paktën 300,000 persona.[218]

63. Në fund të gushtit 1998, ishin shtatë zona të UÇK-së.[219] Zona a Pashtrikut përfshinte komunat e Malishevës, Rahovecit, Prizrenit, Sharrit, ish-Dragashit, dhe Suharekës.[220] Zona e Dukagjinit përfshinte komunat e Istogut, Pejës, Deçanit, Gjurakocit dhe pjesë të komunës së Klinës. Ajo komandohej nga Ramush Haradinaj.[221] Të tjerat ishin zonat e Nerodimes, Shalës, Llapit dhe Karadakut.[222]

64. Pas ofensivës së 25 dhe 26 korrikut 1998, u formuan brigada dhe batalione.[223] Si komandant zone, Sylejman Selimi u ngarkua me themelimin e brigadave në Drenicë nga pikat dhe njësitë ekzistuese.[224] Ai themeloi Brigadën 111 e cila veproi në Likoc, si dhe Brigadat 112, 113 dhe 114.[225] Brigada 121 u formua dikur në gusht 1998.[226] Fatmir Limaj deklaroi se kjo ishte propozuar tashmë më 6 gusht 1998. Por zbatimi u pezullua për njëzet ditë për shkak të një ofensive nga forcat

---

[212] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, shënim 143.
[213] L64, T 4533-4534; Peter Bouckaert, T 5578.
[214] Jakup Krasniqi, T 3415-3417; 3486-3488.
[215] *Shih më poshtë*, paragrafët 78-82.
[216] Ramadan Behluli, T 2818-2821.
[217] Jakup Krasniqi, T 3482-3484.
[218] Prova Materiale P212, nënndarja 3, f. 16; Peter Bouckaert, T 5582.
[219] Jakup Krasniqi, T 3468-3470.
[220] Jakup Krasniqi, T 3479-3482.
[221] Jakup Krasniqi, T 3479-3482.
[222] Jakup Krasniqi, T 3479-3482.
[223] Ramiz Qeriqi, T 3692; Bislim Zyrapi, T 6824.
[224] Jakup Krasniqi, T 3479-3482.
[225] Syleman Selimi, T 2076-2078; Rexhep Selimi, T 6601-6602.
[226] Shukri Buja, T 3989; Bislim Zyrapi, T 6831-6832.

serbe.[227] Kështu deklaroi edhe Ramadan Behluli duke thënë se Brigada 121 u krijua pas vdekjes së Kumanovës në fund të gushtit 1998.[228] Rexhep Selimi deklaroi se kjo ndodhi në fund të gushtit apo në shtator.[229] Megjithatë ekziston një shkresë emërimi për Ramiz Qeriqin "sipas vendimit të komandës së Brigadës 121" e cila mban datën 16 gusht 1998.[230] Sipas përfundimit të Dhomës, kjo tregon se brigada tashmë ekzistonte para datës 16 gusht 1998. Gjithsesi, duke qenë se data e saktë e krijimit të Brigadës 121 nuk ka shumë lidhje me akuzat kundër të Akuzuarit, mjafton të nxirret si përfundim se kjo ndodhi në gjysmën e dytë të gushtit 1998. Brigada 121 ishte brenda nënzonës së Pashtrikut.[231] Në dëshminë e Jakup Krasniqit, territori brenda kufijve të Brigadës 121 nuk ishte i njëjtë me nënzonat para gushtit 1998.[232] Prej pikës së luftimeve në Kroimir u krijua batalioni Ruzhdi Salihu, pjesë e Brigadës 121.[233] Si komandant i këtij batalioni u emërua Ramiz Qeriqi.[234] Përveç Brigadës 121 në zonën operative të Pashtrikut u formuan edhe brigadat 122 deri në 127. Zona e Dukagjinit kishte Brigadat 131 deri në 138, kurse zona e Shalës kishte Brigadat 141 dhe 142. Zona e Llapit kishte Brigadat 151 deri në 153. Zona e Nerodimes kishte Brigadat 161 dhe 162. Zona e Karadakut kishte Brigadat 171 dhe 172.[235]

65. Megjithëse formimi i brigadave dhe batalioneve në kohë të ndryshme gjatë gysmës së dytë të vitit 1998 përfaqëson një hap të mëtejshëm dhe me rëndësi në zhvillimin e vazhdueshëm të një strukture më të formalizuar dhe më tipike ushtarake nga ana e UÇK-së, për sa i përket forcës numerike nuk duhet menduar se këto brigada dhe batalione ishin si brigadat dhe batalionet e ushtrive bashkëkohore evropiane. Në zanafillë shumë brigada dhe batalione të UÇK-së nuk ishin më shumë se një bërthamë ku ushtarët rekrutoheshin dhe transferoheshin në kohë të ndryshme; zakonisht ato përfshinin pikat ekzistuese të UÇK-së në një zonë të caktuar. Ritmi i rritjes së tyre numerike duket se ka ndryshuar mjaft nga vendi në vend.

C. Marrja e Llapushnikut nga UÇK-ja në maj 1998

66. Fshati Llapushnik ndodhet në komunën e Gllogocit, në Kosovën qendrore. Ai ndodhet në një grykë në të dyja anët e rrugës kryesore Pejë-Prishtinë, e cila është një ndër rrugët kryesore midis Prishtinës dhe pjesës perëndimore të Kosovës e Shqipërisë. Gryka e Llapushnikut kishte rëndësi

[227] Fatmir Limaj, T 6012; 6014-6017; 6088.
[228] Ramadan Behluli, T 2765-2766.
[229] Rexhep Selimi, T 6674.
[230] Prova Materiale P155; Ramiz Qeriqi, T 3593.
[231] Shukri Buja, T 4152-4153.
[232] Jakup Krasniqi, T 3488.
[233] Ramadan Behluli, T 2891-2892.
[234] Ramiq Qeriqi, T 3593; 3668; Prova Materiale P155.
[235] Rexhep Selimi, T 6601-6602.

strategjike për UÇK-në; kontrolli i grykës i jepte UÇK-së një korridor për transportimin e armëve dhe furnizimeve nga Shqipëria dhe mundësonte lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe të ushtarëve.[236] Gryka e Llapushnikut ishte me rëndësi strategjike edhe për forcat serbe duke qenë se jepte mundësi për të depërtuar në fshatrat në kufi me zonën e Drenicës,[237] dhe për të penguar UÇK-në që të zotëronte epërsinë e dukshme të sapopërmendur.

67. Më 9 maj 1998, forcat serbe sulmuan fshatrat e grykës së Llapushnikut, ndër të cilët Llapushnikun, Komoranin dhe Krajkovën.[238] Më 8 maj 1998 rreth orës 8:00, forcat policore serbe u vendosën në Gurin e Gradinës,[239] një shkëmb në Llapushnik, në jug të rrugës Pejë-Prishtinë, dhe në një shkollë fshati nga hapën zjarr.[240] Megjithëse në dëshmi ka mospërputhje për armët e përdorura në betejë, nga të pranishmit del e qartë se forcat serbe ishin të pajisura shumë më mirë[241] dhe kishin epërsi të dukshme numerike mbi UÇK-në në ate zonë.

68. Brenda një kohe të shkurtër fshatrat përreth mësuan për luftimet në Llapushnik. Ruzhdi Karpuzi dëshmoi se më 8 maj 1998 – tërë dëshmia tjetër tregon se ishte data 9 maj – ai nga fshati Shalë, rreth 9 km nga Llapushnikut, kishte dëgjuar të shtëna të cilat sipas tij vinin nga drejtimi i Komoranit dhe Nekocit. Ai shkoi aty dhe pa se luftimet po zhvilloheshin në Llapushnik.[242] Ruzhdi Karpuzi shkoi afër fshatit Kishnarekë dhe prej andej mori rrugën nëpërmjet maleve për në Llapushnik. Gjatë rrugës, hasi pesë anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Ymer Alushanin, me pseudonimin Vogëlushi, komandant i UÇK-së[243] nga Komorani, Enver Mulakun dhe Ramadan Zogun, të cilët po luftonin forcat serbe.[244] Ruzhdi Karpuzi vendosi t'u bashkohej dhe luftoi me ata në rrugën Pejë-Prishtinë.[245]

[236] Sylejman Selimi T 2091-2095, 2147. Bislim Zyrapi dëshmoi se Llapushniku ishte pozicion i rëndësishëm për UÇK-në sepse Gryka e Llapushnikut ishte vendi ku rruga Prishtinë-Pejë mund të bllokohej, T 6856. *Shih* edhe Bislim Zyrapin, T 6858. Prova materiale P44, në një intervistë Fatmir Limaj, thotë: "Mbajtja e grykës së Llapushnikut kishte një domethënie të veçantë për ushtrinë dhe popullin tonë sepse kjo grykë ia ngriti rëndësinë e ushtrisë sonë. Kjo grykë bëri të mundur lëvizjen e popullatës dhe armatosjen e saj masivisht dhe u bë pikë organike lidhëse për territoret e çliruara."
[237] Sylejman Selimi T 2091-2095, T 2150-2152.
[238] Sylejman Selimi, T 2091. *Shih* edhe L64, T 4345.
[239] Elmi Sopi, T 6720-6721.
[240] Elmi Sopi, T 6720-6721.
[241] Sipas dëshmisë së Elmi Sopit, një helikopter i forcave serbe fluturoi mbi fshatin (T 6721), kurse të tjerët dëshmuan se gjatë betejës së Llapushnikut, forcat serbe përdorën artileri dhe armë të tjera të rënda. Ruzhdi Karpuzi, T 3064, Fadil Kastrati, T 2594; Ramiz Qeriqi, T 3569-3571.
[242] Ruzhdi Karpuzi, T 3062-3063; 3225.
[243] L64 dëshmoi se Ymer Alushani ishte komandant i njësisë Zjarri, T 4335.
[244] Ruzhdi Karpuzi, T 3063-3065.
[245] Ruzhdi Karpuzi, T 3063-3065.

69. Elmi Sopi tha se më 9 maj 1998 rreth orës 11:00, Ymer Alushani arriti në Llapushnik me një grup prej shtatë apo tetë ushtarësh të UÇK-së. Elmi Sopi i shpjegoi çfarë po ndodhte dhe e drejtoi grupin te shtëpia e Haxhi Gashit ku ishin tubuar disa të rinj nga fshati të cilët posedonin pushkë gjahtarësh.[246] Rreth një orë më vonë, një grup prej 16 ushtarësh zbriti nga malet dhe vëllai i Elmi Sopit i çoi në të njëjtën shtëpi, prej së cilës ushtarët u dërguan në vendet ku ishin forcat serbe.[247] Gjithashtu Elmi Sopi dëshmoi se rreth orës 13:00 ai dëgjoi një zhurmë dhe pa tym të zi në qiell dhe pas kësaj i pa forcat serbe duke u tërhequr në drejtim të Komoranit.[248] Pastaj shkoi në vendin e luftimeve dhe pa se si po digjej një autoblindë e tipit "Pinzgauer" e policisë serbe, me shumë municion.[249]

70. Edhe Ramiq Qeriqi[250] e Fatmir Limaj[251] dëshmuan se më 9 maj 1998 gjatë betejës së Llapushnikut, e panë Ymer Alushanin duke udhëhequr një grup prej 5-7 ushtarësh që luftonin forcat serbe në rrugën Pejë-Prishtinë.

71. Fadil Kastrati dëshmoi se më 9 maj 1998, ai ishte në fshatin e tij Blinajë, afër Vërshecit,[252] kur ai dhe disa burra të tjerë nga fshati i tij u thirrën në shtëpinë e Ymer Alushanit[253] në Komoran. Fadil Kastrati me shokë shkuan në këmbë nga Blinaja në Leletiq dhe pak më tutje, ata takuan Ymer Alushanin me një grup burrash dhe vazhduan bashkërisht me makinë për në Llapushnik.[254] Ata arritën në Llapushnik pak kohë para muzgut dhe zunë pozicion te shkëmbi në anën jugore të rrugës Pejë-Prishtinë ku më herët atë ditë kishin qenë forcat serbe.[255]

72. Dëshmia e L64-ës përshkruan ngjarje të ngjashme. Në pasditen e datës 9 maj 1998, atij iu tha se Ymer Alushani donte që ai të shkonte sa më shpejt në Llapushnik. Në muzg, L64 arriti në shtëpinë e Ymer Alushanit në Komoran. Ymeri vetë arriti më vonë dhe i shpjegoi L64-ës dhe ushtarëve të tjerë të UÇK-së të mbledhur aty se forcat serbe kishin sulmuar fshatrat e grykës së Llapushnikut, se ai kishte shkuar aty me disa shokë kur kishte dëgjuar të shtënat e para dhe se kishte patur luftime deri pasdite vonë. Ymer Alushani u tha atyre që të shkonin në Llapushnik para

[246] Elmi Sopi, T 6721.
[247] Elmi Sopi, T 6721-6722.
[248] Elmi Sopi, T 6722.
[249] Elmi Sopi, T 6722.
[250] Ramiz Qeriqi, T 3569-3571.
[251] Fatmir Limaj, T 5940.
[252] Fadil Kastrati, T 2631-2632.
[253] Fadil Kastrati, T 2591-2592.
[254] Fadil Kastrati, T 2632.
[255] Fadil Kastrati, T 2592-2593.

agimit.[256] L64 dhe të tjerë u nisën me këmbë rreth orës 02:00 të datës 10 maj 1998 dhe zunë pozicione në Gurin e Madh, një shkëmb në anën jugore të rrugës Pejë-Prishtinë.[257] Aty pritën deri në mesditën e datës 10 maj 1998. Forcat serbe nuk u kthyen. L64 shkoi për të verifikuar gjendjen në Komoran.[258]

73. Përveç personave që luftuan bashkë me Ymer Alushanin, erdhën edhe anëtarë të tjerë të UÇK-së për të ndihmuar në betejën e Llapushnikut. Ramiq Qeriqi dëshmoi se më 9 maj 1998 ai kishte dëgjuar nga Kleçka të shtëna të cilat vinin nga drejtimi i Llapushnikut dhe vendosi të shkonte atje për të ndihmuar në betejë.[259] Tre grupe, secili nga pesë antëtarë të UÇK-së, u nisën nga Kleçka për në Llapushnik.[260] Fatmir Limaj, Ramiq Qeriqi dhe Topi ishin në krye të secilit prej tre grupeve.[261] I pari, u nis grupi i drejtuar nga Fatmir Limaj. Kur dy grupet e tjerë erdhën në Llapushnik, rreth 20 minuta pas grupit të Fatmir Limajt, beteja po mbaronte. Një pincgauer serb po digjej.[262] Ramiz Qeriqi besonte se suksesin më të madh e arriti njësia Pëllumbi e UÇK-së nga ana veriore e rrugës Pejë-Prishtinë.[263]

74. I Akuzuari Fatmir Limaj dëshmoi se më 9 maj 1998, nga Kleçka ai dëgjoi një komunikim me radio midis anëtarëve të UÇK-së dhe, duke qenë se dialogu ishte i pakuptueshëm, vendosi të zbulonte çfarë kishte ndodhur.[264] Fatmir Limaj, i Akzuari Isak Musliu, Sadik Shala, Nexhim Shala dhe Bardhi udhëtuan së bashku me makinë për në malet e Berishës prej ku panë disa automjete serbe të cilat po u afroheshin forcave të UÇK-së në fshatin Gjergjicë, pranë Arllatit. Ata panë edhe forcat serbe duke qëlluar nga ana veriore e rrugës Pejë-Prishtinë.[265] Fatmir Limaj dhe grupi i tij vendosën të hynin në luftim dhe, pasi caktuan njërin prej tyre për komunikimet me radio, zbritën për në rrugën kryesore afër vendit ku po luftonin anëtarët e UÇK-së. Ata hapën zjarr dhe qëlluan mbi një pincgauer serb i cili duket se ishte mbushur me municion. Pincgaueri u hodh në erë dhe forcat serbe u tërhoqën në drejtim të Drenicës dhe të Komoranit.[266]

[256] L64, T 4344-4345.
[257] L64, T 4349-4350.
[258] L64, T 4350.
[259] Ramiz Qeriqi, T 3568.
[260] Ramiz Qeriqi, T 3568.
[261] Ramiz Qeriqi, T 3568.
[262] Ramiz Qeriqi, T 3568-3569.
[263] Ramiz Qeriqi, T 3568-3571.
[264] Fatmir Limaj, T 5936.
[265] Fatmir Limaj, T 5936-5937, 6075.
[266] Fatmir Limaj, T 5937-5938.

75. UÇK-ja ishte e suksesshme në zmbrapjen e sulmit serb në Llapushnik më 9 maj 1998 dhe forcat serbe u tërhoqën për në pozicionet e tyre të mëparshme në Komoran.[267] Sipas dëshmisë së Fatmir Limajt, pas largimit të forcave serbe, ai dhe grupi i tij u takuan me ushtarët e kryesuar nga Ymer Alushani, të cilët kishin luftuar në rrugën Gjergjicë-Llapushnik dhe ishin kthyer në Kleçkë.[268] Të nesërmen Ymer Alushani erdhi në Kleçkë bashkë me dy civilë dhe i tha Fatmir Limajt që civilët në Llapushnik ishin të shqetësuar se forcat serbe do të vinin përsëri dhe donin që ata të ktheheshin në fshat.[269] Një grup anëtarësh të UÇK-së shkoi atje vullnetarisht dhe në Llapushnik u dislokua një njësi e vogël.[270] Kjo dëshmi përputhet më dëshminë e Elmi Sopit i cili tha se pas tërheqjes së forcave serbe nga Llapushniku, ushtarët e UÇK-së donin të largoheshin, por se banorët e Llapushnikut kërkuan që ata të qëndronin aty për t'i mbrojtur dhe u ofruan atyre bujtje.[271] Ymer Alushani e diskutoi këtë me shokët e tij dhe ushtarët u vendosën nëpër shtëpitë e Llapushnikut.[272]

76. Megjithëse në dëshmitë e lartpërmendura ka mospërputhje kryesisht lidhur me kohën apo vendin e saktë të ngjarjeve të përshkruara, Dhoma është e mendimit se lidhur me marrjen e grykës së Llapushnikut nga forcat e UÇK-së është vërtetuar si më poshtë: Në mëngjesin e datës 9 maj 1998, forcat serbe hynë në grykën e Llapushnikut. Filloi një shkëmbim zjarri midis forcave serbe, luftëtarëve të UÇK-së dhe banorëve të Llapushnikut. Me të dëgjuar të shtënat, Ymer Alushani nga fshati fqinj Komoran dërgoi njerëz në fshatra të tjera përreth për të kërkuar burra që ishin anëtarë të UÇK-së apo që ishin gati të anëtarësoheshin në të. Ata shkuan në Llapushnik bashkë me një forcë të vogël të UÇK-së nga Komorani. Ata zunë pozicione në rrugën Pejë-Prishtinë dhe luftuan me forcat e atjeshme serbe. Ndërkohë, forcat e UÇK-së në Kleçkë mësuan për luftimin. Fatmir Limaj, bashkë me rreth 15 burra shkuan në Llapushnik dhe u përfshinë në luftimet kundër forcave serbe. Në pasditen e hershme, u godit dhe u hodh në erë pincgaueri serb në mes të fshatit. Kjo, siç duket, shkaktoi tërheqjen e forcave serbe. Gjatë pasdites dhe mbrëmjes së datës 9 maj 1998, në Llapushnik erdhën më shumë luftëtarë të UÇK-së. Pas këtyre ngjarjeve, me kërkesë të banorëve të fshatit Llapushnik, atje u dislokuan ushtarë të UÇK-së dhe u strehuan në shtëpi të ndryshme të fshatit.

77. Ushtarët e UÇK-së filluan menjëherë të hapnin llogore dhe të ndërtonin fortifikime të tjera në fshatin Llapushnik.[273] Llogoret u hapën gjatë natës me ndihmën e disa të rinjve nga fshati.[274]

[267] Ramiz Qeriqi, T 3571.
[268] Fatmir Limaj, T 5940.
[269] Fatmir Limaj, T 5940-5941.
[270] Fatmir Limaj, T 5941.
[271] Elmi Sopi, T 6722-6723.
[272] Elmi Sopi, T 6722-6723.
[273] Ruzhdi Karpuzi, T 3068-3069; Elmi Sopi, T 6723-6725.
[274] Elmi Sopi, T 6725, 6733.

Dëshmitë në tërësi vërtetojnë se prej asaj kohe, UÇK-ja qëndroi në Llapushnik deri më 25 apo 26 korrik 1998, kur forcat serbe i dëbuan nga fshati. Gjatë asaj periudhe u shtua shumë fuqia numerike e forcave të UÇK-së në fshat dhe përreth.

D. Rënia e Llapushnikut në korrik 1998

78. UÇK-ja e humbi kontrollin e Llapushnikut në betejën me forcat serbe më 25 dhe 26 korrik 1998. Në mbrëmjen e së premtes, 24 korrik 1998, forcat serbe iu afruan Llapushnikut në rrugën Pejë-Prishtinë, duke ardhur nga drejtimi i Prishtinës.[275] Elmi Sopi dëshmoi se rreth orës 04:00 të datës 25 korrik 1998, një shoku i tij i kishte telefonuar, dhe e kishte informuar se një kolonë tankesh dhe makinash serbe po lëvizte në rrugën Pejë-Prishtinë. Kolona ishte ndalur në postbllokun e Komoranit.[276] Në drejtim të grykës së Llapushnikut ishin nisur edhe forca të tjera serbe të dislokuara në Çukën e Komoranit, në antenën e Radio Prishtinës në Komoran dhe në pularinë e Krajkovës.[277]

79. Herët në mëngjesin e datës 25 korrik 1998, forcat serbe hapën zjarr mbi pozicionet e UÇK-së në Llapushnik.[278] Forcat serbe ishin të pajisura me raketa "Katjusha" dhe topa 220 mm.[279] Në operacionin u përdorën afërsisht 140 tanke serbe.[280] Në ofensivën serbe kundër Llapushnikut morën pjesë edhe njësi të posaçme të MPB-së, dy reparte me nga 200 ushtarë dhe një njësi antiteroriste.[281]Ekzistojnë edhe dëshmi mbi përdorimin e raketave tokë-tokë, të minahedhësve dhe të "helmeve kimike" gjatë ofensivës serbe në Llapushnik.[282] Forcat e UÇK-së ishin të pajisura me mortaja 60 mm, 82 mm dhe me disa 150 mm.[283] Ata shfrytëzuan edhe llogoret dhe fortifikimet e ndërtuara në fshat më parë.[284]

80. Luftimet zgjatën tërë ditën më 25 dhe më 26 korrik 1998. Në mbrëmjen e datës 25 korrik 1998, forcat serbe u afruan dhe UÇK-ja filloi të tërhiqej.[285] Tanket serbe po qëllonin mbi pozicionet e UÇK-së. UÇK-ja u përgjigji me zjarr mortajash. Të paktën një herë UÇK-ja arriti të godiste një

[275] Ruzhdi Karpuzi, T 3211-3213; Elmi Sopi, T 6736.
[276] Elmi Sopi, T 6736.
[277] Elmi Sopi, T 6736.
[278] L64, T 4551-4552; Dr Zeqir Gashi, T 5632; Elmi Sopi, T 6736.
[279] Elmi Sopi, T 6736; Prova Materiale P44 dhe Ole Lehtinen, T 576-579.
[280] Elmi Sopi, T 6736; Prova Materiale P44 dhe Ole Lehtinen, T 576-579.
[281] Philip Coo, T 5734-5736.
[282] Ruzhdi Karpuzi dëshmoi se forcat serbe përdorën predha të kaltërta për të përgjumur ushtarët, T 3221-3223. *Shih* gjithashtu Provën Materiale P44, Ole Lehtinen, T 576-579.
[283] Philip Coo, T 5734-5736; Elmi Sopi, T 6736-6737.
[284] Philip Coo, T 5734-5736; *Shih më sipër* edhe paragrafin 77.
[285] Ruzhdi Karpuzi, T 3211-3213; Elmi Sopi, T 6736.

tank serb.[286] Megjithatë, forcat e UÇK-së nuk ishin në gjendje t'i bënin ballë forcës së sulmit serb dhe më 26 korrik, tërë forcat e UÇK-së u tërhoqën nga Llapushnikut.[287] Gjatë betejës u vra Ymer Alushani, drejtues i UÇK-së.[288]

81. Gjithashtu më 26 korrik 1998, gati tërë popullata e Llapushnikut u largua nga gryka për në malet e Berishës, në veçanti drejt fshatrave Negroc, Arllat dhe Tërpezë.[289] Zeqir Gashi dëshmoi se ai dhe infermieret të cilat punonin në klinikun e tij ikën për në fshatin Berishë dhe prej andej për në Novosellë.[290] Sipas dëshmisë së Elmi Sopit, vetëm disa pleq që nuk mund të largoheshin, mbetën në shtëpitë e tyre, ku më vonë u vranë nga forcat serbe.[291]

82. Më poshtë në këtë vendim, Dhoma do të trajtojë pasojat e rënies së Llapushnikut për individët e mbajtur në kamp-burg.[292]

[286] Ruzdhi Karpuzi, T 3213-3214.
[287] Elmi Sopi, T 6736; Ruzhdi Karpuzi, T 3214; L64, T 4553.
[288] Dr Zeqir Gashi, T 5635; L64, T 4555-4556; Fatmir Limaj, T 5989.
[289] Elmi Sopi, T 6736; 6761-6762.
[290] Dr Zeqir Gashi, T 5632-5635.
[291] Elim Sopi, T 6761-6762.
[292] *Shih më poshtë* paragrafët 447-507.

IV. JURIDIKSIONI SIPAS NENEVE 3 DHE 5 TË STATUTIT

A. Juridiksioni sipas Nenit 3

1. Ekzistenca e konfliktit të armatosur dhe lidhja

(a) Kuadri ligjor

83. Me qëllim që Tribunali të ketë juridiksion mbi krimet e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit, duhen plotësuar dy kushte paraprake. Për kohën që ka lidhje me Aktakuzën duhet të ketë konflikt të armatosur, ndërkombëtar ose të brendshëm dhe veprimet e të akuzuarve duhet të kenë lidhje të ngushtë me këtë konflikt të armatosur.[293]

84. Kushti përcaktues për ekzistencën e një konflikti të armatosur u parashtrua në Vendimin *Tadiq* në lidhje me Juridiksionin dhe prej atëherë është zbatuar në mënyrë të pandryshueshme nga Tribunali:

> Konflikt i armatosur ekziston sa herë që përdoret forca e armatosur midis shteteve ose dhunë e armatosur e zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti.[294]

Në bazë të këtij kushti, në përcaktimin e ekzistencës së një konflikti të armatosur të brendshëm, Dhoma duhet të shqyrtojë dy kritere: (i) shkalla e konfliktit dhe (ii) organizimi i palëve.[295] Këto kritere përdoren "së paku vetëm për të dalluar konfliktin e armatosur nga banditizmi, kryengritjet e paorganizuara dhe jetëshkurtra, ose veprimtaritë terroriste që nuk trajtohen prej së drejtës humanitare ndërkombëtare."[296] Elementët gjeografikë dhe kohorë të kushtit janë gjithashtu të përcaktuar në jurisprudencë: Tribunali ka juridiksion mbi krimet e kryera kudo në territorin e kontrolluar prej një pale në konflikt, derisa të arrihet zgjidhje paqësore e konflktit.[297]

---

[293] Vendimi *Tadiq* për Juridiksionin, paragrafët 67, 70; Aktgjykimi *Tadiq,* paragrafët 562, 572; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 55. *Shih* edhe Aktgjykimin *Çelebiqi*; paragrafët 184-185; Aktgjykimin K*ërnojelac*, paragrafi 51; Aktgjykimin *Naletiliq,* paragrafi 225.

[294] Vendimi *Tadiq* për Juridiksionin, paragrafi, 70; *Shih* edhe Aktgjykimin *Tadiq,* paragrafët 561-571; Aktgjykimin *Aleksovski,* paragrafët 43-44; Aktgjykimin *Çelebiqi*; paragrafët 182-192; Aktgjykimin *Furunxhija*, paragrafi 59; Aktgjykimin *Bllashkiq,* paragrafët 63-64; Aktgjykimin *Kordiq,*paragrafi 24; Aktgjykimin *Kërstiq,* paragrafi 481; Aktgjykimin *Stakiq,* paragrafi 568.

[295] *Shih* Aktgjykimin *Tadiq,* paragrafi 562.

[296] Aktgjykimi *Tadiq,* paragrafi 562.

[297] Vendimi *Tadiq* për Juridiksionin, paragrafi, 70; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 57.

85. Mbrojtja argumenton se në përcaktimin e ekzistencës së një konflikti të armatosur në lidhje me juridiksionin e Tribunalit Dhoma mund të marrë në shqyrtim kontrollin e kryengritësve mbi një territor të caktuar, përdorimin e ushtrisë prej qeverisë kundër kryengritësve, statusin e kryengritësve si ndërluftues dhe nëse kryengritësit kanë organizim të ngjashëm me një shtet dhe autoritet për respektimin e rregullave të luftës.[298] Ky argument bazohet në Komentin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq ("KNKK") mbi Nenin e Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës, që është baza e akuzave të ngritura sipas Nenit 3 të Statutit. Në pjesën përkatëse, Komenti rendit kushte të ndryshme për zbatimin e Nenit të Përbashkët 3 të cilat u diskutuan në Konferencën Diplomatike për Konventat e Gjenevës. Mirëpo Komenti qartëson shprehimisht se kjo listë nuk është në asnjë mënyrë e detyrueshme dhe ajo thjesht sugjerohet si "kriter praktik" për të dalluar një konflikt të mirëfilltë të armatosur nga një veprim banditesk ose kryengritje jetëshkurtër ose e paautorizuar.[299] Më tej deklarohet:

> A do të thotë kjo se Neni 3 nuk është i zbatueshëm në rastet kur në një vend shpërthen trazirë e armatosur por nuk përmbushet ndonë prej kushteve të mësipërme (të cilat nuk janë të detyrueshme dhe përmenden vetëm si tregues)? Ne nuk jemi të këtij mendimi, përkundrazi mendimi ynë është se Neni duhet të gjejë një zbatim sa më të gjerë.[300]

86. Historia e hartimit të Nenit të Përbashkët 3 jep më shumë qartësi. Disa variante të atij që më vonë u bë i njohur si Neni i Përbashkët 3 kërkuan që ta kushtëzonin zbatimin e tij, ndër të tjera me njohjen e kryengritësve shprehimisht prej qeverisë zyrtare, përfshirjen e konfliktit në rendin e ditës të Këshillit të Sigurimit ose Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ekzistencën e një organizate të kryengritësve me shembëllim shtetëror, dhe të pushtetit civil që ushtron autoritet faktik mbi personat në territorin e caktuar.[301] Mirëpo, asnjë nga këto kushte nuk u përfshi në variantin përfundimtar të Nenit të Përbashkët 3, që aktualisht u miratua prej shteteve palë në

[298] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 205-207
[299] Koment i KNKK-së për Konventën e Gjenevës I, paragrafët 49-50.
[300] Koment i KNKK-së për Konventën e Gjenevës I, paragrafi 50.
[301] Kështu amendamenti australian priret ta zbatoi dispozitë përkatëse vetëm në qoftë se "(a) qeveria zyrtare i kishte njohur kryengritësit si ndërluftues; ose (b) qeveria zyrtare kishte deklaruar të drejtat e veta si ndërluftues; (c) qeveria zyrtare i ka njohur kryengritësit si ndërluftues vetëm në lidhje me Konventën në fjalë; ose (d) konflikti ishte pranuar në rendin e ditës të Këshillit të Sigurimit ose Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara si kërcënim ndaj paqes ndërkombëtare, shkelje e paqes, ose akt agresioni." Delegacioni amerikan bëri këto propozime në lidhje me atë që më vonë u bë Neni i Përbashkët 3: "-se kryengritësit duhet të kenë një organizatë që synon të zotërojë tiparet e një shteti;-se autoriteti civil i kryengritësve duhet të ushtrojë pushtet faktik mbi personat brenda një territori të caktuar;-se forcat e armatosura duhet të veprojnë në drejtimin e autoritetit të organizuar civil dhe të jenë të përgatitura për respektimin e ligjeve të zakonshme të luftës;-se autoriteti civil i kryengritësve duhet të pranojë detyrimet prej dispozitave të Konventës" *Dokumenti Përfundimtar i Konferencës Diplomatike Mbledhur nga Këshilli Federal Zviceran për Themelimin e Konventave Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Viktimave të Luftës dhe Mbajtur në Gjenevë nga 21 prill deri më 12 gusht 1949* ("Dokumenti Përfundimtar i Konferencës Diplomatike"), Vëll II, Kreu B, faqe 121. *Shih* edhe Projektin e Parë dhe të Dytë hartuar prej Palës së Parë Hartuese, Shtojcat A dhe B të Raportit të 7-të të Komitetit të Përbashkët, Dokumenti Përfundimar i Konferencës Diplomatike, Vëll II-B, faqet 124-125.

Konferencën Diplomatike. Ky është një tregues të qartë se hartuesit e Konventave të Gjenevës nuk synonin shprehimisht asnjë kusht të tillë për zbatimin e Nenit të Përbashkët 3.

87. Gjithashtu Dhoma është e vetëdijshme për Nenin 8 të Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJPN) në të cilin ndër të tjera përkufizohen krimet e luftës në një konflikt të armatosur jondërkombëtar. Në paragrafin 2(f) të Nenit 8 të Statutit të GJPN-së përkufizohet një kusht i ngjashëm me kushtin e formuluar në Vendimin *Tadiq* për Juridiksionin. Konflikti i armatosur i brendshëm përkufizohet prej po atyre dy tipareve, "konflikt i armatosur i zgjatur" dhe "grupe të organizuara të armatosura", pa përfshirë kushte të tjera.[302] Po ashtu si në jurisprudencën e Tribunalit Neni 8(2)(d) i Statutit të GJNP-së më tej qartëson se Statuti i GJNP-së nuk zbatohet në "rastet e turbullirave dhe tensioneve të brendshme, si trazira, veprime të izoluara dhe sporadike të dhunës ose veprime të tjera të ngjashme." Në një koment të Statutit të GJNP-së më tej sugjerohet se për përcaktimin e një konflikti të armatosur[303] nuk janë të domosdoshëm faktorë të tjerë si pjesëmarrja e forcave qeveritare në një palë ose ushtrimi i kontrollit tokësor prej forcave rebele.

88. Mbrojtja madje argumenton edhe se shkalla e organizimit të palëve që duhet për të provuar një konflikt të armatosur si edhe në përgjithësi shkalla e intensitetit të tij nuk janë përkufizuar ende prej jurisprudences së Tribunalit.[304] Ata argumentojnë se ligji nuk kërkon të pamundurën dhe se që një palë në konflikt të jetë e detyruar prej të drejtës humanitare ndërkombëtare, ajo duhet të jetë në gjendje të zbatojë të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe së paku duhet të njohë kuptimin themelor të parimeve të parashtruara në Nenin e Përbashkët 3, të ketë aftësi për propagandimin e rregullave dhe metodë për ndëshkimin e shkeljeve.[305] Gjithashtu ata i referohen Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës, i cili përcakton kufi më të lartë për të provuar ekzistencën e një konflikti të armatosur dhe argumentojnë se që Protokolli Shtesë II të jetë i zbatueshëm, duhet vërtetuar se pala kryengritëse (në rastin konkret UÇK-ja) ishte e organizuar në mënyrë të mjaftueshme për kryerjen e operacioneve të vazhdueshme dhe ngulmuese ushtarake dhe për

[302] Në paragrafin 2(f) të Nenit 8 të GJPN-së lexohet: "Paragrafi 2(e) zbatohet në konfliket e armatosura jondërkombëtare dhe rrjedhimisht nuk zbatohet në turbullira dhe tensione të brendshme, si trazirat, veprime sporadike dhe të izoluara të dhunës ose veprime të tjera të ngjashme. Ai gjen zbatim në konfliktet e armatosura që ndodhin në territorin e një shteti ku ka konflikt të armatosur të zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose midis grupeve të tilla."

[303] Knut Dormann, "Elementë të Krimeve të Luftës brenda Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare: Burime dhe Koment." Cambridge University Press, 2002, faqe 386-387 referencë te G. Abi-Saab, "Konfliktet e armatosura jondërkombëtare" në Institutin Henry Dunant/UNESCO (botues), *International Dimensions of Humanitarian Law*(Martinus, Nijhoff, Geneva, Paris dhe Dordrecht, 1988), faqe 237; C. Greenwood. "Scope of Application of Humanitarian Law" në D. Fleck (botues). *The Handbook of Humanitarian Law in Armed Conflict* (Oxford University Press, Oxford, 1995), faqe 48.

[304] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafi 37; Argumentet Përmbyllëse, T 7371.

[305] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafi 38.

imponimin e disiplinës mbi trupat e veta, se ushtroi një farë stabiliteti në territoret të cilat ishte në gjendje të kontrollonte dhe kishte infrastrukturën minimale për zbatimin e dispozitave të Protokollit Shtesë II.[306]

89. Dhoma nuk është e këtij mendimi. Dy elementët përcaktues të konfliktit të armatosur, intensiteti i konfliktit dhe shkalla e organizimit të palëve përdoren "*vetëm*, së paku për të dalluar konfliktin e armatosur prej banditizmit, kryengritjeve jetëshkurtra dhe të paorganizuara, ose veprimtarive terroriste, që nuk trajtohen prej të drejtës humanitare ndërkombëtare."[307] Rrjedhimisht për vërtetimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur mjafton një farë organizimi i palëve. Kjo shkallë nuk ka nevojë të jetë e njëjtë si në rastin e përcaktimit të përgjegjësisë së eprorëve për veprimet e vartësve të tyre brenda organizatës, sepse kjo dispozitë e Statutit nuk synon përcaktimin e përgjegjësisë penale individuale. Ky qëndrim pajtohet me komente të tjera bindëse për këtë çështje. Në një studim të KNKK-së që iu parashtrua si dokument referues Komisionit Përgatitor për përcaktimin e elementeve të krimeve për GJPN-në theksohej se:

> Përcaktimi nëse konflikti i armatosur nuk është ndërkombëtar nuk varet prej gjykimeve subjektive të palëve në konflikt; ai duhet të përcaktohet në bazë të kritereve objektive; shprehja "konflikt i armatosur" parasupozon ekzistencën e përleshjeve midis forcate të armatosura *të organizuara në një shkallë më të madhe ose më të vogël;* duhet të jetë ekzistojë opozita ndaj forcave të armatosura dhe *një farë intensiteti* i luftimeve.[308]

90. Për këto arsye Dhoma do të zbatojë kushtin e përmendur në Vendimin *Tadiq* për Juridiksionin për të përcaktuar nëse është provuar ekzistenca e konfliktit të armatosur. Në pajtueshmëri me vendimet e Dhomave të tjera të këtij Tribunali dhe të TPNR-së, përcaktimi i intensitetit të konfliktit dhe organizimit të palëve janë çështje faktike për të cilat duhet vendosur duke marrë parasysh provat e veçanta dhe mbi bazë rast pas rasti.[309] Si shembuj në vlerësimin e intensitetit të konfliktit, Dhomat e tjera kanë marrë parasysh faktorë të tjerë si forca e sulmeve dhe nëse ka patur shtim të përleshjeve të armatosura,[310] përhapja e sulmeve nëpër territor gjatë një periudhe kohore,[311] çdo shtim të forcave qeveritare dhe mobilizimi dhe shpërndarja e armëve ndër

[306] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 208-217.
[307] Aktgjykimi *Tadiq*, paragrafi 562 (theksi është shtuar)
[308] KNKK, Dokument operativ, 29 qershor 1999 (paraqitur nga KNKK si dokument referues për të ndihmuar Komisionin Përgatitor në punën e tij për përcaktimin e elementëve të krimeve për GJNP-në (theksi është shtuar)
[309] "Përkufizimi i konfliktit të armatosur në vetvete është abstrakt dhe për përshkrimin e një situate si "konflikt i armatosur" që përmbush kriteret e Nenit të Përbashkët 3, do të vendoset rast pas rasti." *Prokurorja kundër Rutagandës,* Lënda Nr. ICTR-96-3, Aktgjykim, 6 dhjetor 1999, paragrafi 93.
[310] Aktgjykimi *Tadiq*, paragrafi 565, Aktgjykimi *Çelibiqi,* paragrafi 189; Vendimi *Millosheviq* mbi Rregullën 98bis, paragrafi 28.
[311] Aktgjykimi *Tadiq*, paragrafi 566; Vendimi *Millosheviq* mbi Rregullën 98*bis*, paragrafi 29.

të dyja palët në konflikt,[312] si edhe nëse konflikti ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe nëse është miratuar ndonjë rezolutë për çështjen.[313] Në lidhje me organizimin e palëve në konflikt Dhomat e Tribunalit kanë marrë parasysh faktorë ndër të cilët, ekzistencën e shtabeve, zonat e përcaktuara operative dhe aftësinë për sigurimin, transportin dhe shpërndarjen e armëve.[314]

91. Gjithashtu, për plotësimin e parakushteve juridiksionale të Nenit 3 të Statutit, Prokuroria duhet të provojë jo vetëm ekzistencën e konfliktit të armatosur, por edhe lidhjen e mjaftueshme midis veprimeve të pretenduara të të akuzuarve dhe konfliktit të armatosur.[315] Nuk kërkohet domosdoshmërisht që konflikti i armatosur të ketë qenë shkakësor në kryerjen e krimit të akuzuar, mirëpo ai duhet të ketë luajtur një rol thelbësor në aftësinë e kryesve për kryerjen e atij krimi.[316] Në përcaktimin e ekzistencës së një lidhjeje të tillë, Dhoma mund të marrë në shqyrtim ndër të tjera nëse kryesi është luftues, nëse viktima është joluftues, nëse viktima është anëtar i palës kundërshtare, nëse mund të thuhet se veprimi i ka shërbyer synimit përfundimtar të një fushate ushtarake, dhe nëse krimi kryhet si pjesë ose në kontekstin e detyrave zyrtare të kryesit.[317]

92. Më tej Mbrojtja argumenton se Protocolli Shtesë II nuk zbatohet në rastin në fjalë sepse "ekziston një argument bindës se faktikisht UÇK-ja ishte grup i armatosur që luftonte për vetëvendosje kundër sundimit të huaj dhe një regjimi racist," rast që trajtohet prej paragrafit 4 të Nenit 1 të Protokollit Shtesë I.[318] Ashtu si është treguar, më parë karakteri i një konflikti të armatosur nuk ka lidhje me zbatimin e Nenit 3 të Statutit.[319] Rrjedhimisht është i panevojshëm shqyrtimi i mëtejshëm i këtij argumenti.

(b) Përfundime

93. Aktakuza pohon se konflikti i armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së ekzistonte në Kosovë jo më vonë se fillimi i vitit 1998.[320] Dhoma dëgjoi dëshmi dhe është e bindur se forcat serbe që ishin në Kosovë në 1998 përbëheshin prej forcave të konsiderueshme të Ushtrisë së

[312] Vendimi *Milloshevi*q mbi Rregullën 98*bis*, paragrafët 30-31. *Shih* edhe Aktgjykimin *Çelibiqi,* paragrafi 188.
[313] Aktgjykimi *Tadiq*, paragrafi 567, Aktgjykimi *Çelibiqi,* paragrafi 190.
[314] Vendimi *Milloshevi*q mbi Rregullën 98*bis*, paragrafët 23-24
[315] Aktgjykimi *Tadiq*, paragrafët 572-573.
[316] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 58.
[317] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 59.
[318] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 184-197.
[319] *Shih më sipër*, paragrafi 83.
[320] Aktakuzë, paragrafi 4.

Jugosllavisë ("UJ") dhe Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme ("MPB"),[321] me një fjalë të policisë dhe rrjedhimisht në bazë të kuptimit të kushtit *Tadiq* përbëjnë "autoritete qeveritare". Më poshtë Dhoma do të shtjellojë nëse Prokuroria ka vërtetuar se UÇK-ja zotëronte tiparet e një grupi të armatosur dhe të organizuar në përputhje me kuptimin e kushtit *Tadiq* dhe nëse veprimet e dhunshme që ndodhën në kohën që ka lidhje ishin deri në shkallën që përputhet me jurisprudencën e Tribunalit për të vërtetuar ekzistencën e konfliktit të armatosur.

(i) Organizimi i UÇK-së

94. Më parë në këtë vendim, Dhoma ka shqyrtuar krijimin e UÇK-së dhe ngritjen e Shtabit të saj të Përgjithshëm.[322] Ajo ka pranuar se në kohën në fjalë ekzistonte një Shtab i Përgjithshëm i UÇK-së dhe ndër anëtarët e tij ishin Azem Syla, Sokol Bashota, Rexhep Selimi, Lahi Brahimaj, Xhavid Zeka, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi.[323] Ndërkohë që një pjesë e dëshmive tregojnë se shumica e komandantëve rajonalë ishin të përfaqësuar në "komandën e lartë" e përshkruar si organ i UÇK-së që merrte vendime për tërë UÇK-në,[324] d.m.th. Shtabi i Përgjithshëm, këto dëshmi janë të pamjaftueshme që Dhoma të nxjerrë përfundim.

95. Gjithashtu, ashtu si është treguar prej Dhomës më parë në këtë vendim,[325] gradualisht nga fundi i majit deri në fund të gushtit 1998 territori i Kosovës u nda në shtatë zona prej UÇK-së: Drenica, Dukagjini, Pashtriku, Shala, Llapi, Nerodima dhe Karadaku.[326] Çdo zonë kishte një komandant dhe në të përfshihej territori i disa komunave.[327] Niveli i organizimit dhe i zhvillimit të çdo zone ishte i ndryshueshëm dhe jo të tëra zonat kishin të njëjtin nivel organizimi dhe zhvillimi; kjo u ndikua ndjeshëm prej ekzistencës dhe shkallës së pranisë së UÇK-së në secilën zonë para prillit 1998.[328]

96. Prej dëshmive Dhoma pranon dhe arrin në përfundimin se komandantët e zonave emëroheshin prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Ashtu si dëshmoi Sylejman Selimi, në një mbledhje që u mbajt në fund të majit 1998 në të cilën ishin të pranishëm edhe Rexhep Selimi, përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm dhe individë me poste të rëndësishme në njësitë e tjera,

[321] Prova Materiale P230; Philip Coo, T 5697-5699, John Crosland, T 1910, 1877-1879, 1890, 1900; Prova Materiale P92, nënndarjet 7 dhe 17. *Shih* edhe, *poshtë*, paragrafët 161-165.
[322] *Shih* më lart, paragrafët 44 dhe 45.
[323] *Shih* më lart, paragrafi 46.
[324] Peter Bouckaert, T 5513-5514.
[325] *Shih* më lart, paragrafin 63.
[326] Fillimisht tërë territori i Kosovës mund të jetë përmendur si Zona Një dhe zonat e tjera si nënzona, Jakup Krasniqi, T 3322-3323. Jakup Krasniqi dëshmoi se zonat dhe nënzonat i referoheshin të njëjtës gjë, T 3479-3482.
[327] Jakup Krasniqi, T 3479-3482.

Sylejman Selimi u caktua për t'u emëruar komandant i Zonës së parë Operative. Mirëpo ky propozim duhej miratuar prej Shtabit të Përgjithshëm dhe faktikisht Sylejman Selimi u emërua komandant i Zonës së parë Operative prej Shtabit të Përgjithshëm.[329] Ky përfundim i Dhomës konfirmohet edhe prej dëshmive se në mes të qershorit 1998 Shtabi i Përgjithshëm filloi të emëronte komandantët e zonave.[330]

97. Përfundimi i Dhomës është se çdo drejtues i një njësie operative kishte detyrim të informonte Shtabin e Përgjithshëm për të gjitha zhvillimet në zonën e tij të përgjegjësisë.[331] Për shembull, komandanti i zonës së Drenicës, Sylejman Selimi, i raportonte drejtpërdrejtë Shtabit të Përgjithshëm. Nuk kishte nivel të ndërmjetëm komandimi.[332]

98. Megjithëse jo pa mëdyshje, Dhoma në përgjithësi pranon se komandantët e zonave vepronin në përputhje me udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm. "Rregullorja e Përkohshme për Organizimin e Jetës së Brendshme të Ushtrisë" e UÇK-së ("Rregullorja")[333] u shpërnda në njësi të ndryshme prej Shtabit të Përgjithshëm.[334] Sylejman Selimi dëshmoi se ai filloi të krijonte zonën dhe policinë ushtarake në bazë të një propozimi të Shtabit të Përgjithshëm.[335]

99. Gjithashtu dëshmitë tregojnë se Shtabi i Përgjithshëm ishte aktiv në emërime kyçe individuale të rëndësishme për zhvillimin dhe funksionimin e UÇK-së. Për shembull, pas ardhjes në Kosovë të Bislim Zyrapit më 29 maj 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e emëroi atë si përgjegjës për zhvillimin dhe profesionalizmin e UÇK-së, funksion që ai e pati prej qershorit deri në mes të korrikut 1998.[336] Më 11 qershor 1998 Shtabi i Përgjithshëm emëroi Jakup Krasniqin si zëdhënës i UÇK-së.[337] Në korrik 1998 Shtabi i Përgjithshëm emëroi një drejtori civile në Malishevë.[338]

100. Shtabi i Përgjithshëm ishte gjithashtu aktiv në organizimin e çështjeve të një rëndësie të përgjithshme për funksionimin e UÇK-së, për shembull furnizimi i armëve. Kështu në maj 1998

---

[328] Jakup Krasniqi, T 3412-3415; T 3468-3470.
[329] Sylejman Selimi, T 2070-2072; 2212. *Shih* edhe Rexhep Selimi, T 6691.
[330] Shukri Buja, T 3797-3799.
[331] *Shih* Jakup Krasniqi, T 3412-3413.
[332] Sylejman Selimi, T 2072-2075; 2231-2232.
[333] Prova Materiale P156, *Shih më poshtë*, paragrafët 110-112.
[334] Ramiz Qeriqi mendonte se Rregullorja duhet të jetë dërguar prej Shtabit të Përgjithshëm, T 3604.
[335] Sylejman Selimi, T 2212-2213.
[336] Bislim Zyrapi, T 6821.
[337] Jakup Krasniqi, T 3311-3313; Prova Materiale P 48, ERN U0038475

Shtabi i Përgjithshëm e urdhëroi Shukri Bujën të organizonte linjën e furnizimit me armë nga Shqipëria për në Kosovë dhe në veçanti për në komunat e Kaçanikut, Lipjanit, Shtimes dhe Ferizajt.[339] Ky urdhër erdhi nga Shtabi i Përgjithshëm dhe Shukri Bujës iu komunikua nga Hashim Thaçi.[340]

101. Gjithashtu Shtabi i Përgjithshëm nxirrte deklarata dhe komunikata politike që informonin publikun në Kosovë dhe bashkësinë ndërkombëtare mbi objektivat dhe veprimtaritë e tij. Deklarata politike Nr. 2 e UÇK-së, e nxjerrë prej Shtabit të Përgjithshëm më 27 prill 1998 dhe e publikuar në gazetën kosovare "Bujku" pas dy ditësh, se përshkruante UÇK-në dhe synimet e saj politike si vijon:[341]

> UÇK-ja përbën tërësinë e forcave të armatosura të Kosovës dhe territoreve të saj të pushtuara, dhe synimi i saj është çlirimi dhe bashkimi i territoreve të pushtuara të Shqipërisë.

Më tej Deklarata politike Nr. 2 shpalli se UÇK-ja kishte karakter mbrojtës dhe çlirues dhe se dënonte terrorizmin dhe forma të tjera të dhunës ndaj civilëve dhe robërve të luftës.[342]

102. Prej fillimit të qershorit 1998 UÇK-ja kishte një zëdhënës zyrtar, Jakup Krasniqin,[343] detyrat e të cilit ishin të komunikonte me median vendëse dhe të huaj të bazuar në Kosovë dhe të bënte të njohur programin politik të UÇK-së.[344] Jakup Krasniqi ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.[345]

103. Komunikimet midis UÇK-së dhe publikut përgjithësisht kryheshin nëpërmjet komunikatave. Si rregull komunikatat nxirreshin prej Shtabit të Përgjithshëm. Ndonjëherë ato nxirreshin prej komandantëve të zonave që vepronin pa dijeninë e Shtabit të Përgjithshëm. Kjo pohohej shprehimisht në një komunikatë të tillë.[346] Nga fundi i vitit 1997 deri në gusht 1998 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së lëshoi dhjetra komunikata që informonin për operacione ushtarake të ndërmarra prej organizatës.[347]

---

[338] Fatmir Limaj, T 5990-5991.
[339] Shukri Buja, T 3773-3774.
[340] Shukri Buja, T 3773-3774.
[341] Prova Materiala P142, Pika 1; Jakup Krasniqi, T 3371-3373.
[342] Prova Materiala P142, Pikat 2 dhe 3.
[343] Jakup Krasniqi, T 3311.
[344] Jakup Krasniqi, T 3311-3313.
[345] Jakup Krasniqi, T 3310-3311.
[346] Jakup Krasniqi, T 3314-3315.
[347] Jakup Krasniqi, T 3319-3340.

104. Për kohën që ka lidhje me Aktakuzën, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, ndonjëherë i përmendur në dëshmi si selia e përgjithshme,[348] nuk kishte të njëjtën vendndodhje.[349] UÇK-ja u detyrua të funksiononte si organizatë klandestine.[350] Anëtarët e UÇK-së dhe të Shtabit të Përgjithshëm ishin nën rrezikun e vazhdueshëm të kapjes. Si pasojë Shtabi i Përgjithshëm mblidhej jo rregullisht dhe në vende të ndryshme, për shkak të gjendjes së sigurisë. Anëtarët e tij komunikonin kryesisht me telefon dhe faks.[351] Sidoqoftë në vende të ndryshme të Kosovës kishte një numër shtabesh lokalë të UÇK-së. Dëshmitë tregojnë se shtabet kryesore të UÇK-së ishin në Malishevë,[352] Kleçkë[353] dhe në fshatin Divjakë.[354] Shtabe kishte ndër të tjera edhe në Jabllanicë,[355] Carralevë,[356] Shalë,[357] Vojnikë,[358] Likoc,[359] Pjetërshticë[360] dhe Llapushnik.[361]

105. Komandantët e zonave të UÇK-së iu jepnin urdhra komandantëve të njësive brenda zonës së tyre. Vendimet e Sylejman Selimit si komandant shpërndaheshin menjëherë kur ai ishte i pranishëm dhe kopjet e urdhrave për njësitë përgjithësisht i dërgoheshin edhe Shtabit të Përgjithshëm.[362] Prej dëshmive mund të supozohet se për shkak të mungesës së burimeve fizike të mjaftueshme, për arsye sigurie dhe për shkak se UÇK-së i mungonin pajisjet radiondërlidhëse, përgjithësisht urdhrat jepeshin gojarisht, por më vonë urdhrat operativë transmetoheshin me shkrim.[363] Natyrisht kishte raste kur nuk ishte e mundur që vartësit të zbatonin urdhrat për shkak të kushteve të luftimit.[364]

106. Dëshmitë tregojnë se Shtabi i Përgjithshëm i jepte komandantëve të zonave përgjegjësinë e ngritjes së brigadave. Si komandant i Zonës së Parë Operative, Sylejman Selimi fillimisht u ngarkua me ngritjen e brigadave në zonën e Drenicës prej pikave dhe njësive ekzistuese. Si rezultat ai formoi brigadat 111, 112, 113 dhe 114.[365]

---

[348] *Shih* Fatmir Limaj, T 5950-5952; Peter Bouckaert, T 5513-5514.
[349] Fatmir Limaj T 5950-5952.
[350] Jakup Krasniqi, T 3305-3307.
[351] Jakup Krasniqi, T 3309-3310. *Shih* edhe Sylejman Selimi, T 2072-2073.
[352] John Crosland, T 1952-1952; Jan Kickert, T 675; Fatmir Limaj, T 5959-5960.
[353] L95, T 4218-4223, 4230-4231; Ramadan Behluli, T 2681-2686.
[354] Rexhep Selimi, T 6602; 6658-6659.
[355] John Crosland T1959; L95, T 4185-4191.
[356] John Crosland T 1933, 1938; Jan Kickert, T 687-688.
[357] John Crosland T1907.
[358] John Crosland T1872, 1925
[359] Jakup Krasniqi, T 3425-3426.
[360] L04, T 1119-1120.
[361] *Shih më poshtë*, paragrafi 249.
[362] Sylejman Selimi, T 2231-2232.
[363] Sylejman Selimi, T 2076-2078. Konfirmues i autoritetit të tij për lëshimin e urdhrave me shkrim është një urdhër i 1 gushtit 1998 drejtuar komandantëve të njësive dhe autoriteteve civile ku urdhërohej që të maskoheshin tregjet dhe ndalohej grumbullimi publik i më shumë se tre personave, Sylejman Selimi, T 2079-2081; Prova Materiale P93.
[364] Sylejman Selimi, T 2078.

107. Komandantët e zonave autorizonin edhe lëvizjen e ushtarëve. Sylejman Selimi dëshmoi se ushtarët duhej të merrnin leje për të kaluar në një zonë tjetër operative dhe kjo leje jepej prej komandantit të njësisë.[366] Mirëpo sipas disa dëshmive ushtarët nuk kishin nevojë për lejen e komandantit të njësisë së tyre për të kaluar nga njëra njësi në tjetrën.[367]

108. Domethënës për përcaktimin e shkallës së organizimit të UÇK-së është aftësia e njësive të UÇK-së për bashkërendimin e operacioneve të tyre. Në fund të korrikut 1998 komandanti i njësisë së L95-ës e përbërë prej 30 ushtarësh, urdhëroi që ushtarët e njësisë të shkonin në malet e Berishës në ndihmë të forcave të UÇK-së të atjeshme sepse kishte gjasa që ata të sulmoheshin prej forcave serbe.[368] Për pasojë L95 dhe ushtarë të tjerë të njësisë së tij shkuan në fshatin Novosellë.[369]

109. Komandantët e disa njësive kishin autoritet të miratonin emërimin e komandantëve të njësive më të vogla brenda zonës së tyre operative. Ramiz Qeriqi me pseudonimin "Luani", i cili në fillim të qershorit 1998 ishte përgjegjës për 70 deri në 100 persona në pika të ndryshme luftarake: Carralevë, Zborc, Fushticë, Blinajë dhe Pjetërshticë,[370] pranoi që Ramadan Behluli të merrte komandën e Pjetërshticës.[371] Ramadan Behluli ishte nën komandën e Luanit dhe Luani i jepte urdhra.[372] Këta urdhra kryesisht kishin të bënin me mbrojtjen e pozicioneve ekzistuese dhe i transmetoheshin atij personalisht.[373] Në lidhje me disa çështje, si hapja e pozicioneve të reja dhe llogoreve, Ramadan Behluli vepronte nga dita në ditë me nismën e tij, por këtë e bënte me miratimin e Luanit.[374] Dikur në maj ose qershor 1998 Shukri Buja mori komandën e Kroimirit dhe meqë Pjetërshtica dhe Carraleva kishin kaluar në zonën e përgjegjësisë së Kroimirit, Luani u bë zëvendësi i tij.[375] Luani dinte se mbi të dhe Shukri Bujën ishte komandë më e lartë dhe se "vija organizative" shkonte nga Likoci (ku komandant ishte Rexhep Selimi) në Kleçkë (ku komandant ishte Fatmir Limaj) e më tej në Kroimir dhe se komandant i përgjithshëm ishte Azem Syla.[376]

---

[365] Sylejman Selimi, T 2076-2078.
[366] Sylejman Selimi, T 2150-2152.
[367] Elmi Sopi, T 6733-6734.
[368] L95, T 4203-4212.
[369] L95, T 4203-4212.
[370] Ramiz Qeriqi, T 3575, 3577.
[371] Ramadan Behluli, T 2665; 2851.
[372] Ramiz Qeriqi, T 3575-3576; Ramadan Behluli, T 2666, 2668.
[373] Ramadan Behluli, T 2666, 2668.
[374] Ramadan Behluli, T 2666-2668.
[375] Ramadan Behluli, T 2667; Prova Materiale P116; Ramiz Qeriqi, T 3578.
[376] Ramiz Qeriqi, T 3578-3579.

110. Gjithashtu Rregullorja e UÇK-së[377] e konfirmon ekzistencën e kësaj strukture dhe hierarkie organizative. Megjithëse Rregullorja mban datën "1998" dhe data e saktë e shpalljes së saj nuk është identifikuar, prej dëshmive Dhoma pranon dhe nxjerr përfundimin, se të paktën në fund të qershorit 1998 kjo rregullore ishte në qarkullim dhe iu shpërndahej ushtarëve të UÇK-së në pozicione të ndryshme. Kjo mbështetet prej dëshmisë së Ramiz Qeriqit, me pseudonimin Luani, i cili dëshmoi se në fund të qershorit 1998 ai dhe Shukri Buja e kishin Rregulloren dhe duhej t'i jepte nga një kopje çdo ushtari.[378] Edhe Fatmir Limaj dëshmoi se në fund të qershorit 1998 ai mori Rregulloren e UÇK-së.[379]

111. Ndër të tjera Rregullorja përcaktoi disa grada të ushtarakëve të UÇK-së, përkufizoi detyrat e komandantëve dhe zëvendëskomandantëve të njësive, si edhe detyrat e komandantëve të kompanive, togave dhe skuadrave dhe krijoi një zinxhir të hierarkisë ushtarake midis komandantëve të rangjeve të ndryshme.[380] Në Rregullore deklarohej se "bindja, respekti dhe urdhrat përputhen rreptësisht me hierarkinë ushtarake".[381] Rregullorja autorizonte një oficer të një rangu më të lartë që "të kërkonte nga një oficer i një rangu më të ulët zbatimin e ligjit, rregullave, urdhrave, udhëzimeve, etj." dhe kushtëzonte se "një oficer i një rangu më të ulët është i detyruar të zbatojë urdhrat, vendimet, udhëzimet, etj."[382] Gjithashtu, Rregullorja përmbante dispozita shprehimisht të qarta që garantonin se urdhrat do të zbatoheshin nga lart-poshtë.[383]

112. Rregullorja shënoi një hap të rëndësishëm në procesin e vazhdueshëm për zhvillimin dhe zbatimin e një bashkërendimi dhe përputhjeje më të madhe brenda UÇK-së që po zgjerohej me shpejtësi dhe midis njësive të UÇK-së. Rregullorja iu shpërnda njësive prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.[384] Rregullorja deklaronte se ndër të tjera detyra e parë e komandantit të një njësie ishte ndër të tjera të mbikëqyrte bindjen ndaj programit dhe rregullave të UÇK-së dhe zbatimin e tyre.[385]

---

[377] Prova Materiale P156.
[378] Ramiz Qeriqi, T 3604.
[379] Fatmir Limaj, T 6543; Prova Materiale P156.
[380] Prova Materiale 156, Kapitujt 5 dhe 6.
[381] Prova Materiale 156, Kapitulli 5, Neni 1.3.
[382] Prova Materiale 156, Kapitulli 5, Neni 1.4.
[383] Prova Materiale 156, Kapitulli 5, Neni 2.2: "Urdhrat nuk diskutohen: ato zbatohen besnikërisht, shpejt dhe saktë. Ushtari është i detyruar t'i raportojë oficerit zbatimin e urdhrit. Oficeri është përgjegjës për pasojat e mundshme të urdhrit të dhënë." Prova Materiale P156, Kapitulli 5, Neni 2.5: "Komandanti është i detyruar të sigurojë zbatimin e urdhrit."
[384] Karakteri i Rregullores dhe synimi i saj i vetëdukshëm janë të mjaftueshëm për të treguar se ajo u hartua dhe shpërnda nga i vetmi
autoritet bashkërendues i UÇK-së në atë kohë, d.m.th. Shtabi i Përgjithshëm. Këtë dinte Ramiz Qeriqi në atë kohë, T 3604. Rregullorja iu shpërnda njësive afërsisht në të njëjtën kohë siç del prej dëshmive të Ramiz Qeriqit dhe Fatmir Limajt të cilët ishin në njësi të ndryshme.

113. Tregues i shkallës së zhvillimit të organizimit formal të UÇK-së është ngritja e policisë ushtarake, e cila përgjithësisht ishte përgjegjëse për disiplinën e ushtarëve[386] dhe kontrollin e lëvizjeve të ushtarakëve të UÇK-së.[387] Dëshmitë në lidhje me datën e themelimit të policisë ushtarake pasqyron mospërputhjet që janë të dukshme thuajse në të gjitha aspektet e zhvillimit të strukturës organizative të UÇK-së. Disa dëshmitarë deklaruan se policia ushtarake nuk ishte themeluar ende deri në gusht 1998 apo më vonë. Për shembull, i Akuzuari Fatmir Limaj tha se policia ushtarake filloi të vepronte pavarësisht në secilën zonë në gusht 1998 dhe se uniformat e policisë ushtarake fillimisht u panë në mes të dhjetorit 1998.[388] Mirëpo Ramadan Behluli pa policë ushtarakë në Kroimir pak para ofensivës në Zborc, e cila ndodhi më 25 dhe 26 korrik 1998.[389] Ata mbanin uniforma të zeza me mbishkrimin PU në emblemën e tyre.[390] Ramiz Qeriqi pranoi propozimin e Mbrojtjes se policia ushtarake si organizatë brenda UÇK-së nuk ekzistonte deri pak kohë pas formimit të brigadave dhe batalioneve.[391] Në kundërshtim me këtë, Sylejman Selimi dëshmoi se si komandant i zonës së Drenicës ai filloi të ngrinte policinë ushtarake afërsisht dy muaj pas emërimit të tij si komandant zone në maj 1998, me fjalë të tjera në korrik 1998, dhe afërsisht rreth kohës kur ai mbante mend formimin e brigadave.[392] Mirëpo gjatë dhënies së dëshmisë së tij Sylejman Selimi pranoi edhe se ai mund të ketë lëshuar një urdhër në lidhje me policinë ushtarake në maj 1998,[393] për të cilin siç theksohet në paragrafin vijues, ndodhi në të vërtetë. Gjithashtu ai pranoi edhe se ishte e mundshme që prej mesit të majit 1998 ka ekzistuar një urdhër apo udhëzim prej Shtabit të Përgjithshëm për një njësi të policisë ushtarake.[394]

114. Dokumentet me shkrim sidoqë kanë qenë dhe janë të pakta, tregojnë se në lidhje me periudhën kohore kujtesa e dëshmitarëve për aq sa ajo u shpalos në dëshminë gojore është tepër e rezervuar dhe se në fakt hapat për krijimin e policisë ushtarake në UÇK filluan më herët se sa shumë thonë në këtë moment. "Programi për Policinë Ushtarake" i lëshuar në emër të Sylejman Selmit dhe nënshkruar prej Shaban Shalës, u nxor më 13 maj 1998. Programi detyronte komandantët në zonën e Drenicës të informonin ushtarët e tyre për programin e policisë

[385] Prova Materiale 156, Kapitulli 6, Neni 1.2.
[386] Sylejman Selimi, T 2082-2084; Ramiz Qeriqi, T 3611.
[387] Ramadan Behluli, T 2793-2794.
[388] Fatmir Limaj, T 6091-6093.
[389] Ramadan Behluli, T 2793-2794.
[390] Ramadan Behluli, T 2793-2794.
[391] Ramiz Qeriqi, T 3669-3670.
[392] Sylejman Selimi, T 2082; 2186; 2195.
[393] Sylejman Selimi, T 2212-2213.
[394] Sylejman Selimi, T 2212-2213.

ushtarake.[395] Në program deklarohej se ushtarët që largohen nga vija e frontit pa leje prej komandantit do të burgosen nga policia ushtarake. Programi trajton rastet e moslejimit të mbajtjes së armëve dhe autorizonte përdorimin e forcës prej policisë ushtarake kundër një ushtari që nuk u bindej urdhrave.[396] Programi parashikonte hyrjen në fuqi më 20 maj 1998.[397]

115. Ky Program përputhet me Rregulloren e UÇK-së, Kapitulli i Tetë i së cilës trajton policinë ushtarake. Aty kushtëzohet se policia ushtarake është e organizuar në zonat dhe nënzonat operative dhe ndër detyrat e tjera të saj janë mbajtja e rregullit dhe disiplinës në njësitë dhe bazat ushtarake, kontrolli i lëvizjeve të ushtarëve dhe lejekalimet e tyre, kontrolli i levizjeve të personave të dyshimtë, sigurimi i transportit të materialit ushtarak dhe konfiskimi i dokumenteve dhe armëve të ushtarakëve dhe ushtarëve të cilët thyejnë rregullat.[398]

116. Në lidhje me shkallën e zbatimit në praktikë të rregullave për policinë ushtarake dhe rregullat disiplinore provat janë të pakta. Sipas raporteve në gjysmën e dytë të qershorit 1998 policia e UÇK-së organizonte qarkullimin rrugor në Malishevë.[399] Provat mbi zbatimin faktik të procedurave disiplinore janë të pakta. Peter Bouckaert dëshmoi se gjatë vizitës së tij në Kosovë midis shtatorit dhe nëntorit 1998 atij dhe një studiuesi tjetër të Human Right Watch iu tha prej anëtarëve të UÇK-së se ekzistonin procedura disiplinore, mirëpo gjatë tërë periudhës së tyre studimore, prej fundit të shkurtit deri në nëntor 1998, ata nuk dokumentuan një rast të vetëm ku UÇK-ja disiplinoi ose ndëshkoi trupat e veta.[400] Sylejman Selimi tregoi se para formimit të brigadave nuk ekzistonte disiplinë e rreptë ushtarake.[401] Në dëshminë e tij Fatmir Limaj sugjeroi se në periudhën nga maji në korrik 1998 ai mund të dëbonte për sjellje të keqe vetëm ushtarë të njësisë nën përgjegjësinë e tij, dhe se në rast se një ushtari i ishte dhënë armë, ajo mund t'i merrej. Sipas tij ai nuk mund të pengonte një ushtar që ai kishte dëbuar prej njësisë së tij të shkonte në një njësi tjetër.[402] Ndërkohë që ka prova se para formimit të policisë ushtarake, ndaj ushtarëve mund të jenë dhënë dënime disiplinore,[403] këto prova nuk identifikojnë raste të largimit të ushtarëve prej njësive të tyre.[404]

---

[395] Prova Materiale P 95, Sylejman Selimi, T 2214-2216; 2220-2230.
[396] Prova Materiale P 95, Pikat 1-6
[397] Prova Materiale P 95.
[398] Prova Materiale P 156, Kapitulli i Tetë, Neni 1.3.
[399] Prova Materiale P 92, nënndarje 29.
[400] Peter Bouckaert, T 5518.
[401] Sylejman Selimi, T 2175-2177.
[402] Fatmir Limaj, T 6566-6569.
[403] Këto dënime përfshinin caktimin e detyrave shtesë, vërejtje me shkrim, heqjen e armëve dhe uniformës për ushtarin dhe në rast të
përsëritjes së gabimit largimin e ushtarit nga detyra, Sylejman Selimi, T 2082-2086.
[404] *Shih* edhe Sylejman Selimi, T 2082-2086.

117. Për sa më sipër, Dhoma pranon dhe nxjerr përfundimin se në mes të majit 1998 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së mori formalisht masa për formimin e policisë ushtarake brenda UÇK-së. Megjithëse prej dëshmive në dispozicion të Dhomës nuk është e dukshme se rregullat ushtarake zbatoheshin në të njëjtën mënyrë në njësitë e UÇK-së, Dhoma e konsideron këtë hap si dëshmues të qartë të formalizmit dhe efektivitetit gjithnjë në rritje rë strukturës organizative të UÇK-së deri në mes të majit 1998 dhe të përparimit të Shtabit të Përgjithshëm drejt garantimit të funksionimit të UÇK-së si forcë ushtarake e disiplinuar dhe e bashkërenduar.

118. Faktor tjetër i rëndësishëm në lidhje me shkallën dhe efektivitetin e organizimit të UÇK-së gjatë kohës në fjalë është aftësia për të rekrutuar anëtarë të rinj. Ndërsa ngjarjet në fillim të vitit 1998 në Kosovë patën ndikim pozitiv në anëtarësimin në UÇK,[405] prej dëshmive duket e qartë se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së bëri përpjekje të vazhdueshme për të bindur njerëzit që të anëtarësoheshin në organizatë. Më 15 qershor 1998, në deklaratën e tij të parë publike si zëdhënës zyrtar i UÇK-së transmetuar në televizionin shqiptar dhe rishtypur në gazetën kosovare "Bujku", Jakup Krasniqi paraqiti pjesë të programit të UÇK-së dhe i bëri thirrje popullit të Kosovës të bashkohej me UÇK-në.[406] Ai gjithashtu dëshmoi se synimi i komunikatave të UÇK-së, si material propagandistik, ishte rritja e respektit për UÇK-në dhe autoritetit të saj, me qëllim që njerëzit të besonin në të dhe të anëtarësoheshin.[407] Në të vërtetë numri i njerëzve që po anëtarësoheshin në UÇK po rritej me shpejtësi.[408] Raportet e UJ-së tregojnë se gjatë periudhës në fjalë UÇK-ja mobilizoi 3500-4500 njerëz.[409]

119. Dëshmitë konfirmojnë se përgjithësisht pas anëtarësimit në UÇK, ushtarët bënin stërvitje ushtarake. Për ta ilustruar këtë, L95 bëri stërvitje për armë dhe të tjera pasi u regjistrua në UÇK në mesin e majit 1998.[410] Në Kleçkë u ngrit edhe një qendër stërvitore për vullnetarë prej Fatmir Limajt. Ai caktoi Ajet Kastratin përgjegjës të stërvitjes.[411] Në qytetet shqiptare Tropojë, Kukës dhe Bajram Curri u krye stërvitje fillestare e forcave të UÇK-së.[412]

[405] *Shih më lart* paragrafët 49-52.
[406] Prova Materiale P 139; Jakup Krasniqi, T 3355-3359.
[407] Jakup Krasniqi, T 3340-3341.
[408] *Shih* për shembull, Shukri Buja, T 3779; Ramiz Qeriqi, T.3575.
[409] Philip Coo, T 5792-5794. *Shih* edhe Provën Materiale P92, nënndarje 17. Dhoma nënvizon se dëshmitë sugjerojnë se ky numër mund të jetë i zmadhuar, Philip Coo, T 5794-5800; John Crosland, T. 2009.
[410] L95, T 4197-4198.
[411] Fatmir Limaj, T 5970-5972.
[412] John Crosland, T 1960. *Shih* edhe Provën Materiale P92, nënndarje 13.

120. Në fund të qershorit 1998 Shtabi i Përgjithshëm dërgoi tre oficerë me përvojë ushtarake, Bislim Zyrapin, Agim Qelajn dhe një person të identifikuar vetëm si "Hans" në Kleçkë dhe pika të tjera përfshirë edhe Llapushnikun për të vlerësuar armatimin e ushtarëve të UÇK-së dhe për të këshilluar komandantët e njësive përkatëse për çështje si stërvitja, taktika dhe dislokimi në pozicionet mbrojtëse.[413]

121. Në fillim të vitit 1998, përfshirë edhe periudhën që ka lidhje me Aktakuzën, UÇK-ja kishte më së shumti armë të lehta.[414] Zakonisht ushtarët e UÇK-së ishin të armatosur me pushkë AK-47, armë standarde për rajonin, dhe granathedhësa.[415] Armatim tjetër i UÇK-së në sasi të kufizuar ishin pistoleta, pushkë gjysëmautomatike dhe automatike,[416] disa armë kundërtanke,[417] armë të lehta të këmbësorisë të kalibrave 7.62 dhe 7.9 dhe armë të tjera dore,[418] disa mortaja 60 mm dhe 82 mm,[419] si edhe mortaja 150 mm dhe 250 mm, bomba dore dhe disa mina.[420]

122. Shumica e armëve të UÇK-së vinin prej Shqipërisë.[421] Disa armë erdhën edhe nga Kosova meqë civilët që zotëronin armë ia dorëzuan UÇK-së.[422] Shpesh këto ishin pushkë gjahu. UÇK-ja përdori edhe armë të prodhimit jugosllav.[423] Së paku në fillim shumë komandantë rajonesh dhe pikash kërkonin armë me nismën e tyre. Të tjerët rekrutonin vetëm ata që vinin me armët e tyre.[424] Ndërkohë dhe më shumë nga fundi i majit 1998 dhe më pas, siç është shtjelluar më parë, Shtabi i Përgjithshëm ishte drejtpërdrejtë veprues në sigurimin e furnizimeve me armë dhe shpërndarjen e tyre.

123. Dëshmitë ndryshojnë ndjeshëm në lidhje me sasinë dhe përdorimin e uniformave në UÇK në periudhën para gushtit 1998. Disa dëshmi tregojnë se deri në shkurt 1998 shumë prej ushtarëve të UÇK-së kishin uniforma me shenja identifikuese të përkatësisë,[425] megjithëse nga dëshmitë del se uniformat ushtarake ishin të ndryshme.[426] Disa ushtarë të UÇK-së mbanin uniforma të bëra

[413] Fatmir Limaj, T 5973-5974, 6077-6078.
[414] Sylejman Selimi, T 2147; John Crosland, T 2010.
[415] Philip Coo, T 5726-5727. *Shih* edhe Ramadan Behluli, T 2851-2855.
[416] Bislim Zyrapi, T 6823. *Shih* edhe Elmi Sopi, T 6736-6737.
[417] Bislim Zyrapi, T 6823. *Shih* edhe Elmi Sopi, T 6736-6737.
[418] Rexhep Selimi, T 6597.
[419] Philip Coo, T 5734-5736; Elmi Sopi, T 6736-6737.
[420] Fatmir Limaj, T 6011-6012.
[421] John Crosland, T 1885-1887, 1960; Prova Materiale P92, nënndarje 10; Sylejman Selimi, T 2147-2148. *Shih* edhe Fatmir Limaj, T 5970-5971; Rexhep Selimi, T 6623-6624.
[422] Shukri Buja, T 4035-4036.
[423] Sylejman Selimi, T 2148.
[424] Ruzhdi Karpuzi, T 3070-3072.
[425] Peter Bouckaert, T 5511-5513.
[426] John Crosland, T 1901, 1953.

vetë.[427] Të tjerë nuk kishin uniforma fare.[428] Ashtu si për shumë aspekte të tjera edhe gjendja për uniformat u përmirësua me afrimin e fundit të vitit 1998. Ndërkohë që ekzistenca e uniformës mund të jetë tregues i ekzistencës së një njësie të mirëorganizuar, Dhoma ka pikëpamjen se vetëm ky faktor nuk është përcaktues në këtë rast për ekzistencën e një strukture ushtarake të organizuar, ashtu si ka pak ndikim në funksionimin e UÇK-së, veçanërisht duke marrë parasysh zgjerimin e saj të shpejtë pas marsit 1998 që padyshim ushtroi trysni të paparashikuar në furnizimin me materiale si uniformat në një kohë që nevojat e tjera ishin qartësisht më të domosdoshme për funksionimin ushtarak të UÇK-së.

124. Dëshmitë tregojnë qartë se të paktën deri afër fundit të vitit 1998 UÇK-ja nuk ishte e pajisur mjaftueshmërisht me pajisje komunikimi për lidhjen e shtabeve me njësitë ose për lidhjen ndërmjet njësive. Për këtë arsye dhe për shkak të sigurisë, komunikimi më i shumtë kryhej me korrierë.[429] Mirëpo ishin disa radiotransmetues,[430] dhe disa njësi përdornin radio dydrejtimëshe dhe telefona mobilë, shpesh të anëtarëve të veçantë.[431] Mjete të tjera komunikimi ishin të shtënat.[432]

125. Tregues i shkallës së organizimit të UÇK-së është roli i saj në negociatat me përfaqësuesit e Bashkësisë Evropiane dhe misionet e huaja në Beograd. Jan Kickert, diplomat në ambasadën austriake në Beograd, tregoi se nga mesi i viti 1998 ishte bërë e qartë se zgjidhja e krizës së Kosovës nuk do të arrihej pa përfshirjen e UÇK-së.[433] Ky ishte vlerësimi i Misionit të tij, që merr rëndësi të veçantë meqenëse në atë kohë Austria kishte Kryesinë e Bashkimit Evropian.

126. Në korrik 1998, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Jashtme austriake, Albert Rohan, u organizua një takim i përfaqësuesve të misioneve të shteteve të Bashkësisë Evropiane me përfaqësuesit e UÇK-së në Malishevë që ishte e njohur si "kryeqytet" i të ashtuquajturave "territore të lira", d.m.th. nën kontrollin e UÇK-së.[434] Takimi u mbajt më 22 korrik 1998 dhe ndërmjet të pranishmëve ishin Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme austriake, Albert Rohan, Drejtori i Departamentit të Ballkanit të Ministrisë së Jashtme austriake, Gerhard Jandl, Nick Turnbull, Jan Kickert dhe një vëzhgues i Misionit Monitorues të Bashkësisë Evropiane

[427] Ramadan Behluli, T 2851-2855. *Shih* edhe Elmi Sopi, T 6726.
[428] Elmi Sopi, T 6726.
[429] *Shih* Ramadan Behluli, T 2853-2855; Ramiz Qeriqi, T 3588; Jakup Krasniqi, T 3453-3455. *Shih* edhe Shukri Buja, T 3998-4001.
[430] Sylejman Selimi dëshmoi se njësitë e zonës së Pashtrikut dhe Drenicës komunikonin me radio apo personalisht, T 2148-2150.
[431] Prova Materiale DL13, paragrafi 44; Prova Materiale DL13, Shtojcë, faqe 6. *Shih* edhe L12, T 1792-1795.
[432] Shukri Buja, T 3998-4001.
[433] Jan Kickert. T 659-660.
[434] Jan Kickert. T 661.

("ECMM").[435] Të pranishëm në takim nga UÇK-ja ishin Gani Krasniqi, një civil dhe kryetari i komunës së Malishevës, dhe Kadri Veseli, i cili iu paraqit delegacionit të huaj si Numri 7.[436]

127. Të nesërmen, më 23 korrik 1998, u mbajt takimi i dytë. Të pranishëm në takim ishin Hashim Thaçi që u paraqit si Numri 3 dhe Kadri Veseli i paraqitur si Numri 7.[437] Më 24 korrik 1998 Jan Kickert përgatiti një raport për Ministrinë e Jashtme austriake ku ndër të tjera thuhej se përfaqësuesit e kishin informuar ambasadën për vendosmërinë e UÇK-së për të bashkëpunuar me palët e tjera në Kosovë dhe për pjesëmarrje në qeverinë e bashkimit kombëtar ose në një tryezë të rrumbullakët.[438]

128. Më 30 korrik 1998 u mbajt një takim i tretë midis përfaqësuesve të misioneve të huaja të shteteve të Bashkësisë Evropiane dhe UÇK-së në Kleçkë.[439] Të pranishëm në takim ishin Jan Kickert i ambasadës austriake dhe David Slinn i ambasadës britanike në Beograd. UÇK-ja u përfaqësua nga Jakup Krasniqi, zëdhënësi zyrtar i UÇK-së, Ramë Buja, personi përgjegjës për organizimin e pushtetit civil në të ashtuquajturat territore të lira, dhe Fatmir Limaj.[440] Në takim u diskutua krijimi i një platforme politike kosovare të njësuar, i një delegacioni prej subjekteve të ndryshme politike të Kosovës për të hyrë në negociata.[441] Raporti i përgatitur nga Jan Kickert më 31 korrik 1998 për Ministrinë e Jashtme austriake tregonte se gjatë takimit përfaqësuesit e UÇK-së konfirmuan një ndryshim në taktikat e tyre dhe propozuan kushte që UÇK-ja të mos ndërmerrte operacione mësymëse.[442] Në raport pohohej:

> Përfaqësuesit e UÇK-së me të cilët u takuam konfirmuan ndryshim në taktikat e tyre: ata e kanë të qartë se nuk është e mundur një luftë konvencionale me vija fronti të mirëpërcaktuara dhe si pasojë ata do të kufizohen në aksione guerrilje. U përsërit kërcënimi se ata mund të fillonin në çdo kohë aksione në qytete të mëdha si Prishtina.[443]

Raporti më tej tregon se përfaqësuesit e UÇK-së përmendën këto tri kushte që UÇK-ja të ushtronte vetëpërmbajtje: tërheqja e ushtrisë jugosllave, kthimi i të gjithë personave të dëbuar, dhe heqja e postbllokeve serbe.[444]

---

[435] Jan Kickert. T 663; 749.
[436] Jan Kickert. T 663-664.
[437] Jan Kickert. T 669-670, 717.
[438] Prova Materiale P56, f. 1; Jan Kickert. T 670-672
[439] Jan Kickert. T 677, 749, 750; Jakup Krasniqi, T 3406-3408.
[440] Jan Kickert. T 680, 749; Jakup Krasniqi, T 3406-3408.
[441] Jan Kickert. T 688-689. *Shih* edhe Jakup Krasniqi, T 3409-3410.
[442] Prova Materiale P59, f.4; Jan Kickert, T 687-693.
[443] Prova Materiale P59, f.4; Jan Kickert, T 692.
[444] Prova Materiale P59, f.4; Jan Kickert, T 693.

129. Siç konfirmohet nga kjo dëshmi, në korrik 1998 UÇK-ja ishte pranuar prej përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe brenda në Kosovë si palë kyçe e përfshirë në negociatat politike për zgjidhjen e krizës së Kosovës. Kjo zbulon dhe konfirmon se në atë kohë UÇK-ja kishte arritur qëndrueshmëri dhe efektivitet organizativ, cilësi të cilat veçanërisht i dhanë aftësinë e njohur për të folur me një zë dhe me një farë autoriteti bindës në emër të anëtarëve të vetë. Nevoja e UÇK-së për fshehtësi dhe ekzistenca e një hierakie të përcaktuar në radhët e veta del prej momentit kur individët e përfshirë në negociata me misionet e huaja përmendeshin me numër, që siç duket përputhej me pozitën e tyre në hierarkinë e UÇK-së. Gjithashtu nga këto diskutime duket se UÇK-ja ishte në gjendje të formulonte dhe deklaronte ndryshim të taktikave ushtarake si edhe kushte për mosndërmarrjen e operacioneve të tjera ushtarake. Ky është tregues se në atë kohë UÇK-ja kishte aftësi të bashkërendonte planifikimin dhe veprimtaritë ushtarake dhe të përcaktonte një strategji ushtarake të njësuar si edhe kishte aftësinë të ndërmerrte operacione më të gjera ushtarake.

130. Dhoma nënvizon se rëndësia e pranisë së Fatmir Limajt në takimin e tretë është çështje e diskutueshme. Prokuroria mbështetet në këtë fakt si provë e pozitës së tij të lartë në UÇK. Mirëpo Dhoma thekson se ai nuk përdori numër hierarkik në takim. Fatmir Limaj e shpjegon praninë e tij me arsyetimin se në atë kohë ai ishte komandant i njësisë së vendit ku u mbajt takimi, d.m.th. në Kleçkë.

131. Dhoma dëgjoi dëshmi se përfaqësuesit e misioneve të huaja dhe organizatave joqeveritare ishin në disa raste të paqartë për strukturën komanduese të UÇK-së. Një raport i ambasadës austriake në Beograd për Ministrinë Federale Austriake të Punëve të Jashtme që u referohej burimeve amerikane e përshkruante strukturën komanduese të UÇK-së si "mister" dhe "më shumë si strukturë komanduese dhe bashkërenduese të shpërndarë dhe horizontale." [445] Jan Kickert dëshmoi se kjo tregonte vështirësitë që kishin misioni amerikan dhe misionet e tjera të huaja në identifikimin e bashkëbiseduesve të tyre.[446] Në një raport tjetër të ambasadës austriake për Ministrinë e Jashtme austriake përmendej një deklaratë e Richard Hollbrukut ku bëhej e ditur se ai nuk kishte dijeni nëse UÇK-ja kishte hierarki të brendshme komanduese.[447] Peter Bouckaert i Human Rights Watch dëshmoi se ai e kishte të vështirë të kuptonte se kush përfshihej në strukturën e brendshme të UÇK-së dhe për këtë arsye ai parapëlqente të fliste me komandantët rajonalë dhe nënrajonalë.[448]

[445] Prova Materiale P61, f.1; Jan Kickert, T 708.
[446] Jan Kickert, T 708.
[447] Prova Materiale P64, f.1; Jan Kickert, T 715.

132. Përfundimi i Dhomës është se këto dëshmi nuk vërtetojnë mosekzistencën e një strukture organizative të UÇK-së. Ato pasqyrojnë kushtet në të cilat vepronte UÇK-ja në atë kohë. Në fakt UÇK-ja ishte organizatë klandestine që vepronte në fshehtësi për të ruajtur udhëheqjen e vetë[449] dhe nën rrezikun e vazhdueshëm të operacioneve ushtarake të forcave serbe.[450] Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm nuk mblidheshin rregullisht për shkak të gjendjes së sigurisë dhe paraqiteshin jo me emra, por me numra për të njëjtën arsye.[451] Si pasojë nuk është aspak e papritur që struktura organizative dhe hierarkia e UÇK-së ishin të paqarta ose jo të njohura prej vëzhguesve të jashtëm dhe se për disa kjo tregonte një gjendje të pështjelluar.

133. Ndër dëshmitë e paraqitura para Dhomës janë deklarata të ndryshme që vlerësojnë nivelin organizativ të UÇK-së në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën. "Raporti ekspert mbi Organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Ngjarjet në Kosovë në 1998" nga Robert Churcher nxjerr përfundimin se UÇK-ja nuk ishte e aftë të krijonte një sistem komandues apo disiplinën dhe aftësinë e nevojshme për t'u konsideruar forcë e armatosur brenda kuptimit ligjor të Aktakuzës, se UÇK-ja nuk ishte në gjendje të përfshihej në operacione luftarake që çojnë në konflikt të armatosur, dhe se trupat serbe përdorën forcë tejet të palejueshme kundër qytetarëve të vetë.[452] Bazë për këtë përfundim janë mbresat e autorit mbi gjendjen në Kosovë ku ai ishte i pranishëm nga qershori në dhjetor 1998 si edhe për një farë kohe në 1993 dhe 1997, dhe vlerësimi i autorit për dëshmitë e dhëna para Dhomës.[453] Gjithashtu si dëshmi para Dhomës është një raport nga Human Rights Watch ku përfundohet se gjatë kohës në fjalë UÇK-ja ishte forcë e organizuar ushtarake sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare,[454] si edhe një raport i ambasadës austriake për Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme të 7 korrikut 1998 ku përmendej një deklaratë e Adem Demaçit se në UÇK ekzistonin struktura të qarta organizative dhe hierarkike.[455] Dhoma i ka shqyrtuar faktet e paraqitura në mbështetje të këtyre deklaratave për të përcaktuar nivelin e lartpërmendur organizativ dhe i ka marrë parasysh në nxjerrjen e përfundimeve.

---

[448] Peter Bouckaert, T 5513-5514.
[449] *Shih më lart*, paragrafët 45 dhe 46.
[450] *Shih më poshtë,* paragrafi 172.
[451] *Shih më lart*, paragrafët 46 dhe 129.
[452] Prova Materiale DL13, f 18.
[453] Prova Materiale DL13. Robert Churcher dëshmoi se raporti ishte analizë e bazuar mbi çfarë mbante mend dhe dinte ai, çfarë kishte lexuar dhe mbi burimet të cilat ai i lexoi sipas kërkesës së Mbrojtjes, T 6383-6384.
[454] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 92. Një raport i Human Rights Watch e përshkruante kështu UÇK-në: "megjithëse UÇK-ja është kryesisht ushtri guerilje pa struktura të ngurta hierarkike, dhe me fraksione të veçanta të brendshme, gjatë periudhës së mbuluar prej këtij raporti (nga shkurti deri në shtator 1998) UÇK-ja ishte një forcë e organizuar ushtarake në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare."
[455] Prova Materiale P64, f 2. Një raport i ambasadës austriake për Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme përmend një deklaratë të Adem Demaçit, kryetar i Partisë Parlamentare të Kosovës (PKK), një nga partitë politike kundërshtare të

134. Përfundimi i Dhomës është se para fundit të majit 1998, UÇK-ja kishte karakteristika të mjaftueshme të një grupi të armatosur të organizuar, e aftë të përfshihej në një konflikt të brendshëm të armatosur.

(ii) Ashpërsia e konfliktit

135. Në 1997 dhe herët në 1998 në Kosovë ndodhën veprime sporadike dhune midis forcave serbe dhe UÇK-së. Disa prej këtyre incidenteve u shqyrtuan prej Dhomës më lart në këtë vendim.[456] Më i fuqishëm prej tyre ishte sulmi në fund të shkurtit dhe herët në mars 1998 kundër fshatrave Qirez, Likoshan dhe Prekaz i Poshtëm në rajonin e Drenicës gjatë të cilit u vranë 83 shqiptarë të Kosovës.[457] Vëzhguesit ndërkombëtarë që ishin të pranishëm në Kosovë në atë kohë dëshmuan se këto ngjarje shënuan një pikë kthese në konfliktin në Kosovë.[458]

136. Rreth 5 marsit 1998 në rrethinën e Klinës-Llaushës, në jugperëndim të Prekazit, u ndërmor një operacion policor. Raportet treguan se ndërtesat u sulmuan me armë të rënda dhe mortaja. Një grup diplomatësh të cilët më 8 mars 1998 vizituan Prekazin raportuan shkatërrime të mëdha në një numër të kufizuar ndërtesash, prani të dendur e të vazhdueshme të policisë dhe mungesë të plotë të veprimtarive civile. Shtëpive iu vu zjarri, u dogjën ose u goditën me zjarr armësh. Në operacion morën pjesë forcat serbe të Ministrisë së Brendshme (MPB) dhe forca të lidhura me njësitë e posaçme serbe, të pajisura me autoblinda dhe automjete të tjera të rënda.[459]

137. Komunikata Nr. 45 e lëshuar prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së më 11 mars 1998 përshkruante operacionet ushtarake që u ndërmorën në ditët rreth 7 marsit 1998 midis forcave të armatosura të UÇK-së dhe forcave ushtarake, paraushtarake dhe policore serbe në rajonin midis Gllogocit, Klinës dhe Mitrovicës në lindje si dhe në rajonet midis Deçanit, Gjakovës dhe Klinës; midis Malishevës dhe Rahovecit dhe midis Deçanit dhe Pejës. Në dëshminë e tij Jakup Krasniqi i përmendi këto operacione ushtarake.[460]

LDK-së së Ibrahim Rugovës, se në UÇK ekzistonte një hierarki dhe strukturë organizative e qartë dhe se ai vetë ishte takuar me persona që prezantoheshin me numra. *Shih* edhe Jan Kickert, T 715, 717.

[456] *Shih më lart,* paragrafët 48 dhe 49.

[457] *Shih më lart,* paragrafi 49

[458] Philip Coo, T 5707-5709; Peter Bouckaert, T 5516-5517; Prova Materiale P212, nënndarje 5.

[459] John Crosland, T 1864-1865, Prova Materiale P92, nënndarje 3.

[460] Jakup Krasniqi, T 3336.

138. Rreth 24 marsit 1998, në disa fshatra midis Deçanit dhe Gjakovës, rreth 60 km në perëndim të Prishtinës pati shkëmbime zjarri. U vranë një polic serb dhe 5 shqiptarë të Kosovës dhe u plagosën një polic dhe 10 shqiptarë të Kosovës. Në fshatin Irzniq, 10 km në juglindje të Deçanit u dëgjuan të shtëna prej një helikopteri të policisë. Pati dy shpërthime të pasuara prej një shkëmbimi zjarri që zgjati 20 minuta.[461] Afërsisht në të njëjtën kohë pati shkëmbim zjarri në rrethinën e Jashanicës, në Drenicë, ku u përfshi policia e posaçme serbe. U dëgjuan të paktën 50 – 100 të shtëna.[462] Rapotet tregojnë se në atë zonë u dërguan armë të rënda si sisteme të mbrojtjes ajrore "Praga", dhe se dy toga policore me një xhip të armatosur me një mitraloz të rëndë u panë duke lëvizur në perëndim nga Skënderaj drejt Llaushës.[463] Gjithashtu forcat serbe dislokuan në këtë zonë një BOV – 3, armë tritytëshe. Ndërkohë që kjo armë është kryesisht kundërajrore dhe jo kundër këmbësorisë,[464] dislokimi i saj tregon se ajo ishte për t'u përdorur kundër këmbësorisë sepse UÇK-ja nuk kishte mjete ajrore. Gjithashtu pati raporte se rreth 25 marsit 1998 në Gjakovë u përdorën autoblinda të policisë ("APC") dhe se gjatë shkëmbimit të zjarrit atje u vranë të paktën katër policë dhe pesë shqiptarë të Kosovës.[465]

139. Më 13 prill 1998 në lagjen Kodra e Trimave të Prishtinës, UÇK-ja sulmoi një stacion policor. Një polic u plagos dhe ndërtesa pësoi dëme të konsiderueshme.[466] Raportet treguan se në të njëjtën kohë familjet serbe po largoheshin nga rrethina e Deçanit në një numër të madh si pasojë e kërcënimeve prej shqiptarëve kosovarë të armatosur.[467] Më 14 prill 1998 nja 18 familje serbe u larguan nga Deçani dhe gjendja e serbëve u tensionua shumë.[468]

140. Më 22 prill 1998 në rrethinën e Deçanit dhe Gjakovës pati të shtëna të shumta si pasojë e të cilave shumë civilë serbë dhe shqiptarë të Kosovës u larguan nga rrethina.[469] Raportet treguan për prani të UJ-së në atë zonë.[470] Pati raporte se shqiptarë të Kosovës po rrëmbenin serbë, se shqiptarë të Kosovës sulmuan UJ-në dhe se forcat serbe po sulmonin fshatrat e shqiptarëve të Kosovës.[471] Një raport sugjeronte se pas një sulmi kundër një instalimi të UJ-së u vranë dy shqiptarë të Kosovës.[472]

[461] John Crosland, T 1869; Prova Materiale P92, nënndarje 5.
[462] Prova Materiale P92, nënndarje 5.
[463] Prova Materiale P92, nënndarje 5; John Crosland, T 1871-1872.
[464] John Crosland, T 1873.
[465] Prova Materiale P92, nënndarje 6.
[466] Prova Materiale P92, nënndarje 9; John Crosland, T 1882
[467] Prova Materiale P92, nënndarje 9; John Crosland, T 1883.
[468] Prova Materiale P92, nënndarje 9.
[469] Prova Materiale P92, nënndarje 11; John Crosland, T 1887.
[470] Prova Materiale P92, nënndarje 11.
[471] Prova Materiale P92, nënndarje 11.
[472] Prova Materiale P92, nënndarje 11.

141. Në kufirin Shqipëri – Kosovë ndodhën incidente të tjera. Një telegram diplomatik i 24 prillit 1998 u referohej burimeve të UJ-së që raportonin një operacion ushtarak kundër një grupi prej 200 personash të cilët po hynin në Kosovë nga Shqipëria, i cili u ndërmor më 22 prill 1998 në rrethinën e Gjakovës, ku si pasojë u vranë së paku 16 prej tyre.[473] Raporte të tjera treguan për operacione luftarake të vazhdueshme në rrethinë dhe më shumë viktima.[474]

142. Më 3 maj 1998, në Ponoshec afër Deçanit, 8 km nga kufiri shqiptar, filloi luftim i ashpër i cili vazhdoi për më shumë se dy ditë. Pati raporte për viktima midis shqiptarëve të Kosovës dhe përqëndrim të forcave policore serbe.[475] Pothuajse në të njëjtën kohë pati disa përleshje me viktima në fshatrat e zonës së Drenicës.[476] Në zonë u dislokuan forca të shumta të MPB-së dhe UJ-së, përfshi edhe 80 – 100 policë të njësisë së posaçme kundër terrorit në katër vendndodhje të ndryshme.[477] Sipas John Crosland-it, zona nga Ponosheci deri në Junik ishte bërë vijë fronti ku forcat serbe u përpoqën t´i zbraznin fshatrat me qëllim që të hapnin zjarr pa kufizim. Ata e bënë këtë me sulme për dëmtimin e shtëpive për t´i detyruar njerëzit të braktisnin zonën.[478]

143. Siç është shtjelluar me më shumë hollësi në këtë vendim më parë, më 9 maj 1998 në Llapushnik filluan luftime midis forcave serbe dhe luftëtarëve të UÇK-së.[479] Si rezultat luftëtarët e UÇK-së shkatërruan një Pinzgauer serb, autoblindë e përdorur në luftim. Pas tërheqjes së forcave serbe UÇK-ja ngriti një njësi në fshat.

144. Rreth mesit të majit 1998 UÇK-ja mbylli dy rrugët kryesore që çonin në Pejë: rrugën Mitrovicë-Pejë dhe Pejë-Prishtinë.[480] Ka dëshmi se në rrugën e tretë kryesore për në Pejë, (Prishtinë, Shtime, Suharekë, Prizren) UÇK-ja ngrinte rregullisht prita[481] dhe se UÇK-ja mund ta kishte mbyllur rrugën po të kishte patur atë synim.[482]

145. Në këto rrugë UÇK-ja dhe forcat serbe ngritën postblloqe. Në fund të majit 1998 në rrugën Pejë – Prishtinë kishte prani të dendur të MPB-së. Rreth Ferizajt dhe Gjilanit u ngritën postblloqe të

[473] Prova Materiale P92, nënndarje 12.
[474] Prova Materiale P92, nënndarje 12; John Crosland, T 1895-1897.
[475] Prova Materiale P92, nënndarje 15; John Crosland, T 1909, 1911.
[476] Prova Materiale P92, nënndarje 15; John Crosland, T 1909, 1911.
[477] Prova Materiale P92, nënndarje 15; John Crosland, T 1909, 1911.
[478] John Crosland, T 1910.
[479] *Shih më lart* paragrafët 66-77.
[480] John Crosland, T 1915-1916; Prova materiale P60, ff 1-2.
[481] John Crosland, T 1915-1916, 1921.
[482] John Crosland, T 1943.

reja të MPB-së.[483] Edhe UÇK-ja ngriti postblloqe në rrugë, ndonjëherë vetëm dy km larg postblloqeve të MPB-së.[484] Për të kaluar postblloqet e UÇK-së gazetarët dhe vëzhguesit duhet të kishin lejekalimi prej UÇK-së. Ato lëshoheshin prej Adem Demaçit dhe ishin të vlefshme për një ditë.[485] Natyrisht që kjo është një dëshmi tjetër e organizimit efektiv të UÇK-së.

146. Tregues i ashpërsisë në rritje të konfliktit është një raport i datës 13 maj 1998 nga Gjeneralmajori Nebojsha Pavkoviq, komandant i Korpusit të Prishtinës, drejtuar komandës së Armatës së Tretë të UJ-së. Raporti pohonte se gjendja e sigurisë në Kosovë po "ndërlikohej çdo ditë e më shumë" për shkak të sulmeve gjithnjë e më të shpeshta kundër anëtarëve të MPB-së, qytetarëve të kombësisë serbe dhe shqiptarëve kosovarë "besnikë ndaj sistemit".[486] U raportua se forcat e MPB-së nuk kishin mundur të arrinin bllokimin dhe shkatërrimin e forcave të UÇK-së në Drenicë, Gjakovë dhe Deçan, gjë që kishte çuar në "përhapjen" e UÇK-së në komunat e Rahovecit, Suharekës dhe Istogut dhe në rajonet e komunave të Kaçanikut, Lipjanit dhe Ferizajt. Sipas vlerësimit të atëhershëm të UJ-së, UÇK-ja kontrollonte afërsisht 30% të Kosovës.[487] Philip Coo dëshmoi se ky vlerësim bazohej në raportet e zbulimit të UJ-së dhe se u konfirmua prej raporteve të ECMM-së.[488] Duke marrë parasysh gjendjen në raportin e Gjeneralmajorit Pavkoviq propozohej një angazhim më i gjerë i njësive të Korpusit të Prishtinës.[489]

147. Raportet e 14 majit 1998 përshkruan një sulm të 50 shqiptarëve kosovarë të armatosur kundër një vendbanimi serb afër Klinës në Drenicë gjatë të cilit u plagos një polic serb. Afërsisht në të njëjtën kohë forcat zyrtare serbe raportuan se në Smonicë afër kufirit shqiptar ishin vrarë 10 shqiptarë kosovarë kurse burimet shqiptare pretenduan se dhjetë personat u vranë prej minave tokësore.[490]

148. Më 15 maj 1998 në rrethinën e Gjakovës, Ponoshecit dhe Junikut filluan luftime të ashpra në të cilat morën pjesë forcat e policisë së posaçme serbe.[491] John Crosland u ndalua për një kohë të shkurtër nga UÇK-ja në Vojnik dhe besonte se në kohë UÇK-ja kontrollonte pjesë të Drenicës dhe rajoneve të tjera ku ata kishin marrë nën kontroll ish-pozicionet e MPB-së.[492]

[483] John Crosland, T 1926. *Shih* edhe Oleg Safiulin T 1714-1719.
[484] John Crosland, T 1926-1927.
[485] Peter Bouckaert, T 5514-5515.
[486] Prova Materiale P92, nënndarje17.
[487] Prova Materiale P92, nënndarje17.
[488] Philip Coo, T 5714-5717.
[489] Prova Materiale P92, nënndarje17; Philip Coo, T 5717.
[490] Prova Materiale P92, nënndarje18.
[491] John Crosland, T 1924; Prova Materiale P92, nënndarje 19.
[492] John Crosland, T 1925; Prova Materiale P92, nënndarje 19.

149. Më 18 ose 19 maj 1998 një luftim tjetër shpërtheu në grykën e Llapushnikut. Forcat serbe duke përdorur mortaja, raketa dhe mina në luftim u përpoqën të merrnin kontrollin e grykës.[493] Si rezultat i këtij luftimi që zgjati gjithë ditën u vranë dy ushtarë të UÇK-së.[494] Më 20 maj 1998 fshati Bokshiq u granatua nga të dy palët. Operacionet luftarake vazhduan për pjesën më të madhe të ditës tjetër. Pati viktima si nga pala serbe po ashtu dhe nga UÇK-ja.[495] Më 26 maj 1998 u raportua një prani shumë e dendur e MPB-së në rrugën Pejë-Prishrinë.[496] Më 29 maj 1998 një luftim tjetër midis forcave serbe dhe UÇK-së shpërtheu në Llapushnik.[497] Luftimet filluan në orën 07:00 dhe vazhduan deri në 21:00-22:00.[498]

150. Më 29 maj 1998, me urdhër të komandës së Korpusit së Prishtinës, të paktën pesë ose gjashtë Brigada të Korpusit të Prishtinës u vunë në gadishmëri të plotë luftarake. Ata ishin përgatitur të dislokoheshin dhe të kryenin operacione luftarake në një kohë parapërgatitore shumë të shkurtër.[499] Sipas mendimit ekspert të Philip Coo, ky urdhër tregonte se komanda e Korpusit të Prishtinës kishte vlerësuar se gjendja ishte jashtëzakonisht e tensionuar, sepse vënia e njësive në gadishmëri të plotë luftarake i lodhte trupat dhe kërkonte shumë mjete në dispozicion.[500]

151. Më 31 maj 1998 një force policore speciale serbe sipas vlerësimeve prej rreth 300 vetësh sulmoi fshatin Poklek i Ri afër Gllogocit.[501] Gjatë sulmit policia kapi dhjetë burra njëri prej të cilëve më vonë u gjet i vdekur po atë ditë. Nëntë të tjerët janë zhdukur.[502]

152. Në fund të majit 1998 forcat policore serbe dhe të UJ-së nisën një mësymje të madhe kundër një sërë fshatrash në kufirin Kosovë-Shqipëri, e cila dukej se synonte të bllokonte rrugët e furnizimit të UÇK-së.[503] U granatuan fshatra nga Peja në veri deri në Gjakovë në jug, edhe pse ishin ende civilë të pranishëm dhe më vonë u shkatërruan sistematikisht.[504]

[493] Ruzhdi Karpuzi, T3072-3074.
[494] Ruzhdi Karpuzi, T3072-3074.
[495] L95, T 4198-4201.
[496] Prova Materiale P92, nënndarje 20.
[497] L64, T 4361-4363; Elmi Sopi, T 6726-6728.
[498] Elmi Sopi, T 6726-6728.
[499] Philip Coo, T 5720-5721.
[500] Philip Coo, T 5720-5721.
[501] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 33.
[502] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 33.
[503] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 38.
[504] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 38.

153. Afërsisht në të njëjtën kohë, drejt fundit të majit 1998, shpërthyen luftime të ashpra në Deçan dhe në Drenicë në Kosovën perëndimore.[505] Luftimet në Deçan dhe rreth tij vazhduan katër ditë.[506] Sipas raporteve serbe UÇK-ja e kishte rrethuar qytetin.[507] Më 7 qershor 1998, Ministria e Jashtme Jugosllave organizoi një udhëtim për diplomatët e huaj dhe atashetë ushtarakë në zonën e Deçanit.[508] Një raport i Ministrisë Federale të Jashtme austriake e përshkruan zonën si vijon:

> Deçan, shkatërrime të konsiderueshme, por në asnjë mënyrë aq drastike siç përshkruhen nga LDK-ja ("80% i shkatërruar", "Vukovar i dytë"); qyteti dukej i vdekur (klientët e kafenesë në sheshin kryesor – disa prej tyre nga Baballoqi, (shih më poshtë)-dukeshin se ishin për "shfaqje"), shumë prej kosovarëve dukej se ishin larguar prej qytetit; gjendja duket e tendosur, prani e fortë policore dhe fortifikime në qytet, tanke të blinduar, disa stacione policore të fortifikuara në rrethinë; një numër çuditërisht i vogël vrimash plumbi dhe gjurma të tjera të shtënash, dhe shumë shtëpi të dëmtuara prej zjarrit (kryesisht vetëm në katin e epërm) – ndoshta zjarrvënie, sipas kolegëve ushtararakë, akuza të dyanshme se kjo është bërë me qëllim spastrimin etnik; kolegët të cilët vizituan rajonin e Drenicës në mars raportuan shkatërrim krahasimisht të pakët (nuk kishte granatime me armë të rënda).[509]

154. Raporte të fundit të majit dhe fillimit të qershorit 1998 tregojnë për përleshje më afër kryeqytetit, Prishtinës.[510] Nga fundi i majit 1998 kishte raporte për sulme kundër postbllokut policor në Komoran, 21 km në perëndim të Prishtinës në rrugën Pejë-Prishtinë dhe përleshje të tjera në Sllatinë, afër aeroportit të Prishtinës.[511]

155. Më 8 qershor ose rreth kësaj date u sulmua fshati Popoc afër Gjakovës, si rezultat i të cilit një ushtar i UJ-së u vra dhe tre u plagosën.[512] Shqiptarë të Kosovës të armatosur sulmuan dy fshatra serbe në luginën e Drenicës, Banjën dhe Suhogërllën, ku luftimi vazhdoi për disa orë.[513]

156. Më 14 qershor 1998, filluan luftime në Carralevë.[514] Forcat serbe kishin tanke, "Praga", mortaja të rënda, mitralozë dhe granathedhësa.[515] Luftimi vazhdoi së paku tri orë,[516]megjithëse ka

[505] Prova Materiale P92, nënndarje 20 dhe 21; John Crosland, T 1929.
[506] Prova Materiale P92, nënndarje 21.
[507] Prova Materiale P92, nënndarje 21.
[508] Jan Kickert, T 698-699; Prova Materiale P60.
[509] Prova Materiale P60; Jan Kickert, T 698-699.
[510] *Shih* John Crosland, T 1931-1932.
[511] Prova Materiale P92, nënndarje 21.
[512] Prova Materiale P92, nënndarje 23.
[513] Prova Materiale P92, nënndarje 22 dhe 23.
[514] Ramadan Behluli, T 2795-2801; Ramiz Qeriqi, T 3582-3584. *Shih* edhe John Crosland, T 1931-1932; Prova Materiale P92, nënndarje 22 dhe 24.
[515] Ramiz Qeriqi, T 3583-3584.
[516] Ramadan Behluli, T 2856.

dëshmi se vazhdoi tërë ditën.[517] Forcat serbe patën viktima,[518] ndërsa u duk se nga ana e UÇK-së nuk pati të plagosur.[519]

157. Më 18 qershor 1998 u raportuan incidente në kufirin Kosovë-Maqedoni si rezultat i të cilëve mund të jenë vrarë tre policë serbë.[520] Një polic dhe ushtar serb u vranë më 18 qershor 1998 në Carralevë.[521]

158. Një raport i rregullt operativ i Organizatës Territoriale Ushtarake të UJ-së në Kosovë drejtuar Armatës së Tretë më 6 qershor 1998 përshkruante një sulm të UÇK-së kundër stacionit policor në Runik, Skënderaj.[522] Gjatë sulmit, UÇK-ja përdori granathedhësa, që tregon për mundësinë e tyre për ndërmarrjen e operacioneve më të gjera.[523] Në gjysmën e dytë të qershorit 1998, MPB-ja u detyrua të braktiste shumë postblloqe në zonën përreth Klinës së Epërme, Kluvanjës, Gjurakocit dhe Runikut.[524] U raportuan sulme në Fushë-Kosovë, pesë km nga Prishtina.[525] Raportet zbulojnë se në atë kohë UÇK-ja kontrollonte afërsisht 35% të territorit të Kosovës dhe ishte në gjendje të vepronte në 65% të saj.[526]

159. Më 23 qershor 1998 ose rreth kësaj date UÇK-ja mori kontrollin e një miniere qymyri dhe fshatin Bardh i Madh, 10km në perëndim të Prishtinës.[527] Në rrethinë u dëgjuan të shtëna gjatë tërë ditës dhe u raportua se banorët shqiptarë kosovarë ikën në Prishtinë.[528] Disa raporte tregojnë se UÇK-ja kishte lëshuar një thirrje për banorët vendas që të mos i braktisnin shtëpitë e tyre sepse UÇK-ja do të garantonte sigurinë e tyre.[529] Afërsisht pas një jave forcat serbe u orvatën ta rimerrnin minierën.[530] Raportet tregojnë se forcat serbe përdorën gaz lotsjellës, se në rrethinë u dëgjuan të shtëna automatiku dhe shpërthime dhe se në operacion morën pjesë forcat e sigurisë, UJ-ja dhe

[517] Ramiz Qeriqi, T 3583.
[518] Ramiz Qeriqi, T 3582-3583.
[519] Ramadan Behluli, T 2855.
[520] Prova Materiale P92, nënndarje 27; John Crosland, T 1939.
[521] John Crosland, T 1937.
[522] Philip Coo, T 5723.
[523] Philip Coo, T 5723.
[524] John Crosland, T 1941-1942.
[525] John Crosland, T 1943; Prova Materiale P92, nënndarje 29.
[526] John Crosland, T 1941.
[527] John Crosland, T 1937-1938, 1945-1950; Prova Materiale P92, nënndarje 30.
[528] Prova Materiale P92, nënndarje 30.
[529] Prova Materiale P92, nënndarje 30.
[530] Prova Materiale P92, nënndarje 32; Prova Materiale P62; Jan Kickert, T 710.

civilë të armatosur serbë.[531] Ky ishte operacioni i parë ku pala serbe konfirmoi zyrtarisht pjesëmarrjen e UJ-së.[532]

160. Afërsisht në të njëjtën kohë filloi luftimi në Klinë.[533] UÇK-ja kërkoi të merrte nën kontroll disa fshatra serbe në zonë me qëllim që të çelte një korridor midis Drenicës dhe Deçanit. U raportua se afërisht 800 serbë ikën nga fshatrat fqinje në Klinë.[534] Në fund të qershorit 1998, UÇK-ja organizoi një bllokadë në fshatin Kijevë që gjendet ndanë rrugës Pejë-Prishtinë.[535]

161. Më 23 qershor 1998 në Carralevë pati përsëri luftim.[536] Forcat serbe ishin të pajisura me tanke dy prej të cilëve u dëmtuan gjatë luftimit, i cili zgjati afërsisht 2-3 orë.[537] Luftimet vazhduan deri në fillim të korrikut 1998.[538] Sipas dëshmisë së Ramiz Qeriqit, nga 17 qershori deri më 25 korrik 1998 ndodhën gjashtë raste luftimi në rrethinën e Kroimirit, të gjitha të suksesshme për UÇK-në.[539]

162. Më 19 korrik 1998, UÇK-ja nisi mësymje mbi Rahovecin, operacion i përshkruar si sulmi i parë madhor i UÇK-së ndaj një qyteti më të madh.[540] Dëshmitë sugjerojnë se luftimi filloi lokalisht pa autorizimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së por pas fillimit të sulmit Shtabi i Përgjithshëm e mbështeti operacionin.[541] UÇK-ja kapi afërisht 85 serbë etnikë. Raportet tregojnë se 40 prej tyre nuk u panë më kurrë.[542] Manastiri i Shën Kozmait dhe Damianit në Zoçishtë, ku ishin strehuar disa serbë të moshuar gjatë luftimit, u sulmua me artileri të lehtë dhe mitralozë për 45 minuta dhe bujtina u dëmtua prej dy granatave.[543] Rahoveci mbeti nën kontrollin e UÇK-së deri më 21 korrik 1998 kur forcat serbe e rimorën qytetin.[544]

163. Gjatë tërë muajit korrik 1998 vazhduan luftimet midis forcave serbe dhe UÇK-së. Më 24 korrik 1998 forcat serbe ndërmorën një ofensivë të madhe në rajonin e Llapushnikut, Komoranit

[531] Prova Materiale P92, nënndarje 32.
[532] Prova Materiale P62; Jan Kickert, T 710.
[533] Prova Materiale P92, nënndarje 30.
[534] Prova Materiale P92, nënndarje 30.
[535] Prova Materiale P61; Jan Kickert T 707; Philip Coo, T 5731-5734.
[536] Ramadan Behluli, T 2816-2817.
[537] Ramadan Behluli, T 2816-2817.
[538] Jakup Krasniqi, T 3345-3351.
[539] Ramiz Qeriqi, T 3584-3587.
[540] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 79; Peter Bouckaert, T 5578. *Shih* edhe Jakup Krasniqi, T 3486.
[541] Jakup Krasniqi, T 3415-3417.
[542] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 79.
[543] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 79.
[544] Peter Bouckaert, T 5578- 5579.

dhe Klinës lindore.[545] Në betejën e Llapushnikut, më 25 dhe 26 korrik 1998, forcat serbe përdorën armë të rënda ushtarake si tanke, topa 220 mm dhe raketa "Katjusha".[546] Luftimet vazhduan tërë ditën më 25 korrik dhe 26 korrik 1998 derisa UÇK-ja u tërhoq nga rrethina.[547] Fshati Llapushnik kaloi nën kontrollin serb. Afërsisht në të njëjtën kohë pati luftime në Zborc dhe Carralevë.[548]

164. Siç është përmendur më herët, forcat serbe të angazhuara në Kosovë në 1998 përbëheshin kryesisht prej njësive të UJ-së dhe MPB-së. UJ-ja përfaqësohej kryesisht prej Korpusit të Prishtinës, që kishte një numër brigadash vartëse aktive, të blinduara të motorizuara dhe artilerike dhe i raportonte Armatës së Tretë, e cila nga ana e saj varej prej Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.[549] Gjithashtu përgjatë kufirit perëndimor të Kosovës u dislokuan elemente të Brigadës 63 të parashutistëve, Brigadës 72 të forcave të posaçme dhe Brigadës së parë të blinduar nga Beogradi.[550] Nga fundi i prillit 1998 u vu re prani e dendur e UJ-së në Kosovë.[551] Më 21 prill 1998 u ngrit një postkomandë pararojë e Korpusit të Prishtinës.[552] Në fund të prillit 1998, në zonën e Drenicës ishin ngritur gjashtë pozicione për bateri artilerike, që tregonte se UJ-ja ofronte mbështetje me zjarr për operacionet ekzistuese në terren të cilët në atë kohë kryheshin nga policia në atë rrethinë.[553] Në mes të majit 1998, vetëm UJ-ja kishte thuajse 2000 njerëz të caktuar për sigurimin e zonave kufitare të Kosovës dhe 2500 të tjerë për "kontroll në thellësi të territorit."[554]

165. Forcat e MPB-së përbëheshin prej Njësive të Posaçme Policore ("PJP"), që ishin të pajisura me autoblinda, mitralozë të rëndë dhe mortaja, midis të tjerash; Njësia e Posaçme Kundër Terrorit ("SAJ"); dhe Njësia e Operacioneve të Posaçme ("JSO").[555] Gjithashtu ishin të ashtuquajturat njësi të mbrojtjes lokale, organizata të formuara për mbrojtjen e fshatrave dhe qytezave të cilat përbëheshin prej civilëve, rezervistëve të MPB-së dhe përfaqësuesve të qarqeve territoriale ushtarake.[556] Në qershor 1998, me vendim të Presidentit Sllobodan Millosheviq, u formua Komanda e Përbashkët për Kosovën për të siguruar bashkëpunimin dhe harmoninë midis

[545] Philip Coo, T 5743; John Crosland, T 1965-1967; Prova Materiale P92, nënndarje 36.
[546] *Shih më sipër*, paragrafët 78-82
[547] *Shih më sipër*, paragrafët 80-82
[548] Ramiz Qeriqi, T 3584, 3590-3592.
[549] Prova Materiale P230, paragrafët 4-6; Philip Coo, T 5694-5695 .
[550] John Crosland, T 1890; Philip Coo, T 5694-5696.
[551] John Crosland, T 1897-1900.
[552] Philip Coo, T 5711-5714; Prova Materiale P230, paragrafët 27-28.
[553] John Crosland, T 1900.
[554] Prova Materiale P230, paragrafi 27.
[555] Prova Materiale P230, parag 8-12; Philip Coo, T 5597-5599; John Crosland, T 1872.
[556] Prova Materiale P230, paragrafët 15-21; Philip Coo, T 5702-5703.

institucioneve politike serbe, institucioneve për çështje civile, MPB-së dhe forcave të UJ-së në Kosovë.[557]

166. Siç është thënë më herët, në konflikt u përdorën midis të tjerash, tanke dhe mjete të blinduara, armë të artilerisë së rëndë, sisteme të mbrojtjes ajrore, autoblinda, mitralozë dhe lëndë shpërthyese. Gjithashtu ka dëshmi se në 1998 në Kosovë u përdorën edhe mina tokësore. Në shtator 1998 në një rrugë në jug të Likocit në zonën e Drenicës shpërthyen mina tokësore.[558] Mirëpo nuk është e qartë se ato ishin vendosur prej forcave serbe. Likoci ishte bazë e fortë e UÇK-së dhe ka disa sugjerime se minat ishin vendosur më parë prej shqiptarëve të Kosovës.[559]

167. Konflikti në Kosovë në periudhën në fjalë rezultoi në një numër të madh njerëzish të shpërngulur. UNHCR-ja në Podgoricë raportoi në fillim të majit 1998 se 5000 civilë kishin ikur nga Kosova në Mal të Zi në javët e fundit, 800 prej të cilëve kishin ikur në ditët e para të majit 1998.[560] Më 26 qershor 1998 i njëjti burim raportoi se në Mal të Zi ishin regjistruar formalisht 11500 refugjatë nga Kosova dhe në atë kohë vlerësohej se numri i tyre ishte 15000.[561]

168. Mbrojtja argumenton se nuk duhen konsideruar si konflikt i armatosur një sërë sulmesh sporadike dhe të përkohshme e rajonalisht të veçuara e të ndërmarra në një zonë të gjerë e të diskutuar gjeografike.[562] Pikëpamja e Dhomës është se aktet e dhunës që ndodhën në Kosovë nga fundi i majit 1998 deri të paktën më 26 korrik 1998 nuk është e saktë të përshkruhen si përkohësisht sporadike dhe gjeografikisht të shpërndara. Siç është shtjelluar në paragrafët e mëparshëm, përleshje periodike me armë ndodhën faktikisht në mënyrë të vazhdueshme në intervale mesatarisht tri deri në shtatë ditë nëpër një zonë gjeografike të gjerë që zgjerohej gjithnjë e më shumë.[563]

169. Gjithashtu Mbrojtja argumenton se përdorimi thjesht i njëanshëm i forcës nuk mund të përbëjë dhunë të tejzgjatur të armatosur që do të shënojë fillimin e një konflikti të armatosur.[564] Dhoma ka mendimin se ky argument nuk mbështetet prej fakteve të provuara në këtë proces. Ndërsa provat tregojnë se forcat e UÇK-së ishin numerikisht më të pakta se forcat serbe, më pak të organizuara dhe të përgatitura dhe nuk ishin aq të armatosura dhe të stërvitura, provat tregojnë se

[557] Prova Materiale P230, paragrafi 17; Philip Coo, T 5704.
[558] Prova Materiale P212, nënndarje 5, f 49.
[559] Prova Materiale P212, nënndarje 5, ff 49, 75.
[560] Prova Materiale P92, nënndarje 15.
[561] Prova Materiale P92, nënndarje 31.
[562] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 204. *Shih* edhe Dosjen Paragjyqësore të Mbrojtes për Limajn, paragrafi 15; Dosja e
Paragjyqësore e Mbrojtes për Musliun, paragrafi 15.
[563] *Shih më sipër*, paragrafët 136-163.
[564] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafi 27.

konflikti nuk ishte thjesht i njëanshëm. UÇK-ja kreu sulme kundër një sërë objektivash ushtarake, njerëzore dhe tregtare serbe nëpër një zonë të gjerë dhe në zgjerim të Kosovës.[565] Gjithashtu, forcat e UÇK-së ishin të afta t'u bënin qëndresë të fortë dhe efektive forcave serbe që ndërmorën operacione ushtarake dhe policore.[566] Ndërsa në periudhën në fjalë, në zonat përkatëse të Kosovës u dislokuan forca të shumta serbe, të mirëpajisura, UÇK-ja arriti një nivel të qenësishëm suksesi ushtarak të përgjithshëm, duke i mbërthyer forcat serbe me anë të taktikave efektive të tipit guerilje.

170. Në fund Mbrojtja argumenton se fuqia e forcave serbe nuk tregon se qëllimi i tyre ishte shkatërrimi i UÇK-së, por spastrimi etnik i Kosovës.[567] Megjithëse është e vërtetë se civilët u nxorën nga shtëpitë e tyre dhe u detyruan ta lëshonin Kosovën si rezultat i operacioneve ushtarake, provat zbulojnë se kjo ishte e vërtetë për të dyja palët. Padyshim që civilët ikën kur shtëpitë dhe fshatrat e tyre u shkatërruan dhe në disa raste njësitë e armatosura nga të dyja palët u angazhuan që kjo të ndodhte. Mirëpo për Dhomën nuk është e qartë se qëllimi i parë i aparatit ushtarak të secilës palë gjatë periudhës në fjalë, nuk ishte shkatërrimi i palës kundërshtare, edhe pse mund të kenë ekzistuar objektiva të tjera ose përfundimtare. Dy forcat ishin mbërthyer kryesisht në një luftë të dyanshme ushtarake. Megjithëse forcat serbe kishin epërsi të madhe numerike dhe ishin më të stërvitura dhe të pajisura, duket se ato ishin të keqpërgatitura për përballimin e forcave të vogla guerilje që nuk i mbërthenin ato në beteja të përzgjatura fikse. Gjithashtu zbulimi ushtarak serb mund të ketë mbivlerësuar fuqinë dhe aftësitë e UÇK-së në atë kohë kështu që forcat serbe u dislokuan në numër më të madh dhe me mjete më të shumta ushtarake sesa ishte e nevojshme në lidhje me forcat faktike të UÇK-së. Në lidhje me këtë, dëshmitë zbulojnë se shumë operacione luftarake u kryen në zonën e Drenicës ku UÇK-ja u zhvillua më herët dhe ndoshta ishte më e organizuar. Por Dhoma mendon se më e rëndësishme është se përcaktimi i ekzistencës së konfliktit të armatosur bazohet vetëm në dy kritere: ashpërsia e konfliktit dhe organizimi i palëve, rrjedhimisht synimi i forcave të armatosura për t'u përfshirë në akte dhune apo për arritjen e objektivave të tjera nuk ka rëndësi në lidhje me këtë aspekt.

(iii) Përfundim

171. Dhoma është e bindur se para fundit të majit 1998 në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së. Në atë kohë UÇK-ja kishte një Shtab të Përgjithshëm që emëronte komandantët e zonave, u jepte udhëzime njësive të ndryshme të formuara ose në

[565] *Shih më sipër*, paragrafët 147; 158; 159 dhe 162.
[566] *Shih më sipër*, paragrafët 76; 142; 149; 153; 155; 156; 159 dhe 161.
[567] Argumentet Përmbyllëse, T 7490.

formim e sipër dhe nxirrte deklarata publike në emër të organizatës.[568] Komandantët e njësive jepnin urdhra luftarakë dhe përgjithësisht njësitë vartëse dhe ushtarët vepronin në përputhje me këto urdhra.[569] U morën masa për hartimin e rregullave disiplinore dhe krijimin e policisë ushtarake[570] si edhe për rekrutimin, stërvitjen dhe pajisjen e anëtarëve të rinj.[571] Megjithëse përgjithësisht më pak të pajisur se UJ-ja dhe MPB-ja, ushtarët e UÇK-së kishin armë, ndër të cilat, mortaja artilerike dhe granathedhësa.[572] Deri në korrik 1998 UÇK-ja ishte pranuar si pjesëmarrës i nevojshëm dhe i vlefshëm në negociatat me qeveritë dhe organizmat ndërkombëtare për përcaktimin e një zgjidhjeje të krizës së Kosovës dhe për hartimin e kushteve në këto negociata për moskryerjen e operacioneve ushtarake.[573]

172. Gjithashtu, nga fundi i majit 1998, njësitë e UÇK-së ishin të angazhuara vazhdimisht në përleshje të armatosura me forca të konsiderueshme serbe në zonat përgjatë kufirit Kosovë-Shqipëri në perëndim, deri afër Prishtinës në lindje, Prizrenit dhe kufirit Kosovë-Maqedoni në jug dhe deri në komunën e Mitrovicës në veri.[574] Aftësia e UÇK-së për t'u përfshirë në operacione të tilla të ndryshme është një tregues tjetër i nivelit të organizimit të saj. Nga ana serbe në konflikt u angazhuan forcat e posaçme serbe të armatosura rëndë, të MPB-së dhe UJ-së dhe përpjekjet e tyre synonin të kontrollonin dhe shtypnin forcat e UÇK-së. Civilët serbë dhe shqiptarë të Kosovës u detyruan të braktisnin shtëpitë, fshatrat dhe qytetet e tyre për shkak të operacioneve ushtarake dhe numri i viktimave po rritej.

173. Për sa më sipër, Dhoma është e bindur dhe gjykon se në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur i brendshëm para fundit të majit 1998. Ai vazhdoi edhe për një kohë të gjatë pas 26 korrikut 1998.

174. Gjithashtu duke marrë parasysh përfundimet e veta të nxjerra gjetiu në këtë vendim, Dhoma është e bindur se është provuar lidhja e kërkuar midis sjelljes së pretenduar në Aktakuzë dhe konfliktit të armatosur. Veçanërisht, Dhoma u referohet përfundimeve të veta se kamp-burgu ku ndodhën krimet e pretenduara u ngrit pasi UÇK-ja mori nën kontroll fshatin Llapushnik,[575] se ai

[568] *Shih më sipër*, paragrafët 94; 96; 98; 99; 100; dhe 101-103.
[569] *Shih më sipër*, paragrafët 105 dhe 109.
[570] *Shih më sipër*, paragrafët 110-112 dhe 113-116.
[571] *Shih më sipër*, paragrafët 118-120.
[572] *Shih më sipër*, paragrafët 121; 122 dhe 158.
[573] *Shih më sipër*, paragrafët 125-129.
[574] *Shih më sipër*, paragrafët 144-163.
[575] *Shih më sipër*, paragrafin 76.

drejtohej nga anëtarë të UÇK-së[576] dhe se efektivisht kampi pushoi së ekzistuari pasi UÇK-ja e humbi kontrollin e grykës së Llapushnikut.[577] Të burgosurit në kamp ishin kryesisht, në qoftë se jo tërësisht, ata serbë ose shqiptarë të Kosovës që ishin bashkëpunëtorë ose që dyshoheshin se bashkëpunonin me autoritetet serbe.

2. Katër kushtet *Tadiq*

175. Në jurisprudencën e Tribunalit është provuar se që një vepër penale të jetë brenda juridiksionit të Nenit 3 të Statutit, duhen përmbushur katër kushte:

> (i) shkelja duhet të përbëjë thyerje të një rregulle të së drejtës humanitare ndërkombëtare;
>
> (ii) rregulla duhet të jetë zakonore në përmbajtje ose, në qoftë se është ligj traktati, duhet të përmbushen kushtet e kërkuara;
>
> (iii) shkelja duhet të jetë e rëndë, me fjalë të tjera, duhet të përbëjë thyerje të një rregulle që mbron vlera të rëndësishme dhe thyerja duhet të shkaktojë pasoja të rënda për viktimën;
>
> (iv) shkelja e rregullës duhet të përmbajë sipas të drejtës zakonore ose konvencionale përgjegjësinë penale individuale të personit që thyen rregullën.[578]

176. Për rastin në fjalë, tre të Akuzuarit ngarkohen me katër akuza për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit, përkatësisht dy akuza për trajtim mizor, një akuzë për torturë dhe një për vrasje. Të katër akuzat bazohen në Nenin e Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949. Dhoma e Apeleve ka gjykuar se shkeljet e Nenit të Përbashkët 3 përfshihen në Nenin 3 të Statutit.[579] Veçanërisht jurisprudenca ka përcaktuar se Neni i Përbashkët 3 është pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare,[580] se e drejta zakonore ndërkombëtare imponon përgjegjësi penale për shkelje të rënda të Nenit të Përbashkët 3[581] dhe se shkeljet e rënda të Nenit të Përbashkët 3 gjithashtu plotësojnë katër kushtet *Tadiq*.[582] Më tej, meqë Neni i Përbashkët 3 mbron personat mospjesëmarrës në luftime, viktimat e shkeljes së pretenduar duhet të mos kenë marrë pjesë aktivisht në luftime në kohën e kryerjes së krimit.[583]

---

[576] *Shih më poshtë*, paragrafët 273 dhe 276.
[577] *Shih më poshtë*, paragrafin 278.
[578] Vendimi *Tadiq* për Juridiksionin, paragrafi 94; Shih dhe Vendimin e Apelit *Aleksovski,* paragrafi 20; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 66.
[579] Vendimi *Tadiq* për Juridiksionin, paragrafi 89; Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 136; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 68.
[580] Vendimi *Tadiq* për Juridiksionin, paragrafi 98; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 68.
[581] Vendimi *Tadiq* për Juridiksionin, paragrafi 134; Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafët 153-174.
[582] Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 125; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 68.
[583] Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 420; Aktgjykimi *Blagojeviq,* paragrafi 540; Aktgjykimi *Kvoçka,* paragrafi 124 dhe Aktgjykimi *Jelisiq,* paragrafi 34.

177. Mbrojtja nuk pajtohet me vendimet e Dhomës së Apelit dhe argumenton se penalizimi i Nenit të Përbashkët 3 ende nuk ka fituar statusin e së drejtës zakonore ndërkombëtare.[584] Ata kundërshtojnë veçanërisht se praktika shtetërore dhe *opinio juris* përcaktojnë përgjegjësi penale për shkelje të Nenit të Përbashkët 3[585] dhe se Konventat e Gjenevës të vitit 1949 ofrojnë bazë për penalizimin e shkeljeve të Nenit të Përbashkët 3,[586] dhe argumentojnë se e drejta humanitare ndërkombëtare bën dallim midis konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe të brendshme dhe rrjedhimisht përgjegjësia individuale penale për aktorët joshtetërorë mund të mos jetë në nivel ndërkombëtar.[587] Mbrojtja argumenton se përgjegjësia penale për shkeljet e Nenit të Përbashkët 3 mund të shkelë parimin *nullum crimen sine lege* meqë penalizimi i Nenit të Përbashkët 3 nuk përbënte një pasqyrim të vërtetë të së drejtës zakonore ndërkombëtare në atë kohë.[588] Gjithashtu argumentohet se në bazë të provës përcaktuar në Vendimin mbi Apelin *Aleksovski* interesi i drejtësisë kërkon një ndryshim nga vendimet e mëparshme të Dhomës së Apelit.[589]

178. Statusi i vendimeve të Dhomës së Apelit u përcaktua në Vendimin mbi Apelin *Aleksovski*. Në bazë të këtij vendimi *ratio decidendi* /arsyet e vendimeve/ të Dhomës së Apelit janë detyruese për Dhomën Gjyqësore.[590] Dhoma e Apelit duhet të ndjekë vendimet e veta të mëparshme, mirëpo duhet të ketë lirinë të shkëputet prej tyre për arsye të forta në interes të drejtësisë.[591] Në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes, Dhomat Gjyqësore nuk mund të shkëputen prej vendimeve të mëparshme të Dhomës së Apelit.

179. Duke marrë parasysh sa më sipër, Dhoma nuk e gjykon të nevojshme të shtjellojë më tej argumentet e Mbrojtjes në lidhje me këtë. Duke u bazuar në jurisprudencën të Dhomës së Apelit ajo do të provojë përmbushjen e katër kushteve *Tadiq* në lidhje me shkeljet e rënda të Nenit të Përbashkët 3. Dhoma u referohet përfundimeve të veta të nxjerra gjetiu se viktimat e mbajtura në kamp-burg në periudhën në fjalë nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime[592] dhe rrjedhimisht gjykon se për rastin në fjalë janë provuar parakushtet juridiksionale të Nenit 3 të Statutit.

---

[584] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafët 47-58.
[585] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafët 50-52.
[586] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafi 55.
[587] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafët 56-57.
[588] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafët 58-59.
[589] Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur, paragrafi 48.
[590] Vendimi i Apelit *Aleksovski,* paragrafi 113.
[591] Vendimi i Apelit *Aleksovski,* paragrafi 107.
[592] *Shih më poshtë*, paragrafët 279; 331; 340; 348; 359; 367; 376; 384; 398; 410; 415; 419; 423; 427; 430; 433; 436; 440 dhe 444.

B. Juridiksioni sipas Nenit 5

1. Kuadri ligjor

180. Krimet e përmendura në Nenin 5 të Statutit janë krime kundër njerëzimit vetëm kur "kryhen në një konflikt të armatosur".[593] Ky kusht kthehet në domosdoshmëri për të provuar se në kohën dhe vendin përkatës *ekzistonte* konflikt i armatosur dhe se objektivisht, veprimet e të akuzuarit lidhen gjeografikisht dhe në mënyrë kohore me konfliktin e armatosur.[594] Nuk kërkohet lidhje midis krimeve kryesore dhe konfliktit të armatosur. Megjithëse veprimet ose mosveprimet duhet të ndodhin gjatë konfliktit të armatosur, e vetmja lidhje që kërkohet është midis veprimeve të të akuzuarit dhe sulmit mbi popullatën civile (koncept i shtjelluar në paragrafët vijues).[595]

181. Për t'u cilësuar si krime kundër njerëzimit, veprimet e të akuzuarit duhet të jenë pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik "kundër një popullate civile". Jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar se elementet e përgjithshëm të nevojshëm për zbatueshmërinë e Nenit 5 të Statutit janë: (i) duhet të ekzistojë një sulm; (ii) veprimet e kryesit duhet të jenë pjesë e sulmit; (iii) sulmi duhet të jetë kundër një popullate civile; (iv) sulmi duhet të jetë i gjerë ose sistematik; dhe (v) kryesi duhet të dijë se veprimet e tij ose të saj janë pjesë e një praktike të krimeve të gjera ose sistematike kundër një popullate civile dhe të dijë se veprimet e tij ose të saj përputhen me këtë praktikë (me fjalë të tjera të njohë kornizën më gjerë brenda së cilës ndodhin veprimet e tij ose të saj dhe të dijë se veprimet e tij ose të saj janë pjesë e sulmit).[596]

182. Konceptet e "sulmit" dhe "konfliktit të armatosur" janë kuptime të dallueshme dhe të veçanta, megjithëse sipas Nenit 5 të Statutit, sulmi kundër një popullate civile mund të jetë pjesë e një konflikti të armatosur.[597] Sulmi është përkufizuar si një varg veprimesh që përfshin kryerjen e akteve të dhunës.[598] Ndoshta, për të qenë më i dobishëm, në kontekst të krimeve kundër njerëzimit, fjala "sulm" nuk kufizohet në përdorimin e forcës së armatosur por gjithashtu përfshin çfarëdo keqtrajtimi të popullatës civile.[599] Ai mund t'i paraprijë, të shkojë më tej ose të vazhdojë gjatë konfliktit të armatosur, pra mund të jetë, por jo domosdoshmërisht, pjesë e konfliktit të armatosur.[600]

---

[593] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafët 82 dhe 86.
[594] Vendimi i Apelit *Tadiq,* paragrafi 251; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 83; Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 23.
[595] Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 33.
[596] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 85.
[597] Aktgjykimi *Vasileviq,* paragrafi 30; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 86.
[598] Aktgjykimi *Naletiliq,* paragrafi 233.
[599] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 86; Aktgjykimi *Vasileviq,* paragrafët 29-30.
[600] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 86.

183. Sulmi duhet të jetë i gjerë *ose* sistematik, kushti është veçues dhe jo bashkues.[601] Fjala "i gjerë" i referohet karakterit në shkallë të madhe të sulmit dhe numrit të viktimave, ndërsa shprehja "sistematik" i referohet karakterit të organizuar të veprimeve të dhunës dhe pamundësisë së ndodhisë së rastësishme të tyre.[602] Dhoma e Apelit ka deklaruar se praktika e krimeve, përkatësisht përsëritja jorastësore e rregullt e një sjelljeje të ngjashme kriminale është shprehje e kësaj ndodhie sistematike.[603] Sipas Dhomës së Apelit,

> "vlerësimi i çfarë përbën sulm "të gjerë" ose "sistematik" është në thelb relativ në aspektin se varet prej popullatës civile e cila pretendohet se po sulmohej. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore duhet 'fillimisht të identifikojë popullatën që është objekt i sulmit dhe duke marrë parasysh mjetet, metodat, burimet dhe rezulatin e sulmit kundër popullatës, të qartësojë nëse me të vërtetë sulmi ishte i gjerë ose sistematik'. Pasojat e sulmit kundër popullatës së shënjuar, numri i viktimave, karakteri i veprimeve, pjesëmarrja e mundshme e zyrtarëve ose autoriteteve ose çfarëdo praktikë e identifikueshme e krimeve mund të merren në shqyrtim për të përcaktuar nëse sulmi përmbush njërin prej dy kushteve, ose të dy, sulm i 'gjerë' ose 'sistematik' në lidhje me popullatën e caktuar civile."[604]

184. Ekzistenca e një strategjie ose plani (ose se kryerja e krimeve u mbështet nga një strategji ose plan) mund të jetë domethënëse në aspektin e provave, mirëpo nuk është kusht ligjor për të vërtetuar karakterin e gjerë ose sistematik të sulmit dhe se ai drejtohej kundër një popullate civile.[605]

185. Sulmi duhet të jetë kundër një popullate civile. Ashtu siç ka deklaruar Dhoma e Apelit

> "shprehja "drejtuar kundër" është një shprehje e cila 'përcakton se në kontekstin e një krimi kundër njerëzimit popullata civile është objekti parësor i sulmit.' Për të përcaktuar nëse mund të thuhet se sulmi

[601] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 97; Aktgjykimi *Naletilić,* paragrafi 236; Aktgjykimi *Kunarac,* paragrafi 431; Vendimi i Apelit *Kordić,* paragrafi 94; Dhoma thekson se pasi ajo bindet se është përmbushur njëri prej kushteve, nuk është e detyruar të shqyrtojë nëse është përmbushur kushti alternativ, Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 93.
[602] Vendimi i Apelit *Blashkić,* paragrafi 101.
[603] Vendimi i Apelit *Blashkić,* paragrafi 101, ku citohet Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 94.
[604] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 95 (pa shënimet në fund të faqes)
[605] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 98; 101. Dhoma e Apelit gjykoi se "as sulmi dhe as veprimet e të akuzuarit nuk kanë nevojë të mbështeten prej ndonjë 'strategjie' ose 'plani' […]mund të jetë e dobishme të provohet se sulmi ishte drejtuar kundër një popullate civile dhe se ishte i përhapur ose sistematik (sidomos ky i fundit) për të treguar se në fakt ekzistonte një strategji apo plan po ndoshta këto çështje mund të provohen duke iu referuar çështjeve të tjera." Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e moderoi përfundimin e Dhomës Gjyqësore *Blashkiq* në lidhje me ekzistencën e një strategjie apo plani. Duhet mbajtur parasysh se Dhoma Gjyqësore *Blashkiq* pohoi se "karakteri sistematik ka të bëjë me katë elementë, të cilët në lidhje me këtë rast mund të shprehen si vijon: 1) ekzistenca e një objektivi politik, një plan mbi bazën e të cilit kryhet sulmi, ose një ideologji në kuptimin e gjerë të fjalës, d.m.th., për shkatërrimin, përndjekjen ose dobësimin e një popullate; 2) kryerja e një veprimi kriminal në një shkallë shumë të gjerë kundër një grupi civilësh ose kryerja e përsëritur dhe e vazhdueshme e veprimeve çnjerëzore që kanë lidhje me njëri-tjetrin; 3) kryerja dhe përdorimi i burime ushtarake ose të tjera të konsiderueshme, publike ose private; 4) përfshirja e autoriteteve të larta politike dhe/ose ushtarake në përkufizimin dhe hartimin e planit metodik (parag 203). Dhoma e Apelit deklaroi se

ishte drejtuar kundër, Dhoma Gjyqësore, *ndër të tjera* do të marrë në shqyrtim mjetet dhe metodat e përdorura gjatë sulmit, statusin e viktimave, numrin e tyre, karakterin diskriminues të sulmit, karakterin e krimeve të kryera gjatë tij, qëndresën ndaj sulmuesve në atë kohë dhe shkallën që mund të thuhet të përmbushjes ose orvatjes për përmbushjen e kushteve paralajmërues të ligjeve të luftës prej forcës sulmuese. Në qoftë se krimet e pretenduara kundër njerëzimit u kryen gjatë një konflikti të armatosur, ligjet e luftës janë një matës me të cilët Dhoma mund të vlerësojë karakterin e sulmit dhe ligjshmërinë e veprimeve të kryera gjatë tij."[606]

186. Dhoma rikujton se e drejta zakonore ndërkombëtare ndalon absolutisht marrjen në shënjestër të civilëve.[607] Shprehja "popullatë civile" duhet interpretuar gjerësisht dhe bën fjalë për një popullatë që ka karakter mbizotërues civil. Një popullatë mund të cilësohet "civile" edhe po të ketë jocivilë midis saj për sa kohë që është kryesisht civile.[608] Prania brenda një popullate e anëtarëve të grupeve të armatosura të qëndresës, apo ish-luftëtarëve të cilët kanë dorëzuar armët nuk e ndryshon karakterin e saj civil.[609] Si rezultat, përkufizimi "civil" është i gjerë dhe përfshin individë të cilët në një kohë të caktuar kryen akte qëndrese si edhe personat që ishin jashtë luftimit kur u krye krimi.[610] Domëthënës për përcaktimin nëse prania e ushtarëve brenda një popullate civile e privon popullatën prej karakterit të saj civil është numri i ushtarëve si edhe nëse ata janë me lejë.[611] Nuk ekzistojnë kushte që viktimat të jenë lidhur me një palë të veçantë në konflikt.[612]

187. Në jurisprudencën e Tribunalit është theksuar se fjala "popullatë" nuk nënkupton se duhet të jetë sulmuar krejt popullata në tërësinë gjeografike në të cilën po ndodh sulmi.[613] Është provuar se marrja në shënjestër e një grupi të zgjedhur civilësh – për shembull vrasja e caktuar e një numri kundërshtarësh politikë - nuk mund të përmbushë kushtet e Nenit 5. Është e mjaftueshme të

---

ekzistenca e një strategjie apo plani mund të jetë e rëndësishme si provë, por nuk është element ligjor i krimit, Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafët 100 dhe 120.

[606] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 91 (pa shënimet në fund të faqes); Aktgjykimi *Naletiliq,* paragrafi 235.

[607] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 109.

[608] Aktgjykimi *Jelisiq,* paragrafi 54; Aktgjykimi *Kupreshkiq,* paragrafët 547-549; Aktgjykimi *Naletiliq,* paragrafi 235; Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 180; Aktgjykimi *Kupreshkiq,* paragrafi 549; Aktgjykimi *Blashkiq,* paragrafi 214; Aktgjykimi *Jelisiq,* paragrafi 54.

[609] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 113. Në këtë rast Dhoma Gjyqësore kishte mendimin (parag 214) se shprehja popullatë 'civile' përfshin anëtarët e një levizjeje qëndrese si edhe ish-luftëtarë (pavarësisht nëse mbanin ose nuk mbanin uniforma) me kusht që ata nuk merrnin pjesë në luftime kur u kryen krimet e pretenduara për arsye se ose ata ishin larguar nga ushtria, ose nuk mbanin më armë, ose përfundimisht ishin jashtë luftimit, veçanërisht për shkak se ishin plagosur ose ishin kapur. *Shih* dhe Aktgjykimin *Jelesiq,* paragrafi 54; Aktgjykimin *Kordiq,* paragrafi 180 dhe Aktgjykimin *Naletiliq,* paragrafi 235.

[610] Aktgjykimi *Galiq,* paragrafi 143.

[611] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 115.

[612] Aktgjykimi *Vasileviq,* paragrafi 33.

[613] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 109; Aktgjykimi *Galiq,* paragrafi 143. Në përcaktimin e shtrirjes së shprehjes "popullatë civile", është e nevojshme të qartësohet statusi i së drejtës zakonore në kohën e kryerjes së krimeve duke marrë parasysh veçanërisht Nenin 50 të Protokollit Shtesë I dispozitat e të cilit mund të konsiderohen se pasqyrojnë

tregohet se gjatë sulmit u vunë në shënjestër një numër i mjaftueshëm individësh apo se ata u zgjodhën në një mënyrë që e bind Dhomën se në fakt sulmi ishte drejtuar kundër një "popullate" civile, dhe jo kundër një numri të kufizuar individësh të zgjedhur kuturu.[614]

188. Ashtu siç deklaroi Dhoma e Apelit në *Kunarac*, lidhja e kërkuar midis veprimeve të të akuzuarit dhe sulmit në fakt përmban dy elementë:

- kryerja e një veprimi, i cili prej karakterit apo pasojave është objektivisht pjesë e sulmit; dhe

- dijenia e të akuzuarit se ndaj popullatës civile po kryhet sulm dhe veprimi i tij ose i saj është pjesë e këtij sulmi.[615]

189. Së pari duhet provuar se krimet e pretenduara kishin lidhje me sulmin kundër një popullate civile gjatë një konflikti të armatosur. Me fjalë të tjera, duhet provuar se verpimet e të akuzuarit nuk janë të veçuara,[616] por prej karakterit dhe pasojave, janë objektivisht pjesë e sulmit.[617] Veprimet nuk është e nevojshme të kryhen gjatë sulmit me kusht që ata të kenë lidhje të mjaftueshme me sulmin.[618] Vetëm sulmi, jo veprimet individuale të të akuzuarit, duhet të jetë i gjerë ose sistematik.[619]

190. Kushti i dytë që duhet provuar si pjesë e "lidhjes" është dijenia e të akuzuarit për ekzistencën e një sulmi kundër një popullate civile dhe se veprimet e tij ose të saj janë pjesë e tij. Prova e dijenisë është në varësi të fakteve të një rasti të veçantë; si pasojë, mënyra me anë të së cilës mund të provohet ky element ligjor ndryshon sipas rastit.[620] Nuk është e mjaftueshme që një i akuzuar me vetëdije mori përsipër rrezikun e pjesëmarrjes në zbatimin e strategjisë.[621] Megjithatë, i

---

përgjithësisht të drejtën zakonore dhe rrjedhimisht janë të vlefshme në lidhje me shqyrtimin në fjalë sipas Nenit 5 të Statutit. *Shih* Vendimin e Apelit*, Kordiq,* paragrafi 97.

[614] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 90.

[615] Vendimi i Apelit *Tadiq,* paragrafi 271; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 99. Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 126; Vendimi i Apelit *Kordiq,* paragrafët 99-100; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 99-102.

[616] Një krim do të konsiderohet si 'veprim i izoluar' kur është kaq shumë i veçuar prej sulmit, duke marrë parasysh kontekstin dhe rrethanat kur u krye, saqë logjikisht nuk mund të thuhet se ishte pjesë e sulmit, Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 100.

[617] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 96; Vendimi i Apelit *Kordiq,* paragrafi 178.

[618] Vendimi *Tadiq* për Juridiksionin, paragrafi 251; paragrafi 271; Aktgjykimi *Naletiliq*, paragrafi 234; Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 100.

[619] Vendimi i Apelit *Kordiq,* paragrafi 94.

[620] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 126.

[621] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 125-126.

akuzuari nuk ka nevojë të dijë hollësitë e sulmit apo të miratojë kontekstin brenda të cilit ndodhin veprimet e tij ose të saj.[622] I akuzuari duhet të kuptojë vetëm kontekstin e përgjithshëm në të cilin ndodhin veprimet e tij ose të saj.[623] Motivet e pjesëmarrjes së të akuzuarit në sulm nuk kanë rëndësi,[624] po ashtu si edhe fakti nëse i akuzuari synonte që veprimet e tij ose të saj drejtoheshin kundër popullatës së zgjedhur apo thjesht kundër viktimës së tij ose të saj, sepse është sulmi, dhe jo veprimet e të akuzuarit, i cili duhet të jetë kundër popullatës së zgjedhur, dhe është e nevojshme vetëm që i akuzuari të dijë se veprimet e tij ose të saj janë pjesë e tij.[625]

2. Përfundime

191. Karakteri i "sulmit" pretenduar prej Prokurorisë në këtë proces mpleks një sërë rrethanash ndjeshmërisht të ndryshme nga ato të shqyrtuara më parë prej Tribunalit në trajtimin e zbatimit të Nenit 5. Për shkak të faktorëve strukturalë dhe mundësive organizative dhe ushtarake, një "sulm i drejtuar kundër një popullate civile" më së shpeshti do të zbulohet se ka ndodhur me urdhrin e një shteti. Duke qenë qendra e pushtetit të organizuar brenda një territori të caktuar i aftë të mobilizojë dhe drejtojë fuqi ushtarake dhe civile, shteti sovran nga vetë karakteri zotëron cilësi që e lejojnë të organizojë dhe ndërmarrë sulm kundër një popullate civile; shtetet janë në gjendje që me lehtësi dhe efektivitet të grumbullojnë mjete dhe burime për nisjen e një sulmi kundër një popullate civile në një shkallë "të gjerë" apo mbi një bazë "sistematike". Kurse, faktikisht Dhoma ka para saj një akuzë për një sulm kundër një popullate civile kryer prej një aktori joshtetëror me organizim, personel dhe burime tejet të kufizuara.

192. Prokuroria akuzon për një praktikë të sulmeve të UÇK-së kundër civilëve nëpër një zonë të gjerë gjeografike të Kosovës e mjaftueshme për të qenë sulm i gjerë ose sistematik.[626] Mbrojtja pretendon se Prokuroria nuk ka provuar se ndonjë sulm kundër civilëve në Kosovë, veç atyre të kryer nga forcat serbe kundër shqiptarëve të Kosovës dhe që nuk janë pjesë e kësaj Aktakuze, pati karakter të gjerë ose sistematik.[627]

---

[622] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 102.
[623] Aktgjykimi *Kordiq*, paragrafi 185.
[624] Vendimi i Apelit *Tadiq,* paragrafi 248-272 cituar në Vendimin e Apelit *Kunarac,* paragrafi 103; Dhoma e Apelit konsideroi se "provat se [veprimet u kryen] për arsye thjesht personale, më së shumti mund të ishin tregues të një supozimi kundërshtues se ai nuk kishte dijeni se veprimet e tij ishin pjesë e atij sulmi."
[625] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 103.
[626] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 264.
[627] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 369.

193. Para se të marrë në shqyrtim sjelljen e UÇK-së, Dhoma thekson që në fillim se ekzistenca e një sulmi nga ana e një pale e përfshirë në konflikt të armatosur kundër popullatës civile të palës tjetër nuk e përligj sulmin e palës tjetër kundër popullatës civile të kundërshtarit të vet.[628] Nuk gjen zbatim parimi *tu quoque.*[629] Gjithsesi Dhoma është e vetëdijshme për operacionet e forcave serbe në Kosovë, të cilat përdorën taktika që përfshinë rrafshimin e fshatrave dhe dëbimin e civilëve nga fshatrat dhe shkaktuan vuajtje të gjera e të konsiderueshme të civilëve.[630]

194. Është theksuar në mënyrë të përsëritur se elementi kontekstual i nevojshëm për zbatimin e Nenit 5 përjashton nga sfera e krimeve kundër njerëzimit veprimet e veçuara, kuturu apo të kufizuara.[631] Siç është nënvizuar,[632] që të kemi "sulm" veprimi përkatës nuk ka nevojë të jetë sulm ushtarak apo marrje nën kontroll me forcë; provat duhet vetëm të dëshmojnë "një praktikë veprimi" drejtuar kundër popullatës civile që tregon një shtrirje të gjerë ose sistematike. Megjithatë, ekzistenca e një sulmi është qartësisht e dukshme kur kjo praktikë veprimesh ndodh mbi bazë të një operacioni të madh shtetëror. Kjo mund të ilustrohet prej një numri shembujsh. Në *Prokurorja kundër Nikoliqit* Dhoma Gjyqësore shqyrtoi ekzistencën e masave diskriminuese dhe një "kontrollmarrje autoritare" e cila instaloi "një strukturë autoritare pushteti" si dëshmi të një sulmi në rajonin përkatës gjeografik.[633] Në *Prokurorja kundër Mërkshiqit dhe të tjerëve*, në përcaktimin e ekzistencës së një sulmi Dhoma Gjyqësore shqyrtoi një numër faktorësh domëthënës që përfshinin: "ofensivë të madhe tokësore, detare dhe ajrore prej forcave të APJ-së"; granatim të dendur të qytetit Vukovar për një periudhë trimujore, dhe largimin masiv të grave dhe fëmijëve.[634]

195. Përkundrejt këtyre shembujve, në të cilët forca sulmuese zotëronte epërsi të madhe ushtarake, rasti që po shqyrton Dhoma është dukshëm i ndryshëm. Akuzat në fjalë kundër anëtarëve të UÇK-së janë ndër të tjera sulm drejtuar kundër popullatës civile kryer prej asaj që mund më së miri të përshkruhet për periudhën në fjalë të Aktakuzës si forcë guerilje e mbërthyer në luftime të kufizuara me forca konvencionale ushtarake superiore. Dhoma ka nxjerrë përfundimin se rrethanat ekzistuese gjatë kornizës kohore të përfshirë në Aktakuzë, ishin të mjaftueshme për ekzistencën e

[628] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 87 citon Aktgjykimin *Kupreshkiq*, paragrafi 765.
[629] Aktgjykimi *Kupreshkiq*, paragrafi 765
[630] John Crosland, T 1871; 1920; 1926.
[631] Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare, 1996 *Draft Code of Crimes against Peace and Security of Mankind*, koment mbi Nenin 18; Aktgjykimi *Tadiq,* paragrafët 646,648,653; Aktgjykimi *Akayesu, paragrafi 579.*
[632] *Shih më sipër*, paragrafin 182.
[633] *Prokurorja kundër Dragan Nikoliqit* me pseudonimin "*Jenki*", Rishqyrtim i Aktakuzës në bazë të Rregullës 61 të Rregullores së Procedurës dhe Provave. Lënda Nr: IT-94-2-R61, 20 Tetor 1995, paragrafi 27
[634]*Prokurorja kundër Mile Mërkshiqit, Miroslav Radiqit dhe Veselin Shlivançinit*, Rishqyrtim i Aktakuzës në bazë të Rregullës 61 të Rregullores së Procedurës dhe Provave , Lënda Nr: IT-95-13-R61, 3 Prill 1996, paragrafi 33.

një konflikti të brendshëm të armatosur.[635] Ky konflikt i armatosur i brendshëm kishte karakter të ndryshueshëm. Secila prej forcave kundërshtare kontrollonte zona të ndryshme të Kosovës për periudha të shkurtra kohore.[636] Kishte kalime të shpeshta të territorit nga njëra palë në tjetrën dhe gjatë majit, qershorit dhe korrikut 1998 u zhvilluan beteja të rrepta të lokalizuara midis UÇK-së dhe forcave serbe të cilat zgjatën një, dy ose tri ditë. Kjo ndodhte pjesërisht për shkak të burimeve më të shumta në dispozicion të forcave serbe dhe pjesërisht për shkak të karakterit të strukturave dhe objektivave ushtarake të UÇK-së. UÇK-ja, si forcë e vogël kryengritëse, por gjithnjë në rritje, e vuri theksin më pak në kontrollin territorial dhe u përqëndrua në forma të tjera luftimi.[637]

196. Në Pejë, në mars 1998, elementë të UÇK-së ndërmorën veprime që një dëshmitar i përshkroi si veprime shpaguese ndëshkuese kundër bizneseve dhe biznesmenëve për të cilët besohej se bashkëpunonin me serbët.[638] Bizneset u goditën me bomba dhe pronarët e tyre u vranë.[639] Herët në prill 1998 John Crossland citoi raporte të medias shtetërore serbe për një numër të madh familjesh serbe që po largoheshin nga rajoni i Deçanit për shkak të shqetësimit të vazhdueshëm prej shqiptarëve të armatosur të Kosovës.[640] Megjithëse John Crosland deklaroi se këto raporte ishin të tepruara, ai gjithashtu pohoi se ato përmbanin një farë të vërtete.[641] Gjendja e sigurisë në Kosovë po përkeqësohej prej veprimeve nga të dyja palët.[642]

197. John Crosland tregoi se më 6 prill 1998 në një pyll afër Rahovecit u gjetën gjashtë kufoma.[643] Sipas tij, këta persona ndoshta ishin vrarë për shkak se nuk kishin mbështetur "çështjen shqiptare", mirëpo ishte e pamundur të thuhej me qartësi për shkak të "gjendjes së paqëndrueshme" në atë kohë.[644]

198. Më 23 prill 1998, në Deçan dhe Gjakovë u raportua se civilë serbë dhe shqiptarë po largoheshin nga rajoni për shkak të intensitetit në rritje të luftimeve midis dy forcave kundërshtare në konfliktin e armatosur.[645] Shtëpitë në zonën e Ponoshecit ishin në gjendje të keqe të shkatërruar

[635] *Shih më sipër*, paragrafët 171-174.
[636] John Crosland, T 1867; Peter Bouckaert, T 5592; Susanne Ringgaard Pedersen, T 3538.
[637] Peter Bouckaert, T 5578-5579.
[638] John Crosland, T 1867.
[639] John Crosland, T 1867.
[640] John Crosland, T 1883.
[641] John Crosland, T 1883.
[642] John Crosland, T 1885.
[643] John Crosland, T 1881.
[644] John Crosland, T 1882; 1890.
[645] John Crosland, T 1887.

sepse ndaj tyre kishte patur zjarr të vazhdueshëm të forcave serbe të sigurisë.[646] Civilët ikën prej rajonit për të gjetur strehë për shkak të dendësisë dhe shtrirjes së luftimeve midis dy palëve.[647]

199. Të dyja palët përdorën taktikën e rrëmbimeve në përpjekje për të ndikuar mbi ballafaqimin strategjik dhe ushtarak.[648] U raportuan incidente të rrëmbimit të serbëve prej shqiptarëve të Kosovës, që u konsideruan si një "përpjekje për të fituar epërsi" në rrethanat dhe fushëbetejat e ndryshueshme nga njëri moment në tjetrin.[649] Gjendja filloi të stabilizohej paksa nga fundi i prillit 1998.[650] Ngritja e postblloqeve ishte tregues i stabilizimit gjithnjë në rritje të konfliktit. Në disa raste autoritetet serbe armatosën civilë[651] dhe elementë të forcave serbe u veshën civilë disa herë për veprime të fshehta.[652] Të dyja palët përdorën marrjen në pyetje, arrestimin dhe burgosjen e civilëve si mënyrë e ushtrimit të ndikimit në zona të ndryshme në Kosovë.[653] UÇK-ja gjithashtu zhvilloi strategjinë e sulmit kundër forcave të posaçme të policisë që vepronin në Kosovë.[654]

200. Më 30 qershor 1998, në një telegram diplomatik shkruhej se që nga fillimi i marsit ishin rrëmbyer 40 serbë.[655] John Crosland theksoi se ishte "ndodhi e vazhdueshme rrëmbimi i rregullt i serbëve me qëllim rritjen e frikës ndër ta".[656] Philip Coo pranoi se rrëmbimet ishin një prej taktikave të UÇK-së dhe ishin veçanërisht të shpeshta gjatë qershorit 1998.[657]

201. Më 18 qershor 1998 nënkoloneli Dragosllav Maksimoviq i dërgoi një raport komandës së Armatës së Tretë ku jepeshin hollësi të operacioneve të UÇK-së kundër civilëve serbë në minierën e Bardhit të Madh afër Obiliqit.[658] U raportua se UÇK-ja kapi nëntë civilë serbë etnikë kur ata po shkonin në punë në minierë.[659] Sipas John Crosland-it, UÇK-ja ndërmori sulme nga lugina e Drenicës kundër civilëve serbë të cilët punonin në minierën e Bardhit.[660] Pati raporte se ekonomi

[646] John Crosland, T 1915.
[647] John Crosland, T 1910-1911.
[648] John Crosland, T 1940.
[649] John Crosland, T 1878-1889.
[650] John Crosland, T 1888-1889.
[651] John Crosland, T 2033.
[652] John Crosland, T 2033.
[653] John Crosland, T 1940; 2042; Philip Coo, T 5725.
[654] Fatmir Limaj, T 5924.
[655] John Crosland, T 1951.
[656] John Crosland, T 1952.
[657] Philip Coo, T 5725.
[658] John Crosland, T 1936-1937; T 1945; T 1949-1950.
[659] Prova Materiale P212, nënndarje 5.
[660] John Crosland, T 1937.

bujqësore të veçuara serbe në atë zonë u sulmuan, mirëpo këto raporte nuk u konfirmuan.[661] Më 19 qershor 1998 pati raporte për dëbimin e serbëve prej shqiptarëve të Kosovë në komunën e Klinës.[662]

202. Sipas raporteve, gjatë luftimeve në Rahovec më 19 korrik 1998,UÇK-ja kapi afërsisht 85 serbë etnikë, që duket se ishin civilë apo të nxjerrë jashtë luftimit.[663] Në lidhje me këtë theksohet se më vonë UÇK-ja liroi një numër civilësh të cilët ishin kapur gjatë betejës.[664] Ka prova se më 22 korrik 1998, UÇK-ja i dorëzoi Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq 35 civilë serbë.[665] Mirëpo rezultati i provave është se shumë persona, në dukje civilë, nuk u liruan.

203. Veç rrëmbimeve të civilëve serbë në zonat e betejave të ashpra, një numër civilësh u rrëmbyen pas ngritjes së postblloqeve në zonat me rëndësi strategjike për UÇK-në.[666] Deri në fillim të majit 1998 edhe forcat serbe, edhe UÇK-ja kishin ngritur postblloqe në rrugët kryesore.[667] Në postblloqe të UÇK-së u ndaluan civilë shqiptarë të Kosovës të cilët u mbajtën për t'u marrë në pyetje ose u rrëmbyen prej shtëpive të tyre gjatë natës.[668] Individëve të rrëmbyer dhe të arrestuar shpesh iu lidhën sytë ose u vendosën në vendbagazhet e automjeteve dhe u çuan ose drejtpërdrejtë në Llapushnik ose në vende të tjera ku ata u morën në pyetje para se të dërgoheshin në Llapushnik ose në një vend tjetër ndalimi.[669] Të ndaluarit iu nënshtruan marrjes në pyetje; në disa raste u keqtrajtuan fizikisht, shumë u akuzuan si spiunë të regjimit serb ose se kishin dijeni për ata që konsideroheshin si bashkëpunëtorë në Kosovë.[670] Burgimet nuk ndodhën vetëm në Llapushnik. Kazerma në Jabllanicë gjithashtu shërbeu si burg i improvizuar për ata që u akuzuan si bashkëpunëtorë të forcave serbe.[671] Në kazerma u mbajtën ata që konsideroheshin si bashkëpunëtorë ose spiunë.[672] Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq iu mohua kontakti me një numër të burgosurish prej UÇK-së, duke ngritur kështu pikëpyetje mbi mirëqenien e të ndaluarve.[673]

---

[661] John Crosland, T 1938.
[662] John Crosland, T 1939-1940.
[663] Prova Materiale P212, nënndarje 5.
[664] Prova Materiale P212, nënndarje 5.
[665] Peter Bouckaert, T 5503-5504.
[666] Prova Materiale P212, nënndarje 5.
[667] John Crosland, T 1926.
[668] L96, T 2283; T 2285; L06, T 978-979; L10, T 2909-2910; Ivan Bakraç, T 1397-1398; Oleg Safiulin, T 1723-1726; L07, T 774-776.
[669] L06, T 989-990; L10, T 2913-2917; L96, T 2285-2286; L07, T 779-780; L12, T 1788-1789; *shih më poshtë* paragrafët 243-282.
[670] L07, T 779; L10, 2916-2917; L10, T 2937-2938; Vojko Bakraç, T 1306-1308; L06, T 1007.
[671] L95, T 4255-4260.
[672] L95, T 4255-4260.
[673] Prova Materiale P212, nënndarje 5; Peter Bouckaert, T 5503.

204. Rezultati përmbledhës i këtyre provave tregon përdorimin e taktikave kryengritëse prej UÇK-së në përpjekje për të fituar epërsi kundër forcave serbe në Kosovë, të cilat zotëronin fuqi ushtarake superiore dhe ishin në gjendje të vinin në përdorim burime më të mëdha gjatë konfliktit. Provat tregojnë ekzistencën e një "praktike veprimesh" që tregon se në periudhën që ka lidhje me aktakuzën në territorin e Kosovës kishte "sulm" ushtarak.

205. Prokuroria argumenton se kohëzgjatja dhe shtrirja e sulmit të UÇK-së tregon se sulmi ishte "drejtuar kundër" një popullate civile.[674] Gjithashtu Prokuroria argumenton se popullata civile ishte "objekti parësor i sulmit".[675]

206. Duket se ka patur një numër rrëmbimesh të civilëve serbë. Me aq sa zbulojnë dëshmitë, shumë prej rasteve ndodhën kur një individ në një vendbanim ose në një fshat dyshohej për qëndrim të caktuar kundërshtues ndaj UÇK-së ose interesave të shqiptarëve të Kosovës, ose në disa raste u ndërmorën nga elementë të pavarur të UÇK-së të cilët nuk vepronin në pajtim me një strategji ose udhëzim të përgjithshëm të UÇK-së.

207. Dëshmitë në dispozicion të Dhomës tregojnë se UÇK-ja rrëmbeu një numër serbësh për të cilët mendohej ose dyshohej se kishin rol në organet politike ose qeveritare të Serbisë, veçanërisht policia ose ushtria me të cilët UÇK-ja ishte mbërthyer drejtpërdrejtë në konflikt. Për shembull, Stamen Genov, anëtar i forcave serbe, u keqtrajtua egërsisht prej anëtarëve të UÇK-së pas rrëmbimit të tij dhe më vonë kur ishte i burgosur. Anëtarët e UÇK-së që po keqtrajtonin Stamen Genovin i thanë Ivan Bakraçit se çfarë po i bëhej atij ishte i ngjashëm me keqtrajtimin prej policisë serbe kundër popullatës shqiptare të Kosovës.[676] Statusi i Stamen Genotit si anëtar aktiv i forcave serbe dhe kështu lidhja e tij me aparatin ushtarak serb ishte shkaku që sulmuesit e tij ushtruan dhunë të tejskajshme kundër tij.[677] Nga ana tjetër, Bakraçët dhe të tjerët që pas hetimit rezultuan se nuk kishin lidhje me regjimin serb, u liruan.[678]

208. Dhoma pranon se disa shqiptarë kosovarë u rrëmbyen dhe u burgosën për shkak se mendoheshin se kishin lidhje me autoritetet serbe.[679] Shqiptarët kosovarë të dyshuar për

[674] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 374.
[675] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 374-375.
[676] Ivan Bakraç, T 1428.
[677] Vojko Bakraç, T 1301; Ivan Bakraç, T 1407-1408.
[678] Vojko Bakraç, T 1348-1351; Ivan Bakraç, T 1474-1476.
[679] Peter Bouckaert, T 5488-5489; Prova Materiale P212, nënndarje 5.

bashkëpunim iu nënshtruan diskriminimit, ngacmimit dhe keqtrajtimit.[680] Ata shqiptarë të Kosovës të cilët mendohej se kishin lidhje me regjimin ushtarak ose policor serb u përzgjodhën për trajtim veçanërisht të egër gjatë burgimit. Të akuzuarit si bashkëpunëtorë përmendeshin si "spiunë"[681] ose "tradhtarë të popullit të tyre".[682] Gjatë marrjes së tyre në pyetje në Llapushnik, L06 dhe L10 u pyetën për ata që mendoheshin si spiunë ose për ata të cilët akuzoheshin se kishin bashkëpunuar me serbët në fshatin e tyre.[683]

209. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dokumentoi rrëmbimet e gjithsej 138 serbëve, me sa duket civilë ose jashtë luftimit për të cilët besohej se mbaheshin nga UÇK-ja.[684] Human Rights Watch vlerësoi se, nga fundi i shkurtit 1998 deri në fund të shtatorit 1998 forcat e UÇK-së rrëmbyen 100-140 shqiptarë kosovarë, serbë dhe romë, me sa duket civilë ose jashtë luftimit.[685] Shumë prej këtyre rrëmbimeve ndodhën në Drenicë, në Malishevë dhe në Rahovec.[686] Përveç civilëve serbë që patën pasoja prej luftimeve të drejtpërdrejta midis UÇK-së dhe forcave serbe, gjithashtu pati raste kur civilë serbë u ndaluan në postblloqe të UÇK-së dhe u nxorrën prej autobusëve.[687] Më tej në Aktakuzë janë dhënë në hollësi rrethanat aktuale konkrete të disa prej këtyre rrëmbimeve dhe nuk është e nevojshme të shtjellohen në hollësi këtu.[688] Siç do të dalë në pjesë të tjera të Aktakuzës nuk ka prova në lidhje me rrethanat në të cilat një numër personash me kombësi serbe, të cilët me sa duket ishin civilë, u mbajtën nga UÇK-ja përveçse disa prej këtyre personave të rrëmbyer mund të jenë mbajtur faktikisht në Llapushnik dhe janë pjesë e dëshmive konkrete të shqyrtuara në këtë Aktakuzë.

210. Fatkeqësisht historia konfirmon se veprimet në kohë lufte shpesh sjellin pasoja të këqija për civilët. Gjithsesi Dhoma gjykon se edhe po të pranohet se ata civilë të çfarëdo kombësie për të cilët besohet se janë rrëmbyer prej UÇK-së gjatë periudhës në fjalë, në të vërtetë u rrëmbyen, në kontekst të popullatës së Kosovës, në tërësi rrëmbimet ishin relativisht të pakta në numër dhe nuk mund të thuhet se përbëjnë një ndodhi "të gjerë" në lidhje me Nenin 5 të Statutit.

[680] John Crosland, T 1867; T 1883; Susanne Ringgaard Pedersen, T 3507.
[681] L10, T 2916-2917; L64, T 4504.
[682] Vojko Bakraç, T 1342.
[683] L10, T 2916-2917; T 2938; L06, T 1007.
[684] Peter Bouckaert, T 5483.
[685] Peter Bouckaert, T 5477; T 5482; T 5483.
[686] Peter Bouckaert, T 5482-5483.
[687] Liljana Mitroviq, T 1602-1603.
[688] *Shih më poshtë*, paragrafët 243-282; 290-446.

211. Provat zbulojnë se më të shumtën ekzistonte një përpjekje "sistematike" e UÇK-së për të përzgjedhur shqiptarë kosovarë për të cilët besohej ose dyshohej se bashkëpunonin me autoritetet serbe, por asnjë përpjekje kundër popullatës civile si e tillë.

212. Ekzistenca e një strategjie ose plani mund të jetë tregues i karakterit sistematik të shkeljeve të akuzuara si krime kundër njerëzimit.[689] Ekzistenca e një "strategjie" për kryerjen e një sulmi kundër një popullate civile përcaktohet ose nxirret më së lehti kur bëhet fjalë për veprimet e një shteti, por mungesa e strategjisë nuk do të thotë se nuk ka ndodhur një sulm i gjerë ose sistematik kundër një popullate civile. Megjithëse jo element ligjor i Nenit 5,[690] ekzistenca e një strategjie ose plani është tregues i rëndësishëm se veprimet në fjalë nuk janë thjesht veprime individësh që veprojnë sipas planeve të paorganizuara individuale, por kanë një nivel të përputhshmërisë organizative dhe mbështetje në një shkallë të mjaftueshme për t'i cilësuar krime kundër njerëzimit. Është e logjikshme se një sulm kundër një popullate civile më së shpeshti do të tregojë ekzistencën e strategjisë kur veprimet në fjalë kryhen kundrejt një sfondi të veprimit të dukshëm shtetëror dhe ku mund të dallohen struktura formale komanduese.

213. Mirëpo dalin disa probleme të veçanta kur shqyrtohet nëse një organ nënshtetëror ose grup kundërshtar i armatosur kryengritës apo ndërkufitar në karakter shfaq strategji sulmi. Një kusht që duhet të plotësojë një njësi e tillë organizative që të tregohet se ajo ka kompetencën e mjaftueshme për formulimin e strategjisë, është shkalla e kontrollit faktik të territorit.[691] Siç tha Dhoma Gjyqësore në *Prokurorja kundër Tadiq:*

> "ligjet në lidhje me krimet kundër njerëzimit janë zhvilluar duke marrë parasysh forca ndonëse jo të qeverisë së ligjshme të cilat kanë kontroll faktik ose janë në gjendje të lëvizin lirisht brenda territorit të përcaktuar".[692]

214. Dëshmitë tregojnë karakterin e ndryshueshëm të përleshjeve midis UÇK-së dhe forcave serbe dhe të kontrollit territorial. Dhoma nënvizon aftësinë e UÇK-së për ngritjen e postblloqeve përgjatë rrugëve kryesore,[693] shembujt e shtuar të komandës dhe kontrollit në radhët e UÇK-së,[694] dhe zhvillimin e strukturave civile, si prova të kontrollit të saj në rritje dhe aftësisë për të lëvizuar brenda pjesës më të madhe të Kosovës. Ajo gjithashtu merr parasysh raportet që përcaktojnë se prej

[689] Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 182.
[690] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafët 100 dhe 120. Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 98.
[691] Aktgjykimi *Kupreshkiq,* paragrafi 552.
[692] Aktgjykimi *Tadiq,* paragrafi 654.
[693] *Shih më sipër,* paragrafin 145.
[694] *Shih më sipër,* paragrafët 94-134.

prillit 1998 deri në mes të korrikut 1998, UÇK-ja kontrollonte deri në 40 për qind të territorit të Kosovës.[695] Dhoma bindet prej të tëra provave se të paktën gjatë periudhës përkatëse UÇK-ja kishte kontroll faktik mbi pjesë të Kosovës dhe forcat e saj ishin në gjendje të lëviznin nëpër këto pjesë dhe në vise të tjera të Kosovës.

215. Prej provave që ka Dhoma, UÇK-ja nuk tregoi strategji për vënien në shënjestër të civilëve si të tillë. Peter Bouckaert deklaroi se ai nuk pa kurrë ndonjë urdhër të lëshuar prej UÇK-së për anëtarët e saj për vënien në shënjestër të civilëve të pafajshëm apo për plaçkitjen apo shkatërrimin e pronave serbe.[696] Susanne Ringgaard Pedersen deklaroi se ajo nuk mundi të dallojë një strategji të gjerë për vënien në shënjestër të civilëve.[697] Dhoma e pranon deklaratën e Jakup Krasniqit se rrëmbimet, torturat apo vrasja e civilëve të pafajshëm nuk ishin pjesë e strategjisë politike ose ushtarake të UÇK-së.[698] Dëshmitë nuk vërtetojnë, madje as nuk tregojnë për një strategji të përgjithshme të vënies në shënjestër të civilëve, serbë apo shqiptarë të Kosovës.

216. Dhoma pranon se ka prova të një strategjie të UÇK-së për vënien në shënjestër të shqiptarëve të Kosovës të konsideruar si bashkëpunëtorë, për të cilët besohej ose dyshohej se kishin lidhje me autoritetet dhe interesat serbe. Që në 1997, UÇK-ja i paralajmëroi "larot e regjimit serb" të mos e minonin "luftën çlirimtare".[699] Komunikata numër 43 e UÇK-së, e nxjerrë më 4 mars 1998, përmban shprehje "vdekje armiqve dhe tradhtarëve".[700] Komunikata numër 53 e UÇK-së, e 19 shtatorit 1998 përmend "masa ndëshkuese të llojeve të ndryshme", të marra kundër "elementëve bashkëpunëtorë që vazhdojnë t'i shërbejnë pushtuesit".[701] Dhoma pranon se komunikatat shërbenin pjesërisht për qëllime propagandistike.[702] Mirëpo, ekzistonte një strategji e UÇK-së, e lidhur me objektivat e saj ushtarakë, për të goditur ata individë për të cilët mendohej se bashkëpunonin me forcat serbe. Gjithsesi nën maskën e konkretizimit të kësaj strategjie, një numër civilësh shqiptarë të Kosovës mund të jenë rrëmbyer për arsye të tjera, si hakmarrje personale e anëtarëve të veçantë të UÇK-së dhe motive të tjera. UÇK-ja nuk kishte burime apo strukturën komanduese të kontrollonte si duhej zbatimin e kësaj strategjie prej forcave të veta gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën, dhe

[695] Prova Materiale P212, nënndarje 5; Peter Bouckaert, T 5516.
[696] Peter Bouckaert, T 5564-5565.
[697] Susanne Ringgaard Pedersen, T 3532-3533.
[698] Jakup Krasniqi, T 3439-3441.
[699] Jakup Krasniqi, T 3320.
[700] Jakup Krasniqi, T 3335-3336; Provat Materiale P48 dhe P49.
[701] Ole Lehtinen, T 589; Provat Materiale P48 dhe P49.
[702] Robert Churcher, T 6377.

Dhoma pranon se rastet e rrëmbimeve për arsye jo në lidhje me strategjinë ndaj bashkëpunëtorëve, u kryen nga elementë të këqinj të UÇK-së.[703]

217. Mirëpo provat në tërësi tregojnë se UÇK-ja kishte një strategji që përzgjidhte vetëm ata për të cilët besohej ose dyshohej se kishin lidhje me regjimin serb. Provat që ka Dhoma tregojnë se ekzistonte një shkallë e kufizuar bashkërendimi dhe organizimi i këtyre sulmeve përzgjedhëse. Ekzistenca e kamp-burgut të Llapushnikut në vetvete tregon karakterin e bashkërenduar dhe të organizuar të mënyrës së përzgjedhjes së atyre që dyshoheshin si bashkëpunëtorë. Mirëpo Dhoma arrin në përfundimin se nëse ata që mendoheshin ose dyshoheshin si bashkëpunëtorë, u identifikuan saktësisht ose jo, ata u përzgjodhën si individë dhe jo si anëtarë të një popullate më të madhe të përcaktuar. Gjithsesi Dhoma pranon se kishte edhe raste rrëmbimesh të kryera nga elementë lokalë të UÇK-së, të cilët vepronin pavarësisht prej kontrollit qëndror të UÇK-së sepse gjatë kohës për të cilën bëhet fjalë, UÇK-ja kishte vetëm mundësi të kufizuara për të ushtruar kontroll efektiv.

218. Kushti që të përzgjidhet një "popullatë civile", ka si objektiv, përjashtimin nga sfera e krimeve kundër njerëzimit, kryerjen e krimeve kundër një numri të kufizuar individësh të përzgjedhur rastësisht. Në këtë kuptim, kërkesa që një "popullatë civile" të jetë objektiv i një sulmi mund të shihet si një mënyrë tjetër e theksimit të kushtit që sulmi të jetë i një shkalle të madhe ose të paraqesë karakter sistematik.

219. Që Neni 5 të gjejë zbatim, duhet vërtetuar se ata që janë objekt i sulmit ishin "civilë" sipas kuptimit përkatës, Kjo lidhet me shqyrtimin e kuptimit të fjalës "civilë". Në Dosjen e vetë Përfundimtare të Përbashkët, Mbrojtja pretendon se cilido prej "bashkëpunëtorëve" të përzgjedhur prej UÇK-së, ishin ata që merrnin pjesë aktivisht në luftime dhe si pasojë nuk kishin të drejtën e statusit civil.[704] Rrjedhimisht argumentohet se nuk ka patur sulm kundër një "popullate" siç përcaktohet prej Nenit 5.

220. Në mbështetje të argumenteve të veta, Mbrojtja paraqiti një numër shembujsh ku anëtarët e UÇK-së në deklarata dhe intervista publike bënë dallimin midis "civilëve" dhe "bashkëpunëtorëve".[705] Rexhep Selimi deklaroi se me "bashkëpunëtorë" ai e kishte fjalën për persona të përfshirë në strukturat e shërbimit të fshehtë serb.[706] Jakup Krasniqi përcaktoi si

[703] Susanne Ringgaard Pedersen, T 3532.
[704] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 362-368.
[705] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 362-368.
[706] Rexhep Selimi, T 6634-6639.

bashkëpunëtor një person i cili "ishte i dëmshëm për UÇK-në, në qoftë se ky person i jep regjimit të Beogradit informata mbi lëvizjet e UÇK-së."[707] Peter Bouckaert i Human Rights Watch kuptoi me "bashkëpunëtor" njerëz të cilët punonin me autoritetet serbe, ose njerëz për të cilët dyshohej se ishin informatorë të zyrtarëve serbë.[708]

221. Në një intervistë, Jakup Krasniqi deklaroi se UÇK-ja nuk u mor kurrë me civilët dhe se rregullorja e veprimit të UÇK-së i njihte Konventat e Gjenevës.[709] Megjithatë ndërsa deklaronte se UÇK-ja "zbatonte të gjitha rregullat ndërkombëtare të luftës", Jakup Krasniqi deklaroi se "i paralajmërojmë bashkëpunëtorët se do t'i vrasim nëse ata vazhdojnë rrugën e gabuar."[710] Jakup Krasniqi theksoi gjetiu se "edhe pse disa njerëz kanë vuajtur, këta kanë qenë më shumë bashkëpunëtorë shqiptarë sesa civilë serbë. Ne nuk merremi me civilë, dhe i kthejmë ata që marrim si robër lufte…Ata që kemi rrëmbyer ose përmenden në një listë ose janë raportuar si të ekzekutuar, por ne nuk sillemi poshtërsisht si Serbia."[711]

222. Duke paraqitur një numër deklaratash të tilla, Mbrojtja argumenton se UÇK-ja bëri një dallim themelor midis civilëve, të cilët UÇK-ja konsideroi se kishin të drejtë të kishin mbrojtje dhe bashkëpunëtorëve, të cilët do të trajtoheshin si luftues. Mirëpo Dhoma nuk ka prova të mjaftueshme që të nxjerrë përfundimin se ata që akuzoheshin për bashkëpunim me regjimin serb zotëronin cilësi që do t'i përjashtonin nga popullata civile.

223. Dhoma është e bindur se përkufizimi i UÇK-së për "bashkëpunëtorët" përfshiu si civilë po ashtu edhe ata që konsideroheshin luftues. Dhoma rikujton se në paragrafin 1 të Nenit 50 të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës (për të cilat Mbrojtja e fton Dhomën t'i zbatojë në rastin konkret) pohohet se "kur ka dyshim se një person është civil, ai person do të konsiderohet civil". Dhoma e Apelit i ka konsideruar dispozitat e Nenit 50 si pasqyrim të së drejtës zakonore ndërkombëtare. [712] Gjithsesi Dhoma pranon, se përkufizimi "civil" i përdorur në ligjet e luftës nuk mund të importohet gjithandej në shqyrtimin e krimeve kundër njerëzimit. Në lidhje me këtë Dhoma nënvizon se në *Prokurorja kundër Tadiq* Dhoma Gjyqësore përcaktoi se:

[707] Jakup Krasniqi, T 3324-3325.
[708] Peter Bouckaert, T 5488-5489.
[709] Jakup Krasniqi, T 3384-3385.
[710] Jakup Krasniqi, T 3362-3364.
[711] Ole Lehtinen, T 587-588.
[712] Vendimi i Apelit *Kordiq,* paragrafi 97; Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 110.

> Përkufizimi i civilëve në Nenin e Përbashkët 3 nuk gjen zbatim të menjëhershëm në krimet kundër njerëzimit sepse është pjesë e ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe mund të zbatohet vetëm me analogji. E njëjta gjë vlen edhe për përkufizimin në Protokollin I dhe Komentin mbi Konventën IV ttë Gjenevës në lidhje me trajtimin e civilëve, të dyja mbështetin një interpretim të gjerë të fjalës "civilë".[713]

224. Duke i marrë parasysh këto përcaktime, dhe në bazë të provave që ka Dhoma në lidhje me ata që u arrestuan dhe u mbajtën për shkak të veprimeve të tyre të dyshuara ose akuzuar si bashkëpunim, Dhoma nxjerr përfundimin se të paktën në përgjithësi, ata që mendoheshin si bashkëpunëtorë të rrrëmbyer nga UÇK-ja, gëzonin të drejtën e statusit si civilë.

225. Pranimi i rrëmbimit të civilëve të caktuar, serbë apo shqiptarë të Kosovës, të identifikuar dhe përmendur këtu, gjithsesi nuk tregon, të paktën në rrethanat e provuara për këtë rast, se UÇK-ja kishte një strategji për përzgjedhjen e një "popullate civile". Në fakt dëshmitë tregojnë sesi disa serbë të rrëmbyer për të cilët dyshohej se ishin ushtarakë apo police, iu nënshtruan një dhune të konsiderueshme ose u keqtrajtuan në kuadër të një teknike hetimore prej UÇK-së për të vërtetuar dyshimet. Një numër serbësh të rrëmbyer, me sa duket civilë, më vonë u vranë prej UÇK-së. Për të tjerë nuk është dëgjuar që prej rrëmbimit të tyre ose që kur ata mbaheshin prej UÇK-së. Mirëpo disa u liruan. Për më të shumtën e rasteve, dëshmitë nuk mundësojnë një përcaktim pse disa u liruan dhe të tjerët jo. Është e qartë se në shumë raste ekzistonte një proces vendimmarrës nga UÇK-ja. Mirëpo nga provat nuk del mbi çfarë baze merreshin vendimet. Në shumë prej rasteve por jo në të gjitha, një faktor përcaktues ose faktori përcaktues mund të ketë qenë lidhjet me policinë ose ushtrinë serbe ose pjesëmarrja në forcat e armatosura civile ose paraushtarake të angazhuara kundër UÇK-së. Çfarëdo arsyesh të kenë qenë, ekzistenca e procesit të vendimmarrjes që ndikoi pasojat e rrëmbimeve të UÇK-së është një tregues me një farë peshe kundër ekzistencës dhe zbatimit të një strategjie të përgjithshme të UÇK-së për rrëmbimin e popullatës civile serbe në Kosovë. Këto prova nuk vërtetojnë se rrëmbimet, burgimi dhe keqtrajtimi i civilëve serbë ishin të asaj shkalle apo dendësie saqë sulmi të konsiderohej se ishte i drejtuar kundër një popullate civile.

226. Në rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje, shumica e të burgosurve të identifikuar në kamp-burg ishin shqiptarë të Kosovës. Provat nuk mundësojnë ndonjë përfundim në lidhje me përpjesëtimin e përgjithshëm të civilëve të rrëmbyer dhe burgosur nga UÇK-ja midis viktimave shqiptarë dhe serbë të Kosovës. Ajo që është provuar në lidhje me ata që u rrëmbyen dhe u burgosën tregon se rrëmbimet ndodhën në vendndodhje të ndryshme gjeografike, ishin relativisht të

[713] Aktgjykimi *Tadiq,* paragrafi 639.

kufizuara në numër dhe pati relativisht pak rrëmbime krahasuar me popullatën civile në Kosovë, në atë masë që nuk është e mundur të nxirret një përfundim se vetë popullata civile ishte vetë subjekt i një sulmi ose se shqiptarët kosovarë bashkëpunëtorë dhe ata që mendoheshin ose dyshoheshin si bashkëpunëtorë dhe të rrëmbyer të tjerë ishin të një klase apo kategorie kaq të madhe dhe të gjerë në numër sa të përbënin një "popullatë" sipas kuptimit përkatës.

227. Mjetet dhe metodat e përdorura nga UÇK-ja në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën në rrëmbimin e civilëve serbë dhe shqiptarë të Kosovës (të marra së bashku apo ndarazi) nuk tregojnë karakteristika të një sulmi drejtuar kundër një popullate civile. Të paktën për më të shumtën e rasteve për të cilat ka prova, individët të cilët u rrëmbyen dhe më pas u burgosën, u përzgjodhën si individë për shkak të lidhjeve të tyre të dyshuara ose të njohuar me veprime bashkëpunimi me autoritetet serbe dhe jo sepse ata ishin anëtarë të një popullate të përgjithshme kundër të cilës ishte drejtuar sulm nga UÇK-ja.

228. Pas shqyrtimit të dëshmive në dispozicion, Dhoma gjykon se gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën nuk ka patur sulm të UÇK-së drejtuar kundër një "popullate civile", të kombësisë shqiptare apo serbe, të asaj shkalle që mund të konsiderohej "i gjerë"; gjithsesi siç është treguar më herët ka prova të një niveli të organizimit ose bashkërendimit sistematik të rrëmbimit dhe burgosjes së disa individëve. Megjithëse UÇK-ja shpalosi një strategji për përzgjedhjen e atyre shqiptarëve të Kosovës të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet serbe, Dhoma gjykon se nuk pati sulm të drejtuar kundër një popullate civile, serbe apo shqiptare. Në bazë të kuptimit të shtjelluar më herët në këtë Aktgjykim, Prokuroria nuk ka provuar se veprimet e tre të Akuzuarve që pretendohet se përbëjnë krime kundër njerëzimit sipas Pikave 1, 3, 5, 7 dhe 9 në Aktakuzë ishin pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik drejtuar kundër një popullate civile. Nuk është provuar se për rastin në fjalë gjen zbatim Neni 5. Rrjedhimisht Pikat 1, 3, 5, 7 dhe 9 hidhen poshtë.

V. AKUZAT

A. Kuadri ligjor në lidhje me krimet e akuzuara

1. Hyrje

229. Në Aktakuzë pretendohet se tre të Akuzuarit Fatmir Limaj, Haradin Bala dhe Isak Musliu janë përgjegjës për veprat penale të Pikave 1 deri në 8. Gjithashtu të Akuzuarit Fatmir Limaj dhe Haradin Bala akuzohen me Pikat 9 dhe 10. Pretendohet se të gjitha veprat penale të ngarkuara janë kryer në periudhën nga maj deri afërsisht më 26 korrik 1998. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me kapjen e paligjshme të së paku 35 civilëve serbë dhe shqiptarë të Kosovës nga komunat e Shtimes, Gllogocit dhe Lipjanit në Kosovë dhe transferimin e tyre me forcë në kamp-burgun e Llapushnikut.[714] Aktakuza pretendon se tre të Akuzuarit i mbajtën këta civilë në mënyrë të paligjshme për periudha të gjata në kamp-burgun e Llapushnikut, dhe morën në pyetje civilët shqiptarë të Kosovës të konsideruar si bashkëpunëtorë me forcat serbe që ndodheshin në atë zonë.[715] Këto pretendime janë bazë e një akuze për krime kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit, përkatësisht burgim (Pika 1), dhe një akuze për shkeljen e ligjeve dhe zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, gjegjësisht trajtim mizor (Pika 2). Tre të Akuzuarit, gjithashtu ngarkohen nga Aktakuza për mbajtjen e këtyre civilëve në kushte çnjerëzore në kamp-burg dhe për sulmet, torturat dhe rrahjet ndaj tyre në mënyrë të përsëritur.[716] Në lidhje më këto akuza, tre të Akuzuarit ngarkohen me përgjegjësi penale për tortura si krim kundër njerëzimit në bazë të Nenit 5 të Statutit (Pika 3), dhe si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit (Pika 4), veprime çnjerëzore si krim kundër njerëzimit në bazë të Nenit 5 të Statutit (Pika 5), dhe trajtim mizor si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit (Pika 6). Gjithashtu tre të Akuzuarit ngarkohen me vrasjen e 14 civilëve në kamp-burg ose rreth tij gjatë burgimit të tyre.[717] Këto pretendime janë bazë e një akuze për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe një akuze për krim kundër njerëzimit, gjegjësisht vrasje në bazë të Neneve 3 dhe 5 të Statutit (Pikat 7 dhe 8). Së fundi, të Akuzuarit Fatmir Limaj dhe Haradin Bala ngarkohen me vrasjen e 10 të burgosurve në malet e Berishës më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date, si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe krim kundër njerëzimit përkatësisht në bazë të Neneve 3 dhe 5 të Statutit, (Pikat 9 dhe 10).

[714] Aktakuzë, paragrafët 21-22.
[715] Aktakuzë, paragrafët 21-23.
[716] Aktakuzë, paragrafët 25-26.

2. Krime kundër njerëzimit (Pikat 1, 3, 5, 7 dhe 9)

230. Veprat penale në Pikat 1, 3, 5, 7 dhe 9 ngarkohen në bazë të Nenit 5 të Statutit të këtij Tribunali. Siç është gjykuar më herët në këtë vendim, nuk janë provuar kushtet paraprake për zbatueshmërinë e Nenit 5 të Statutit.[718] Si rrjedhojë Pikat 1, 3, 5, 7 dhe 9 duhet të hidhen poshtë.

3. Trajtim mizor (Pikat 2 dhe 6)

231. Trajtimi mizor në bazë të Nenit 3 të Statutit përkufizohet si veprim ose mosveprim i qëllimshëm që shkakton lëndim ose vuajtje të rëndë mendore ose fizike, dhe që përbën një sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor të një personi që nuk merr pjesë aktive në luftime. Në lidhje me gjendjen mendore kriminale të nevojshme, kryesi duhet të ketë vepruar me synimin e drejtpërdrejtë për të kryer trajtim mizor ose me synim të tërthortë, d.m.th. të ketë qenë në dijeni se trajtimi mizor ishte pasojë e mundshme e veprimit apo mosveprimit të tij.[719]

232. Të Akuzuarit ngarkohen me trajtim mizor në bazë të Nenit 3 të Statutit në Pikat 2 dhe 6. Duke lënë mënjanë trajtimin mizor në Pikën 6 (që trajton konkretisht kushtet e pretenduara çnjerëzore të burgimit në kamp-burg),[720] trajtimi mizor në Pikën 2 është në lidhje me "kapjen e paligjshme", "burgimin e paligjshëm për periudha të zgjatura" dhe "marrjen në pyetje" të civilëve serbë dhe/ose shqiptarë të Kosovës në kamp-burgun e Llapushnikut.[721] Këto veprime si të tilla akuzohen se përbëjnë sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor, dhe rrjedhimisht përbëjnë trajtim mizor në bazë të Nenit 3 të Statutit. Dhoma ka pikëpamjen se problemi nëse një sjellje e caktuar përbën trajtim mizor është çështje faktesh që do të përcaktohet rast pas rasti. Dhoma thekson se para këtij Tribunali nuk është provuar asnjëherë vepra penale e trajtimit mizor në lidhje me këto veprime konkrete.[722] Në përcaktimin nëse "kapja e paligjshme", "burgimi i paligjshëm për periudha të zgjatura" dhe "marrja në pyetje" për të cilat akuzohet në rastin në fjalë, Dhoma për pasojë ka marrë parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me këtë rast. Dhoma ka nxjerrë përfundimin se së paku në bazë të rrethanave të këtij rasti, këto veprime <u>në vetvete</u> nuk përbëjnë sulm të rëndë kundër dinjitetit

[717] Aktakuzë, paragrafët 28-32.
[718] *Shih më sipër,* paragrafin 228.
[719] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 261.
[720] Aktakuzë, paragrafi 26.
[721] Aktakuzë, paragrafët 22-33.
[722] Në Dosjen e vetë Përfundimtare, Prokuroria përmend "heqjen arbitrare të lirisë pa proces të rregullt ligjor" si trajtim mizor në bazë të Nenit 3. Nuk përmenden "kapja e paligjshme" dhe "marrja në pyetje"e civilëve serbë dhe/ose shqiptarë kosovarë. Gjithsesi për arsye se këto janë veprime të akuzuara në Aktakuzë, Dhoma i ka marrë në shqyrtim, paragrafët 390-932.

njerëzor brenda kuptimit të trajtimit mizor në bazë të Nenit 3 të këtij Statuti. Rrjedhimisht edhe Pika 2 hidhet poshtë.

233. Për shkak të hedhjes poshtë të Pikave 1, 2, 3, 5, 7 dhe 9, Dhoma do të vazhdojë me shqyrtimin e provave për veprat penale të torturës sipas Nenit 3 të Statutit në lidhje me Pikën 4, trajtimit mizor sipas Nenit 3 të Statutit në lidhje me Pikën 6, dhe vrasjes sipas Nenit 3 të Statutit në lidhje me Pikat 8 dhe 10.

4. Tortura (Pika 4)

234. Aktakuza i ngarkon tre të Akuzuarit ndër të tjera me torturë si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3, dhe si krim kundër njerëzimit në bazë të Nenit 5 të Statutit.

235. Kuadri ligjor mbi torturën është i mirëpërcaktuar prej jurisprudencës së Tribunalit. Për të provuar krimin e torturës, si krim lufte ose krim kundër njerëzimit,[723] duhet të përmbushen këta tre elementë:

(1) Duhet të ekzistojë një veprim ose mosveprim që shkakton dhimbje ose vuajtje shumë të mëdha, fizike ose mendore;

(2) Veprimi ose mosveprimi duhet të jetë i qëllimshëm; dhe

(3) Veprimi ose mosveprimi duhet të jetë kryer me një synim konkret si për shembull për nxjerrjen e informacionit ose rrëfimit, për ndëshkimin, frikësimin ose për ta detyruar viktimën ose një person të tretë, ose për ta diskriminuar viktimën apo një person të tretë për çfarëdo arsye.[724]

236. Një veprim ose mosveprim mund të përbëjë sjelljen e fajshme të torturës nëse ka shkaktuar dhimbje ose vuajtje të rënda. Gjithsesi keqtrajtimi që nuk shkon deri në këtë shkallë mizorie, mund të jetë vepër tjetër penale brenda juridiksionit të Tribunalit.[725] Gjithashtu nuk kërkohet që veprimi ose mosveprimi të ketë shkaktuar dëmtim të përhershëm,[726] dhe po ashtu nuk kërkohet që veprimi

[723] Përkufizimi i veprës penale është i njëjtë pavarësisht Nenit të Statutit në bazë të të cilit akuzohet i akuzuari. Shih Aktgjykimin *Bërgjanin*, paragrafi 482; Aktgjykimin *Kërnojelac*, paragrafi 178; Aktgjykimin *Furunxhija*, paragrafi 139.
[724] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafët 142, 144 ku konfirmohet Aktgjykimi *Kunarac*, paragrafi 497. *Shih* edhe Aktgjykimin *Bërgjanin*, paragrafi 481, Aktgjykimin *Kërnojelac*, paragrafi 179.
[725] Aktgjykimi *Çelebiqi*, paragrafi 481, Aktgjykimi *Kërnojelac*, paragrafi 181.
[726] Aktgjykimi *Kvoçka*, paragrafi 148.

ose mosveprimi të ketë shkaktuar lëndim fizik, meqenëse dëmtimi mendor është formë mbizotëruese e ushtrimit të torturës.[727]

237. Në lidhje me vlerësimin e rrezikshmërisë së veprimeve që akuzohen si torturë, jurisprudenca e mëparshme e Tribunalit ka përcaktuar se duhen marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit dhe veçanërisht karakteri dhe konteksti i shkaktimit të dhimbjes, paramendimi dhe institucionalizimi i keqtrajtimit, gjendja fizike e viktimës, mënyra dhe metoda e përdorur dhe pozita e inferioritetit të viktimës.[728] Gjithashtu të rëndësishme për vlerësimin e Dhomës janë pasojat fizike dhe mendore të trajtimit mbi viktimën, mosha, gjinia ose gjendja shëndetësore e viktimës.[729] Gjithashtu, në qoftë se keqtrajtimi ka ndodhur për një periudhë të zgjatur, Dhoma do të shqyrtojë ashpërsinë e trajtimit në tërësi.[730] Së fundi kjo Dhomë pajtohet me gjykimin e Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, konkretisht në kontekstin e përdhunimit, se në rrethana të caktuara vuajtja mund të përkeqësohet prej kushteve shoqërore e kulturore[731] dhe gjatë vlerësimit të ashpërsisë së sjelljes së akuzuar, duhet marrë parasysh prejardhja shoqërore, kulturore dhe fetare e viktimave.

238. Sa për gjendjen mendore kriminale të nevojshme për krimin e torturës, jurisprudenca e mëparshme e Tribunalit provon se është i nevojshëm synimi i drejtpërdrejtë: kryesi duhet të ketë synuar të vepronte në një mënyrë e cila normalisht do t'i shkaktonte vuajtje ose dhimbje të mëdha, fizike ose mendore viktimës.[732] Nuk ka rëndësi nëse kryesi mund të ketë patur motiv të ndryshëm, në qoftë se ai veproi me synimin e kërkuar.[733]

239. Për të provuar krimin e torturës, veprimi ose mosveprimi i akuzuar duhet të jetë bërë me një synim të përcaktuar: për nxjerrjen e informacionit ose rrëfimit, ose për ndëshkimin, frikësimin apo detyrimin e viktimës apo një personi të tretë apo për diskriminimin për çfarëdo arsye të viktimës apo një personi të tretë. Nuk është e nevojshme që synimi i ndaluar të jetë i vetmi synim i veprimit apo mosveprimit në fjalë.[734]

240. Dhe së fundi, Dhoma nënvizon se ndërsa në jurisprudencën e mëparshme të këtij Tribunali janë nxjerrë përfundime të ndryshme në lidhje me çështjen nëse, për të provuar krimin e torturës, veprimi ose mosveprimi i akuzuar duhet të jetë kryer prej ose me nxitjen apo me pëlqimin ose

[727] Aktgjykimi *Kvoçka*, paragrafi 149.
[728] Aktgjykimi *Kërnojelac*, paragrafi 182.
[729] Aktgjykimi *Kvoçka*, paragrafi 143.
[730] Aktgjykimi *Kërnojelac*, paragrafi 182.
[731] Aktgjykimi *Çelebiqi*, paragrafi 495.
[732] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 153.
[733] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 153.
[734] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 155, Aktgjykimi *Kvoçka*, paragrafi 153; Aktgjykimi *Kërnojelac*, paragrafi 184.

pranimin e një zyrtari apo personi që vepron në cilësi zyrtare,[735] kjo çështje aktualisht është pëcaktuar prej Dhomës së Apelit. Në bazë të së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe jurisprudencës së Tribunalit nuk është e nevojshme që kryesi të ketë vepruar në cilësi zyrtare.[736]

5. Vrasje (Pikat 8 dhe 10)

241. Tre të akuzuarit ngarkohen me vrasje në bazë të Nenit 3 të Statutit.[737] Për të provuar veprën penale të vrasjes janë të nevojshëm tre elementë.[738] (a) vdekja e një viktime, megjithëse nuk është e nevojshme të provohet se është gjetur kufoma e personit të vdekur;[739] (b) se vdekja ishte pasojë e një veprimi ose mosveprimi të kryesit; dhe (c) synimi i kryesit në kohën e veprimit ose mosveprimit për vrasjen e viktimës ose, në mungesë të këtij synimi të përcaktuar, dijenia e tij se vdekja është pasojë e mundshme e veprimit ose mosveprimit.[740]

B. Përfundime

242. Dhoma vë në dukje se në mbështetje të akuzave të burgimit dhe trajtimit mizor (Pikat 1 dhe 2), Prokuroria ka deklaruar në Aktakuzë se të paktën 35 individë u arrestuan dhe mbajtën në kamp-burgun e Llapushnikut.[741] Mirëpo në Aktakuzë janë përmendur shprehimisht vetëm 24 individë për të cilët pretendohet se janë viktima të vrasjes.[742] Në fillim të gjyqit, Prokuroria paraqiti një dokument që përmbante emrat dhe fotografitë e personave për të cilët u argumentua se ishin viktima të mbajtura në kamp-burgun e Llapushnikut, ndërmjet të cilëve 28 ishin vrarë dhe 22 kishin mbetur gjallë.[743] Dhoma nënvizon se kjo ka krijuar një farë paqartësie. Në veçanti duket se në këtë dokument Prokuroria pretendon vrasjen edhe të katër individëve të tjerë, të cilët nuk ishin përmendur në Aktakuzë. Duke marrë parasysh se këto akuza të tjera për vrasje nuk ishin trajtuar si duhet në Aktakuzë, Dhoma nuk i ka shqyrtuar ato në këtë vendim.

---

[735] *Shih* për shembull Aktgjykimin *Çelebiqi*, paragrafi 494 dhe Aktgjykimin *Kvoçka*, paragrafët 137-141.
[736] Vendimi i Apelit *Kunarac,* paragrafi 148; Vendimi i Apelit *Kvoçka,* paragrafi 284.
[737] Aktakuzë, paragrafët 28-33; 34-37.
[738] *Shih* Vendimin e Apelit *Kvoçka,* paragrafët 257 dhe 261.
[739] *Shih* Aktgjykimin *Kërnojelac*, paragrafi 326, zgjeruar prej Dhomës së Apelit në Vendimin e Apelit *Kvoçka,* paragrafi 260, "Fakti i vdekjes së një viktime mund të nxirret tërthorazi prej të tëra dëshmive të paraqituara para Dhomës Gjyqësore. Tërë ajo çfarë kërkohet të provohet prej dëshmive është se i vetmi përfundim i arsyeshëm prej dëshmive është se viktima vdiq si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të të akuzuarit ose të një apo më shumë personave për të cilët i akuzuari është penalisht përgjegjës." *Shih* dhe Aktgjykimin *Tadiq*, paragrafi 240.
[740] *Shih* Dhomën Gjyqësore *Strugar*, paragrafi 236.
[741] Aktakuzë, paragrafi 22.
[742] Aktakuzë, paragrafët 29-32 dhe Shtojcat I, II dhe III.
[743] Prova Materiale P54.

1. Ekzistenca e një kamp-burgu në Llapushnik

243. Pretendohet se veprimet e akuzuara prej kësaj Aktakuze kanë ndodhur në një kamp-burg të ngritur në fshatin Llapushnik ose në lidhje me të, pak pasi në fshat ishin dislokuar trupat e UÇK-së në maj 1998. Tre të Akuzuarit nuk e pranojnë ekzistencën e një kamp-burgu të UÇK-së në Llapushnik në çfarëdo kohe midis fillimit të majit dhe fundit të korrikut 1998. Një numër dëshmitarësh të Prokurorisë dhe Mbrojtjes, ndër ta ish-anëtarë të UÇK-së dëshmuan se ata nuk ishin në dijeni të ekzistencës së këtij kampi.[744] Fatmir Limaj dëshmoi se ai nuk pa apo dëgjoi kurrë për një kamp-burg në Llapushnik. Ai dëshmoi se ai nuk besonte se kishte një të tillë.[745] Një ish-anëtar i UÇK-së i thirrur si dëshmitar i mbrojtjes, Elmi Sopi, deklaroi se krejt fshati Llapushnik ishte befasuar prej akuzës së ekzistencës së kamp-burgut dhe ata ishin njohur me këtë vetëm pas arrestimit të tre të Akuzuarve në këtë Aktakuzë.[746] Rrjedhimisht për Dhomën është e nevojshme të përcaktojë nëse është provuar ekzistenca e një kamp-burgu të UÇK-së në Llapushnik dhe nëse atje janë mbajtur individë gjatë kohës që ka lidhje me këtë Aktakuzë.

244. Një numër dëshmitarësh të Prokurorisë dëshmuan për rrethanat e rrëmbimit të tyre prej vendeve të ndryshme në komunat e Gllogocit, Lipjanit dhe Shtimes si dhe mbajtjen e tyre në një oborr shtëpiak fshatar në periudhën nga qershori në korrik 1998. Dhoma do të shqyrtojë më poshtë dëshmitë e tyre. Llapushniku është në komunën e Gllogocit. Lipjani dhe Shtimja janë komuna fqinje në jug-lindje të Gllogocit.

245. Dëshmitari L06 dëshmoi se më 13 qershor 1998, së bashku me Dëshmitarin L10 dhe dy persona të tjerë, u ndaluan prej dy ushtarëve të UÇK-së me maska, të cilët mbanin automatikë.[747] Rreth një orë më vonë katër ushtarë të UÇK-së të veshur me uniforma kamuflimi erdhën dhe morën L06-ën, L10-ën dhe një ose dy persona e i çuan te shtëpia e Idriz Muharremit.[748] Atje kishte shumë ushtarë, midis të cilëve Ali Gashi dhe Ramadan Behluli.[749] L06 dhe L10 u futën në vendbagazhin e një makine dhe personi i tretë u vendos në një makinë tjetër.[750] L06 dhe L10 u transportuan me makinë në një vend për të cilin L06 tha se ishte Llapushniku. L06 e njihte Llapushnikun sepse ai e njihte zonën pasi kishte patur të afërm të cilët kishin jetuar atje.[751] Udhëtimi zgjati afërsisht tri orë

[744] Fadil Kastrati, T 2620; Jakup Krasniqi, T 3475; Jan Kickert, T 696, 737-739; Peter Bouckaert, T 5586; Ramadan Behluli, T 2832-2835; Dr Zeqir Gashi, T 5631-5632; Elmi Sopi, T 6739; Rexhep Selimi, T 6606.
[745] Fatmir Limaj, T 6336.
[746] Elmi Sopi, T 6739.
[747] L06, T 974; 977-979.
[748] L06, T 983; 985.
[749] L06, T 983-984.
[750] L06, T 989-990.
[751] L06, T 994; 1068.

në një rrugë me gropa.[752] Sapo arritën atje L06 u çua në një dhomë në të cilën ishte një person nga Carraleva, më vonë i identifikuar si Emin Emini.[753] Të nesërmen një person të cilin L06 e përmendi si Shala, erdhi në dhomë dhe e lidhi L06-ën me zinxhirë të rëndë.[754] Më vonë u vërtetua se kjo dhomë, ku u çua L06 ishte fllaniku i një oborri fshatar shtëpiak.[755] Dhoma ishte rreth 2 x 3 metra dhe kishte dysheme prej betoni. Në dysheme kishte bajga dhe një tub. Çatia pikonte. Dhoma kishte vetëm një dritare shumë të vogël. Kishte një kovë e cila përdorej për nevoja personale.[756] Nga fundi i burgimit të L06-ës numri i të burgosurve në këtë dhomë shkoi deri në 12 ose 13 persona gjithsej.[757] L06 mbante mend emrat e dy prej tyre Adem dhe Shefqet,[758] dhe mundi të identifikonte L96-ën si një nga të burgosurit e fllanikut.[759] Lutfiu ishte gjithashtu një i burgosur i kësaj dhome ashtu siç ishte dhe L07 për disa ditë.[760] Dy roja, për të cilët L06 tha se ishin Shala dhe Murrizi, u sillnin ushqim dhe ujë të burgosurve.[761] Çdo tri ose katër ditë Shala hapte derën dhe i linte të burgosurit të ecnin për pak kohë.[762]

246. L06 dëshmoi se ai u mbajt në fllanik afërsisht dy muaj.[763] Në ditën e tij të fundit të burgimit kampi u granatua prej forcave serbe. L06-ës dhe të burgosurve të tjerë u thanë të dilnin nga fllaniku dhe u detyruan të ecnin drejt maleve të shoqëruar prej rojeve të burgut, Shalës dhe Murrizit.[764] Jashtë fllanikut ishin të burgosur të tjerë, ndër ta Milaimi nga Reçaku, Dëshmitari L96, Hida, Dëshmitari L04, Dëshmitari L12, një person me një këmbë të lënduar, dhe Lumaj.[765] Të gjithë u detyruan të ecnin drejt maleve. Ata arritën në një lëndinë të rrethuar prej maleve të Berishës ku qëndruan afërsisht dy orë. Roja e UÇK-së thirri emrat e dhjetë të burgosurve, ndër ta dhe L06-ën. L06 tha se atyre iu dhanë pusulla me emrat e tyre mbi to dhe iu thanë të shkonin drejt Kishnarekës.[766]

247. Dëshmitari L10 dëshmoi se më 14 qershor 1998 ai së bashku me dëshmitarin L06 dhe një individ tjetër u ndaluan prej dy njerëzve të armatosur me maska dhe me emblemat e UÇK-së në

[752] L06, T 990.
[753] L06, T 990-992; Prova Materiale P54.
[754] L06, T 993-994.
[755] L06, T 1038-1039; Prova Materiale P6.
[756] L06, T 990-993; 995-997.
[757] L06, T 999.
[758] L06, 999-1001; 1039-1045; Prova Materiale P54.
[759] L06, T 1039-1045; Prova Materiale P54.
[760] L06, T 1039-1045.
[761] L06, T 997-998; 1001, 1101-1102.
[762] L06, T 997-998.
[763] L06, T 990-993.
[764] L06, T 1025, 1028.
[765] L06, T 1033-1034; 1039-1045.
[766] L06, T 1028-1030.

afërsi të fshatit Zborc.[767] Pas një ore erdhën tre ose katër njerëz të armatosur e të maskuar të cilët i çuan të tre burrat në shtëpinë e Idriz Muharremit që ndodhej afër. Atje L10 u detyrua të hynte në vendbagazhin e një makine e cila udhëtoi afërsisht një orë e gjysëm. Makina ndaloi dhe L10 u çua në një "qilar të errët". Pak më vonë aty sollën edhe individin e tretë i cili ishte marrë bashkë me L10-ën. Ai i tha L10-ës se ata ishin në Kleçkë.[768] Afërsisht pas një ore L10-ës i lidhën sytë dhe e futën përsëri në vendbagazhin e një makine.[769] Makina udhëtoi deri në një vend tjetër afërsisht një orë.[770] Sapo hynë brenda atij ia hoqën mbulesën për sytë dhe L10 pa ushtarë të maskuar të cilët e pyetën kush ishte spiun në fshatin e tij.[771] Pastaj L10 u çua në atë që ai e përshkroi si qilar.[772] Më vonë u qartësua se ky ishte fllaniku i oborrit shtëpiak ku ishte sjellë ai.[773] Dhoma ishte 4 x 3 metra, kishte një dritare, një derë prej hekuri dhe dysheme betoni.[774] Dera ishte gjithmonë e mbyllur. Ishte një kovë që përdorej për nevoja personale.[775] Dy roja për të cilët L10 tha se ishin Shala dhe Murrizi sillnin ujë dhe ushqim.[776] Në fillim në fllanik mbaheshin katër persona, por më vonë atje u mbajtën deri në 15 persona.[777] L10 tha se ndërmjet tyre ishin Shefqeti dhe Ademi nga Godanci, Lutfiu nga Bregu i Zi, Hyzriu nga fshati Belincë, Dëshmitari L96 dhe dy serbë.[778] L10 mundi të identifikonte fotografitë e Bashkimit nga Godanci, Fehmi Xhemës, Ademit nga Godanci dhe L96-ës si të burgosur të mbajtur në fllanik.[779]

248. L10 dëshmoi se ai u mbajt afërsisht dy muaj në kamp-burg.[780] Në ditën e fundit të qëndrimit të tij në kamp filluan granatime dhe luftime. Në orën 10:00 ose 11:00, Shala dhe Murrizi u futën në dhomë, u thanë të burgosurve se kishte "granatime" dhe i nxorrën ata në oborr.[781] Atje i rreshtuan të burgosurit në një kolonë dhe u thanë t'i ngjiteshin malit.[782] Afërsisht pas 40 minutash ata ndaluan pranë një qershie. Bazuar në të thënat e një të afërmi të tij , L10 nxorri përfundimin se ky vend ndodhej në malet e Berishës.[783] Atje ishin Shala, Murrizi dhe një ushtar tjetër me automatikë.[784] Afërsisht pas dy orësh Shala i ndau të burgosurit në dy grupe, njëri grup u lirua aty dhe grupi tjetër

[767] L10, T 2907-2909.
[768] L10, T 2913-2915.
[769] L10, T 2915-2916.
[770] L10, T 2916.
[771] L10, T 2916-2917.
[772] L10, T 2916.
[773] L10, T 2927-2928.
[774] L10, T 2918-2920.
[775] L10, T 2918-2921.
[776] L10, T 2918-2922.
[777] L10, T 2922-2923.
[778] L10, T 2923-2925.
[779] L10, T 2969-2973. Prova Materiale P54.
[780] L10, T 2921.
[781] L10, T 2960.
[782] L10, T 2960-2961.
[783] L10, T 2960-2966.

do të lirohej më vonë.[785] L10 ishte në grupin që u lirua. Ai mban mend se në këtë grup ishin edhe personat e përmendur më poshtë: Shefqeti dhe Ademi nga Godanci, një person nga Reçaku, Muja nga Belinca, Dëshmitari L04, Dëshmitari L06 dhe Dëshmitari L12.[786] Atyre iu dhanë nga një pusullë që ishte autorizimi i lirimit, të u shkruan prej Shalës, para se ai t'u thoshte se ata ishin të lirë të largoheshin.[787] Atyre u thanë që të zbrisnin teposhtë, por në të vërtetë ata shkuan në fshatin Kishnarekë.[788] Pas lirimit të tij L10 mësoi prej një të afërmi të tij se ai ishte mbajtur i burgosur në Llapushnik.[789]

249. Deklarata me shkrim e Dëshmitarit L84, e pranuar si provë në bazë të Rregullës 92*bis,* ofron edhe një dëshmi më shumë për ekzistencën e kamp-burgut në Llapushnik. L84, civil, deklaroi se dikur në qershor 1998 ai u çua me makinë nga Kishnareka në Llapushnik prej ushtarëve të UÇK-së.[790] Makinën e ngau një ushtar i UÇK-së i njohur si "Vogëlushi".[791] Kur arritën në Llapushnik makina u ngjit përpjetë prej rrugës Prishtinë-Pejë drejt pyllit dhe arritën në një vend ku dy oborre ndaheshin nga një rrugicë.[792] "Vogëlushi" i tha L84-ës se oborri në anën e majtë ishte shtabi i UÇK-së në Llapushnik. Ai u çua në oborrin e shtabit dhe ndejti në dhomën që është ngjitur me portën e madhe nga ana e djathtë. Në oborr ndodheshin edhe një ndërtesë e madhe kryesore dhe një ndërtesë tjetër më e vogël. Atje L84-ës i thanë se oborri ishte i familjes së "Vojvodës".[793] Në këtë oborr L84 u pyet për njerëz nga fshati i tij dhe të nesërmen u çua në oborrin në anën e djathtë të rrugicës përballë oborrit të shtabit.[794] Ky oborr kishte një portë prej metali ose druri me dy kanata në ngjyrë të kuqërreme. Pranë portës së madhe ishte një derë më e vogël dhe brenda kishte shkallë që të çonin në dhomat e sipërme menjëherë në të djathtë brenda portës.[795] Pasi ngjiteshe lart nëpër shkallë, ishin dy dhoma të veçanta.[796] Përshkrimi i oborrit të dytë dhe i oborrit të Shtabit dhe ndërvendosja fizike e të dyve, përputhen me përshkrimin e kamp-burgut të pretenduar prej Prokurorisë. L84 ndejti në njërën prej këtyre dhomave me një plak.[797] Në dhomën tjetër ishte një djalë i ri nga Carraleva. Te porta dhe te shkallët jashtë dhomës ku mbahej L84 ishte gjithmonë një

[784] L10, T 2962-2963.
[785] L10, T 2963.
[786] L10, T 2964.
[787] L10, T 2967.
[788] L10, T 2964.
[789] L10, T 2934-2935.
[790] Prova materiale P197, paragrafët 14, 17-22.
[791] Prova materiale P197, paragrafi 22.
[792] Prova materiale P197, paragrafi 23.
[793] Prova materiale P197, paragrafët 23-24.
[794] Prova Materiale P197, paragrafët 25-28, 30.
[795] Prova Materiale P197, paragrafi 30.
[796] Prova Materiale P197, paragrafi 32.
[797] Prova Materiale P197, paragrafi 32.

rojë.[798] Një ditë, një rojë i tha L84-ës të dilte dhe ai foli me L64-ën, i cili mbante uniformën e UÇK-së.[799] L84 ndejti në Llapushnik tri netë, dy të fundit në oborrin e dytë të ruajtur përballë oborrit që shërbente si shtab i UÇK-së ku ai u çua fillimisht.[800] Atë e pyetën për disa persona.[801] L84 deklaroi se para se të lirohej ai u kërcënua dhe iu tha të mos i tregonte askujt çfarë kishte parë.[802]

250. Dëshmitari L04 dëshmoi se më 28 qershor 1998 apo rreth kësaj date, ai u mor prej shtëpisë së tij nga një grup ushtarësh në uniforma të zeza dhe me emblema të UÇK-së, midis tyre Alush Gashi dhe Rrahman Tafa.[803] Ushtarët dhe L04 fillimisht shkuan në shtëpinë e L12-ës. Nga andej ushtarët morën L12-ën dhe të gjithë së bashku shkuan në shtëpinë e një personi tjetër për të kërkuar armë.[804] Pasi gjetën një armë në këtë shtëpi, dy ushtarë, Alush Gashi dhe Shukri Buja, i cili gjithashtu ishte atje, ua lidhën duart pas shpine me litar L04-ës dhe L12-ës, ua mbuluan kokat me thasë dhe i detyruan të hynin në një makinë.[805] Fillimisht i çuan në një shtëpi në fshat që shërbente si shtab i UÇK-së dhe më pas në një shtab tjetër të UÇK-së në fshatin Pjetërshticë.[806] Atje L04 dhe L12 u fyen dhe u rrahën me shkopinj të hollë ende me kokë të mbuluar me thasë.[807] L04-ës iu thye një dhëmb dhe kishte dhimbje.[808] Pas rrahjeve L04 dhe L12 u detyruan të shtriheshin në pjesën e pasme të një kombi, ende me thes në kokë.[809] Kombi udhëtoi afërsisht një orë e pastaj u kthye sërish majtas. L04 dhe L12 u nxorrën nga makina. Një individ të cilit një ushtar iu drejtua si "Shala" ua hoqi thasët nga koka.[810] L04 e dinte se ata ishin në Llapushnik.[811] Ai e njihte mjaft mirë fshatin Llapushnik pasi në të shkuarën ai kalonte një herë në javë përmes këtij fshati.[812]

251. L04 u mbajt në ahurin e oborrit shtëpiak.[813] Në ahur mbaheshin edhe njerëz të tjerë, midis tyre ai përmendi Veselin dhe Shyqën nga Godanci, Elmi Qerkinin nga Carraleva, Agimin, Dëshmitarin L12, dy serbë nga komuna e Suharekës, një person nga Kroimiri dhe një person i thirrur Bosnjaku.[814] Shyqja nga Godanci kishte një këmbë të thyer.[815] Pak ditë më vonë në ahur

[798] Prova Materiale P197, paragrafët 30, 32.
[799] Prova Materiale P197, paragrafi 35.
[800] Prova Materiale P197, paragrafi 31.
[801] Prova Materiale P197, paragrafët 25-28.
[802] Prova Materiale P197, paragrafi 36.
[803] L04, T 1110-1113.
[804] L04, T 1113-1118.
[805] L04, T 1118-1119.
[806] L04, T 1119-1121.
[807] L04, T 1121-1122.
[808] L04, T 1122.
[809] L04, T 1123.
[810] L04, T 1124-1125.
[811] L04, T 1123-1124.
[812] L04, T 1272-1273.
[813] L04, T 1127-1130.
[814] L04, T 1131-1136, 1139.

sollën Milaim Kamberin nga Reçaku, Hetën nga Petrova dhe Xhelë Halimin nga Petrova.[816] Të gjithë të burgosurit u lidhën me zinxhir pas murit.[817] Shala ishte roja i ahurit, ai u sillte ushqim të burgosurve dhe ishte gjithmonë atje.[818] L04 pa edhe ushtarë të tjerë të UÇK-së në kamp-burg, përkatësisht individët e përmendur si Çerçizi, Tamuli dhe Murrizi.[819] Një herë L04 u nxorr jashtë ahurit. Në atë kohë ai pa malet e Berishës dhe një shtëpi të vogël brenda oborrit.[820] Ky përshkrim përputhet me kamp-burgun e pretenduar prej Prokurorisë.

252. Dëshmitari L04 tha se ai kaloi 28 ditë në oborrin e burgut.[821] Ditën e fundit të mbajtjes në ahur erdhi Murrizi dhe i liroi të burgosurit prej zinxhirëve. Atyre iu tha të shkonin në oborr dhe bashkë me të burgosurit e tjerë u detyruan të ecnin drejt maleve të Berishës.[822] L04 pa edhe njerëz të tjerë në oborr, të cilët siç dukej gjithashtu ishin mbajtur në kamp-burg, ndër ta Emin Eminin, Hyzriun, Safetin, Lutën, një të burgosur femër, Dëshmitarin L06 dhe Dëshmitarin L96.[823] Të burgosurit u ngjitën në malet e Berishës dhe atje pushuan afërsisht një orë. Pastaj Murrizi thirri emrat e 11 të burgosurve, ndër ta edhe L04, dhe u tha se ishin të lirë të shkonin. Të tjerët do të liroheshin më vonë.[824] Emrat e të burgosurve të grupit të parë ishin Shefqeti, Milaimi, Muja, Luma, një person nga Kraishta, Afrim Qeriqi nga Kroimiri, Dëshmitari L12, Dëshmitari L10 dhe Dëshmitari L04. Shala u dha secilit prej tyre nga një pusullë në të cilën L04 tha se deklarohej që Komandant Çeliku kishte urdhëruar lirimin e tyre. Ai u tha atyre të shkonin në Kishnarekë.[825] Të burgosurit të cilët mbetën më pas në malet e Berishës ishin Heta, Safeti, Hyzriu, Luta, Xhela, Hasani, Ibushi, Shyqja, Dëshmitari L96 dhe një grua.[826]

253. Edhe Dëshmitari L12 dëshmoi se një natë në verën e vitit 1998 ai u mor nga shtëpia e tij prej ushtarëve të UÇK-së. Një grup ushtarësh të UÇK-së në uniforma ushtarake, vetëm tre prej të cilëve nuk mbanin maskë, dhe Dëshmitari L04 erdhën në shtëpinë e tij afërsisht në orën 01:30-02:00 dhe e çuan në një shtëpi tjetër ku ushtarët e UÇK-së morën një pushkë, një gjenerator dhe një telefon.[827]

---

[815] L04, T 1139.
[816] L04, T 1136-1138.
[817] L04, T 1140-1141.
[818] L04, T 1175, 1177-1179.
[819] L04, T 1136, 1172-1173, 1175-1176, 1192-1194.
[820] L04, T 1183.
[821] L04, T 1173.
[822] L04, T 1192-1194.
[823] L04, T 1192-1194. Dhoma thekson se prania e një gruaje midis të burgosurve nuk është konfirmuar prej dëshmive.
[824] L04, T 1194-1195.
[825] L04, T 1197-1198; Prova Materiale P76.
[826] L04, T 1197-1198; Prova Materiale P76. Dhoma thekson se prania e një gruaje midis të burgosurve në malet e Berishës nuk është konfirmuar prej dëshmive
[827] L12, T 1788-1792.

L12 tha se midis ushtarëve të UÇK-së ishin Shukri Buja, Ramadan Behluli, Sulë Qeriqi dhe Ali Ramadani.[828] Atje L12 dhe L04 u detyruan të futeshin në një makinë dhe u lidhën së bashku. L12-ës ia mbuluan kokën me thes dhe ata u çuan me makinë në fshatin Pjetërshticë prej Ali Ramadanit dhe Shukri Bujës.[829] Në fshat, L12 dhe L04 u çuan në një shtëpi ku u rrahën nga ushtarët e UÇK-së, Rrahman dhe Alush Gashi. L12 u godit në shpinë dhe në këmbë me shkopinj të rëndë. Ushtarët i shanë L12-ën dhe L04-ën ndërkohë që po i rrihnin.[830] Pas afërsisht 15 minutash, L12 dhe L04 u futën në një makinë dhe sipas L12-ës, u çuan në Llapushnik.[831] Atje, një person që L12 e përshkroi si Shala, ia hoqi L12-ës thesin prej kokës.[832]

254. Pastaj Dëshmitari L12 u mbajt në një ahur.[833] Në murin e majtë ishte një dritare dhe mbi dyshemenë prej betoni kishte bajga dhe gjak.[834] Në ahur ishin edhe njerëz të tjerë, të cilët ishin të gjithë të lidhur me zinxhirë.[835] Kur u pyet, L12 mbante mend se bashkë me atë ishin mbajtur këta persona: Elmi Qerkini, Xheladini, Heta nga Petrova, Afrim Qeriqi nga Kroimiri, Muja nga Belinca, Milaimi nga Reçaku dhe Shefqet Ramadani nga Godanci.[836] Roja i ahurit ishte një person i përmendur si Shala. Ai kishte çelësat e ahurit, vinte çdo ditë dhe sillte ushqim. L12 pa edhe një rojë tjetër në kamp-burg, për të cilin L12 tha se quhej Murrizi.[837]

255. L12 dëshmoi se gjatë ditës së fundit të burgimit të tij, në kamp shpërtheu një predhë. Shala i nxori të gjithë të burgosurit nga ahuri dhe i çoi në malet e Berishës. Të burgosurit marshuan njëri pas tjetrit përmes maleve. Kolonës i printe Murrizi dhe Shala qëndronte prapa.[838] Një i burgosur e kishte këmbën e lënduar dhe nuk mund të ecte vetë. Grupi arriti në një luginë. Atje u lirua gjysma e të burgosurve midis tyre edhe L12, kurse gjysma tjetër mbeti në atë vend.[839] Të liruarve u dhanë nga një pusullë.[840] Pasi u liruar, kur po ecte drejt kodrave, L12 e kuptoi se ishte mbajtur në Llapushnik. Ai e kishte vizituar fshatin shumë herë dhe e njihte shumë mirë.[841]

[828] L12, T 1788-1791.
[829] L12, T 1794-1795.
[830] L12, T 1797-1798.
[831] L12, T 1788-1791; 1797-1798.
[832] L12, T 1799.
[833] L12, T 1799.
[834] L12, T 1802-1803.
[835] L12, T 1799; 1803.
[836] L12, T 1820-1823.
[837] L12, T 1800-1802.
[838] L12, T 1813-1815.
[839] L12, T 1815-1818.
[840] L12, T 1818.
[841] L12, T 1815-1816.

256. Vojko Bakraçi dëshmoi se më 29 qershor 1988, një ose dy kilometra pasi kishin kaluar përmes Suharekës, ai dhe djali i tij Ivani, në atë kohë 18-vjeçar, u rrëmbyen prej ushtarëve të UÇK-së nga një autobus i cili udhëtonte nga Gjakova në Prishtinë.[842] Ata kishin jetuar në Kroaci por ishin me kombësi serbe. Nga autobusi u morën Vojko Bakraçi, djali i tij dhe dy serbë të tjerë Zhelko Çuk, më vonë i identifikuar si Gjorgje Çuk[843] dhe Stamen Genov, dhe atyre u lidhën sytë. Fillimisht Stamen Genovi dhe Gjorgje Çuk dhe më vonë dy Bakraçët u çuan me makinë në një shkollë fshati.[844] Pak kohë më vonë Vojko Bakraçi dhe djali i tij u futën në një kombi me sy të lidhur dhe u çuan në një shtëpi fshatare.[845] Edhe Stamen Genov e Gjorgje Çuk u futën në kombi dhe u lidhën.[846] Në shtëpinë fshatare, Vojko Bakraç dhe i biri hynë në oborr përmes një porte, ua hoqën mbulesën e syve dhe i çuan në një shtëpi të vogël, fillimisht përmes një kuzhine dhe pastaj në një dhomë për ngrënie ku kishte sfungjerë.[847] Në këtë dhomë ishin disa ushtarë.[848]

257. Shpejt pas kësaj Vojko Bakraç dhe i biri u çuan në një bodrum sipas tij në mes të oborrit.[849] Më vonë u provua se ishte fllaniku në atë oborr shtëpiak.[850] Dhoma ishte tre me pesë ose gjashtë metra dhe kishte një dritare të vogël dhe një derë.[851] Dyshemeja, ndoshta prej betoni ishte e mbuluar me sanë dhe kashtë. Pranë derës ishte një kovë për nevoja personale. Dera ruhej, megjithëse jo tërë kohën.[852] Së bashku me Bakraçët atje mbaheshin 13 persona: tre shqiptarë kosovarë, një serb i quajtur Zhelko, një plak i sëmurë serb, dy vëllezër serbë nga Suhareka të quajtur Kërstiq, të cilët më vonë u identifikuan prej tij si Milovan Kërstiq dhe Miodrag Kërstiq,[853] një serb tjetër i rrëmbyer nga një autobus, Vojko Bakraçi me të birin, Ivanin, Stamen Genov dhe Gjorgje Çuk.[854] Një njeri i përmendur si Shala ishte roje në kamp-burg, ai komunikonte me të burgosurit dhe u sillte ushqim dhe cigare.[855]

258. Vojko Bakraçi dhe i biri u mbajtën për dy ose tri ditë dhe netë në fllanik.[856] Ditën e tretë ose të katërt të qëndrimit të Vojko Bakraçit në kamp, në fllanik hyri një person dhe i tha Ivan Bakraçit

[842] Vojko Bakraç, T 1286-1297.
[843] Vojko Bakraç, T 1291-1294; Prova Materiale P54.
[844] Vojko Bakraç, T 1291-1299.
[845] Vojko Bakraç, T 1304-1306.
[846] Vojko Bakraç, T 1304.
[847] Vojko Bakraç, T 1304-1306.
[848] Vojko Bakraç, T 1306-1307.
[849] Vojko Bakraç, T 1311-1314.
[850] Vojko Bakraç, T 1326-1329.
[851] Vojko Bakraç, T 1311-1314.
[852] Vojko Bakraç, T 1329.
[853] Vojko Bakraç, T 1314-1317; Prova Materiale P54.
[854] Vojko Bakraç, T 1311-1314.
[855] Vojko Bakraç, T 1330-1332.
[856] Vojko Bakraç, T 1329.

të dilte nga fllaniku.[857] Më vonë, një ushtar e çoi Vojko Bakraçin në ndërtesën kryesore ku ai pa të birin duke pirë çaj me personin që i kishte thënë të dilte nga fllaniku. Vojko Bakraçin e kthyen në fllanik, mirëpo pas gjysëm ore ai u çua sërish në një pjesë trualli me bar ku pa të birin dhe pastaj në një dhomë në katin e parë të ndërtesës kryesore ku ai dhe i biri ndejtën pesë ditë derisa u liruan.[858] Atje ndodheshin dy ose tre shqiptarë kosovarë, njëri prej të cilëve quhej Gëzim.[859] Vojko Bakraçit dhe të birit iu kërkuan të jepnin deklaratë me shkrim dhe në video mbi kushtet në kamp-burg.[860] Atyre u thanë se do të liroheshin sapo KNKK-ja apo UNHCR-ja do të ishin në gjendje t'i merrnin në dorëzim. Ditën e fundit në atë oborr shtëpiak atyre iu thanë të hipnin në një xhip dhe ua lidhën sytë. Pas 15-20 minutash, ua hoqën mbulesën e syve, makina vazhdoi udhëtimin dhe ata u çuan në Malishevë.[861]

259. Edhe Ivan Bakraçi dëshmoi për rrëmbimin e tij dhe të babait të tij, nga një autobus që udhëtonte nga Gjakova në Prishtinë në fund të qershorit 1998. Diku pas Prizrenit autobusi u ndal prej gjashtë ushtarëve me automatikë ose bazuka. Tre ushtarë mbanin uniforma kamuflimi.[862] Ushtarët hipën në autobus dhe kontrolluan letërnjoftimet e udhëtarëve. Ivan Bakraçit i thanë të zbriste nga autobusi dhe po ashtu edhe babait të tij. Gjithashtu u thanë të zbrisnin prej autobusit edhe dy serbëve, Stamen Genovit dhe një individi të quajtur Çuk, më vonë i identifikuar si Gjorgje Çuk.[863] Shoferit të autobusit iu tha të vazhdonte udhëtimin.[864] Një makinë mori Stamen Genovin dhe Gjorgje Çukun dhe i çoi diku dhe u kthye pas gjysëm ore ose një ore. Pastaj ushtarët e UÇK–së ua lidhën sytë Ivan Bakraçit dhe të atit, i futën në një makinë dhe udhëtuan përmes një pylli. Afërsisht pas një ore ata arritën në një fshat dhe ndaluan para një ndërtese që dukej si shkollë.[865] Atje ndodheshin Stamen Genovi dhe Gjorgje Çuku. Ata kaluan thuajse pesë orë në shkollë. Gjatë kësaj kohe, ushtarët, afërsisht dhjetë, u bënë atyre pyetje.[866]

260. Atë natë Ivan Bakraçit, të atit dhe dy serbëve të marrë nga autobusi ua lidhën sërish sytë dhe i futën në kombi.[867] Udhëtimi vazhdoi afërisht 45 minuta ose një orë. Rruga ishte me gropa. Kombi ndalonte në çdo disa minuta, si duket për të kaluar postbllоqet.[868] Kur arritën në vendmbërritjen e

[857] Vojko Bakraç, T 1334-1336.
[858] Vojko Bakraç, T 1338.
[859] Vojko Bakraç, T 1339-1342.
[860] Vojko Bakraç, T 1343-1345.
[861] Vojko Bakraç, T 1345-1351.
[862] Ivan Bakraç, T 1395-1397.
[863] Ivan Bakraç, T 1405, Prova Materiale P54.
[864] Ivan Bakraç, T 1397-1402.
[865] Ivan Bakraç, T 1403-1405.
[866] Ivan Bakraç, T 1403-1408.
[867] Ivan Bakraç, T 1410.
[868] Ivan Bakraç, T 1410-1411.

tyre Ivan Bakraçit iu hoq thesi nga koka dhe ai pa një gardh të madh ngjyrë kafe dhe një portë. Ivani dhe të tjerët u çuan në një shtëpi dhe u mbajtën në një dhomë në katin përdhes afërsisht për një orë e gjysëm.[869] Para dhomës kryesore, ishte një korridor i vogël me wc-në në të të majtë.[870] Në dhomën kryesore kishte dyshekë dhe pranë derës ishte një stufë. Kur Ivanin dhe të atin i prunë në dhomë atje ishin disa ushtarë. Ivan Bakraçi dhe i ati u morën në pyetje.[871] Afërsisht pas një orë e gjysëm Ivan Bakraçi dhe i ati u çuan në bodrumin e ndërtesës ngjitur, që më vonë u identifikua si fllaniku në atë oborr.[872] Ivan Bakraçi e përshkroi fllanikun si shumë të vogël, afërisht katër me dy metra. Në një lartësi rreth 40 cm nga dyshemeja ishte një raft 30-40 cm i gjerë. Pranë derës ishte një kovë që përdorej për nevoja personale.[873] Dyshemeja ishte prej betoni dhe ishte e mbuluar me sanë.[874] Kur Ivani, i ati dhe dy serbët e marrë nga autobusi, Stamen Genov dhe Gjorgje Çuk u prunë në fllanik, atje ndodheshin gjashtë ose shtatë njerëz: tre shqiptarë kosovarë dhe tre apo katër serbë.[875] Ivan Bakraçi dhe i ati kaluan tri ose pesë netë në fllanik.[876]

261. Një ditë Ivan Bakraçit iu tha se duhej të dilte nga fllaniku. Një person i përmendur si Shala dhe një njeri me maskë të zezë thanë se ata duhej të flisnin me të. Ivanin e çuan në dhomën në katin përdhes ku fillimisht ai erdhi për t'u marrë në pyetje. Shala dhe ushtarë të tjerë i sollën ushqim. Ivani u lejua të fliste shkurtimisht me të atin dhe pas kësaj ai dhe i ati u kthyen në dhomën në katin përdhes dhe ndejtën një farë kohe atje.[877] Pastaj të dy u çuan në një dhomë në katin e parë, e cila ndodhej drejtpërdrejtë mbi vendin ku ishin ulur, atje ndodhej një i ri shqiptar kosovar. Ndonjëherë në dhomë kishte ushtarë, por më të shumtën e kohës ishin vetëm ata të tre. Dera ishte e mbyllur me çelës tërë kohën. Ivan Bakraçi dhe i ati kaluan dy ose tri netë në dhomë.[878] Para lirimit të tyre, Ivan Bakraçit dhe të atit u kërkuan të jepnin deklaratë të filmuar në video për kushtet në kamp-burg. Ivani dhe i ati dhanë deklarata të veçanta përpara pesë ose gjashtë ushtarëve të armatosur të cilët kishin ardhur me kamera.[879] Të nesërmen Ivan Bakraçit dhe të atit ua mbuluan sytë dhe i çuan me xhip në një qytet të vogël, ku ata kaluan te xhipat e UNICEF-it dhe u çuan në një stacion policor serb.[880]

[869] Ivan Bakraç, T 1412-1416; 1428.
[870] Ivan Bakraç, T 1426-1427.
[871] Ivan Bakraç, T 1426-1428.
[872] Ivan Bakraç, T 1441-1447.
[873] Ivan Bakraç, T 1443-1447.
[874] Ivan Bakraç, T 1450-1455.
[875] Ivan Bakraç, T 1443-1447.
[876] Ivan Bakraç, T 1450.
[877] Ivan Bakraç, T 1458-1460.
[878] Ivan Bakraç, T 1458-1464.
[879] Ivan Bakraç, T 1471-1474.
[880] Ivan Bakraç, T 1474-1476.

262. Dëshmitari L07 deklaroi se në korrik 1998 kur po udhëtonte përmes Pjetërshticës ai u ndal prej anëtarëve të UÇK-së.[881] L07 nuk ishte i armatosur dhe ishte i veshur civil.[882] Pastaj dy ushtarë të UÇK-së e sollën te shkolla në Kroimir, afërsisht 2-2.5 km nga vendi ku e kishin ndalur. L07 dëshmoi se pas ardhjes së tij, ai u mor në pyetje nga Ramiz Qeriqi, me pseudonimin Luani.[883] Një ushtar e keqtrajtoi L07-ën dhe atij iu thye një dhëmb. Ai u mbajt në ndërtesën shkollore një ose dy orë.[884] Pastaj L07 u çua në shtabin e UÇK-së në Kroimir në vendbagazhin e makinës së tij. L07 mbeti në vendbagazh afërsisht për 30 minuta kur dy ushtarë të veshur me uniforma të UÇK-së erdhën dhe i dhanë pak ujë. Pastaj L07-ën e çuan në një vend që ai mendoi se ishte Llapushniku.[885] Dy ushtarë e çuan L07-ën në një ahur dhe në atë kohë ai i kishte sytë e mbuluar. Atje ai ndejti afërsisht 10 minuta dhe pas kësaj kapuçi mbi kokën e tij u hoq dhe ai u nxorr jashtë. Ia vunë menjëherë kapuçin dhe e çuan në një dhomë tjetër. Në atë interval të shkurtër kohor kur i kishte sytë e pambuluar, L07 gjithsesi pa kodrat rreth Llapushnikut. L07 e njihte rrethinën sepse ai kishte të afërm të cilët jetonin në Berishë.[886] Në dhomën tjetër L07 pa afërsisht pesë ushtarë. Midis tyre ishte Shukri Buja i cili e njohu L07-ën dhe urdhëroi lirimin e tij.[887] Një person të cilin L07 e përshkroi si komandant Çeliku i tha një personi të thirrur "Shalë" i cili iu paraqit L07-ës si rojë burgu, ta lëshonte L07-ën të shkonte në shtëpi dhe deklaroi se L07 duhej të ndihej si në shtëpi.[888]

263. Rreth orës 19:00, L07 dhe "Shala" shkuan në dhomën lart në katin e parë për të parë televizor.[889] L07 e kaloi natën me dy "kroatë", babë e bir, rrëmbyer prej rrugës në Carralevë dhe dy shqiptarë kosovarë, Faruk Gashi prej Shtimes dhe Gëzim Emini nga Carraleva të cilët ishin të veshur civilë.[890] Të nesërmen L07 u çua në një dhomë, që më vonë u identifikua si fllaniku, ku ai u mbajt dy ditë e një natë.[891] Në atë dhomë mbaheshin gjashtë shqiptarë kosovarë dhe gjashtë serbë; Lutfiu prej Bregut të Zi, Dëshmitari L10 dhe Ademi nga Godanci, një serb i quajtur Mijë nga Reçani, Halim Budakova, një ish-polic serb në Shtime i cili ishte goditur në dy gjunjtë, dhe dy serbë të tjerë.[892] L07 mundi të njihte fotografitë e Miodrag Kërstiqit, Milovan Kërstiqit dhe Sllobodan Mitroviqit si të burgosur të mbajtur në fllanik.[893] L07 deklaroi se dhoma ruhej nga Shala.[894] Në

[881] L07, T 774-776.
[882] L07, T 778.
[883] L07, T 777-778.
[884] L07, T 778-779.
[885] L07, T 781, 846; Prova Materiale P71, paragrafi 11.
[886] L07, T 790-791; 847-849, Prova Materiale P71, paragrafi 12.
[887] L07, T 791-796.
[888] L07, T 795-796; 808.
[889] L07, T 808-809; 812.
[890] L07, T 814-816.
[891] L07, T 817, 821.
[892] L07, T 817; 821-828. Në lidhje me Mijën nga Reçani, *shih* edhe T 825; 828; Prova Materiale P54.
[893] L07, T 825; 828; Prova Materiale P54.
[894] L07, T 808; 831.

kamp ishin edhe roje të tjerë të UÇK-së: një ushtar i maskuar i quajtur Hoxha i cili i rrahu të burgosurit në dy raste dhe Murrizi.[895]

264. Ditën e dytë në fllanik L07 u çua përsëri në dhomën me dy "kroatët" dhe Gëzim Eminin.[896] L07 u lirua të nesërmen dhe iu kërkua nëse mund ta çonte Elmi Qerkinin nga Carraleva me makinë në shtëpi dhe ai pranoi.[897] Para se të dilte prej oborrit atij iu kërkua të shkruante dhe nënshkruante një deklaratë që e detyronte me kërcënim për jetën të mos tregonte çfarë kishte parë në kamp.[898] Të nesërmen në mëngjes në orën 03:00 atij iu dhanë çelësat e makinës së tij. Një ushtar i UÇK-së e voziti makinën e L07-ës ku ishin L07, Elmi Qerkini dhe Gëzim Emini të cilët u liruan po atë ditë, deri në rrugën Arllat-Malishevë. Pas tyre vinte një ushtar tjetër i UÇK-së me një makinë tjetër. Në rrugë ushtari ia ktheu çelësat L07-ës dhe u kthye në drejtimin e kamp-burgut me makinën e dytë të cilën e voziti ushtari tjetër.[899]

265. Dëshmitari L96 dëshmoi se më 18 korrik ose rreth kësaj date pesë ushtarë të UÇK-së me uniforma kamuflimi, dy prej të cilëve kishin shenjat e UÇK-së, erdhën në shtëpinë e tij.[900] Makina ndaloi në shtëpinë e të afërmit të tij i cili u rrëmbye në të njëjtën mënyrë. L96 u fut në makinën e ushtarëve dhe u çua në drejtim të Rancës dhe Lanishtës. Gjatë udhëtimit, L96 u godit me kondakun e pushkës disa herë.[901] Pas një farë kohe ia mbuluan kokën me një batanije.[902] Pas një ndalese të shkurtër në Rancë, ata vazhduan në drejtim të Shtimës, Kroimirit, Shalës, Nekocit dhe në Kishnarekë ata e lanë rrugën e asfaltuar dhe morën një rrugë malore. Udhëtuan afërsisht një orë dhe arritën para një porte prej metali përmes të cilës hyhej në një oborr.[903] Brenda oborrit një person i thirrur Shala i çoi L96-ën dhe bashkëudhëtarin e tij lart nëpër shkallë në të djathtë të ndërtesës dhe e futi në një dhomë pa drita.[904] Dhoma ku u mbajt L96 kishte një çezmë në qoshen e majtë, një dritare dhe një tjetër derë në skajin tjetër. Nuk kishte orendi të tjera veç një qilimi dhe disa dyshekëve prej sfungjeri.[905] L96 përshkroi se ai u mbajt me Bajrush Rexhajn, Mujë Musliun nga Belinca, Sahit Beqajn, Alush Lumën dhe një person nga Varigoci.[906] Gjatë natës ushtarë me

[895] L07, T 819; 834; 923.
[896] L07, T 839.
[897] L07, T 839.
[898] L07, T 839-840; Prova Materiale P71, paragrafi 27.
[899] L07, T 840-844; Prova Materiale P71, paragrafi 30.
[900] L96, T 2283-2285, 2515.
[901] L96, T 2285-2288.
[902] L96, T 2287-2288.
[903] L96, T 2290-2294; Prova Materiale P97.
[904] L96, T 2294.
[905] L96, T 2301-2302.
[906] L96, T 2295-2298; 2301. L96 gjithashtu identifikoi dhe fotografitë e Bajrush Rexhajt, (T 2415, Prova Materiale P54), Sahit Beqajt (T 2411, 2513; Prova Materiale P54), dhe Alush Lumës (T 2414, Prova Materiale P54) si të burgosur të mbajtur atje.

uniforma ushtarake të UÇK-së sollën një plak, Shaban Hotin, mësues i gjuhës ruse i cili ishte i lidhur me zinxhirë dhe dukej i rrahur keqasi.[907] Ushtarët e tërhoqën zvarrë përmes dhomës ku ishte L96 dhe e çuan në dhomën përbri.[908] Të nesërmen sollën Musli Musliun.[909] Dhoma ishte e mbyllur me çelës tërë kohën dhe të burgosurit shoqëroheshin nga një rojë kur shkonin te nevojtorja në oborr.[910] Në këto raste L96 mundi të shihte një shtëpi me ballkon dhe të burgosur të tjerë.[911] Ai gjithashtu pa dhe njohu kodrat përreth dhe tha se e dinte që ndodhej në rrethinën e Llapushnikut.[912] Të burgosurit ruheshin prej personave të cilët thirreshin Shala dhe Murrizi dhe një person emri i të cilit ishte Avdullah, i njohur edhe si Seli, i shoqëronte në nevojtore.[913]

266. Në ditën e dytë të burgimit të tij, L96 u vendos në një dhomë, më vonë e identifikuar si fllanik. Atje L96 kaloi katër ditë dhe netë.[914] Dhoma kishte tavan të ulët dhe ishte afërsisht 3 metra e gjatë. Kishte dysheme prej betoni me kashtë mbi të, dy rafte dhe një dritare pranë derës. Pas derës ishte një kovë që përdorej për nevoja personale.[915] L96 dëshmoi se kur L96 shkoi në fllanik atje mbaheshin këta persona: Emin Emini, Hyzriu nga Belinca, Luta nga Bregu i Zi, Ademi nga Godanci dhe Shefqet Ramadani.[916] L96 mundi të njihte fotografitë e L06-ës dhe L10-ës si të burgosur të mbajtur në fllanik.[917] Të nesërmen në dhomë sollën Shaban Hotin.[918] L96-ës iu tha se tre serbë, një polic i qarkullimit rrugor në Shtime, i cili shërbente në Suharekë dhe ishte marrë prej një autobusi në Carralevë, Bobani nga Suhareka dhe Dragani nga Zubni Potok ishin mbajtur më parë në atë dhomë së bashku me Agimin nga Godanci dhe Vesel Ahmetin, por ata i kishin larguar para ardhjes së L96-ës. Gjithsesi Dragani kishte vrarë veten.[919] Shala dhe Murrizi u sillnin bukë dhe ujë të burgosurve.[920] L96 dëshmoi se ai pa edhe persona të tjerë me uniformë në kamp, përkatësisht Çerçizin, Salihin dhe një person të quajtur Hoxha.[921]

267. L96 dëshmoi se ditën e fundit të burgimit të tij personi që thuhet se është Shala hapi derën dhe i urdhëroi të burgosurit të dilnin. L96 pa Shalën që hapi derën e shtëpisë prej ku dolën Alush

[907] L96, T 2312-2315.
[908] L96, T 2312-2313.
[909] L96, T 2326-2328.
[910] L96, T 2303; 2309.
[911] L96, T 2303.
[912] L96, T 2304, 2319.
[913] L96, T 2302-2303; 2309.
[914] L96, T 2333.
[915] L96, T 2333.
[916] L96, T 2336-2337. Në lidhje me Lutën (Lutfiun) *shih* edhe T 2405-2409. Prova Materiale P54, dhe në lidhje me Ademin nga Godanci, *shih* T 2415; Prova Materiale P54.
[917] L96, T 2411, 2413; Prova Materiale P54.
[918] L96, T 2336.
[919] L96, T 2341-2345.
[920] L96, T 2338-2340.

Luma dhe personi nga Varigoci dhe derën e garazhit prej nga doli Safet Hysenaj nga Petrova. Shala hapi derën e ahurit prej nga dolën shumë të burgosur, midis tyre Xheladin Ademaj, Mujë Musliu, Hasan Dobreva, Hasan Hoxha, Hetem Rexhaj, Dëshmitari L12, Milaim Hoxha nga Reçaku i cili mbante Shyqërinë i njohur edhe si Shyqja nga Godanci, i cili kishte një këmbë të thyer, një i ri nga Kroimiri dhe një plak.[922] Shala i urdhëroi të burgosurit të rreshtoheshin dhe kolona nisi të ecte. Kolonës i printe një ushtar tjetër i UÇK-së, Murrizi, dhe Shala ishte në fund.[923] Afërsisht 200 metra pasi ishin larguar prej oborrit ata u kthyen në të majtë drejt një shtegu malor i cili shkonte përpjetë.[924] Në një moment gjatë ecjes Murrizi pyeti nëse po shkonin në Berishë apo në Kleçkë dhe Shala iu përgjigj "merr majtas". Afërsisht pas një kilometri ata u urdhëruan të ndalin para një druri qershie dhe një pusi ku qëndruan dy ose tri orë.[925] Pastaj Shala thirri emrat e Shefqet Ramadanit, Ademit, Dëshmitarit L10, personit nga Varigoci, Milaim Hoxhës dhe Mujës nga Belinca. Shala u nis me grupin e tij dhe eci teposhtë në drejtim të rrugës për në Suharekë.[926] Pas 40 minutash apo dy orësh, kjo është mospërputhje në dëshminë e L96-ës, Shala u kthye dhe thirri emrat e L96-ës, Hetem Rexhës, Xheladin Ademajt, Hysriut nga Belinca, Hasan Hoxhës, Safet Hysenit, Banushit, Alush Lumës, Shyqëriut, Shaban Hotit dhe Bashkimit nga Godanci dhe e urdhëroi Murrizin t'i printe grupit drejt një pike tjetër. Ata u çuan në një vend të hapët në mal ku Shala i urdhëroi të burgosurit të uleshin ndërkohë që ata u rreshtuan.[927] L96 dëshmoi, gjë që shtjellohet në hollësi më vonë në këtë vendim, se Shala, Murrizi dhe një ushtar i tretë i cili ishte bashkuar me ta pak pasi grupi ishte larguar prej kamp-burgut, hapën zjarr mbi të burgosurit dhe se L96 arriti të ikte.[928]

268. Dëshmitari i Prokurorisë Dragan Jashoviq, hetues policor për krime në Ferizaj dëshmoi se në qershor dhe korrik 1998 ai mori raporte për njerëz të rrëmbyer dhe të mbajtur në Llapushnik.[929] Më 27 qershor 1998 një i afërm i Agim Ademit i raportoi atij se ishin rrëmbyer Agim Ademi dhe Vesel Ahmeti. Në fillim të korrikut 1998 ai mori informacion nga një "lidhje operative e regjistruar" se Agim Ademi, Vesel Ahmeti, Shyqëri Zymeri dhe Adem Ramadani fillimisht ishin çuar në një burg në Kleçkë dhe pastaj ishin transferuar në Llapushnik.[930] Ai gjithashtu dëshmoi se informacioni që mori policia në lidhje me individët e rrëmbyer në komunën e Shtimes, duke

[921] L96, T 2488.
[922] L96, T 2347-2350, 2357, 2414.
[923] L96, T 2351-2352.
[924] L96, T 2363; 2484-2485.
[925] L96, T 2372-2374.
[926] L96, T 2376; 2385; 2387; 2486; 2413; Prova Materiale P108.
[927] L96, T 2377-2381; 2486; Prova Materiale P108.
[928] *Shih më poshtë*, paragrafin 451.
[929] *Shih* Provat Materiale P205 dhe 206.
[930] Dragan Jashoviq, T 5223-5224; 5231-5232.

përfshirë fshatrat Carralevë, Belincë, Petrovë dhe Godanc i Epërm, tregonte se këta persona ishin çuar në një burg në Llapushnik, që ndodhej në komunën e Gllogocit ose përmes Pjetërshticës, Kroimirit, Shalës, ose nga Godanci përmes fshatrave të ndryshëm në Kleçkë.[931] Dragan Jashoviqi dëshmoi se ai mori informacion nga dy të afërm të Hyzri Hajrizit se ky i fundit ishte rrëmbyer dhe çuar në një burg në Llapushnik. Në një rast informacioni për mbajtjen e Hyzri Hajrizit në Llapushnik erdhi nga shtabi i UÇK-së në Rancë.[932] Natyrisht që tërë këto informacione për një burg në Llapushnik janë fjalë dëgjuar prej të tjerëve. Më tej në këtë Aktgykim Dhoma ka dhënë pikëpamjen e saj mbi besueshmërinë e Dragan Jashoviqit.[933] Gjithësesi duhet theksuar se dëshmia e dhënë prej tij nuk është e papajtueshme me një pjesë të konsiderueshme të dëshmive të drejtpërdrejta për një kamp-burg të UÇK-së në fshatin Llapushnik.

269. Gjithashtu Dragan Jashoviqi dëshmoi se më 1 gusht 1998 ai mori një deklaratë prej L96-ës i cili tregoi për burgimin e tij në Llapushnik.[934] Po atë ditë, Dragan Jashoviqi, L96 dhe një oficer policor Momçillo Shparavallo shkuan në sekretariatin e brendshëm në Prishtinë dhe pastaj në Llapushnik për të kryer një hetim në terren.[935] Në bazë të udhëzimeve të L96-ës ata udhëtuan në rrugën Prishtinë-Pejë në drejtim të Pejës dhe afërsisht një kilometër pas Komoranit u kthyen majtas. Ata erdhën në një shtëpi fshatare dhe hynë në oborr. Ky përshrim përputhet me vendndodhjen e pretenduar të oborrit të përdorur si kamp-burg. Dragan Jashoviqi hyri në katin e sipërm të ndërtesës kryesore ku ishin dy dhoma. Në garazh L96 gjeti një dyshek sfungjeri dhe shpjegoi se ai kishte fjetur atje. L96 gjithashtu shpjegoi se ai ishte mbajtur në një dhomë që ishte fllanik. Dragan Jashoviqi pa plisa të bardhë dhe rripa mesi para ahurit.[936] L96 konfirmoi se ai e vizitoi oborrin ku ndodhej kamp-burgu me Dragan Jashoviqin pasi kishte ikur dhe se ai njohu dyert prej metali në ngjyrë kafe të oborrit dhe përshkroi vendet që kishte parë gjatë burgimit të tij.[937]

270. Ole Lehtinen, hetues në Zyrën e Prokurores, dëshmoi se dëshmitarët i kishin treguar vendndodhjen e kamp-burgut në të cilin ishin mbajtur në Llapushnik dhe se ai e kishte vizituar vendin disa herë, herën e fundit në verën dhe vjeshtën e vitit 2003.[938] Ai paraqiti fotografi të ndërtimeve dhe hapësirave të ndryshme në këtë vend.[939] Pastaj këto fotografi iu treguan dëshmitarëve të cilët dëshmuan për burgimin në Llapushnik. Ivan Bakraçi identifikoi dhomën

[931] Dragan Jashoviq, T 5256.
[932] Dragan Jashoviq, T 5264-5271.
[933] *Shih më sipër*, paragrafin 27.
[934] Dragan Jashoviq, T 5279; 5284.
[935] Dragan Jashoviq, T 5285-5286.
[936] Dragan Jashoviq, T 5291-5298.
[937] L96, T 2391-2393.
[938] Ole Lehtinen, T 449; 479.

kryesore në ndërtesën kryesore, fllanikun dhe nevojtoren;[940] Vojko Bakraçi identifikoi fllanikun ku u çuan ai me të birin;[941] L06 identifikoi fllanikun ku ishte mbajtur ai, pusin, nevojtoren dhe ahurin ku ishte rrahur;[942] L10 identifikoi fllanikun ku ishte mbajtur dhe vendin ku zbrazte kovën;[943] L96 identifikoi dhomën në katin e sipërm të shtëpisë si dhomë ku ai ishte mbajtur;[944] L04 identifikoi ahurin dhe vende të tjera që kishte parë gjatë burgimit si edhe shtabin e UÇK-së në një oborr tjetër përtej rrugicës;[945] L07 identifikoi dhomën në ndërtesën kryesore ku kishte fjetur, dhomën ku pa individët të cilët i përshkroi si komandant Çeliku dhe Shukri Buja, oborrin, ndërtesën ku ishte mbajtur dhe kuzhinën;[946] L12 identifikoi portat e oborrit.[947]

271. Disa dëshmitarëve të cilët dëshmuan për burgimin e tyre në Llapushnik, iu treguan vizatime ose Ivan Bakraçit një fotografi e oborrit të burgut në Llapushnik. Këto vizatime u ishin treguar dëshmitarëve më parë dhe secili prej tyre kishte identifikuar dhe shënuar vendet e veçanta ku ishte mbajtur.[948] Të gjithë dëshmitarët konfirmuan se ata e kishin njohur vendin dhe se ata vetë i kishin bërë shënimet në vizatime. Gjithashtu Ivan Bakraçi, Vojko Bakraçi dhe L10 kishin vizatuar vendndodhje të të burgosurve të tjerë në të njëjtën dhomë me ta dhe konfirmuan vërtetësinë e këtyre dokumenteve.[949]

272. Në dëshmitë e disa dëshmitarëve ka mospërputhje. Për shembull, L10 dëshmoi se në ditën e rrëmbimit të tij, ai fillimisht u çua në Kleçkë dhe u mbajt atje afërsisht një orë para se të çohej në Llapushnik,[950] kurse L06 i cili u rrëmbye bashkë me L10-ën, dëshmoi se ai ishte çuar drejt në Llapushnik.[951] L06 dëshmoi se grupit të të burgosurve të cilët u liruan në malet e Berishës iu tha të shkonin në Kishnarekë,[952] kurse L10 dëshmoi se atyre iu tha të shkonin teposhtë, por në vend të bënin këtë ata vendosën të shkonin në fshatin Kishnarekë.[953] Më tej L04 dëshmoi se në ditën e

---

[939] Prova Materiale P5; Prova Materiale P6; Ole Lehtinen, T 466-48.
[940] Ivan Bakraç, T 1426-1427 re Ndërtesa A1 në Provën Materiale P6, T 1443-1447 re Ndërtesa A5, T 1467-1471 re U008-3672.
[941] Vojko Bakraç, T 1326-1329.
[942] L06, T 1038-1039; Provat Materiale P5 dhe P6.
[943] L10; T 2927-2932; Prova Materiale P6.
[944] L96; T 2315-2316.
[945] L04; T 1127-1130; Prova Materiale P5; Prova Materiale P6.
[946] L07; T 800, 803.
[947] L12, T 1815.
[948] Ivan Bakraç, T 1412-1416; 1442-1443, Prova Materiale P79; L06, T 1035-1037; Prova Materiale P74; L10, T 2923-2925, Prova Materiale P123; L96, T 2353-2359; Prova Materiale P100, L07, T 798-799; 864-866, Prova Materiale P68.
[949] Ivan Bakraç, T 1443-1447, Prova Materiale P82; Vojko Bakraç, T 1317-1318, Prova Materiale P78; L10, T 2925-2927, Prova Materiale P124.
[950] L10, T 2909, 2913-2915.
[951] L06, T 990.
[952] L06, T 1028-103.
[953] L10, T 2964.

fundit të burgimit një rojë i quajtur Murrizi i liroi të burgosurit në ahur nga zinxhirët dhe më vonë kur ata iu ngjitën maleve të Berishës, Murrizi liroi dhjetë prej tyre,[954] kurse L12, i cili u rrëmbye bashkë me L04-ën si edhe dëshmitarë të tjerë të mbajtur në kamp dëshmuan se ishte Shala ai që i nxori nga kampi dhe i cili i liroi më vonë në livadh.[955] Ndërsa disa dëshmitarë dëshmuan se dy rojat, Shala dhe Murrizi, i çuan ata në malet e Berishës ditën e fundit të burgimit të tyre dhe ishin atje me të burgosurit,[956] L96 dhe L10 dëshmuan se atje ishte dhe një ushtar i tretë.[957] Megjithëse dëshmitë e Vojko dhe Ivan Bakraçit janë pak a shumë të njëjta, ato zbulojnë disa mospërputhje në lidhje me rrethanat e daljes së Ivan Bakraçit nga fllaniku dhe transferimit të tij dhe të atit në një dhomë në ndërtesën kryesore, si edhe në lidhje me organizatën ndërkombëtare te e cila u liruan.[958] Këto mospërputhje nuk kanë të bëjnë me elementë të rëndësishëm faktualë dhe rrethanat e rrëmbimit dhe mbajtjes së çdo dëshmitari në kamp-burg. Gjithashtu si pasojë e kohës që ka kaluar midis ngjarjeve të përshkruara dhe dëshmive të dëshmitarëve para Tribunalit, mospërputhje të tilla nuk janë të habitshme apo të pazakonta.

273. Gjithsesi, Dhoma ka mendimin se historitë e dëshmitarëve konfirmojnë se secili prej këtyre dëshmitarëve ishte çuar në kamp-burgun e administruar prej UÇK-së ose ishte mbajtur atje. Dëshmitarët u rrëmbyen në rrethana të ngjashme; nga rruga[959] ose nga shtëpitë e tyre[960] prej ushtarëve të armatosur me uniforma të zeza ose kamuflimi,[961] me maska të zeza[962] ose me shenja të UÇK-së.[963] Disa prej këtyre ushtarëve u identifikuan si Ali/Alush Gashi,[964] Ramadan Behluli,[965] Shukri Buja,[966] Rrahman Tafa,[967] Sulë Qeriqi dhe Ali Ramadani dhe të gjithë ishin ushtarë të UÇK-së.[968] Dëshmitarëve ua mbulonin sytë, i futnin në makinë, në disa raste në vendbagazh, dhe i çonin në një oborr shtëpie fshati.[969] Atje një individ i përmendur si Shala ua hiqte mbulesën e syve dhe i çonte në dhomën ku u mbajtën.[970]

[954] L04, 1192-1195.
[955] L12, T 1815-1818. *Shih* edhe L10, T 2963, L96, T 2375-2377.
[956] L06, T 1025, 1028; L04, T 1194-1195; L12, T 1813-1816.
[957] L96, T 2365; L10, T 2962-2963.
[958] *Shih* Vojko Bakraç, T 1334-1351; Ivan Bakraç, T 1458-1464, 1471-1474.
[959] L06, T 977; L10, T 2907-2909; Vojko Bakraç, T 1286-1290; Ivan Bakraç, T 1395-1397; L07, T 774-775.
[960] L04, T 1110-1113; L12, T 1788; L96, T 2282-2285.
[961] L06, T 983, 985; L04, T 1110-1113; L12, T 1788-1792; L07, T 781; L96, T 2283-2285.
[962] L06, T 979; L10, T 2907-2909; L12, T 1788-1792.
[963] L10, T 2907-2909; L04, T 1110-1113; L96, T 2283-2285.
[964] L06, T 984; L04, T 1111.
[965] L06, T 984; L12, T 1790-1792.
[966] L04, T 1115-1118; L12, T 1789.
[967] L04, T 1112; 1122.
[968] L12, T 1788-1791.
[969] L06, T 990; L10, 2910-2911; 2913-2916; L04, T 1123; L12, T 1788-1791, 1797-1798; Vojko Bakraç, T 1304-1306; Ivan Bakraç, T 1410-1411; L07, T 778-781, 846; L96, T 2285-2288.

274. Dëshmitarët dhanë përshkrime të përputhshme të dy dhomave kryesore ku u mbajtën të burgosurit dhe të krejt oborrit të shtëpisë në fshat. L06, L10, Vojko dhe Ivan Bakraçi, dhe L96 përshkruan fllanikun ku ata u mbajtën si dhomë të vogël dy me tre ose tre me katër metra me dysheme prej betoni, një dritare të vogël dhe një kovë që përdorej për nevoja personale,[971] me kashtë ose sanë mbi dysheme.[972] L04 dhe L10 përshkruan ahurin ku u mbajtën si dhomë ku u mbajtën edhe të tjerë e të tërë ishin të lidhur me zinxhirë.[973] Vojko Bakraçi, Ivan Bakraçi dhe L96 përshkruan portat prej metali ngjyrë kafe të oborrit,[974] përshkrim që përputhet me tregimin e L84-ës.[975]

275. Gjithashtu shumë dëshmitarë identifikuan dëshmitarë të tjerë të cilët u mbajtën me ta ose individë të cilët ishin mbajtur në të njëjtën dhomë me ta në të njëjtën kohë. L06 pa L10-ën dhe L07-ën të burgosur në fllanik.[976] L10 pa L06-ën dhe L96-ën në fllanik.[977] L07 pa L06-ën në të njëjtën dhomë[978] dhe L96 pa L06-ën dhe L10-ën në fllanik.[979] Të gjithë dëshmitarët ishin mbajtur atje me një numër individësh,[980] megjithëse kujtesa mbi numrin e saktë ndryshonte, duke përfshirë Ademin nga Godanci,[981] Lutfiun (Luta) nga Bregu i Zi[982] dhe Hyzriun nga Belinca.[983] Më tej L04 dhe L12 përshkruan ahurin ku u mbajtën si një dhomë ku mbaheshin edhe të tjerë, të gjithë të lidhur me zinxhirë.[984] L04 dhe L12 dëshmuan se ata u mbajtën bashkë me, ndër të tjerë, Shefqet Ramadanin (Shyqja) nga Godanci,[985] Elmi Qerkinin nga Carraleva,[986] Milaim Kamberin nga Reçaku,[987] Hetën nga Petrova[988] dhe Xheladin (Xhela) Halimin nga Petrova.[989]

---

[970] L10, T 993-994; L04, T 1124-1125; L12, T 1799; L96, T 2294.
[971] L06, T 990-993, 995-997; L10, T 2918-2921; Vojko Bakraç, T 1329; Ivan Bakraç, T 1443-1444; L96, T 2333.
[972] Vojko Bakraç, T 1329; Ivan Bakraç, T 1443-1444; L96, T 2333.
[973] L04, T 1140-1141; L12, T 1802-1803.
[974] Vojko Bakraç, T 1304-1306; Ivan Bakraç, T 1412-1416; L96, T 2290-2294.
[975] Prova Materiale P197, paragrafi 30.
[976] L06, T 1039-1045.
[977] L10, T 2923-2925.
[978] L07, T 822.
[979] L96, T 2411; 2413.
[980] Vojko Bakraç, T 1311-1314; Ivan Bakraç, T 1443-1447.
[981] L06, T 999-1001; L10, T 2923-2925; L07 (vetëm në lidhje me Ademin nga Godanci), T 821-828; L96, T 2346-2347, 2411, 2413.
[982] L06, T 1039-1045; L10, T 2923-2925; L07, T 817, 821-828; L96,T 2409, 2415.
[983] L10, T 2923-2925.
[984] L04, T 1140-1141; L12, T 1802-1803.
[985] L04, T 1131-1136, 1139; L12, T 1820-1823.
[986] L04, T 1131-1136, L12, T 1820-1823.
[987] L04, T 1136-1138; L12, T 1820-1823.
[988] L04, T 1136-1138; L12, T 1820-1823.
[989] L04, T 1136-1138; L12, T 1820-1823.

276. Dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve përputhen në lidhje me praninë e rojave në oborrin shtëpiak. Të gjithë dëshmitarët dëshmuan se rojat në burg ishin Shala ose Shala dhe Murrizi,[990] megjithëse disa dëshmitarë panë edhe njerëz të tjerë me uniformë në kamp, gjegjësisht Tamulin,[991] Çerçizin,[992] Avdullahun,[993] Salihin dhe Hoxhën[994] dhe Dëshmitarin L64.[995]

277. Dhoma nënvizon se dëshmia e Shukri Bujës e shtjelluar në hollësi gjetiu në këtë vendim,[996]sugjeron se L07 u mbajt në shtëpinë e Ymer Alushanit me pseudonimin "Vogëlushi" në Llapushnik. Mirëpo duke marrë parasysh faktin se L07 dha një përshkrim të hollësishëm të kamp-burgut, identifikoi fotografitë e kamp-burgut, se ai u pa atje nga L06 dhe se ai vetë pa disa të burgosur atje, midis tyre edhe L06-ën, Dhoma nuk mund t'a pranojë dëshminë e Shukri Bujës në lidhje me këtë dhe gjykon se në fakt L07 u mbajt në të njëjtin kamp-burg si dëshmitarët e tjerë.

278. Së fundi të gjithë dëshmitarët treguan histori thelbësisht të ngjashme lidhur me rrethanat e lirimit të tyre. Duket se më 25 ose 26 korrik 1998[997] pati luftime në afërsi të oborrit të burgut,[998] Shala dhe Murrizi hapën dyert e të tëra dhomave dhe kthinave të atij oborri dhe i urdhëruan të burgosurit të dilnin në oborr, pastaj i detyruan të ecnin në rresht për në malet e Berishës,[999] ku ata u ndalën në një lëndinë pranë një druri qershie[1000] afërsisht një orë. Në atë vend u lirua një grup prej afërsisht 10 individësh dhe ata shkuan në Kishnarekë.[1001]

279. Bazuar në sa më sipër, Dhoma është e bindur dhe nxjerr përfundimin se midis atyre që u mbajtën në kamp-burgun e administruar nga UÇK-ja, ishin këta individë: Dëshmitari L06 nga 13 ose 14 qershor 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998; Dëshmitari L10 nga 13 ose 14 qershor 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998; Dëshmitari L04, nga 28 qershor deri më 25 ose 26 korrik 1998; Dëshmitari L12 nga 28 qershor deri më 25 ose 26 korrik 1998; Vojko Bakraç, nga 29 qershor 1998 deri më 6 korrik 1998; Ivan Bakraç nga 29 qershor deri më 6 korrik 1998; Dëshmitari L07, për tri ditë në korrik 1998; dhe Dëshmitari L96 nga 18 deri më 25 ose 26 korrik 1998. Dhoma është e

[990] L06, T 997-998; 1001, 1101-1102; L10, T 2918-2922; L04, T 1175-1179, 1192-1194; L12, T 1800-1802; Vojko Bakraç, T 1330-1332; Ivan Bakraç, T 1458-1460; L07, T 795-798; L96, T 2302-2303, 2309.
[991] L04, T 1175-1176.
[992] L04, T 1172-1173; L96, T 2488. *Shih* edhe L10, T 2917, 2922.
[993] L96, T 2309.
[994] L96, T 2488.
[995] Prova Materiale P 197, paragrafi 35.
[996] *Shih më poshtë*, paragrafët 456-457.
[997] *Shih më sipër*, paragrafët 78-81.
[998] L06, T 1025; L10, T 2960.
[999] L06, T 1025-1028; L10, T 2960-2961; L04, T 1192-1194. L12, T 1813-1815; L96, T 2347-2349.
[1000] L10, T 2960-2966; L96, T 2372-2374.
[1001] L06, T 1028-1030; L10, T 2963-2964; L04, T 1194-1198; L12, T 1815-1818.

bindur se individët e lartpërmendur ishin civilë.[1002] Rrethanat e burgimit të viktimave të përmendur në Aktakuzë shqyrtohen më vonë në këtë vendim.[1003]

280. Gjithashtu, duke marrë parasysh ndikimin tërësor të këtyre dëshmive Dhoma është e bindur se kamp-burgu ku u mbajtën individët e lartpërmendur ndodhej në fshatin Llapushnik. Përshkrimet prej disa dëshmitarëve të largësisë dhe rrugës nga vendi ku u rrëmbyen deri në vendin ku u burgosën, ose tregojnë Llapushnikun si vendndodhjen e këtij kamp-burgu, ose përputhen me këtë përfundim. Makina me të cilën u mor L04, u kthye në të majtë nga Pjetërshtica dhe udhëtoi afërsisht një orë para se të kthehej sërish majtas dhe të arrinte në destinacion.[1004] L96 u mor nga fshati i tij në drejtim të Shtimes, Kroimirit dhe Shalës.[1005] Po të shqyrtohet harta e zonës këto histori tregojnë se dëshmitarët mund të jenë çuar në Llapushnik.[1006] Kur u liruan, L04-ës, L06-ës, L10-ës dhe L12-ës iu tha prej rojave të UÇK-së të shkonin në Kishnarekë[1007] ose shkuan atje, që është një fshat fqinj me Llapushnikun.[1008] Më tej dëshmitarë si L12 dhe L07 si dhe L96 dëshmuan se ata ishin në gjendje të njihnin terrenin rreth kamp-burgut prej përvojave të tyre të mëparshme me Llapushnikun,[1009] ose malet ku ata u çuan ditën e tyre të fundit të burgimit.[1010] Të tjerët ishin në gjendje të identifikonin kamp-burgun ku ishin mbajtur në bazë të çfarë panë pas lirimit. Ishin edhe dëshmitarë të cilët u mbështetën në informacionin e të afërmve të tyre, mbi të cilin Dhoma nuk mbështetet për këtë pikë.[1011]

281. Dhoma mendon se faktorë të tjerë me rëndësi janë përputhshmëria dhe hollësitë e përshkrimit prej dëshmitarëve të oborrit shtëpiak fshatar ku ata ishin mbajtur,[1012] përshkrime që përputhen qartësisht me oborrin shtëpiak fshatar të pretenduar prej Prokurorisë. Gjithashtu, thuajse të gjithë dëshmitarët që dëshmuan për mbajtjen e tyre në atë oborr shtëpiak fshatar njohën dhe identifikuan fotografitë e oborrit shtëpiak fshatar të pretenduar, të paraqitura prej Ole Lehtinen-it.[1013]

[1002] *Shih* L06, T 983; L10, T 2909; L12, T 1786.
[1003] *Shih më poshtë*, paragrafët 319-446.
[1004] L04, T 1123-1124.
[1005] L96, T 2290-2294.
[1006] *Shih* Prova Materiale P1, Harta 5.
[1007] L04, T 1196-1198; L06, T 1028-1030; L10, T 2964-2965; L12, T 1818.
[1008] *Shih* Prova Materiale P1, Harta 5.
[1009] L06, T 1068; L04, T 1272-1273; L12, T 1815-1816.
[1010] L12, T 1815-1816; L07, T 790-791, 847, 849; L96, T 2304, 2319.
[1011] *Shih* L10, T 2960-2966.
[1012] *Shih më sipër*, paragrafin 274.
[1013] *Shih më sipër*, paragrafin 270.

282. Mbi këtë bazë, Dhoma është e bindur dhe nxjerr përfundimin se nga mesi i qershorit 1998 deri më së shumti 25 ose 26 korrik 1998 në fshatin Llapushnik në jug të rrugës Prishtinë-Pejë ekzistonte një kamp-burg i drejtuar prej UÇK-së. Dhoma pranon se oborri i vizatuar në Provat Materiale P5 dhe P6 me ndërtesa dhe ngrehina të shënuara nga A1 deri në A9 ishte vendndodhja e kamp-burgut dhe vendi i mbajtjes ose burgimit prej UÇK-së të Dëshmitarit L06, Dëshmitarit L10, Dëshmitarit L04, Dëshmitarit L12, Vojko dhe Ivan Bakraçit, Dëshmitarit L07, Dëshmitarit L96 dhe shumë të tjerëve.

2. Krimet në kamp-burgun e Llapushnikut ose përreth tij (Pikat 4, 6 dhe 8)

283. Prokuroria akuzon se afërsisht prej majit 1998 deri afërsisht më 26 korrik 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e Fatmir Limajt dhe Isak Musliut i mbajtën të burgosurit në kamp-burgun e Llapushnikut në kushte të ashpra dhe çnjerëzore dhe i nënshtruan ata rregullisht ndaj sulmeve fizike dhe psikologjike, duke përfshirë tortura dhe rrahje. Prokuroria argumenton se të tre të Akuzuarit morën pjesë në mbajtjen dhe zbatimin e kushteve çnjerëzore në kamp-burg, që përfshinin ushqim dhe kujdes mjekësor të pamjaftueshëm dhe morën pjesë ose ndihmuan apo inkurajuan torturat dhe rrahjet e të burgosurve.[1014] Më parë Dhoma gjykoi se Neni 5 nuk ishte i zbatueshëm për këtë rast, dhe se nuk ishte provuar vepra penale e trajtimit mizor bazuar në kapjen e paligjshme, marrjen në pyetje dhe transferimin e dhunshëm të individëve (Pika 2). Rrjedhimisht akuzat e lartpërmendura tani mbështetin vetëm një pikë për torturat dhe një pikë për trajtimin mizor si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës (përkatësisht Pikat 4 dhe 6). Gjithashtu Prokuroria akuzan se prej një date afërsisht në qershor 1998 deri afërsisht më 26 korrik 1998, tre të Akuzuarit kryen, ose ndryshe ndihmuan dhe inkurajuan krimin e vrasjes së katërmbëdhjetë të burgosurve në kamp-burgun e Llapushnikut ose përreth tij.[1015] Tani këto akuza mbështetin një pikë për krimin e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës (Pika 8).

284. Në pjesë të mëparshme të këtij Aktgjykimi Dhoma ka provuar se për periudha të ndryshme kohore një numër individësh janë mbajtur në një oborr shtëpiak që ndodhet në Llapushnik, i përdorur si kamp-burg deri më 25 ose 26 korrik 1998. Të burgosurit u mbajtën në vende të ndryshme në kamp-burg, gjegjësisht në fllanik, në ahur dhe në disa dhoma në shtëpinë kryesore dhe në garazh.

[1014] Aktakuzë, paragrafët 25-26.
[1015] Aktakuzë, paragrafët 29-32.

(a) Kushtet e burgimit

285. Kushtet e burgimit në ahur ishin shumë të vështira sipas dëshmitarëve të cilët u mbajtën atje. Dy ish-të burgosur dëshmuan se dhoma, e cila ishte e nxehtë[1016] kishte vetëm një dritare të vogël, dyshemeja ishte prej betoni dhe mbi dysheme kishte pleh bagëtish dhe gjak.[1017] L04 dëshmoi se të burgosurit nuk lejoheshin të shkonin në nevojtoren jashtë dhe ata që ishin të lidhur ose të prangosur me zinxhirë, në disa raste me të burgosur të tjerë, duhej të jashtqitnin në rrobat e tyre ku uleshin dhe flinin.[1018] Nuk kishte mundësi për t'u larë.[1019] Ajri dhe kundërmimi u përshkruan mbytës.[1020] Në gjyq L12 theksoi se kishte raste kur ata hanin një herë në disa ditë. Gjithsesi atyre iu jepej ujë në shishe plastike.[1021]

286. Të burgosurve të mbajtur në fllanik nuk iu ofrua trajtim më i mirë. Disa dëshmitarë dëshmuan se deri në 13 apo 15 të burgosur,[1022] disa të lidhur[1023] ishin tërë ditën në fllanik i cili kishte përmasa 2 me 3 ose 4 metra dhe kishte tavan të ulët.[1024] Ivan Bakraçi shpjegoi se të burgosurit nuk lejoheshin të flisnin me shoshoqin.[1025] Ish-të burgosur dëshmuan se dhoma kishte vetëm një dritare të vogël dhe dera prej hekuri ishte gjithmonë e mbyllur.[1026] Dëshmitarët dëshmuan se në fillim, dhoma ishte e ftohtë dhe e lagët për shkak të një vrime në tavan, por vetëm pak ditë më vonë u bë tmerrësisht e nxehtë, jo vetëm sepse ishte verë po edhe pse nuk kishte aspak ajrim;[1027] temperatura dhe kundërmimi u bënë të padurueshme duke marrë parasysh se të burgosurit ishin të detyruar të flinin, kryenin nevojat personale dhe hanin në atë dhomë.[1028] L96 dëshmoi se nuk kishte hapësirë të mjaftueshme për të shtrirë gjymtyrët. Në çdo tri apo katër ditë Shala e hapte derën dhe i linte të burgosurit të ecnin nga pak në mbrëmje.[1029] Kjo u konfirmua prej L06-ës[1030] dhe

[1016] L12, T 1802-1805.
[1017] L12, T 1802-1803.
[1018] L04, T 1140-1141.
[1019] L04, T 1140-1141.
[1020] L64, T 4901-4902.
[1021] L12, T 1805.
[1022] L07, T 821; Vojko Bakraç, T 1311-1318; Prova Materiale P78; L06, T 999; Prova Materiale P99.
[1023] L10, T 2918-2921. L10 dëshmoi se disa të burgosur ishin të lidhur me zinxhirë me njëri-tjetrin dhe se ai vetë ishte lidhur me zinxhirë me Fehmi Xhemën. Sipas dëshmisë së L10-ës, Emin Emini ishte lidhur te dritarja. L06 dëshmoi se dy dëshmitarë ishin lidhur prej duarsh me pranga dhe dëshmoi se ai vetë u lidh me 10kg zinxhirë dhe nuk mund të lëvizte, T 993-994.
[1024] L96, T 2333; Ivan Bakraç, T 1443-1447 (sipas tij dhoma ishte rreth dy me katër metra); Vojko Bakraç, T 1311-1314; L07, T 829; L10, T 2918-2921; L06, T 995-996.
[1025] Ivan Bakraç, T 1447-1449; Vojko Bakraç dëshmoi se të burgosurit flisnin vetëm kur ishte e nevojshme dhe atëherë ata pëshpërisnin, T 1311-1314. Sipas dëshmisë se L06-ës, të burgosurit nuk guxonin të flisnin me njëri-tjetrin sepse Shala i kishte paralajmëruar ata se do të ndëshkoheshin po të flisnin, T 999.
[1026] L10, T 2918-2921; L06, T 995-997.
[1027] Ivan Bakraç, T 1450-1455; L10 T 2918-2921; L07, T 829; L06, T 995.
[1028] L96, T 2333, 2339; Ivan Bakraç, T 1450-1455; L10, T 2918-2921; L06, T 995-997.
[1029] L96, T 2339.
[1030] L06, T 997-998.

L07-ës të cilët shpjeguan më tej se dritarja mbahej hapur tërë kohën dhe dera hapej herë pas here duke lënë pak ajër të freskët në dhomë.[1031] Gjithashtu dëshmitarët dëshmuan se flinin mbi një qilim të vogël mbi dysheme i cili fillimisht ishte mjaft i lagët meqë atyre nuk u ishte dhënë ndonjë shtrat, megjithëse dikur sollën ca sanë.[1032] Ish-të burgosurit theksuan se asnjë prej të burgosurve në fllanik nuk lejohej të shkonte në nevojtoren jashtë dhe se si pasojë ata ishin të shtrënguar të përdornin një kovë pas derës,[1033] e cila nuk zbrazej rregullisht. L06 dëshmoi se gjatë dy javëve të para të burgimit të tij, nuk kishte ende kovë dhe të burgosurit duhej të jashtqitnin në dysheme pas derës.[1034] Ivan Bakraçi dëshmoi së të burgosurit ishin të kufizuar në një vend të tillë 24 orë në ditë pa mundur të largoheshin dhe pa asnjë mundësi për t'u larë ose mjet pastrimi.[1035] Të burgosurit në fllanik dëshmuan se merrnin ushqim, supë ose bukë një herë ose dy herë në ditë prej rojeve të përmendur si Shala dhe Murrizi, megjithëse kishte raste kur ata nuk merrnin ushqim çdo ditë.[1036] Sipas Ivan Bakraçit ushqimi për të burgosurit ishte më shumë ushqim për bagëtinë sesa për njerëzit.[1037] Mirëpo L07 kishte mendimin se për kohën që ai ishte atje, të burgosurit kishin ushqim të mjaftueshëm dhe po ashtu si L06 ai deklaroi se kishte ujë të mjaftueshëm.[1038] Përgjithësisht, L07 dëshmoi se të burgosurit jetonin në "kushte mjaft të vështira".[1039] Ivan Bakraçi dëshmoi se të burgosurit merrnin cigare, në fakt më shumë se nevojiteshin dhe lejoheshin të pinin duhan në dhomë.[1040] Nuk ofrohej shërbim mjekësor me gjithë faktin se disa të burgosur kishin pësuar lëndime të rënda kur ishin marrë në burgimin e UÇK-së ose në kamp-burg kur u rrahën nga anëtarë të UÇK-së.[1041] Duhet theksuar se në fshat funksiononte një klinikë nga fundi i majit deri më 25 ose 26 korrik 1998.[1042]

287. L96, L07, Vojko dhe Ivan Bakraçi dëshmuan në lidhje me kushtet e burgimit në shtëpinë kryesore të oborrit megjithëse duket se ata ishin mbajtur në vende të ndryshme në shtëpi dhe në rrethana të ndryshme.[1043] L96 dëshmoi se pas ardhjes së tij në kamp-burgun e Llapushnikut, ai u çua në një dhomë ku ishte mbyllur me çelës bashkë me të burgosur të tjerë. Dera hapej kryesisht prej njerëzve të cilët ai i përmendi si Shala dhe Murrizi.[1044] L96 dëshmoi se të burgosurit kishin ujë

[1031] L07, T 829; 832.
[1032] L07, T 821; 828; Ivan Bakraç, T 1450-1455; Vojko Bakraç, T 1329; L10, T 2918-2921.
[1033] Provat Materiale P82, P99 dhe P126; L10, T 2918-2921; 2931-2932; Ivan Bakraç, T 1443-1447; Vojko Bakraç, T 1329; L96, T 2333; L07, T 830-831.
[1034] L06, T 996-997.
[1035] Ivan Bakraç, T 1450-1455.
[1036] L96, T 2338-2340; L10, T 2918-2921.
[1037] Ivan Bakraç, T 1450-1455.
[1038] L07, T 829; L06, T 997.
[1039] L07, T 831.
[1040] Ivan Bakraç, T 1450-1455.
[1041] Ivan Bakraç, T 1450-1455; L06, T 997; L10, T 2918-2921; L07, T 825-828.
[1042] Dr Zeqir Gashi, T 5604-5606.
[1043] *Shih më sipër*, paragrafët 257-258; 260-261; 263-266.
[1044] L96, T 2309.

sepse në dhomë ishte një çezmë dhe në dhomë nuk kishte orendi veç një qilimi dhe disa dyshekëve prej sfungjeri.[1045] Gjithashtu sipas dëshmisë së L96-ës, të burgosurit merrnin një farë ushqimi, kryesisht mbeturinat e ushqimit të njerëzve të tjerë. Ata lejoheshin të shkonin në nevojtoren jashtë në oborr por vetëm të shoqëruar dhe me lejen e personit të cilin ai e përmendi si Shala.[1046]

288. Prej dëshmive të dhëna në këtë gjyq është e dukshme dhe Dhoma gjykon se kushtet e burgimit në fllanik dhe në ahur ishin të tmerrshme. Dhoma ka mendimin se prej dëshmive del qartë se ushqimi dhe uji nuk jepeshin rregullisht dhe nuk kishte mundësi për larje dhe pastrim. Ahuri dhe fllaniku nuk ishin të ajrosur sa duhet dhe kishte raste kur ishin të tejmbushur, në veçanti fllaniku. Edhe pse të burgosurit lejoheshin të dilnin prej fllanikut ndonjëherë për të marrë ajër të freskët, gjendja dhe kushtet në dhomë ishin të mjerueshme. Nuk kishte pajisje për fjetje as në fllanik e as në ahur, gjë që përkeqësoj me tejmbushjen veçanërisht në fllanik. Të burgosurit në ahur lidheshin me zinxhir pas murit ose me të burgosur të tjerë. Nuk ofrohej kurrfarë kujdesi mjekësor, megjithëse ekzistonte.[1047]

289. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të tre të Akuzuarve mbi sa më lart, Dhoma gjykon se kushtet e mjerueshme të burgimit në fllanik dhe në ahur në kamp-burgun e Llapushnikut, ishin të tilla që shkaktonin vuajtje të rënda mendore dhe fizike të të burgosurve dhe përbënin sulm të rëndë kundër dinjitetit të të burgosurve. Gjithashtu, duke marrë parasysh periudhën e zgjatur kohore gjatë së cilës këto kushte u mbajtën pa u përmirësuar, Dhoma bindet se ato ishin imponuar qëllimisht. Dhoma gjykon se kushtet e burgimit në ahur ose fllanik përbëjnë veprën e akuzuar penale të trajtimit mizor (Pika 6). Duke u bazuar në dëshmitë ekzistuese të kufizuara, del se kushtet në shtëpinë kryesore nuk ishin të ngjashme me ato në ahur apo bodrum. Nuk ka prova të mjaftueshme që të tregojnë se burgimi në shtëpinë kryesore në vetvete përbënte veprën penale të trajtimit mizor.

(b) Trajtim mizor, torturë dhe vrasje

(i) Vojko dhe Ivan Bakraçi

290. Dhoma tashmë ka nxjerrë përfundimin se Vojko dhe Ivan Bakraçi u mbajtën nga UÇK-ja në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut nga 29 qershor 1998 deri më 6 korrik 1998.[1048]

[1045] L96, T 2301-2302.
[1046] L96, T 2302-2303.
[1047] Dr Zeqir Gashi, T 5604-5606.
[1048] *Shih më sipër*, paragrafin 279.

Rrjedhimisht Dhoma bindet se Vojko dhe Ivan Bakraç nuk merrnin pjesë aktive në luftime në atë kohë.

291. As Vojko dhe as Ivan Bakraçi nuk dëshmuan se ishin rrahur në kamp-burgun e Llapushnikut. Mirëpo të dy personat dëshmuan se kishin parë të burgosur të tjerë kur rriheshin nga ushtarët e UÇK-së përditë, kryesisht gjatë natës.[1049] Ivan Bakraçi dëshmoi se të burgosurit zgjoheshin me llampa dore dhe keqtrajtoheshin në ndonjë rast, disa herë në ditë.[1050] Vojko Bakraçi dëshmoi se një i bashkëburgosur në fllanik, Stamen Genov, u nxor jashtë bodrumit dhe e kthyen gjysëm ore më vonë të rrahur.[1051] Ivan Bakraçi dëshmoi se Shala ishte i pranishëm në disa rrahje.[1052] Vojko dhe Ivan Bakraç treguan veçanërisht sesi një natë Stamen Genov iu lut të burgosurve të tjerë t'a mbytnin sepse nuk mund t'i duronte më gjatë rrahjet. Ivan Bakraç përshkroi me fjalë gjendjen kur asnjë prej të burgosurve nuk mund t'i përgjigjej përgjërimeve të Stamen Genovit dhe sa e tmerrshme ishte t'a shihje atë kur vuante në atë gjendje.[1053] Ivan Bakraç dëshmoi se ishte i frikësuar si i ati duke mos ditur nëse në fund kapësit e tyre do t'i vrisnin apo do t'i lironin.[1054]

292. Prokuroria argumenton se fakti që Bakraçët u detyruan të shihnin rrahjet duke përfshirë në veçanti një gjoja ekzekutim[1055] si edhe kërcënimi i bërë ndaj Vojko Bakraçit se i biri mund të vritej,[1056] përbënte torturë e kryer me qëllim për të ndëshkuar, frikësuar apo diskriminuar viktimat.[1057]

293. Dhoma pranon se Bakraçët u cënuan personalisht duke parë rrahjen e të burgosurve dhe lëndimet e pësuara si edhe frika që secili prej tyre pati në ato rrethana, veçanërisht në momentet kur secili prej tyre pa tjetrin të cilin e largonin prej aty, duke e ditur mjaft mirë në atë kohë, me gjithë

[1049] Vojko Bakraç, T 1332-1334; Ivan Bakraç, T 1455-1458. *Shih* edhe, Provën Materiale P202.
[1050] Ivan Bakraç, T 1456.
[1051] Vojko Bakraç, T 1332.
[1052] Ivan Bakraç, T 1457.
[1053] Vojko Bakraç, T 1332-1333; Ivan Bakraç, T 1455-1458.
[1054] Ivan Bakraç, T 1455.
[1055] Vojko Bakraçi e përshkroi si "një situatë të pakëndëshme" faktin që ata u detyruan të shihnin rrahjen e katër ose pesë personave dhe një gjoja ekzekutim, si rezultat i të cilit njëri prej tyre nuk mund të qëndronte në këmbë. Sipas Vojko Bakraçit një person i armatosur me pistoletë ia dha armën një ushtari tjetër duke i thenë që t'i vriste të burgosurit. Ushtari u bind dhe ia vendosi të burgosurit pistoletën në ballë por arma nuk kishte plumba. Sipas dëshmisë së Vojko Bakraçit : "ata [njerëzit që u rrahën] po qanin, po lypnin mëshirë. Pastaj personi i parë e mori pistoletën, ia vuri në ballë të burgosurit tjetër dhe e shkrepi por ishte e zbrazët. Mendoj se ishte një lloj torture psikologjike." Vojko Bakraçi dëshmoi se pastaj iu tha se njerëzit që u rrahën konsideroheshin tradhtarë të popullit, T 1341-1342.
[1056] Vojko Bakraç shpjegoi më tej se një mbrëmje , kur ai dhe djali i tij dëgjuan të shtëna jashtë shtëpisë, një person i armatosur menjë pistoletë erdhi dhe i tha se ai mund t'a vriste djalin e tij, pas kësaj Vojko Bakraçi tha se ai ishte shokuar, "filloi të dridhej dhe […] ndoshta pati krizë nervore" T 1345.
[1057] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafët 418-419.

mbajtjen e tyre për një kohë të shkurtër në fllanik, fatin që i priste të burgosurit të cilët nxirreshin nga dhoma. Në përgjithësi të burgosurit dhe midis tyre edhe Bakraçët, ishin qartësisht të detyruar të jetonin me frikën e përhershme prej keqtrajtimit fizik, nëse jo vdekjes, dhe në një gjendje të vazhdueshme ankthi që bëhej më e rëndë kur ata shihnin zgjedhjen arbitrare të burgosurve që keqtrajtoheshin.

294. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në bazë të përvojës së tyre të caktuar, që sapo u përmend, Bakraçët patën vuajtje të rënda psikologjike dhe se kjo vuajtje u imponua qëllimisht prej kapësve të tyre. Gjithashtu, Dhoma tashmë ka nxjerrë përfundimin se kushtet e burgimit në fllanik në vetvete ishin të tilla që përbënin trajtim mizor.[1058] Rrjedhimisht duke marrë parasysh këto fakte është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6) në lidhje me Vojko dhe Ivan Bakraçin. Mirëpo Dhoma nuk mund të bindet se ka prova të mjaftueshme që provojnë se është shkaktuar vuajtje psikologjike aq e rëndë sa të provohet vepra penale e torturës. Për më tepër, nuk ka prova që tregojnë synimin konkret të kryesve kur ndodhën këto gjëra dhe prej dëshmive mund të nxirret më shumë se një përfundim. Rrjedhimisht, nuk është provuar elementi mendor konkret i torturës në lidhje me asnjë prej Bakraçëve. (Pika 4).

(ii) Dëshmitari L07

295. Ashtu siç u provua më lart, L07 u mbajt prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut për tri ditë në korrik 1998.[1059] Gjithashtu Dhoma është e bindur se L07 nuk merrte pjesë aktivisht në luftime gjatë burgimit të tij.

296. L07 dëshmoi se pasi arriti në kamp-burgun e Llapushnikut, dy ushtarë e çuan menjëherë në ahur.[1060] Më tej L07 shpjegoi se më vonë atë mbrëmje, ai u çua në katin e parë të shtëpisë së madhe.[1061] L07 dëshmoi se të nesërmen, një person me maskë erdhi në mes të natës dhe e urdhëroi të vishej.[1062] Pastaj L07 u nxor jashtë ku një njeri tjetër me uniformë ushtarake po priste pranë një automjeti.[1063] Pastaj të dy personat filluan t'a rrihnin,[1064] e shkelmuan në stomak[1065] dhe duke i

[1058] *Shih më sipër,* paragrafin 289.
[1059] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[1060] L07, T 790.
[1061] L07, T 808-809; 812; Prova Materiale P71, paragrafët 15-16.
[1062] L07, T 816-817.
[1063] L07, T 817.

mbajtur krahët, e shkelmuan në brinjë.[1066] L07 tregoi se i pranishëm ishte edhe një person që ai thotë se ishte Murrizi, i cili mbante një armë zjarri, por ai nuk ndërhyri.[1067] Më tej L07 u çua në fllanik,[1068] ku u mbajt për dy ditë.[1069] L07 dëshmoi se në atë dhomë tashmë ishin 12 njerëz.[1070] L07 tregoi se të burgosurit u keqtrajtuan fizikisht dy herë,[1071] kur rojat hynë në fllanik dhe i goditën me shuplaka të burgosurit[1072] përveç L07-ës, sepse roja të cilin ai e përmendi si "Shalë"[1073] ose "Shala",[1074] i ndaloi rojat e tjerë ta keqtrajtonte.[1075] L07 dëshmoi se të burgosurit u shanë ndërkohë që u goditën me shuplaka.[1076]

297. Duke lënë mënjanë për momentin përgjegjësinë penale të të tre të Akuzuarve, siç u shtjellua më herët, Dhoma ka nxjerrë përfundimin se kushtet e burgimit në fllanik ishin të tilla që përbëjnë trajtim mizor.[1077] Gjithashtu Dhoma pranon dëshminë e L07-ës se ai u rrah ashtu si tregoi gjatë burgimit në kamp-burgun e Llapushnikut. Rrjedhimisht në bazë të secilit prej këtyre keqtrajtimeve të L07-ës dhe kushteve të tij të burgimit, të marrë veç ose bashkë, Dhoma gjykon se në lidhje me L07-ën është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6). Nuk ka prova që tregojnë se L07 u rrah me një synim të caktuar ose se keqtrajtimi ishte aq i rëndë sa të përbënte veprën penale të torturës. Rrjedhimisht, Dhoma përfundon se në lidhje me L07-ën nuk janë provuar elementët e veprës penale të torturës (Pika 4).

(iii) Dëshmitari L10

298. Dhoma tashmë ka arritur në përfundimin se L10 u mbajt prej UÇK-së në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut për periudhën nga 13 ose 14 qershor 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998.[1078] Gjithashtu Dhoma është e bindur se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime gjatë asaj kohe.

[1064] L07, T 816-817; Prova Materiale P71, paragrafi 18. L07 deklaroi se rrahja ndodhi jashtë ndërtesës te shënuar me dhomat : "1" dhe "2" në Provën Materiale P68 dhe vazhdoi deri te pragu i ndërtesës shënuar "P", T 820.
[1065] L07, T 819.
[1066] L07, T 817.
[1067] L07, T 819.
[1068] L07, T 819-820.
[1069] L07, T 798-799; 821, 829; Provat Materiale P6-A5, P68, P71, paragrafët 19; 24.
[1070] L07, T 821.
[1071] L07, T 833.
[1072] L07, T 833.
[1073] L07, T 796.
[1074] L07, T 810.
[1075] L07, T 833.
[1076] L07, T 834.
[1077] *Shih më sipër,* paragrafin 289.
[1078] *Shih më sipër,* paragrafin 279.

299. L10 dëshmoi se pas ardhjes së tij në kamp-burgun e Llapushnikut, disa njerëz filluan ta shanin, bërtisnin "pse je këtu?" dhe ta rrihnin.[1079] L10 shpjegoi se më pas ai u çua në fllanik ku ia lidhën përsëri duart.[1080] L10 dëshmoi se pasi hyri brenda atij ia zgjidhën sytë dhe ushtarë të maskuar i kërkuan të tregonte emrat e spiunëve në fshatin e tij.[1081] L10 u përgjigj se nuk dinte, se ai vetë nuk ishte spiun dhe se nuk njihte ndonjë spiun.[1082] Më vonë gjatë dëshmisë së tij, kur u pyet nëse ishte rrahur pasi kishte mbërritur në kamp-burgun e Llapushnikut, L10 u përgjigj se ai ishte rrahur "herën e parë kur më nxorën nga makina dhe më futën brenda." L10 gjithashtu u pyet nëse ishte rrahur përsëri dhe përgjigjja ishte "njëri prej tyre më shkelmoi dy herë, po nuk më kujtohet saktësisht kush ishte. Ishte person i maskuar. Më pas ai më shkelmoi dy herë. Pas kësaj, jo më. Ata nuk më rrahën më."[1083] L10 dëshmoi se një herë kur ai zbrazi kovën që përdorej për nevoja personale, një rojë që ai tha se ishte Shala, i vuri armën te koka dhe i tha L10-ës të mos e ngrinte kokën se do të vritej.[1084] Gjithashtu L10 dëshmoi se kishte parë të burgosur të tjerë duke u rrahur.[1085] Më tej ai shpjegoi se gjatë burgimit të tij, individi të cilin ai e përmendi si Shala e kishte çuar atë dhe të burgosur të tjerë në një vend ku u detyruan të hapnin varre dhe varrosën kufomat e tre individëve, "të mbuluar me gjak, të mavijosur në fytyrë […] gjysma e kokës së tyre ishte e prerë."[1086] Sipas fjalëve të L10-ës, "ishte pamje e llahtarshme."[1087]

300. Dhoma tashmë ka arritur në përfundimin se kushtet në fllanik ishin të tilla që burgimi atje përbënte trajtim mizor.[1088] Dhoma pranon dëshminë e L10-ës të ravijëzuar më lart. Sipas kësaj dëshmie, ai u rrah dy herë në kamp-burgun e Llapushnikut prej rojave të UÇK-së megjithëse nuk ka prova për rrethanat konkrete ose për rrahësit. Ai gjithashtu u detyrua të varroste kufomat e të burgosurve të tjerë, të shpërfytyruara prej keqtrajtimit para vdekjes që sipas pikëpamjes së Dhomës i shtoi vuajtjet e L10-ës ashtu si dhe kërcënimet ndaj tij.

301. Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me L10-ën janë provuar elementët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6) mbi bazën e çdo keqtrajtimi fizik dhe psikologjik dhe kushteve të burgimit ushtruar mbi të, të marra veç ose bashkë.

[1079] L10, T 2916.
[1080] L10, T 2916.
[1081] L10, T 2916.
[1082] L10, T 2917.
[1083] L10, T 2935-2936.
[1084] L10, T 2920.
[1085] L10, T 2936-2937.
[1086] L10, T 2943-2944.
[1087] L10, T 2943-2946.
[1088] *Shih më sipër,* paragrafin 289.

302. Mirëpo dëshmia nuk është e qartë nëse rojet e UÇK-së që e pyetën L10-ën për spiunët në fshatin e tij ishin të njëjtët persona që e keqtrajtuan ose nëse marrja në pyetje ishte e lidhur me keqtrajtimin. Mbi këtë bazë, Dhoma nuk është në gjendje të nxjerrë përfundimin se rrahjet u bënë për një qëllim të caktuar. Rrjedhimisht nuk janë provuar elementët e veprës penale të torturës (Pika 4) në lidhje me L10-ën.

(iv) Dëshmitari L06

303. Dhoma tashmë ka arritur në përfundimin se L06 u mbajt prej UÇK-së në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut për periudhën nga 13 ose 14 qershor 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998.[1089] Si rrjedhojë Dhoma është gjithashtu e bindur se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime gjatë asaj kohe.

304. L06 dëshmoi se gjatë burgimit të tij ai i kishte patur duart të lidhura me një zinxhir 10kg, që e bënte të pamundur lëvizjen.[1090] L06 deklaroi se afërsisht një javë pas arrestimit të tij, një individ të cilin ai e përmendi si Shala, erdhi në fllanik dhe ia hoqi zinxhirët gjatë ditës.[1091] L06 dëshmoi se atë natë, Ali Gashi dhe Ramadan Behluli ia lidhën sytë, ia lidhën duart pas shpine dhe e çuan te plehu i bagëtive. Ata e pyetën pse u shiste dru serbëve dhe i kërkuan "të fliste për spiunët".[1092] Përsëri sipas dëshmisë së L06-ës, Ramadan Behluli e goditi disa herë në shpinë me një shkop dhe Ali Gashi e goditi në të dyja anët e qafës me dorë.[1093] L06 shpjegoi se rrahja vazhdoi afërsisht 20 minuta dhe pastaj atë e kthyen në fllanik.[1094] Sipas dëshmisë së L06-ës, ai pati dhimbje në qafë, kokë dhe shpinë për dhjetë ditë me radhë.[1095] Dhoma thekson se rrëfimi i L06-ës u konfirmua përgjithësisht prej L10-ës në lidhje me rrahjet,[1096] megjithëse në dëshmitë e tyre ka mospërputhje në lidhje me identitetet dhe rolet e sulmuesve të L06-ës, të cilat shqyrtohen gjetiu në këtë vendim.[1097]

305. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma tashmë ka arritur në perfundimin se kushtet e burgimit në fllanik ishin të tilla që burgimi në

[1089] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[1090] L06, T 993-994.
[1091] L06, T 1007.
[1092] L06, T 1007-1008.
[1093] L06, T 1010-1011.
[1094] L06, T 1011.
[1095] L06, T 1011.
[1096] L10, T 2937-2939.
[1097] *Shih më poshtë,* paragrafët 330 dhe 654.

atë vend përbënte trajtim mizor.[1098] Vetëm këto kushte burgimi dhe fakti që L06 ishte i lidhur me një zinxhir 10kg për pjesën më të madhe të burgimit të tij dhe u rrah keqasi e bëjnë Dhomën të gjykojë se në lidhje me L06-ën janë provuar elementët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6).

306. Dhoma është po ashtu e bindur se mbi L06-ën u ushtrua dhunë e rëndë dhe se sulmuesit e tij e keqtrajtuan me një synim të caktuar, për ta ndëshkuar dhe/ose për të marrë informacion në lidhje me të ashtuquajturit spiunë të cilët pretendohej se vepronin në fshatin e tij. Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, rrjedhimisht Dhoma gjykon se në lidhje me L06-ën janë provuar elementët e veprës penale të torturës (Pika 4).

(v) Dëshmitari L96

307 Përfundimi i Dhomës është se L96 u mbajt prej UÇK-së në shtëpinë kryesore dhe në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut për një kohë të shkurtër para dhe deri më 25 ose 26 korrik 1998.[1099] Si rrjedhim Dhoma është gjithashtu e bindur se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime gjatë asaj kohe.

308. L96 dëshmoi se ai ishte keqtrajtuar menjëherë pas ardhjes së tij në kamp-burgun e Llapushnikut. Sipas dëshmisë së L96-ës, kur ai u çua në dhomën në shtëpinë kryesore ai u rrah afërsisht gjysëm ore në terr prej një personi të cilin e përmendi si Shala.[1100] L96 dëshmoi se gjatë burgimit të tij, një njeri të cilin L96 pretendoi se e kishte identifikuar si Isak Musliu, erdhi në dhomën në shtëpinë kryesore, i shoqëruar prej Murrizit dhe një ushtari të armatosur me Kallashnikov.[1101] L96 shpjegoi se tre personat kaluan përmes dhomës ku mbahej ai dhe shkuan në dhomën përbri.[1102] Pak minuta më vonë Murrizi e urdhëroi L96-ën të ngrihej në këmbë dhe të qëndronte pranë murit. Sipas dëshmisë së L96-ës personi që thuhet se ishte Isak Musliu e urdhëroi Murrizin t'ia lidhte duart L96-ës me zinxhir dhe ushtari i armatosur me Kallashnikov e goditi L96-ën me shuplakë në fytyrë kaq fort sa L96 ra në gjunjë. Sipas dëshmisë së L96-ës njeriu që ai pretendoi se e identifikoi si Isak Musliu, bëri një lëvizje karate dhe i dha një goditje përnjimend të fortë duke bërë që L96 të binte në dysheme me duar të lidhura.[1103] L96 shpjegoi se po ky njeri filloi ta shkelmonte "pa e kontrolluar veten" dhe se ai humbi vetëdijën për një kohë të shkurtër për shkak

[1098] *Shih më sipër,* paragrafin 289.
[1099] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[1100] L96, T 2295-2296; 2299; 2512.
[1101] L96, T 2329-2330.
[1102] L96, T 2329.
[1103] L96, T 2329-2330.

të rrahjes.[1104] Gjithashtu L96 dëshmoi se pastaj atë e çuan në fllanik ku ai mendon se u mbajt për katër ditë e netë, derisa kamp-burgu u braktis, në lidhje me të cilin Dhoma gjykoi se ishte më 25 ose 26 korrik 1998 dhe të burgosurit u mblodhën të gjithë në oborr dhe u çuan të përcjellë prej UÇK-së në malet e Berishës.[1105]

309. Në një pjesë tjetër të këtij vendimi,[1106] Dhoma ka shënuar se ka rezerva të qenësishme ndaj besueshmërisë në përgjithësi në lidhje me L96-ën dhe arsyet për këtë. Dhoma nuk mund të pranojë dëshminë e L96-ës në një çështje në qoftë se nuk bindet se ka dëshmni të tjera të cilat ajo i pranon që konfirmojnë dëshminë e L96-ës për atë çështje, të paktën për një hollësi materiale. Duke lënë mënjanë për momentin përgjegjësinë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma tashmë ka arritur në përfundimin se kushtet në fllanik ishin të tilla që burgimi atje përbënte trajtim mizor.[1107] Siç është gjykuar më sipër,[1108] dëshmitë e të burgosurve të tjerë konfirmojnë në mënyrë të mjaftueshme se ashtu si thotë L96, ai u mbajt në kamp-burg. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se në lidhje me L96-ën janë provuar elementët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6). Mirëpo Dhoma nuk mund të bindet për shkallën e rrahjes apo keqtrajtimit të tij siç përshkruhet në dëshminë e tij, kështu që mbi këtë bazë nuk janë provuar veprat penale të trajtimit mizor (Pika 6) dhe të torturës (Pika 4) në lidhje me L96-ën.

(vi) Dëshmitari L04

310. Përfundimi i Dhomës është se L04 u mbajt prej UÇK-së në ahur, në kamp-burgun e Llapushnikut prej afërsisht fundit të qershorit deri më 25 ose 26 korrik 1998.[1109] Si rrjedhim Dhoma është gjithashtu e bindur se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime gjatë asaj kohe. Sipas dëshmisë së L04-ës, gjatë burgimit të tij në kamp-burg ai u keqtrajtua dhe pa të burgosur të tjerë në ahur që u rrahën vazhdimisht nga ushtarët e UÇK-së në kamp.[1110]

311. L04 dëshmoi se një herë dy ushtarë të UÇK-së të cilët ai i përmendi si Tamuli dhe Shala erdhën në ahur, ia lidhën sytë dhe e çuan në një dhomë ku po priste një person, të cilin L04 e përmend si Çerçizi. L04 dëshmoi se sapo hyri në dhomë, Çerçizi e fyeu dhe filloi t'a rrihte me

[1104] L96, T 2330.
[1105] L96, T 2333.
[1106] *Shih më sipër,* paragrafin 26.
[1107] *Shih më sipër,* paragrafin 289.
[1108] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[1109] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[1110] L04, T 1126-1127; 1172-1173; 1175-1177.

shkop ndërkohë që Tamuli e shkelmoi.[1111] L04 dëshmoi se pastaj Çerçizi e hodhi në dysheme, e shkelmoi dhe i përdrodhi krahun.[1112] L04 dëshmoi se edhe sot e kësaj dite ai ka dhimbje në këmbën dhe krahun e djathtë për shkak të rrahjeve.[1113] Dhoma e pranon dëshminë e L04-ës se në këtë rast ai u keqtrajtua prej anëtarëve të UÇK-së.

312. Gjithashtu L04 dëshmoi se një herë tjetër Shala i çoi atë dhe dy të burgosur të tjerë nga kamp-burgu i Llapushnikut në një vend të panjohur në male ku atyre iu kërkua të varrosnin kufomat e tre njerëzve.[1114] L04 dëshmoi se njëri prej personave për të cilin iu tha t'a varroste ishte Agim Ademi, i bashkëburgosur në kamp.[1115] Ai nuk i identifikoi dy kufomat e tjera. Ashtu si është shpjeguar diku tjetër në këtë vendim,[1116] për këtë incident dëshmoi edhe L10.[1117] Prej kufomave shihej se ishin keqtrajtuar.[1118] Dhoma pranon se ky incident ka ndodhur dhe se rrethanat e tij do t'i kenë shkaktuar L04-ës një farë traume psikologjike.

313. Bazuar në sa më lart, dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma është bindur se gjatë burgimit të tij prej UÇK-së në ahur, në kamp-burgun e Llapushnikut, L04 iu nënshtuar keqtrajtimit fizik dhe mendor. Keqtrajtimi fizik i pësuar i shkaktoi dëmtim të këmbës dhe krahut të djathtë që edhe aktualisht i shkaktojnë atij dhimbje. Gjithashtu Dhoma pranon se rrethanat e varrimit të kufomave gjatë burgimit të L04-ës kanë shkaktuar L04-ës një farë vuajtjeje fizike dhe traume psikologjike, të mjaftueshme për t'u cilësuar trajtim mizor. Rrjedhimisht Dhoma është bindur se në lidhje me L04-ën është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6), bazuar në kushtet e burgimit dhe për shkak të keqtrajtimit fizik dhe psikologjik shkaktuar atij. Mirëpo Dhoma nuk ka prova se kryesit vepruan me një ose më shumë synime, gjë që është e domosdoshme për t'u cilësuar torturë. Si pasojë nuk është provuar vepra penale e torturës (Pika 4) në lidhje me L04-ën.

[1111] L04, T 1175-1176.
[1112] L04, T 1175-1176.
[1113] L04, T 1206-1207.
[1114] L04, T 1187-1189.
[1115] L04, T 1187-1189. L04 flet për "Agimin nga Godanci". Sidoqoftë në dëshminë e tij të mëvonshme, L04 identifikoi në fotografi Agim Ademin si personin që ai e përmendi si "Agimi nga Godanci", T 1199.
[1116] *Shih më poshtë,* paragrafët 400-402.
[1117] L10, T 2943-2945.
[1118] L04, T 1189.

(vii) Dëshmitari L12

314. Përfundimi i Dhomës është se L12 u mbajt prej UÇK-së në ahur, në kamp-burgun e Llapushnikut prej afërsisht fundit të qershorit deri më 25 ose 26 korrik 1998.[1119] Si rrjedhim gjithashtu është provuar se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime gjatë asaj kohe.

315. L12 dëshmoi se pas ardhjes së tij në kamp, një ushtar të cilin ai e përmendi si Shala, e çoi në ahur dhe e lidhi me zinxhir pas murit. Ai shpjegoi se duart u lidhën pas një sendi të drunjtë ngjitur në mur dhe ai u lidh me zinxhir si bagëti.[1120] L12 dëshmoi se pasi e lidhi me zinxhirë për muri, Shala filloi ta rrihte me shkop. Sipas dëshmisë së L12-ës ai u godit në brinjë, duar, këmbë dhe kokë derisa humbi vetëdijen.[1121] L12 dëshmoi se dhimbja e shkaktuar prej rrahjes zgjati tri ose katër ditë.[1122] L04, i cili mbahej në ahur me L12-ën dëshmoi se ai e pa këtë keqtrajtim. Sipas dëshmisë së L04-ës, kur L12 arriti në kamp-burg në qershor 1998, L12 u rrah me shkop prej një njeriu që L04 tha se ishte Shala, derisa L12 humbi vetëdijen.[1123] Sipas dëshmisë së L04-ës, L12 u godit "59 herë me të njëjtin shkop."[1124] Dhoma pranon se në këtë rast L12 u keqtrajtua rëndë.

316. Sipas dëshmisë së L12-ës, disa ditë pas ardhjes së tij në kamp, individi i përmendur si Shala erdhi në ahur, ia lidhi sytë L12-ës dhe e çoi atë në një hambar 500 metra larg ahurit, ku L12 u rrah.[1125] Mirëpo dëshmia e L12-ës është e paqartë nëse ai u rrah me grushte prej dy grave apo prej katër individëve.[1126] Si pasojë Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundim në lidhje me numrin dhe identitetin e sulmuesve të L12-ës, megjithëse pranon dëshminë e L12-ës se Shala e çoi në hambar. Gjithashtu Dhoma pranon dëshminë e L12-ës se në këtë rast ai u keqtrajtua rëndë. L12 dëshmoi se kur po rrihej ai u pyet për vendndodhjen e një individi dhe rrahja ndaloi kur ai u përgjigj se "atë e kishin vrarë serbët".[1127] L12 shpjegoi se edhe sot e kësaj dite trupi i tij është i mbuluar me blana prej rrahjeve në kamp-burgun e Llapushnikut gjatë burgimit të tij atje dhe se ai nuk mund të punojë prej dhimbjeve nga të cilat vuan ende.[1128]

317. Edhe L96 dëshmoi se ditën e fundit të burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut në lidhje me të cilën Dhoma ka arritur në përfundimin se ishte më 25 ose 26 korrik 1998, ai e pa L12-

[1119] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[1120] L12, T 1799.
[1121] L12, T 1800.
[1122] L12, T 1801.
[1123] L04, T 1125-1126.
[1124] L04, T 1125-1126.
[1125] L12, T 1808-1809.
[1126] L12, T 1808-1810.
[1127] L12, T 1808-1810.

ën midis të burgosurve të tjerë që po largoheshin nga kampi dhe sipas dëshmisë së L96-ës, L12 ishte "në gjendje shumë të keqe".[1129]

318. Bazuar mbi sa më sipër, duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma është bindur se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së në ahur në kamp-burgun e Llapushnikut, L12 iu nënshtrua keqtrajtimit fizik, të përshkruar në dëshminë e tij si pasojë e të cilit L12 ende ka dhimbje. Siç është provuar më parë,[1130] Dhoma është e bindur se kushtet e burgimit në ahur ishin të tilla që burgimi atje përbënte trajtim mizor. Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se në lidhje me L12-ën është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6), vërtetuar prej burgimit dhe veças ose bashkë prej keqtrajtimit psikologjik dhe fizik shkaktuar L12-ës. Gjithashtu Dhoma ka mendimin se keqtrajtimi i ushtruar ndaj L12-ës arriti në masën e kërkuar që të përbëjë veprën penale të torturës dhe u krye konkretisht për të marrë informacion prej tij. Si pasojë në lidhje me L12-ën është provuar vepra penale e torturës (Pika 4).

(viii) Ajet Gashi

319. Shefqet Gashi deklaroi në një deklaratë me shkrim se Ajet Gashi, shqiptar kosovar, u arrestua në fund të majit 1998 kur u paraqit në shtabin e UÇK-së në Likoc bashkë me Rahim Kryeziun. Nuk është e qartë nëse Ajet Gashi iu bashkua radhëve të UÇK-së apo u thirr në shtab.[1131] Shefqet Gashi mendonte se Ajet Gashi u mbajt në shtab, me sa duket, se mendohej që ai ishte spiun i cili bashkëpunonte me forcat serbe.[1132] Ajet Gashi nuk u pa më derisa kufoma e tij u zbulua afër Leletiqit dhe vdekja e tij u raportua në mes të qershorit 1998.[1133]

320. Shefqet Gashi deklaroi se atij i kapi veshi një bisedë midis dy ushtarëve të UÇK-së të cilëve nuk u përmenden emrat, të cilët përmendën burgimin e Ajet Gashit në një kamp-burg në fshatin Llapushnik.[1134] L64 dëshmoi se ai e pa fillimisht Ajet Gashin në kamp-burgun e Llapushnikut dikur herët në qershor 1998.[1135] L64 kishte dëgjuar biseda mbi praninë e një "spiuni të madh" në kamp-burgun e Llapushnikut.[1136] Ymer Alushani e çoi atë në një dhomë në kamp-burgun e

[1128] L12, T 1829.
[1129] L96, T 2413-2414.
[1130] *Shih më sipër,* paragrafin 289.
[1131] Prova Materiale P183; L64, T 4475.
[1132] L64, T 4475
[1133] Prova Materiale P183.
[1134] Prova Materiale P183.
[1135] Prova Materiale P183; L64, T 4456.
[1136] L64, T 4456.

Llapushnikut;[1137] kur Ymer Alushani hapi derën, ai përmendi fjalën "spiunë".[1138] Sipas L64-ës, në atë dhomë ishin tre-katër persona. Njëri prej personave dergjej mbi dysheme, i cili ose nuk ndihej mirë ose ishte një farë invalidi.[1139] Ymer Alushani e urdhëroi atë të mos lëvizte.[1140] Dukej se ai individ nuk mund të qëndronte në këmbë.[1141] L64 nxorri përfundimin se individi që dergjej në dysheme ishte "spiuni i madh" për të cilin ai kishte dëgjuar.[1142] L64 pretendoi se ai quhej Ajet Gashi, për të cilin qarkullonin fjalë të ndryshme. Mendohej se Ajet Gashi bashkëpunonte me forcat serbe në Lipjan.[1143] L64 deklaroi se ai kishte dëgjuar që Ajet Gashi merrte rrogë për punën e tij.[1144] Gjithashtu L64 dëgjoi thashetheme në lidhje me keqtrajtimin e pretenduar të një studenteje shqiptare të Kosovës prej Ajet Gashit.[1145] L64 deklaroi se Ajet Gashi ishte në kamp-burgun e Llapushnikut disa kohë para se të ekzekutohej.[1146]

321. Dhoma nuk pranon se prania e Ajet Gashit në kamp-burgun e Llapushnikut u identifikua bindshëm prej L64-ës. Veç rezervave të shprehura prej Dhomës gjetiu në këtë Aktgjykim mbi besueshmërinë e përgjithshme të L64-ës, dëshmia e tij në lidhje me burgimin e Ajet Gashit në kamp-burgun e Llapushnikut është jobindëse për Dhomën. L64 nuk jep asnjë arsye të dallueshme për pretendimin se individi të cilin ai pa në Llapushnik ishte Ajet Gashi.[1147] Është e paqartë sesi L64 mësoi se Ajet Gashi ishte "spiuni i madh" i cili mbahej në Llapushnik, sepse ai nuk e kishte njohur më parë Ajet Gashin.[1148] L64 e identifikoi personin për të cilin ai mendoi se ishte Ajet Gashi vetëm me hamendje dhe supozim.[1149] Me sa duket ai dëgjoi nga individë të panjohur për Dhomën se "spiuni i madh" dhe Ajet Gashi ishte i njëjti person.[1150] Mirëpo në një deklaratë të mëparshme për hetuesit, L64 deklaroi se ai nuk e njihte Ajet Gashin dhe nuk e dinte se Ajet Gashi mbahej në Llapushnik.[1151] Asnjë dëshmitar tjetër gojor i thirrur prej Prokurorisë, nuk e identifikoi Ajet Gashin apo e përmendi si të burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut. Në deklaratën me shkrim të Shefqet Gashit shënohet se ai dëgjoi dikë, i cili nuk u identifikua, të thoshte se Ajet Gashi mbahej në

[1137] L64, T 4456-4457.
[1138] L64, T 4458.
[1139] L64, T 4457.
[1140] L64, T 4457.
[1141] L64, T 4457-4458.
[1142] L64, T 4458.
[1143] L64, T 4457-4458; 4476.
[1144] L64, T 4476.
[1145] L64, T 4475.
[1146] L64, T 4490.
[1147] L64, T 4458.
[1148] L64, T 4768.
[1149] L64, T 4458.
[1150] L64, T 4457-4458.
[1151] L64, T 4768.

Llapushnik.[1152] Dhoma nuk i jep shumë rëndësi kësaj hollësie. Duke marrë parasysh këto rrethana, Dhoma nuk bindet se Ajet Gashi ishte i burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut.

322. Gjithashtu është e nevojshme të komentohen rrethanat e vrasjes së pretenduar të Ajet Gashit dhe dëshmia e L64-ës në lidhje me këtë çështje. Prokuroria pretendon se Ajet Gashi u vra më 12 qershor 1998 ose rreth kësaj date.[1153] Kufoma e Ajet Gashit u gjet midis Magurës dhe Leletiqit në anë të rrugës.[1154] Shefqet Gashi, vëllai i viktimës, deklaroi se ai mësoi prej një programi televiziv gjerman se midis Magurës dhe Leletiqit ishte gjetur kufoma e Ajet Gashit.[1155] Gjithashtu gazetat shqiptare informuan për vdekjen e Ajet Gashit në Leletiq.[1156] Deklaratës me shkrim të Shefqet Gashit i është bashkëngjitur një artikull gazete i 15 qershor 1998 ku pohohet se Ajet Gashi ishte vrarë me pesë plumba në krahëror.[1157] Gjithashtu deklaratës me shkrim të Shefqet Gashit i bashkëngjitet një vendim gjykate i 29 majit 2002, që konfirmon se Ajet Gashi u vra më 12 qershor 1998.[1158] Të afërmit e Shefqet Gashit të cilët e panë kufomën treguan se Ajet Gashi e kishte krahun e thyer dhe në stomakun e tij kishte shenja plagësh.[1159] Duart i kishte të mavijosura dhe me të çara.[1160] Ekzaminimi mjeko-ligjor i kufomës prej Dr. José Pablo Baraybar konfirmon se shkaku i vdekjes së Ajet Gashit ishin plagë të shumta plumbi në kokë dhe trung.[1161] Gjithashtu ai zbulon se kishte plagë plumbi edhe në gjymtyrët e epërm.[1162]

323. L64 dëshmoi se Ajet Gashi u ekzekutua.[1163] Sipas dëshmisë së L64-ës, dikur në gjysmën e parë të qershorit 1998, Ymer Alushani erdhi në shtëpinë e Rexhep Vojvodës në Llapushnik dhe i kërkoi L64-ës doreza dhe një maskë.[1164] Në atë kohë në shtëpi u mblodh një grup. Të pranishëm ishin, vëllai i L64-ës, Fadil Kastrati, Zeneli, Tamuli dhe të tjerë.[1165] Ymer Alushani i tha L64-ës se atij i duheshin doreza dhe maska "për të hequr diçka."[1166] Pas pak grupi u nis me makina.[1167] L64 udhëtoi në një kolonë makinash me Ymer Alushanin dhe të tjerët në drejtim të Leletiqit.[1168] L64

[1152] Prova Materiale P183.
[1153] Aktakuzë, paragrafi 29.
[1154] Prova Materiale P183.
[1155] Prova Materiale P183.
[1156] Prova Materiale P183.
[1157] Prova Materiale P183.
[1158] Prova Materiale P183.
[1159] Prova Materiale P183.
[1160] Prova Materiale P183.
[1161] Prova Materiale P111.
[1162] Prova Materiale P111.
[1163] L64, T 4490.
[1164] L64, T 4490.
[1165] L64, T 4490-4491.
[1166] L64, T 4490.
[1167] L64, T 4490.
[1168] L64, T 4491-4492.

dëshmoi se ai pa makina të tjera të parkuara në kryqëzimin e rrugës drejt Leletiqit dhe Magurës.[1169] Në anën e majtë të rrugës në drejtim të Leletiqit ishte makina e Fadil Kastratit; makina tjetër ishte në anën tjetër të rrugës që çonte në Magurë.[1170] L64 dëshmoi se vendbagazhi i një makine ishte i hapur.[1171] Kur L64 u afrua ai pa një njeri të shtrirë në anë të rrugës në gjendje kritike, për të cilin thotë se ishte Ajet Gashi.[1172] Pastaj Ymer Alushani i tha L64-ës se ata kishin urdhër për ta ekzekutuar atë person.[1173] L64 deklaroi se ai refuzoi të merrte pjesë në ekzekutim.[1174] L64 dëshmoi se Ymer Alushani dhe Tamuli e vranë personin duke shkrepur afërsisht 20 plumba kundër tij.[1175] Sipas dëshmisë së L64-ës, pas kësaj Fadil Kastrati dhe vëllai i L64-ës shkuan në shtëpi, kurse Ymer Alushani dhe të tjerët shkuan në një dasmë.[1176]

324. Ekzistojnë lajme gazetash që dokumentojnë vdekjen e Ajet Gashit ku pohohet se natën e 12 ose 13 korrikut[1177] në rrethinën në fjalë u dëgjuan të shtëna, dhe dëshmia e L64-ës në lidhje me kohën, vendin dhe shkakun e vrasjes në të cilën ai ishte dëshmitar përputhet me dëshmi të tjera që dokumentojnë vdekjen e Ajet Gashit.[1178] Mirëpo Dhoma tashmë ka shprehur rezerva në lidhje me besueshmërinë e pjesëve të konsiderueshme të dëshmisë së L64-ës.[1179] Për këtë arsye Dhoma mbetet e rezervuar për dëshminë e L64-ës në lidhje me rrethanat e kësaj vrasjeje, e pambështetur aktualisht nga dëshmi të tjera. Dhoma pranon se Ajet Gashi është i vdekur. Mirëpo Dhoma nuk është e bindur për identifikimin e Ajet Gashit prej L64-ës në Llapushnik dhe po ashtu nuk është e bindur prej dëshmisë së L64-ës se njeriu të cilin ai pa kur u vra, ishte në fakt Ajet Gashi.

325. Përfundimi i Dhomës është se Prokuroria nuk ka provuar se Ajet Gashi u mbajt i burgosur në Llapushnik. Rrjedhimisht del se nuk janë provuar elementët e torturës (Pika 4) dhe trajtimit mizor (Pika 6) në kamp-burgun e Llapushnikut në lidhje me Ajet Gashin. Mbi bazën e provave mjeko-ligjore del se Ajet Gashi është vrarë. Mirëpo meqë nuk është provuar se njeriu i cili u vra në praninë e L64-ës ishte Ajet Gashi, nuk ka prova për rrethanat e vdekjes së tij apo personave përgjegjës. Për këtë arsye, nuk janë provuar elementë të vrasjes (Pika 8) së Ajet Gashit në lidhje me këtë Aktakuzë.

[1169] L64, T 4492.
[1170] L64, T 4492.
[1171] L64, T 4492.
[1172] L64, T 4492.
[1173] L64, T 4492.
[1174] L64, T 4492-4493.
[1175] L64, T 4493.
[1176] L64, T 4493.
[1177] Prova Materiale P183.
[1178] Prova Materiale P183.

(ix) Fehmi Xhema (gjithashtu i njohur si Fehmi Tafa)

326. L06 dëshmoi se më 13 ose 14 qershor 1998, ai bashkë me Fehmi Xhemën (ose Fehmi Tafën), shqiptar etnik, dhe të tjerë, duke përfshirë edhe L10-ën, u ndaluan në një postbllok të UÇK-së midis Carralevës dhe Zborcit prej dy ushtarëve të UÇK-së me maska dhe me automatikë.[1180] Edhe L12 dëshmoi se Fehmi Xhema u rrëmbye.[1181] Më pas ata u çuan në shtëpinë e Idriz Muharremit,[1182] e cila ishte afërsisht 200-300 metra nga vendi ku ata u arrestuan prej ushtarëve të UÇK-së.[1183] Në shtëpi, Fehmi Xhema dhe L06 u vendosën në makina të ndryshme.[1184] L06 dhe L10 udhëtuan bashkë.[1185] Sipas L10-ës, makinat shkuan fillimisht në një shtëpi në Kleçkë.[1186] L10 deklaroi se Fehmi Xhema i tha se ata ishin në Kleçkë.[1187] L10 pohoi se afërsisht pas gjysëm ore ose një ore, ata u vendosën në të njëjtën makinë dhe u çuan në një vend tjetër.[1188]

327. Ashtu siç është përmendur prej Dhomës, mospërputhjet midis dëshmive të L06-ës dhe L10-ës në lidhje me arrestimin e tyre nuk kanë të bëjnë me elementë të rëndësishëm faktikë dhe rrethanat e rrëmbimit të secilit dëshmitar.[1189] Gjithashtu këto mospërputhje nuk ndikojnë në përfundimin e Dhomës se Fehmi Xhema u mbajt në Llapushnik. Një numër dëshmitarësh vërtetuan praninë e Fehmi Xhemës në kamp-burgun e Llapushnikut.[1190] L06 e identifikoi praninë e Fehmi Xhemës në fllanik, ku ai i kishte duart të lidhura me pranga.[1191] L10 u lidh me pranga me Fehmi Xhemën.[1192] Gjithashtu L10 e njohu Fehmi Xhemën prej fotografisë.[1193]

328. L06 dëshmoi se gjatë shtatë ditëve të burgimit të tij, ai pa kur Ramadan Behluli dhe Ali Gashi e nxorën Fehmi Xhemën nga fllaniku dhe e çuan drejt ahurit. L06 pati përshtypjen se Fehmi Xhema nuk ishte i pranishëm për një orë.[1194] L06 dëshmoi se kur u kthye, Fehmi Xhema ishte rrahur rëndë.[1195] Sulmuesit e tij e sollën në dhomë prej këmbësh dhe e "hodhën" mbi dysheme.[1196]

[1179] *Shih më sipër,* paragrafin 28.
[1180] L06, T 977-979.
[1181] L12, T 1791; T 1824-1829; Prova Materiale P54.
[1182] L10, T 2913; L06, T 983. Në transkript përfshihen dy shkronjëzime të ndryshme për "Idriz Muharremin".
[1183] L10, T 2913; L06, T 983.
[1184] L06, T 983; L10, T 2913.
[1185] L06, T 989; L10, T 2913.
[1186] L10, T 2915.
[1187] L10, T 2915.
[1188] L10, T 2911-2916.
[1189] *Shih më sipër,* paragrafët 245-248; 272-273.
[1190] L06, T 989-990; L10, T 2921; T 2971.
[1191] L06, T 993.
[1192] L10, T 2921.
[1193] L10, T 2971; Prova Materiale P54.
[1194] L06, T 1010-1012.
[1195] L06, T 1011-1012.

L06 trokiti në derë për të kërkuar ujë për Fehmi Xhemën. Shala i tha të pushonte trokitjet se ndryshe do t'i jepte "njëqind shkopinj".[1197] Sipas L06-ës, Fehmi Xhema "nuk kishte lëndime në trup", por ai ishte në gjendje të tillë saqë vdiq 20 minuta pasi e kishin prurë në dhomë.[1198] L06 dëshmoi se kaluan tri ditë derisa kufoma e Fehmi Xhemës u hoq nga dhoma.[1199]

329. L10 dha një dëshmi të ndryshme nga dëshmia e L06-ës për vdekjen e Fehmi Xhemës. L10 deklaroi se ditën pasi u rrah L06, katër individë, të cilët L10 tha se ishin Shala, Murrizi, Çerçizi dhe një person tjetër, hynë në dhomë kur të burgosurit po flinin dhe ia lidhën duart Fehmi Xhemës, ia mbuluan sytë dhe e nxorën.[1200] Personi për të cilin L10 thotë se ishte Çerçizi dhe personi të cilin L10 nuk e njohu, mbanin maska. L10 dëgjoi një britmë të Fehmi Xhemës. Fehmi Xhema u kthye në fllanik afërsisht pas njëzet minutash prej Shalës, i cili i udhëzoi të burgosurit të mos e hapnin gojën.[1201] Fehmi Xhema ishte krejt i enjtur prej plagëve dhe nuk mund të qëndronte në këmbë.[1202] Ai ishte në gjendje mjaft të keqësuar dhe kritike. L10 dëshmoi se ai vuri pak ujë në gjoksin e Fehmi Xhemës sepse ai po vdiste.[1203] L10 deklaroi se Fehmi Xhema vdiq pak më vonë.[1204] Të nesërmen, Shala dhe disa të tjerë hynë në dhomë dhe e hoqën kufomën duke e zvarritur. L10 pa një makinë "Omega" të bardhë dhe mendon se kufoma e Fehmi Xhemës u transportua me të, megjithëse ai nuk ka asnjë informacion konkret për këtë.[1205]

330. Dëshmitë e dhëna nga L06 dhe L10 për vdekjen e Fehmi Xhemës ndryshojnë në pika të rëndësishme. L06 deklaroi se Fehmi Xhema u nxor jashtë pasi ai vetë ishte rrahur, kurse L10 deklaroi se Fehmi Xhema u nxor jashtë një ditë pasi ishte rrahur L06. Gjithashtu dëshmitë ndryshojnë për ditën kur u hoq kufoma e Fehmi Xhemës nga ahuri. Më thelbësore është se L06 dhe L10 dhanë dëshmi jopërputhëse të identiteteve të atyre që thuhet se ishin sulmuesit e Fehmi Xhemës. L06 dëshmoi se Fehmi Xhema u hoq dhe u rrah prej Ali Gashit dhe Ramadan Behlulit; L10 deklaroi se morën pjesë Shala, Murrizi, Çerçizi dhe një person tjetër. Gjithashtu dëshmitë ndryshojnë në lidhje me identitetet e njerëzve të cilët rrahën L06-ën.[1206]

[1196] L06, T 1011-1012.
[1197] L06, T 1012.
[1198] L06, T 1012.
[1199] L06, T 1013.
[1200] L10, T 2939.
[1201] L10, T 2939-2941.
[1202] L10, T 2942.
[1203] L10, T 2942.
[1204] L10, T 2942.
[1205] L10, T 2942.

331. Pasi i ka kushtuar mjaft vëmendje dëshmive të L06-ës dhe L10-ës dhe veçanërisht mospërputhjeve të dukshme dhe duke marrë parasysh sjelljen dhe mënyrën sesi secili prej këtyre dëshmitarëve dëshmoi, tonin e përgjithshëm të dëshmive të tyre, rrethanat e mbajtjes së tyre në kamp-burgun e Llapushnikut dhe kohëzgjatjen dhe kohën që ka kaluar që prej këtyre ngjarjeve, Dhoma vlerëson se L06 dhe L10 ishin dëshmitarë të ndershëm; por është e qartë se disa ngjarje janë ngatërruar të paktën në mendjen e njërit prej tyre. Nuk mund të përcaktohet nëse kjo vjen për shkak të rrethanave të burgimit të tyre dhe vuajtjeve të tyre personale apo prej viteve që kanë kaluar. Si pasojë, Dhoma nuk mund të jetë e bindur për disa çështje që ngrihen në dëshmitë e tyre, veçanërisht identitetet e individëve të cilët e nxorrën Fehmi Xhemën nga fllaniku. Gjithsesi Dhoma është e bindur se Fehmi Xhema u mbajt nga UÇK-ja në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut për një periudhë nga 13 qershori 1998 deri në një datë të panjohur para 25 ose 26 korrikut 1998. Dhoma nxjerr përfundimin se në një nga ditët e burgimit të tij, Fehmi Xhema u nxor jashtë fllanikut dhe u kthye më vonë pasi ishte rrahur keqasi. Për arsyet e shtjelluara në paragrafët vijues, Dhoma gjithashtu nxjerr përfundimin se Fehmi Xhema ishte në fllanik një deri në tri ditë dhe gjatë kësaj kohe ai iu duk i vdekur si L06-ës po ashtu edhe L10-ës. Më në fund ai u hoq prej fllanikut dhe nuk u kthye. Kur ishte në kamp-burgun e Llapushnikut, Fehmi Xhema nuk merrte pjesë aktive në luftime.

332. Dhoma gjykon se me gjithë keqtrajtimin e rëndë nga i cili vuajti, Dhoma ka prova të pamjaftueshme për të përcaktuar nëse ai u rrah me një synim të caktuar ashtu siç kërkohet për krimin e torturës. Provat lënë të hapur se Fehmi Xhema u rrah thjesht për motive arbitrare.

333. Dhoma gjykon se gjatë burgimit në kamp-burgun e Llapushnikut Fehmi Xhema iu nënshtrua trajtimit mizor. Ai iu nënshtrua një dhune të konsiderueshme që padyshim i shkaktoi atij vuajtje dhe lëndime të skajshme fizike. Duke marrë parasysh rrethanat, Dhoma është e bindur se sulmuesit e tij vepruan qëllimisht. Veç vuajtjeve fizike, Fehmi Xhema u mbajt për shumë ditë në fllanik dhe u prangos me një të burgosur tjetër, L10-ën, gjë që e shtoi vuajtjen e tij.[1207] Ashtu siç e ka shtjelluar Dhoma, kushtet në dhomë ishin të mjerueshme dhe ishin të tilla që shkaktuan vuajtje të rënda fizike dhe psikologjike apo përbënin një sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor, e mjaftueshme për t'u cilësuar trajtim mizor.[1208]

[1206] L06, T 1007-1008; L10, T 2938.
[1207] L06, T 993; L10, T 2918-2923.
[1208] *Shih më sipër,* paragrafin 289.

334. Prokuroria pretendon se dikur në qershor apo korrik 1998, Fehmi Xhema u vra në kampburgun e Llapushnikut.[1209] Vdekja e Fehmi Xhemës është e pakundërshtueshme. Analiza e ADN-së së një mostre eshtërore të mbetjeve njerëzore të gjetura në një vendvarrim në Mirenë vërteton sipas gjykimit të Dhomës, lidhjen familjare me anëtarë të tjerë të familjes Xhema.[1210] Raporti i autopsisë së 13 tetorit 2003 i mbetjes së kufomës përcaktoi se shkaku i vdekjes së Fehmi Xhemës ishte plagë plumbi në krahëror.[1211] Në vërtetimin e vdekjes së Fehmi Xhemës gjithashtu shënohet se shkaku i vdekjes së tij ishte plagë plumbi në krahëror.[1212] Vendvarrimi në Mirenë nuk është larg nga ana lindore e Llapushnikut. Në kohën që ka lidhje me Aktakuzën ndodhej në të njëjtën zonë kontrolli të UÇK-së si Llapushniku. Nga Llapushniku mund të shkohet me makinë në Mirenë.

335. Mbrojtja pretendon se informacioni mjeko-ligjor është i papajtueshëm me dëshmitë e L06-ës dhe L10-ës të cilat u përmblodhën më lart, duke ngritur dyshime thelbësore rreth besueshmërisë së tyre si dëshmitarë.[1213] Dhoma nuk i vlerëson dëshmitë në lidhje me shkakun e vdekjes në këtë mënyrë. Dëshmitë e dëshmitarëve në lidhje me mënyrën e vdekjes së Fehmi Xhemës nuk janë domosdoshmërisht të papajtueshme me provat mjeko-ligjore. Dhoma pranon se L06 dhe L10 menduan se Fehmi Xhema "vdiq" pasi u kthye në fllanik. Mirëpo këto janë vlerësime joprofesionale për gjendjen fizike të Fehmi Xhemës; ato nuk përbëjnë deklarime të një fakti mjekësor. Ndërsa është e qartë se Fehmi Xhema ishte në një gjendje dëshpërimisht të keqe kur u kthye në fllanik, kjo nuk parakupton që ai ishte klinikisht i vdekur. "Vdekja" e Fehmi Xhemës e përshkruar prej L06-ës dhe L10-ës, faktikisht mund të ketë qenë koma e thellë si pasojë e rrahjeve të rënda që kishte pësuar.

336. Dhoma pranon nga dëshmitë e L06-ës dhe L10-ës se kur e kthyen në fllanik, në krahërorin e Fehmi Xhemës nuk kishte asnjë shenjë plumbi. Përfundimi i Dhomës është se ai u ekzekutua më vonë pasi u hoq prej fllanikut. Provat mjeko-ligjore tregojnë se shkak klinik i vdekjes së tij ishte pushkatimi. Dhoma gjykon se kështu ka ndodhur, edhe pse L06-ës dhe L10-ës iu duk se Fehmi Xhema kishte vdekur para se të hiqej prej fllanikut. Nuk është e qartë prej dëshmive nëse edhe personi ose personat që vranë Fehmi Xhemën gjithashtu menduan se ai ishte i vdekur, apo nëse atë e hoqën nga fllaniku që ta pushkatonin. Kur e hoqën, Fehmi Xhema mund të ketë ardhur në vete ose pasi të jetë kontrolluar trupi i tij mund të jetë zbuluar se organet e tij jetike ende punonin. Pavarësisht nëse ndodhi një gjë e tillë ose jo, përfundimi i Dhomës është se rrethanat tregojnë që

[1209] Aktakuzë, paragrafi 32.
[1210] Prova Materiale P256.
[1211] Prova Materiale P 227.
[1212] Prova Materiale P 228.
[1213] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 909.

Fehmi Xhemën e hoqën nga fllaniku thuajse të vdekur dhe në një kohë më pas ai u vra nga ata që e mbanin të burgosur dhe më pas kufoma e tij u varros në Mirenë.

337 Është e qartë se në këto rrethana nuk mund të përcaktohet nëse faktikisht Fehmi Xhema u ekzekutua në kamp-burgun e Llapushnikut apo pasi ishte hequr që andej. Ndërkohë që në Aktakuzë deklarohet se ai u vra në kamp-burg, kjo hollësi nuk është element thelbësor i akuzës për vrasje. Më vonë në këtë Aktgjykim do të shqyrtohet nëse është treguar se një ose më shumë prej të Akuzuarve e kanë vrarë atë ose ndryshe janë penalisht përgjegjës për vrasjen e tij në një nga mënyrat e pretenduara.[1214] Duke e lënë mënjanë për momentin këtë çështje, Dhoma është tërësisht e bindur dhe gjykon se kur u ekzekutua, Fehmi Xhema ishte i burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut dhe se personi ose personat që e qëlluan atë, ose synonin t'a vrisnin, ose t'i shkaktonin dëmtim ose lëndim të rëndë trupor me dijeninë e pritshme se vdekja ishte pasojë e mundshme e të shtënave.

338. Rrjedhimisht duke lënë mënjanë për momentin përgjegjësinë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Fehmi Xhemën janë vërtetuar elementët e trajtimit mizor (Pika 6) mbi bazën e keqtrajtimit të Fehmi Xhemës dhe kushteve të burgimit të tij. Gjithsesi, nuk janë vërtetuar elementët e torturës (Pika 4). Gjithashtu Dhoma është bindur se në lidhje me Fehmi Xhemën janë vërtetuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 8).

(x) Milovan Kërstiq dhe Miodrag Kërstiq

339. Liljana Mitroviqi dëshmoi se më 24 qershor 1998, Sllobodan Mitroviqi dhe Milovan Kërstiqi morën Miodrag Kërstiqin nga një spital në Beograd dhe u nisën për në Reçan në Kosovë.[1215] Ata udhëtonin në një Volkswagen Golf në ngjyrë të kaltër të errët.[1216] Ata ndaluan në Krushec.[1217] Prej tyre nuk u dëgjua më. Pasi arriti në Kosovë për të kërkuar burrin e saj, Sllobodan Mitroviqin, Liljana Mitroviqit iu tha nga Abdyl Kryeziu se Sllobodan Mitroviqi dhe vëllezërit Kërstiq, të gjithë serbë etnikë, ishin rrëmbyer në Carralevë dhe ishin çuar në drejtim të Malishevës.[1218] Sllobodanka Kërstiq deklaroi se vëllai i burrit të saj të ndjerë i tha asaj se ai e pa makinën e Miodrag Kërstiqit në Malishevë një muaj pas rrëmbimit, të vozitur nga një shqiptar kosovar nga Malisheva i quajtur Liman.[1219]

[1214] *Shih më poshtë,* paragrafin 661.
[1215] Liljana Mitroviq, T 1596-1599; Prova Materiale P187.
[1216] Prova Materiale P187.
[1217] Liljana Mitroviq, T 1599.
[1218] Liljana Mitroviq, T 1601-1602.
[1219] Prova Materiale P187.

340. Individë të shumtë identifikuan Milovan Kërstiqin[1220] dhe Miodrag Kërstiqin[1221] si të burgosur në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut. Ivan Bakraçi dëshmoi se Milovan Kërstiqi i tregoi atij se si ishte prurë aty.[1222] Ivan Bakraçi deklaroi se Milovan Kërstiqi i kishte treguar se ai ishte çuar në një shkollë në makinën e tij, për të cilën Ivan Bakraçi tha se ishte Volkswagen Golf i kaltër i errët.[1223] Vojko Bakraçi dëshmoi se ai kishte dëgjuar të njëjtën histori nga "vëllezërit Kërstiq."[1224] Në Llapushnik, me sa duket u gjetën dokumentet personale të Milovan Kërstiqit.[1225] Mbi bazën e këtyre dëshmive, Dhoma është e bindur se Milovan Kërstiqi dhe Miodrag Kërstiqi u mbajtën në kamp-burgun e Llapushnikut prej UÇK-së për një kohë të pacaktuar duke filluar prej 24 qershorit 1998. Dhoma nxjerr përfundimin se ata nuk merrnin pjesë aktive në luftime gjatë asaj kohe.

341. Dhoma është e bindur prej dëshmive se në çfarë kushtesh u mbajtën këta dhe të burgosur të tjerë, se kushtet e burgimit në fllanik ishin të tilla sa të përbënin trajtim mizor (Pika 6). Mirëpo nuk ka prova për keqtrajtim të drejtpërdrejtë dhe të mëtejshëm konkret ushtruar ndaj Milovan Kërstiqit ose Miodrag Kërstiqit.

342. Prokuroria pretendon se Milovan dhe Miodrag Kërstiqi u vranë në kamp-burgun e Llapushnikut midis 24 qershorit 1998 dhe 26 korrikut 1998.[1226] Meqënëse kufomat e Milovan dhe Miodrag Kërstiqit nuk janë gjetur, Prokuroria e fton Dhomën të zbatojë faktorët e renditur në *Prokurorja kundër Kërnojelacit* për të përcaktuar se provohen elementët për vrasje.[1227] Kanë kaluar disa vite që kur Milovan dhe Miodrag Kërstiqi janë zhdukur dhe gjatë kësaj kohe ata nuk kanë kontaktuar as familjet e tyre dhe askënd tjetër. Dhoma ka dëshmi të zhdukjes së burgosurve të tjerë në Llapushnik. Nuk është paraqitur asnjë provë në lidhje me keqtrajtimin e Milovan Kërstiqit ose Miodrag Kërstiqit gjatë burgimit të tyre në Llapushnik, por Dhoma merr parasysh dëshmitë e sjelljes së përgjithshme kundrejt të burgosurve dhe dhunën e ushtruar kundrejt disa të burgosurve. Gjithashtu Dhoma është e vetëdijshme për dëshmitë se disa persona të mbajtur në kamp-burg më vonë u liruan.

[1220] Ivan Bakraç, T 1447-1449. Vojko Bakraç, T 1314-1317; L07, T 824; Prova Materiale P54.
[1221] L07, T 821-824; Vojko Bakraç, T 1314-1317, Prova Materiale P54.
[1222] Ivan Bakraç, T 1448-1449.
[1223] Ivan Bakraç, T 1448.
[1224] Vojko Bakraç, T 1313.
[1225] Provat Materiale P244/245, nënndarje 17.
[1226] Aktakuzë, paragrafi 30.
[1227] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 462.

343. Megjithatë, provat e paraqitura nga Prokuroria nuk e bindin Dhomën se Prokuroria ka provuar elementët e vrasjes në lidhje me Milovan Kërstiqin dhe Miodrag Kërstiqin. Dhoma nuk disponon asnjë provë se Milovan Kërstiqi ose Miodrag Kërstiqi u vranë në kamp-burgun e Llapushnikut prej rojeve të UÇK-së të kamp-burgut, ose se u vranë midis datave të pretenduara prej Prokurorisë në Aktakuzë, që do të thotë, midis 24 qershorit 1998 dhe 26 korrikut 1998. Në fakt, Sllobodanka Kërstiq dëgjoi se Milovan Kërstiqi dhe Miodrag Kërstiqi ishin gjallë në gusht 1998.[1228] Mirëpo ky ishte informacion i dorës së dytë. Më tej, në nëntor 1998, vëllai i Sllobodanka Kërstiqit pa një program televiziv që tregonte ushtarë të UÇK-së në Kukës, në Shqipëri. Vëllai i Sllobodanka Kërstiqit i tha asaj se ndërmjet tyre ai njohu Miodrag Kërstiqin.[1229] Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, Dhoma nuk mund të bindet se Prokuroria ka vërtetuar se Milovan Kërstiqi dhe Miodrag Kërstiqi janë faktikisht të vdekur.

344. Në lidhje me Milovan Kërstiqin ose Miodrag Kërstiqin nuk janë provuar elementët e veprës penale të torturës (Pika 4). Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Milovan Kërstiqin dhe Miodrag Kërstiqin janë provuar elemnetët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6). Dhoma gjykon se nuk janë vërtetuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 8) në lidhje me Milovan Kërstiqin dhe Miodrag Kërstiqin.

(xi) Sllobodan Mitroviq

345. Liljana Mitroviqi deklaroi se, më 24 qershor 1998, Sllobodan Mitroviqi, serb etnik, dhe kushëriri i tij Milovan Kërstiqi morën Miodrag Kërstiqin nga një spital në Beograd dhe u nisën për në Reçan në Kosovë.[1230] Liljana Mitroviqi e pa për herë të fundit burrin e saj më 23 qershor 1998 në Arangjelovac.[1231] Autoritetet serbe i thanë Liljana Mitroviqit se një makinë që përputhej me përshkrimin e një Volkswagen Golf në të cilën po udhëtonin burrat ishte parë duke kaluar kufirin në Merdare.[1232] Liljana Mitroviqi u nis për në Kosovë më 25 qershor 1998, ku Abdyl Kryeziu nga Suhareka i tha se burri i saj dhe vëllezërit Kërstiq ishin rrëmbyer në Carralevë dhe ishin çuar në drejtim të Malishevës.[1233]

346. Të tjerët e identifikuan Sllobodan Mitroviqin si të pranishëm në kamp-burgun e Llapushnikut. L07 e identifikoi Sllobodan Mitroviqin prej fotografisë si i burgosur mbajtur në

[1228] Prova Materiale P 187.
[1229] Prova Materiale P 187.
[1230] Liljana Mitroviq, T 1596-1599.
[1231] Liljana Mitroviq, T 1596.
[1232] Liljana Mitroviq, T 1600-1601.
[1233] Liljana Mitroviq, T 1601.

fllanik, në Llapushnik.[1234] Vojko Bakraçi deklaroi se ai u mbajt në fllanik me "vëllezërit Kërstiq, njëri prej të cilëve quhej Sllobodan",[1235] megjithëse ai nuk mundi ta identifikonte Sllobodan Mitroviqin në fotografi. Në Llapushnik u gjetën dokumenta që siç duket ishin të Sllobodan Mitroviqit.[1236]

347. Ivan Bakraçi e njohu Sllobodan Mitroviqin në fotografi si njëri prej personave që ishte mbajtur në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut.[1237] Ai nuk e njihte me emër personin të cilin e identifikoi në fotografi. Sipas Ivan Bakraçit, Sllobodan Mitroviqi kishte një plumb në këmbë dhe i kishte treguar atij se ishte qëlluar në orvatje për të ikur nga një autobuz që ishte ndaluar prej UÇK-së.[1238] Kjo nuk përputhet me dëshmitë e dhëna nga Liljana Mitroviqi dhe Sllobodanka Kërstiqi në lidhje me arrestimin e Sllobodan Mitroviqit të cilat u informuan se Sllobodan Mitroviqi po udhëtonte me veturë, jo me autobuz.[1239] Dhoma thekson se rrethanat e përshkruara prej Ivan Bakraqit duket se përputhen me variantin e Prokurorisë në lidhje me arrestimin dhe zhdukjen e Serbolub Miladinoviqit për të cilin Prokuroria pretendon se edhe ai u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1240] Në dëshmi ka paqartësi të dukshme.

348. Pavarësisht nga kjo, në bazë të dëshmive Dhoma është e bindur se Sllobodan Mitroviqi u identifikua si i burgosur në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut. Gjithashtu Dhoma është e bindur se Sllobodan Mitroviqi u mbajt në fllanik prej UÇK-së për një kohë të papërcaktuar duke filluar më 24 qershor 1998. Dhoma gjykon se Sllobodan Mitroviqi nuk merrte pjesë aktive në luftimet gjatë asaj kohe.

349. Ashtu siç është shtjelluar prej Dhomës, kushtet në fllanik në periudhën përkatëse ishin të tilla që përbënin veprën penale të trajtimit mizor. Veç kësaj nuk ka prova se Sllobodan Mitroviqi iu nënshtrua torturave ose keqtrajtimit të drejtpërdrejtë në Llapushnik.

350. Prokuroria akuzon se Sllobodan Mitroviqi u vra në kamp-burgun e Llapushnikut dikur midis 24 qershorit 1998 dhe 26 korrikut 1998.[1241] Prokuroria i kërkon Dhomës të zbatojë faktorët e parashtruar në *Prokurorja kundër Kërnojelacit* në lidhje me dëshmitë që ka. Që prej zhdukjes së

[1234] L07, T 829; Prova Materiale P54.
[1235] Vojko Bakraç, T 1311-1314.
[1236] Provat Materiale P244/245, nënndarje7 dhe nënndarje 17.
[1237] Ivan Bakraç, T 1449; Prova Materiale P54.
[1238] Ivan Bakraç, T 1444-1449; Prova Materiale P54.
[1239] Liljana Mitroviq, T 1596-1599. Prova Materiale P187.
[1240] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 220; L96, T 2342.
[1241] Aktakuzë, paragrafi 30.

Sllobodan Mitroviqit kanë kaluar disa vjet dhe gjatë kësaj kohe ai nuk ka kontaktuar as familjen e tij, as të tjerë. Gjithashtu Dhoma ka prova të zhdukjes së burgosurve të tjerë në Llapushnik. Gruaja e Sllobodan Mitroviqit dëgjoi prej një personi që pretendonte se e kishte parë Sllobodan Mitroviqin, por siç duket ky ishte trillim.[1242] Liljana Mitroviqi dëshmoi para Dhomës se ajo nuk e kishte parë të shoqin që prej zhdukjes së tij dhe ishte e bindur se ai është vrarë.[1243] Dhoma nuk ka dyshim se Liljana Mitroviqi dëshmoi të vërtetën. Mirëpo dëshmia e saj nuk ofron qartësi të mjaftueshme për rrethanat e vdekjes së mundshme të burrit të saj për të vërtetuar elementët e veprës penale të vrasjes.

351. Dhoma gjykon se në lidhje me Sllobodan Mitroviqin nuk janë provuar elementet e veprës penale të torturës (Pika 4). Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Sllobodan Mitroviqin janë provuar elementët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6). Dhoma gjykon se në lidhje me Sllobodan Mitroviqin nuk janë vërtetuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 8).

(xii) Mirosllav Shuliniq

352. Më 21 maj 1998, Mirosllav Shuliniqi, serb etnik po kthehej nga Dobërdolli për në Vide kur ai u zhduk.[1244] Vëllai i Mirosllav Shuliniqit, Jeremija Shuliniqi mori informacion prej MPB-së se më 21 maj 1998 Mirosllav Shuliniqi kishte kaluar postbllokun e MPB-së në Komoran drejt Llapushnikut. Thuhet se po atë ditë makina e tij ishte parë nga tre gazetarë në Llapushnik.[1245]

353. Në një shënim që hetuesit i treguan Jeremija Shuliniqit dhe i cili i është bashkëngjitur deklaratës së tij me shkrim shkruhet: "Jam Mirosllav Shuliniqi lindur më 8 qershor 1996 /si në origjinal/. Profesioni punëtor. Kapur nga UÇK-ja në Llaposhnik /si në origjinal/ 21 maj 1998."[1246] Jeremija Shuliniqi deklaroi se ai njohu shkrimin e Mirosllav Shuliniqit.[1247]

354. Prokuroria ka thirrur vetëm një dëshmitar gojor i cili mund të dëshmonte për praninë e Mirosllav Shuliniqit në Llapushnik.[1248] Kur iu tregua një fotografi e Mirosllav Shuliniqit, Ivan Bakraçi deklaroi se ai e njohu atë si personin i cili "buzëqeshte gjithmonë" dhe i cili kishte udhëtuar

[1242] Liljana Mitroviq, T 1611.
[1243] Liljana Mitroviq, T 1612-1613.
[1244] Prova Materiale P194.
[1245] Prova Materiale P194.
[1246] Prova Materiale P194.
[1247] Prova Materiale P194.
[1248] Ivan Bakraç, T 1469.

me Milovan Kërstiqin në një Volkswagen Golf me ngjyrë në të kaltër të errët.[1249] Mirëpo sipas deklaratës me shkrim të Jeremija Shuliniqit, Mirosllav Shuliniqi nuk ishte me Milovan Kërstiqin kur u arrestua; sipas Jeremija Shuliniqit Mirosllav Shuliniqi udhëtoi vetëm për në Dobërdoll për të mbaruar ca punë.[1250] Gjithashtu Jeremija Shuliniqi deklaroi se Mirosllav Shuliniqi udhëtonte me një Toyota Corolla dhe jo me Volkswagen Golf.[1251] Më vonë gjatë dëshmisë së tij Ivan Bakraçit iu tregua një fotografi e Mirosllav Shuliniqit dhe u pyet nëse e njihte atë si njëri prej personave me të cilët Ivan Bakraçi foli kur po pyeste për vendndodhjen dhe shëndetin e Stamen Genovit.[1252] Ivan Bakraçi pranoi se Mirosllav Shuliniqi ishte njëri prej personave me të cilin ai kishte folur.[1253]

355. Dhoma është e bindur se Ivan Bakraçi dëshmoi të vërtetën. Mirëpo kujtesa e tij lidhur me rrethanat e arrestimit të Mirosllav Shuliniqit nuk përputhet me deklaratën me shkrim te Jeremija Shuliniqit lidhur me arrestimin e Mirosllav Shuliniqit. Dhoma nuk ka bazë të mjaftueshme për të përcaktuar se si u arrestua Mirosllav Shuliniqi. Rrjedhimisht ka mundësi që Ivan Bakraçi ta ketë identifikuar gabimisht Mirosllav Shuliniqin. Asnjë dëshmitar tjetër gojor i thirrur prej Prokurorisë nuk ka dëshmuar për praninë e Mirosllav Shuliniqit në kamp-burgun e Llapushnikut. Për më tepër nuk dihet se prej kujt erdhi deklarata me shkrim e supozuar e Mirosllav Shuliniqit që u identifikua si e tillë prej Jeremia Shuliniqit. Rrjedhimisht Dhoma mbetet me dyshimin nëse Mirosllav Shuliniqi është mbajtur në kamp-burgun e Llapushnikut.

356. Si pasojë Dhoma gjykon se në lidhje me Mirosllav Shuliniqin nuk janë provuar elementët e veprës penale të torturës (Pika 4), trajtimit mizor (Pika 6), vrasjes (Pika 8).

(xiii) Zhivorad Kërstiq

357. Sipas deklaratave me shkrim të Snezhana Simonoviqit dhe Stojan Stojanoviqit, Zhivorad Kërstiqi, serb etnik, u mor prej një autobusi më 25 qershor 1998 kur po kthehej nga Prizreni në Prishtinë pasi kishte qenë në një ceremoni përkujtimore për vëllanë e tij.[1254] Stojan Stojanoviqi dëgjoi nga nipi i Zhivorad Kërstiqit se Zhivorad Kërstiqi ishte nxjerrë prej autobusit në Carralevë.[1255] Sipas Stojan Stojanoviqit, autobusi u ndalua prej ushtarëve të cilët u paraqitën si

[1249] Ivan Bakraç, T 1449.
[1250] Prova Materiale P194.
[1251] Prova Materiale P194.
[1252] Ivan Bakraç, T 1469.
[1253] Ivan Bakraç, T 1469.
[1254] Prova Materiale P192; Prova Materiale P193.
[1255] Prova Materiale P193.

anëtarë të UÇK-së.[1256] Në autobus u gjetën çanta dhe dokumente identifikimi të Zhivorad Kërstiqit.[1257] Zhivorad Kërstiqi u rrëmbye me dy serbë të tjerë të paidentifikuar.[1258]

358. Kunati i Zhivorad Kërstiqit deklaroi se ai takoi dy njerëz të cilët ishin liruar prej Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.[1259] Kur iu tregua fotografia e Zhivorad Kërstiqit, të dy personat e njohën atë si i mbajtur në një kamp burgimi bashkë me ta.[1260] Në deklaratën me shkrim nuk jepen të qarta identitetet e dy personave, por përshkrimet dhe rrethanat e tyre përputhen me Bakraçët. Në një deklaratë me shkrim Snezhana Simonoviq, vajza e Zhivorad Kërstiqit, shënoi se në tetor 1998 ajo u informua prej një individi se të burgosurit e një kampi diku afër Suharekës i kishin treguar se në kamp ishte një burrë që quhej Kërstiq, i cili ishte nga Prishtina, kishte tri vajza dhe ishte shëndetlig.[1261] Zhivorad Kërstiqi kishte tri vajza.[1262] Vojko Bakraçi deklaroi se në fllanikun në kamp-burgun e Llapushnikut mbahej edhe një plak i sëmurë.[1263] Ai dëshmoi se plaku i sëmurë kishte diabet[1264] dhe pak para se të arrestohej kishte bërë operacion në sy.[1265] Vojko Bakraçi e identifikoi Zhivorad Kërstiqin në fotografi si të burgosur në fllanik.[1266] Vojko Bakraçi deklaroi se plaku ishte i vetmi i burgosur me flokë të thinjur.[1267] Deklarata me shkrim e Snezhana Simonoviqit konfirmoi se Zhivorad Kërstiqi kishte bërë operacion në sy afërsisht një muaj para arrestimit të tij.[1268] Gjithashtu në deklaratën e saj Snezhana Simonoviqi deklaroi se Zhivorad Kërstiqi merrte ilaçe për diabet në kohën e arrestimit.[1269]

359. Dhoma pranon se Zhivorad Kërstiqi u mbajt prej UÇK-së në fllanik në Llapushnik për një kohë të papërcaktuar që prej 25 qershorit 1998. Dhoma pranon se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime në atë kohë. Dhoma gjykon se Zhivorad Kërstiqi iu nënshtrua trajtimit mizor për shkak të kushteve të përgjithshme të burgimit në fllanik. Dhoma ka pranuar se këto kushte ishin të tilla që burgimi në fllanik përbënte veprën penale të trajtimit mizor. Veçanërisht Dhoma merr parasysh moshën dhe gjendjen shëndetësore të Zhivorad Kërstiqit në kohën e burgimit të tij. Ai ishte ligsht,

[1256] Prova Materiale P193.
[1257] Prova Materiale P193. Prova Materiale P192.
[1258] Prova Materiale P192.
[1259] Prova Materiale P193.
[1260] Prova Materiale P193.
[1261] Prova Materiale P192.
[1262] Prova Materiale P193.
[1263] Vojko Bakraç, T 1311-1314.
[1264] Vojko Bakraç, T 1312-1313.
[1265] Vojko Bakraç, T 1312.
[1266] Vojko Bakraç, T 1314-1317; Prova Materiale P54.
[1267] Vojko Bakraç, T 1314-1317.
[1268] Prova Materiale P192.
[1269] Prova Materiale P192.

vuante prej diabetit, dhe po shërohej prej operacionit në sy në kohën kur u arrestua. Nuk ka prova se Zhivorad Kërstiqi iu nënshtrua torturave në kamp-burgun e Llapushnikut.

360. Prokuroria akuzon se Zhivorad Kërstiqi u vra midis 24 qershorit 1998 dhe 26 korrikut 1998 në kamp-burgun e Llapushnikut.[1270] Përsëri Prokuroria mbështetet mbi prova të tërthorta dhe e fton Dhomën të marrë parasysh faktorët në *Prokurorja kundër Kërnojelacit.*

361. Nuk ka prova për keqtrajtimin e drejtpërdrejtë të Zhivorad Kërstiqit në kamp-burgun e Llapushnikut. Që prej zhdukjes së tij Zhivorad Kërstiqi nuk ka kontaktuar as miqtë dhe as familjen. Snezhana Simonoviq deklaroi se ajo u informua se Zhivorad Kërstiqi ishte gjallë në tetor 1998. Në deklaratën e tij me shkrim, Stojan Stojanoviqi deklaroi se Boshko Buha i kishte thënë dikur në 1999 se Zhivorad Kërstiqi kishte vdekur.[1271] Boshko Buja nuk mund t'i tregonte Stojan Stojanoviqit për kohën dhe rrethanat e sakta të vdekjes së Zhivorad Kërstiqit.[1272] Gjithsesi Boshko Buha i tha Stojan Stojanoviqit se Zhivorad Kërstiqi kishte vdekur "ca kohë më parë".[1273] Stojan Stojanoviqi tha gjithashtu se edhe nipave të Zhivorad Kërstiqit të cilët po përpiqeshin të siguronin lirimin e tij, u ishte thënë se ai kishte vdekur.[1274] Ndërkohë që këto dëshmi të dorës së dytë nuk mund të provojnë vdekjen e Zhivorad Kërstiqit, ato nuk ofrojnë asnjë arsye për të besuar se ai mund të jetë ende gjallë. Mirëpo në bazë të dëshmive Dhoma gjykon se nuk mund të arrijë me qartësi të mjaftueshme në përfundimin se Zhivorad Kërstiqi është i vdekur.

362. Po të pranohet për momentin se Zhivorad Kërstiqi vdiq në kamp-burg, dy përfundime të mundshme do të mbështetnin akuzën e vrasjes, përkatësisht se ai u vra qëllimisht prej një individi ose individëve, ose ai vdiq për shkak se trajtimi mjekësor nuk iu dha qëllimisht. Dhoma ka prova të pamjaftueshme në mbështetje të supozimit të parë. Me provat që ka Dhoma nuk është provuar elementi i synimit që do të mbështeste supozimin e dytë. Në këto rrethana nuk është provuar vepra penale e vrasjes në lidhje me Zhivorad Kërstiqin.

363. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se në lidhje me Zhivorad Kërstiqin nuk janë provuar elementët e veprës penale të torturës (Pika 4). Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Zhivorad Kërstiqin janë provuar elementët e veprës

[1270] Aktakuzë, paragrafi 30.
[1271] Prova Materiale P193.
[1272] Prova Materiale P193.
[1273] Prova Materiale P193.
[1274] Prova Materiale P193.

penale të trajtimit mizor (Pika 6). Dhoma gjykon se Prokuroria nuk ka vërtetuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 8) në lidhje me Zhivorad Kërstiqin.

(xiv) Stamen Genov

364. Vojko dhe Ivan Bakraçi dëshmuan se Stamen Genovi, serb etnik dhe anëtar i personelit mjekësor të UJ-së, u mor prej anëtarëve të UÇK-së prej një autobusi që udhëtonte nga Gjakova në Beograd më 29 qershor 1998, bashkë me Vojko Bakraçin, Ivan Bakraçin dhe Gjorgje Çukun.[1275] Stamen Genovi ishte i veshur civil por mbante një armë zjarri në çantën e tij.[1276] Pasi u urdhëruan të zbrisnin prej autobusit, Stamen Genovi dhe Gjorgje Çuku u morën me një automjet të kaltër.[1277] Automjeti u kthye shpejt dhe mori Vojko dhe Ivan Bakraçin. Pastaj ata u çuan me automjet në një shkollë fshati.[1278] Kur Vojko dhe Ivan Bakraçi arritën, Stamen Genovi ishte në fund të dhomës.[1279] Afërsisht pas një ore, ushtarët e UÇK-së filluan ta rrihnin Stamen Genovin.[1280] Keqtrajtimi u shtua pasi u zbulua letërnjoftimi ushtarak i Stamen Genovit; ai u rrah deri sa ra nata dhe në një moment humbi vetëdijen.[1281] Pastaj e lidhën dhe e vendosën në një kombi së bashku me Gjorgje Çukun dhe Bakraçët.[1282] Vojko dhe Ivan Bakraçi dëshmuan se ata udhëtuan në kombi bashkë me Stamen Genovin dhe Gjorgje Çukun afërsisht një orë para se të hynin në një oborr që e identifikuan si kamp-burgun e Llapushnikut.[1283] Më pas Vojko dhe Ivan Bakraç, Stamen Genovi dhe Gjorgje Çuku u çuan në një dhomë në katin përdhes në shtëpinë kryesore të oborrit.[1284]

365. Stamen Genovi filloi të keqtrajtohej sërish egërsisht menjëherë pasi kishte mbërritur në kamp-burgun e Llapushnikut.[1285] Ivan dhe Vojko Bakraçi, Stamen Genovi dhe Gjorgje Çuku ishin afërsisht një orë e gjysëm në dhomën në shtëpinë kryesore.[1286] Gjatë kësaj kohe Stamen Genovi u godit me kondakë pushkësh dhe u shkelmua. Ushtarët e UÇK-së që rrihnin Stamen Genovin e quanin "polic serb" dhe deklaruan se shqiptarët e Kosovës nën sundimin serb ishin të detyruar të duronin po atë keqtrajtim që po ushtrohej kundër Stamen Genovit.[1287] Kur po e rrihnin, Stamen

[1275] Vojko Bakraç, T 1291-1294; Ivan Bakraç, T 1395-1401.
[1276] Vojko Bakraç, T 1296.
[1277] Vojko Bakraç, T 1294.
[1278] Vojko Bakraç, T 1298.
[1279] Ivan Bakraç, T 1405-1406.
[1280] Ivan Bakraç, T 1407.
[1281] Vojko Bakraç, T 1299; Ivan Bakraç, T 1407-1408.
[1282] Vojko Bakraç, T 1304-1305; 1299-1302.
[1283] Ivan Bakraç, T 1410-1412; Vojko Bakraç, T 1305; Provat Materiale P5 dhe P6.
[1284] Vojko Bakraç, T 1305-1306; Prova Materiale P5-A1; Ivan Bakraç, T 1410-1413; Prova Materiale P6-A8.
[1285] Ivan Bakraç, T 1428.
[1286] Ivan Bakraç, T 1428.
[1287] Ivan Bakraç, T 1428.

Genovin e pyetën sa njerëz kishte vrarë si anëtar i UJ-së.[1288] Në një moment të rrahurat u ndaluan kur një thikë u drejtua drejt organeve seksuale të Stamen Genovit.[1289] Rrahjet ndaluan pasi Stamen Genovi u dëmtua rëndë dhe duhej të mbartej.[1290] Pastaj Stamen Genovi u vendos në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut bashkë me Bakraçët.[1291] Ivan Bakraçi përshkroi gjendjen e rëndë fizike të Stamen Genovit prej rrahjeve. Ai nuk ishte në gjendje të lëvizte atje rrotull dhe mund të ketë pasur gjymtyrët e thyera.[1292] Vojko Bakraçi deklaroi se Stamen Genovi rrihej çdo ditë; atë e nxirrnin nga fllaniku individë me kapuçë në kokë dhe e kthenin pas rrahjeve. Shumë herë pas këtyre rrahjeve Stamen Genovi ishte gjysëm i alivanosur, një herë ishte pa vetëdije.[1293] Një natë ishte në gjendje kaq të dëshpëruar fizike dhe psikologjike saqë u kërkoi Ivan Bakraçit dhe Vojko Bakraçit t'a mbysnin.[1294] Duket se ai përzgjidhej rregullisht për trajtim veçanërisht të dhunshëm.[1295]

366. Stamen Genovi ishte anëtar i personelit mjekësor të UJ-së. Dhoma pranon dëshmitë e Ivan dhe Vojko Bakraçit se Stamen Genovi u rrah shtazërisht shpeshherë megjithëse nuk mund të provohet identiteti i kryesve. Dhoma gjykon se kapësit e Stamen Genovit ushtruan keqtrajtim fizik dhe psikologjik ndaj tij me synim për t'a ndëshkuar, hetuar dhe frikësuar. Rrjedhimisht Dhoma nxjerr përfundimin se ndaj Stamen Genovit u ushtruan akte torture. Keqtrajtimi i Stamen Genovit u shtua kur kapësit e tij zbuluan letërnjoftimin e tij ushtarak.[1296] Dhoma gjykon se ai u ndëshkua dhe u mor në pyetje për shkak të përkatësisë së tij ushtarake. Prej dëshmive gjithashtu del se në Llapushnik pasi UÇK-ja u largua prej andej, u gjet një deklaratë e nënshkruar prej Stamen Genovit në të cilën jepeshin hollësi të strukturave dhe personelit të UJ-së në Kosovë.[1297] Dhoma gjykon se në bazë të rrethanave, ky informacion u nxor me anë të kërcënimeve dhe ushtrimit të dhunës.

367. Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Stamen Genovi u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut prej UÇK-së për një kohë të papërcaktuar duke filluar prej 29 qershorit 1998 deri në një datë të panjohur para 25 ose 26 korrikut 1998. Rrjedhimisht ai nuk merrte pjesë aktive në luftime në atë kohë. Dhoma tashmë ka përcaktuar se kushtet në fllanik ishin të tilla që burgimi atje përbënte veprën penale të trajtimit mizor. Gjatë mbajtjes së tij në fllanik Stamen Genovi iu nënshtrua dhunës së skajshme dhe keqtrajtimit shtazarak prej personave të panjohur.

[1288] Vojko Bakraç, T 1307-1308.
[1289] Vojko Bakraç, T 1309.
[1290] Vojko Bakraç, T 1311.
[1291] Ivan Bakraç, T 1441; T 1442; Vojko Bakraç, T 1311.
[1292] Ivan Bakraç, T 1450.
[1293] Vojko Bakraç, T 1332-1333.
[1294] Vojko Bakraç, T 1333; Ivan Bakraç, T 1458.
[1295] Ivan Bakraç, T 1457.
[1296] Vojko Bakraç, T 1301; Ivan Bakraç, T 1407-1408.
[1297] Prova Materiale P182; Provat Materiale P244/245. nënndarje 1a.

368. Prokuroria akuzon se Stamen Genovi u vra dikur midis 24 qershorit 1998 dhe 26 korrikut 1998 në kamp-burgun e Llapushnikut.[1298] Në Dosjen e vetë Përfundimtare, Prokuroria sugjeron se "duket se Stamen Genovi u vra me armë zjarri, megjithëse provat mbështesin sigurisht edhe supozimin se ai mund të ketë vdekur prej rrahjeve të egra dhe përsëritura…"[1299] Nuk ekzistojnë prova mjeko-ligjore për vdekjen e Stamen Genovit. Prokuroria e fton Dhomën të mbështetet mbi provat rrethanore për të provuar elementët e veprës penale të vrasjes. Dhoma do t'i mbajë parasysh faktorët e përmendur në *Prokurorja kundër Kërnojelacit.*

369. Bakraçët të cilët ishin në të njëjtën dhomë me Stamen Genovin për më të shumtën e kohës gjatë së cilës ky i fundit u rrah, më në fund u hoqën prej fllanikut në kamp-burgun e Llapushnikut. Vojko Bakraçi dëshmoi se një natë ai dëgjoi të shtëna dhe nga kjo supozoi se ishte ekzekutuar Stamen Genovi.[1300] Mirëpo ai dëshmoi edhe se kishte dëgjuar nga të tjerët se Stamen Genovi mund të ishte liruar.[1301] Kur më në fund Bakraçët u liruan, Vojko Bakraçi kërkoi dokumentet e identifikimit që ishin në kuletën e Stamen Genovit.[1302] Kuleta e Stamen Genovit ishte ende atje. Në bazë të kësaj ai mendoi se Stamen Genovi ishte vrarë sepse të liruave ua kthenin gjësendet e tyre personale.[1303]

370. Gjithsesi dëshmitë në lidhje me vrasjen e pretenduar të Stamen Genovit janë të paqarta. Dëshmitë e Ivan dhe Vojko Bakraçit përmbajnë disa kundërthënie. Sipas Ivan Bakraçit, kur ai vizitoi bodrumin, duke shkuar atje iu tha se Stamen Genovi ishte liruar.[1304] Gjithashtu, Vasil Dimitrovi, kushëriri i Stamen Genovit, tha në një deklaratë me shkrim se Ivan Bakraçi e kishte informuar se një herë ai kishte kaluar pranë bodrumit për të verifikuar nëse Stamen Genovi ishte ende gjallë dhe se ai foli me vetë Stamen Genovin.[1305] Mirëpo kjo nuk konfirmohet prej dëshmisë së Ivan Bakraçit.

371. Më tej, sipas deklaratës me shkrim të Vasil Dimitrovit ai u informua prej disa burimeve se Stamen Genovi është ende gjallë. Sipas deklaratës me shkrim të Vasil Dimitrovit më 27 gusht 2001,

[1298] Aktakuzë, paragrafi 30.
[1299] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 459.
[1300] Vojko Bakraç, T 1344-1345.
[1301] Vojko Bakraç, T 1343.
[1302] Vojko Bakraç, T 1348-1349.
[1303] Vojko Bakraç, T 1349.
[1304] Ivan Bakraç, T 1468.
[1305] Prova Materiale P182, paragrafi 13.

nëna e Stamen Genovit deklaroi se ajo kishte patur një thirrje telefonike prej djalit të saj.[1306] Vasil Dimitrovi përpiqet të ngrejë pikëpyetje nëse ishte Stamen Genovi në telefon, por nuk ofron arsye për mosbesimin e tij ndaj nënës së Stamen Genovit.[1307] Në deklaratën e Vasil Dimitrovit shënohet se ai u informua prej Jovica Kostovit se Rehbexhej Rexhi /në origjinal Rehbedžej Redži/ e kishte parë Stamen Genovin të gjallë në një kamp burgimi diku afër Tetovës në Maqedoni në vjeshtën e 2002.[1308] Gjithashtu Jovica Kostovi e informoi Vasil Dimitrovin se Mirjana Mitroviqi e kishte parë Stamen Genovin të gjallë në kampin e Tetovës në 2002.[1309] Kufoma e Stamen Genovit nuk është gjetur.

372. Dëshmitë janë të tilla që Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundime konfirmuese në lidhje me vërtetësinë e thirrjes telefonike për nënën e Stamen Genovit, apo vërtetësinë e deklarimit se ishte prej Stamen Genovit. Veç kësaj, nuk ka dëshmi për kontakte të pretenduara apo të identifikuara të Stamen Genovit me miqtë ose familjen e tij që prej momentit kur ai u zbrit prej autobusit. Dhoma nuk u jep shumë rëndësi raporteve të tjera të dorës së dytë dhe të pavërtetuara në lidhje me vendndodhjen e tij. Gjatë mbajtjes së tij në kamp-burgun e Llapushnikut ai iu nënshtrua një keqtrajtimi veçanërisht të egër. Duke ndjekur këtë logjikë, rrethanat e trajtimit të tij sugjerojnë pamundësinë e lirmit të tij. Dhoma pranon se sulmuesit e Stamen Genovit të paktën kishin si synim t'i shkaktonin dëmtim trupor shumë të rëndë me dijeninë e arsyeshme se veprimet e tyre kishin të ngjarë të shkaktonin vdekjen e tij. Gjithsesi, sidomos për shkak të, me sa duket, thirrjes telefonike të nënës së Stamen Genovit, Dhoma ka mbetur me një ndjenjë paqartësie për vdekjen e tij. Rrjedhimisht nuk mund të nxirren përfundime në lidhje me faktin dhe rrethanat e vdekjes së tij.

373. Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Stamen Genovin janë provuar elementet e veprës penale të torturës (Pika 4), dhe elementët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6). Dhoma gjykon se Prokuroria nuk ka vërtetuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 8) në lidhje me Stamen Genovin.

(xv) Gjorgje Çuk

374. Gjorgje Çuk ishte refugjat serb me prejardhje nga rajoni i Krajinës në Kroaci.[1310] Vojko dhe Ivan Bakraçi dëshmuan se më 29 qershor 1998, Gjorgje Çuku po udhëtonte me autobus nga

[1306] Prova Materiale P182, paragrafi 17.
[1307] Prova Materiale P182, paragrafi 17.
[1308] Prova Materiale P182, paragrafi 18.
[1309] Prova Materiale P182, paragrafi 18.
[1310] Prova Materiale P181, paragrafi 5.

Gjakova në Beograd.[1311] Ai u nxor nga autobusi bashkë me Stamen Genovin, Ivan Bakraçin dhe Vojko Bakraçin.[1312] Pasi u urdhëruan të zbrisnin prej autobusit, Stamen Genovi dhe Gjorgje Çuku u morën prej aty me një automjet të kaltër.[1313] Automjeti u kthye, mori Vojko dhe Ivan Bakraçin dhe i çoi në të njëjtin drejtim, në një shkollë fshati.[1314] Kur arritën Bakraçët, ata deklaruan se Gjorgje Çuku po e përplaste kokën pas murit, si duket në mënyrë të pavullnetshme.[1315] Gjorgje Çuku u lidh dhe u vendos në një kombi së bashku me Stamen Genovin dhe u çua në oborrin që Bakraçët e identifikuan si kamp-burgu i Llapushnikut. Pasi arritën në kamp-burgun e Llapushnikut, rifilluan rrahjet ndaj Gjorgje Çukut. Identiteti i sulmuesve është i panjohur. Ndërkohë që rrahja e tij ishte në të vërtetë e egër, siç u përmend më lart, objektivi parësor i dhunës ishte Stamen Genovi.[1316] Pastaj katër të ndaluarit u çuan në fllanik.[1317] Në dëshminë e tij para Dhomës Vojko Bakraçi nuk mbante mend raste konkrete të rrahjes së Gjorgje Çukut në fllanik.[1318] Pas braktisjes së kamp-burgut të Llapushnikut nga UÇK-ja, atje u gjetën dokumente që si duket ishin të Gjorgje Çukut.[1319] Të burgosurit e tjerë e identifikuan Gjorgje Çukun si të mbajtur në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut.[1320]

375. Nuk ka prova që ta çojnë Dhomën në përfundimin se rrahjet ndaj Gjorgje Çukut përbënin torturë. Nuk është treguar se rrahjet e Gjorgje Çukut ishin me një synim të caktuar. Rrjedhimisht nuk është provuar se ndaj Gjorgje Çukut është kryer krimi i torturës në kamp-burgun e Llapushnikut.

376. Dhoma gjykon se Gjorgje Çuku u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut prej UÇK-së për një kohë të papërcaktuar duke filluar prej 29 qershorit 1998 deri jo më vonë se 25 ose 26 korrik 1998. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime në atë kohë. Dhoma gjykon se Gjorgje Çuk iu nënshtrua trajtimit mizor si pasojë e kushteve në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut ku u mbajt, dhe rrahjeve ushtruar ndaj tij. Dhoma ka përcaktuar se kushtet në fllanik ishin të tilla që burgimi në këto kushte përbënte veprën penale të trajtimit mizor.

[1311] Prova Materiale P181, paragrafi 3; Vojko Bakraç, T 1291-1294.
[1312] Ivan Bakraç, T 1401; Vojko Bakraç, T 1294.
[1313] Vojko Bakraç, T 1294.
[1314] Vojko Bakraç, T 1298.
[1315] Vojko Bakraç, T 1299; Ivan Bakraç, T 1405.
[1316] Vojko Bakraç, T 1304-1307.
[1317] Ivan Bakraç, T 1441.
[1318] Vojko Bakraç, T 1428; T 1374.
[1319] Prova Materiale P244/245. nënndarje 17.
[1320] L06, T 1042; L07, T 823.

377. Prokuroria akuzon se Gjorgje Çuku u vra dikur midis 24 qershorit 1998 dhe 26 korrikut 1998 në kamp-burgun e Llapushnikut.[1321] Ashtu si sapo u përmend, Dhoma ka pranuar se Gjorgje Çuku u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut. Gjorgje Çuku u pa për herë të fundit në kamp. Veçanërisht i rëndësishëm është fakti se që prej rrëmbimit dhe zhdukjes së tij ai nuk ka kontaktuar me familjen prej shtatë vjetësh. Vëllai i Gjorgje Çukut nuk dëgjoi kurrë thashetheme se Gjorgje Çuku ishte ende gjallë.[1322] Në dallim me disa të burgosur të tjerë, nuk ka asnjë bazë prej dëshmive për hamendjen se ai është ende gjallë. Mirëpo asnjë prej dëshmitarëve të thirrur nuk ka dëshmuar për vdekjen e tij, dhe nuk ka prova mjeko-ligjore që konfirmojnë vdekjen e tij ose shkakun e vdekjes. Dhoma pranon se ai nuk ishte midis të burgosurve të mbetur të cilët u detyruan të ecnin prej kamp-burgut në malet e afërta të Berishës prej rojeve të UÇK-së më 25 ose 26 korrik 1998 ndërkohë që forcat serbe përparuan drejt Llapushnikut.

378. Dhoma ka prova të rrahjes së Gjorgje Çukut në kamp-burgun e Llapushnikut pas ardhjes së tij atje[1323] dhe ka dijeni për rastet e dhunës së ushtruar ndaj disa të burosurve. Mirëpo nuk ka dëshmi konkrete në lidhje me gjendjen e rëndë apo rrethanat e mbajtjes së Gjorgje Çukut; ndërkohë është provuar se Gjorgje Çuku iu nënshtrua trajtimit mizor për shkak të mbajtjes së tij në fllanik, nuk dihet asgjë mbi raste të tjera të caktuara të keqtrajtimit të tij gjatë mbajtjes atje. Dhoma mbetet disi e paqartë prej provave, dhe mendon se nuk mund të nxirret asnjë përfundim faktik për vdekjen e Gjorgje Çukut. Rrjedhimisht Dhomës i duhet të nxjerrë përfundimin se në lidhje me Gjorgje Çukun nuk janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes.

379. Dhoma gjykon se në lidhje me Gjorgje Çukun nuk janë provuar elementet e veprës penale të torturës (Pika 4). Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Gjorgje Çukun janë provuar elementët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6). Dhoma gjykon se në lidhje me Gjorgje Çukun nuk janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 8).

(xvi) Sinisha Bllagojeviq

380. Sipas vëllait të Sinisha Bllagojeviqit, Lubisha Bllagojeviq, Sinisha Bllagojeviqi u rrëmbye prej UÇK-së në qershor 1998. Në një deklaratë me shkrim, Lubisha Bllagojeviqi deklaroi se apartamenti i Sinisha Bllagojeviqit në Vërshec u plaçkit pak ditë para zhdukjes së tij më 24 qershor

[1321] Aktakuzë, paragrafi 30.
[1322] Prova Materiale P181, paragrafi 7.
[1323] Vojko Bakraç, T 1307.

1998.[1324] Lubisha Bllagojeviqi mendon se u plaçkit prej UÇK-së.[1325] Në ditën e zhdukjes së Sinisha Bllagojeviqit, në Vërshec me sa duket ishte një postbllok i UÇK-së.[1326] Askush prej dëshmitarëve nuk mundi ta identifikonte Sinisha Bllagojeviqin si të burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut. Rrjedhimisht Prokuroria nuk ka mundur të vërtetojë se Sinisha Bllagojeviqi është mbajtur në kamp-burgun e Llapushnikut.

381. Në Aktakuzë deklarohet se Sinisha Bllagojeviqi u vra në kamp-burgun e Llapushnikut midis 24 qershorit dhe 26 korrikut 1998.[1327] Mirëpo në Dosjen e vetë Përfundimtare Prokuroria ka pranuar se nuk e ka provuar vrasjen e Sinisha Bllagojeviqit.[1328]

382. Rrjedhimisht Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Sinisha Bllagojeviqin nuk janë provuar elementet e veprës penale të torturës (Pika 4), të trajtimit mizor (Pika 6) dhe të vrasjes (Pika 8).

(xvii) Jefta Petkoviq dhe Zvonko Marinkoviq

383. Sipas deklaratës me shkrim të Zvezden Marinkoviqit, Jefta Petkoviqi dhe Zvonko Marinkoviqi, dy serbë prej Suharekës, po udhëtonin me makinë prej Beogradit për në Suharekë më 24 qershor 1998.[1329] Ata po vozitnin kamionin e firmës "Balkan Belt".[1330] Të nesërmen, pasdite, ata u zhdukën diku midis qyteteve Aleksandrovac dhe Suharekë.[1331] Djali i Jefta Petkoviqit, Bogolub Petkoviqi tha në deklaratën e tij me shkrim, e pranuar si provë, se më 27 ose 28 qershor 1998 ai kontaktoi kryetarin e LDK-së në Suharekë, i cili kontaktoi organizata të ndryshme për të gjetur çfarë kishte ndodhur me dy të zhdukurit.[1332] Në deklaratën me shkrim të Bogolub Petkoviqit është shënuar se të nesërmen, kryetari i LDK-së në Suharekë kontaktoi Bogolub Petkoviqin dhe e informoi se Jefta Petkoviqi dhe Zvonko Marinkoviqi ishin rrëmbyer prej UÇK-së në Carralevë më 24 qershor 1998, afërsisht në orën 16:00.[1333]

[1324] Prova Materiale P177, paragrafi 4.
[1325] Prova Materiale P177, paragrafi 4.
[1326] Prova Materiale P177, paragrafi 7.
[1327] Aktakuzë, paragrafi 30.
[1328] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 464.
[1329] Prova Materiale P189, paragrafët 4-6.
[1330] Prova Materiale P191, paragrafi 3; Prova Materiale P189, paragrafi 4.
[1331] Prova Materiale P191, paragrafët 4-5.
[1332] Prova Materiale P191, paragrafi 8.
[1333] Prova Materiale P191, paragrafi 9.

384. Dhoma pranon dëshminë se Jefta Petkoviqi u mbajt prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, ai u njoh prej L04-ës në fotografi si serb nga Suhareka i cili mbahej në ahur.[1334] L04 nuk mundi ta identifikonte me emër. Dhoma gjykon se ai u mbajt prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut për një kohë të papërcaktuar duke filluar afërsisht më 24 qershor 1998 deri në vdekjen e tij në një datë para mesit të korrikut 1998. Dhoma është e bindur se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime në atë kohë. Ashtu si ka konkluduar Dhoma, kushtet në ahur ishin të tilla që mbajtja atje ishte e mjaftueshme për t'u konsideruar si vepër penale e trajtimit mizor. Nuk ka prova konkrete për keqtrajtimin apo torturimin e Jefta Petkoviqit në Llapushnik.

385. L04 nuk mundi të identifikonte fotografinë e Zvonko Marinkoviqit.[1335] Asnjë i burgosur tjetër nuk e njohu Zvonko Marinkoviqin. Megjithëse kujtesa e L04-ës për një të burgosur përputhet disi me përshkrimin fizik të Zvonko Marinkoviqin, kjo nuk ishte aspak bindëse dhe nuk provon se Zvonko Marinkoviqi u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.

386. Prokuroria akuzon se Jefta Petkoviqi dhe Zvonko Marinkoviqi u vranë dikur në mes të korrikut 1998 në kamp-burgun e Llapushnikut.[1336] Ka prova mjeko-ligjore për vdekjen e Zvonko Marinkoviqit dhe prova mjeko-ligjore të vdekjes së Jefta Petkoviqit me sa duket për ekzekutim. Kufoma e Jefta Petkoviqit u zbulua në një vendvarrim dytësor në një pyll në komunën e Shtimes, afër fshatit Rancë,[1337] që ndodhet në juglindje të Llapushnikut, përtej Carralevës. Provat mjeko-ligjore treguan se ai kishte vdekur prej një plage plumbi në kokë.[1338] Në afërsi të vendvarrimit dytësor u gjetën gëzhoja dhe plumba.[1339] Analizat e ADN-së prej Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur ("ICMP") konfirmuan identitetin e tij.[1340] Kufoma e Zvonko Marinkoviqit u zbulua në nëntor 2004 në të njëjtin vendvarrim në komunën e Shtimës, afër fshatit Rancë.[1341] Provat e mjekësisë ligjore nuk e përcaktuan shkakun e vdekjes së Zvonko Marinkoviqit.

387. L10 dëshmoi se afërsisht në javën e pestë të burgimit të tij, një person të cilin ai e njihte si Shala erdhi dhe e mori atë nga fllaniku. L10-ës iu mbyllën sytë dhe u vendos në një makinë bashkë me L04-ën dhe një individ tjetër, identitetin e të cilit L10 muk mund ta konfirmonte.[1342] Ata udhëtuan një orë. Pastaj L10-ës, L04-ës dhe individit të panjohur iu kërkua të hapnin një varr ku u

[1334] L04, T 1201.
[1335] L04, T 1201.
[1336] Aktakuzë, paragrafi 31.
[1337] Prova Materiale P111, paragrafi 68.
[1338] Prova Materiale P111, paragrafët 71-72.
[1339] Prova Materiale P111, paragrafi 68.
[1340] Prova Materiale P225.
[1341] Prova Materiale P111.

vendosën tri kufoma.[1343] Kufomat ishin të mavijosura dhe të mbuluara me gjak dhe L10 nuk mundi t'i njihte.[1344]

388. L04 pohoi se ai ishte nxjerrë prej ahurit nga Shala afërsisht më 18 korrik 1998.[1345] Mbi kokë iu hodh një thes dhe ai u çua me makinë në mal bashkë me L10-ën dhe një individ tjetër. Kur arritën, atyre ua hoqën thasët nga koka dhe u urdhëruan të hapnin një varr me kazma.[1346] Atyre iu desh më se një orë për hapjen e gropës.[1347] Pasi mbaruan gërmimin i vunë tri kufomat në gropë. L04 njohu kufomën e Agim Ademit, por jo dy të tjerët.[1348]

389. Edhe L10, edhe L04 nuk ishin të sigurtë për vendndodhjen e saktë të varrimit. Gjatë dëshmisë së tij për varrimin e tri kufomave, që ai tha u bë me urdhër të Shalës, L04 deklaroi se kufomat u varrosën në një vend të veçuar në male, ku ata shkuan me makinë.[1349] L10 deklaroi se ata udhëtuan afërsisht një orë, por ai nuk e di se në çfarë drejtimi udhëtuan.[1350]

390. Prokuroria parashtron se dy prej kufomave të cilët L04 dhe L10 u detyruan të varrosnin ishin Zvonko Marinkoviqi dhe Jefta Petkoviqi.[1351] Mirëpo as L04, dhe as L10 nuk mund t'i identifikonin kufomat që varrosën si Jefta Petkoviqi dhe Zvonko Marinkoviqi. Megjithëse L04 dëshmoi se moshat e kufomave i afroheshin moshave të Zvonko Marinkoviqit dhe Jefta Petkoviqit,[1352] L04 dëshmoi se ai njohu vetëm Agim Ademin midis tri kufomave dhe se ai nuk i njohu dy individët e tjerë të cilët u detyrua t'i varroste.[1353] Veçanërisht, L04 nuk e identifikoi njërën prej kufomave si Jefta Petkoviqin edhe pse L04 e kishte njohur atë në fotografi si i burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut. L10 nuk mundi të identifikonte asnjë prej tri kufomave.[1354]

391. Gjithashtu provat e mjekësisë ligjore nuk e ndihmojnë Dhomën që të përcaktojë nëse dy prej kufomave të varrosura prej L04-ës dhe L10-ës ishin Jefta Petkoviqi dhe Zvonko Marinkoviqi. Kufomat e Zvonko Marinkoviqit dhe Jefta Petkoviqit u zbuluan në një vendvarrim dytësor bashkë

[1342] L10, T 2943.
[1343] L10, T 2944.
[1344] L10, T 2944-2945.
[1345] L04, T 1187-1188.
[1346] L04, T 1188.
[1347] L04, T 1188.
[1348] L04, T 1188-1189.
[1349] L04, T 1188.
[1350] L10, T 2943.
[1351] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafët 465-468.
[1352] L04, T 1191.
[1353] L04, T 1189.

me një kufomë të tretë të paidentifikuar. Provat e mjekësisë ligjore që tregojnë se kufomat e Jefta Petkoviqit dhe Zvonko Marinkoviqit u varrosën fillimisht në një vend të panjohur, krijojnë paqartësi të konsiderueshme në lidhje me rrethanat dhe kohën e vdekjes së tyre. Fakti se kufoma e Agim Ademit, për të cilin L04 deklaroi se ai u detyrua ta varroste bashkë me dy kufomat e tjera, nuk u identifikua në të njëjtin vendvarrim ku u gjetën kufomat e Jefta Petkoviqit dhe Zvonko Marinkoviqit, e përforcon paqartësinë lidhur me identitetet e dy kufomave të varrosura prej L04-ës dhe L10-ës. Rrjedhimisht Dhoma nuk mund të arrijë me qartësi të mjaftueshme në përfundimin se dy kufomat të cilat L04 dhe L10 u detyruan të varrosnin, ishin Jefta Petkoviqi dhe Zvonko Marinkoviqi.

392. Gjithsesi, meqë Jefta Petkoviqi u pa për herë të fundit në kamp-burgun e Llapushnikut, dëshmitë mbështesin përfundimin se ai u vra në kamp-burgun e Llapushnikut. Ai nuk ka kontaktuar me familjen e tij ose të tjerët që prej zhdukjes së tij. Kufoma e tij është gjetur. Ekzaminimi mjeko-ligjor i kufomës së tij tregon se ai është ekzekutuar. Dhoma nxjerr përfundimin se Prokuroria nuk ka provuar se një prej kufomave të varrosura prej L04-ës dhe L10-ës ishte Jefta Petkoviqi. Mirëpo Dhoma është e bindur se në lidhje me Jefta Petkoviqin janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes, dhe se ai u vra gjatë kohës si i burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut.

393. Kufoma e Zvonko Marinkoviqit është zbuluar, mirëpo nuk është përcaktuar shkaku i vdekjes së tij. Nuk është identifikuar prania e tij në kamp-burgun e Llapushnikut. Kufoma e tij u gjet bashkë me atë të Jefta Petkoviqit dhe një kufomë tjetër. Provat e mjekësisë ligjore tregojnë se tri kufomat ishin varrosur fillimisht në një vend të panjohur dhe pastaj ishin çuar në vendndodhjen në komunën e Shtimes më vonë, kur kufomat ishin shpërbërë keqasi.[1355] Dëshmia e varrosjes fillestare të kufomave në një vend të panjohur e shton paqartësinë e Dhomës lidhur me rrethanat e vdekjes së Zvonko Marinkoviqit. Mbi këtë bazë, Dhoma gjykon se Prokuroria nuk ka provuar elementët e veprës penale të vrasjes në lidhje me Zvonko Marinkoviqin.

394. Dhoma gjykon se në lidhje me Jefta Petkoviqin nuk janë provuar elementet e veprës penale të torturës (Pika 4). Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Jefta Petkoviqin janë provuar elementët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6) dhe elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 8).

[1354] L10, T 2944.

395. Dhoma gjykon se provat për mbajtjen e Zvonko Marinkoviqit në kamp-burgun e Llapushnikut janë të pamjaftueshme. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se në lidhje me Zvonko Marinkoviqin nuk janë provuar Pikat 4, 6 dhe 8.

(xviii) Agim Ademi

396. Dragan Jashoviqit iu raportua se më 27 qershor 1998, individë të panjohur rrëmbyen Agim Ademin dhe Vesel Ahmetin dhe i çuan në një vend të panjohur.[1356] Kjo dëshmi përputhet me atë të L96-ës, i cili dëshmoi se ai dëgjoi prej Shefqet Ramadanit për një person të njohur si "Agimi prej Godancit", i cili u mbajt në Llapushnik dhe ishte pronar i autobusëve për transport në Godanc.[1357] Shefqet Ramadani tha se Agimi ishte marrë prej Llapushnikut me një makinë, mirëpo ai nuk e dinte nëse Agimi ishte ende gjallë.[1358] Edhe L101 kishte dëgjuar për rrëmbimin e Agim Ademit, për të cilin ai dëgjoi se kishte ndodhur në zonën e Godancit.[1359] Sipas qendrës së shtypit në Prishtinë Agim Ademi u rrëmbye nga UÇK-ja në Godanc të Poshtëm më 26 qershor 1998.[1360]

397. Edhe L04 dëshmoi për praninë dhe zhdukjen e Agim Ademit në kamp-burgun e Llapushnikut. L04 deklaroi se "Agimi" u mbajt bashkë me L04-ën dhe të të tjerë në ahur.[1361] Ai nuk e njihte Agim Ademin para se të mbahej bashkë me të në ahur. L04 dëshmoi se një mbrëmje, erdhi një individ për të cilin ai tha se ishte Çerçizi, ia lidhi Agimit duart me tel dhe e nxori jashtë.[1362] L04 nuk e mban mend kur ndodhi.[1363] Herën tjetër kur e pa Agimin ishte kur ai u detyrua ta varroste atë.[1364] Ai mendon se kjo ndodhi afërsisht më 18 korrik 1998.[1365] L04 e njohu Agim Ademin prej fotografisë si "Agimi" të cilin ai e përmendi si të pranishëm në ahur.[1366]

398. Dhomës i la mbresë sjellja e L04-ës gjatë dëshmisë së tij dhe pranon se tregimi i tij ishte i çiltër dhe i besueshëm. Edhe pse asnjë i burgosur tjetër nuk ka konfirmuar praninë e Agim Ademit në kamp-burgun e Llapushnikut, Dhoma është e bindur prej dëshmisë së L04-ës dhe gjykon se në të vërtetë Agim Ademi u mbajt në ahur në kamp-burgun e Llapushnikut. Dhoma gjykon se Agim

---

[1355] Prova Materiale P111.
[1356] Dragan Jashoviq, T 5224.
[1357] L96, T 2345-2346.
[1358] L96, T 2345-2346.
[1359] Prova Materiale P224, paragrafi 8.
[1360] Prova Materiale P212.
[1361] L04, T 1139.
[1362] L04, T 1186.
[1363] L04, T 1186.
[1364] L04, T 1187.
[1365] L04, T 1187.

Ademi u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut prej afërsisht fundit të qershorit 1998 deri afërsisht para 18 korrikut 1998. Rrjedhimisht ai nuk merrte pjesë aktive në luftimet në atë kohë. Dhoma gjykon se Agim Ademi u mbajt në ahur në kamp-burgun e Llapushnikut dhe ka konkluduar se kushtet në ahur ishin të tilla që burgimi atje përbënte veprën penale të trajtimit mizor. Nuk ka prova të torturave ndaj Agim Ademit kur ai u mbajt në Llapushnik.

399. Prokuroria akuzon se Agim Ademi u vra në kamp-burgun e Llapushnikut dikur në mes të korrikut të vitit 1998.[1367] L04 deklaroi se ai u detyrua të varroste Agim Ademin dhe dy kufoma të tjera. L04 deklaroi se rreth 18 korrikut 1998 një roje për të cilin ai tha se ishte Shala, mori L04-ën dhe dy të tjerë nga ahuri për të varrosur Agim Ademin.[1368] Ai tha se Shala dhe të tjerë ua mbuluan kokat me thasë dhe i çuan në mal.[1369] Të burgosurit morën kazma prej makinës dhe shkuan në një vend afërsisht 100 metra prej makinës.[1370] Shala caktoi vendin ku do të hapej gropa dhe u tha të burgosurve të gërmonin.[1371] Hapja e gropës zgjati afërsisht një orë. Kur mbaruan gërmimin, L04 pa tri kufoma të dergjura përtokë. L04 dëshmoi se njohu njërën prej kufomave si Agim Ademi me të cilin kishte qenë i bashkëburgosur.[1372]

400. L04 dëshmoi se ai dhe dy të burgosur të tjerë u detyruan t'i fusnin kufomat në gropë. L04 njohu vetëm Agim Ademin, jo dy kufomat e tjera. Agim Ademi mbante veshur pantallona të kuqe[1373] dhe ishte afërsisht 25 ose 26 vjeç.[1374] L04 pa se kufoma e Agim Ademit kishte një plagë plumbi në anën e majtë.[1375] Tregimi i L10-ës për këtë rast konfirmon dëshminë e L04-ës,[1376] mirëpo L10 nuk mundi t'i identifikonte kufomat.[1377] Atij nuk iu kërkua të shikonte fotografinë e Agim Ademit.[1378]

401. Është i paqartë transportimi i kufomave në vendin e varrimit. L04 dëshmoi se pasi kishte mbaruar me hapjen e gropes, ai pa një kufomë të cilin e njohu si Agim Ademi, të cilin e njihte prej

---

[1366] L04, T 1199; Prova Materiale P54.
[1367] Aktakuzë, paragrafi 31.
[1368] L04, T 1187.
[1369] L04, T 1188.
[1370] L04, T 1188.
[1371] L04, T 1188.
[1372] L04, T 1187-1188; T 1139.
[1373] L04, T 1189.
[1374] L04, T 1189.
[1375] L04, T 1189.
[1376] L10, T 2943-2946.
[1377] L10, T 2944.
[1378] L10, T 2970-2974.

kamp-burgut të Llapushnikut.[1379] L10 deklaroi se ata u urdhëruan të shkonin të merrnin kufomat e t'i vendosnin në gropë,[1380] mirëpo ai nuk thotë "prej ku u morën" kufomat. Dëshmitë nuk japin hollësi për transportimin e kufomave në vendin e varrimit dhe për kohën e ekzekutimit të individëve. Meqë Agim Ademi u pa për herë të fundit në kamp-burgun e Llapushnikut, dëshmitë mbështesin përfundimin se vdekja e Agim Ademit ndodhi në lidhje me mbajtjen e tij në kamp-burgun e Llapushnikut.

402. Dhoma pranon dëshminë e L04-ës mbi këtë incident dhe gjykon se Agim Ademi vdiq pasi u qëllua në anën e majtë. Dhoma gjykon se personi ose personat të cilët qëlluan Agim Ademin në këtë mënyrë, duhet të kenë vepruar qëllimisht, ose me synimin për ta vrarë Agim Ademin ose për t'i shkaktuar atij dëmtim ose lëndim të rëndë trupor dhe vepruan të vetëdijshëm se vdekja e tij ishte pasojë e mundshme e të shtënave.

403. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se në lidhje me Agim Ademin nuk janë provuar elementet e veprës penale të torturës (Pika 4), mirëpo duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Agim Ademin janë provuar elementët e veprës penale të trajtimit mizor (Pika 6) dhe elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 8).

(xix) Vesel Ahmeti

404. Sipas L97-ës, afërsisht në orën një të mëngjesit të 27 qershorit 1998, ushtarët e UÇK-së erdhën në shtëpinë e tij në Godanc dhe kërkuan Vesel Ahmetin, shqiptar kosovar.[1381] Ai u mor prej shtëpisë dhe u çua drejt portës prej afërsisht 10 ushtarëve.[1382] Më vonë L97 mësoi se Vesel Ahmeti ishte çuar në fshatin Zborc ku ai e kaloi natën në shtëpinë e Syl Smajlit. Pas kësaj ai dëgjoi tregime të ndryshme në lidhje me vendndodhjen e Vesel Ahmetit.[1383] Bajram Ademi i raportoi Dragan Jashoviqit se më 27 qershor 1998, individë të panjohur rrëmbyen Agim Ademin dhe Vesel Ahmetin.[1384] Dragan Jashoviqi dëshmoi se në fillim të korrikut 1998 ai dëgjoi se Vesel Ahmeti fillimisht ishte çuar në një burg në Kleçkë, para se të çohej në kamp-burgun e Llapushnikut.[1385]

[1379] L04, T 1188.
[1380] L10, T 2944.
[1381] Prova Materiale P221.
[1382] Prova Materiale P221.
[1383] Prova Materiale P221.
[1384] Dragan Jashoviq, T 5223-5224.
[1385] Dragan Jashoviq, T 5231-5232.

Qendra e shtypit në Prishtinë raportoi se Vesel Ahmeti ishte rrëmbyer më 26 qershor 1998, në Godancin e Poshtëm.[1386]

405. L04 dëshmoi se e kishte parë "Veselin" nga Godanci në ahur, në kamp-burgun e Llapushnikut.[1387] Ai deklaroi se mësoi se Veseli ishte nga Godanci, prej bisedës me të.[1388] Mirëpo ai nuk mund ta identifikonte Vesel Ahmetin në fotografi.[1389] Ai deklaroi se një person për të cilin ai tha se ishte Çerçizi, erdhi një herë natën, ua lidhi duart Agimi Ademit dhe Veselit dhe i nxori jashtë.[1390] L04 nuk dha dëshmi tjetër për vendndodhjen e Veselit pasi ai u mor prej ahurit.

406. Prokuroria akuzon se Vesel Ahmeti u vra në kamp-burgun e Llapushnikut dikur në mes të korrikut 1998.[1391] L96 dëshmoi se Shefqet Ramadani i tha se Vesel Ahmetin e kishin marrë me makinë prej Llapushnikut njëkohësisht me "Agimin nga Godanci".[1392] L96 deklaroi se ai u pyet nga Shefqet Ramadani nëse Vesel Ahmeti ishte "ende gjallë"; L96 nuk e dinte.[1393] L96 e njohu Vesel Ahmetin në fotografi dhe deklaroi se ai e njihte Vesel Ahmetin që para luftës, jo nga koha e tij në Llapushnik.[1394]

407. Dhoma nuk ka arsye për të mos e besuar dëshminë e L04-ës lidhur me ata me të cilët ai u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut. L04 nuk mundi të konfirmonte se "Veseli" që ai identifikoi, në fakt ishte Vesel Ahmeti. Përkundrejt identifikimit të Agim Ademit prej tij, L04 nuk mundi ta identifikonte Vesel Ahmetin në fotografi.[1395] Mirëpo asnjë i burgosur tjetër nuk e pa Vesel Ahmetin në kamp-burgun e Llapushnikut. Për arsyet e përmendura gjetiu në këtë vendim, Dhoma u kushton pak rëndësi dëshmive të L96-ës dhe Dragan Jashoviqit. Ajo gjithashtu është e vetëdijshme se këto dëshmi janë tregime prej të tjerëve, të pakonfirmuara. Në mungesë të provave të tjera, Dhoma nuk mund të nxjerrë me qartësi të mjaftueshme përfundimin se Vesel Ahmeti është mbajtur në kamp-burgun e Llapushnikut.

408. Nuk ka prova të gjetjes së kufomës së Vesel Ahmetit dhe nuk ka prova që tregojnë se ai u varros me Agim Ademin. Siç u tha në lidhje me Agim Ademin, L04 në të vërtetë varrosi edhe dy kufoma të tjera, përfshirë edhe Agim Ademin. Mirëpo ai nuk identifikoi asnjërën prej këtyre dy

[1386] Prova Materiale P212.
[1387] L04, T 1132-1133; T 1135; Prova Materiale P54. L96 dëshmoi se ai njohu Vesel Ahmetin por nuk ishte i sigurtë se kur e pa për herë të fundit, T 2405-2409.
[1388] L04, T 1136.
[1389] L04, T 1199.
[1390] L04, T 1186.
[1391] Aktakuzë, paragrafi 31.
[1392] L96, T 2345.
[1393] L96, T 2345.
[1394] L96, T 2405.

kufomave, megjithëse ai e kishte njohur "Veselin" nga Godanci si të bashkëburgosur në ahur. Në mungesë të dëshmive të tjera të besueshme lidhur me Vesel Ahmetin, Dhoma gjykon se Prokuroria nuk ka provuar që Vesel Ahmeti është i vdekur.

409. Rrjedhimisht për këto arsye Dhoma gjykon se në lidhje me Vesel Ahmetin nuk janë provuar elementet e veprës penale të torturës (Pika 4), të trajtimit mizor (Pika 6) dhe të vrasjes (Pika 8).

(xx) Emin Emini

410. Emin Emini ishte nga fshati Carralevë.[1396] Dhoma nuk ka dëshmi në lidhje me rrethanat e rrëmbimit të pretenduar të Emin Eminit prej UÇK-së apo të transferimit të tij të mëtejshëm në kamp-burgut e Llapushnikut. Mirëpo ka dëshmi për mbajtjen e Emin Eminit në kamp-burg. L06 dhe L10 përshkruan se pas ardhjes së tyre në kamp-burg, afërsisht më 13 qershor 1998, ata u çuan në fllanik[1397] dhe atje gjetën një person, te i cili dukeshin lëndime dhe si pasojë nuk mund të fliste.[1398] Më tej L10 kujton se personi në fjalë ishte lidhur me zinxhir te dritarja, dhe se dy ushtarë me maska të UÇK-së e pyetën L10-ën nëse personi ishte spiun serb. L10 tha se ai nuk e dinte.[1399] L06 dhe L10 e identifikuan Emin Eminin në fotografi në gjyq si njeriun të cilin e gjetën në fllanik.[1400] Edhe L96 dëshmoi për mbajtjen e Emin Eminit prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut. Sipas dëshmisë së L96-ës, pak pasi ishte prurë në kamp-burg, afërsisht më 20 korrik 1998, L96 u çua në fllanik[1401] dhe atje midis të burgosurve të tjerë ishte Emin Emini nga Carraleva.[1402] L96 dëshmoi se Emin Emini ishte në gjendje të tmerrshme dhe se ai i kishte thënë L96-ës se kishte qenë atje për 55 ditë.[1403] Gjithashtu L96 tregoi se Emin Emini mbante të fshehur një orë prej personit të përmendur si Shala dhe ishte vazhdimisht i frikësuar se mos e kapnin për këtë.[1404] L96 dëshmoi se ai e njihte Emin Eminin para luftës dhe e identifikoi me emër dhe në fotografi në gjyq si të bashkëburgosur në fllanik.[1405] Po ashtu e rëndësishme është dëshmia e L04-ës. Është përcaktuar se L04 mbahej jo në të njëjtin vend me Emin Eminin në kamp-burgun e

[1395] L04, T 1199; Prova Materiale P54.
[1396] L96, T 2333-2335.
[1397] *Shih më sipër,* paragrafët 245-247.
[1398] L06, T 990-993; L10, T 2916-2918.
[1399] L10, T 2916-2918.
[1400] L06, T 992-993; L10, T 2969-2970; Prova Materiale P54. L06 e quajti personin në fllanik si Emin Muharremi, gjithashtu i njohur si Emin Sadrija nga Carraleva, T 992-993. Sidoqoftë L06 ishte në gjendje ta identifikonte personin në fotografi si Emin Emini.
[1401] *Shih më sipër,* paragrafin 266.
[1402] L96, T 2333-2335.
[1403] L96, T 2338.
[1404] L96, T 2361-2362.
[1405] L96, T 2405-2406; Prova Materiale P54.

Llapushnikut.[1406] Gjithsesi, L04 dëshmoi se ditën e fundit të burgimit të tij, kur të burgosurit u larguan andej nën sulmin e forcave serbe, që sipas përfundimit të Dhomës ndodhi më 25 ose 26 korrik 1998,[1407] ai pa Emin Eminin në oborrin e kamp-burgut.[1408] Gjithashtu L04 e identifikoi Emin Eminin në fotografi.[1409] Përputhja e dëshmive dhe fakti që përmendet më vonë në këtë Aktgjykim[1410] se Emin Emini ishte midis të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës nën ruajtjen e UÇK-së, më 25 ose 26 korrik 1998 pasi të tjerët ishin liruar, dhe se kufoma e tij u gjet midis atyre të të burgosurve të tjerë të kampit në një varr të madh, në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, e bindin Dhomën të nxjerrë përfundimin se Emin Emini u mbajt prej UÇK-së në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut, të paktën prej mesit të qershorit deri më 25 ose 26 korrik 1998, ku ai u shoqërua bashkë me të burgosurit e tjerë në malet e Berishës. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht është provuar edhe se Emin Emini nuk merrte pjesë aktive në luftime në atë kohë.

411. Dhoma dëgjoi dëshmi se gjatë burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut, Emin Emini u keqtrajtua. Si u përshkrua më sipër, kur L06 dhe L10 u çuan në fllanik, ata e gjetën personin, të cilin e identifikuan si Emin Emini, në gjendje të tillë fizike që i bëri të besonin se ai ishte rrahur egërsisht; kokën e kishte të enjtur, njërin sy e kishte të verbuar.[1411] L06 dëshmoi se ai e pyeti më vonë Emin Eminin çfarë kishte ndodhur me të. Sipas dëshmisë së L06-ës, Emin Emini tha se ai ishte rrahur nga një person i quajtur "Luan".[1412] Nuk ka dëshmi të tjera në lidhje me identitetin e sulmues(ve) të Emin Eminit. Nga dëshmia e L10-ës duket se dy ushtarë të maskuar të UÇK-së të cilët e pyetën L10-ën nëse Emin Emini ishte spiun, kërkonin të konfirmonin dyshimin e tyre se ai ishte spiun. Mirëpo nga dëshmitë është e paqartë nëse faktikisht Emin Emini ishte rrahur mbi bazën e këtyre dyshimeve ose madje nga po ata persona. Megjithëse Dhoma është e bindur prej dëshmive se Emin Emini ishte sulmuar fizikisht dhe madje egërsisht para se të çoheshin në fllanik L06 dhe L10. Dhoma nuk mund të bindet se ky sulm u krye për një apo më shumë synime të caktuara të nevojshme për të provuar veprën penale të torturës.

412. L10 gjithashtu përmendi edhe dy raste të tjera me sa duket të keqtrajtimit ushtruar ndaj Emin Eminit gjatë burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut. Së pari, L10 dëshmoi se një herë, anëtarët e UÇK-së për të cilët ai tha se ishin Shala, Çerçizi dhe Murrizi e nxorën Emin Eminin nga fllaniku. L10 dëshmoi se Emin Emini u kthye nja dyzet minuta më vonë; ai po mbante stomakun

[1406] *Shih më sipër,* paragrafin 251.
[1407] *Shih më poshtë,* paragrafin 448.
[1408] L04, T 1192-1194.
[1409] L04, T 1199-1206; Prova Materiale P54.
[1410] *Shih më poshtë,* paragrafët 458-461.
[1411] L06, T 992-993; L10, T 2916-2918.

me dorë dhe u tha të burgosurve të tjerë se ishte rrahur.[1413] Nuk ka dëshmi të tjera për këtë ngjarje konkrete, as për identitetet e tre anëtarëve të UÇK-së përmendur nga L10. Veçanërisht, megjithëse L10 tha se L06 ishte i pranishëm në atë kohë, L06 nuk e përmend këtë incident në dëshminë e tij. Për shkak të mospërputhjes së dukshme midis dëshmive të L10-ës dhe L06-ës lidhur me këtë incident, Dhoma gjykon se nuk mund të bindet krejtësisht për rrethanat e këtij sulmi konkret apo për identitetet e atyre personave të përmendur prej L10-ës. Së dyti, L10 dëshmoi se një herë Emin Emini tha se ai ishte rrahur nga një person të cilin ai e përmendi si komandant Çeliku.[1414] Në mungesë të ndonjë konfirmimi tjetër prej dëshmive të tjera, dëshmia e dorës së dytë e L10-ës nuk e bind Dhomën se në rast se ka ndodhur, ky keqtrajtim i përmendur ka ndodhur ashtu si përshkruhet.

413. Gjithsesi, ekzaminimi mjeko-ligjor i kufomës së Emin Eminit zbuloi se ai kishte pësuar thyerje në dërrasën e krahërorit dhe në brinjë si pasojë e forcës së një sendi jo të mprehtë, të shkaktuara afërsisht tri javë para vdekjes,[1415] d.m.th. kur Emin Emini mbahej prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut.

414. Bazuar në sa më sipër, duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma është e bindur se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut, Emin Emini pësoi rrahje të egra që i shkaktuan thyerje të shumta dhe lëndime të tjera. Ndërkohë që siç u përcaktua më lart, Dhoma nuk mund të bindet për rrethanat konkrete të disa prej këtyre rrahjeve apo për kryesit, duke marrë parasysh dëshminë e mjekësisë ligjore dhe kushtet e përgjithshme të kamp-burgut, Dhoma është e bindur se Emin Emini pati vuajtje të rënda mendore dhe fizike, dhe se kryesit vepruan qëllimisht. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6). Mirëpo Dhoma nuk mund të bindet prej dëshmive se keqtrajtimi ndaj Emin Eminit u ushtrua për ndonjë synim të ndaluar e nevojshme për të provuar veprën penale të torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Emin Eminit prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1416]

[1412] L06, T 992-993.
[1413] L10, T 2935-2937.
[1414] L10, T 2935-2937; 2994-2996.
[1415] Dr George Maat, T 5168-5171; Prova Materiale P200; *Shih* edhe, Provën Materiale P111.
[1416] *Shih më poshtë,* paragrafët 458-462.

(xxi) Ibush Hamza

415. Para Dhomës nuk janë paraqitur dëshmi të drejtpërdrejta veçanërisht në lidhje me burgimin e Ibush Hamzës në kamp-burgun e Llapushnikut.[1417] Mirëpo, për asyet e shpjeguara më vonë në këtë vendim,[1418] Dhoma është e bindur se përmendja prej L04-ës e një të bashkëburgosuri, i njohur prej tij si Ibush, dhe i cili mbeti me grupin e vogël të të burgosurve nën ruajtjen e UÇK-së në malet e Berishës pasi L04 u lirua,[1419] zbulon dhe Dhoma gjykon se personi të cilin L04 e njihte si Ibushi ishte i bashkëburgosur në kamp-burgun e Llapushnikut dhe midis të burgosurve të shoqëruar prej rojeve të UÇK-së në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998. Gjetja e mëvonshme e kufomës së identifikuar të Ibush Hamzës në varrin e madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës[1420] e bind Dhomën dhe ajo nxjerr përfundimin se personi të cilin L04 e njihte si Ibushi, faktikisht ishte Ibush Hamza, dhe se ai u mbajt prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut për një kohë të papërcaktuar deri më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai u çua në malet e Berishës bashkë me të burgosurit e tjerë. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht është provuar se Ibuzh Hamza nuk merrte pjesë aktive në luftme në atë kohë.

416. Nuk ka dëshmi për keqtrajtim të ushtruar ndaj Ibush Hamzës gjatë burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut. Gjithashtu nuk ka dëshmi mbi vendndodhjen e tij të saktë brenda kamp-burgut. Ashtu si u theksua më sipër, kushtet e burgimit ndryshonin ndjeshëm nga vendi në vend.[1421] Rrjedhimisht për rastin në fjalë, Dhoma nuk mund të arrijë në përfundimin se kushtet e mbajtjes së Ibush Hamzës ishin kaq të mjerueshme saqë ato përbënin vuajtje të rënda fizike dhe mendore apo sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor dhe arrinin në trajtim mizor. Si rrjedhim Dhoma gjykon se në lidhje me Ibush Hamzën nuk janë provuar veprat penale të trajtimit mizor (Pika 6) dhe torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Ibush Hamzës prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1422]

(xxii) Hyzri Hajrizi

417. Hyzri Hajrizi ishte nga fshati Belincë.[1423] E vetmja dëshmi që flet për zhdukjen e Hyzri Hajrizit është ajo e Dragan Jashoviqit i cili dëshmoi se mori informacion prej një të afërmi të Hyzri

[1417] Në lidhje me këtë Dhoma thekson se L96 përmend një ish të burgosur me emrin "Banush" ose "Ibush" por L96 pranoi se ai ishte i pasigurtë në lidhje me emrin e saktë, T 2502-2503.
[1418] *Shih më poshtë,* paragrafët 463-466.
[1419] Prova Materiale P76, L04, T 1197-1198.
[1420] *Shih më poshtë,* paragrafët 463-466.
[1421] *Shih më sipër,* paragrafët 285-289.
[1422] *Shih më poshtë,* paragrafët 463-467.
[1423] L04, T 1199-1206; L10, T 2922-2925; 2969-2973; L96, T 2334-2335.

Hajrizit i cili ishte i pranishëm kur Hyzri Hajrizi u ndalua prej anëtarëve të UÇK-së afër fshatit Petrovë dhe u çua në shtabin e UÇK-së në Rancë.[1424] Sipas dëshmisë së Dragan Jashoviqit një i afërm tjetër i Hyzri Hajrizit raportoi se një njeri që thuhej se quhej Dulla, i cili shërbente në shtabin e UÇK-së në Rancë, kishte thënë se Hyzri Hajrizi ishte çuar në një burg në fshatin Llapushnik.[1425] Gjithsesi, duke marrë parasysh karakterin e këtyre dëshmive dhe rezervat mbi besueshmërinë e dëshmisë së Dragan Jashoviqit,[1426] Dhoma nuk është e gatshme që vetëm mbi këto dëshmi të nxjerrë përfundime konfirmuese lidhur me rrethanat e sakta të arrestimit të Hyzri Hajrizit.

418. Ish-të burgosur dëshmuan se ishin mbajtur me Hyzri Hajrizin në kamp-burgun e Llapushnikut, apo se e kishin pare atje. L10 dëshmoi se një person të cilin ai e njihte si "Hyzriu nga Belinca", të cilin e identifikoi në fotografi si Hyzri Hajrizi, ishte i bashkëburgosur në fllanik.[1427] Kjo dëshmi përputhet me dëshminë e L96-ës se ai u mbajt në fllanik bashkë me "Hyzri Hajrizin nga Belinca".[1428] Së fundi L04 dëshmoi se ditën e fundit të burgimit të tij, kur të burgosurit u mblodhën në oborrin e kamp-burgut, ai pa "Hyzrinë" të cilin e identifikoi kur iu tregua një fotografi e Hyzri Hajrizit.[1429] Këto dëshmi përputhëse si edhe fakti i përmendur më vonë në këtë vendim[1430] se Hyzri Hajrizi ishte midis grupit të të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës nën ruajtjen e UÇK-së më 25 ose 26 korrik 1998, pasi të tjerët ishin liruar, dhe se kufoma e tij u gjet midis atyre të të burgosurve të tjerë të kamp-burgut në një varr të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, e bindin Dhomën dhe ajo nxjerr përfundimin se Hyzri Hajrizi u mbajt prej UÇK-së në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut.

419. Dhoma nënvizon se sipas dëshmisë së L10-ës, kur L10 u çua fillimisht në fllanik rreth mesit të qershorit 1998, atje ishte vetëm një i burgosur, Emin Emini.[1431] Ky fakt mund të tregojë se Hyzri Hajrizi u arrestua dikur pas mesit të qershorit 1998; mirëpo mund edhe që Hyzri Hajrizi të jetë mbajtur më parë në një vend tjetër brenda kamp-burgut, para se të transferohej në fllanik. Në mungesë të dëshmive të tjera, Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundim për kohën e ardhjes së Hyzri Hajrizit në kamp-burgun e Llapushnikut. Gjithsesi Dhoma është e bindur se Hyzri Hajrizi u mbajt nga UÇK-ja në kamp-burgun e Llapushnikut deri më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai dhe të burgosurit

[1424] Dragan Jashoviq, T 5264-5268.
[1425] Dragan Jashoviq, T 5269-5271.
[1426] *Shih më sipër,* paragrafin 27.
[1427] L10, T 2922-2925; 2969-2973; Prova Materiale P54.
[1428] L96, T 2334-2335. Mirëpo L96, nuk e identifikoi Hyzri Hajrizin në fotografi, T 2405-2409; Prova Materiale P54.
[1429] L04, T 1192-1194; 1199-1200; Prova Materiale P54.
[1430] *Shih më poshtë,* paragrafët 468-471.
[1431] L10, T 2917-2918.

e tjerë u çuan prej rojeve të UÇK-së në malet e Berishës. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht gjatë kësaj periudhe Hyzri Hajrizi nuk merrte pjesë aktive në luftime.

420. L10 dëshmoi se njerëz të maskuar rrahën "Hyzrinë", njeriun të cilin ai e identifikoi si Hyzri Hajrizi në kamp-burgun e Llapushnikut.[1432] Dëshmisë i mungonin saktësimet dhe nuk ka dëshmi të tjera që mund ta ndihmonin Dhomën të përcaktonte me bindje rrethanat, karakterin dhe shkallën e sulmit fizik ndaj Hyzri Hajrizit ose prej kujt u krye.

421. Bazuar në sa më sipër, duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma nuk mund të bindet se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, Hyzri Hajrizi iu nënshtrua keqtrajtimit fizik. Gjithsesi siç u përcaktua më lart,[1433] Dhoma është e bindur se kushtet e burgimit në fllanik ishin të tilla saqë ato u shkaktuan vuajtje të rënda mendore ose fizike të burgosurve, ndër ta edhe Hyzri Hajrizi, ose përbënin sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor. Fakti se këto kushte u mbajtën për një kohë të gjatë e bind Dhomën se ato u imponuan qëllimisht. Rrjedhimisht në bazë të burgimit të tij në fllanik, Dhoma gjykon se në lidhje me Hyzri Hajrizin është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6). Mirëpo nuk është provuar vepra penale e torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Hyzri Hajrizit prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1434]

(xxiii) Shaban Hoti

422. Shaban Hoti ishte profesor i specializuar në gjuhën ruse dhe jetonte në Prishtinë. Një i afërm i tij tha në një deklaratë me shkrim e pranuar si provë se më 20 korrik 1998, Shaban Hoti u largua prej shtëpisë së tij në Prishtinë për të takuar një grup gazetarësh rusë me të cilët ai punonte dhe nuk u kthye.[1435] Njëri prej këtyre gazetarëve rusë, Oleg Safiulin, dëshmoi se më 20 korrik 1998 ai po udhëtonte përmes territorit nën kontrollin e UÇK-së me ekipin e tij dhe përkthyesin Shaban Hotin, kur ata u ndaluan në një postbllok të UÇK-së afër Llapushnikut. Oleg Safiulini dëshmoi se ai dhe ekipi i tij përfshirë edhe Shaban Hotin u urdhëruan të ktheheshin pas dhe ata u kthyen. Më pas kur po filmonin disa pamje afërsisht një kilometër prej postbllokut të UÇK-së, një njësi ushtarësh të UÇK-së i ndaloi përsëri dhe i ktheu në postbllokun e UÇK-së.[1436] Oleg Safiulin dëshmoi se një komandant i paidentifikuar i UÇK-së erdhi në postbllok dhe se njerëzit e tij u çuan në një shtëpi në

[1432] L10, T 2936.
[1433] *Shih më sipër,* paragrafin 289.
[1434] *Shih më poshtë,* paragrafët 468-472.
[1435] Prova Materiale P222.
[1436] Oleg Safiulin, T 1728-1731; Prova Materiale P87.

anën jugore të rrugës Prishtinë-Pejë.[1437] Oleg Safiulin dëshmoi se pak orë më vonë, një komandant i paidentifikuar, ndoshta i njëjti komandant të cilin e kishte parë në postbllok, erdhi në shtëpi dhe e mori në pyetje. Shaban Hoti përkthente, ai tashmë ishte rrahur, e kishte këmishën të gjakosur dhe dukej i tmerruar.[1438] Oleg Safiulin u lirua pak më vonë dhe nuk di asgjë çfarë ndodhi më pas me Shaban Hotin.[1439]

423. L96 dëshmoi se gjatë ditëve të para të burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut, kur ai po mbahej në katin e parë të shtëpisë kryesore, dikur rreth 18 korrikut 1998,[1440] ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së prunë në dhomë një të moshuar. Të nesërmen, L96 dëgjoi nga një ushtar i UÇK-së që ai tha se ishte Shala, se ky i moshuar ishte Shaban Hoti, profesor i rusishtes, i cili punonte si përkthyes për gazetarë rusë.[1441] Sipas dëshmisë së L96-ës më pas ai dëgjoi nga Shaban Hoti vetë se ai ishte nga Prishtina dhe se punonte me gazetarë rusë.[1442] L96 e identifikoi Shaban Hotin në fotografi.[1443] Megjithëse në dëshminë e L96-ës del se më vonë Shaban Hoti u transferua në ahur bashkë me L96-ën, askush prej të burgosurve të cilët dëshmuan nuk e ka identifikuar Shaban Hotin si të bashkëburgosur. Gjithsesi duke marrë parasysh provat mbështetëse se kufoma e Shaban Hotit u gjet në varrin e madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, bashkë me ato të të burgosurve të tjerë në kamp-burgun e Llapushnikut[1444] dhe dëshminë e Oleg Safiulinit, Dhoma mund të pranojë dëshminë e L96-ës në këtë pikë, dhe nxjerr përfundimin se Shaban Hoti u mbajt prej UÇK-së në kamp-burg, të paktën për një pjesë të kohës në dhomën në katin e parë të shtëpisë kryesore të kamp-burgut, afërsisht prej 20 korrikut 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai dhe të burgosur të tjerë u çuan në malet e Berishës nga rojet e UÇK-së. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht është provuar se gjatë asaj kohe Shaban Hoti nuk merrte pjesë aktive në luftime.

424. L96 dëshmoi se Shaban Hoti u keqtrajtua në kamp-burgun e Llapushnikut. Sipas dëshmisë së L96-ës kur ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së e prunë Shaban Hotin fillimisht në dhomën në katin e parë të ndërtesës kryesore, Shaban Hoti u lidh me zinxhirë dhe ishte rrahur egërsisht; ai nuk mund të qëndronte në këmbë dhe këmisha që mbante veshur kishte njolla gjaku.[1445] Kjo dëshmi përputhet pjesërisht me dëshminë e Oleg Safiulinit, i cili kishte qenë me Shaban Hotin disa orë më parë. Gjithashtu L96 dëshmoi se me gjithë gjendjen e Shaban Hotit në atë kohë, ushtarët e UÇK-së

[1437] Oleg Safiulin, T 1739-1741; Prova Materiale P88.
[1438] Oleg Safiulin, T 1741-1746.
[1439] Oleg Safiulin, T 1746-1748.
[1440] *Shih më sipër,* paragrafin 265.
[1441] L96, T 2312-2314.
[1442] L96, T 2346-2347.
[1443] L96, T 2405-2409; Prova Materiale P54.
[1444] *Shih më poshtë,* paragrafët 473-476.

e tërhoqën atë zvarrë në dhomën përbri dhe vazhduan t'a rrihnin afërsisht për gjysëm ore.[1446] L96 deklaroi se ai dëgjoi ushtarët kur e pyetën Shaban Hotin: "Ende përkthen për gazetarët rusë?" Të nesërmen në mbrëmje, tha L96, në dhomën ku mbahej Shaban Hoti hynë gjashtë ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së dhe filluan t'a keqtrajtonin sërish. Ushtarët bërtitnin dhe kërcenin mbi të; ai ishte i shtrirë në dysheme, duar e këmbëlidhur. Sipas dëshmisë së L96-ës dera e dhomës mbeti e hapur gjatë tërë incidentit, kështu që ai e pa drejtpërdrejtë ngjarjen.[1447] Nuk ka dëshmi të tjera të drejtpërdrejta në lidhje me këto dy incidente. Ashu siç përmendet më vonë në këtë vendim,[1448] megjithëse autopsia fillestare e kufomës që u gjet se ishte Shaban Hoti zbuloi thyerje të shumta në kafkë, fletën shpatullore, rrezor, eshtrën e kofshës dhe fyellin e kërcirit,[1449] ekzaminimi i mëtejshëm dhe më i hollësishëm mjeko-ligjor zbuloi se këto thyerje përputheshin me plagë prej plumbi,[1450] të cilat kanë më shumë gjasë të kenë ndodhur në kohën e vdekjes. Gjithashtu në ekzaminimin mjeko-ligjor të kufomës së Shaban Hotit është shënuar se ekziston mundësia e thyerjes së një brinje para vdekjes; mirëpo nuk jepet asnjë konfirmim për këtë dhe as ndonjë vlerësim i vjetërsisë së thyerjes së mundshme.[1451] Pasi ka marrë parasysh të gjitha këto rrethana, duke përfshirë edhe rrethanat në të cilat Shaban Hoti u arrestua fillmisht prej UÇK-së, arsyen e dhënë për arrestimin dhe burgimin e tij, mbajtjen e tij të mëtejshme me gjithë lirimin e ekipit të gazetarëve rusë, trajtimin që iu bë kur u ndalua fillimisht, dhe gjetjen e kufomës, pavarësisht mungesës së provave mbështetëse të mjekësisë ligjore, Dhoma është e bindur se mund të pranojë dëshminë e L96-ës për keqtrajtimin e ushtruar ndaj Shaban Hotit në shtëpinë kryesore të kamp-burgut të Llapushnikut. Rrethanat e bindin Dhomën dhe ajo nxjerr përfundimin se Shaban Hoti u përzgjodh për keqtrajtim të rëndë si pasojë e drejtpërdrejtë e punës së tij si përkthyes për gazetarët rusë.

425. Bazuar në sa më sipër, dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma është e bindur se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, Shaban Hoti iu nënshtrua rrahjeve të egra që i shkaktuan vuajtje të rënda fizike dhe mendore, megjithëse Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundime mbi identitetin e kryesve. Dhoma gjykon se rrahjet ndaj Shaban Hotit ishin si pasojë e drejtpërdrejtë e punës së tij si përkthyes për gazetarët rusë dhe se kryesit vepruan qëllimisht dhe me synimin për ta ndëshkuar dhe frikësuar Shaban Hotin. Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se në lidhje me Shaban Hotin janë

[1445] L96, T 2312-2314; 2317.
[1446] L96, T 2312-2314; 2317.
[1447] L96, T 2322-2325.
[1448] Prova Materiale P110; *Shih më poshtë,* paragrafin 475.
[1449] Prova Materiale P111; *Shih më poshtë,* paragrafin 475.
[1450] Prova Materiale P111.
[1451] Prova Materiale P111.

provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6), dhe torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Shaban Hotit prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1452]

(xxiv) Hasan Hoxha

426. Dy të afërm të Hasan Hoxhës dhanë deklarata në këtë gjyq për çfarë kishin dëgjuar lidhur me zhdukjen e Hasan Hoxhës. Sipas deklaratave të tyre me shkrim, Hasan Hoxha u arrestua më 17 korrik 1998 pasi u largua nga shtëpia me makinë me Alush Lumën, dhe fillimisht u mor në pyetje në një shkollë në Pjetërshticë.[1453] Sipas një raporti pa datë të OSBE-së për persona të zhdukur, Hasan Hoxha dhe Alush Luma u arrestuan prej UÇK-së rreth 17 korrikut 1998, kur po shkonin me makinë në fshatin Shalë.[1454]

427. L96 dëshmoi se gjatë mbajtjes së tij fillimisht në katin e parë të shtëpisë kryesore në kamp-burgun e Llapushnikut rreth 18 korrikut 1998,[1455] ai pa në dhomë individë për të cilët tha se ishin Hasan Hoxha dhe Alush Luma.[1456] L96 e identifikoi Hasan Hoxhën në fotografi si të bashkëburgosur.[1457] Gjithashtu L96 dëshmoi se në ditën e tij të fundit të burgimit, kur të burgosurit ishin mbledhur në oborr, ai pa Hasan Hoxhën të dilte prej njërës nga dhomat, ndoshta nga ahuri, mendoi ai.[1458] Nuk ka asnjë dëshmi tjetër të drejtpërdrejtë të burgimit të Hasan Hoxhës në kamp-burg. Dhoma i ka shprehur gjetkë arsyet për rezervat në lidhje me dëshminë e L96-ës.[1459] Mirëpo ashtu siç është përmendur më poshtë në këtë vendim,[1460] kufoma për të cilën Dhoma ka arritur në përfundimin se është e Hasan Hoxhës, u gjet në vendin e ekzekutimit, në malet e Berishës, ndonëse pak më e veçuar se kufomat e tjera. Sipas vlerësimit të Dhomës, ky fakt ofron konfirmim të qartë në pikëpamje thelbësore të dëshmisë së L96-ës për mbajtjen e Hasan Hoxhës në kamp-burg. Për këtë arsye, Dhoma është e bindur se dëshmia e L96-ës në lidhje me Hasan Hoxhën duhet pranuar. Rrjedhimisht Dhoma, gjykon se Hasan Hoxha u mbajt nga UÇK-ja në kamp-burgun e Llapushnikut, prej afërsisht 17 korrikut 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai dhe të burgosur të tjerë u çuan në malet e Berishës prej rojeve të UÇK-së. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht është provuar se gjatë asaj kohe Hasan Hoxha nuk merrte pjesë aktive në luftime.

[1452] *Shih më poshtë,* paragrafët 473-477.
[1453] Provat Materiale P185 dhe P186.
[1454] Provat Materiale P46; P147.
[1455] *Shih më sipër,* paragrafin 265.
[1456] L96, T 2297-2298; 2301.
[1457] L96, T 2405-2409; Prova Materiale P54.
[1458] L96, T 2349-2350.
[1459] *Shih më sipër,* paragrafin 26.
[1460] *Shih më poshtë,* paragrafët 478-482.

428. Sipas dëshmisë së L64-ës ai dëgjoi se Hasan Hoxha ishte rrahur keqasi.[1461] Nuk ka dëshmi të tjera të cilat do ta lejonin Dhomën të përcaktonte rrethanat e këtij keqtrajtimi të pretenduar apo të konfirmonte nëse ka ndodhur ose jo.

429. Bazuar në sa më sipër, në mungesë të provave të tjera për këtë çështje, Dhoma nuk është e bindur se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, Hasan Hoxha iu nënshtrua keqtrajtimit fizik. Meqë për shkak të dëshmisë së kufizuar të L96-ës nuk mund të përcaktohet nëse Hasan Hoxha u mbajt diku tjetër përveç shtëpisë kryesore, dhe duke marrë parasysh kushtet në shtëpinë kryesore,[1462] Dhoma nuk mund të bindet se kushtet e burgimit ishin të tilla saqë ato shkaktuan vuajtje të rënda mendore ose fizike, ose përbënin sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se në lidhje me Hasan Hoxhën nuk janë provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6) dhe torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Hasan Hoxhës prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës do të shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1463]

(xxv) Safet Hysenaj

430. Safet Hysenaj ishte nga fshati Petrovë.[1464] Dhoma nuk ka prova në lidhje me rrethanat e arrestimit të Safet Hysenajt dhe transferimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut. Gjithsesi, ish-të burgosurit kanë dëshmuar se Safet Hysenaj u mbajt në kamp-burg. L96 dëshmoi se në ditën e tij të fundit të burgimit, më 25 ose 26 korrik 1998, kur të burgosurit u mblodhën në oborr, ai pa Safet Hysenajn duke dalë nga garazhi në oborr. Ishte hera e parë që L96 e pa atë në kamp-burg.[1465] Kjo dëshmi përputhet me atë të L04-ës, i cili dëshmoi se në ditën e fundit të burgimit të tij, kur L04 u nxor jashtë ahurit, në oborr ai pa "Safetin nga Petrova".[1466] Kjo dëshmi si edhe fakti, i përmendur më tej në këtë vendim,[1467] se Safet Hysenaj ishte midis të burgosurve të cilët mbetën nën ruajtjen e UÇK-së në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998, pasi të tjerët u liruan, dhe se kufoma e tij u gjet midis atyre të të burgosurve të tjerë të kamp-burgut në një varr të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, e bindin Dhomën të nxjerrë përfundimin se Safet Hysenaj u mbajt në kamp-

[1461] L64, T 4515-4518.
[1462] *Shih më sipër,* paragrafët 287; 289.
[1463] *Shih më poshtë,* paragrafët 478-483.
[1464] L04, T 1199-1206; L96, T 2272; Dragan Jashoviq, T 5271-5273.
[1465] L96, T 2348; 2357-2358; Provat Materiale P100 dhe P101.
[1466] L04, T 1192-1194; 1199-1206. Dhoma thekson se personi të cilin L04 e identifikoi në fotografi si "Safeti nga Petrova" nuk është Safet Hysenaj por Gjorgje Çuk. Megjithatë Dhoma vlerëson se cilësia e dy fotografive dhe ngjashmëria janë të tilla saqë ajo nuk është e bindur se ky identifikim i gabuar është përfundimtar.
[1467] *Shih më poshtë,* paragrafët 484-487.

burgun e Llapushnikut, ka shumë të ngjarë në garazh, për një kohë të papërcaktuar deri më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai dhe të burgosur të tjerë u çuan në malet e Berishës prej rojeve të UÇK-së. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht është provuar se gjatë kohës që ka lidhje me këtë proces Safet Hysenaj nuk merrte pjesë aktive në luftime.

431. Dhoma nuk disponon dëshmi nga dëshmitarë okularë në lidhje me keqtrajtimin e ushtruar ndaj Safet Hysenajt gjatë burgimit të tij, ose në lidhje me kushtet e burgimit të tij. Kjo përputhet me përfundimin e nxjerrë prej dëshmisë së L96-ës se Safet Hysenaj u mbajt në garazh, siç i duket i izoluar prej të burgosurve të tjerë. Ekzaminimi mjeko-ligjor i kufomës së Safet Hysenajt gjetur në varrin e madh në malet e Berishës, zbuloi se ai kishte pësuar thyerje të shumta në nofullën e poshtme dhe të sipërme, që përputheshin me forcë të ushtruar me një send jo të mprehtë, gjë që me gjasë ndodhi para vdekjes.[1468] Mirëpo provat e mjekësisë ligjore nuk përcaktojnë sa kohë para vdekjes mund të kenë ndodhur këto lëndime dhe në mungesë të provave të tjera, Dhoma nuk mund të bindet se këto lëndime iu shkaktuan Safet Hysenajt gjatë kohës kur ai u mbajt në kamp-burg.

432. Duke u bazuar në sa më sipër, dhe në bazë të dëshmive në dispozicion, Dhoma nuk është e bindur se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, Safet Hysenaj iu nënshtrua vuajtjeve të rënda mendore ose fizike ose se kushtet e burgimit ishin të tilla saqë ato përbënin sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se në lidhje me Safet Hysenajn nuk janë provuar veprat penale të trajtimit mizor (Pika 6) dhe torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Safet Hysenajt prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1469]

(xxvi) Bashkim Rashiti

433. Bashkim Rashiti ishte nga fshati Godanc.[1470] Një i afërm i Bashkim Rashitit deklaroi në një deklaratë me shkrim, të pranuar si provë, se më 11 korrik 1998, Bashkim Rashiti shkoi të paraqitej në shtabin e UÇK-së në Kroimir dhe nuk u kthye.[1471] Ish-të burgosurit në kamp-burgun e Llapushnikut, L06, L10 dhe L96, të gjithë e identifikuan në fotografi Bashkim Rashitin ose "Bashkimin nga Godanci", si të bashkëburgosur në fllanik në kamp.[1472] Këto dëshmi të

[1468] Prova Materiale P111.
[1469] *Shih më poshtë,* paragrafët 484-488.
[1470] L10, T 2969-2973.
[1471] Prova Materiale P223.
[1472] L06, T 1039-1045; L10, T 2969-2973; 2965-2966; L96, T 2407-2408; 2334-2335; Prova Materiale P54; Prova Materiale P108.

përputhshme si edhe fakti i përmendur më vonë në këtë vendim[1473] se Bashkim Rashiti ishte midis të burgosurve të cilët mbetën nën ruajtjen e UÇK-së në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998, pasi të tjerët u liruan, dhe se kufoma e tij u gjet midis atyre të të burgosurve të tjerë të kampit në një varr të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, e bindin Dhomën të nxjerrë përfundimin se Bashkim Rashiti u mbajt në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut afërsisht prej 11 korrikut deri më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai dhe të burgosur të tjerë u çuan në malet e Berishës prej rojeve të UÇK-së.

434. Nuk ka prova për keqtrajtim konkret ushtruar ndaj Bashkim Rashitit gjatë mbajtjes së tij nga UÇK-ja. Gjithsesi, siç u përmend më sipër[1474] Dhoma është e bindur se kushtet e burgimit ishin të tilla saqë ato u shkaktuan të burgosurve, ndër ta edhe Bashkim Rashitit vuajtje të rënda mendore ose fizike dhe ato përbënin sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor. Fakti se këto kushte u mbajtën për një kohë të gjatë e bind Dhomën se ato ishin imponuar qëllimisht. Duke lënë mënjanë çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma gjykon se në lidhje me Bashkim Rashitin është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6), mirëpo nuk është provuar vepra penale e torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Bashkim Rashitit prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës do të shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1475]

(xxvii) Hetem Rexhaj

435. Hetem Rexhaj jetonte në fshatin Petrovë.[1476] L96 dëshmoi se ai dëgjoi për rrethanat e rrëmbimit të Hetem Rexhajt prej një të afërmi të Hetem Rexhajt, i cili i tregoi L96-ës se ushtarë të maskuar të UÇK-së erdhën një natë në fillim të korrikut 1998 në shtëpinë e Hetem Rexhajt dhe i thanë Hetem Rexhajt se komandant Luani kishte kërkuar që ai të paraqitej të nesërmen në shtabin e UÇK-së në Kroimir.[1477] Thuhet se Hetem Rexhaj së bashku me të afërmin e tij e takoi komandant Luanin të nesërmen në shtabin e UÇK-së, në Kroimir. Kur i afërmi i Hetem Rexhajt u largua nga shtabi, ai pa pesë ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së të cilët ia mbuluan kokën me thes Hetem Rexhajt.[1478] Kjo dëshmi u kundërshtua nga Ramiz Qeriqi me pseudonimin Luani, i cili dëshmoi se ai i tha Hetem Rexhajt të shkonte në Shalë, kur ai erdhi për t'u anëtarësuar në Kromir, pasi ishte thirrur për t'u anëtarësuar në UÇK.[1479] Ramiz Qeriqi mohoi se kishte qenë i pranishëm kur Hetem

[1473] *Shih më poshtë,* paragrafët 489-492.
[1474] *Shih më sipër,* paragrafin 289.
[1475] *Shih më poshtë,* paragrafët 489-493.
[1476] L04, T 1136-1138; 1203; L96, T 2238; 2253; Prova Materiale P54.
[1477] L96, T 2259-2262.
[1478] L96, T 2262-2264.
[1479] Ramiz Qeriqi, T 3618-3619; 3706.

Rexhajt ia mbuluan kokën me thes.[1480] Prej kësaj dëshmie mbeten të pazgjidhura një sërë pikash, veçanërisht rrethanat e sakta të zhdukjes së Hetem Rexhajt dhe pjesëmarrja e mundshme e Ramiz Qeriqit me pseudonimin Luani. Gjithsesi, pavarësisht çfarëdo përgjigjeje të saktë për këto pika, duke marrë parasysh tërësinë e dëshmive, Dhoma vlerëson se është provuar se Hetem Rexhaj u zhduk në një kohë pasi ishte thirrur në fillim të korrikut 1998 në shtabin e UÇK-së në Kroimir.

436. Sipas dëshmisë së L04-ës ai u çua në ahur në fund të qershorit 1998.[1481] L04 dëshmoi se pas katër ditësh në dhomë prunë "Hetën nga Petrova", të cilin L04 e identifikoi në fotografi si Hetem Rexhaj.[1482] Kjo dëshmi përputhet me përfundimin e Dhomës mbi zhdukjen e Hetem Rexhajt dhe zbulon se ai u çua në kamp-burgun e Llapushnikut, pak pasi ishte zhdukur. Sipas dëshmisë së L04-ës, Hetem Rexhaj ishte ende në kamp-burg, ditën e fundit të burgimit, për të cilën Dhoma konkludoi se ishte më 25 ose 26 korrik 1998. Atë ditë të burgosurit e mbetur u mblodhën në oborr para se të shkonin në këmbë të shoqëruar prej rojeve të UÇK-së në malet e Berishës.[1483] Edhe L96 dëshmoi se e kishte parë Hetem Rexhajn në kamp-burg, megjithëse ata ishin mbajtur në vende të ndryshme.[1484] Sipas dëshmisë së L96-ës, në fillim të burgimit të tij, ai dëgjoi nga një ushtar i UÇK-së për të cilin tha se ishte Shala, se Hetem Rexhaj po mbahej në kamp-burg.[1485] Por vetëm më 25 ose 26 korrik 1998, ditën e fundit të burgimit, L96 e pa Hetem Rexhajn për herë të parë, ai ishte në oborr me të burgosurit e tjerë.[1486] Sipas L96-ës, Hetem Rexhaj "kishte ndryshuar krejtësisht" dhe "dukej si […] gjysma e çfarë kishte qenë, shumë i pafuqishëm, i dobësuar, i parruar…ishte në gjendje të tmerrshme."[1487] Kjo dëshmi si edhe dëshmitë e L04-ës, L12-ës dhe L96-ës se Hetem Rexhaj ishte midis të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës nën ruajtjen e UÇK-së, pasi të tjerët ishin liruar,[1488] e bindin Dhomën dhe ajo përfundon se në të vërtetë Hetem Rexhaj u mbajt nga UÇK-ja në kamp-burgun e Llapushnikut për një kohë afërsisht prej fillimit të korrikut deri më 25 ose 26 korrik 1998 kur ai bashkë me të burgosur të tjerë u çua nga rojet e UÇK-së në malet e Berishës. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht është provuar edhe se Hetem Rexhaj nuk merrte pjesë aktive në luftimet në atë kohë.

[1480] Ramiz Qeriqi, T 3707.
[1481] *Shih më sipër,* paragrafët 250-251.
[1482] L04, T 1136-1138.
[1483] L04, T 1192-1194.
[1484] *Shih më sipër,* paragrafin 267.
[1485] L96, T 2295.
[1486] L96, T 2349; 2354-2355; 2360; Prova Materiale P98 dhe P100.
[1487] L96, T 2349.
[1488] *Shih më poshtë,* paragrafin 494.

437. L04 dëshmoi se ai pa kur Hetem Rexhaj u rrah dhe u mor në pyetje në tre-katër raste prej një ushtari të UÇK-së, për të cilin L04 tha se ishte Shala,[1489] dhe një herë prej një ushtari të UÇK-së, për të cilin L04 deklaroi se ishte Çerçizi.[1490] Nuk ka dëshmi të tjera në lidhje me këto raste keqtrajtimesh. Megjithëse që Dhoma e pranon ndershmërinë e L04-ës në këtë dhe pjesën tjetër të dëshmisë së tij, në atë që ai deklaron, mungojnë kaq shumë saktësime dhe hollësi, saqë Dhoma mbetet disi e paqartë çfarë ndodhi në të vërtetë. Gjithashtu, kur L96 foli për gjendjen e Hetem Rexhajt, as ai e as dëshmitarë të tjerë nuk përmendën lëndime të dukshme apo shenja të tjera të sulmeve fizike kur Hetem Rexhaj u pa më 25 ose 26 korrik 1998. Në këto rrethana, në fund Dhoma nuk është e bindur se mbi bazën e dëshmive në dispozicion ajo duhet të nxjerrë përfundimin se gjatë burgimit të tij prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, ai u rrah disa herë.

438. Duke u bazuar në sa më sipër, dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma nuk është e bindur se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, Hetem Rexhaj iu nënshtrua keqtrajtimit fizik. Gjithesi, siç u përmend më sipër[1491] Dhoma është e bindur se kushtet e burgimit në ahur ishin të tilla saqë ato u shkaktuan të burgosurve, ndër ta edhe Hetem Rexhajt, vuajtje të rënda mendore ose fizike ose ato përbënin sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor. Fakti se këto kushte u mbajtën për një kohë të gjatë e bind Dhomën se ato ishin imponuar qëllimisht. Rrjedhimisht Dhoma gjykon se në lidhje me Hetem Rexhajn është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6), mirëpo nuk është provuar vepra penale e torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Hetem Rexhajt prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1492]

(xxviii) Lutfi Xhemshiti

439. Lutfi Xhemshiti i njohur si Luta ishte rojtar pylli nga fshati Breg i Zi[1493]. Dy të afërm të Lutfi Xhemshitit thanë në deklarata me shkrim të pranuara si prova, se ata ishin të pranishëm kur Lutfi Xhemshiti u arrestua prej ushtarëve të UÇK-së në shtëpinë e tij gjatë natës së 2 korrikut 1998.[1494] Ka dëshmi se pak netë para arrestimit, ushtarë të UÇK-së ndër ata edhe Ramiz Qeriqi me pseudonimin Luani, erdhën në shtëpinë e Lutfi Xhemshitit dhe konfiskuan pushkën.[1495] Mirëpo

[1489] L04, T 1136-1138; 1176-1177.
[1490] L04, T 1173-1174.
[1491] *Shih më sipër,* paragrafin 289.
[1492] *Shih më poshtë,* paragrafët 494-497.
[1493] L96 dëshmoi se ai e njihte Lutfi Xhemshitin që para luftës, T 2409. Dragan Jashoviq dëshmoi gjithashtu të njëjtën gjë, T 5306-5307.
[1494] Provat Materiale P195 dhe P196.
[1495] Ramiz Qeriqi, T 3614-3618; Provat Materiale P195 dhe P196.

Ramiz Qeriqi e mohoi në gjyq se kishte marrë pjesë në arrestimin faktik të Lutfi Xhemshitit,[1496] dhe duke marrë parasysh tërësinë e dëshmive, Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundime pohuese për këtë çështje.

440. Disa ish-të burgosur dëshmuan se e kishin parë Lutfi Xhemshitin në kamp-burgun e Llapushnikut. L07 dëshmoi se kur e çuan në fllanik dikur në korrik 1998, atje mbaheshin disa të burgosur, midis të cilëve ishte "Lutfiu nga Bregu i Zi."[1497] Edhe L06 e identifikoi Lutfi Xhemshitin në fotografi si të bashkëburgosur në fllanik.[1498] Kjo dëshmi konfirmohet edhe prej L10-ës, i cili dëshmoi se "Lutfiu nga Bregu i Zi" u mbajt bashkë me atë në fllanik,[1499] dhe prej L96-ës, i cili e identifikoi Lutfi Xhemshitin si të bashkëburgosur.[1500] Mbi bazën e këtyre dëshmive përputhëse, Dhoma është e bindur se Lutfi Xhemshiti u mbajt në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut për një kohë afërsisht prej 2 korrikut 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai bashkë me të burgosur të tjerë u çuan prej rojeve të UÇK-së nga kamp-burgu në malet e Berishës. Gjithashtu dëshmitë e përmendura më vonë në këtë vendim[1501] konfirmojnë përfundimin se Lutfi Xhemshiti ishte në grupin më të vogël të të burgosurve të cilët mbetën nën ruajtjen e UÇK-së në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998, pasi të tjerët ishin liruar, dhe se kufoma e tij u gjet midis atyre të të burgosurve të tjerë në një varr të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht është provuar edhe se Lutfi Xhemshiti nuk merrte pjesë aktive në luftimet në atë kohë.

441. Nuk ka dëshmitarë okularë për keqtrajtim të ushtruar ndaj Lutfi Xhemshitit gjatë burgimit të tij prej UÇK-së në kamp-burg. Mirëpo L07 dëshmoi se kur ai u çua fillimisht në fllanik, dukej se Lutfi Xhemshiti ishte rrahur egërsisht. Përveç kësaj dëshmie, ekziston edhe konfirmimi i qenësishëm prej ekzaminimit mjeko-ligjor të kufomës së Lutfi Xhemshitit, i cili zbuloi se ai kishte pësuar thyerje të dy brinjëve për shkak të ushtrimit të forcës me mjet jo të mprehtë, shkaktuar afërsisht dy javë para vdekjes, d.m.th. gjatë kohës kur ai mbahej nga UÇK-ja në kamp-burg.[1502] Megjithatë, nuk ka dëshmi për rrethanat konkrete të këtij keqtrajtimi dhe as për identitetet e kryesve.

[1496] Ramiz Qeriqi, T 3614-3618.
[1497] L07, T 821-822.
[1498] L06, T 1039-1045; Prova Materiale P54.
[1499] L10, T 2922-2925.
[1500] L96, T 2409. L96 e identifikoi Lutfi Xhemshitin në fotografi si "Luta" nga "Bregu i Zi".
[1501] *Shih më poshtë,* paragrafët 498-501.
[1502] Dr George Maat, T 5173-5175; Prova Materiale P200.

442. Bazuar në sa më sipër, dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma është e bindur se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut, Lutfi Xhemshiti iu nënshtrua rrahjeve të egra që i shkaktuan thyerje të shumta të brinjëve. Megjithëse, siç u përcaktua më lart Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundime mbi rrethanat konkrete të keqtrajtimit apo të kryesve të saktë, duke marrë parasysh provat e mjekësisë ligjore dhe kushtet e përgjithshme në kamp-burg, Dhoma është e bindur se Lutfi Xhemshiti iu nënshtrua vuajtjeve ose lëndimeve të rënda fizike dhe mendore dhe se kryesit vepruan qëllimisht. Rrjedhimisht Dhoma përfundon se është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6). Mirëpo bazuar në dëshmitë Dhoma nuk është e bindur se keqtrajtimi i Lutfi Xhemshitit u krye për ndonjë synim të ndaluar dhe rrjedhimisht gjykon se nuk janë provuar elementët e veprës penale të torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Lutfi Xhemshitit prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1503]

(xxix) Shyqyri Zymeri

443. Shyqyri ose "Shyqë" Zymeri ishte nga fshati Godanc.[1504] Një i afërm i tij dha një deklaratë se gjatë natës së 26 qershorit 1998, ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së erdhën në shtëpinë e Shyqyri Zymerit, konfiskuan një pushkë, pyetën Shyqyri Zymerin për një pistoletë, dhe e arrestuan forcërisht.[1505]

444. L04 dëshmoi se ishte mbajtur në ahur, në kamp-burgun e Llapushnikut me "Shyqën nga Godanci", të cilin e identifikoi në fotografi si Shyqyri Zymeri.[1506] Edhe L96 deklaroi se "Shyqja nga Godanci", të cilin ai e identifikoi në fotografi si Shyqyri Zymeri, ishte në kamp-burgun e Llapushnikut,[1507] megjithëse duket se L96 nuk e kishte parë atë para ditës së fundit, më 25 ose 26 korrik 1998, kur të burgosurit u mblodhën në oborr dhe u shoqëruan në malet e Berishës. Që të dy, L04 dhe L96 përshkruan sesi Shyqyri Zymeri kishte një këmbë të thyer, dhe sesi e mbartën gjatë ecjes së vështirë nën ruajtjen e UÇK-së për në malet e Berishës.[1508] Në lidhje me këtë Dhoma thekson se edhe L06 në dëshminë e tij tha se një prej të burgosurve të cilët u çuan ditën e fundit në

[1503] *Shih më poshtë,* paragrafët 498-502.
[1504] Prova Materiale P224.
[1505] Prova Materiale P224; *shih edhe* Provën Materiale P221. Gjithashtu Dragan Jashoviqi dëshmoi se atij iu raportua se Shyqyri Zymeri u arrestua bashkë me disa persona të tjerë nga individë të panjohur më 27 qershor 1998. Dragan Jashoviqi dëshmoi se pati raporte ku pretendohej përfshirja e Ramiz Qeriqit i njohur si Luani, ndër të tjerë, T 5223-5224; 5231-5243. Ramiz Qeriqi e mohoi përfshirjen e tij në këto arrestime, T 3623. Gjithsesi nuk ka dëshmi të tjera që do t'i mundësonin Dhomës të arrinte në një përfundim mbi këtë çështje.
[1506] L04, T 1131-1135; 1199-1206; Prova Materiale P54.
[1507] L96, T 2409; Prova Materiale P54.
[1508] L04, T 1139-1141; L96, T 2349-2350; 2352; 2363; 2409.

malet e Berishës, kishte një këmbë të thyer.[1509] Këto dëshmi përputhëse si edhe fakti i përmendur më vonë në këtë vendim[1510] se Shyqyri Zymeri ishte në grupin më të vogël të të burgosurve të cilët mbetën nën ruajtjen të UÇK-së në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998, pasi të tjerët ishin liruar, dhe se kufoma e tij u gjet midis atyre të të burgosurve të tjerë në një varr të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës e bindin Dhomën të nxjerrë përfundimin se Shyqyri Zymeri u mbajt në ahur, në kamp-burgun e Llapushnikut për një kohë afërsisht prej 27 qershorit 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai dhe të burgosurit e tjerë u çuan prej rojeve të UÇK-së në malet e Berishës. Përfundimi i Dhomës është se rrjedhimisht është provuar edhe se Shyqyri Zymeri nuk merrte pjesë aktive në luftimet në atë kohë.

445. Veç dëshmive të saposhqyrtuara për këmbën e thyer të Shyqyri Zymerit në kohën e largimit nga kamp-burgu, ekzaminimi mjeko-ligjor i kufomës së tij zbuloi se ai kishte pësuar thyerje të shumta të katër brinjëve dhe të fyellit të këmbës së djathtë për shkak të forcës me një sendi jo të mprehtë shkaktuar dy-tri javë para vdekjes,[1511] d.m.th. kur ai u mbajt prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut. Megjithatë nuk ka prova për rrethanat e këtij keqtrajtimi apo për identitetin e kryesit ose kryesve.

446. Bazuar në sa më sipër, dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të tre të Akuzuarve, Dhoma është e bindur se gjatë periudhës së burgimit të tij prej UÇK-së, në kamp-burgun e Llapushnikut, Shyqyri Zymeri iu nënshtrua keqtrajtimit të egër që i shkaktoi thyerje të shumta. Megjithëse Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundime pohuese mbi rrethanat e keqtrajtimit apo të identitetit të kryesve, duke marrë parasysh provat e mjekësisë ligjore dhe kushtet e përgjithshme në kamp-burg, Dhoma është e bindur se Shyqyri Zymeri iu nënshtrua vuajtjeve ose lëndimeve të rënda fizike dhe mendore dhe se kryesit vepruan qëllimisht. Rrjedhimisht Dhoma përfundon se është provuar vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6). Mirëpo Dhoma nuk mund të bindet se keqtrajtimi i Shyqyri Zymerit u krye për ndonjë synim të ndaluar të nevojshëm për të provuar veprën penale të torturës (Pika 4). Akuza e vrasjes së Shyqyri Zymerit prej UÇK-së më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në malet e Berishës shqyrtohet më vonë në këtë vendim.[1512]

[1509] L06, T 1025-1028.
[1510] *Shih më poshtë,* paragrafët 503-506.
[1511] Dr George Maat, T 5164-5168. Prova Materiale P200. *Shih* edhe, Provën Materiale P111.
[1512] *Shih më poshtë,* paragrafët 503-507.

3. Krimet në malet e Berishës (Pika 10)

447. Në Aktakuzë deklarohet se më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date, dhjetë shqiptarë kosovarë, të burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut, u vranë në malet e Berishës.[1513] Emrat e atyre që thuhet se janë viktimat, përmenden në Shtojcën III të Aktakuzës. Mbi bazë të këtyre akuzave, të Akuzuarit Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj ngarkohen me dy akuza për vrasje si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit, përkatësisht në bazë të Neneve 3 dhe 5 të Statutit (Pikat 9 dhe 10). Për arsyet e përmendura më parë,[1514] për rastin në fjalë, Pika 9 hidhet poshtë.

448. Siç është përmendur më parë në këtë vendim, më 25 ose 26 korrik 1998, forcat serbe nisën një ofensivë të madhe kundër forcave të UÇK-së në rrethinën e Llapushnikut.[1515] Zhvillimi i ofensivës në dobi të forcave serbe, shkaktoi përshpejtimin e largimit të forcave të UÇK-së nga Llapushniku dhe kamp-burgu. Prej dëshmive nuk del krejtësisht e qartë nëse kamp-burgu u braktis më 25 apo 26 korrik 1998, megjithëse ky fakt nuk ndikon mbi përfundimet e Dhomës në lidhje me ngjarjet fill pas braktisjes së kamp-burgut. Dëshmitë tregojnë se në mëngjesin e 25 ose 26 korrikut 1998, dy rojat e identifikuar si Shala dhe Murrizi, i mblodhën në oborr ata të burgosur të cilët ndodheshin në atë kohë në kamp-burg, prej vendeve ku mbaheshin.[1516] Dëgjoheshin granatime.[1517] Shala dhe Murrizi të armatosur me automatikë, urdhëruan afërsisht 20 të burgosur të ecnin drejt maleve të Berishës. Murrizi u priu drejt kodrave.[1518] Shala ecte në fund.[1519] Disa dëshmitarë treguan para Dhomës se shumë prej të burgosurve ishin në gjendje të dobët fizike, disa më keq se të tjerët.[1520] Në veçanti, një i burgosur kishte një këmbë të thyer dhe duhej mbartur gjatë tërë ecjes.[1521]

449. L96 dëshmoi se gjatë rrugës, kur grupi kishte marrë një shteg kryesor në pyll, aty afër kaloi një traktor me civilë të armatosur.[1522] Në atë kohë Shala ishte afër L96-ës. Sipas dëshmisë së L96-ës, ai dëgjoi Shalën kur tha se po vinte "komandant Çeliku" dhe ai do ta pyeste çfarë të bënte me të burgosurit.[1523] Pastaj Shala i urdhëroi të burgosurit të ndaleshin dhe shkoi të fliste me një njeri në

[1513] Aktakuzë, paragrafët 34-37.
[1514] *Shih më sipër,* paragrafin 228.
[1515] *Shih më sipër,* paragrafët 78-81.
[1516] L04, T 1192-1194; L12, T 1813-1815; L06, T 1025; 1028; L10, T 2960-2961; L96, T 2347; 2515.
[1517] L12, T 1813-1815; L06, T 1025; 1028; L10, T 2960.
[1518] L12, T 1815-1818; L96, T 1485-2486.
[1519] L12, T 1815-1818; L06, T 1107; L10, T 2960-2961.
[1520] L06, T 1025; 1028; L10, T 2960-2961; L96, T 2349-2350.
[1521] L06, T 1025; 1028; L10, T 2960-2961; L12, T 1815-1818; L96, T 2349-2350.
[1522] L96, T 2364; Prova Materiale P106.
[1523] L96, T 2364.

uniformë;[1524] më pas ai u kthye me një nga njerëzit që shoqëronin komandantin dhe i urdhëroi të burgosurit të vazhdonin ecjen.[1525] Siç përmendet më vonë në këtë vendim,[1526] megjithëse dy të burgosur dëshmuan se kishin parë një traktor kur po ecnin, dëshmia e L96-ës nuk u konfirmua për pikat e tjera prej ndonjë nga dëshmitarëve të cilët përshkruan ecjen.[1527]

450. Grupi arriti në malet e Berishës dhe ndaloi afër një qershie.[1528] Dëshmitë e të mbeturve gjallë nga ajo ditë përputhen në faktin se afërsisht pas dy orësh, Shala thirri emrat e rreth 10 të burgosurve, d.m.th. afërsisht gjysma e grupit, të cilët u çuan nja 100 metra më larg.[1529] Secilit prej tyre iu dha nga një pusullë e cila konfirmonte lirimin e tyre dhe iu tha të shkonin.[1530] Ndërsa shumica prej dëshmitarëve thanë se ishte Shala ai që i zgjodhi dhe liroi të burgosurit, një dëshmitar dëshmoi se ai u lirua nga Murrizi.[1531] Nuk ekziston asnjë pusullë si provë. Përfundimi i Dhomës është se në procesin e lirimit të të burgosurve morën pjesë si Shala po ashtu edhe Murrizi.

451. Vetëm një dëshmitar, L96, dha dëshmi të drejtpërdrejtë për atë që ndodhi me të burgosurit të cilët mbetën në malet e Berishës pas lirimit të grupit të parë. L96 dëshmoi se nja dyzet minuta ose dy orë[1532] pasi grupi i parë i të burgosurve u largua në një anë dhe u lirua, Shala u kthye te qershia, thirri emrat e të burgosurve të cilët kishin mbetur dhe urdhëroi Murrizin t'i çonte në një vend tjetër.[1533] Grupi arriti në një vend të hapur. Të burgosurve iu dha ujë dhe Shala i urdhëroi të uleshin.[1534] Sipas dëshmisë së L96-ë, në atë kohë Shala shoqërohej prej Murrizit dhe një ushtari tjetër, për të cilin Shala tha se ishte dërguar prej personit për të cilin ai pretendon se ishte komandant Çeliku.[1535] Pastaj Shala u tha diçka Murrizit dhe ushtarit të tretë dhe pas kësaj Shala u tha të burgosurve, "Jeni dënuar me vdekje" dhe filloi të mbushte armën. Dy të tjerët tashmë kishin zënë pozicion. L96 deklaroi se ai vrapoi menjëherë në drejtim të kundërt të tre njerëzve kur dëgjoi zjarr automatiku prej dy Kallashnikovëve. Ai dëgjoi britma. Ai dëshmoi se arriti të arratisej, duke u rrokullisur teposhtë kodrës. Pas një farë kohe, nuk u dëgjuan më të shtëna apo britma. Sipas dëshmisë së L96-ës, ai e pati të qartë se të burgosurit kishin vdekur.[1536]

[1524] L96, T 2364-2365.
[1525] L96, T 2365.
[1526] *Shih më poshtë,* paragrafin 554.
[1527] L04, T 1192-1195; L10, T 2966; L12 dëshmoi se gjatë ecjes ai nuk pa asnjë person, T 1818. L06, T 1025-1026.
[1528] L06, T 1028-1029; L10, T 2962; L96, T 2372-2374; Prova Materiale P108; *Shih më sipër,* paragrafin 278.
[1529] L06, T 1028-1030; L12, T 1815-1818; L10, T 2962-2963.
[1530] L06, T 1028-1030; L10, T 2962-2965; L12, T 1817-1818.
[1531] L04, T 1194-1195.
[1532] L96, T 2377; 2486.
[1533] L96, T 2377-2379.
[1534] L96, T 2379-2381; Provat Materiale P108 dhe P109.
[1535] L96, T 2365.
[1536] L96, T 2381-2383.

452. L96 dëshmoi se më vonë ai zbuloi se edhe një person tjetër, Xheladin Ademaj, kishte mbetur gjallë prej ekzekutimit.[1537] Xheladin Ademaj nuk ka dëshmuar në këtë proces. Kaare Birkeland, ish-hetues i CCIU-së /Njësia Qendrore Hetimore Kriminale/, dëshmoi se ai e intervistoi Xheladin Ademajn më 13 shtator 2000.[1538] Gjatë kësaj interviste, Xheladin Ademaj nuk përmendi asgjë në lidhje me një ekzekutim në malet e Berishës; ai vetëm deklaroi se ishte çuar në një pyll prej ushtarëve të UÇK-së të cilët i kishin thënë të shkonte.[1539] Kaare Birkeland dëshmoi se kur ai e ballafaqoi Xheladin Ademajn me deklaratën e L96-ës në lidhje me ekzekutimin, Xheladin Ademaj e pranoi gojarisht para Kaare Birkeland-it se ai kishte gënjyer në deklaratën e mëparshme, mirëpo nuk dëshironte që kjo të ishte e dokumentuar.[1540] Gjithsesi, dy të burgosur të cilët u çuan në malet e Berishës prej ushtarëve të UÇK-së më 25 ose 26 korrik 1998, L04 dhe L12, dëshmuan se "Xhela", të cilin e njohën në fotografi si Xheladin Ademaj, ishte midis të burgosurve të cilët mbetën pas lirimit të grupit të parë.[1541] Kjo dëshmi e bind Dhomën se Xheladin Ademaj ishte midis të burgosurve të cilët mbetën nën ruajtjen e UÇK-së në malet e Berishës pasi disa prej tyre u liruan dhe se, ose Xheladin Ademaj i shpëtoi ekzekutimit, ose u lirua më 25 ose 26 korrik 1998. Siç jepet më vonë në hollësi, Dhoma nuk mund të përjashtojë apo konfirmojë mundësinë se dhe Hetem Rexhaj mbeti gjallë prej ekzekutimit.[1542]

453. Dëshmia e L96-ës në lidhje me identitetin e kryesve të pretenduar ka nevojë për shqyrtim të mëtejshëm. Për arsye të shpjeguara më vonë në këtë vendim, Dhoma nuk mund të pranojë si të saktë dhe të besueshme, dëshminë e L96-ës në lidhje me takimin me komandant Çelikun.[1543] Gjithashtu Dhoma nuk është e bindur se në kohën e pushkatimit ishte i pranishëm edhe një ushtar i tretë, sipas përshkrimit të L96-ës, ushtar i dërguar nga Çeliku, dhe i cili ishte me Shalën dhe Murrizin në kohën e ekzekutimit. Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundim pohues në një mënyrë apo tjetrën lidhur me praninë e ushtarit të tretë. Një element tjetër i rëndësishëm i dëshmisë së L96-ës për takimin dhe bisedën midis Shalës dhe personit për të cilin ai tha se ishte komandant Çeliku, më 25 ose 26 korrik 1998, është se në atë takim, komandant Çeliku veçoi një prej ushtarëve në traktor

[1537] L96, T 2397-2398.
[1538] Kaare Birkeland, T 1644-1648.
[1539] Kaare Birkeland, T 1649-1650; Prova Materiale P85. Kaare Birkeland dëshmoi se deklarata ishte bazuar në shënimet që ai kishte marrë gjatë intervistës më 13 shtator 2000 dhe ishte nënshkruar prej Xheladin Ademajt më 21 shtator 2000, T 1647-1648. Shënimet origjinale të Kaaren Birkeland ishin "asgjësuar" pasi ai u largua nga Kosova, T 1666-1667.
[1540] Kaare Birkeland, T 1657-1659; 1677; 1687; 1690. Kaare Birkeland i bëri një shtojcë deklaratës origjinale, por shtojca nuk është nënshkruar prej Xheladin Ademaj, Prova Materiale P86.
[1541] L04, T 1197-1198; L12, T 1824-1829; Prova Materiale P54. Gjithashtu ka prova se Xheladin Ademaj u mbajt si i burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut, L04, T 1136-1138; L12, T 1820-1823.
[1542] *Shih më poshtë,* paragrafët 494-497.
[1543] *Shih më poshtë,* paragrafët 553-556.

që të ishte si rojë e tretë me Shalën dhe Murrizin për pjesën tjetër të ecjes dhe në fund për ekzekutimin e disa të burgosurve. Vetëm një i burgosur tjetër, L10, përmend një rojë të tretë, megjithëse dëshmia e tij nuk tregon sesi u bashkua ky ushtar me grupin.[1544] Provat kriminalistike në lidhje me çfarë u zbulua te kufomate e varrosura të shumicës së grupit të fundit të të burgosurve në malet e Berishës, dhe shumë pranë tyre, mund të kishin ofruar konfirmimin e pranisë vepruese të një rojeje të tretë në kohën e ekzekutimit të të burgosurve. Të varrosur me kufomat dhe shumë afër tyre, u gjetën një sërë gëzhojash dhe fishekësh të harxhuar. Për disa është provuar se janë shkrepur prej një Kallashnikovi. Për disa të tjera është provuar se janë shkrepur prej një Kallashnikovi tjetër, duke konfirmuar kështu përdorimin e të paktën dy armëve të ngjashme në ekzekutim. Disa gëzhoja dhe fishekë ishin në gjendje të tillë të keqe saqë nuk mund të nxirrej asnjë përfundim nga çfarë arme ishin shkrepur. Ishte edhe një grup tjetër i vogël gëzhojash dhe fishekësh. Ata kishin të njëjtin kalibër si Kallashnikovi por gjendja e tyre nuk mundësonte nxjerrjen e një përfundimi nëse ato ishin shkrepur prej dy armëve të lartpërmendura. Kështu ndërsa provat e kriminalistikës konfirmojnë se për vrasjen e të burgosurve u përdorën të paktën dy Kallashnikovë, këto prova, as provojnë dhe, as përjashtojnë përdorimin e një Kallashnikovi të tretë. Rrjedhimisht provat e kriminalistikës as konfirmojnë dhe, as mohojnë praninë vepruese të një rojeje të tretë në malet e Berishës në kohën e ekzekutimit. Dëshmitë e L10-ës dhe L96-ës në lidhje me praninë e një rojeje të tretë mund të jenë ose mund të mos jenë të sakta.

454. Megjithatë, Dhoma është e bindur dhe prej rrethanave të përgjithshme nxjerr përfundimin se ushtarët e UÇK-së të identifikuar si Shala dhe Murrizi, ishin me grupin e dytë të burgosurve në Berishë dhe ishin të pranishëm dhe pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në pushkatimin e të burgosurve. Ky përfundim mund të nxirret nga tërësia e dëshmive në lidhje me rolin e Shalës dhe të Murrizit në kamp-burg,[1545] nga fakti se kur Llapushniku u sulmua nga serbët, të dy personat i shoqëruan të burgosurit e mbetur gjatë ecjes në malet e Berishës,[1546] nga roli i tyre i përbashkët në lirimin e grupit të parë të të burgosurve,[1547] duke i lënë të burgosurit e tjerë, duke përfshirë edhe L96-ën, me Shalën dhe Murrizin,[1548] dhe se më vonë në rrethinë u zbuluan kufomat e të gjithë të burgosurve, me përjashtim të L96-ës, Hetem Rexhajt dhe Xheladin Ademajt.[1549] Përfundimi i Dhomës është se Shala dhe Murrizi dhe ndoshta një ushtar i tretë i UÇK-së, vepruan së bashku, kur shtinë dhe vranë

[1544] L10, T 2961-2963.
[1545] *Shih më sipër,* paragrafin 276.
[1546] *Shih më sipër,* paragrafët 448; 450.
[1547] *Shih më sipër,* paragrafin 450.
[1548] *Shih më sipër,* paragrafin 450.
[1549] *Shih më poshtë,* paragrafët 457; 459; 464; 469; 474; 481; 485; 490; 499 dhe 504.

të gjithë të burgosurit e mbetur me përjashtim të L96-ës, Xheladin Ademajt dhe ndoshta Hetem Rexhajt.

455. L96 dëshmoi se pak kohë para se t'u jepte një intervistë të dytë hetuesve të CCIU-së në gusht 2001, ai u kthye në Llapushnik me dy të afërm me qëllim që të gjente vendin e vrasjeve në malet e Berishës. Ai tha se në vendin e ekzekutimit mund të shiheshin ende eshtra dhe kafka, megjithëse aty ishte hedhur dhe.[1550] Sipas dëshmisë së L96-ës më vonë ai i çoi hetuesit e CCIU-së në atë vend.[1551]

456. Rrethanat e arratisjes së L96-ës ashtu siç i tregoi ai, janë jobindëse. L96 përshkroi tre ushtarë të armatosur me Kallashnikovë të cilët qëndronin në këmbë afërsisht shtatë metra larg 12 të burgosurve të ulur pranë shoshoqit.[1552] Gjithashtu L96 dëshmoi se një prej ushtarëve ishte përballë tij dhe sugjeroi se ndoshta ky ushtar nuk shtiu qëllimisht kundër tij.[1553] Në këto rrethana është e vështirë të përfytyrohet sesi mundi t'i shpëtojë L96 ekzekutimit fizikisht. Një problem tjetër shqetësues sipas pikëpamjes së Dhomës është përpjekja e vazhdueshme e L96-ës gjatë dëshmisë së tij për t'i bishtnuar pranimit të kontakteve shoqërore dhe të tjera të mëhershme të tija me serbët.[1554] Veçanërisht Dhoma nuk mund të pranojë dëshminë e L96-ës se ai eci vetëm rreth 40 km përmes territorit të kontrolluar prej UÇK-së, pas arratisjes prej pushkatimit në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998, dhe arriti në Ferizaj.[1555] Dhoma mendon se e vërteta është se L96 u dorëzua te policët serbë në postbllokun e Komoranit, pak pas arratisjes së tij, pas të cilës ai u dha një intervistë të hollësishme autoriteteve serbe.[1556] Mendimi i Dhomës është se dëshmia e dhënë prej L96-ës në lidhje me çfarë bëri fill pas arratisjes e deri sa u dha informacion autoriteteve serbe për periudhën e tij të burgimit prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, dhe aspekte të tjera të dëshmisë së tij duke përfshirë tregimin e tij të veçantë sesi grupi që po ecte u takua me Fatmir Limajn dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së në një traktor në malet e Berishës atë ditë, u ndikuan prej përpjekjeve të L96-ës për të mos pranuar karakterin e vërtetë dhe shkallën e lidhjeve të tij me disa serbë. Siç është treguar më parë, Dhoma ka rezerva të mëdha për disa aspekte të dëshmisë së tij dhë përgjithësisht nuk është e gatshme të pranojë dëshminë e tij nëse ajo nuk përputhet me çfarë kanë thënë dëshmitarë të tjerë të besueshëm, apo nuk konfirmohet në pika të rëndësishime prej dëshmive të tjera.[1557]

[1550] L96, T 2401-2402.
[1551] L96, T 2402-2403.
[1552] L96, T 2381-2383.
[1553] L96, T 2473-2474.
[1554] *Shih më sipër,* paragrafin 26.
[1555] L96, T 2388-2389; 2420-2425.
[1556] L96, T 2424-2428; Dragan Jashoviq, T 5284.
[1557] *Shih më sipër,* paragrafin 26.

457. Dhomës iu paraqit një numër i madh dëshmish në lidhje me këto ngjarje, duke përfshirë edhe dëshmi ekspertësh. Judy Thomas, oficere e policisë kanadeze e cila shërbeu në CCIU shpjegoi në një deklaratë me shkrim e cila u pranua si provë me pëlqimin e mbrojtjes, sesi fillimisht u gjetën dhe zhvarrosën tetë kufoma në një vend të largët në malet e Berishës midis 20 dhe 24 gushtit 2001,[1558] dhe sesi pas një kontrolli tjetër më 11 prill 2002 u gjet kufoma e nëntë, afërsisht 14 metra larg vendit fillestar të varrimit.[1559] Dy civilë i çuan hetuesit në atë vend.[1560] Mbetjet e kufomave të zbuluara në fillim të tetë personave dhe pastaj të kufomës së nëntë të gjetur më vonë iu nënshtruan ekzaminimit të hollësishëm të mjekësisë ligjore.[1561] Gjithashtu Judy Thomas shënoi se në atë vend nuk kishte varre ose gropa të shënuara dhe kufomat ishin mbuluar me dhe i cili nuk ishte dheu që i përkiste atij vendi. Ky fakt dhe përfundime të tjera e çuan atë në përfundimin se megjithëse viktimat ishin vrarë në vendin ku u gjetën, kufomat ishin mbuluar ca kohë më vonë.[1562] Autopsia e mbetjeve skeletore të tetë kufomave të para u krye prej një antropologeje mjeko-ligjore të OSBE-së, Dr. Tarja Formisto, midis 5 dhe 12 shtatorit 2001; ajo e kufomës së nëntë u krye nga i njëjti person më 16 prill 2002.[1563] Kjo autopsi provoi për të tërë kufomat se vdekja kishte ndodhur më shumë se dy vjetë më parë, që përputhet me kohën e vrasjeve të pretenduara.[1564] Më tej u kryen dy ekzaminime antropologjike të mbetjeve të kufomave prej një ekipi ekspertësh të udhëhequr prej Dr. Jose Pablo Baraybar, midis nëntorit 2002 dhe dhjetorit 2003,[1565] dhe prej Dr. George Maat në korrik 2003.[1566] Në maj 2004, Dr. Daniel Vacek i Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur ("KNPZH") paraqiti një raport mbi rezultatet e analizës ADN të mostrave biologjike të tetë prej nëntë kufomave, këto mostra ishin dhënë prej CCIU-së. Në dhjetor 2004 u paraqit shtojca e raportit.[1567] Analiza balistike e gëzhojave, fishekëve dhe coprave, të cilat siç kanë pranuar edhe palët u gjetën në vendin e zhvarrimit,[1568] zbulon praninë e më se 30 gëzhojave të kalibrit të automatikut Kallashnikov, shumicë e cilëve të prodhuar në Shqipëri, disa në Kinë dhe një në Gjermaninë Lindore.[1569] Siç u përmend më lart, përfundimet e ekspertit të balistikës, Wim Kerkhoff, duket se tregojnë se shumica e gëzhojave u shkrepën prej dy Kallashnikovëve të ndryshëm, por disa gëzhoja të një kalibri të ngjashëm nuk mund të përcaktoheshin se ishin shkrepur prej ndonjë nga këta dy Kallashnikovë. U

[1558] Prova Materiale P110; Vendndodhja u identifikua nga Sateliti për Pozicionim Global si 88467E-09500N.
[1559] Prova Materiale P110, paragrafët 41-42 të deklaratës dhe përkujtesës së Judy Thomas-it 0323-2015.
[1560] Prova Materiale P110, paragrafi 18 i deklaratës së Judy Thomas-it.
[1561] Prova Materiale P110, paragrafët 41-42 të deklaratës dhe përkujtesës së Judy Thomas-it 0323-2015.
[1562] Prova Materiale P110, paragrafi 39 i deklaratës së Judy Thomas-it.
[1563] Prova Materiale P111.
[1564] Prova Materiale P111.
[1565] Prova Materiale P111.
[1566] Prova Materiale P200.
[1567] Të dy, raporti dhe shtojca u pranuan si Prova Materiale P112.
[1568] T 2580.
[1569] Prova Materiale P113, f 7.

analizuan edhe një grup prej pesë fishekësh dhe një veshje fisheku. Mirëpo, jo papritmas, nuk mund të përcaktohej nëse ndonjë prej plumbave ishte shkrepur prej ndonjë nga gëzhojat ose nëse ishte shkrepur ose jo prej dy armëve të lartpërmendura apo nga ndonjë armë e tretë e një kalibri të ngjashëm.[1570] Në vend u gjet edhe një copë metalike po asgjë e rëndësishme nuk doli prej ekzaminimit të saj balistik.[1571] Me kufomat u gjetën gjashtë gëzoja dhe pesë fishekë.[1572] Të gjithë këto aktekspertime u pranuan si prova me pëlqimin e Mbrojtjes dhe Mbrojtja nuk e ka kundërshtuar vlefshmërinë apo saktësinë e përfundimeve të këtyre ekspertëve në ekzaminimet e tyre mjeko-ligjore, të ADN-së dhe balistike.[1573] Vendndodhja e vendvarrimit ku u gjetën nëntë kufomat, d.m.th. në male në perëndim të fshatit Berishë afër rrugës që çon në Kleçkë,[1574] përgjithësisht përputhet me dëshmitë e të burgosurve, përfshirë edhe atë të L96-ës.

(a) Emin Emini

458. Më herët në këtë vendim Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Emin Emini u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1575] Dhoma dëgjoi dëshmi gojore se Emin Emini ishte midis grupit të vogël të të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës kur u lirua grupi i parë. L04 dëshmoi se Emin Emini, të cilin ai e identifikoi në fotografi,[1576] ishte njëri nga të burgosurit të cilët mbetën në malet e Berishës kur ai u lirua.[1577] Kur u pyet, L12 kujtoi emrat e disa të burgosurve duke përfshirë edhe Emin Eminin, për të cilin deklaroi se ishte në grupin që mbeti në malet e Berishës kur ai u lirua.[1578] Edhe L96 e identifikoi Emin Eminin në fotografi si njërin prej të burgosurve të grupit që ishte çuar për ekzekutim.[1579]

459. Analiza e ADN-së e kryer mbi mostrat eshtërore të kufomës 3 (NN987) e gjetur në varrin e madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, kur u krahasua me ADN-në e një mostre gjaku dhënë prej një anëtari të familjes së Emin Eminit, zbuloi se gjasa e lidhjes familjare ishte më e madhe se 98.8%.[1580] Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se njëra prej kufomave (kufoma 3-NN987) gjetur në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës ishte e Emin Eminit.

[1570] Prova Materiale P113, f 9.
[1571] Prova Materiale P113, f 9.
[1572] Prova Materiale P110.
[1573] T 2575-2581.
[1574] Prova Materiale P1, hartat 6 dhe 7.
[1575] *Shih më sipër,* paragrafin 410.
[1576] L04, T 1199-1206; Prova Materiale P54.
[1577] L04, T 1196-1197; Prova Materiale P76.
[1578] L12, T 1820-1823. L12 e identifikoi Emin Eminin në fotografi, T 1824-1829; Prova Materiale P54.
[1579] L96, T 2405-2409; Prova Materiale P54. Megjithëse emri i Emin Eminit nuk figuron si i tillë midis emrave të të burgosurve në vendin e ekzekutimit të përmendur në listen e L96-ës, duket se ai identifikohet në atë listë si "Emin Idrizi Carralevë" Prova Materiale, P108.
[1580] Prova Materiale P112, f. 6 e raportit dhe f. 5 e shtojcës.

460. Autopsia e kryer nga Dr. Tarja Formisto mbi kufomën NN987, më 6 shtator 2001, zbuloi një plagë plumbi në kafkë.[1581] Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN987 kryer më vonë prej Dr. Jose Pablo Baraybar qartësoi se vdekja ishte shkaktuar nga plagë të shumta plumbi në kokë.[1582] Ky përfundim u konfirmua thelbësisht edhe nga një ekzaminim tjetër mjeko-ligjor kryer prej Dr. George Maat, i cili zbuloi se viktima NN987 kishte thyerje të shumta rreth ose në kohën e vdekjes për shkak të dëmtimeve mekanike dhe të përputhshme me plagë plumbi dhe dëmtim prej forcës së një mjeti jo të mprehtë.[1583]

461. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur se kufoma e Emin Eminit u zhvarros prej varrit të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës dhe se Emin Emini u vra në të njëjtin vend me shumë të shtëna. Edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, dëshmitë mbi mbajtjen e Emin Eminit në kamp-burg, prania e tij në grupin e fundit të burgosurve që u mbajtën në vendin e përgjithshëm në malet e Berishës prej ushtarëve të UÇK-së të njohur si Shala dhe Murrizi, të cilët ishin të dy të armatosur në atë kohë, mënyra e vdekjes së tij (plagë të shumta plumbi) dhe numri i viktimave të cilët pësuan të njëjtin fat, nuk i lënë asnjë dyshim Dhomës se Emin Emini u vra prej të tjerëve dhe se kryesit ishin anëtarët e UÇK-së të njohur si Shala dhe Murrizi, të cilët vepruan së bashku dhe me synim për ta vrarë atë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën kur u vra, Emin Emini mbahej nga UÇK-ja dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

462. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Emin Eminin janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

(b) Ibush Hamza

463. Më parë Dhoma ka nxjerrë përfundimin se dëshmitë në lidhje me identitetet e atyre të cilët u mbajtën në kamp-burgun e Llapushnikut, në vetvete nuk provojnë se Ibush Hamza është mbajtur në

[1581] Prova Materiale P111.
[1582] Prova Materiale P111.
[1583] Prova Materiale P200.

kamp-burgun e Llapushnikut.[1584] Mirëpo emri "Ibush" del në listën e personave të cilët L04 dëshmoi se mbetën në malet e Berishës pas lirimit të tij.[1585] Përfundimi i qartë është se një person të cilin L04 e njohu në kamp si Ibushi, ishte i bashkëburgosur në kamp, ishte një prej të burgosurve të cilët u çuan në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998 dhe ishte në grupin e fundit të të burgosurve që mbeti pas lirimit të disa të burgosurve. Ky është përfundimi i Dhomës.

464. Analiza e ADN-së e kryer mbi mostrat eshtërore të kufomës 1 (NN985) e gjetur në varrin e madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, kur u krahasua me ADN-në e mostrave të gjakut dhënë prej anëtarëve të familjes së Ibush Hamzës, zbuloi se gjasa e lidhjes familjare ishte më e madhe se 99.9%[1586] me ADN-në e kufomës 1 (NN985). Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se njëra prej kufomave (kufoma 1-NN985) gjetur në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës ishte e Ibush Hamzës, i njohur në kamp prej L04-ës si Ibushi.

465. Autopsia e kryer nga Dr. Tarja Formisto mbi kufomën NN985 më 5 shtator 2001, zbuloi plagë të shumta plumbi.[1587] Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN985 kryer më vonë prej Dr. Jose Pablo Baraybar qartësoi se vdekja ishte shkaktuar nga plagë të shumta plumbi në krahëror dhe në legen.[1588] Ky përfundim u konfirmua edhe nga një ekzaminim tjetër mjeko-ligjor kryer prej Dr. George Maat, i cili zbuloi se viktima NN985 kishte pësuar thyerje të shumta rreth ose në kohën e vdekjes për shkak të dëmtimeve mekanike.[1589]

466. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur se kufoma e Ibush Hamzës u zhvarros prej varrit të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës dhe se Ibush Hamza u vra në të njëjtin vend me shumë të shtëna. Edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, dëshmia e L04-ës mbi burgimin e personit të cilin ai e njihte si Ibushi, prania e këtij njeriu në grupin e fundit të të burgosurve që u mbajtën në vendin e përgjithshëm në malet e Berishës prej ushtarëve të UÇK-së të njohur si Shala dhe Murrizi, të cilët në atë kohë ishin të dy të armatosur, mënyra e vdekjes së tij (plagë të shumta plumbi) dhe numri i viktimave të cilët pësuan të njëjtin fat, nuk i lënë asnjë dyshim Dhomës se Ibush Hamza u vra prej të tjerëve dhe se kryesit ishin anëtarët e UÇK-së të njohur si Shala dhe Murrizi, të cilët vepruan së bashku dhe me

[1584] *Shih më sipër,* paragrafin 415. Prova Materiale P54; L12, T 1824-1829; L04, T 1199-1206; L96, T 2405-2409; Emri i Ibush Hamzës nuk ndodhet në listën që L96 dha me emrat e të burgosurve në vendin e ekzekutimit, Prova Materiale P108.
[1585] Prova Materiale P76, L04, T 1197-1198.
[1586] Prova Materiale P112, f. 5 e raportit dhe f. 4 e shtojcës. Identiteti i dhënësit të mostrës krahasuese të gjakut u mbajt i fshehtë.
[1587] Prova Materiale P111.
[1588] Prova Materiale P111.

synim për ta vrarë atë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën kur u vra, Ibush Hamza ishte i burgosur dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

467. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Ibush Hamzën janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

(c) Hyzri Hajrizi

468. Më herët në këtë vendim Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Hyzri Hajrizi u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1590] Hyzri Hajrizi ishte midis të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës kur u lirua grupi i parë. L04 e identifikoi Hyzri Hajrizin në fotografi[1591] dhe me emër[1592] si njëri nga të burgosurit të cilët mbetën pas kur ai u lirua. Edhe pse L96 nuk e identifikoi Hyzri Hajrizin në fotografi,[1593] ai dëshmoi se "Hyzriu nga Belinca" ishte njëri nga të burgosurit e grupit që mbeti te qershia.[1594] Në lidhje me këtë Dhoma nënvizon se L10 dëshmoi se ishte mbajtur në fllanik me "Hyzriun nga Belinca", të cilin ai e identifikoi në fotografi si Hyzri Hajrizi.[1595] Edhe L04 e identifikoi Hyzri Hajrizin në fotografi si njeriun të cilin ai në dëshminë e tij e përmendi si "Hyzriu nga Belinca".[1596]

469. Analiza e ADN-së e kryer mbi mostrat eshtërore të kufomës 5 (NN989) e gjetur në varrin e madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, kur u krahasua me ADN-në e mostrave të gjakut dhënë prej anëtarëve të familjes së Hyzri Hajrizit, zbuloi se gjasa e lidhjes familjare ishte më e madhe se 99.9%.[1597] Gjithashtu më 7 tetor 2001 vëllait të Hyzri Hajrizit, Hazbi Hajrizit iu treguan fotografi të rrobave të gjetura në vendin e varrimit dhe ai identifikoi këmishën e gjetur mbi

---

[1589] Prova Materiale P200.
[1590] *Shih më sipër,* paragrafët 417-419.
[1591] L04, T 1199-1206. Prova Materiale P54.
[1592] "Hyzrija" përfshihet në listën me emrat e të burgosurve, që mbetën pas në malet e Berishës, dhënë prej L04-ës, T 1197-1198. Prova Materiale P76.
[1593] L96, T 2405-2409. Prova Materiale P54.
[1594] L96, T 2377-2387; "Hyzriu nga Belinca" përfshihet në listën e dhënë prej L96-ës, me emrat e të burgosurve që ishin në vendin e ekzekutimit, Prova Materiale P108.
[1595] L10, T 2922-2925; 2969-2973; Prova Materiale P54.
[1596] L04, T 1199-126; Prova Materiale P54.
[1597] Prova Materiale P112, f. 8 e raportit dhe f. 6 e shtojcës.

kufomën 5 (NN989) të cilën e kishte veshur vëllai i tij kur u zhduk.[1598] Në bazë të këtyre dëshmive Dhoma është e bindur se njëra prej kufomave (kufoma 5-NN989) gjetur në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës ishte e Hyzri Hajrizit.

470. Autopsia e kryer nga Dr. Tarja Formisto mbi kufomën NN989 më 10 shtator 2001, zbuloi kafkë të thyer.[1599] Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN989 kryer më vonë prej Dr. Jose Pablo Baraybar qartësoi se në kafkë kishte thyerje të cilat përputheshin me plagë plumbi të tërthortë dhe se vdekja ishte shkaktuar nga një plagë plumbi në kokë.[1600] Ky përfundim u konfirmua edhe nga një ekzaminim tjetër mjeko-ligjor kryer prej Dr. George Maat, i cili zbuloi se viktima NN989 kishte pësuar thyerje të kafkës rreth ose në kohën e vdekjes për shkak të dëmtimeve mekanike.[1601]

471. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur se kufoma e Hyzri Hajrizit u zhvarros prej varrit të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës dhe se Hyzri Hajrizi u vra në të njëjtin vend prej një plumbi në kokë. Edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, dëshmitë mbi burgimin e Hyzri Hajrizit në kamp-burg dhe prania në grupin e fundit të të burgosurve që u mbajtën në vendin e përgjithshëm në malet e Berishës prej ushtarëve të UÇK-së të njohur si Shala dhe Murrizi, të cilët ishin të dy të armatosur në atë kohë, mënyra e vdekjes së tij dhe numri i viktimave të cilët pësuan të njëjtin fat në të njëjtin vend, nuk i lënë asnjë dyshim Dhomës se Hyzri Hajrizi u vra prej një plumbi në kokë dhe u pushkatua prej ushtarëve të UÇK-së të njohur si Shala dhe Murrizi, të cilët vepruan së bashku dhe me synim për ta vrarë atë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën kur u vra, Hyzri Hajrizi ishte i burgosur nga UÇK-ja dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

472. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Hyzri Hajrizin janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

[1598] Prova Materiale P110, paragrafi 52 i deklaratës së Judy Thomas.
[1599] Prova Materiale P111.
[1600] Prova Materiale P111.
[1601] Prova Materiale P200; Dr George Maat, T 5160-5163; 5176.

(d) Shaban Hoti

473. Tashmë Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Shaban Hoti u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1602] Vetëm një dëshmitar, L96, dha dëshmi gojore para Dhomës se Shaban Hoti ishte midis të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës kur u lirua grupi i parë. L96 dëshmoi se Shaban Hoti ishte një ndër të burgosurit e pranishëm në vendin e ekzekutimit.[1603] Asnjë prej të burgosurve të tjerë të cilët dëshmuan në lidhje me vajtjen në malet e Berishës nuk mundi ta identifikonte Shaban Hotin në fotografi.[1604] Asnjë prej tyre nuk e përmendi atë si njërin prej të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës kur u lirua grupi i parë. Mirëpo sipas mendimit të Dhomës, kjo fare mirë mund të jetë për shkak se Shaban Hoti u mbajt në shtëpinë kryesore të kamp-burgut të Llapushnikut.[1605] Veç L96-ës i cili gjithashtu u mbajt gjatë tri ditëve të para të burgimit të tij në atë shtëpi dhe e kishte hasur Shaban Hotin në atë kohë,[1606] është e kuptueshme që asnjë prej të burgosurve të tjerë nuk pati kontakte me Shaban Hotin gjatë kohës së burgimit në kamp-burg kështu që ai ishte i panjohur për ta në malet e Berishës, ditën e ekzekutimit.

474. Analiza e ADN-së e kryer mbi mostrat eshtërore të kufomës 4 (NN988) e gjetur në varrin e madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, kur u krahasua me ADN-në e mostrave të gjakut dhënë prej anëtarëve të familjes së Shaban Hotit, zbuloi se gjasa e lidhjes familjare ishte më e madhe se 99.9%.[1607] Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se njëra prej kufomave (kufoma 4-NN988) gjetur në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës ishte e Shaban Hotit.

475. Autopsia e kryer nga Dr. Tarja Formisto mbi kufomën NN988 më 10 shtator 2001, zbuloi thyerje të shumta, duke përfshirë edhe kafkën.[1608] Gjatë autopsisë u gjet një fishek i shformuar.[1609] Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN986 kryer më vonë prej Dr. Jose Pablo Baraybar qartësoi se vdekja ishte shkaktuar nga plagë të shumta plumbi në kokë dhe në krahëror.[1610] Ky përfundim u konfirmua edhe nga një ekzaminim tjetër mjeko-ligjor kryer prej Dr. George Maat, i cili zbuloi se viktima NN988 kishte pësuar thyerje të shumta, duke përfshirë edhe kafkën rreth ose

[1602] *Shih më sipër,* paragrafët 422-423.
[1603] L96, T 2377-2387; Shaban Hoti përfshihet në listën e dhënë prej L96-ës, me emrat e të burgosurve që ishin në vendin e ekzekutimit, Prova Materiale P108.
[1604] L04, T 1199-1206; L06, T 1039-1045; L12, T 1824-1829; Prova Materiale P54. Për më tepër Shaban Hoti nuk bën pjesë në listën që dha L04, me emrat e të burgosurve që mbetën në malet e Berishës, pasi u lirua ai, Prova Materiale P76.
[1605] *Shih më sipër,* paragrafët 422-423.
[1606] L96, T 2312-2316; 2336; 2346-2347.
[1607] Prova Materiale P112, f. 6 e raportit të dytë i 12 dhjetorit 2004. Një analizë e mëparshme e ADN-së për kufomën 4 (NN988) kishte përjashtuar mundësinë e lidhjes me familjen e Hetem Rexhajt, f. 7 e raportit ekspert
[1608] Prova Materiale P111.
[1609] Prova Materiale P110.
[1610] Prova Materiale P111.

në kohën e vdekjes për shkak të dëmtimeve mekanike.[1611] Të tre ekzaminimet përputhen në lidhje me lëndimet që shkaktuan vdekjen e Shaban Hotit.

476. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur se kufoma e Shaban Hotit u zhvarros prej varrit të madh në afërsi të vendit të ekzekutimit në malet e Berishës dhe se Shaban Hoti u vra më 25 ose 26 korrik 1998, në të njëjtin vend me shumë plumba. Edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, fakti se Shaban Hoti ishte mbajtur prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut deri më 25 ose 26 korrik 1998, fakti se ai u gjet i vdekur në varrin kryesor në afërsi të vendit të ekzekutimit, shkaku i vdekjes së tij dhe numri i viktimave të cilët pësuan të njëjtin fat në këtë vend, nuk i lënë asnjë dyshim Dhomës se Shaban Hoti u vra me armë zjarri dhe kryesit ishin ushtarët e UÇK-së të njohur si Shala dhe Murrizi, të cilët ishin të dy të armatosur dhe ruanin grupin e të burgosurve që mbetën pas lirimit të të tjerëve. Duke marrë parasysh rrethanat Dhoma është gjithashtu e bindur se Shala dhe Murrizi vepruan së bashku për ta vrarë Shaban Hotin më 25 ose 26 korrik 1998 dhe secili veproi me synimin për ta vrarë atë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën e vdekjes së tij Shaban Hoti ishte i burgosur nga UÇK-ja dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

477. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Shaban Hotin janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

(e) Hasan Hoxha

478. Më parë në këtë vendim Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Hasan Hoxha u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1612] Dhoma dëgjoi dëshmi gojore kundërthënëse lidhur me fatin e Hasan Hoxhës dhe praninë e tij të pretenduar midis të burgosurve të ekzekutuar në malet e Berishës. L96 e identifikoi Hasan Hoxhën në fotografi[1613] dhe me emër,[1614] si njëri prej të burgosurve që mbetën në vendin e ekzekutimit pasi disa u liruan. Gjithashtu "Hasani" del në listën e emrave të të burgosurve

[1611] Prova Materiale P200. Dr George Maat, T 5160-5163.
[1612] *Shih më sipër,* paragrafin 427.
[1613] L96, T 2405-2409; Prova Materiale P54.
[1614] L96, T 2406. Emri "Hasan Hoxha Dobreva" përfshihet në listën e dhënë prej L96-ës, me emrat e të burgosurve që ishin në vendin e ekzekutimit, Prova Materiale P108.

për të cilët L04 dëshmoi se mbetën në malet e Berishës ditën kur u lirua ai.[1615] Mirëpo L04 nuk mundi ta identifikonte Hasan Hoxhën në fotografi.[1616] Sipas dëshmisë së L64-ës, dikur në korrik 1998, ai pa tri kufoma afër fshatit Morinë, dhe për njërin prej tyre mendoi se ishte Hasan Hoxha.[1617] L64 dëshmoi se ai e kishte parë Hasan Hoxhën më parë një herë, pak para asaj kohe, rrugës për në Llapushnik.[1618] Mirëpo siç e kupton Dhoma dëshminë e L64-ës, ai ishte në një makinë kur i pa kufomat dhe nuk doli nga makina që t'i këqyrte kufomat nga afër që të mund të konfirmonte dyshimin e tij se një prej kufomave ishte Hasan Hoxha.[1619] Në këto rrethana Dhoma nuk mund të mbështetet në dëshminë e L64-ës në lidhje me këtë çështje.[1620]

479. Më 11 prill 2002, gjatë zhvarrimit të dytë në vendin në malet e Berishës ekipi i CCIU-së gjeti një kufomë të nëntë (NN376), afërsisht 14 metra larg prej varrit kryesor. Dhoma nuk ka prova të kryerjes së ndonjë analize ADN mbi kufomën. Gjithsesi në një raport të datës 23 maj 2003, hetuesi i CCIU-së Andreas Manthey, deklaroi se familja e Hasan Hoxhës i identifikoi rrobat e gjetura gjatë ekzaminimit si rrobat që kishte veshur Hasan Hoxha në ditën e zhdukjes së tij.[1621] Fleta e fotografive identifikuese të pantallonave të gjetura me mbetjet e kufomës NN376 tregojnë pantallona të errëta sportive "adidas" me vija të bardha ose të verdha.[1622]

480. Gjithashtu në një raport pa datë për Persona të Zhdukur përpiluar prej OSBE-së, deklarohet se në kohën e zhdukjes së tij Hasan Hoxha mbante veshur një kostum sportiv me vija të verdha dhe patika.[1623] Dikur në 2001, Ramadan Hoxha, vëllai i Hasan Hoxhës, këqyri rrobat e gjetura me tetë kufomat e para dhe tha se në atë kohë Hasan Hoxha mbante veshur tuta sportive (trajnerka) "adidas".[1624] Dikur në 2002, Ramadan Hoxha dhe Nuhi Hoxha, djali i Hasanit, u thirrën prej CCIU-së për identifikimin e rrobave të gjetura me kufomën e nëntë dhe të dy deklaruan se ata i identifikuan rrobat, ndër to, pantallonat sportive "adidas", brekët dhe kanotieren e të afërmit të tyre të zhdukur.[1625]

481. Dhoma e pranon këtë identifikim pohues të veshjes prej Ramadan dhe Nuhi Hoxhës, i cili nuk kundërshtohet prej Mbrojtjes, dhe nxjerr përfundimin se rrobat e gjetura në atë vend bashkë me

[1615] L04, T 1197-1198. Prova Materiale P76.
[1616] L04, T 1199-1206. Prova Materiale P54.
[1617] L64, T 4518-4519.
[1618] L64, T 4515-4518.
[1619] L64, T 4518-4519.
[1620] *Shih* gjithashtu *më sipër,* paragrafin 28.
[1621] Prova Materiale P110.
[1622] Prova Materiale P111.
[1623] Provat Materiale P46 dhe P147.
[1624] Prova Materiale P110.

kufomën e nëntë NN 376, janë të Hasan Hoxhës. Kjo përputhet me dëshmitë e përshkruara më lart. Tutat sportive "adidas" janë lehtësisht të dallueshme në fletën e fotografive identifikuese dhe përputhen me përshkrimin e dhënë nga vëllai i Hasan Hoxhës dhe i dokumentuar në raportin për Personat e Zhdukur. Gjithashtu dëshmitë mbi mbajtjen e Hasan Hoxhës prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut dhe identifikimi i tij prej L96-ës në vendin e ekzekutimit, të cilin Dhoma mund ta pranojë, duke marrë parasysh konfirmimin nga dëshmitë e tjera të përmendura, gjithashtu përputhen me faktin e pranisë së Hasan Hoxhës midis të burgosurve të mbetur në vendin e ekzekutimit më 25 ose 26 korrik 1998, pas lirimit të disave. Dëshmitë nuk ofrojnë shpjegim të drejtpërdrejtë mbi faktin e gjetjes së kufomës së Hasan Hoxhës disa metra larg varrit kryesor; mund të jetë fare mirë vendi ku ra Hasan Hoxha kur u pushkatua. Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN376 kryer prej Dr. Jose Pablo Baraybar qartësoi se shkaku i vdekjes së Hasan Hoxhës ishte një plagë plumbi në krahëror.[1626]

482. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur se kufoma e Hasan Hoxhës u zhvarros prej një varri në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës dhe se Hasan Hoxha u vra më 25 ose 26 korrik 1998, në atë vend me armë zjarri. Edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, fakti se Hasan Hoxha ishte mbajtur prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, vendi ku u gjet kufoma e tij, mënyra e vdekjes së tij (plagë plumbi në krahëror) dhe numri i viktimave të cilët pësuan të njëjtin fat dhe kufomat e të cilëve u gjetën në po atë vend, nuk i lënë asnjë dyshim Dhomës se Hasan Hoxha u vra në vendin e ekzekutimit më 25 ose 26 korrik 1998 prej dy ushtarëve të armatosur të UÇK-së të cilët shoqëronin të burgosurit, përkatësisht individët e identifikuar si Shala dhe Murrizi dhe se secili prej tyre veproi bashkërisht me synim për ta vrarë atë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën e vdekjes së tij Hasan Hoxha ishte i burgosur nga UÇK-ja dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

483. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Hasan Hoxhën janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

[1625] Provat Materiale P185 dhe P186.
[1626] Prova Materiale P111.

(f) Safet Hysenaj

484. Tashmë Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Safet Hysenaj u mbajt prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut.[1627] Gjithashtu Dhoma ka dëshmi se Safet Hysenaj ishte midis të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës kur u lirua grupi i parë. L96 e identifikoi Safet Hysenajn në fotografi si njërin prej të burgosurve të pranishëm në vendin e ekzekutimit.[1628] Edhe L04 e përmendi "Safetin" si njërin prej të burgosurve të grupit që mbeti pas pasi të tjerët u liruan në malet e Berishës.[1629]

485. Analiza e ADN-së e kryer mbi mostrat eshtërore të kufomës 8 (NN1000) e gjetur në në varrin kryesor në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, kur u krahasua me ADN-në e mostrave të gjakut dhënë prej anëtarëve të familjes së Safet Hysenajt, zbuloi se gjasa e lidhjes familjare ishte më e madhe se 99.9%.[1630] Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se njëra prej kufomave (kufoma 8-NN1000) gjetur në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës ishte e Safet Hysenajt.

486. Autopsia e kryer nga Dr. Tarja Formisto mbi kufomën NN1000 më 12 shtator 2001, nuk zbuloi lëndime.[1631] Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN1000 kryer më vonë prej Dr. Jose Pablo Baraybar nuk e identifikoi shkakun e vdekjes.[1632] Megjithatë ekzaminimi tjetër mjeko-ligjor kryer prej Dr. George Maat në 2003 zbuloi se viktima NN1000 kishte një thyerje të eshtrës së shpatullës së djathtë, rreth ose në kohën e vdekjes, për shkak të forcës mekanike. Edhe ai shënoi se diagnoza në lidhje me kohën e lëndimit ishte e paqartë.[1633]

487. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur se kufoma e Safet Hysenajt u zhvarros prej varri kryesor në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës. Rreth kohës së vdekjes Safet Hysenaj pësoi një thyerje në eshtrën e shpatullës së djathtë. Gjithashtu para vdekjes së tij Safet Hysenaj u mbajt prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut dhe ishte midis të burgosurve që u çuan në vendin e ekzekutimit nga ushtarët e armatosur të UÇK-së të njohur si Shala dhe Murrizi. Mbi bazën e këyre provave të marra së bashku, Dhoma është e bindur se Safet Hysenaj u vra në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998 në të njëjtën kohë si viktimat e tjera. Gjithashtu, edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, fakti se në atë

[1627] *Shih më sipër,* paragrafin 430.
[1628] L96, T 2406-2408; Prova Materiale P54. "Safet Hysenaj Petrovë" përfshihet në listën e dhënë prej L96-ës, me emrat e të burgosurve që ishin në vendin e ekzekutimit, Prova Materiale P108.
[1629] L04, T 1197-1198; Prova Materiale P76.
[1630] Prova Materiale P112, f. 11 e raportit dhe f. 7 e shtojcës.
[1631] Prova Materiale P111.
[1632] Prova Materiale P111.

kohë Safet Hysenaj ishte i burgosur me disa viktima të tjera të cilët u ekzekutuan në të njëjtën kohë në atë vend, e bind Dhomën të nxjerrë përfundimin se Safet Hysenaj u vra prej shoqëruesve të UÇK-së të identifikuar si Shala dhe Murrizi, të cilët vepruan së bashku dhe me synim për ta vrarë atë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën kur u vra, Safet Hysenaj ishte i burgosur nga UÇK-ja dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

488. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Safet Hysenajn janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

(g) Bashkim Rashiti

489. Tashmë Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Bashkim Rashiti u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1634] Dhoma ka dëshmi se Bashkim Rashiti ishte midis të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës kur u lirua grupi i parë. L10 dëshmoi se "Bashkimi nga Godanci",[1635] të cilin ai më parë e kishte identifikuar në fotografi si Bashkim Rashiti,[1636] mbeti te qershia bashkë me 10-12 të burgosur të tjerë pas lirimit të grupit të parë të të burgosurve.[1637] Edhe L96 e identifikoi Bashkim Rashitin në fotografi si njërin prej të burgosurve që mbetën në vendin e ekzekutimit.[1638] L04 nuk e përmendi Bashkim Rashitin midis të burgosurve për të cilët ai dëshmoi se mbetën në malet e Berishës;[1639] mirëpo siç është përcaktuar më parë, L04 dhe Bashkim Rashiti nuk ishin mbajtur në të njëjtën dhomë në kamp-burgun e Llapushnikut, kështu që L04 nuk e njihte Bashkim Rashitin nga kamp-burgu.

490. Analiza e ADN-së e kryer mbi mostrat eshtërore të kufomës 2 (NN986) e gjetur në varrin e madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, kur u krahasua me ADN-në e mostrave të gjakut të një anëtari të familjes së Bashkim Rashitit, identiteti i të cilit u mbajt i fshehtë, konfirmoi se

---

[1633] Prova Materiale P200; Dr George Maat, T 5158-5159.
[1634] *Shih më sipër,* paragrafin 443.
[1635] Dhoma thekson në lidhje me këtë se ka prova se me të vërtetë Bashkim Rashiti ishte me prejardhje nga fshati Godanc, Prova Materiale P224, paragrafi 8.
[1636] L10, T 2929-2973; Prova Materiale P54.
[1637] L10, T 2965-2966.
[1638] L96, T 2407-2408; Provat Materiale P54 dhe P108.
[1639] Prova Materiale P76.

kufoma 2 ishte e Bashkim Rashitit duke pasur gjasën e lidhjes familjare më të madhe se 99.9%.[1640] Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se njëra prej kufomave (kufoma 2-NN986) gjetur në varrin kryesor në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, ishte e Bashkim Rashitit.

491. Autopsia e kryer nga Dr. Tarja Formisto mbi kufomën NN986 më 6 shtator 2001, zbuloi një plagë plumbi në kafkë.[1641] Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN986 kryer më vonë prej Dr. Jose Pablo Baraybar qartësoi se vdekja ishte shkaktuar nga një plagë plumbi në kokë.[1642] Ky përfundim u konfirmua edhe nga një ekzaminim tjetër mjeko-ligjor kryer prej Dr. George Maat, i cili zbuloi se viktima NN986 kishte pësuar një thyerje në kafkë rreth ose në kohën e vdekjes për shkak të forcës mekanike.[1643]

492. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur dhe arrin në përfundimin se kufoma e Bashkim Rashitit u zhvarros prej varrit kryesor në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës dhe se Bashkim Rashiti u vra në atë vend më 25 ose 26 korrik 1998, me plumb në kokë. Edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, fakti se Bashkim Rashiti ishte mbajtur prej UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut, vendi ku u gjet kufoma e tij, mënyra e vdekjes së tij dhe numri i të burgosurve të tjerë të cilët pësuan të njëjtin fat, e bindin Dhomën të nxjerrë përfundimin se Bashkim Rashiti u vra prej dy ushtarëve të armatosur të UÇK-së të cilët shoqëronin të burgosurit, përkatësisht individët e identifikuar si Shala dhe Murrizi dhe se secili prej tyre veproi bashkërisht dhe me synim për ta vrarë atë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën e vdekjes së tij Bashkim Rashiti ishte i burgosur nga UÇK-ja dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

493. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Bashkim Rashitin janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

[1640] Prova Materiale P112, f. 5 e raportit dhe f. 4 e shtojcës. Identiteti i dhuruesit të mostrave krahasuese të gjakut u mbajt i fshehtë.
[1641] Prova Materiale P111.
[1642] Prova Materiale P111.
[1643] Prova Materiale P200; Dr George Maat, T 5160-5163.

(h) Hetem Rexhaj

494. Tashmë Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Hetem Rexhaj u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1644] Dhoma dëgjoi dëshmi gojore se Hetem Rexhaj ishte në grupin e vogël të të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës nën ruajtjen e dy ushtarëve të armatosur të UÇK-së, të njohur si Shala dhe Murrizi, kur u lirua grupi i parë. L96 dëshmoi se Hetem Rexhaj ishte midis të burgosrve të pranishëm në vendin e ekzekutimit.[1645] Kjo dëshmi konfirmohet nga dëshmia e L04-ës i cili e identifikoi Hetem Rexhajn në fotografi si njërin prej të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës pasi u lirua ai.[1646] Kur u pyet, edhe L12 e kujtoi emrin e "Hetës nga Petrova",[1647] i cili sipas dëshmisë së tij ishte në grupin e dytë të burgosurve që mbetën në malet e Berishës, pas lirimit të disa të burgosurve.[1648]

495. Ekzaminimet e hollësishme kriminalistike të cilat u kryen në varrin e madh i cili përmbante mbetjet e tetë kufomave në malet e Berishës, dhe në varrin e veçuar të afërt ku vitin pasues dhe pas ndikimeve mbi terrenin te një dimri tjetër u gjetën mbetjet e një kufome tjetër, nuk kanë identifikuar mbetje të Hetem Rexhajt.[1649] Sipas dëshmisë së L96-ës Hetem Rexhaj mbeti pas me grupin e fundit të burgosurve kur L96 arriti të ikte. L96 nuk mund të thoshte se çfarë ndodhi me Hetem Rexhajn pasi L96 u arratis. Nuk ka dëshmi tjetër në lidhje me çfarë ndodhi me Hetem Rexhajn.

496. Fati i të burgosurve të tjerë në atë grup ofron deri diku një bazë për të ardhur në përfundimin se edhe Hetem Rexhaj u vra me të burgosurit e tjerë. Në rast se është kështu, ekzistojnë dy arsye të dukshme në lidhje me mosgjetjen e kufomës së tij. Së pari ai mund të ketë rënë në një vend tjetër prej shumicës së të burgosurve. Kjo mund të ketë ndodhur në rast se edhe ai u përpoq të ikte dhe në përpjekje e sipër u qëllua dhe u vra dhe më vonë, me kalimin e kohës, kufoma e tij është mbuluar në vendin ku ra. Kjo përputhet me rrethanat e dukshme të vdekjes së Hasan Hoxhës, kufoma e të cilit u gjet afërsisht 14 metra larg varrit kryesor masiv. Kur u gjet në 2002, disa eshtra ishin zbuluar, pa dyshim si pasojë e një dimri tjetër, edhe pse ekzistenca e kufomës së tij nuk ishte zbuluar në kohën e zhvarrimeve në varrin masiv në 2001, gjatë kontrollit të asaj zone. Mbetet mundësia që kufoma e

[1644] *Shih më sipër,* paragrafin 436.
[1645] L96, T 2377-2378. "Hetë Rexhaj Petrovë" përfshihet në listën e dhënë prej L96-ës, me emrat e të burgosurve që ishin në vendin e ekzekutimit, Prova Materiale P108.
[1646] L04, T 1192-1194; 1199-1206; Prova Materiale P54. "Heta" bën pjesë në listën që dha L04, me emrat e të burgosurve që mbetën në malet e Berishës, pasi u lirua ai, T 1197-1198, Prova Materiale P76.
[1647] Dhoma thekson në lidhje me këtë se L96 dëshmoi se familja e Hetem Rexhajt ishte nga fshati Petrovë, T 2238; 2253.
[1648] L12, T 1820-1823.
[1649] Konkretisht u krye analiza e ADN-së mbi mostrat eshtërore të njërës prej kufomave me qëllim që të provohej nëse mbetja ishte e Hetem Rexhajt, por analiza e përjashtoi gjasën e lidhjes familjare, Prova Materiale P112, f.7 e raportit ekspert.

Hetem Rexhajt të gjendet aty afër por e pazbuluar. Së dyti kufoma e tij mund të jetë lëvizur prej atij vendi. Nuk ka dëshmi për arsyen dhe kohën e kësaj pandehme, megjithëse ka dëshmi të tërthorta të pambështetura nga L96 për njerëz prej Kishnarekës të cilët thuhet se kanë dëgjuar se me urdhër të Shalës, një kufomë u lëviz dhe kufomat e tjera u mbuluan.[1650] Mundësi të tjera janë se atë ditë Hetem Rexhaj nuk u vra, ai u arratis ose iu fal jeta, ose se ai nuk ishte në grupin e të burgosurve me Shalën dhe Murrizin atë ditë në malet e Berishës, edhe pse dëshmitë e bindin Dhomën se ai ishte i burgosur në kampin në Llapushnik dhe se ishte midis të burgosurve të cilët u detyruan të ecnin prej Shalës dhe Murrizit për në malet e Berishës, më 25 ose 26 korrik 1998. Gjithashtu ka prova se Hetem Rexhaj nuk është parë më që prej shtatë vitesh që kanë kaluar prej atëherë.[1651]

497. Prokuroria kërkon të mbështetet në prova rrethanore të vrasjes së Hetem Rexhajt bazuar veçanërisht në praninë e tij si i burgosur në kampin e Llapushnikut, gjendjen e tij të ligështuar fizike më 25 ose 26 korrik 1998, kur ai dhe të burgosurit e tij u detyruan të ecnin në male, ekzekutimin e të gjithë njerëzve që mbetën pas lirimit të disave prej Shalës dhe Murrizit përveç L96-ës, i cili iku dhe Xheladin Ademajt, praktikën e paligjshmërisë dhe vrasjeve prej anëtarëve të UÇK-së në kamp, për të cilat argumenton se vazhduan me ngjarjet në mal më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date, dhe mosparjen e mëvonshme të tij prej shtatë vitesh e deri më sot. Ndërkohë që prej këtyre fakteve mund të nxirret përfundimi i vrasjes, Dhoma ka mendimin se janë të hapura edhe mundësitë që nuk përkojnë me vrasjen. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh peshën e provave, Dhoma gjykon se Prokuroria nuk ka provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Hetem Rexhaj u vra më 25 ose 26 korrik 1998 në malet e Berishës.

(i) Lutfi Xhemshiti

498. Tashmë Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Lutfi Xhemshiti u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1652] Dhoma disponon dëshmi përputhëse se Lutfi Xhemshitit gjithashtu i njohur si "Luta",[1653] ishte në grupin e vogël të të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës kur u lirua grupi i parë. L10 e identifikoi "Lutën" si njërin prej të burgosurve të cilët mbetën në grupin te qershia.[1654] "Luta" përmendet edhe në listën e emrave të të burgosurve për të cilët L04 dëshmoi se

[1650] L96, T 2464-2467.
[1651] L96, T 2464-2465; 2467.
[1652] *Shih më sipër,* paragrafët 439-440.
[1653] L96 dëshmoi se ai e njihte Lutfi Xhemshitin si "Luta" nga Bregu i Zi që para lufte, T 2409.
[1654] L10, T 2965-2966.

mbetën në malet e Berishës pasi u lirua ai.[1655] Edhe L96 e identifikoi Lutfi Xhemshitin si një nga të burgosurit e grupit të tij në vendin e ekzekutimit.[1656]

499. Analiza e ADN-së e kryer mbi mostrat eshtërore të kufomës 6 (NN990) e gjetur në varrin e madh në vendin e ekzekutimit, në malet e Berishës, kur u krahasua me ADN-në e mostrave të gjakut dhënë prej anëtarëve të familjes së Lutfi Xhemshitit, zbuloi se gjasa e lidhjes familjare ishte më e madhe se 99.9%.[1657] Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se njëra prej kufomave (kufoma 6-NN990) gjetur në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, ishte e Lutfi Xhemshitit.

500. Autopsia e kryer nga Dr. Tarja Formisto mbi kufomën NN990 më 11 shtator 2001, zbuloi lëndime në parzmor dhe në skajin parzmoral të brinjëve.[1658] Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN990 kryer më vonë prej Dr. Jose Pablo Baraybar nuk e ka identifikuar shkakun e vdekjes.[1659] Gjithsesi ekzaminimi tjetër mjeko-ligjor kryer prej Dr. George Maat zbuloi se viktima NN990 kishte pësuar një thyerje në parzmor, rreth ose në kohën e vdekjes për shkak të forcës mekanike.[1660]

501. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur se kufoma e Lutfi Xhemshitit u zhvarros prej varrit të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës dhe megjithëse provat mjeko-ligjore nuk e përcaktojnë përfundimisht shkakun e saktë të vdekjes, Dhoma gjykon se në kohën e vdekjes, Lutfi Xhemshiti pësoi dëmtime mekanike, prej një force të atillë që shkaktoi thyerje të parzmorit dhe brinjëve të tij,[1661] dhe këto dëmtime përgjithësisht përputhen me ato të pësuara prej disa viktimave të tjera. Gjithashtu duke marrë parasysh dëshmitë mbi burgimin e Lutfi Xhemshitit në kamp-burgun e Llapushnikut, dhe të pranisë së tij nën ruajtjen e rojave të UÇK-së, Shala dhe Murrizi, në vendin e ekzekutimit, Dhoma nxjerr përfundimin se Lutfi Xhemshiti u vra më 25 ose 26 korrik 1998 në malet e Berishës bashkë me viktimat e tjera, me të cilët u varros. Dhoma nuk mund të përcaktojë nëse ai vdiq menjëherë prej plagëve apo vdiq pas një farë kohe, i lënë të vdiste si pasojë e plagëve të tij. Edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, fakti se Lutfi Xhemshiti mbahej prej UÇK-së në atë kohë, lëndimet e shkaktuara ndaj tij dhe ndaj viktimave të tjera të cilët vdiqën më 25 ose 26 korrik 1998 në atë vend,

[1655] L04, T 1197-1198; Prova Materiale P76.
[1656] L96, T 2409; Prova Materiale P54. "Lutfiu nga Bregu i Zi" përfshihet në listën e dhënë prej L96-ës, me emrat e të burgosurve që ishin në vendin e ekzekutimit, Prova Materiale P108.
[1657] Prova Materiale P112, f. 9 e raportit dhe f. 6 e shtojcës.
[1658] Prova Materiale P111.
[1659] Prova Materiale P111.
[1660] Prova Materiale P200.
[1661] Prova Materiale P200.

e bindin Dhomën të nxjerrë përfundimin se Lutfi Xhemshiti u vra prej të tjerëve dhe se kryesit, konkretisht rojet e UÇK-së të cilët shoqëronin të burgosurit, përkatësisht individët e identifikuar si Shala dhe Murrizi, vepruan bashkërisht dhe me synim për ta vrarë atë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën e vdekjes së tij Lutfi Xhemshiti ishte i burgosur nga UÇK-ja dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

502. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Lutfi Xhemshitin janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

(j) Shyqyri Zymeri

503. Tashmë Dhoma ka arritur në përfundimin se Shyqyri Zymeri u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut.[1662] Dhoma disponon dëshmi se Shyqyri Zymeri ishte ndër të burgosurit të cilët mbetën në malet e Berishës nën ruajtjen e UÇK-së kur u lirua grupi i parë. L04 dëshmoi se "Shyqja nga Godanci" të cilin ai e identifikoi në fotografi si Shyqyri Zymeri[1663] dhe i cili në atë kohë kishte një këmbë të thyer, ishte njëri prej të burgosurve të cilët mbetën në malet e Berishës pasi u lirua ai.[1664] Edhe L96 e identifikoi Shyqyri Zymerin në fotografi si një nga të burgosurit e pranishëm në vendin e ekzekutimit.[1665]

504. Analiza e ADN-së e kryer mbi mostrat eshtërore të kufomës 7 (NN991) e gjetur në varrin e madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, kur u krahasua me ADN-në e mostrave të gjakut dhënë prej anëtarëve të familjes së Shyqyri Zymerit, zbuloi se gjasa e lidhjes familjare ishte më e madhe se 99.9%.[1666] Rrjedhimisht Dhoma është e bindur se njëra prej kufomave (kufoma 7-NN991) gjetur në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës, ishte e Shyqyri Zymerit.

[1662] *Shih më sipër,* paragrafin 444.
[1663] L04, T 1199-1206; Prova Materiale P54.
[1664] L04, T 1192-1195; 1197-1198; "Shyqa" bën pjesë në listën që dha L04, me emrat e të burgosurve që mbetën në malet e Berishës, pasi u lirua ai, T 1197-1198, Prova Materiale P76.
[1665] L96, T 2409; Prova Materiale P54. "Shyqëriu nga Godanci" përfshihet në listën e dhënë prej L96-ës, me emrat e të burgosurve që ishin në vendin e ekzekutimit, Prova Materiale P108.
[1666] Prova Materiale P112, f 10 e raportit dhe f 7 e shtojcës.

505. Autopsia e kryer nga Dr. Tarja Formisto mbi kufomën NN991 më 11 shtator 2001, zbuloi lëndime të shumta në nofullën e poshtme, fyell dhe rrezor.[1667] Ekzaminimi mjeko-ligjor i mbetjes skeletore të NN991 kryer më vonë prej Dr. Jose Pablo Baraybar nuk e ka identifikuar shkakun e saktë të vdekjes.[1668] Gjithsesi ekzaminimi tjetër mjeko-ligjor kryer prej Dr. George Maat zbuloi se viktima NN991, rreth ose në kohën e vdekjes, kishte pësuar thyerje të shumta ndër të tjera në nofullën e poshtme, fyell dhe eshtrën e bërrylit për shkak të forcës mekanike.[1669]

506. Mbi bazën e provave të mësipërme, Dhoma është e bindur se kufoma e Shyqyri Zymerit u zhvarros prej varrit të madh në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës dhe se Shyqyri Zymeri u vra në atë vend. Edhe po të lihet mënjanë dëshmia e L96-ës në lidhje me ekzekutimin e të burgosurve, fakti se Shyqyri Zymeri ishte mbajtur prej UÇK-së në atë kohë, lëndimet e shumta që pësoi rreth kohës së vdekjes dhe numri i të burgosurve të tjerë të varrosur në të njëjtin varr të cilët u vranë në të njëjtën kohë në atë vend, e bindin Dhomës se Shyqyri Zymeri u vra më 25 ose 26 korrik 1998 në atë vend prej të tjerëve dhe kryesit, konkretisht rojet e UÇK-së, përkatësisht individët e identifikuar si Shala dhe Murrizi, vepruan bashkërisht dhe me synim për ta vrarë atë në atë kohë. Gjithashtu Dhoma është e bindur se në kohën e vdekjes së tij Shyqyri Zymeri ishte i burgosur nga UÇK-ja dhe nuk merrte aktivisht pjesë në luftime. Mundësia, e cila mbi bazën e dëshmive nuk mund të përjashtohet tërësisht, e pjesëmarrjes edhe të një ushtari të tretë të UÇK-së në pushkatim, sipas mendimit të Dhomës nuk ndikon mbi këto përfundime.

507. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve Fatmir Limaj dhe Haradin Balaj, Dhoma nxjerr përfundimin se në lidhje me Shyqyri Zymerin janë provuar elementët e veprës penale të vrasjes (Pika 10).

[1667] Prova Materiale P111.
[1668] Prova Materiale P111.
[1669] Prova Materiale P200.

VI. PËRGJEGJËSIA E TË AKUZUARVE

A. Kuadri ligjor mbi format e përgjegjësisë

508. Pretendohet se në bazë të Nenit 7 (1) të Statutit, tre të Akuzuarit janë përgjegjës për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen edhe nëpërmjet pjesëmarjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale ose përndryshe për ndihmën dhe inkurajim në planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimeve të ngarkuara në Aktakuzë.[1670] Gjithashtu për të Akuzuarit Fatmir Limaj dhe Isak Musliu pretendohet se janë penalisht përgjegjës në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit si eprorë të anëtarëve të UÇK-së të cilët vepronin në kamp-burgun e Llapushnikut.

1. Përgjegjësia në bazë të Nenit 7(1) të Statutit

(a) Kryerja

509. "Kryerje" e një krimi "lidhet me kryerjen fizike të një krimi apo shkaktimin e një mosveprimi të fajshëm si shkelje e së drejtës penale".[1671] Dhoma e Apelit ka përcaktuar se Neni 7(1) "mbulon para së gjithash kryerjen fizike të një krimi nga vetë shkelësi apo moskryerjen e fajshme të një veprimi i cili ishte i autorizuar prej një rregulle të së drejtës penale".[1672] Sjellja e fajshme e nevojshme për kryerjen e një krimi është se i akuzuari mori pjesë fizikisht ose ndryshe drejtpërsëdrejti, në elementët materialë të krimit të përcaktuar në Statut, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve,[1673] individualisht ose bashkërisht me të tjerët. Gjendja e nevojshme mendore kriminale është se i akuzuari veproi me synim për të kryer krimin, ose i vetëdijshëm mbi gjasën e konsiderueshme se krimi do të ndodhte si pasojë e kësaj sjelljeje.

(b) Kryerja me anë të pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale

510. Në bazë të Nenit 7(1) përgjegjësia penale individuale bie jo vetëm mbi personat të cilët kryejnë veprimin kriminal, por në rrethana të caktuara bie edhe mbi ata të cilët në një farë mënyre e bëjnë të mundshme kryerjen fizike të veprimit prej kryesve.[1674] Kur një numër personash janë përfshirë në një plan të përbashkët për kryerjen e një krimi, ata mund të gjykohen fajtorë për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale ("NPK") në lidhje me atë krim.

[1670] Aktakuzë, paragrafi 6.
[1671] Aktgjykimi *Kërstiq,* paragrafi 601; Vendimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 188; Aktgjykimi *Kunarac,* paragrafi 390.
[1672] Vendimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 188.
[1673] Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 376.
[1674] Vendimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 192.

Bashkëkryerja në kontekstin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale ndryshon nga ndihma dhe inkurajimi. Kur ndihmëdhënësi dhe inkurajuesi di vetëm se ndihma që po jep e ndihmon një person të veçantë të kryejë një krim të vetëm, ai është përgjegjës vetëm për dhënie ndihme dhe inkurajim për atë krim. Kjo vlen edhe kur kryesi kryesor merr pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale që përfshin kryerjen e krimeve të tjera. Mirëpo kur i akuzuari di se po ndihmon një grup personash pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe ai ka të njëjtin synim, atëherë ai mund të shpallet penalisht përgjegjës për të gjitha krimet e kryera në përmbushjen e synimit të përbashkët si bashkëkryes.[1675]

511. Në jurisprudencën e Tribunalit janë identifikuar tri kategori të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në lidhje me sjelljen e fajshme për të gjitha ato është e nevojshme ekzistenca e disa personave, ekzistenca e një projekt-plani ose synimi të përbashkët, i cili përbën ose përfshin kryerjen e një krimi të parashikuar në Statut, dhe pjesëmarrja e të akuzuarve në atë plan. Në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, i akuzuari synon të kryejë një krim dhe të gjithë bashkëkryesit kanë po këtë synim. Në kategoria e dytë e cila përfshin të ashtuquajtura raste të "kampeve të përqëndrimit" ose NPK sistemore, i akuzuari ka dijeni për karakterin e një sistemi shtypës, në zbatimin e të cilit ai merr pjesë, dhe synimin për përmbushjen, me bashkëveprim, të planit të përbashkët në keqtrajtimin e të burgosurve të një kampi përqëndrimi.[1676] Në këto raste synimi i nevojshëm mund të nxirret edhe prej dijenisë së provuar të kryerjes së krimeve në kamp dhe pjesëmarrjes së vazhduar në funksionimin e kampit, si edhe nga pozita eprore e të akuzuarit në kamp.[1677] Kategoria e tretë përfshin raste në të cilat njëri prej pjesëmarrësve kryen një krim jashtë planit të përbashkët. Gjendja mendore kriminale në raste të tilla shfaqet e dyfishtë. Së pari i akuzuari duhet të ketë synimin të marrë pjesë dhe kontribuojë në qëllimin e përbashkët kriminal. Së dyti për t'a bërë përgjegjës për krime të cilat nuk ishin pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal, të cilat gjithsesi ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të tij, i akuzuari gjithashtu duhet të dijë se një krim i tillë mund të kryhet prej një anëtari të grupit dhe, me vullnet të lirë, ai e merr përsipër rrezikun se mund të ndodhë krim prej pjesëmarrjes së tij në atë ndërmarrje ose vazhdimit të pjesëmarrjes së tij.[1678] Nuk është e nevojshme prania e pjesëmarrësit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale në kohën e kryerjes së krimit nga shkelësi kryesor.[1679]

[1675] Vendimi i Apelit *Kvoçka*, paragrafi 90.
[1676] Vendimi i Apelit *Tadiq*, paragrafët 196; 202-203; 227-228.
[1677] Vendimi i Apelit *Kvoçka*, paragrafi 243.
[1678] Vendimi i Apelit *Tadiq*, paragrafët 204; 227-228; Vendimi i Apelit *Kvoçka*, paragrafi 83.
[1679] Vendimi i Apelit *Kërnojelac*, paragrafi 81.

512. Dhoma e Apelit ka thënë se përgjegjësia për krimet e kryera jashtë qëllimit të përbashkët të NPK-së, por që ishin "pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e tij" (kategoria e tretë e NPK-së) del vetëm kur Prokuroria provon se i akuzuari kishte dijeni të mjaftueshme që krimet e tjera ishin pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme për atë. Dhoma e Apelit nënvizoi se çështja nëse krimet e kryera jashtë qëllimit të përbashkët të NPK-së ishin "pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme", duhet vlerësuar në lidhje me njohuritë e një të akuzuari të veçantë.[1680]

(c) Planifikimi

513. Është thënë se "planifikimi" nënkupton se një apo disa persona planifikojnë ose projektojnë kryerjen e një krimi si në fazën përgatitore po ashtu edhe në atë zbatuese.[1681] Sjellja e fajshme e "planifikimit" kërkon që një ose më shumë persona të planifikojnë ose projektojnë veprime kriminale që përbëjnë një ose më shumë krime të parashikuara prej Statutit, të cilat kryhen më vonë.[1682] Është e mjaftueshme të tregohet se planifikimi ishte faktor që kontribuoi ndjeshëm në atë sjellje kriminale.[1683] Personi i cili planifikon një veprim apo mosveprim me synimin e kryerjes së krimit ose duke ditur se gjatë zbatimit të planit ka gjasë të ndjeshme të kryerjes së krimit, ka gjendjen mendore kriminale të nevojshme e cila provon përgjegjësinë për planifikimin në bazë të Nenit 7 (1) të Statutit.[1684]

(d) Nxitja

514. Në jurisprudencën e Tribunalit përkufizimi i fjalës "nxitje" ka kuptimin "shtyj dikë tjetër në kryerjen e një vepre penale".[1685] Si veprimet po ashtu edhe mosveprimet mund të përbëjnë nxitje, ku përfshihen veprime të shprehura dhe të nënkuptuara.[1686] Duhet provuar lidhja midis nxitjes dhe kryerjes,[1687] por nuk është e nevojshme të tregohet se krimi nuk do të kishte ndodhur pa përfshirjen e të akuzuarit.[1688] Sjellja e fajshme provohet në qoftë se tregohet se sjellja e të akuzuarit ishte një faktor që kontribuoi ndjeshëm në sjelljen e kryesit.[1689] Gjendja e nevojshme mendore kriminale për

[1680] Vendimi i Apelit *Kvoçka*, paragrafi 86.
[1681] Aktgjykimi *Bërgjanin,* paragrafi 268; Aktgjykimi *Kërstiq,* paragrafi 601; Aktgjykimi *Stakiq,* paragrafi 443.
[1682] Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 26, ku citohet Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 386.
[1683] Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 26.
[1684] Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 31.
[1685] Aktgjykimi *Kërstiq,* paragrafi 601; Aktgjykimi *Akayesu,* paragrafi 482; Aktgjykimi *Blashkiq,* paragrafi 280; Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 27; Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 387.
[1686] Aktgjykimi *Bërgjanin,* paragrafi 269; Aktgjykimi *Blashkiq,* paragrafi 280.
[1687] Aktgjykimi *Bërgjanin,* paragrafi 269; Aktgjykimi *Blashkiq,* paragrafi 280.
[1688] Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 27.
[1689] Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 27.

"nxitje" është se i akuzuari synoi të provokonte ose shkaktonte kryerjen e krimit ose ishte i vetëdijshëm për gjasën e ndjeshme se prej nxitjes do të ndodhte krim.[1690]

(e) Urdhërimi

515. Veprimi i fajshëm e "urdhërimit" kërkon që një person në pozitë eprore udhëzon një person tjetër të kryejë një shkelje.[1691] Nuk është e nevojshme të tregohet ekzistenca e një strukture formale komanduese epror-vartës ose lidhje midis urdhëruesit dhe kryesit; mjafton që urdhëruesi të ketë autoritet faktik ose ligjor për të urdhëruar kryerjen e shkeljes, ose se autoriteti mund të nënkuptohet logjikisht.[1692] Nuk është kusht që urdhri të jepet me shkrim apo në ndonjë formë të veçantë, dhe ekzistenca e urdhrit mund të provohet me anë të provave rrethanore.[1693] Në lidhje me gjendjen mendore kriminale, i akuzuari ose duhet të ketë synuar të shkaktonte kryerjen e krimit, ose të ketë qenë i vetëdijshëm për gjasën e ndjeshme të kryerjes së krimit si pasojë e kryerjes ose zbatimit të urdhrit.[1694]

(f) Ndihma dhe inkurajimi

516. "Ndihma dhe inkurajimi" janë përkufizuar si veprim i dhënies së ndihmës praktike, inkurajimit ose mbështetjes morale, që ka ndikim të ndjeshëm në kryerjen e një krimi të caktuar.[1695] "Ndihmë" dhe "inkurajim" nuk janë sinonime po të shihen rigorozisht.[1696] "Ndihmë" nënkupton mbështetje; "inkurajim"do të thotë jo më shumë se të japësh zemër ose të jesh për kryerjen e një veprimi të caktuar .[1697] Sidoqoftë këto forma të përgjegjësisë janë shqyrtuar vazhdimisht bashkë në jurisprudencën e Tribunalit.

517. Sjellja e fajshme e ndihmës dhe inkurajimit është se mbështetja, zemërdhënia ose ndihma e ndihmuesit ose inkurajuesit ka ndikim të ndjeshëm mbi kryerjen e krimit.[1698] Nuk ka kusht për lidhje shkakësore midis sjelljes së ndihmuesit ose inkurajuesit dhe kryerjes së krimit, apo për provë se një sjellje e tillë ishte kusht që i parapriu kryerjes së krimit.[1699] Në rrethana të caktuara, një

[1690] Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 32.
[1691] Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 28; ku citohet Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 388.
[1692] Vendimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafi 270.
[1693] *Prokurorja kundër Jean de Dieu Kumuhanda,* Lënda Nr: ICTR-99-54A-A, Vendim, 19 shtator 2005, para 76 ku citohet Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 388; Aktgjykimi *Blashkiq,* paragrafi 281.
[1694] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* para 42; Vendimi i Apelit *Kordiq*, paragrafi 30; Aktgjykimi *Bërgjanin,* paragrafi 270.
[1695] Aktgjykimi *Kërstiq,* paragrafi 601; Vendimi i Apelit *Aleksovski*, para 162, ku citohet Aktgjykimi *Furunxhija*, para 249.
[1696] Aktgjykimi *Kvoçka* para 254, ku citohet Aktgjykimi *Akayesu*, para 484.
[1697] Aktgjykimi *Kvoçka* para 254, ku citohet Aktgjykimi *Akayesu*, para 484.
[1698] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* para 48; Aktgjykimi *Furunxhija*, para 249; Aktgjykimi *Kunarac,* paragrafi 391.
[1699] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* para 48.

mosveprim mund të përbëjë sjelljen e fajshme të ndihmës dhe inkurajimit.[1700] Më tej, ndihma mund të ndodhë para, gjatë ose pas kryerjes së krimit kryesor.[1701] Ndërkohë që çdo rast bazohet në faktet e veta, thjesht prania në vendin e krimit zakonisht nuk do të përbëjë ndihmë ose inkurajim. Mirëpo prania mund të jetë e mjaftueshme kur ajo i jep legjitimitet ose i ofron mbështetje kryesit faktik. Në raste të veçanta mbështetja mund të provohet nëpërmjet sjelljes së dukshme mirëkuptuese ose miratuese për kryerjen e veprimit në fjalë. Për shembull lidhur me këtë, prania e një eprori mund të shërbejë si inkurajim apo mbështetje.[1702]

518. Gjendja mendore kriminale e nevojshme është se ndihmuesi ose inkurajuesi di se me sjelljen e tij ose të saj po ndihmon ose lehtëson kryerjen e shkeljes.[1703] Kjo dijeni nuk është e nevojshme të jetë shprehur qartësisht. Natyrisht që ajo mund të nxirret prej rrethanave përkatëse.[1704] Ndihmuesi ose inkurajuesi nuk është e nevojshme të ketë gjendjen mendore kriminale të kryesit, por ai ose ajo duhet të jetë i/e vetëdijshëm/shme për elementët thelbësorë të krimit të kryer në fund prej kryesit[1705] dhe duhet të jetë i/e vetëdijshëm/shme për gjendjen mendore të kryesit.[1706] Kjo nuk do të thotë se ndihmuesi dhe inkurajuesi duhet të dijë për krimin e caktuar që do të kryhet prej kryesit. Në qoftë se se ndihmuesi dhe inkurajuesi di se ka gjasë që kryesi do të kryejë një numër krimesh, dhe një prej krimeve faktikisht është kryer, atëherë ai ka synuar të ndihmojë ose lehtësojë kryerjen e atij krimi dhe është fajtor si ndihmues ose inkurajues.[1707]

2. Përgjegjësia në bazë të Nenit 7(3) të Statutit

519. Neni 7 (3) i Statutit parashtron:

> Fakti se çfarëdo prej veprimeve të përmendura në nenet nga 2 në 5 të këtij Statuti u krye prej një vartësi, nuk e çliron eprorin e tij prej përgjegjësisë penale në qoftë se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi ishte në prag të kryerjes së veprimeve të tilla ose e kishte bërë këtë dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e këtyre veprimeve ose për ndëshkimin e kryesve.

[1700] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* para 47; *Shih* edhe Aktgjykimin *Kërnojelac,* para 88; Aktgjykimi *Kunarac,* paragrafi 391.
[1701] Aktgjykimi *Bërgjanin,* paragrafi 271; Vendimi i Apelit *Blashkiq,* para 48; Aktgjykimi *Kërnojelac,* para 88
[1702] Aktgjykimi *Bërgjanin,* paragrafi 271.
[1703] Aktgjykimi *Furunxhija*, para 249; Vendimi i Apelit *Tadiq*, para 229; Vendimi i Apelit *Blashkiq,* para 49; Vendimi i Apelit *Vasileviq,* para 102.
[1704] Aktgjykimi *Çelebiqi*, para 328; Aktgjykimi *Tadiq*, para 676.
[1705] Vendimi i Apelit *Aleksovski*, para 162; Aktgjykimi *Kërnojelac,* para 90. "Ndihmuesi dhe inkurajuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për elementët thelbësorë të krimit të kryer prej shkelësit kryesor, duke përfshirë edhe gjendjen e nevojshme mendore kriminale të shkelësit kryesor. Gjithsesi ndihmuesi dhe inkurajuesi nuk është e nevojshme të ketë të njëjtën gjendje kriminale mendore si të shkelësit kryesor."
[1706] Aktgjykimi *Bërgjanin,* paragrafi 273; Vendimi i Apelit *Aleksovski*, para 162.
[1707] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* para 50 ku citohet Aktgjykimi *Blashkiq,* para 287; Aktgjykimi *Furunxhija*, para 246; Aktgjykimi *Bërgjanin,* paragrafi 272.

Parimi i përgjegjësisë penale individuale të eprorit për mosparandalimin apo mosndëshkimin e krimeve të kryera nga vartësit, është parim i njohur i të drejtës zakonore ndërkombëtare,[1708] i vlefshëm për konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe të brendshme.[1709]

520. Është përcaktuar se për nxjerrjen e përgjegjësisë penale individuale sipas Nenit 7(3) të Statutit duhen përmbushur tre elementë:

> (i) ekzistenca e lidhjes epror-vartës;
> (ii) eprori dinte ose kishte arsye të dinte se veprimi kriminal ishte në prag të kryerjes ose ishte kryer; dhe
> (iii) eprori nuk mori masa të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimit kriminal ose ndëshkimin e kryesit të tij.[1710]

(a) Lidhja epror-vartës

521. Lidhja epror-vartës është thelbi i doktrinës së përgjegjësisë së komandantit për krimet e kryera nga vartësit e tij. Pozicioni komandues dhe autoriteti kontrollues i veprimeve të kryesve formon bazën ligjore të detyrës së eprorit për të vepruar dhe përgjegjësisë së tij rrjedhëse për moskryerjen e veprimit.[1711]

522. Ekzistenca e pozitës komanduese mund të dalë prej statusit formal ose ligjor të një eprori, ose nga ekzistenca e autoritetit faktik të kontrollit. Ajo rrjedh thelbësisht prej "zotërimit apo moszotërimit faktik të autoritetit kontrollues mbi veprimet e vartësve."[1712] Në përcaktimin e shkallës së kontrollit të ushtruar nga eprori mbi vartësin, Dhoma e Apelit mbështeti satndardin e kontrollit efektiv, si mundësia materiale për parandalimin ose ndëshkimin e sjelljes kriminale.[1713] Ekzistenca e lidhjes epror-vartës "nuk […] përcakton një kërkesë për vartësi *të dretpërdrejtë* apo *formale*".[1714] Analogjikisht, nuk është kusht që lidhja midis eprorit dhe vartësit të ketë karakter të

[1708] Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 195, Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 357.
[1709] Për zbatimin e parimit të përgjegjësisë së komandantit në konfliktet e brendshme të armatosura, *shih Prokurorja kundër Hazhihasanoviqit dhe të tjerët.,* Lënda Nr IT-01-47-AR72, Vendimi i Dhomës së Apelit mbi Apelin e Ndërkohshëm që Kundërshton Juridiksionin në Lidhje me Përgjegjësinë Komanduese, 16 korrik 2003, paragrafi 31.
[1710] Aktgjykimi *Çelebiqi,* paragrafi 346. *Shih* edhe Aktgjykimin *Kordiq,* paragrafi 401; Aktgjykimi *Blashkiq,* paragrafi 294; Aktgjykimi *Kvoçka,* paragrafi 314; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 358.
[1711] Vendimi i Apelit *Aleksovski,* paragrafi 76; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 359.
[1712] Aktgjykimi *Çelebiqi,* paragrafi 370; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 362.
[1713] Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 256. Dhoma e Apelit ka hedhur poshtë argumentin se një epror mund të jetë penalisht përgjegjës mbi bazën e fuqisë së ndikimit të tij sepse ajo deklaroi se "ndikimi thelbësor si mjet kontrolli në çfarëdo kuptimi i cili nuk plotëson kuptimin e zotërimit të kontrollit efektiv mbi vartësit" (d.m.th. zotërimi i aftësisë materiale për parandalim dhe ndëshkim) nuk gëzon statusin e një rregulle të së drejtës zakonore ndërkombëtare, sidomos e tillë që të mund të shkaktojë përgjegjësi penale. *Shih* Vendimin e Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 266.
[1714] Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 203.

përhershëm.[1715] Gjithashtu, Dhoma rikujton se "kushti i kontrollit efektiv […] nënkupton se për të njëjtin krim të kryer nga një vartës mund të jetë përgjegjës më shumë se një person."[1716]

(b) Elementi mendor: eprori dinte ose kishte arsye të dinte

523. Që eprori të mbajë përgjegjësinë e Nenit 7 (3) të Statutit për krime të kryera nga një vartës, duhet provuar se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi ishte në prag të kryerjes ose kishte kryer krime të tilla.

524. Megjithëse nuk mund të parasupozohet dijenia faktike e një eprori se vartësit e tij po kryenin ose do të kryenin një krim, ajo mund të provohet prej provave rrethanore,[1717] si numri, lloji dhe shtrirja e veprimeve të paligjshme, koha kur ndodhën veprimet e paligjshme, numri dhe lloji i trupave dhe logjistikës së përfshirë, vendndodhja gjeografike, nëse veprimet janë të përhapura, ritmi taktik i operacioneve, mënyra e kryerjes së veprimeve të ngjashme të paligjshme, oficerët dhe personeli i përfshirë, dhe vendndodhja e komandantit në atë kohë.[1718]

525. Në përcaktimin nëse një epror "kishte arsye të dinte" se vartësit e tij po kryenin ose do të kryenin një krim, duhet treguar se faktikisht ai kishte në dispozicion informacion konkret që tregonte për shkelje të kryera ose që do të kryheshin prej vartësve të vet.[1719] Në fakt informacioni duhet të jetë në dispozicion të eprorit, i cili në fund të fundit mund të mos jetë përgjegjës për mosmarrjen e një informacioni të tillë.[1720] Gjithsesi informacioni faktikisht në dispozicion nuk është e nevojshme që të jetë i mjaftueshmën në vetvete që të çojë në nxjerrjen e përfundimit për ekzistencën e krimeve të tilla.[1721] Mjafton që eprori të zotërojë informacion të mjaftueshëm, edhe pse të karakterit të përgjithshëm, që të informohet mbi gjasën e veprimeve të paligjshme prej vartësve të vet, me fjalë të tjera që të përligjë hetime të tjera për të qartësuar nëse në të vërtetë po kryheshin ose do të kryheshin veprime të tilla.[1722]

[1715] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 362.
[1716] Aktgjykimi *Blashkiq,* paragrafi 303, që i referohet Aktgjykimit *Aleksovski,* paragrafi 106; *shih* edhe Aktgjykimin *Strugar,* paragrafi 365.
[1717] Aktgjykimi *Çelebiqi,* paragrafi 386; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 368.
[1718] Aktgjykimi *Çelebiqi,* paragrafi 386. *Shih* edhe Aktgjykimin *Kordiq,* paragrafi 427; Aktgjykimi *Blashkiq,* paragrafi 307; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 368.
[1719] Aktgjykimi *Çelebiqi,* paragrafi 393; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 369.
[1720] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafët 62-63; Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 226.
[1721] Aktgjykimi *Çelebiqi,* paragrafi 393; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 369.
[1722] Aktgjykimi *Çelebiqi,* paragrafi 393; Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 437; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 370.

(c) Masa të nevojshme dhe të arsyeshme

526. Problemi nëse një epror nuk mori masa të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e një krimi apo ndëshkimin e kryesit të tij lidhet me faktin nëse ai ka kontroll efektiv. Eprori do të mbajë përgjegjësi nëse ai nuk mori masa të tilla brenda mundësive të veta materiale. Nuk ka rëndësi nëse eprori kishte kompetenca të shprehura ligjore, në qoftë se ai ka patur mundësi materiale për të vepruar.[1723]

527. Në Nenin 7 (3), eprori ka detyrë të parandalojë kryerjen e shkeljes dhe të ndëshkojë kryesit. Këto nuk janë detyrime alternative.[1724] Detyra për parandalimin fillon prej momentit kur eprori vihet në dijeni apo ka arsye të dijë se po kryhet ose do të kryhet një krim, kurse detyra për ndëshkim pasi eprori vihet në dijeni për kryerjen e krimit.[1725] Eprori duhet të veprojë që prej momentit kur ai e merr këtë informacion. Detyrimet e tij për të parandaluar nuk përmbushen thjesht duke pritur dhe ndëshkuar më pas.[1726]

528. Përmbushja e detyrës për parandalimin e kryerjes së krimit prej eprorit varet prej mundësisë së tij materiale për të ndërhyrë në rastin konkret. Faktorë të cilët mund të merren parasysh në këtë përcaktim janë ndër të tjerë, mosthirrja në raport prej eprorit mbi kryerjen e operacioneve ushtarake në pajtim me të drejtën ndërkombëtare,[1727] mosnxjerrja e urdhrave për përshtatjen e praktikave përkatëse me rregullat e luftës,[1728] mosprotestimi ose moskritika kundër veprimeve kriminale,[1729] mosmarrja e masave disiplinore për parandalimin e kryerjes së mizorive prej trupave nën komandën eprore[1730] dhe moskëmbëngulja para autoritetit epror për marrjen e menjëhershme të masave.[1731]

529. Detyra e eprorit për ndëshkimin e kryesve të një krimi përfshin detyrimin për kryerjen e një hetimi efektiv për të provuar faktet.[1732] Eprori ka detyrim të marrë masa aktive për ndëshkimin e kryesve. Për këtë qëllim, eprori mund të ushtrojë kompetencat e tija për të ndëshkuar, ose në qoftë se atij i mungojnë këto kompetenca, t'i raportojë kryesit te autoritetet kompetente.[1733]

[1723] Aktgjykimi *Çelebiqi,* paragrafi 395 (nuk përfshihen shënimet në fund të faqes). *Shih* edhe Aktgjykimin *Kordiq,* paragrafi 443; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 372.
[1724] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 83.
[1725] Vendimi i Apelit *Blashkiq,* paragrafi 83; Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafët 445-446.
[1726] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 373.
[1727] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 374.
[1728] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 374.
[1729] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 374.
[1730] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 374.
[1731] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 374.
[1732] Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 376.
[1733] Aktgjykimi *Kordiq,* paragrafi 446; Aktgjykimi *Strugar,* paragrafi 376.

B. Përfundime

1. Përgjegjësia e Fatmir Limajt

(a) A u identifikua Fatmir Limaj në kamp-burgun e Llapushnikut?

530. Në Aktakuzë pretendohet se Fatmir Limaj me pseudonimin Çeliku, drejtoi funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut, se ai mori pjesë personalisht në zbatimin e mbajtjes së të burgosurve, marrjen e tyre në pyetje si edhe në trajtimin e egër dhe çnjerëzor ushtruar kundër tyre. Gjithashtu pretendohet se Fatmir Limaj planifikoi, nxiti dhe urdhëroi vrasjen e të burgosurve në kamp-burgu, dhe në malet e Berishës.[1734] Mbrojtja e Fatmir Limajt argumenton se i Akuzuari Fatmir Limaj nuk dinte kurrgjë apo se nuk mori pjesë në ngritjen dhe organizimin e një kamp-burgu të tillë.[1735] Dhoma dëgjoi dëshmi nga disa dëshmitarë të Prokurorisë të cilët pretenduan se e identifikuan Fatmir Limajn si person të cilin e kishin parë në kamp-burgun e Llapushnikut.

531. Për Vojko Bakraçin dhe djalin e tij Ivan Bakraçin u arrit në përfundimin se janë mbajtur në kamp-burgun e Llapushnikut afërsisht një javë në korrik 1998.[1736] Sipas dëshmive të tyre, gjatë mbajtjes së tyre, ata takuan disa herë "komandantin" e kamp-burgut.

532. Vojko Bakraçi dëshmoi se kur u mbajt me të birin, Ivanin, në fllanik,[1737] një njeri me uniformë kamuflimi erdhi dhe mori Ivanin. Personi ishte më i gjatë se dëshmitari, në të tridhjetat dhe kishte një mjekër të vogël dhe një çantë oficeri.[1738] Më vonë edhe Vojko Bakraçi u thirr jashtë fllanikut dhe u çua në një dhomë në katin përdhes të ndërtesës kryesore ku ai pa të birin Ivanin dhe të njëjtin person duke biseduar dhe duke pirë çaj. Personi i tha Ivanit se fllaniku nuk ishte vend i përshtatshëm për të.[1739] Prej atij momenti, megjithëse Vojko Bakraçin e çuan në fllanik për një periudhë të shkurtër, ai dhe i biri ndejtën në dhomën në katin e sipërm të shtëpisë.[1740] Vojko Bakraçi supozoi se ky person kishte "pozitë eprore" meqë ushtarët dhe rojat i bindeshin.[1741] Gjithashtu Vojko Bakraçi dëshmoi se një herë më vonë, ai dhe Ivani u çuan në dhomën në katin përdhes të shtëpisë ku ata panë rrahjen e katër apo pesë personave. Sipas dëshmisë së tij, njeriu të

[1734] Aktakuzë, paragrafi 10.
[1735] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 503.
[1736] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[1737] Vojko Bakraç e përshkroi dhomën ku u mbajt si "bodrum"por e identifikoi si fllanik në Provën Materiale P5, T 1326-1329.
[1738] Vojko Bakraç, T 1334-1335.
[1739] Vojko Bakraç, T 1338.
[1740] Vojko Bakraç, T 1338.
[1741] Vojko Bakraç, T 1336.

cilin ai e kishte identifikuar si "komandant" ishte i pranishëm dhe i tha atij se këta njerëz ishin tradhtarë të popullit të tyre.[1742] Incidenti vazhdoi afërsisht 45 minuta dhe pas kësaj, Vojko dhe Ivan Bakraçin i kthyen në dhomën lart.[1743] Vojko Bakraçi mban mend se gjatë këtij takimi të dytë, "komandanti" i tha Vojko Bakraçit se ai ishte jurist.[1744] Vojko Bakraçi dëshmoi se ai e takoi "komandantin" edhe një herë para lirimit të tij, kur "komandanti" i kërkoi atij dhe djalit të tij të shkruanin një deklaratë për kushtet në kamp-burg.[1745] Pasi bëri deklaratën, Vojko Bakraçi i kërkoi "komandantit" të kontaktonte vjehrrën e tij dhe t'a informonte se ata do të liroheshin. Sipas dëshmisë së Vojko Bakraçit, "komandanti" tha se ai e bëri këtë të nesërmen,[1746] gjë që sugjeron se ky ishte takimi i tretë. Në janar 2002, gjatë një interviste me hetues të CCIU-së, Vojko Bakraçit iu treguan një sërë fotografish. Njëra prej fotografive sipas vlerësimit të Dhomës ishte një fotografi shumë e identifikueshme e Fatmir Limajt, megjithëse i rruar dhe jo me mjekrën e vogël të përshkruar prej dëshmitarit. Në lidhje me këtë fotografi Vojko Bakraçi në atë kohë dëshmoi: "Numri 2 duket i njohur, por nuk e di prej ku dhe nuk mund ta lidh me këtë rast."[1747] Numri 2 ishte fotografia e Fatmir Limajt.

533. Ivan Bakraçi, djali në atë kohë 18-vjeçar i Vojko Bakraçit, dëshmoi se pas ardhjes në kamp-burgun e Llapushnikut, ai dhe i ati u çuan në një dhomë brenda shtëpisë,[1748] ku u morën në pyetje nga një njeri që dukej se komandonte.[1749] "Komandanti" ishte afërsisht 35 vjeç, rreth 180-185 cm i gjatë, me trup mesatar, me flokë paksa të gjatë, pjesërisht të thinjur dhe të krehur pas; ai ishte i rruar.[1750] Sipas dëshmisë së Ivan Bakraçit, "komandanti" rrinte ulur afërsisht gjysëm metri larg tyre gjatë hetimit dhe u soll në një mënyrë shumë profesionale, duke mos dhënë asnjë shenjë se donte t'u bënte keq. Marrja në pyetje vazhdoi 10-15 minuta.[1751] Gjatë asaj kohe Stamen Genovi po rrihej në prani të "komandantit", i cili u duk se e toleroi atë trajtim megjithëse ai nuk mori vetë pjesë në të.[1752] Më vonë Ivan Bakraçi pati një bisedë të dytë me "komandantin", në dhomën lart në po atë

[1742] Vojko Bakraç, T 1341-1342.
[1743] Vojko Bakraç, T 1342.
[1744] Vojko Bakraç, T 1336; 1342.
[1745] Vojko Bakraç, T 1343-1345.
[1746] Vojko Bakraç, T 1345-1348.
[1747] Fakt i Pranuar, T 1370-1371; Prova Materiale DB1(fleta me fotografi A1)
[1748] Ivan Bakraç, T 1416; 1426. Ivan Bakraçi identifikoi shtëpinë dhe dhomën në Provat Materiale P5 dhe P6, T 1426-1427.
[1749] Ivan Bakraç, T 1428. Ivan Bakraçi dëshmoi se të gjithë e përshëndetën këtë person dhe qendronin gatitu kur ai u afrua, T 1430.
[1750] Ivan Bakraç, T 1430. Ivan Bakraçi shtoi më vonë në dëshminë e tij se megjithëse "komandanti" nuk kishte mjekër, ai nuk ishte "i saporruar", T 1572-1573. Sidoqoftë nuk është e qartë prej këyre pyetjeve nëse ky përshkrim i "komandantit" ishte siç dukej në kamp, apo në fotografinë që Ivan Bakraçi gjeti në internet.
[1751] Ivan Bakraç, T 1431.
[1752] Ivan Bakraç, T 1431.

shtëpi. Takimi i dytë vazhdoi afërsisht 15-20 minuta.[1753] "Komandanti" u soll në të njëjtën mënyrë si më parë dhe u tha se ata do të liroheshin,[1754] por më parë duhej të bënin një deklaratë.[1755] Dikur në javët pas ngjarjeve, Ivan Bakraçi tha se ai dhe babai i tij panë në televizor "komandantin", duke marshuar në një kolonë me ushtarë të UÇK-së. Nuk është e qartë nëse ajo që u pa në televizor ishte fotografi e marshimit apo video.[1756] Sipas dëshmisë së tij të dy njohën "komandantin" e kamp-burgut.[1757] Në 1999, Ivan Bakraçi pa të njëjtën fotografi të "komandantit" në internet. Ai e identifikoi fotografinë në gjyq.[1758] Mirëpo ai nuk ia përmendi këtë fakt Prokurorisë deri pak ditë para dëshmisë së tij,[1759] edhe pse duket se ai kishte hyrë në atë faqe interneti dhe kishte parë të njëjtën fotografi qindra herë midis 1999 dhe 2003.[1760] Në gjyq, Ivan Bakraçi e njohu "komandantin" edhe në një video mbi të njëjtin marshim si komandant të kolonës së ushtarëve të UÇK-së.[1761] Në të vërtetë në këtë video Fatmir Limaj shihet në kolonën marshuese. Mirëpo ai kishte mjekër. Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Ivan Bakraçi deklaroi se gjatë intervistës në janarin e vitit 2003 hetuesit nuk i kishin treguar asnjë fotografi të "komandantit".[1762] Në gjyq atij iu tregua një fletë me fotografi të tetë personave, ku përfshihej edhe një fotografi, sipas vlerësimit të Dhomës, shumë e identifikueshme e Fatmir Limajt të rruar, ashtu si e kishte përshkruar ky dëshmitar personin që kishte parë në kamp-burg. Mirëpo Ivan Bakraçi deklaroi se "personi nuk është në fotografi, dua të them personi i cili është në internet."[1763]

534. Dhoma është e bindur se të dy, Vojko dhe Ivan Bakraçi, dëshmuan ndershmërisht. Mirëpo ekzistojnë rrethana që mund ta bëjnë dëshminë e një dëshmitari të caktuar jo të besueshme edhe pse dëshmia u dha në një mënyrë tërësisht të ndershme. Veçanërisht në këtë rast, ngjarjet që përjetuan Ivan dhe Vojko Bakraçi në kamp ishin jashtëzakonisht tronditëse. Ato ndodhën para disa vitesh. Në vitet që pasuan, Ivan Bakraçi dhe ndoshta Vojko Bakraçi janë ndikuar prej transmetimeve televizive dhe informacionit në internet ku duket se paraqitej Fatmir Limaj. Sipas pikëpamjes së Dhomës këta faktorë fare mirë mund të ndikojnë mbi aftësinë e secilit ose të të dyve për të identifikuar besnikërisht një ose më shumë prej të Akuzuarve. Rrjedhimisht është e nevojshme që dëshmitë e

[1753] Ivan Bakraç, T 1432-1433.
[1754] Ivan Bakraç, T 1431-1432.
[1755] Ivan Bakraç, T 1471-1474.
[1756] Ivan Bakraç, T 1561-1562.
[1757] Ivan Bakraç, T 1561-1563.
[1758] Prova Materiale P80; Ivan Bakraç, T 1433-1436; 1563-1564; 1584.
[1759] Ivan Bakraç, T 1433-1437.
[1760] Ivan Bakraç, T 1563-1566.
[1761] Prova Materiale P35. U bë një fotografi e personit të cilin Ivan Bakraçi e identifikoi si Fatmir Limaj, Prova Materiale P81; Ivan Bakraç, T 1437-1438; 1568.
[1762] Ivan Bakraç, T 1566; 1573.
[1763] Prova Materiale DL1 (fleta me fotografi B1); Ivan Bakraç, T 1573-1575.

tyre të shqyrtohen me imtësi, në veçanti kur Ivan Bakraçi pretendon se identifikon Fatmir Limajn si "komandanti" në kamp duke iu referuar pamjes së kolonës marshuese të ushtarëve të UÇK-së.

535. Dhoma ka mendimin se dëshmitë e Vojko Bakraçit dhe Ivan Bakraçit, sidomos të marra bashkë, zbulojnë disa mospërputhje. Rezultati kyç i dëshmisë së Vojko Bakraçit është se njeriu të cilin ai në atë kohë e konsideroi si "komandanti" ishte ai i cili erdhi dhe mori të birin Ivanin nga fllaniku dhe të cilin ai e pa edhe dy herë të tjera në dhomën në katin përdhes të shtëpisë. Mirëpo, Ivan Bakraçi e identifikoi njeriun që e nxori nga fllaniku dhe me të cilin po bisedonte në shtëpi si Shala, të cilin ai e dallon nga njeriu të cilin ai vetë e identifikon si "komandant".[1764] Takimi i dytë me atë që siç duket ishte "komandanti" që Vojko Bakraçi e përshkruan në dëshminë e tij, është kur ai dhe i biri panë rrahjen e disa personave në dhomë në katin përdhes të shtëpisë, gjatë së cilës atij i kujtohej prania e "komandantit". Ky incident nuk përmendet prej Ivan Bakraçit në dëshminë e tij. E vetmja dëshmi e dhënë prej tij për rrahjet në prani të "komandantit" ka të bëjë me kohën kur ai dhe i ati sapo arritën në kamp-burg dhe u morën në pyetje. Sipas Dhomës, ose Vojko dhe Ivan Bakraçi e kanë fjalën për "komandantë" të ndryshëm, ose kanë kujtime të ndryshme për kohën dhe rrethanat kur ndodhën takimet e tyre me "komandantin". Dhoma ka mendimin se në këto rrethana do të ishte mjaft problematike që prej dëshmisë së Vojko Bakraçit të nxirrej përfundimi se njeriu të cilin ai e mendoi se ishte "komandanti", dhe po ai njeri i cili erdhi të merrte të birin nga fllaniku, ishte Fatmir Limaj. Ky problem natyrisht që bëhet më i madh prej faktit se Vojko Bakraçi nuk mundi ta njihte Fatmir Limajn në vargun e fotografive që iu treguan atij gjatë intervistës me hetuesit e CCIU-së në janar 2002.

536. Në parashtrimet e veta përfundimtare, Prokuroria argumenton se Vojko Bakraçi e identifikoi pamjen e Fatmir Limajt kur ai ishte ende në kamp-burgun e Llapushnikut.[1765] Mirëpo ky argument mbështetet vetëm prej një raporti shënimesh të një interviste që thuhet se Vojko Bakraçi bëri me autoritetet serbe më 8 korrik 1998 pas lirimit të tij.[1766] Thuhet se Vojko Bakraçi shpjegoi se një herë gjatë mbajtjes së tyre, ai dhe djali i tij Ivani panë një kolonë ushtarësh të UÇK-së në televizor dhe në krye të kolonës, njohën komandantin i cili kishte ardhur shpesh në kamp, dhe disa të tjerë.[1767] Mirëpo Prokuroria mbështetet në një dokument i cili pretendohet se përmban shënime të marra nga një individ i panjohur në emër të Qendrës së Degës së Sigurimit Shtetëror serb. Pretendohet se shënimet bazohen mbi informacionin e dhënë nga Vojko Bakraçi gjatë një interviste me autoritetet

[1764] Ivan Bakraç, T 1458-1464.
[1765] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 150.
[1766] Prova Materiale P202.
[1767] Prova Materiale P202, f. 5.

serbe më 8 korrik 1998. Gjatë dëshmisë së tij Vojko Bakraçi nuk u pyet në lidhje me këtë pjesë të shënimeve. Mbajtësi i panjohur i shënimeve nuk ka dëshmuar. Ato nuk janë nënshkruar prej Vojko Bakraçit. Me gjithë pyetjet e zgjatura mbi kujtesën e Vojko Bakraçit gjatë dëshmisë së tij në lidhje me "komandantin", ai nuk përmendi se kishte njohur dikë në televizor gjatë kohës së burgimit të tij. Gjithashtu, siç u pohua më sipër, Ivan Bakraçi dëshmoi se ai e kishte njohur "komandantin" në televizor bashkë me të atin. Mirëpo kur u pyet konkretisht në gjyq kur ndodhi kjo, ai dëshmoi se kjo ndodhi në javët pas lirimit të tij dhe babait të tij.[1768] Në këto rrethana, Dhoma nuk mund t'u japë rëndësi shënimeve të bëra prej dikujt më 8 korrik 1998 dhe padyshim që nuk mund të nxjerrë përfundimin se Vojko Bakraçi identifikoi pamjen e Fatmir Limajt kur ishte ende në kamp-burgun e Llapushnikut. Veç kësaj, në mungesë të dëshmisë së drejtpërdrejtë nga Vojko Bakraçi ku të konfirmohej se në të vërtetë, ai e njohu "komandantin" kur ai dhe i biri panë televizor kohë pas lirimit të tyre nga kamp-burgu, Dhoma nuk mund të bindet se ky është identifikim i besueshëm prej Vojko Bakraçit, edhe sikur kjo të ketë qenë përshtypje e ndershme e asaj kohe e Ivan Bakraçit.

537. Ivan Bakraçi dëshmoi se ai e takoi njeriun të cilin e identifikoi si "komandanti" dy herë në kamp-burg, secili takim vazhdoi 10-20 minuta gjatë të cilëve ata duket se kanë biseduar. Kjo kohë relativisht e gjatë e takimeve, në rrethana të tilla, mund të ishte bazë për një identifikim të mëtejshëm të saktë të "komandantit".[1769] Gjithsesi Dhoma nënvizon se megjithëse Ivan Bakraçi deklaroi se në kohën e mbajtjes së tij në kamp-burgun e Llapushnikut "komandanti" ishte krejt i rruar, në fotografinë në internet prej të cilës ai pretendon ta ketë identifikuar "komandantin", është një njeri me mjekër.[1770] Për më tepër, fotografia në internet është tejet e vogël dhe sipas mendimit të Dhomës tiparet e njeriut në atë fotografi nuk janë lehtësisht të dallueshme.[1771] Nga ana tjetër, kur iu tregua një fotografi e Fatmir Limajt krejtësisht i rruar, ashtu siç e kujtonte Ivan Bakraçi "komandantin" që iu paraqit në Llapushnik, Ivan Bakraçi nuk e njohu "komandantin".[1772] Megjithëse Dhoma e pranon tërësisht ndershmërinë e Bakraçëve babë e bir, ajo është e ndërgjegjshme së dëshmia e Vojko Bakraçit nuk iu përgjigj plotësisht disa pikave që kishin lidhje me identifikimin dhe se prej atyre të dyve, Ivan Bakraçi dukej se kishte kujtesën më të qartë dhe më të besueshme të çështjeve përkatëse. Megjithatë, për arsyet e treguara, Dhoma nuk mund të bindet për besueshmërinë e identifikimit të pretenduar të të Akuzuarit Fatmir Limaj prej Ivan Bakraçit.

[1768] Ivan Bakraç, T 1561-1562.
[1769] Profesor Willem Wagenaar, T 7157-7160; 7163.
[1770] Prova Materiale P80.
[1771] Prova Materiale P80.
[1772] Prova Materiale DL1 (fleta me fotografi B1).

538. Në bazë të përfundimit të Dhomës, L06 u mbajt disa javë në fllanik, në kamp-burgun e Llapushnikut.[1773] Gjatë dëshmisë së tij L06 deklaroi se një ditë një njeri erdhi te dera e fllanikut dhe e pyeti pse ndodhej atje. L06 i tregoi për rrethanat e tij dhe personi u përgjigj se ai do ta shqyrtonte çështjen dhe e paralajmëroi L06-ën se po të ishte fajtor, ai do të vritej, por në rast se ishte i pafajshëm do të lirohej.[1774] L06 tha se i njëjti njeri erdhi pas një jave, i tha L06-ës se ai mund të shkonte në shtëpi dhe se ata të cilët e kishin sjellë atë aty do të vuanin pasojat.[1775] L06 e përshkroi njeriun i cili urdhëroi lirimin e tij si më të gjatë dhe më të ri se vetja;[1776] personi nuk kishte mjekër dhe kishte uniformë të UÇK-së.[1777] L06 deklaroi se në atë kohë ai nuk e njohu këtë njeri, por se ai e njohu atë më vonë në televizor, ndoshta një vit pas luftës.[1778] Sipas dëshmisë së tij në këtë mënyrë ai mësoi se emri i atij personi ishte Fatmir Limaj.[1779] Mirëpo në një deklaratë të dhënë hetuesve të CCIU-së në janar 2002, siç duket L06 bëri të ditur se kur ishte në Llapushnik një i burgosur i tha se ai person ishte Fatmir Limaj.[1780] Rrjedhimisht ka një mospërputhje të dukshme nëse L06, gjatë burgimit të tij mësoi se personi ishte Fatmir Limaj apo nëse ai e pa Fatmir Limajn në televizor ndoshta një vit pas ngjarjeve dhe kështu e njohu si personin i cili kishte urdhëruar lirimin e tij. Në gjyq L06 deklaroi se në deklaratën e janarit 2002 mund të jetë bërë gabim në përkthim dhe se ai e dëgjoi emrin e Fatmir Limajt në televizor, kohë pas ngjarjeve.[1781] Gjithashtu Dhoma thekson se duket se L06 e ka parë Fatmir Limajn disa herë në televizor gjatë viteve që kaluan prej 1998 dhe deri në gjyq.[1782]

539. L06 dëshmoi se njeriu të cilin ai më vonë e identifikoi si Fatmir Limaj, foli me atë dhe L10-ën të dyja herët në Llapushnik.[1783] Dëshmi në gjyq dha edhe L10, në lidhje me të cilën Dhoma ka arritur në përfundimin se është mbajtur në fllanik bashkë me L06-ën.[1784] Ai dëshmoi pak a shumë se "komandant Çeliku" erdhi dy herë në fllanik, dhe herën e dytë i tha L10-ës se do të lirohej.[1785] Kjo dëshmi e takimeve konfirmon një aspekt të dëshmisë së L06-ës. Mirëpo përshkrimi i "komandant Çelikut" prej L10-ës ndryshon; njeriu të cilin ai pretendon se ka parë ishte tejet i gjatë,

[1773] *Shih më sipër,* paragrafët 270; 279.
[1774] L06, T 1014; 1016.
[1775] L06, T 1014.
[1776] L06 dëshmoi se ai ishte lindur në 1951, T 970. Shtatëlartësia e tij, përkatësisht 175.5 cm, u dokumentua si fakt i pranuar, T 5187-5188.
[1777] L06, T 1016-1017.
[1778] L06, T 1014-1015; 1021-1022.
[1779] L06, T 1021-1022; 1058.
[1780] L06, T 1058.
[1781] L06, T 1054; 1058; 1102-1106.
[1782] L06, T 1014-1015; 1021-1022.
[1783] L06, T 1073-1074.
[1784] *Shih më sipër,* paragrafët 270; 279.
[1785] L10, T 2952-2953.

afërsisht 2 metra, mbante uniformë kamuflimi dhe "pak mjekër, jo shumë të gjatë".[1786] Gjithashtu L10 dëshmoi se ai e kishte dëgjuar emrin Çeliku dy herë në Llapushnik. Mirëpo në dëshminë e tij nuk del e qartë lidhja e atij emri me njeriun të cilin takoi dy herë. Mundet që L10 e bëri këtë lidhje për shkak se mori një pusullë e cila konfirmonte lirimin e tij, e cila atij i kujtohet se ishte nënshkruar prej "komandant Çelikut",[1787] mirëpo ky nuk është përfundim faktik që mund të bëhet prej Dhomës sepse pusulla nuk ekziston si provë. Gjithashtu ekzistenca e ndonjë pusulle të tillë nuk u përmend prej L10-ës në deklaratën e tij të mëparshme për këto ngjarje dhënë hetuesve të CCIU-së në gusht 2001 dhe ndoshta ajo që ka më rëndësi është se në atë kohë L10 nuk përmendi asgjë në lidhje me "komandant Çelikun".[1788] Sipas dëshmisë së L10-ës, vetëm pas ngjarjeve, megjithëse është e paqartë koha e saktë, ai e mësoi emrin e vërtetë të komandant Çelikut, kur ai pa Fatmir Limajn në televizor dhe mendoi se e njohu si njeriun të cilin e kishte parë në Llapushnik.[1789] Edhe L10 e ka parë Fatmir Limajn disa herë në televizor në vitet e mëpasme që prej 1998 e deri në gjyq.[1790]

540. Të dy, L06 dhe L10 e identifikuan të Akuzuarin Fatmir Limaj në gjyq si njeriu të cilin e kishin përshkruar në Llapushnik.[1791] Diku tjetër në këtë vendim, Dhoma ka përmendur mundësinë e identifikimit të gabur të një personi të akuzuar në mjedisin e sallës së gjyqit.[1792] Veç kësaj, në lidhje me L06-ën dhe L10-ën, Dhoma mendon se prej dëshmive të tyre duket se identifikimi i Fatmir Limajt prej secilit dëshmitar në sallën e gjyqit ndoshta fare mirë mund jetë ndikuar pa vetëdije prej lidhjes së mëvonshme që çdo dëshmitar bëri midis Fatmir Limajt në televizion dhe njeriut të cilin kishin parë në Llapushnik. Për Dhomën mbetet problem besueshmëria e mënyrës sesi L06 dhe L10 e njohën më vonë Fatmir Limajn në televizor si njeriu në Llapushnik. Çdo takim në Llapushnik zgjati vetëm pak minuta. Ato ndodhën kur L06 dhe L10 ishin të ulur në fllanik dhe njeriu që thuhet se ishte Fatmir Limaj, ishte jashtë dhe fliste "nga dera dhe dritarja".[1793] Në këto rrethana mundësia për vëzhgim të saktë është e kufizuar. Përshkrimet e dhëna nga dy dëshmitarët nuk përputhen; L10 mban mend një njeri me mjekër dhe gjatësi spikatëse, afërsisht 2 metra, kurse L06 e përshkroi të njëjtin person pa mjekër, dhe thjesht pohoi se ishte më i gjatë se ai.[1794] Megjithatë pavarësisht kujtimeve të ndryshme, të dy dëshmitarët gjykuan se ata kishin identifikuar të njëjtin njeri në

[1786] L10, T 2952-2955.
[1787] L10, T 2955-2957; 2963.
[1788] L10, T 2974-2980; 3002.
[1789] L10, T 2955-2957; 3000-3004.
[1790] L10, T 2955-2957; 3001-3002.
[1791] L06 e identifikoi Fatmir Limajn nga ngjyra e kollares dhe nga pozicioni i tij në sallën e gjyqit në lidhje me të akuzuarit e tjerë, T 1023-1024, L10, T 2955-2957.
[1792] *Shih më sipër,* paragrafin 18.
[1793] L10, T 2996-2997.
[1794] Palët pranuan se shtatëlartësia e L06-ës është 175.5 cm, T 5187-5188.

televizion ca kohë më vonë. Pastaj ata e identifikuan atë në gjyq. Prokuroria nuk i ka shtjelluar rrethanat e njohjes së Fatmir Limajt në televizion prej dy dëshmitarëve si njeriu të cilin kishin parë në Llapushnik. Dhoma nuk ka dëshmi në lidhje me llojin e programeve televizive që çuan në këtë identifikim. Natyrisht mundet që L06 dhe L10 të jenë të saktë në identifikimet e tyre përkatëse të Fatmir Limajt në televizion si njeriu të cilin ata e panë së bashku në Llapushnik, pavarësisht kujtesës së tyre të ndryshme për pamjen e tij të jashtme. Mirëpo në rrethanat e sipërpërmendura Dhoma nuk mund t'a nxjerrë e bindur këtë përfundim.

541. Dhoma arriti në përfundimin se L04 u mbajt në ahur në kamp-burgun e Llapushnikut afërsisht prej fundit të qershorit deri më 25 ose 26 korrik 1998.[1795] Ai fillimisht dëshmoi se një ushtar i quajtur Tamuli erdhi dhe e nxorri nga ahuri. Ai i tha se atje ishte "komandant Çeliku" dhe e çoi në shtëpi.[1796] "Komandant Çeliku" e pyeti L04-ën kush e kishte sjellë atë atje dhe pse, dhe L04 iu përgjigj se nuk e dinte.[1797] Pastaj "komandant Çeliku" i tha Tamulit ta kthente L04-ën në ahur.[1798] Përsëri sipas dëshmisë së L04-ës, del se po atë ditë më vonë "komandant Çeliku" erdhi në ahur dhe i pyeti të burgosurit për emrat. Kur erdhi radha e L04-ës, "komandant Çeliku" i tha se ai mund të shkonte në shtëpi.[1799] Gjithsesi, L04 mbeti në kamp-burgun e Llapushnikut edhe dy javë të tjera.[1800]

542. Mbrojtja e Fatmir Limajt thekson se kjo dëshmi paraqet disa mospërputhje me deklaratat e mëparshme të L04-ës. Mospërputhja e parë ka të bëjë me vetë takimin me "komandant Çelikun". Duket se kur L04 u intervistua prej një hetuesi të CCIU-së, Anargyros Kereakes, në janar 2002, ai nuk përmendi se ishte marrë për të takuar një komandant, apo më konkretisht, "Komandant Çelikun".[1801] L04 nuk e shpjegon në mënyrë tjetër këtë harresë veçse me faktin se mund të mos e kenë kuptuar përkthyesit.[1802] Mospërputhja e dytë ka të bëjë me personin i cili e çoi te "komandant Çeliku". Në gjyq L04 dëshmoi se ai person ishte Tamuli[1803] ndërsa në një deklaratë të dytë që dha në mars 2002, L04 deklaroi se personi i cili e çoi të takonte "komandant Çelikun", ishte Murrizi.[1804] Kur u ballafaqua me këtë mospërputhje të dukshme, L04 dëshmoi se ai kishte gabuar për shkak se

[1795] *Shih më sipër,* paragrafët 270; 279.
[1796] L04, T 1182.
[1797] L04, T 1183.
[1798] L04, T 1183.
[1799] L04, T 1183-1184.
[1800] L04, T 1183-1184.
[1801] L04, T 1209-1210.
[1802] L04, T 1210.
[1803] L04, T 1182.
[1804] L04, T 1212.

"vuante nga tronditjet prej luftës".[1805] Në të njëjtën deklaratë L04 tha se Shala ishte personi i cili erdhi fillimisht në ahur dhe i tha për ardhjen e "komandant Çelikut".[1806] Kur u pyet nga Mbrojtja, L04 e korrigjoi dëshminë e tij në gjyq se këtë e kishte dëgjuar nga Tamuli, dhe më pas dëshmoi se kishte qenë Shala.[1807] Mospërputhja e tretë ka të bëjë me kohën midis bisedës së L04-ës me "komandant Çelikun" dhe vizitës së mëvonshme të komandantit në ahur, gjatë së cilës u urdhërua lirimi i L04-ës. Në deklaratën e tij të mëparshme në mars 2002, L04 deklaroi se "komandant Çeliku" u kthye në ahur dy ditë pas takimit të parë.[1808] Mirëpo në gjyq, L04 tregoi se kjo ndodhi po atë ditë të takimit.[1809] Mospërputhja e katërt lidhet me karakterin e bisedës midis L04-ës dhe "komandant Çelikut" gjatë takimit. L04 dëshmoi se ai u pyet nga komandanti për asyen që ishte sjellë në kamp-burgun e Llapushnikut. Në gjyq, L04 deklaroi se përgjigjja e tij ishte se nuk e dinte dhe takimi u kufizua vetëm në këtë dialog mjaft të shkurtër.[1810] Mirëpo në deklaratën e tij të dytë në mars 2002, L04 dëshmoi ndryshe, pikërisht se ai i kishte shpjeguar me hollësi "komandant Çelikut" arsyen për të cilën ai mendonte se ishte arrestuar. Shpjegimi bënte fjalë për një incident që kishte ndodhur një vit më parë dhe gjatë të cilit L04-ës dhe një individi tjetër iu konfiskuan traktorët nga dy policë serbë ndërkohë që ata po mblidhnin dru pa leje dhe komunikimi i mëvonshëm i L04-ës me një nga policët për rimarrjen e traktorëve.[1811] Në deklaratën e tij L04 tregoi se ai mendonte se ky incident kishte qenë arsyeja për mbajtjen e tij në kamp-burgun e Llapushnikut.[1812]

543. Ekzistenca e mospërputhjeve midis dëshmisë gojore të një dëshmitari dhe deklaratave të dhëna më parë është në vetë natyrën e procedurave penale. Në kohë të ndyshme një dëshmitari mund t'i jenë parashtruar pyetje të ndryshme; ai mund të ketë harruar apo kujtuar hollësi të caktuara. Megjithëse besueshmëria e një dëshmitari nuk cënohet vetvetiu prej pranisë së mospërputhjeve në deklarata të ndryshme, gjithsesi ato kërkojnë një shqyrtim të vëmendshëm kur përcaktohet rëndësia që duhet t'i jepët dëshmisë së një dëshmitari. Karakteri i çështjes që lidhet me mospërputhjen mund të ketë rëndësi për vlerësimin e ndikimit të saj mbi besueshmërinë e dëshmitarit. Për shembull hollësi thjesht rastësore që ndodhën dhe kanë rëndësi relativisht të pakët, mund të mos mbahen mend, apo të mos mbahen mend me saktësi disa vite pas ngjarjeve. Gjatë tërë dëshmisë së tij L04 theksoi sesa i paharrueshëm kishte qenë takimi i tij me komandant Çelikun

[1805] L04, T 1212.
[1806] L04, T 1213.
[1807] L04, T 1213.
[1808] L04, T 1217-1218.
[1809] L04, T 1183-1184; 1217-1218.
[1810] L04, T 1183.
[1811] L04, T 1216.
[1812] L04, T 1216.

sepse u urdhërua lirimi i tij.[1813] Megjithatë duket se ai nuk e përmendi fare këtë takim kur u intervistua fillimisht për këto ngjarje prej një hetuesi të CCIU-së në janar 2002. L04 e ka bërë të qartë në dëshminë e tij në dispozicion të Dhomës se para intervistës së janarit 2002, ai e kishte parë Fatmir Limajn shumë herë në televizor dhe prej kësaj kishte arritur në përfundimin se Fatmir Limaj ishte komandant Çeliku.[1814] Rrjedhimisht, mospërmendja prej tij e takimit në intervistën e janarit 2002, aq më tepër në qoftë se në atë kohë ai dinte se Fatmir Limaj ishte figurë e mirënjohur politike në Kosovë, mbetet e pashpjeguar. Sigurisht që pyetjet e bëra në atë intervistë mund t'ia kenë larguar vëmendjen prej takimit me komandant Çelikun, por ky nuk është shpjegim i qartë, duke marrë parasysh rëndësinë që L04 i jep takimit. Gjithashtu edhe kur u pyet prej Mbrojtjes, L04 nuk u duk se mbante mend të kishte dhënë ndonjë shpjegim për arsyen e arrestimit të tij, qoftë gjatë kohës së takimit me "komandant Çelikun" apo kur u intervisuta prej një hetuesi në mars 2002.

544. L04 gjithashtu dëshmoi se personi për të cilin ai thotë se ishte komandant Çeliku në kamp, kishte një mjekër mesatare.[1815] Kur u intervistua prej hetuesve të CCIU-së në 2002, L04 e identifikoi Fatmir Limajn në fotografi si njeriun për të cilin mendoi se ishte "komandant Çeliku".[1816] Mirëpo kjo fotografi nuk është në prova kështu që Dhoma nuk mund të vlerësojë as cilësinë e kësaj fotografie dhe, as nëse përputhet me përshkrimin gojor të L04-ës për "komandant Çelikun". L04 nuk mbante mend, nëse kishte apo nuk kishte mjekër personi të cilin e identifikoi në fotografi gjatë intervistës së vitit 2002.[1817] Ka të ngjarë që Fatmir Limaj të ketë qenë fytyrë e njohur për L04-ën në kohën e intervistës së vitit 2002 dhe kështu është edhe tani, duke marrë parasysh daljet e tija të shumta dhe mjaft të shpeshta në televizion dhe në shtyp pas luftës para vitit 2002.[1818] Vetë L04 deklaroi se fytyra dhe emri i Fatmir Limajt ishin mjaft të njohura pas luftës.[1819] Në këto rrethana Dhoma është e shqetësuar se kjo mund të ketë patur një farë ndikimi në identifikimin e mëvonshëm të Fatmir Limajt prej L04-ës gjatë intervistës me hetuesit. Dhoma nuk është e qartë për asnjë prej mundësive. Për më tepër nuk ka prova që t'i mundësojnë Dhomës të përcaktojë nëse programet televizive ku u pa Fatmir Limaj, sugjeruan ndonjë lidhje me rastin në fjalë, faktor me rëndësi të madhe mbi çështjen nëse L04 mund të jetë ndikuar pa vetëdije të lidhë Fatmir Limajn me njeriun të cilin e kishte identifikuar si komandantin në Llapushnik. Në veçanti Dhoma nuk di nëse Fatmir Limaj u identifikua me emrin Çeliku në një apo më shumë programe të medias dhe nëse ai u pa me ose pa mjekër dhe në rast se po, çfarë mjekre. Në këto rrethana, edhe sikur L04 të ketë

[1813] L04, T 1209; 1210; 1212.
[1814] L04, T 1218-1219.
[1815] L04, T 1220-1222.
[1816] L04, T 1184-1185.
[1817] L04, T 1219-1220; 1220-1222.
[1818] Provat Materiale DL17; DL18 dhe DL19.

identifikuar ndershmërisht dhe ndoshta edhe saktësisht Fatmir Limajn, kur e pa në televizion si njeriu të cilin e kishte parë në Llapushnik, Dhoma nuk mund të jetë e sigurtë për këtë prej dëshmisë së dhënë në gjyq.

545. L07 dha dëshmi në lidhje me praninë e pretenduar të Fatmir Limajt në kamp-burgun e Llapushnikut. Ai deklaroi se pas ardhjes së tij në kamp, ai u çua në një dhomë ku pa Shukri Bujën, të cilin e njihte personalisht, dhe "komandant Çelikun".[1820] Ushtarët i thanë L07-ës se ata po e çonin te "komandant Çeliku" dhe se në atë kohë ai tashmë dinte për "komandant Çelikun", sepse ai dilte në shtyp.[1821] Sipas dëshmisë së L07-ës, Shukri Buja e njohu L07-ën dhe i kërkoi komandant Çelikut ta linte të shkonte,[1822] dhe më pas Shukri Buja dhe komandant Çeliku dolën të dy prej dhomës. Komandant Çeliku u kthye pas pesë minutash dhe urdhëroi Shalën, njërin prej ushtarëve të pranishëm, që ta linte L07-ën të shkonte në shtëpi.[1823] Ky takim zgjati afërsisht 15 minuta.[1824] Një apo dy ditë pas takimit komandant Çeliku erdhi në fllanik me një komandant tjetër dhe u habit kur e pa L07-ën atje.[1825] L07 u çua përsëri në dhomën brenda shtëpisë.[1826] Të nesërmen, komandant Çeliku erdhi në shtëpi dhe i tha L07-ës se ishte i lirë të shkonte. Komandant Çeliku i diktoi L07-ës një deklaratë dhe e detyroi atë ta nënshkruante se ai nuk do të tregonte çfarë kishte parë në kamp, ndryshe do të vritej[1827] dhe të nesërmen në mëngjes L07 u lirua me veturën e tij.[1828]

546. Shukri Buja dëshmoi ndryshe për këto ngjarje para Dhomës. Ai dëshmoi se kur dëgjoi prej babait të L07-ës, se L07 ishte arrestuar prej Ymer Alushanit me pseudonimin Vogëlushi, ai shkoi në Llapushnik të pyeste. Shukri Buja dëshmoi se ai shkoi në shtëpinë e Vogëlushit dhe pyeti nëse ndodhej L07 atje. Vogëlushi e pohoi këtë gjë dhe tha se L07 ishte arrestuar për shkak se në xhepin e tij ishin gjetur adresa serbësh, të cilat ishin menduar si të inspektorëve serbë. Shukri Buja deklaroi se ai i dha garanci Vogëlushit se familja e L07-ës nuk kishte asnjë lidhje me policinë dhe L07 u thirr jashtë dhe u lirua menjëherë, megjithëse L07 këmbënguli që t'a linte veturën e tij në përdorim të UÇK-së. Sipas dëshmisë së Shukri Bujës, Fatmir Limaj nuk ishte i pranishëm në atë rast dhe ngjarja ndodhi në një shtëpi njëkatëshe, që sugjeron shtëpi të ndryshme nga ajo në kamp-burgun e

---

[1819] L04, T 1218-1219.
[1820] L07, T 792; Prova Materiale P71, paragrafi13.
[1821] L07, T 794.
[1822] L07, T 795; Prova Materiale P71, paragrafi14.
[1823] L07, T 795-796; Prova Materiale P71, paragrafi15.
[1824] L07, T 796.
[1825] L07, T 834-836; Prova Materiale P71, paragrafi 25.
[1826] L07, T 834-838.
[1827] L07, T 840.
[1828] L07, T 840-841.

Llapushnikut.[1829] Ka dëshmi se Vogëlushi ishte komandant në fshatin Llapushnik.[1830] Në dëshminë e tij Fatmir Limaj mohoi se kishte marrë pjesë apo kishte urdhëruar lirimin e L07-ës. Nëpërmjet shpjegimit të arrestimit të L07-ës, Fatmir Limaj tha se duhet të kishte qenë një prej ndalimeve të shkurtra të cilat ndodhnin shpesh në atë kohë.[1831]

547. Kundërshtitë midis këtyre dëshmive janë të dukshme, edhe pse Dhoma e ka të vështirë të vlerësojë rëndësinë e tyre. Kur arriti në përfundimin e mëparshëm se L07 faktikisht u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut, Dhoma shqyrtoi dëshminë kundërthënëse të Shukri Bujës, ku sugjerohej mbajtja në një shtëpi të ndryshme në Llapushnik prej komandant Vogëlushit, por nuk e pranoi atë duke marrë parasysh tërësinë e dëshmive të tjera.[1832] Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundim nëse dëshmia e Shukri Bujës është e gabuar, e rreme apo e ngatërruar.[1833] Ekziston edhe mundësia që dëshmia e Shukri Bujës në lidhje me këtë pikë të jetë ndikuar nga besnikëria e tij e dukshme ndaj UÇK-së në përgjithësi dhe Fatmir Limajt në veçanti. Në këto rrethana, për Dhomën mbetet pyetja nëse njeriu i cili ishte me Shukri Bujën, në kohën e urdhërimit të lirimit të L07-ës, ishte në fakt personi të cilin ai e përmendi si "komandant Çeliku", me gjithë dëshminë kundërthënëse të Shukri Bujës.

548. Sipas dëshmisë së L07-ës, ai u lirua në prani të të burgosurve të tjerë, midis të cilëve ishin dy "kroatë".[1834] Bazuar në dëshmitë e tjera Dhoma nuk ka asnjë dyshim se dy "kroatët" ishin Vojko dhe Ivan Bakraçi. Megjithëse me kombësi serbe, ata kishin qenë banorë të Kroacisë, dhe përshkrimi i dhënë nga L07, gjegjësisht i një babai me të birin,[1835] si edhe i dhomës në shtëpi në cilën L07 tha se mbaheshin ata, e konfirmojnë këtë.[1836] Dhoma thekson se as Vojko dhe, as Ivan Bakraçi nuk e përmendën këtë ngjarje në dëshmitë e tyre.

549. Në kohën e takimit të tij të pretenduar në kamp-burgun e Llapushnikut L07 nuk e kishte takuar asnjëherë komandant Çelikun. Prej dëshmisë nuk del se njeriu të cilin takoi, u paraqit si komandant Çeliku gjatë takimit. L07 mban mend se atij iu tha se po e çonin te komandant Çeliku

[1829] Shukri Buja, T 4025-4032; Shukri Buja nuk e identifikoi shtëpinë në kamp-burgun e Llapushnikut si shtëpia ku ai takoi atë ditë Vogëlushin; T 4144-4145; Prova Materiale P6.
[1830] *Shih më poshtë* paragrafin 712
[1831] Fatmir Limaj, T 6336-6337.
[1832] *Shih më sipër* paragrafët 277-279
[1833] Shtëpia e përshkruar nga Shukri Buja sipas dëshmisë së tij përdorej nga ushtarët. Ka dëshmi se e njëjta gjë vlen edhe për shtëpinë në kamp-burgun e Llapushnikut, *shih më poshtë* paragrafin 694.
[1834] L07, T 839.
[1835] L07, T 812-816
[1836] Vojko Bakraç, T 1338.

dhe, se ai e njohu komandant Çelikun menjëherë, sepse e kishte parë në shtypin e asaj kohe.[1837] Në lidhje me këtë Dhoma thekson se ajo disponon dëshmi që Fatmir Limaj ishte njëri prej dy ushtarëve të cilët qëndronin pranë Jakup Krasniqit kur ai dha deklaratën e parë publike si zëdhënës i UÇK-së, në qershor 1998, në Kleçkë.[1838] Gjithashtu Fatmir Limaj u pa në kolonën e ushtarëve gjatë një procesioni funeral më 16 qershor 1998, i cili u transmetua.[1839] Gjithsesi në këto video Fatmir Limaj nuk është objekti i vetëm ose kryesor i vëmendjes së shikuesit. Së fundi, duket se më 3 qershor 1998, Fatmir Limaj i dha një intervistë një gazetari të televizionit të Tiranës, por prej dëshmisë duket se kjo intervistë pati vetëm transmetim zanor.[1840] Pra, edhe një herë prej medias, L07 nxorri përfundimin se komandant Çeliku ishte Fatmir Limaj.[1841]

550. Gjithashtu L07 e identifikoi Fatmir Limajn në gjyq si njeriun të cilin e pa në Llapushnik.[1842] Dhoma ka përmendur gjetiu nevojën për kujdes të madh në vlerësimin e identifikimit të të akuzuarit në një sallë gjyqi për shkak të mundësisë së gabimit prej mjedisit sugjestionues.[1843] Për më tepër në këtë rast ekziston edhe mundësia tjetër që L07 pa vetëdije mund të ketë pretenduar se ka njohur të akuzuarin Fatmir Limaj për shkak të daljeve të tij të shumta publike në televizion dhe gazeta, veçanërisht pas ngjarjeve në Llapushnik. Pasi i ka shqyrtuar me kujtes të gjithë këta faktorë, Dhoma mendon se, megjithëse L07 ishte i ndershëm në dëshminë e tij me gjithë vështirësitë e hasura dhe ndonëse identifikimi i tij mund të jetë i saktë, Dhoma nuk mund të bindet se është i besueshëm identifikimi i Fatmir Limajt prej tij si personi të cilin ai e njohu në kamp-burgun e Llapushnikut si komandant Çeliku.

551. Dëshmitari i fundit dëshmia e të cilit mund ta lidhte të Akuzuarin Fatmir Limaj me funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut, është L96. Dhoma tashmë ka arritur në përfundimin se L96 u mbajt në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut afërsisht një javë, në korrik 1998.[1844] L96 dëshmoi se ai nuk e pa asnjëherë komandant Çelikun në kamp-burgun e Llapushnikut.[1845] Mirëpo ai dëshmoi se në ditën e tij të fundit të burgimit, kur të burgosurit ecën të shoqëruar drejt maleve të afërta të Berishës, të burgosurit dhe shoqëruesit arritën në një shteg në pyll ku ai pa një traktor me njerëz të armatosur.[1846] Sipas dëshmisë së L96-ës, në atë moment Shala ndodhej pranë L96-ës dhe

[1837] L07, T 794.
[1838] Fatmir Limaj, T 5956.
[1839] Prova Materiale P35; Fatmir Limaj, T 6299-6301.
[1840] Prova Materiale P35; Fatmir Limaj, T 6268.
[1841] L07, T 805-807; 860.
[1842] L07, T 806-807
[1843] *Shih më sipër* paragrafin 18.
[1844] *Shih më sipër* paragrafin 279.
[1845] L96, T 2386.
[1846] L96, T 2364; Prova Materiale P106.

L96 e dëgjoi kur tha se po vinte "komandant Çeliku" dhe se Shala do t'a pyeste çfarë të bënte me të burgosurit.[1847] Pastaj Shala i urdhëroi të burgosurit të ndalonin dhe shkoi të fliste me një nga njerëzit në traktor i cili ishte me uniformë. L96 tha se prej kësaj ai kuptoi se ky njeri ishte "komandanti" të cilin përmendi Shala. Ky person ishte i ri dhe kishte një mjekër të parruar prej dy-tri javësh.[1848] L96 nuk ishte në gjendje ta dëgjonte bisedën midis Shalës dhe "komandantit".[1849] Pas bisedës Shala u kthye me njërin prej personave të cilët shoqëronin komandantin, domethënë roja e tretë për të burgosurit. Shala i urdhëroi të burgosurit të vazhdonin ecjen.[1850]

552. Vetëm shumë më vonë, në fund të vitit 2000, ose në fillim të vitit 2001, L96 thotë se ai e pa Fatmir Limajn në televizion për herë të parë. Sipas dëshmisë së L96-ës, në atë kohë ai njohu "njeriun që e kishte parë gjatë rrugës nga Llapushniku në Berishë" për të cilin Shala kishte thënë në atë kohë se ishte komandant Çeliku.[1851] L96 tha se më vonë ai e pa Fatmir Limajn shumë herë në media.[1852] Kur u intervistua prej hetuesve të CCIU-së në shkurt 2002, L96 identifikoi një fotografi të Fatmir Limajt në një fletë fotografish që iu treguan, si komandanti të cilin e kishte parë në shtegun në malet e Berishës.[1853]

553. Për një sërë arsyesh, Dhoma ka rezerva të forta për dëshminë e L96-ës lidhur me takimin në shtegun në malet e Berishës me njeriun të cilin L96 kuptoi se ishte komandant Çeliku. Në deklaratat që L96 dha në gusht 1998 dhe gusht 2000 nuk përmendet as takimi dhe, as emri i Çelikut.[1854] I vetmi shpjegim që L96 dha në dëshminë e tij për këto mospërmendje ishte se në kohën kur ai dha deklaratat, ai u përqëndrua në individët përgjegjës për vrasjet në malet e Berishës dhe "harroi" për komandant Çelikun.[1855] Në rast se ka qenë kështu, ai e bëri këtë pavarësisht dëshmisë së tij se, bazuar në çfarë pa dhe dëgjoi në atë kohë, ai mendonte se ky ishte njeriu i identifikuar prej Shalës si komandant Çeliku, të cilin Shala e kishte pyetur gjatë takimit për fatin e të burgosurve. Ndër të burgosurit ishte dhe L96 dhe një i afërm i tij. Gjithashtu Dhoma thekson se duket se L96 nuk e dëgjoi për herë të parë emrin e komandant Çelikut gjatë atij takimi në malet e Berishës. L96 dëshmoi se para burgimit të tij i kishin thënë se komandant Çeliku mund të lironte të afërmin e tij.[1856]

[1847] L96, T 2364.
[1848] L96, T 2364-2365.
[1849] L96, T 2365; 2373.
[1850] L96, T 2365
[1851] L96, T 2399-2400.
[1852] L96, T 2456-2460.
[1853] L96, T 2366-2367; 2370-2371; Prova Materiale P104.
[1854] L96, T 2416-2418; 2437-2442.
[1855] L96, T 2418; 2440.
[1856] L96, T 2269-2271; 2455.

554. Atë ditë, më 25 ose 26 korrik 1998, në grupin e shoqëruar nga Shala dhe Murrizi për në malet e Berishës ishin më shumë se 20 të burgosur.[1857] Disa prej këtyre të burgosurve dëshmuan para Dhomës. Askush prej tyre nuk dëshmoi se Shala ndaloi për të takuar një njeri dhe ca më pak se ai takoi komandant Çelikun.[1858] Në fak,t L06 përmendi një automjet që kaloi pranë kolonës së të burgosurve. Mirëpo ai dëshmoi se automjeti vozitej prej një civili i cili e pyeti Shalën nëse duhej të transportonte një të burgosur të plagosur, gjë të cilën Shala e refuzoi.[1859] L10 dëshmoi se në një moment gjatë ecjes, pranë kolonës së të burgosurve kaloi një traktor me ushtarë por në dëshminë e tij ai nuk sugjeroi se traktori ndaloi ose se Shala e ndërpreu ecjen, ose foli me njërin prej tyre.[1860] Gjithësesi ai përmendi praninë e një rojeje të tretë më vonë gjatë asaj dite, siç është përmendur gjetiu.[1861] Me gjithë numrin e dëshmitarëve të mundshëm që mund të konfirmonin dëshminë e L96-ës për bisedën midis Shalës dhe personit për të cilin ai tha se ishte komandant Çeliku, nuk ka asnjë dëshmi tjetër mbështetëse për historinë e tij. Gjithashtu në lidhje me këtë, për arsyet e shpjeguara më herët në këtë vendim,[1862] është me rëndësi përfundimi i Dhomës se nuk mund të përcaktohej nëse ishte e saktë dëshmia e L96-ës për praninë në vendin e ekzekutimit në malet e Berishës të një ushtari të tretë të UÇK-së i cili ishte dërguar prej njeriut për të cilin L96 tha se ishte Çeliku gjatë atij takimi të Shalës me Çelikun.

555. Hera e parë kur L96 përmendi takimin që kishte të bënte me komandant Çelikun në malet e Berishës ishte në një intervistë që ai dha në gusht 2001.[1863] Duket se kjo intervistë është bërë pasi L96 kishte parë Fatmir Limajn në televizion, siç thotë ai. Megjithëse kjo nuk e cënon domosdoshmërisht besueshmërinë e identifikimit të pretenduar prej L96-ës të një fotografie të Fatmir Limajt në një intervistë të mëvonshme, gjithsesi del pyetja nëse L96 mund të ketë gabuar në identifikim për shkak se kishte parë Fatmir Limajn në televizion. Kjo mund të ketë ndodhur krejt pa vetëdije nga ana e L96-ës. Identifikimi në gjyq i Fatmir Limajt prej L96-ës si njeriu të cilin ai e pa gjatë udhëtimit në Berishë[1864] mund të jetë ndikuar prej të njëjtit faktor si edhe prej rrezikut të mirënjohur të identifikimit të gabuar të të akuzuarit në mjediset e sallës së gjyqit, faktor të cilin Dhoma e ka përmendur gjetiu.

[1857] *Shih më sipër* paragrafin 450.
[1858] L04, T 1192-1195; L10, T 2960-2966; L12 dëshmoi se ai nuk pa askënd gjatë ecjes, T 1818; L06, 1025-1026.
[1859] L06, 1025-1026.
[1860] L10, T 2962.
[1861] *Shih më sipër* paragrafin 453.
[1862] *Shih më sipër* paragrafin 453.
[1863] L96, T 2416-2418.
[1864] L96, T 2574.

556. Në këtë kontekst është gjithashtu me rëndësi shpjegimi i L96-ës sesi mësoi që Çeliku ishte Fatmir Limaj. L96 deklaroi se dikur në tetor 1998, ai foli në telefon me personin tjetër për të cilin L96 tha se mbeti gjallë prej ekzekutimit në malet e Berishës, Xheladin Ademaj.[1865] L96 dëshmoi se ata të dy si dhe axha i L96-ës u takuan në gusht të vitit 2000 dhe gjatë bisedës personi tjetër i tregoi L96-ës se komandant Çeliku ishte Fatmir Limaj, dhe se ai dilte shpesh në televizion ose në shtyp.[1866] Ndërkohë që gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, L96-ës iu tha se personi tjetër kishte nënshkruar një deklaratë se nuk kishte ndodhur asnjë takim i tillë, njeriu tjetër nuk ka dhënë dëshmi dhe se nuk ka asnjë deklaratë të tij si provë. Rrjedhimisht në lidhje me këtë pike, dëshmia e L96-ës as nuk mund të konfirmohet dhe, as të refuzohet. Në rast se dëshmia e L96-ës për këtë takim është e saktë, kjo do të ishte një arsye më shumë për kujdes mbi besueshmërinë e identifikimit të një fotografie të Fatmir Limajt prej L96-ës në 2002, sepse, për arsye të asaj që ndodhi në takim, L96 mund të jetë ndikuar të identifikojë në televizion njeriun të cilin e pa në malet e Berishës. Pasi ka shqyrtuar të gjithë këta faktorë si edhe çështjet e rëndesishme që ndikojnë mbi besueshmërinë e përgjithshme të L96-ës, të cilat përmenden gjetiu në këtë vendim, Dhoma nuk mund të bindet se identifikimi i një fotografie të Fatmir Limajt në 2002, ose se identifikimi i Fatmir Limajt në gjyq prej L96-ës janë të besueshëm.

557. Siç është përmendur gjetiu në këtë Aktgjykim, në dëshminë e tij Fatmir Limaj mohon dijeninë e tij për një kamp-burg të UÇK-së në Llapushnik.[1867] Gjithashtu Fatmir Limaj dëshmoi se më 25 korrik 1998, ai kishte patur një keqësim të papritur të shëndetit, gjatë të cilit humbi vetëdijen. Kjo ndodhi në Llapushnik dhe ai u përmend më vonë dhe e pa veten në Kleçkë ku e kishin çuar të tjerët.[1868] Rrjedhimisht ai mohon se ka qenë në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998, në traktor ose zbritur prej tij.[1869] Thelbi i dëshmisë së Fatmir Limajt është se rreth mesditës së 26 korrikut 1998, në Kleçkë erdhi një ushtar dhe i tha se Llapushniku kishte rënë. Sipas Fatmir Limajt, shqetësimi i tij parësor kishte qenë se forcat serbe do të niseshin drejt Malishevës ku ishin strehuar mijëra njerëz, kështu që ai shkoi me makinë me nipin e tij, Naser Sabitin, për të paralajmëruar popullatën civile që të iknin në luginën e Kleçkës.[1870] Në dëshminë e tij Ferat Sopi konfirmoi se më 25 korrik 1998, Fatmir Limaj erdhi në klinikën e improvizuar në Llapushnik shumë i sëmurë dhe humbi vetëdijen. Sipas dëshmisë së Ferat Sopit, Fatmir Limajt iu desh të merrte serum.[1871] Shënimet mjekësore të klinikës së improvizuar të cilat janë në prova nuk përmbajnë ndonjë shënim

[1865] L96, T 2397.
[1866] L96, T 2398-2399.
[1867] Fatmir Limaj, T 6002; 6336.
[1868] Fatmir Limaj, T 5986-5987; 6084.
[1869] Fatmir Limaj, T 5986-5987.
[1870] Fatmir Limaj, T 5987-5989.

të datës 25 korrik 1998.[1872] Rrjedhimisht ato as e konfirmojnë dhe, as e kundërshtojnë dëshminë e sipërpërmendur.

558. L64, ish-anëtar i UÇK-së, dëshmoi se ai shkoi disa herë në kamp-burgun e Llapushnikut gjatë kohës që ka lidhje me këtë çështje.[1873] Sipas dëshmisë së tij, megjithëse ai e pa Fatmir Limajn, d.m.th. Çelikun, disa herë në fshatin Llapushnik,[1874] ai nuk e pa atë në asnjë rast në kamp-burg.[1875] Mirëpo L64 tregoi se një herë ai pa një xhip jashtë burgut dhe prej çfarë thoshin të tjerët, nxori përfundimin se ishte xhipi i Çelikut.[1876] Mbetet e panjohur se kush e sugjeroi këtë dhe mbi çfarë baze. Për këtë pikë nuk ka dëshmi të tjera. Dhoma përfundon se kjo dëshmi nuk provon se Çeliku ose i Akuzuari Fatmir Limaj ishte në atë rast apo në ndonjë rast tjetër në kamp-burgun e Llapushnikut.

559. Mbrojtja e Fatmir Limajt ka sugjeruar si në parashtrim po ashtu edhe gjatë dëshmive, se karakteri i Fatmir Limajt është krejtësisht i papajtueshëm me akuzat e ngritura në Aktakuzë. Thelbi i argumentit të Mbrojtjes është se shndërrimi i Fatmir Limajt nga një njeri i përgjegjshëm në një "përbindësh" vetëm për tre-katër muaj do të ishte i jashtzakonshëm.[1877] Dhoma mendon se ky nuk është një faktor shumë domethënës në qoftë se do të kishte dëshmi bindëse për të kundërtën, sidomos duke marrë parasysh angazhimin e hapur të Fatmir Limajt për arritjen e objektivave ushtarake dhe politike të UÇK-së.

560. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma nuk mund të pranojë asnjë prej identifikimeve individuale të Fatmir Limajt prej këtyre dëshmitarëve si identifikim të besueshëm mbi bazën e të cilëve Dhoma mund të gjykonte jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Fatmir Limaj ishte personi të cilin ata e panë ose e njohën si Çeliku në kamp-burgun e Llapushnikut, ose në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998.

561. Gjithashtu Dhoma ka shqyrtuar rezultatin përmbledhës të këtyre identifikimeve për të përcaktuar nëse ato, ose disa prej tyre të marra së bashku eliminojnë rrezikun e gabimit në

[1871] Ferat Sopi, T 7053-7054.
[1872] Provat Materiale P215; P216 dhe P217. Dhoma thekson se shënimi i vetëm i cili mund të jetë bërë më 25 korrik 1998 gjithashtu mban dhe datën 24 korrik 1998, Prova Materiale P217.
[1873] L64, T 4444.
[1874] L64, T 4356-4357; 4363; 4395-4396.
[1875] L64, T 4465-4466.
[1876] L64, T 4465-4466.
[1877] Argumentet Mbyllëse, T 7430-7431.

identifikime individuale, që kështu të provohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Fatmir Limaj ishte personi. Megjithëse pranohet se një shumësi identifikimesh prej personash të ndryshëm, në kohë dhe rrethana të ndryshme për një rast të caktuar mund të jetë e mjaftueshme për të eliminuar rrezikun e një gabimi të ndershëm që ekziston në lidhje me çdo identifikim të veçantë, kur shqyrtohet veças, kjo nuk është as e zakonshme dhe, as e thjeshtë. Për rastin në fjalë, sipas mendimit të peshuar të Dhomës vështirësitë lidhur me një numër identifikimesh dhe lloji i gabimit për çdo identifikim përkatës janë të një rëndësie të tillë saqë pavarësisht gjasës së madhe të dukshme në dëshmi, në fjalë të fundit Dhoma nuk mund të bindet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Fatmir Limaj është identifikuar si personi i përmendur në dëshmitë e tyre prej këtyre personave, ose ndonjë prej tyre.

562. Në të vërtetë, në vend që të përforcojë identifikimin e njeriut i cili pretendohet se është komandant Çeliku, rezultati i tërësisë së dëshmive nxjerr në dritë paqartësinë dhe mospërputhjet e përhapura në këtë tërësi dëshmish që kanë lidhje me çështjen. Shumica e takimeve fizike të dëshmitarëve me "komandantin" prej të cilëve është bërë identifikimi, ishin në numër të kufizuar dhe me kohëzgjatje të shkurtër. Është domethënës fakti se dy dëshmitarët të cilët me gjasa patën kontakte më të shumta me "komandantin", Vojko dhe Ivan Bakraçi, dhanë përshkrime fizike mospërputhëse të personit të cilin ata e panë në Llapushnik dhe nuk mund ta identifikonin pohimisht "komandantin" në fletët përkatëse të fotografive. Në qoftë se të gjitha përshkrimet fizike të dhëna prej dëshmitarëve merren bashkë, në vend të përvijimit të ngjashmërive spikatëse, ndryshimet lidhur me shtatlartësinë e "komandantit", veshjen dhe pasjen apo mospasjen e mjekrës janë mospërputhje penguese. Konkretisht, përshkrimet e fytyrës së "komandantit" shkojnë nga krejt i rruar, në mjekër të vogël, të mesme dhe mjekër të rritur prej tri javësh. Rrjedhimisht, në vend të pakësojë rrezikun e gabimit në identifikime individuale, krahasimi i tyre sjell më shumë paqartësi.

563. Dhoma do të përmendë në veçanti se ajo ka patur parasysh një faktor të rëndësishëm në këtë çështje kritike, që është shpeshtësia e daljes së Fatmir Limajt në televizion dhe të fotografive të tij në gazeta për shkak të rolit të tij aktiv politik në Kosovë që prej luftës. Dhoma vlerëson se shfaqja e vazhdueshme e figurës së Fatmir Limajt në media ka çuar në një rrezik mjaft të kuptueshëm se disa dëshmitarë të këtij gjyqi mund të jenë ndikuar pa vetëdije prej këtyre paraqitjeve të shpeshta në media, sa të lidhin pamjen në media me personin e mbajtur mend nga dëshmitarët në Llapushnik apo malet e Berishës, në mes të vitit 1998. Për shkak të këtij rreziku duhej patur shumë kujdes në procesin e identifikimit të mëvonshëm, kujdes i cili nuk ka qenë gjithmonë i dukshëm gjatë intervistave të institucioneve të ndryshme gjatë viteve. Gjithashtu Dhomës i është dashur të tregojë kujdes të veçantë në vlerësimin se, duke marrë parasysh atë rrezik dhe rreziqe të tjera të njohura për

gabim në identifikime të ndryshme të përmendura më parë, dhe duke marrë parasysh dëshmi të tjera që kanë lidhje, Dhoma duhet të bindet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se është treguar se Fatmir Limaj ka patur rol në ngjarjet në kamp-burgun e UÇK-së në Llapushnik, ose në ngjarjet lidhur me të burgosurit në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998. Për arsyet e treguara, Dhoma gjykon se në lidhje me këtë pikë kyçe dëshmitë nuk provojnë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm rolin e Fatmir Limajt për shkeljet për cilat ai akuzohet ose në lidhje me to.

564. Në mungesë të një identifikimi të provuar të pranisë së Fatmir Limajt në kamp-burgun e Llapushnikut, e vetmja dëshmi e përdorur prej Prokurorisë për ta lidhur Fatmir Limajn me funksionimin e kampit, është një dokument i gjetur në apartamentin e të Akuzuarit prej hetuesve të Prokurorisë gjatë një kontrolli më 19 shkurt 2003.[1878] Në pamje të parë ky dokument duket se është një tërësi shënimesh të panënshkruara prej një individi të identifikuar vetëm si Naim, dikur në nëntor 1998. Ai përmban informacione që duket se informojnë për lëvizje të shqiptarëve kosovarë të dyshuar si bashkëpunëtorë dhe civilëve serbë. Aty është edhe emri i njërit prej viktimave të përmendura në Aktakuzë: "Lutfi Xhemshiti është e mundshme gruaja e tij dhe katër fëmijë /si në origjinal/".[1879] Fatmir Limaj dëshmon se ai nuk ka kurrfarë dijenie për këtë dokument. Shpjegimi i Fatmir Limajt sesi u gjend ky dokument në shtëpinë e tij është se ai mund të ketë qenë midis një sërë dokumentesh të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila ndodhej përtej rrugës përballë apartamentit, zëdhënës i së cilës ishte Fatmir Limaj pas luftës, të cilat mbaheshin përkohësisht në apartamentin e tij.[1880] Pavarësisht vërtetësisë së kësaj dëshmie, Dhoma nuk është e bindur se ky dokument provon lidhje midis të Akuzuarit dhe fatit të viktimës në fjalë. Nuk është e mjaftueshme të provohet një lidhje e tillë thjesht duke u bazuar në përmendjen e emrit të viktimës, në një dokument të nënshkruar nga një i tretë, në një kontekst të panjohur dhe disa muaj pas vrasjes së pretenduar të viktimës.

565. Për sa më sipër, Dhoma gjykon se të gjitha akuzat mbi pjesëmarrjen personale të Fatmir Limajt në funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut bien.

[1878] Ole Lehtinen, T 518-522.
[1879] Provat Materiale P30, f 1.
[1880] Fatmir Limaj, T 6338-6339.

(b) A kishte Fatmir Limaj pozitë komanduese dhe kontrolluese mbi ushtarët e UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut?

566. Në Aktakuzë pretendohet se përgjegjësia penale e Fatmir Limajt rrjedh edhe prej pozitës së tij si epror në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit. Pretendohet se në këtë cilësi Fatmir Limaj ushtroi komandë dhe kontroll ligjor dhe faktik mbi anëtarët e UÇK-së të cilët vepronin në kamp-burgun e Llapushnikut, dhe se ai kishte autoritet për t'i disiplinuar dhe ndëshkuar këta vartës.[1881]

567. Në lidhje me këtë pikë, Prokuroria ka paraqitur dëshmi për të provuar se Fatmir Limaj ishte komandant i një zone apo rajoni më të madh, që përfshinte fshatin Llapushnik, megjithëse e kishte bazën në Kleçkë. Si rezultat Prokuroria ngre edhe pretendimin se Fatmir Limaj ishte komandant i përgjithshëm të kamp-burgut të Llapushnikut. Mbrojtja e Fatmir Limajt i hedh poshtë të dy këto pretendime dhe argumenton se në kohën që ka lidhje me Aktakuzën, Fatimi Limaj drejtonte thjesht një njësi në Kleçkë e njohur si Çeliku 1.

568. Çështja nëse Fatmir Limaj ushtronte komandë në kamp-burgun e Llapushnikut duhet trajtuar në konteksin se në 1998 brenda UÇK-së filloi ngritja graduale e strukturës, e cila mori forma në zhvillim dhe trajta në ndryshme në zona të ndryshme. Duke marrë parasysh këtë, gjendja në një kohë të caktuar ishte disi e paqartë dhe ndryshonte nga një vend në tjetrin. Dhoma i ka shqyrtuar këto çështje me hollësi gjetiu në këtë vendim.[1882] Sa i përket rolit të Fatmir Limajt në veçanti, Mbrojtja e tij nuk kundërshton se në një kohë të caktuar ai komandonte të paktën një njësi në Kleçkë; dhe jo më parë se gusht 1998 dhe ndoshta në fund të shtatorit 1998, ai u bë komandant i Brigadës 121, gjithashtu nga Kleçka; dhe se në nëntor 1998, ai u bë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Gjithsesi problemi para Dhomës është nëse Prokuroria ka provuar se midis majit dhe korrikut 1998, Fatmir Limaj ishte komandant i një zone apo rajoni që shtrihej përtej Kleçkës dhe përfshinte të paktën pjesën jugore të fshatit Llapushnik, ku ndodhej kamp-burgu. Dëshmitë në lidhje me këtë shpesh janë të paqarta, ato ndryshojnë në aspekte mjaft të rëndësishme nga një dëshmitar në tjetrin, dhe herë pas here janë të pasakta nga pikëpamja kohore. Vetë koncepti i fjalës "komandant" mund të jetë kuptuar gjerësisht prej disa anëtarëve të UÇK-së në atë kohë sepse disa janë prirur ta përdorin atë fjalë thjesht si shenjë respekti apo në njohje të ndikimit të një personi.[1883] Për dëshmitarë të tjerë, del çështja nëse përmendja e tyre për Çelikun ose Fatmir Limajn si komandant ishte e bazuar në dijeni të besueshme apo thjesht në thashetheme apo se ashtu

[1881] Aktakuzë, paragrafët 14-16.
[1882] *Shih më sipër,* paragrafët 53-65.
[1883] *Shih* L95, T 2610; 2612; 2614.

"mendonin". Dëshmitë që siç duket Prokuroria priste prej dy dëshmitarëve të vetë, dy ish-anëtarë të UÇK-së, Shukri Buja dhe Ramadan Behluli, duket se kanë qenë thelbi i argumentit të Prokurorisë lidhur me pozitën e Fatmir Limajt si komandant. Mirëpo në dëshmitë e tyre gojore para Dhomës secili prej këtyre dy dëshmitarëve tha se pasi ishte menduar, çfarë kishte thënë në intervistën e mëparshme me Prokurorinë, kishte qenë gabim në lidhje me aspektet materiale. Kur dëshmuan, secili prej këtyre dëshmitarëve i vendosi ngjarjet lidhur me komandën e Fatmir Limajt në një kohë të mëvonshme sesa në deklaratat e tyre të mëparshme, në çdo rast me vonë se koha që lidhet me këtë Aktakuzë. Rrethanat dhe karakteri i dëshmive të tyre sugjeruan se ky mohim i pjesshëm ishte rezultat i ndjenjës së besnikërisë ndaj UÇK-së në përgjithësi dhe Fatmir Limajt në veçanti, nga Shukri Buja dhe Ramadan Behluli. Rezultati ishte eliminimi i bazës së argumentit të Prokurorisë në lidhje me këtë pikë. Prokuroria u detyrua të parashtronte se Dhoma duhej të mos e besonte dëshminë në gjyq të këtyre dy dëshmitarëve dhe të pranonte si të vërteta dhe të nxirrte përfundimet faktike mbi bazën e intervistave të mëparshme me Zyrën e Prokurores, me gjithë mohimin e tyre të shprehur. Për arsye të shtjelluara prej Dhomës në një vendim gjatë procesit gjyqësor,[1884] në rrethana të veçanta dëshmitë kundërshtuese të dhëna nga këta dy dëshmitarë ofroi bazë për përligjjen e pranimit si prova thelbësore të dëshmive që secili prej tyre i kishte dhënë më parë Zyrës së Prokurorit. Gjithsesi, është i rëndësishëm fakti se në dëshmitë e tyre secili prej këtyre dëshmitarëve i mohoi shprehimisht pjesët përkatëse në intervistat e mëparshme mbi të cilat Prokuroria kërkon të mbështetet. Në këto rrethana, për arsye të shpjeguara më vonë,[1885] Dhoma nuk mund të jetë kaq e sigurtë për vërtetësinë dhe besueshmërinë e deklaratave të mëparshme sa të arrijë në përfundime të kundërta me dëshmitë gojore të secilit prej dy dëshmitarëve. Të paktën në këtë pikë, rezultati i dëshmive të Shukri Bujës dhe Ramadan Behlulit është zero.

569. Dëshmia e L64-ës është e vetmja dëshmi që disponon Dhoma, e cila po të pranohet, do të sugjeronte drejtpërdrejtë se Fatmir Limaj ushtronte komandë në Llapushnik. L64 dëshmoi para Dhomës se dikur rreth mesit të majit 1998, Çeliku erdhi në fshatin Llapushnik. Sipas dëshmisë së L64-ës ushtarët u rreshtuan dhe Çeliku mbajti fjalim. L64 tha se Çeliku u paraqit si personi përgjegjës për zonën dhe njoftoi se Çerçizi do të ishte personi përgjegjës për pozicionin e luftimit në Llapushnik.[1886] Dëshmia e L64-ës përqëndrohet pak a shumë në pikën se sipas mendimit të tij, Çeliku ushtronte funksion komandues. L64 dëshmoi se Çeliku erdhi disa herë në Llapushnik, megjithëse ka mospërpuuthje të shumta midis dëshmisë gojore të dëshmitarit dhe deklaratave të tij

[1884] Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Mëhershme si Dëshmi Provuese, 25 prill 2005.
[1885] *Shih më poshtë,* paragrafët 581-582; 586.
[1886] L64, T 4356-4357.

të mëhershme.[1887] Në veçanti, L64 tha se Çeliku ishte i pranishëm atje në dy ceremoni betimi, në të cilat mori pjesë L04.[1888] Gjithashtu L64 dëshmoi se Çerçizi i raportonte rregullisht Çelikut për gjendjen në Llapushnik.[1889] L64 deklaroi se për shembull më 25 korrik 1998, Çerçizi dhe Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi, shkuan në Kleçkë për përforcime dhe u kthyen me një top, ku Mbrojtja ka pranuar se Fatmir Limaj kishte komandën e një njësie.[1890] Kjo mund të sugjerojë se ndihma koordinohej prej Kleçkës. Gjithashtu L64 dëshmoi se ai ishte thirrur në Kleçkë për të dorëzuar armën e tij, pas një operacioni të ndërmarrë në Lladroc për mbledhjen e armëve pa dijeninë e Çelikut.[1891] L64 deklaroi se Çerçizi i tha për thirrjen, por ai refuzoi të shkonte në Kleçkë.[1892] Mirëpo sipas dëshmisë së tij, ushtarë të tjerë të UÇK-së të cilët morën pjesë në këtë aksion në Lladroc i thanë se ata ishin çarmatosur nga Çeliku për 15 ditë.[1893] Kur gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, L64-ës iu tha se në fakt ai ishte çarmatosur nga Çeliku, por kjo ndodhi sepse ishte zbuluar se ai kishte patur synim të largohej nga Llapushniku për të vrarë dikë. L64 e pranoi se në të vërtetë ai merrte pjesë në një plan për vrasjen e një apo ndoshta dy individëve nga fshati i tij.[1894] Dhoma ka mendimin se dëshmia mbi këtë episod ngre dyshime serioze mbi besueshmërinë e dëshmisë së L64-ës. Sidoqoftë, dëshmia e L64-ës në lidhje me këtë incident priret të tregojë se mundësia materiale e Çelikut për të disiplinuar "vartësit" faktikisht ishte e kufizuar dhe jo e pajtueshme me atë që pritet prej një komandanti.

570. Në gjyq, L64 identifikoi një vizatim të bërë prej tij ku në përgjithësi përshkruhej organizimi i UÇK-së në zonën gjeografike që ka lidhje me këtë çështje.[1895] L64 konfirmoi se njësitë e ndryshme të identifikuara në vizatim, ku përfshiheshin edhe ato të Llapushnikut dhe Kroimirit, ishin të gjitha nën komandën e Kleçkës dhe Fatmir Limajt.[1896] Mirëpo gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, për Dhomën u bë e qartë se dëshmia e L64-ës në lidhje me "komandën" e Fatmir Limajt bazohej kryesisht në thashetheme dhe se ai nuk kishte njohuri të besueshme të strukturës rajonale të UÇK-së në atë kohë.[1897]

[1887] Në një deklaratë që L64 dha në maj 2003, ai deklaroi se Çeliku erdhi në Llapushnik tri ose katër herë gjatë periudhës në fjalë; T.4697. Në një deklaratë tjetër në qershor 2003, L64 deklaroi se Çeliku erdhi 10-15 herë, megjithëse dëshmitari e pa atë personalisht 7 ose 8 herë; T 4899. Në gjyq L64 dëshmoi se ai e pa Çelikun në Llapushnik afërsisht 10 herë midis majit dhe korrikut 1998; T 4395.
[1888] L64, T 4420-4421.
[1889] L64, T 4398.
[1890] L64, T 4399.
[1891] L64, T 4400-4402.
[1892] L64, T 4402.
[1893] L64, T 4401.
[1894] L64, T 4839-4840; 4842-4843; 4867-4869.
[1895] Prova Materiale P173.
[1896] L64, T 4530-4532.
[1897] L64, T 4707-4712.

571. Si provë është edhe një fletore shënimesh apo ditar i L64-ës.[1898] Duket se kjo fletore shënimesh përmban një përmbledhje të shkurtër të fëmijërisë dhe jetës së dëshmitarit dhe më pas shënime më konkrete me data në maj dhe korrik 1998 si dhe gjatë vitit 1999. Mirëpo vlera e saj si provë është problematike. Në një numër shënimesh nuk përmendet viti kur janë mbajtur. Duket se shënime të tjera gabojnë në kohë.[1899] Në gjyq L64 shpjegoi se shënimet e ditarit nuk ishin të njëkohshme, por ato ishin transkript i mëvonshëm i shënimeve të bëra gjatë luftës.[1900] Bie në sy se ditari nuk përfshin një pasqyrim të plotë të ngjarjeve në Llapushnik nga maji në korrik 1998, megjithëse përmenden nja dy incidente që ndoshta kanë lidhje me rastin. Konkretisht, L64 tregon sesi dikur nga fundi i korrikut 1998 Çerçizi i tha se me urdhër të Çelikut, një prej ushtarëve të L64-ës do të merrte detyrën e L64-ës si komandant dhe L64 do të ishte zëvendësi i tij.[1901] L64 përshkroi zemërimin e tij për këtë vendim, të cilin ai e konsideroi si një emërim thjesht mbi bazën e lidhjes familjare me Fatmir Limajn. Zemërimi vazhdon dhe sot e kësaj dite. Shënimi në lidhje me këtë episod në ditar nuk ka datë konkrete në korrik 1998. Sipas vetë dëshmitarit, ky shënim nuk u bë menjëherë në atë kohë dhe se dëshmitari e "pati të pamundur t'i rendiste ngjarjet kronologjikisht".[1902] Në ditar nuk janë shënuar ngjarje të tjera të cilat mund të konsideroheshin të paharrueshme. Për shembull, nuk përmendet asnjë fjalim i Çelikut në maj 1998 në fshatin Llapushnik, ku ai informoi se ishte përgjegjës për zonën. Pas shqyrtimit të këtyre rrethanave dhe duke marrë parasysh rezervat në përgjithësi të Dhomës në lidhje me këtë dëshmitar të përmendura gjetiu,[1903] Dhoma nuk është e bindur se mund ta konsiderojë të besueshme dëshminë e L64-ës.

572. Prokuroria mbështetet në dëshmi të tjera që synojnë të provojnë se Fatmir Limaj komandonte një zonë më të madhe rreth Kleçkës, ku përfshihej Kroimiri dhe Llapushniku. Për këtë qëllim Prokuroria mbështetet në dëshminë e Ramiz Qeriqit i njohur si komandant Luani. Ramiz Qeriqi dëshmoi para Dhomës se ai u kthye në Kosovë në fund të marsit 1998 dhe mori udhëzime nga komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, Azem Syla, që të shkonte në Likoc dhe të takonte Rexhep Selimin.[1904] Sipas dëshmisë së Ramiz Qeriqit, ai i dha një letër Rexhep Selimit ku thuhej se ku duhej të shkonte ai.[1905] Ramiz Qeriqi deklaroi se pas një jave në Likoc, ai shkoi për dy ditë në Kleçkë, ku takoi Çelikun dhe Sadik Shalën.[1906] Në dëshminë e Ramiz Qeriqit nuk sugjerohet se në atë kohë ai mori udhëzime nga Çeliku. Pastaj Ramiz Qeriqi shkoi në Kroimir, vendlindjen e tij. Ai i

[1898] Prova Materiale P169.
[1899] L64, T 4416.
[1900] L64, T 4365-4366; T 4699-4705.
[1901] Prova Materiale P169, f .14; L64, T 4414-4416.
[1902] L64, T 4416.
[1903] *Shih më sipër,* paragrafin 28.
[1904] Ramiz Qeriqi, T 3561-3563.
[1905] Ramiz Qeriqi, T 3563.

përshkroi kështu detyrat e tij: "Unë shkova vetë, thjesht për organizimin e gjërave, të thërrisja shokët e mi të dikurshëm dhe m'u tha – me vete kisha porosinë që duhej t'ua përcillja atyre se ne të gjithë duhej të mobilizoheshim dhe të ndalnim depërtimin e forcave serbe në fshatra në atë zonë dhe t'i pengonim ata për keqtrajtimin e popullatës."[1907] Ramiz Qeriqi dëshmoi se në maj 1998, ai ishte komandant në Kroimir dhe ushtarët e tij po ngrinin pozicione dhe hapnin llogore në pika të ndryshme, ndër të tjera në Carralevë, Zborc, Fushticë dhe Blinajë.[1908] Mirëpo në fund të majit 1998, Shukri Buja u bë komandant në Kroimir dhe Ramiz Qeriqi ishte zëvendësi i tij.[1909] Një aspekt material i dëshmisë së Ramiz Qeriqit është se ai tha se dinte se mbi atë dhe Shukri Bujën kishte një komandë më të lartë. Ai përshkroi një "vijë organizative" nga Likoci në Kleçkë dhe Kroimir. Sipas dëshmisë së tij Fatmir Limaj ishte komandant në Kleçkë, se Rexhep Selimi ishte komandant në Likoc dhe se komandant i përgjithshëm i UÇK-së ishte Azem Syla.[1910] Prej dëshmisë duket se prej mesit të gushtit 1998, Ramiz Qeriqi u bë komandant i batalionit Ruzhdi Salihaj brenda Brigëdës 121[1911] dhe si i tillë i raportonte Fatmir Limajt, i cili në atë kohë ishte komandant i Brigadës 121.[1912] Mirëpo në dëshminë e Ramiz Qeriqit ka disa paqartësi në lidhje me pozitën e tij para mesit të gushtit 1998. Në lidhje me këtë pikë Ramiz Qeriqi dëshmoi se midis majit dhe korrikut 1998, ai shkoi në Kleçkë shumë rrallë dhe nuk merrte urdhra prej Fatmir Limajt. Ai e shpjegon këtë me faktin se ai nuk ishte më komandant në Kroimir;[1913] por ishte Shukri Buja. Ramiz Qeriqi i raportonte dhe merrte urdhra prej Shukri Bujës.[1914] Kur në seancën e pyetjeve të Prokurorisë Ramiz Qeriqi u pyet se nga kush i merrte urdhrat Shukri Buja, Ramiz Qeriqi u përgjigj troç: "Këtë nuk e di. Pyesni Shukriun për këtë."[1915] Këtë përgjigje ai e përsëriti gjatë pyetjeve nga Mbrojtja kur tha: "Si mund të flas unë në emër të tij? Ai mund t'ju tregojë më shumë se unë sepse unë e informoja – i raportoja për pozicionet, për ushtarët, dhe mbase ai duhej t'i raportonte dikujt tjetër."[1916]

573. Në parashtrimin e Prokurorisë, zona e vizatuar nga dëshmitari në Provën Materiale P154, e cila përfshin Llapushnikun, ishte zona që komandohej nga Kleçka, d.m.th. sugjerohet nga Fatmir

---

[1906] Ramiz Qeriqi, T 3563-3565.
[1907] Ramiz Qeriqi, T 3565.
[1908] Ramiz Qeriqi, T 3575.
[1909] Ramiz Qeriqi, T 3578.
[1910] Ramiz Qeriqi, T 3579.
[1911] Prova Materiale P155; Ramiz Qeriqi, T 3593; Fatmir Limaj, T 6089.
[1912] Ramiz Qeriqi, T 3593-3595; Ramiz Qeriqi dëshmoi se që prej emërimin e tij si komandant i Batalionit Ruzhdi Salihaj më 16 gusht 1998 ai i raportonte me shkrim Fatmir Limajt dhe çdo javë mbaheshin takime. T 3711; *shih* edhe Fatmir Limaj, T 6013.
[1913] Ramiz Qeriqi, T 3579-3580; 3711.
[1914] Ramiz Qeriqi, T 3711.
[1915] Ramiz Qeriqi, T 3582.
[1916] Ramiz Qeriqi, T 3711-3712.

Limaj nga maji 1998 e më tej.[1917] Mirëpo përshkrimi i vetë Ramiz Qeriqit për vizatimin, tregon një farë paqartësie në lidhje me periudhën kohore të cilën ai mbante mend:

> Pyetje. Çfarë paraqet kjo vijë?
> Përgjigje: Kjo paraqet zonën – pjesë të zonës ku shërbeva, d.m.th. paraqet katër batalionet që ishin në Kleçkë.
> Pyetje: Dhe –
> Përgjigje: Nën Kleçkën.
> Pyetje: Dhe a është kjo zona që ekzistonte në atë kohë për të cilën po flasim afërsisht maj/qershor 1998?
> Përgjigje: Kjo zonë ekzistonte që para kësaj kohe, por batalioni im nuk ishte i organizuar kështu si e kam vizatuar unë këtu.
> Pyetje: Dhe në atë kohë – në kohën për të cilën po flasim apo edhe më parë siç thatë ju, a ishte kjo zonë nën komandën e Kleçkës ?
> Përgjigje: Ajo ishte nën komandën e Kleçkës, po kur e vizatova ishte një batalion dhe atë batalion e drejtoja unë.[1918]

Kjo nuk u qartësua më tej as gjatë pyetjeve të Prokurorisë dhe as gjatë pyetjeve të Mbrojtjes. Megjithëse një interpretim fjalë për fjalë i një përgjigjeje të Ramiz Qeriqit do të sugjeronte se zona që ai vizatoi në Provën Materiale P154 ishte nën komandën e Kleçkës para formimit të batalionit të tij, d.m.th. para mesit të gushtit 1998, rezultati i përgjithshëm i dëshmisë së tij i dha Dhomës përshtypjen se ai e lidhte ushtrimin e asaj komande me krijimin e batalioneve. Përshkrimi i menjëhershëm dhe spontan i tij gjatë dëshmisë ishte se zona që ai vizatoi përfaqësonte "katër batalione… në Kleçkë". Kjo qartazi lidhet me një periudhë më të vonshme se ajo që ka lidhje me Aktakuzën.

574. Prokuroria i është referuar më tej dëshmisë së Ramiz Qeriqit se dikur në qershor 1998, kur shkoi në Kleçkë, ai mori udhëzime nga Fatmir Limaj që të shkonte për ndihmë në luftimin në Ratkoc.[1919] Në të vërtetë dëshmia e Ramiz Qeriqit në këtë pikë është se Fatmir Limaj ishte ai që jepte udhëzime në Kleçkë.[1920] Mirëpo pandehma tjetër e Prokurorisë se kjo dëshmi tregon se Fatmir Limaj komandonte një zonë më të madhe rreth Kleçkës ku përfshihej edhe Kroimiri[1921] dhe Llapushniku, nuk mbështetet prej dëshmisë së tij. Ramiz Qeriqi e moderoi dëshminë e tij se të gjitha udhëzimet prej Kleçkës vinin prej Fatmir Limajt duke shtuar se kjo vlente edhe për atë në

[1917] Argumentet Mbyllëse, T 7256.
[1918] Ramiz Qeriqi, T 3581.
[1919] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 28.
[1920] Ramiz Qeriqi, T 3574-3575.
[1921] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 28.

Kroimir dhe për të tjerët në vende të tjera.[1922] Rrjedhimisht Dhoma ka mendimin se kjo dëshmi nuk tregon domosdoshmërisht më shumë se Fatmir Limaj ishte komandant në Kleçkë dhe se në këtë cilësi ai e udhëzoi Ramiz Qeriqin të ndihmonte në Ratkoc.

575. Së fundi Prokuroria i referohet dëshmisë së Ramiz Qeriqit se Fatmir Limaj komandonte tri njësi në luftimin e Llapushnikut më 9 maj 1998.[1923] Ramiz Qeriqi dëshmoi se atë ditë ai kishte qenë në Kleçkë dhe se ai e të tjerë shkuan në Llapushnik për të ndihmuar në luftim sepse kishin dëgjuar të shtënat:

> Pyetje: Kush shkoi tjetër në Llapushnik, në rast se pati edhe të tjerë ?
> Përgjigje: Ishim tre grupe që u nisëm nga Kleçka. Çdo grup kishte pesë persona.
> Pyetje: A kishte persona në komandë të çdo grupi?
> Përgjigje: Një grup drejtohej prej meje, një grup prej Topit dhe një prej Çelikut.
> Pyetje: A ishte dikush që komandonte të tre grupet?
> Përgjigje: Nuk ishte puna se dikush ishte në komandë. Në Kleçkë ishte Fatmiri, Çeliku, i cili kishte pozitë më të lartë, komandonte.
> Pyetje: Po në lidhje me tre grupet që ju thatë se udhëtuan nga Llapushniku në Kleçkë, a ishte dikush që komandonte këta tre grupe në atë kohë, vetëm për luftimin në Llapushnik?
> Përgjigje: Kur shkuam në Llapushnik, Fatmiri shkoi me grupin e parë. Topi dhe unë shkuam me grupet tanë. Topi kishte një radiotransmetues, kurse Fatmiri nuk kishte. Ne erdhëm më vonë, ndoshta pas njëzet minutash.
> Pyetje: Por pyetja ime Z. Qeriqi është: A ishte ndonjë person që komandonte të tre grupet që udhëtuan nga Kleçka në Llapushnik?
> Përgjigje: Në Kleçkë komandonte Fatmiri, as unë dhe as Topi.
> Pyetje: Pra ju po thoni se ai ishte në komandë të tre grupeve?
> Përgjigje: Po, sepse ai ishte përgjegjës për njerëzit që ishin në Kleçkë.[1924]

Ndërkohë që dëshmia e mësipërme në fakt mbështet një përfundim se Fatmir Limaj ishte komandant në Kleçkë, sugjerimi tjetër që dëshiron të bëjë Prokuroria se për këtë arsye ai ishte edhe komandant i të tëra forcave të UÇK-së në Llapushnik duket se nuk përfshihet në këtë dëshmi. Po të shihet në mënyrën më positive, ajo më së shumti do të provonte se Fatmir Limaj ishte në komandë të tre grupeve me ushtarë nga Kleçka të cilët luftuan në Llapushnik më 9 maj 1998. Më vonë në dëshminë e tij, Ramiz Qeriqi dëshmoi gjithashtu se ushtarët të cilët shkuan nga Kleçka në Llapushnik atë ditë, nuk u urdhëruan për këtë por shkuan tërësisht me vullnetin e tyre të lirë,[1925]

[1922] Ramiz Qeriqi, T 3575; 3589.
[1923] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 103.
[1924] Ramiz Qeriqi, T 3568-3569.
[1925] Ramiz Qeriqi, T 3658.

fakt që i largohet sugjerimit se aktualisht Fatmir Limaj ishte në komandë të tre grupeve që ndihmuan Llapushnikun atë ditë.

576. Mbrojtja e Fatmir Limajt gjithashtu i referohet dëshmive të disa dëshmitarëve se Ramiz Qeriqi me pseudonimin Luani ishte "figurë qendrore në organizimin dhe kryerjen e rrëmbimeve" në Kroimir.[1926] Dhoma vlerëson se gjatë dëshmisë së tij, Ramiz Qeriqi u orvat të mohonte ose pakësonte përfshirjen e tij në rrëmbimet e civilëve gjatë pranverës dhe verës së vitit 1998. Rrjedhimisht dëshmia e tij duhet trajtuar me kujdes. Mirëpo Prokuroria argumenton se Ramiz Qeriqi nuk kishte arsye ta mashtronte Dhomën në lidhje me organizimin e UÇK-së apo rolin e Fatmir Limajt. Gjithsesi, përshkrimi prej tij i strukturës dhe vendosja e individëve në atë strukturë si komandantë në atë kohë mund të jetë fare mirë një aspekt i përpjekjeve të tij të dukshme për të minimizuar rolin e tij. Duke marrë parasysh këta faktorë, Dhoma nuk mund të bindet prej dëshmisë së Ramiz Qeriqit se Fatmir Limaj ishte komandant i një zone më të gjerë e cila përfshinte edhe Llapushnikun në kohën që ka lidhje me këtë Aktakuzë.

577. Shukri Buja dëshmoi para Dhomës. Ai dëshmoi se u kthye në Kosovë në të njëjtën kohë me Fatmir Limajn, në mars 1998. Të dy bënin pjesë në një grup më të madh që u kthye në Kosovë. Anëtarët e grupit morën armë dhe municione kur ishin në Shqipëri, e kaluan kufirin në këmbë dhe u nisën drejt zonës së Drenicës.[1927] Sipas dëshmisë së Shukri Bujës ai dhe Fatmir Limaj propozuan të shkonin në vendlindjet e tyre përkatëse, si zonat që i njihnin më mirë, mendim që u mbështet nga Hashim Thaçi.[1928] Shukri Buja shkoi që të ngrinte një njësi të UÇK-së në Mullopolc dhe me sa dinte ai Fatmir Limaj do të ketë organizuar lëvizjen e UÇK-së në Kleçkë.[1929] Dëshmia e tij është se të dy komunikonin nëpërmjet lajmëtarëve për të qenë në kontakt me Shtabin e Përgjithshëm përmes Hashim Thaçit. Përgjithësisht Fatmir Limaj e shoqëronte Shukri Bujën për të takuar Hashim Thaçin sepse ai e njihte zonën mirë.[1930] Gjithashtu Shukri Buja dëshmoi se kur dikur nga mesi i prillit 1998 ai qëndroi në Kleçkë, atje ishin disa ushtarë të UÇK-së që ruanin fshatin; sipas tij këta ushtarë më vonë u bënë pjesë e njësisë ose njësia Çeliku 1.[1931] Në dëshminë gojore të Shukri Bujës nuk sugjerohet se në atë kohë ai ishte vartës apo merrte urdhra prej Fatmir Limajt.

[1926] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 144-146.
[1927] Shukri Buja, T 3738-3746.
[1928] Shukri Buja, T 3751.
[1929] Shukri Buja, T 3756-3757.
[1930] Shukri Buja, T 3758-3760.
[1931] Shukri Buja, T 3767-3768.

578. Më tej Shukri Buja deklaroi se në fund të majit 1998 ai shkoi në Kroimir ku ngriti njësinë e quajtur "Sokoli" apo "Petriti".[1932] Gjithsesi Shukri Buja dëshmoi se në muajin qershor 1998, ai nuk kishte linja komunikimi dhe nuk mund të komunikonte me Fatmir Limajn.[1933] Në dëshminë e tij pak a shumë pohohet se ai nuk di për ekzistencën e një strukture komanduese mbi njësitë në maj dhe qershor 1998, përveç Shtabit të Përgjithshëm, dhe se gjendja filloi të ndryshonte me zhvillimin e nënzonave që prej mesit të qershorit 1998.[1934] Më 6 korrik 1998, Shukri Buja u emërua komandant i nënzonës së Nerodimës.[1935] Ai dëshmoi se në atë periudhë, komandant i zonës së Pashtrikut ishte Musë Jashari dhe Fatmir Limaj ishte në Kleçkë me njësinë Çeliku.[1936] Sipas dëshmisë së Shukri Bujës herë pas herë ai dërgonte individë të arrestuar në postblloqe për në Kleçkë sepse "kishte njerëz që mund t'i njihnin. Kishte edhe nga Shtabi i Përgjithshëm…"[1937]

579. Dëshmia e Shukri Bujës ndryshoi në aspekte materiale nga çfarë kishte thënë në një intervistë më të hershme me një përfaqësues të Zyrës së Prokurores në prill 2003. Këto ndryshime ishin të tilla që dëshmia gojore e dëshmitarit ishte ndjeshmërisht më pak e dobishme për Prokurorinë se intervista e mëparshme. Megjithëse Shukri Buja këmbënguli se përgjithësisht ai ishte përpjekur të tregonte të vërtetën gjatë intervistës me Prokurorinë, tani ai mendonte se kishte gabime në ato që i tha Prokurorisë. Këto ai i korigjoi në dëshminë e tij para Dhomës dhe tha se këto korigjime ishin shpjegimi për ndryshimet materiale midis dëshmisë së tij dhe deklaratës së mëparshme.

580. Faktikisht Prokuroria kërkon të mbështetet në ato që Shukri Buja tha në intervistën e tij të mëparshme dhe jo në dëshminë e dhënë në gjyq, për të provuar se Fatmir Limaj ushtronte komandë të ndërmjetme nga Kleçka, midis Shtabit të Përgjithshëm dhe njësive të ndryshme në një zonë e cila përfshinte Kroimirin dhe Llapushnikun.[1938] Gjetiu në këtë vendim, dhe kryesisht në vendimin e Dhomës, dhënë gjatë gjyqit, për të pranuar si dëshmi provuese intervistën e mëparshme të Shukri Bujës, Dhoma ka shqyrtuar faktorë që e bindën Dhomën të merrte këtë drejtim të pazakontë në lidhje me provat. Natyrisht që vendimi për pranimin e kësaj interviste të mëhershme nuk është në asnjë mënyrë përcaktues mbi rëndësinë që Dhoma i kushton asaj. Pasi ka parë videokasetën e deklaratës së mëhershme dhe nga dëshmia e Shukri Bujës, Dhoma bindet se deklarata e mëparshme u dha lirisht. Gjithashtu Dhoma nuk ndikohet prej logjikës së arsyeve të dhëna nga Shukri Buja për

[1932] Shukri Buja, T 3777-3781.
[1933] Shukri Buja, T 3785-3786.
[1934] Shukri Buja, T 3795-3797.
[1935] Shukri Buja, T 3798.
[1936] Shukri Buja, T 3799.
[1937] Shukri Buja, T 4052.

ndryshimet e dukshme në këtë dëshmi. Duke e vëzhguar me kujdes dëshmitarin gjatë dëshmisë së tij, Dhoma mendon se ndryshimet prej intervistës së tij të mëparshme ku ai e përcaktoi periudhën përkatëse për strukturën e UÇK-së, të cilën e kishte shpjeguar më parë, jashtë periudhës kohore që ka lidhje me Aktakuzën, mund të shpjegohen fare mirë prej ndjenjës së dukshme të besnikërisë të cilën e demonstroi fizikisht dhe e zbuloi në dëshminë e tij për UÇK-në në përgjithësi dhe Fatmir Limajn në veçanti.

581. Për këto arsye Dhoma nuk mund të pranojë si të vërtetë dëshminë e Shukri Bujës të dhënë në gjyq në lidhje me periudhën kohore gjatë së cilës Fatmir Limaj mori pozitë komanduese të një zone apo rajoni që përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut. Kjo është e vetmja dëshmi për këtë pikë së cilës i përmbahet dëshmitari. Ai ka mohur shprehimisht çfarë tha më parë në intervistë mbi aspektet përkatëse. Megjithëse Dhoma ka dyshime të forta, ajo nuk mund të nxjerrë përfundime në dobi të Prokurorisë mbi bazën se çfarë tha Shukri Buja në pjesët përkatëse të intervistës së mëparshme, të mohuar shprehimisht prej tij.

582. Gjithashtu Dhoma thekson, se po të bindej për vërtetësinë dhe ndershmërinë e Shukri Bujës për pjesët përkatëse të intervistës së tij të mëparshme, për të cilat ajo nuk është e bindur, mbeten disa probleme të tjera po të pranohet se Fatmir Limaj kishte komandën e një zone e cila përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut në kohën që ka lidhje me Aktakuzën. Duket se mënyra e bërjes së pyetjeve në rastin e mëhershëm ka ndikuar përgjigje të rëndësishme. Disa përgjigje të cilat mund të kuptohen si paralajmërime, nuk u pasuan me pyetje për të qartësuar për çfarë bëhej fjalë.[1939] Në një moment Shukri Buja e përshkruan rolin e Fatmir Limajt si bashkërendues, detyrë të cilën spontanisht e barazoi me rolin e tij në Kaçanik.[1940] Në një vend tjetër roli përshkruhet kështillimor.[1941] Këto cilësime lënë të paqartë nëse Fatmir Limaj kishte rol komandues sipas kuptimit përkatës.[1942] Gjithashtu ka pjesë që lënë të pazgjidhur se kush ishte personi me përgjegjësi më të lartë në Kleçkë, Fatmir Limaj apo Ismet Jashari me pseudonimin Kumanova.[1943]

583. Ramadan Behluli dëshmoi se ai u anëtarësua në UÇK në Kroimir më 20 prill 1998 dhe se në marrëveshje me Ramiz Qeriqin me pseudonimin Luani, ai mori komandën e një njësie në

[1938] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafët 33-36 dhe 41.
[1939] Prova Materiale P160, ff. 36-37.
[1940] Prova Materiale P160, ff. 36-37; 51.
[1941] Prova Materiale P160, f. 43.
[1942] *Shih* Provën Materiale P160, f. 51.
[1943] Prova Materiale P160, f. 43.

Pjetërshticë.[1944] Ramadan Behluli dëshmoi se në lidhje me mbrojtjen e pozicioneve ekzistuese ai merrte urdhra nga Ramiz Qeriqi me pseudonimin Luani. Sipas dëshmisë së Ramadan Behlulit në maj, qershor dhe korrik 1998, Ramiz Qeriqi me pseudonimin Luani, nuk merrte urdhra prej askujt, por i merrte vetë vendimet.[1945] Ajo që është më e rëndësishme, Ramadan Behluli dëshmoi se sipas mendimit të tij nga muaji maj deri në mes të gushtit 1998 nuk kishte komandant të përgjithshëm. Sipas dëshmisë së tij, kjo komandë filloi me formimin e Brigadës 121 në gusht 1998 me Fatmir Limajn si komandant dhe Kleçkën si seli.[1946] Mirëpo ai pranoi se përgjigjet e dhëna në një intervistë me Prokurorinë në prill 2003 mund të kuptoheshin sikur ishte një komandant i përgjithshëm midis majit dhe gushtit 1998 në zonën që ka lidhje me këtë rast. Në lidhje me këtë pikë, Ramadan Behluli dha shpjegimin se në intervistë këto çështje u përmendën vetëm përgjithësisht dhe se nuk u saktësuan datat përkatëse apo të paktën nuk u saktësuan në çdo rast. Dëshmitari deklaroi se zona të cilën ai e vizatoi mbi një hartë gjatë intervistës dhe që përfshinte Llapushnikun, tregonte zonën nën komandën e Fatmir Limajt në fund të vitit 1998 dhe fillim të 1999, dhe jo midis majit dhe gushtit 1998.[1947]

584. Në intervistën e mëparshme më 25 prill 2003, atij iu kërkua të përshkruante strukturën e UÇK-së në pranverën dhe verën e vitit 1998. Dhoma ka mendimin se në përshkrimin e tij Ramadan Behluli e vendosi Fatmir Limajn si komandant të zonës së Pashtrikut.[1948] Gjithsesi në një fjali të kësaj pjese, Ramiz Qeriqi përmendet si komandant batalioni.[1949] Ky është tregues i periudhës kohore të mëvonshme në lidhje me këtë rast. Këtu ngrihet pyetja nëse Ramadan Behluli e kuptoi drejt pyetjen për periudhën kohore apo nëse njohuritë e tij për zhvillimin e strukturës së UÇK-së në atë kohë ishin aq të mjaftueshme saqë e lejonin të vlerësonte se kishte një ndryshim material midis periudhave të ndryshme. Këto çështje nuk u qartësuan gjatë intervistës së mëparshme.

585. Më vonë gjatë intervistës Ramadan Behlulit iu kërkua të vizatonte mbi një hartë zonën nën komandën e Kleçkës në korrik 1998.[1950] Ai e vizatoi zonën vetëm përgjithësisht dhe e quajti zona e Pashtrikut.[1951] Duket qartë që ajo shkon përgjatë rrugës Prishtinë-Pejë dhe përfshin pjesë të fshatit Llapushnik në anën jugore të rrugës.[1952] Ramadan Behluli e vizatoi zonën mbi hartë para se të

[1944] Ramadan Behluli, T 2656-2657; 2659-2660.
[1945] Ramadan Behluli, T 2668-2670; 2678.
[1946] Ramadan Behluli, T 2681-2682.
[1947] Ramadan Behluli, T 2682-2684; Prova Materiale P119.
[1948] Prova Materiale P121, f. 22-23.
[1949] Prova Materiale P121, f. 22.
[1950] Prova Materiale P121, f. 51-52.
[1951] Në lidhje me zonën e Pashtrikut, *shih më sipër,* paragrafët 57-63.
[1952] Prova Materiale P119.

pyetej se a ishte kështu në korrik 1998.[1953] Sidoqoftë kur u pyet konkretisht nëse ishte kështu në korrik 1998, ai u përgjigj: "Kjo është…zona nën komandën e Kleçkës."[1954]

586. Dhoma ka mendimin se dëshmia e Ramadan Behlulit, veçanërisht deklarimi i tij i prerë se nga maji deri në mes të gushtit 1998 nuk kishte komandant të përgjithshëm, përbën një ndryshim të qartë dhe shumë të rëndësishëm prej përgjigjeve që ai dha në intervistën e prillit 2003. Mund të jetë e vërtetë se disa përgjigje mund të jenë ndikuar prej paqartësisë së Ramadan Behlulit në lidhje me kohën, por pavarësisht kësaj, kuptimi i përgjithshëm i pjesëve përkatëse të intervistës së mëparshme është në kundërshtim të dukshëm dhe madje themelor me deklaratat që ai bëri në dëshminë gojore se në muajt maj deri në mes të gushtit 1998 nuk kishte komandant të përgjithshëm. Po ashtu si me Shukri Bujën, Dhoma u bind të pranonte intervistën e mëparshme të Ramadan Behlulit si dëshmi provuese në rrethanat e caktuara të këtij rasti. Dhoma pa videokasetën e intervistës së mëparshme dhe u bind se ajo ishte dhënë lirisht. Në këtë pikë është e nevojshme të përcaktohet rëndësia që duhet t'i jepet intervistës së mëparshme, e cila tani shprehimisht kundërshtohet ose mohohet prej Ramadan Behlulit në pjesë që kanë lidhje me qëllimin përkatës. Midis qëndrimeve të Shukri Bujës dhe Ramadan Behlulit ka disa ndryshime të rëndësishme. Megjithatë, pasi ka shqyrtuar të tëra dëshmitë përkatëse dhe veçanërisht sjelljen e dëshmitarit kur ai foli për këtë çështje, Dhoma nuk është e gatshme të pranojë parashtrimin e Prokurorisë se ajo duhet të pranojë si të vërtetë atë që u tha në intervistën e vitit 2003, dhe mbi këtë bazë të arrijë në përfundimin se Fatmir Limaj ishte komandant i përgjithshëm mbi një zonë e cila përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut për muajt që kanë lidhje me këtë Aktakuzë. Gjithashtu Dhoma nuk mund të pranojë si të vërtetë dhe të besueshme dëshminë përkatëse gojore të Ramadan Behlulit në gjyq për këtë çështje. Po ashtu si me Shukri Bujën, respekti i dukshëm i dëshmitarit ose besnikëria ndaj UÇK-në në përgjithësi dhe Fatmir Limajt në veçanti, mund të kenë ndikuar dëshminë e tij në gjyq dhe shpjegojnë ndryshimet. Sido që të jetë, në lidhje me këtë, Dhoma nuk është e gatshme të mbështetet as në dëshminë e tij dhe, as në intervistën e tij të mëparshme.

587. Sipas argumentit të Prokurorisë, prej një bisede midis Ramadan Behlulit dhe Fatmir Limajt më 17 qershor 1998, Dhoma duhet të nxjerrë përfundimin se Fatmir Limaj mund t'a urdhëronte Ramadan Behlulin sepse ai ishte komandant i përgjithshëm.[1955] Fjalët të cilat përmenden, ndoshta mund të kuptohen si urdhër, por më së miri duket se përbëjnë një sugjerim informal sesi duhej të

[1953] Prova Materiale P121, f. 51.
[1954] Prova Materiale P121, f. 51.
[1955] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 32.

vepronte Ramadan Behluli në të ardhmen.[1956] Ramadan Behluli e karakterizoi bisedën si "bisedë informale",[1957] dhe kjo haptasi kundërshton sugjerimin e Prokurorisë se në fakt Fatmir Limaj po i jepte urdhër Ramadan Behlulit. Gjithashtu kuptimplotë kundër këtij përfundimi të argumentuar prej Prokurorisë është një deklaratë e drejtpërdrejtë e dëshmitarit në intervistën e tij të prillit 2003 se ai nuk merrte urdhra prej askujt tjetër veç Ramiz Qeriqit me pseudonimin Luani, dhe sigurisht jo prej Fatmir Limajt.[1958]

588. Fadil Kastrati dëshmoi se kur ishte në Blinajë, ai bëri fjalë me një fshatar. Sipas dëshmisë së tij, ky incident iu raportua Shukri Bujës dhe dikur më vonë në Blinajë erdhi komandant Çeliku dhe urdhëroi që Fadil Kastratit t'i hiqej arma për 15 ditë sepse ai po prishte rendin në fshat. Thuhet se Çeliku i tha Fadil Kastratit se UÇK-ja kishte rregulla dhe duhej mbajtur disiplinë.[1959] Në bazë të kujtesës së dëshmitarit ky takim ndodhi para ofensivës serbe në korrik 1998.[1960]

589. Fatmir Limaj mbante mend se e kishte konfiskuar armën e Fadil Kastratit dikur para fundit të korrikut 1998. Ai tha se Shukri Buja, në atë kohë komandant i zonës së Nerodimës, dhe ai ishin në Blinajë, ku një i afërm i Fadil Kastratit, në atë kohë komandant në Blinajë, i kërkoi Shukri Bujës t'ia merrte armën Fadil Kastratit sepse ai kishte frikë se Fadil Kastrati do të vritej me një fshatar për hakmarrje. Shukri Buja deklaroi se ai nuk mund ta merrte armën pasi ajo ishte e Fadil Kastratit. Ata vendosën të ndërhynte Fatmir Limaj, sepse ai nuk e njihte Fadil Kastratin. Fatmir Limaj tha se ai i tha Fadil Kastratit se kishte një urdhër nga lart për marrjen e armës prej tij.[1961]

590. Dhoma pranon se në të vërtetë Fatmir Limaj e çarmatosi Fadil Kastratin dikur para fundit të korrikut 1998 në Blinajë. Mirëpo prej këtyre dëshmive mbetet e paqartë se kur e bëri këtë, Fatmir Limaj ushtroi autoritet disiplinor mbi Fadil Kastratin sipas argumentit të Prokurorisë, apo thjesht ndërhyri duke iu referuar një urdhri të pretenduar nga lart, kur iu kërkua të zgjidhte një problem të vështirë personal. Prej dëshmive nuk mund të përcaktohet nëse ky incident i veçantë pasqyronte autoritet të vërtetë disiplinor apo thjesht ndikim personal të Fatmir Limajt, apo varej prej referimit të urdhrit të pretenduar nga lart.

[1956] Në intervistën e tij të mëparshme Ramadan Behluli deklaroi: "Megjithëse edhe Fatmir Limaj më nxiti pak…kur ne po udhëtonim gjatë rrugës, ai më pyeti se si ishte gjendja… unë po i thosha… dhe unë i thashë se si ishte gjendja, se policia vepronte akoma në Carralevë… Ai më tha pse nuk sulmoni… unë i thashë se nuk kisha marrë urdhra. Pastaj ai u përgjigj… ai më tha se në qoftë se unë shikoja një uniformë serbe, s'kishte rëndësi nëse ishte polic apo ushtar, ti vetë… mos pyet por sulmo.", Prova Materiale P121, f 43; Ramadan Behluli, T 2808-2810.
[1957] Ramadan Behluli, T 2809-2910.
[1958] Prova Materiale P121, ff. 23 dhe 28.
[1959] Fadil Kastrati, T 2616-2817.
[1960] Fadil Kastrati, T 2618.
[1961] Fatmir Limaj, T 6569-6572.

591. Ruzhdi Karpuzi dëshmoi se midis majit dhe korrikut 1998 ai ishte ushtar i UÇK-së në njësinë Çeliku 3 në Llapushnik.[1962] Gjatë dëshmisë së tij, ai përshkroi një ceremoni betimi për të cilën mban mend se ndodhi në fund të qershorit ose në fillim të korrikut 1998 në oborrin e Bali Vojvodës në Llapushnik.[1963] Sipas dëshmisë së Ruzhdi Karpuzit ushtarët zgjodhën një person të quajtur Çeliku për të mbajtur një fjalim. Thuhet se Çeliku foli për mbrojtjen e Kosovës me çdo mjet dhe për respektimin e popullatës civile pa dallim kombësie. Ky fjalim u mirëprit nga ushtarët megjithëse disa qeshën me sugjerimin se të gjithë civilët kishin të drejtë të trajtoheshin si të barabartë. Dëshmia e Ruzhdi Karpuzit në thelb është, se megjithëse një grup ushtarësh i thanë Çelikut të bëhej drejtuesi i tyre, ai refuzoi.[1964] Gjithashtu dëshmitari deklaroi se ai e pa Çelikun në Llapushnik dy ose tri herë gjatë betejave në periudhën midis ceremonisë së betimit dhe rënies së grykës në fund të korrikut 1998. Në atë periudhë Çeliku luftonte në vijën e frontit si ushtar i rregullt dhe njihej si Daja.[1965] Sipas dëshmisë së Ruzhdi Karpuzit ai dëgjoi që Çeliku u përmend si komandant vetëm dikur në vjeshtë, pas formimit të Brigadës 121.[1966] Ai nuk kishte dëgjuar asnjëherë që ai të kishte qenë komandant i Çelikut 1.[1967]

592. U zbuluan një sërë ndryshimesh materiale midis dëshmisë gojore të Ruzhdi Karpuzit dhe deklaratës së tij të mëparshme në korrik 2003.[1968] Ndryshimi i parë ka të bëjë me përgjigjen e Çelikut ndaj kërkesës së ushtarëve gjatë ceremonisë së betimit për të qenë drejtuesi i tyre. Deklarata e mëparshme e Ruzhdi Karpuzit tregon se fjalimi i Çelikut i frymëzoi ushtarët që t'a respektonin dhe të dëshironin që ai t'i udhëhiqte; shkurtimisht përgjigjja e Çelikut ishte se ai ishte i gatshëm t'i udhëhiqte në qoftë se ata do të respektonin çfarë kishte thënë ai.[1969] Mirëpo në deklaratë nuk ka ndonjë fakt për ushtarët që qeshën me fjalët e Çelikut. Ndryshimi i dytë midis dëshmisë gojore të dëshmitarit dhe deklaratës së tij të mëparshme ka të bëjë me kohën kur ai mësoi për komandant Çelikun. Në gjyq Ruzhdi Karpuzi deklaroi se ai dëgjoi njerëz që e përmendnin Çelikun si komandant Çeliku dikur në shtator, tetor, nëntor 1998, pas formimit të brigadës 121.[1970] Në deklaratën e mëparshme Ruzhdi Karpuzi tha se kjo ishte pas ceremonisë së betimit, pa saktësuar ndonjë datë.[1971] Mospërputhja e tretë lidhet me praninë dhe rolin e Çelikut në ato pak raste që ai vizitoi Llapushnikun pas ceremonisë së betimit dhe para rënies së grykës më 26 korrik 1998.

[1962] Ruzhdi Karpuzi, T 3078-3081.
[1963] Ruzhdi Karpuzi, T 3098; 3175; Dëshmitari e shënoi vendndodhjen e oborrit me "X" në Provën Materiale P128.
[1964] Ruzhdi Karpuzi, T 3103-3107.
[1965] Ruzhdi Karpuzi, T 3104-3106; 3139-3140; 3200.
[1966] Ruzhdi Karpuzi, T 3106-3107.
[1967] Ruzhdi Karpuzi, T 3278.
[1968] Prova Materiale P136. Në shkurt 2005, pak para se të dëshmonte, Ruzhdi Karpuzi shqyrtoi deklaratën e vetë dhe propozoi disa korigjime, asnjë prej të cilëve nuk kishte ndikim material mbi çështjet në fjalë, Prova Materiale P137.
[1969] Ruzhdi Karpuzi, T 3125-3130; Prova Materiale P136, paragrafi 11.
[1970] Ruzhdi Karpuzi, T 3106-3107; 3137-3138; 3192-3199.

Deklarata e Ruzhdi Karpuzit sugjeron se Çeliku erdhi të vizitonte ushtarët në pozicionet e luftimit për të parë si shkonte hapja e llogoreve.[1972] Kjo fare mirë mund të nënkuptojë pozitën udhëheqëse të Çelikut, e cila nuk përmendet në dëshminë gojore të Ruzhdi Karpuzit, ku ai thjesht e cilëson atë si ushtar të zakonshëm duke luftuar përkrah të tjerëve në vijën e frontit.[1973]

593. Rëndësi ka edhe dëshmia e L95-ës se në fund të korrikut 1998, me urdhër të komandantit të njësisë së tij, L95 dhe ushtarë të tjerë shkuan në Novosellë për të ndihmuar forcat e komandant Çelikut të cilat kishin të ngjarë të sulmoheshin prej forcave serbe.[1974] L95 tregoi se po atë ditë, ose ndoshta të nesërmen, anëtarët e njësisë së tij e takuan komandant Çelikun afër një shkolle në Novosellë në drejtim të Divjakës.[1975] Sipas dëshmisë së L95-ës, komandant Çeliku e thirri L95-ën me pseudonim, e ngarkoi me komandën e njësisë në mungesë të drejtuesit dhe i tha se ai mund të vinte te shtabi në Kleçkë po të kishte nevojë.[1976] L95 dëshmoi se ai e dinte se personi ishte komandant Çeliku sepse ai tha, "ne ishim nën komandën e Çelikut. Ne shkuam atje në ndihmë të atyre. Kështu që kur ai erdhi të [na] takonte, e dinim se ishte komandant Çeliku." [1977]Gjithashtu L95 dëshmoi se në atë kohë komandant Çeliku ishte "komandant zone".[1978] Mirëpo njohuritë e kufizuara të L95-ës në lidhje me këtë aspekt të veçantë të dëshmisë së tij, duke përfshirë edhe kufijtë se asaj zone të pretenduar, ishin shumë të dukshme. Vetë L95 e pranoi se ai ishte i paqartë për kufijtë e zonës për të cilën thotë se ishte nën komandën e Çelikut[1979] dhe dëshmia e tij në lidhje me këtë nuk ishte veçse mendimi i tij në atë kohë, bazuar në çfarë kishte dëgjuar në transmetimet e televizionit dhe të radios dhe prej përshtypjeve të tija si anëtar i UÇK-së në një njësi fqinje.[1980] Dëshmia e L95-ës në lidhje me takimin me komandant Çelikun në Novosellë, sigurisht sugjeron se në atë moment të veçantë, komandant Çeliku kishte pozitë eprore mbi L95-ës. Mirëpo nga vetë dëshmia e L95-ës del lehtësisht se kjo ishte për shkak se njësia e tij ishte urdhëruar të shkonte në ndihmë të njësisë së Çelikut ndaj sulmit të pritshëm prej forcave serbe në atë kohë. Në këtë mënyrë ai u vu nën komandën e Çelikut. Dhoma ka mendimin se kjo dëshmi nuk tregon se komandant Çeliku kishte pozitë komanduese dhe eprore e cila shtrihej gjeografikisht përtej komandës së njësisë së tij lokale.

[1971] Prova Materiale P136, paragrafi 6.
[1972] Ruzhdi Karpuzi, T 3178-3182; Prova Materiale P136, paragrafi 12.
[1973] Ruzhdi Karpuzi, T 3104-3106; 3139-3140; 3178-31881; 3200.
[1974] L95, T 4203-4209.
[1975] L95, T 4213-4214.
[1976] L95, T 4214-4215.
[1977] L95, T 4215.
[1978] L95, T 4217.
[1979] L95, T 4218; 4221.
[1980] L95, T 4218.

594. Gjithashtu Prokuroria kërkon të mbështetet në një sërë intervistash të dhëna prej Fatmir Limajt dhe anëtarëve të tjerë të UÇK-së në momente të ndryshme kohore. Në një dokumentar televiziv të RTK-së (Radio Televizioni i Kosovës) mbi UÇK-në prodhuar pas luftës, ndoshta në 2002,[1981] Skënder Shala, ish-anëtar i UÇK-së, i cili nuk u thirr si dëshmitar, shpjegoi se më 9 maj 1998, ai shkoi në Llapushnik dhe pa një pizgauer ("Pinzgauer") të forcave serbe i cili ishte sulmuar nga "njësia Çeliku" dhe ishte në flakë.[1982] Në këtë kontekst Skënder Shala e përmendi dy herë "komandant Çelikun".[1983] Po të pranohet se kur përmendet Çeliku është fjala për Fatmir Limajn, gjë për të cilën mungojnë prova të drejtpërdrejta, kjo pjesë mund të interpretohej si tregues se në atë kohë Fatmir Limaj ushtronte një farë komande, të paktën mbi njësinë "Çeliku" në Llapushnik. Natyrisht që kjo është tërësisht në përputhje me dëshmi të dhëna më parë dhe me vetë dëshminë e Fatmir Limajt, se atë ditë ai shkoi në Llapushnik për të ndihmuar në luftime bashkë me ushtarë të tjerë nga Kleçka.[1984]

595. Gjithashtu duhet theksuar se ky është dokumentar pas ngjarjes. Si i tillë mund të mos pasqyrojë besnikërisht hollësi të sakta faktike. Për shembull shqyrtimi i krejt intervistës zbulon se Fatmir Limaj herë përmendet si "Daja", herë si "Çeliku", apo "komandant Çeliku", ose "komandant Limaj";[1985] megjithëse konteksti i dokumentarit lidhet qartësisht me periudhën maj deri në korrik 1998, ushtarët e tij, herë përmenden si të "njësisë Çeliku" apo të "Brigadës 121".[1986] Përmendja pas ngjarjes në 2002 e Fatmir Limajt si komandant nuk ndihmon në përcaktimin nëse në mes të vitit 1998, ai, siç e pranon edhe vetë, ishte komandant i njësisë Çeliku 1 me bazë në Kleçkë, apo komandant rajoni ose zone siç pretendohet nga Prokuroria. Pavarësisht sugjerimit në këtë dokumentar, Brigada 121 nuk ishte formuar në kohën që ka lidhje me Aktakuzën. Prokuroria mbështetet edhe në një intervistë të dhënë nga Fatmir Limaj për gazetën Zëri i Kosovës në shtator 1998.[1987] Duke kujtuar suksesin e UÇK-së në Llapushnik, gazetari sugjeron se atje ishte në "komandë" Fatmir Limaj.[1988] Përgjigjja e Fatmir Limajt nuk e mohon këtë sugjerim, por as nuk e konfirmon. Ai përmend vetëm "shpirtin luftarak të tri njësive tona",[1989] që përputhet me dëshminë e tij dhe dëshmitë e tjera të përmendura më parë se tri njësi shkuan nga Kleçka, ose me dëshmitë se UÇK-ja kishte më shumë se një komandant gjatë operacionit të përshkruar.

[1981] Fatmir Limaj, T 6197.
[1982] Prova Materiale P34, f 8.
[1983] Prova Materiale P34, ff 8 dhe 9.
[1984] Fatmir Limaj, T 5936-5938. Në veçanti Fatmir Limaj iu referua incidentit me Pinzgauerin dhe deklaroi se grupi i ushtarëve të UÇK-së ishte me fat që e goditi atë, sepse kjo shërbeu si shkak që forcat serbe të tërhiqeshin. T 5936-5938.
[1985] Prova Materiale P34, ff. 8; 11; 12-13 dhe 14.
[1986] Prova Materiale P34, ff. 8 dhe 11.
[1987] Prova Materiale P44.
[1988] Prova Materiale P44, f. 2.
[1989] Prova Materiale P44, f. 2.

596. Një dëshmitar tjetër i Prokurorisë, Sylejman Selimi dëshmoi se ai u emërua komandant i zonës së parë operative në zonën e Drenicës në fund të majit 1998.[1990] Sylejman Selimi dëshmoi se në këtë cilësi, ai ishte përgjegjës për organizimin e njësive të ndryshme në brigadë, njësi të cilat në atë kohë vepronin pak a shumë në mënyrë të pavarur.[1991] Sipas dëshmisë së tij, zona e Drenicës ishte në veri të rrugës kryesore Prishtinë-Pejë, por përfshinte Llapushnikun. Mirëpo prej dëshmisë së tij në përgjithësi duket se bëhet fjalë për atë pjesë të fshatit Llapushnik në veri të rrugës, dhe jo në pjesën jugore ku ndodhej kamp-burgu dhe se rruga kryesore përmes Llapushnikut ishte aktualisht kufiri i zonës.[1992] Një aspekt i rëndësishëm i dëshmisë gojore të Sylejman Selimit është se nga maji deri në korrik 1998, mbi njësitë Çeliku nuk ishte një komandë apo komandant i vetëm, por njësitë luftonin të pavarura prej njëra-tjetrës.[1993] Sylejman Selimi theksoi se arsyeja që ai deklaroi në një intervistë të mëparshme me Prokurorinë se Fatmir Limaj ishte komandant i njësive Çeliku është sepse pyetja në atë kohë lidhej me veprimtarinë e UÇK-së në 1998 dhe 1999 dhe në atë kohë ai nuk ishte i përgatitur mjaftueshmërisht që të ishte në gjendje të dallonte ndryshimet strukturore në momente të ndryshme kohore.[1994] Ai dëshmoi në gjyq se ai e njohu Fatmir Limajn si komandant Çeliku vetëm gjatë formimit të Brigadës 121.[1995]

597. Kjo dëshmi konfirmohet për pjesën më të madhe prej dëshmisë së Jakup Krasniqit, i cili dëshmoi se për kohën që ka lidhje me këtë proces, në rajonin që u bë zona e Pashtrikut nuk kishte komandant të përgjithshëm. Sipas dëshmisë së tij, komandant i zonës së Pashtrikut u emërua Musë Jashari në korrik 1998.[1996] Dëshmia e Jakup Krasniqit është se në atë kohë Fatmir Limaj ishte komandant i një njësie në Kleçkë.[1997]

598. Në mbështetje të argumentit se në kohën që ka lidhje me këtë Aktakuzë Fatmir Limaj ishte komandant i njësisë Çeliku 1 në Kleçkë, u thirrën dëshmitarë të Mbrojtjes. Këtë e dëshmoi edhe Fatmir Limaj. Ai shpjegoi se në mars dhe prill 1998 në Kleçkë ishin vetëm tre persona, përkatësisht Haxhi Shala, Ismet Jashari me pseudonimin Kumanova dhe ai vetë.[1998] Fatmir Limaj përshkroi se në fund të prillit 1998, Rexhep Selimi pruri dy radio dhe në atë kohë u vendos që Fatmir Limaj të përdorte për thirrje sinjalin ose kodin Çeliku 1, kurse Ismet Jashari, Çeliku 2; sipas dëshmisë së

[1990] Sylejman Selimi, T 2071.
[1991] Sylejman Selimi, T 2076.
[1992] Sylejman Selimi, T 2086-2090; 2149-2150; Sylejman Selimi konfirmoi kufijtë e zonës së Drenicës dhe Pashtrikut ashtu siç paraqiten në Provën Materiale P1, harta 10. *Shih* gjithashtu *më sipër,* paragrafët 57-63.
[1993] Sylejman Selimi, T 2155-2156.
[1994] Sylejman Selimi, T 2156-2157.
[1995] Sylejman Selimi, T 2163-2164.
[1996] Jakup Krasniqi, T 3479-3481.
[1997] Jakup Krasniqi, T 3402.
[1998] Fatmir Limaj, T 5925-5926.

Fatmir Limajt kështu u njoh ai si Çeliku dhe njësia e tij si Çeliku 1.[1999] Gjithsesi ai dëshmoi se në atë kohë ai njihej nga ushtarët si Daja.[2000] Fatmir Limaj e mohoi se kishte koordinuar nga Kleçka veprimet për marrjen e Llapushnikut në maj 1998 dhe në përgjithësi ndihmën midis njësive të ndryshme gjatë luftimeve në qershor dhe korrik 1998.[2001] Rezultati i dëshmisë së tij është se në maj 1998, i vetmi mekanizëm institucional ishte Shtabi i Përgjithshëm dhe nuk kishte nivel të ndërmjetëm komande midis Shtabit të Përgjithshëm dhe njësive të ndryshme.[2002] Fatmir Limaj tregoi se në muajt qershor dhe korrik 1998 ai shkoi shpesh në Llapushnik, deri në njëzet herë, ndonjëherë rrugës për në Likoc.[2003] Së fundi dëshmia e Fatmir Limajt është se ai nuk u bë kurrë komandant i zonës së Pashtrikut; por në fillim të korrikut 1998 Shtabi i Përgjithshëm emëroi Musë Jasharin si komandant të asaj zone.[2004]

599. Dëshmia e Fatmir Limajt mbështetet prej dëshmive të Rexhep Selimit, Bislim Zyrapit dhe Elmi Sopit. Rexhep Selimi dëshmoi se gjatë kohës që ka lidhje me këtë gjyq, Fatmir Limaj e kishte bazën në Kleçkë dhe ishte në krye të një njësie të quajtur Çeliku 1.[2005] Rexhep Selimi konfirmoi dëshminë e Fatmir Limajt se emri Çeliku 1 ishte kod për komunikim me radio.[2006] Sipas dëshmisë së Rexhep Selimit, midis prillit dhe gushtit 1998, Fatmir Limaj nuk kryente detyra të përgjithshme për koordinimin e njësive të UÇK-së në zonë dhe as nuk kishte autoritetin për këtë.[2007] Edhe Bislim Zyrapi dëshmoi se në qershor 1998 Fatmir Limaj ishte anëtar i një njësie me bazë në Kleçkë dhe i gatshëm për ndërhyrje përgjatë pozicioneve në malet e Berishës; mirëpo në atë kohë zona e përgjegjësisë së Fatmir Limajt nuk shtrihej përtej njësisë në Kleçkë.[2008] Gjithashtu Bislim Zyrapi dëshmoi se, sipas tij, në komandë të Llapushnikut ishte Ymer Alushani, me pseudonimin Vogëlushi, dhe jo Fatmir Limaj.[2009] Gjithashtu edhe Elmi Sopi dëshmoi se ai nuk dëgjoi asnjëherë që Fatmir Limaj jepte urdhra në Llapushnik dhe e pa atë atje vetëm gjatë luftimit.[2010]

600. Gjithashtu Dhoma disponon një tërësi dëshmish nga dëshmitarë të mbajtur më parë në kamp-burgun e Llapushnikut dhe të cilët pretendojnë se kanë identifikuar praninë e Fatmir Limajt

[1999] Fatmir Limaj, T 5935-5936; 5938-5939; 6255.
[2000] Fatmir Limaj, T 5938-5939.
[2001] Fatmir Limaj, T 5946-5948; 6286-6287.
[2002] Fatmir Limaj, T 5950-5951; 6277-6278. Fatmir Limaj e hodhi poshtë sugjerimin e Prokurorisë se ekzistonte një hierarki komande nga Likoci në Kleçkë dhe në Kroimir midis majit dhe korrikut 1998 dhe se Fatmir Limaj u jepte urdhra Shukri Bujës dhe Ramiz Qeriqit, T 6264-6266.
[2003] Fatmir Limaj, T 5972-5974.
[2004] Fatmir Limaj, T 5963-5967.
[2005] Rexhep Selimi, T 6597-6598.
[2006] Rexhep Selimi, T 6694-6695.
[2007] Rexhep Selimi, T 6593-6595; 6669-6673; 6693-6694.
[2008] Bislim Zyrapi, T 6825-6826.
[2009] Bislim Zyrapi, T 6826.
[2010] Elmi Sopi, T 6728.

në kamp dhe ushtrimin prej tij të një farë autoriteti mbi funksionimin e tij. Këto dëshmi janë shqyrtuar me hollësi më herët në këtë vendim dhe për arsye të përmendura më herët Dhoma nuk mund të nxirrte përfundimin se i Akuzuari Fatmir Limaj ishte identifikuar në mënyrë të besueshme si personi të cilin këta dëshmitarë panë në kamp-burgun e Llapushnikut.[2011]

601. Për arsyet e identifikuara në paragrafët e mëparshëm Dhoma nuk mund të bindet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Prokuroria ka provuar se në periudhën nga maji deri më 26 korrik 1998, i Akuzuari Fatmir Limaj ishte në pozitë komanduese në UÇK ku përfshihej edhe komanda e ushtarëve të UÇK-së në fshatin Llapushnik apo në veçanti në kamp-burg i cili në atë kohë ndodhej në pjesën jugore të fshatit. Kjo vlen si në lidhje me çdo pjesë dëshmie përkatëse të shqyrtuar veças ashtu edhe për dëshmitë të marra në tërësi. Siç është përmendur, edhe pse prej dëshmive duket se ekziston një gjasë e fortë se Fatmir Limaj vepronte si komandant në kamp-burg në kohën që ka lidhje me këtë Aktakuzë, roli dhe detyra e Dhomës mbeten të qarta. Ajo duhet të vendosë nëse Prokuroria ka mundur të provojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm akuzën se Fatmir Limaj ushtroi komandë ligjore ose faktike, ose kontroll efektiv në kamp-burg, mbi ushtarët e UÇK-së që administronin kampin ose mbi rojat e UÇK-së të cilët shoqëruan të burgosurit e mbetur nga kamp-burgu për në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998. Përfundimi i Dhomës, pas një analize përfundimtare shumë të kujdeshme, është se dëshmitë nuk i provojnë këto pika thelbësore në nivelin e kërkuar, d.m.th. jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

602. Pasi janë shqyrtuar të gjitha pikat në lidhje me të Akuzuarin Fatmir Limaj të përmendura më herët dhe pas shqyrtimit edhe të akuzës së ndërmarrjes së përbashkët kriminale, Prokuroria nuk ka provuar se Fatmir Limaj është fajtor për ndonjë prej akuzave të ngritura në Aktakuzë, si në bazë të Nenit 7(1) po ashtu edhe në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit.

2. Përgjegjësia e Haradin Balës

(a) A u identifikua Haradin Balaj në kamp-burgun e Llapushnikut?

603. Prokuroria në Aktakuzë pretendon se Haradin Bala, me pseudonimin Shala, dhe kjo nuk kundërshtohet, mori pjesë personalisht në zbatimin e burgimit të civilëve serbë dhe shqiptarëve kosovarë të konsideruar si bashkëpunëtorë, në kamp-burgun e Llapushnikut, në marrjen në pyetje të të burgosurve të kampit dhe në trajtimin e tyre të egër dhe çnjerëzor. Gjithashtu pretendohet se Haradin Bala mori pjesë në vrasjen e disa të burgosurve në kamp dhe vrasjen e të tjerëve në malet e

[2011] *Shih më sipër,* paragrafët 530-562.

Berishës.[2012] Mbrojtja e Haradin Balës i mohon këto akuza dhe në veçanti argumenton se roja i burgut i përmendur në dëshmi si Shala, nuk është i Akuzuari Haradin Bala.[2013]

604. Njëri prej të burgosurve të kamp-burgut të Llapushnikut, Vojko Bakraçi, dëshmoi se ai e takoi Shalën në kamp disa herë. Ai e përshkroi Shalën si person të moshës 45-50 vjeç, afërsisht të njëjtën shtatlartësi me Vojko Bakraçin, me flokë të errët dhe mustaqe të zeza.[2014] Sipas dëshmisë së Vojko Bakraçit, Shala mbante një kapelë kuqezi me shenjën e UÇK-së.[2015] Vojko Bakraçi dëshmoi se Shala ishte rojë i cili u çonte ushqim dhe cigare të burgosurve.[2016] Vojko Bakraçi dëshmoi se kur iu kërkua prej "komandantit" të jepte një deklaratë për kushtet në kamp, djali i tij Ivani përmendi se ai kishte luajtur shah me Shalën.[2017] Dëshmitari deklaroi se foli me Shalën. Gjatë këtyre bisedave Vojko Bakraçi e shikoi Shalën drejtpërsëdrejti.[2018] Mirëpo në një intervistë me hetuesit e UNMIK-ut në janar 2002, dëshmitari nuk identifikoi askënd prej një flete me fotografi që iu tregua. Midis tetë fotografive ishte edhe fotografia e Haradin Balës.[2019] Dhoma nënvizon se në provën materiale fytyra e Haradin Balës thuajse nuk shquhet, fakt që ndoshta shpjegon mosidentifikimin e fotografisë së Haradin Balës, mirëpo meqë prej dëshmisë nuk është e qartë nëse prova materiale e paraqitur në gjyq ishte ajo që iu tregua Vojko Bakraçit, apo thjesht një kopje e mëvonshme e keqe e saj, Dhoma nuk mund të arrijë në një përfundim mbi këtë mosidentifikim. Gjatë tërë dëshmisë së tij Vojko Bakraçi foli për Shalën, emri që ai njihte në kamp. Gjatë dëshmisë së tij ai e identifikoi këtë Shalë në sallën e gjyqit. Rrjedhimisht është e nevojshme që Dhoma të shqyrtojë edhe sugjerimin e Mbrojtjes se ndoshta gjatë periudhës në fjalë në Llapushnik ishte edhe një anëtar tjetër i UÇK-së me emër ose pseudonimin Shala. Po të jetë kështu përmendja e Shalës prej dëshmitarëve, jo domosdoshmërisht është e lidhur me Haradin Balën. Kjo shqyrtohet me hollësi më vonë në këtë vendim.

605. Djali i Vojko Bakraçit, Ivani, i cili gjithashtu u mbajt në Llapushnik njëkohësisht me babain e tij, dëshmoi se Shala ishte i moshuar, me shtatlartësi mesatare dhe me mustaqe.[2020] Duket se Shala i pati lënë mbresa të mira Ivan Bakraçit. Ai e përshkroi Shalën si njeri të mirë, i cili u sillte ushqim dhe sende të tjera.[2021] Sipas dëshmisë së tij, Shala ishte ai që ua hapte derën.[2022] Ivan Bakraçi

[2012] Aktakuzë, paragrafi 12.
[2013] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 610.
[2014] Vojko Bakraç, T 1330-1332.
[2015] Vojko Bakraç, T 1372-1374.
[2016] Vojko Bakraç, T 1330-1332.
[2017] Vojko Bakraç, T 1347.
[2018] Vojko Bakraç, T 1332; 1377.
[2019] Fakt i pranuar,Vojko Bakraç, T 1371; Prova Materiale DB1 (fleta me fotografi A2).
[2020] Ivan Bakraç, T 1439-1441.
[2021] Ivan Bakraç, T 1439-1441.

dëshmoi se ai nuk e pa asnjërherë Shalën duke rrahur dikë dhe se ai sillej përgjithësisht me respekt ndaj dëshmitarit dhe babait të tij.[2023] Gjithashtu ai përmendi rastin kur luajti shah me Shalën.[2024] Në ndryshim nga i ati, Ivan Bakraçi nuk pati vështirësi ta identifikonte Shalën prej një flete fotografish. Ai identifikoi një fotografi të Haradin Balës si personi të cilin e njihte si Shala. Ai deklaroi se gjatë një interviste me hetuesin e Prokurorisë në janar 2003, ai e njohu "menjëherë" Shalën në rreshtin e fotografive.[2025] Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja Ivan Bakraçi pohoi se gjatë asaj interviste ai nuk kishte përmendur se kishte luajtur shah me Shalën.[2026] Gjithsesi Dhoma nuk i jep rëndësi kësaj mospërmendjeje meqë shumë lehtë mund të shpjegohej prej kohës së shkurtër të intervistës dhe për shkak se një lojë shahu zor se ishte çështje kyçe në ngjarjet e Llapushnikut.[2027] Në të vërtetë Ivan Bakraçi në dëshminë e tij e përshkroi Shalën me trup "të fortë". Këtë e tha edhe në intervistën e mëparshme. Në dëshminë e tij dëshmitari shtoi se Shala ishte "ndër ata që janë të bëshëm", përshkrim i cili përputhet së paku me pamjen e tij të tanishme.[2028] Trup i fortë nuk përputhet me pamjen e tanishme të Haradin Balës. Përshkrimet e dëshmitarëve mbi ndërtimin trupor të Shalës ndryshojnë disi nga "më shumë thatanik" në "më i trashë se" personi që e përshkruante.[2029] Rrjedhimisht çështja e ndërtimit trupor të Haradin Balës për kohën në fjalë është e paqartë, por duket se dëshmitarët kanë patur përshtypje të ndryshme. Ashtu si edhe në dëshminë e babait të tij, gjatë dhënies së dëshmisë Ivan Bakraçi nuk u pyet nëse ai mund ta identifikonte Haradin Balën në sallën e gjyqit si personi të cilin e njihte si Shala. Natyrisht që ai e identifikoi pa mëdyshje një fotografi të Haradin Balës si Shala prej një flete me fotografi.

606. Një i burgosur tjetër, L04, dëshmoi se ai e pa Shalën në kamp-burg disa herë. Në dëshminë e tij Shala ishte afërsisht 45 vjeç, me shtatlartësi 170-175 cm, flokë të zinj, mustaqe dhe dhëmbë të nxirë.[2030] L04 deklaroi se pas luftës ai mësoi se emri i vërtetë i Shalës ishte Haradin Bala.[2031] Nuk ka dëshmi mbështetëse nga ai burim informacioni për emrin e Shalës kështu që Dhoma nuk i kushton rëndësi. Sipas dëshmisë së L04-ës, Haradin Bala ishte rojë në burg, i cili ishte i pranishëm gjithmonë atje gjatë 28 ditëve të burgimit të dëshmitarit në Llapushnik. Haradin Bala i solli ushqim

---

[2022] Ivan Bakraç, T 1457.
[2023] Ivan Bakraç, T 1457.
[2024] Ivan Bakraç, T 1456.
[2025] Ivan Bakraç, T 1464-1466. Një kopje e fletës me fotografi është provë (Prova Materiale P83; T 1466). Janë tetë fotografi bardhezi, mjaft të qarta. Haradin Bala është numri 8. Sipas mendimit të Dhomës fotografia nr. 8 është e ngjashme me Haradin Balën.
[2026] Ivan Bakraç, T 1554-1555.
[2027] Prokuroria e kundërshtoi taktikën e pyetjeve nga Mbrojtja në lidhje me këto mospërmendje, duke vënë në dukje se deklarata e mëparshme ishte ndoshta 11 faqe e gjatë, T 1553.
[2028] Ivan Bakraç, T 1557.
[2029] L12, T 1811-1812; L06, T 1001-1002.
[2030] L04, T 1179.

dhe cigare L04-ës.[2032] Mbrojtja e Haradin Balës thekson se kur dëshmitari u pyet në tetor 1998 prej autoriteteve serbe në lidhje me ngjarjet në kamp-burg ai nuk përmendi Shalën apo Haradin Balën, megjithëse përmendi ushtarë të tjerë të UÇK-së të cilët i hasi në Llapushnik.[2033] Mungesa e përmendjes së Shalës në deklaratën e L04-ës për autoritetet serbe nuk është e habitshme kur merret parasysh rrallësia e emrave të UÇK-së në tekst. Njerëzit e përfshirë në UÇK përmenden gjatë tërë deklaratës si "anëtarë të UÇK-së" veç dy personave të cilët përmenden me pseudonim. Emrat e vetëm që shihen në deklaratë, janë të të burgosurve.[2034] Dhoma vlerëson se mungesa e përmendjes së Shalës apo Haradin Balës në deklaratë ka pak ndikim në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmisë së L04-ës lidhur me të Akuzuarin.

607. Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, dëshmitari pranoi se përshkrimi i Haradin Balës prej tij në gjyq ndryshonte nga ai i dhënë në deklaratën e parë të dëshmitarit për Prokurorinë, në faktin se atëherë ai tha se Haradin Bala ishte i gjatë 180-185 cm.[2035] Gjithashtu L04 nuk njohu askënd në nje fletë me gjashtë fotografi ku ishte një fotografi e Haradin Balës, kur u pyet prej hetuesve të CCIU-së në 2002.[2036] Fleta me fotografi nuk përfshihet në prova kështu që Dhoma nuk mund të përcaktojë nëse fotografia e Haradin Balës ishte e një cilësie të mirë dhe nëse ngjashmëria ishte e madhe. Mirëpo në gjyq dëshmitari e identifikoi të Akuzuarin Haradin Bala si personi të cilin e kishte njohur në kamp-burg si Shala.[2037] Gjithashtu ai bëri të qartë se njeriu të cilin e përmendi si Shala gjatë dëshmisë së tij, ishte Haradin Bala dhe e hodhi poshtë sugjerimin e Mbrojtjes se ai ngatërroi dikë tjetër me Haradin Balën.[2038] L04 dëshmoi se kur ishte në kamp, ai e pa Shalën çdo ditë[2039] dhe duke marrë parasysh kohëzgjatjen e burgimit të dëshmitarit, kjo i dha atij mundësi të konsiderueshme për vëzhgim nga afër, fakt që mund të përforconte besueshmërinë e identifikimit të tij të mëvonshëm, mirëpo mbetet i pashpjeguar mosidentifikimi i fotografisë prej tij në 2002. Dhoma Gjyqësore është mjaft e ndërgjegjshme për mundësinë e gabimeve në identifikimet në gjyq.[2040] Në këtë rast mundësia e gabimit mund të ishte edhe më e madhe sepse L04 e kishte parë Haradin Balën në televizion para se të dëshmonte.[2041] Duket se dëshmitari e ka parë Haradin Balën në televizion në lidhje me këtë proces gjyqësor, d.m.th. pasi dha intervistën e parë. Duke marrë parasysh

---

[2031] L04, T 1180-1881; 1238-1241.
[2032] L04, T 1177-1179.
[2033] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 680-681; 687; Prova Materiale P203.
[2034] Prova Materiale P203.
[2035] L04, T 1241-1243.
[2036] Fakt i pranuar; T 1370.
[2037] L04, T 1180-1181.
[2038] L04, T 1241-1243.
[2039] L04, T 1177.
[2040] *Shih më sipër,* paragrafin 18.

mosidentifikimin e fotografisë së Haradin Balës prej L04-ës gjatë intervistës së parë, identifikimi në gjyq është i vetmi identifikim prej këtij dëshmitari.

608. Edhe L07 i cili u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut, dëshmoi se ai e pa Shalën në kamp në 1998. Dëshmitari dëshmoi se në atë kohë Shala kishte flokë dhe mustaqe të njëjtë me kohën e dëshmisë së L07-ës në gjyq.[2042] Sipas dëshmisë së L07-ës një ditë Shala kishte veshur këmishë të kuqe dhe pantallona të zeza dhe mbante një automatik në dorë.[2043] L07 deklaroi se Shala ishte rojë burgu dhe kujdesej për të burgosurit.[2044] Dëshmitari dëshmoi se Haradin Bala sillej mjaft mirë me të burgosurit.[2045] Gjatë dëshmisë së tij, L07 e përmendi ndonjëherë Haradin Balën si "komandant Shala".[2046] Gjithsesi ai bëri të qartë se e kishte fjalën për Haradin Balën.[2047]

609. L07 deklaroi se ai e mësoi emrin e vërtetë të Shalës nga vetë Haradin Bala në 1999, kur ata u takuan në një pike shitje karburanti.[2048] Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, L07-ës iu tha se ai nuk e kishte përmendur këtë takim me Haradin Balën gjatë intervistave të tij me hetuesit e UNMIK-ut apo të Tribunalit, përkatësisht në 2002 dhe 2003. Dëshmitari shpjegoi se ai nuk ishte pyetur konkretisht në lidhje me atë pikë.[2049] Deklarata e L07-ës gjatë intervistës me UNMIK-un është më pak se dy faqe dhe aty Haradin Bala përmendet vetëm një herë,[2050] kështu që është e kuptueshme mospërmendja e rrethanave sesi L07 mësoi emrin e vërtetë të Shalës. Gjithsesi intervista me UNMIK-un në 2003 ishte shumë më e hollësishme se më parë. Gjatë saj u ngrit çështja e zbulimit të emrit të Shalës. L07 përshkroi takimin e parë me Shalën dhe deklaroi se "më pas" mësoi emrin e tij të vërtetë.[2051] Nuk u përmendën rrethanat në lidhje me këtë. L07 e shpjegoi mospërmendjen konkrete të takimit në pikën e shitjes së karburantit me arsyen se hetuesit nuk e pyetën.[2052] Dhoma thekson se kjo harresë e hetuesve është disi e habitshme duke marrë parasysh rëndësinë e çështjes së identifikimit të Shalës. Mirëpo ajo pranon se çështja u la mbi bazën se L07 e mësoi emrin e vërtetë të Shalës më pas. Ndërkohë që nuk do të kishte qenë e habitshme që L07 t'u kishte treguar hetuesve si e mësoi emrin e vërtetë të Shalës, Dhoma nuk i kushton rëndësi kësaj harrese në asnjë

[2041] L04, T 1241.
[2042] L07, T 809.
[2043] L07, T 809.
[2044] L07, T 808-810.
[2045] L07, T 832.
[2046] L07, T 795-796; 810.
[2047] L07, T 811.
[2048] L07, T 810.
[2049] L07, T 895.
[2050] Prova Materiale P70.
[2051] Prova Materiale P71, paragrafi 15.
[2052] L07, T 895.

prej intervistave që ai dha para se të dëshmonte. L07 refuzoi menjëherë një sugjerim tjetër të pritshëm të Mbrojtjes së Haradin Balës, sugjerim i pambështetur apo i papërsëritur më tej në prova, se takimi në pikën e karburantit nuk kishte ndodhur.[2053] Edhe pse L07 nuk e përmendi takimin e mëvonshëm me Shalën në një pikë karburanti në asnjërën prej intervistave të tija të mëparshme, duke marrë parasysh rrethanat e çdo interviste, Dhoma bën të qartë se ajo nuk gjykon se L07 nuk e mbante mend takimin me Haradin Balën në pikën e karburantit kur ai dha dy intervistat e mëparshme, apo se ky takim ishte "sajesë e kohëve të fundit" e L07-ës. Gjithashtu Dhoma thekson se dëshmia nuk sugjeron se L07 pati vështirësi për ta njohur Shalën në pikën e karburantit.

610. Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, L07 deklaroi se ai e pa Haradin Balën në televizion kur filloi gjyqi.[2054] Pra ekziston një mundësi që identifikimi në gjyq i Haradin Balës nga L07 të jetë i gabuar, jo vetëm prej ndikimit të mjedisit të sallës gjyqësore në të cilën Haradin Bala ishte i Akuzuar, por edhe prej pamjeve televizive të para nga L07. Dëshmitari u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut për tri ditë,[2055] kështu që mundësitë e tij për të vëzhguar ishin më të kufizuara se të dëshmitarëve të tjerë. Prej dëshmive nuk tregohet nëse L07-ës iu kërkua të identifikonte Shalën prej fotografive. Dhoma arrin në përfundimin se L07 ishte i ndershëm dhe mjaft i qartë në identifikimin prej tij të Haradin Balës si Shala, por për arsyet e përmendura Dhoma duhet të jetë e kujdesshme për besueshmërinë e identifikimit.

611. L10 u mbajt afërsisht një muaj e gjysëm në kamp-burgun e Llapushnikut.[2056] Duket se sipas dëshmisë së tij Shala ishte 40-50 vjeç dhe afërsisht 180-200 cm i gjatë. Dëshmitari deklaroi se Shala kishte mustaqe dhe se flokët i kishte paksa të thinjur. Dhëmbët e Shalës ishin pak të nxirë dhe i mungonin disa dhëmbë të përparmë. L10 dëshmoi se Shala mbante tuta/trajnerka, ndonjëherë pantallona, dhe se mbante gjithmonë automatik.[2057] Shala u sillte të burgosurve ushqim dhe ndonjëherë ujë.[2058] Ai kishte çelësat.[2059] Gjatë tërë dëshmisë së tij L10 përdori pseudonimin Shala për personin për të cilin mendonte se ishte Haradin Bala. L10 deklaroi se ai e mësoi emrin e vërtetë të Shalës nga dy individë,[2060] të cilët ishin dëshmitarë në këtë gjyq, L12 dhe L96. Besueshmëria e dijenisë së tyre se Shala ishte Haradin Bala mund të vlerësohet duke marrë parasysh përfundimet e

[2053] L07, T 899.
[2054] L07, T 899.
[2055] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[2056] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[2057] L10, T 2947.
[2058] L10, T 2920-2922.
[2059] L10, T 2998.
[2060] L10, T 2947-2948.

Dhomës në lidhje me dëshmitë e tyre. Siç do të tregohet asnjëra prej tyre nuk ishte pa të meta.[2061] Rrjedhimisht besueshmëria e burimit të dëshmisë së L10-ës se emri i vërtetë i Shalës është Haradin Bala është më pak se bindëse. Gjithashtu L10 e identifikoi Haradin Balën në gjyq si Shala.[2062] Megjithëse ai nuk pa asnjë pjesë të procesit në televizion, ai i pa të Akuzuarit në televizion në kohën e arrestimit të tyre.[2063] Po ashtu si edhe në rastin e L07-ës, ekziston mundësia e identifikimit të gabuar, së pari sepse identifikimi i të akuzuarit u bë në mjediset e një salle gjyqi dhe së dyti sepse pamjet në televizion mund të kenë ndikuar në identifikimin prej tij. Po ashtu si në rastin e L07-ës, prej dëshmisë nuk sugjerohet se L10-ës iu kërkua të bënte identifikim prej fotografive. Megjithëse përshkrimi i Shalës prej L10-ës nuk ishte shumë i saktë, veçanërisht në lidhje me shtatlartësinë, ai është i arsyeshëm për një sërë arsyesh. Dhoma është e bindur se ai ishte i ndershëm dhe i sigurtë në identifikimin e tij, por për arsyet e treguara Dhoma e sheh me kujdes këtë identifikim Megjithëse në disa pika vlera provuese e dëshmisë së identifikimit prej këtij dëshmitari është pak e ngjashme me atë të L04-ës faktorë kundërpeshues janë kohëzgjatja e burgimit të dëshmitarit dhe sa herë e pa Haradin Balën. Gjithsesi Dhoma ka rezerva mbi besueshmërinë e identifikimit të të Akuzuarit Haradin Bala prej L10-ës.

612. L96 u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut afërsisht një javë në korrik 1998.[2064] Në dëshminë e tij Shala u përshkrua si 45-vjeç, zeshkan me flokë të zinj dhe mustaqe të zeza.[2065] Shala ishte 175-180 cm i gjatë me një fytyrë "pak të hequr".[2066] Sipas dëshmisë së L96-ës Shala mbante uniformë të zezë, këmizhë të zezë dhe ndonjëherë beretë të zezë. Ai kishte emblemën e UÇK-së, ose në këmishë, ose në beretë.[2067] Sipas dëshmisë së L96-ës, Shala mbante gjithmonë një kallashnikov pa kondak.[2068] L96 deklaroi se Shala bashkë me Murrizin u sillnin ushqim të burgosurve dhe i shoqëronin ata në nevojtoren në oborr.[2069] L96 pretendoi se identifikoi emrin e vërtetë të Shalës si Haradin Bala. Arsyeja e dhënë për këtë identifikim nuk ka peshë. L96 deklaroi se gjatë vajtjes për në malet e Berishës dhe konkretisht afër një qershie, njëri prej të burgosurve i tregoi një të afërmi të L96-ës se ai e njihte Shalën dhe se Shala ishte nga zona e Komoranit.[2070] Gjithashtu L96 dëshmoi se pas ngjarjeve në Llapushnik, L96 dhe familja e tij u orvatën të zbulonin

[2061] *Shih më poshtë,* paragrafët 612 dhe 616.
[2062] L10, T 2949.
[2063] L10, T 2949; 3030-3031.
[2064] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[2065] L96, T 2305; 2480.
[2066] L96, T 2305.
[2067] L96, T 2305.
[2068] L96, T 2305.
[2069] L96, T 2302; 2303; 2339-2340.
[2070] L96, T 2478; 2500; 2503.

identitetin e Shalës.[2071] L96 deklaroi se ai e përjashtoi personin e parë për të cilin axha i tij mendonte se L96 kishte parë në kamp, sepse përshkrimi fizik i atij personi ishte i ndryshëm.[2072] Më vonë axha i L96-ës "zbuloi" se emri i vërtetë i Shalës së kamp-burgut ishte Haradin Bala.[2073] Nuk është identifikuar burimi i këtij informacioni. L96 dëshmoi se në gusht 2000 ai takoi Xheladin Ademajn, i cili e kishte emrin e Haradin Balës të shkruar në fletoren e shënimeve.[2074] Sugjerohet se dëshmia e L96-ës për këtë fakt kundërshtohet prej një deklarate që thuhet se është dhënë prej Xheladin Ademajt.[2075] Mirëpo as deklarata nuk u paraqit si provë dhe as përmbajtja e saj nuk mund të nxirret prej dëshmisë së L96-ës. Sido që të jetë, Dhoma nuk mund t'i kushtojë rëndësi dëshmisë së L96-ës se emri i Shalës është Haradin Bala.

613. Në shkurt 2002, gjatë një interviste me hetuesit e UNMIK-ut, L96-ës iu treguan gjashtë fotografi. Ai njohu menjëherë njërin prej tyre si "Shala".[2076] Kjo ishte fotografi e Haradin Balës. Mbrojtja e Haradin Balës argumentoi se atij identifikimi nuk i duhej kushtuar aspak rëndësi sepse argumentohet se hetuesit nuk ndoqën procedurën e duhur. Në veçanti, duket se L96-ës iu kërkua nëse dëshironte më shumë kohë, gjatë së cilës mund të dilte prej dhomës.[2077] Mirëpo L96 e kishte identifikuar menjëherë "Shalën", para se t'i ofrohej kohë më shumë dhe mundësia e daljes së shkurtër nga dhoma.[2078] Prandaj sido të ketë qenë procedura e duhur, vlera e këtij identifikimi nuk cënohet prej të metave të sugjeruara. Gjithashtu duhet theksuar se sipas dëshmisë së L96-ës, ai e pa Shalën në kampin e Llapushnikut çdo ditë, në disa raste disa herë në ditë.[2079] Gjatë dëshmisë së tij, dëshmitari e identifikoi Haradin Balën edhe në gjyq.[2080] Gjithsesi dëshmitari deklaroi se ai pa një transmetim televiziv të këtij procesi gjyqësor para se të vinte për të dëshmuar.[2081] Rrjedhimisht për arsyet e përmendura në lidhje me dëshmitarët e tjerë, Dhoma është e ndërgjegjshme për mundësinë e identifikimit të gabuar për shkak të identifikimit të një të akuzuari në mjedisin e sallës gjyqësore dhe për shkak të parjes në televizion të procesit gjyqësor. Gjithashtu Dhoma ka marrë parasysh edhe pikëpamjet e shprehura gjetiu në këtë vendim, të nxjerra prej çështjeve të tjera, në lidhje me besueshmërinë e L96-ës. Pasi i ka shqyrtuar të tëra këto çështje, Dhoma gjithsesi pranon se L96 njohu në fotografi Haradin Balën si personin të cilin e njohu në Llapushnik dhe në dëshminë e tij e

[2071] L96, T 2476; 2478-2479.
[2072] L96, T 2395; 2478-2479; 2501-2502.
[2073] L96, T 2396.
[2074] L96, T 2399; 2477.
[2075] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 795; L96, T 2471-2472; 2477.
[2076] L96, T 2366-2367; 2369; Prova Materiale P102. Janë gjashtë fotografi bardhezi relativisht të qarta. Bala është nr. 5.
[2077] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 781.
[2078] L96, T 2367.
[2079] L96, T 2304-2305; 2338.
[2080] L96, T 2574.
[2081] L96, T 2471-2472.

përmendi si Shala. Megjithatë, për shkak të rezervave dhe për arsyet e përmendura diku tjetër[2082] në lidhje me ndershmërinë dhe besueshmërinë në përgjithësi të L96-ës dhe për shkak të çështjeve të përmendura në këtë paragraf që mund të çojnë në gabim, Dhoma nuk është e gatshme të pranojë dhe të mbështetet në këtë identifikim në mungesë të dëshmive të tjera për identifikim, të cilat e bindin Dhomën pavarësisht prej L96-ës.

614. L06, i cili u mbajt afërsisht një muaj e gjysëm në kamp-burgun e Llapushnikut,[2083] dëshmoi se ai e pa Shalën çdo ditë.[2084] L06 dëshmoi se Shala ishte afërsisht 50 vjeç, kishte fytyrë të zeshkët dhe dhëmbët pak të krimbur. L06 deklaroi se Shala ishte pak më i gjatë dhe më i shëndoshë se ai vetë.[2085] Në fakt Haradin Bala është gjysëm centimetri më i gjatë se L06.[2086] Rrjedhimisht në kundërshtim të një sugjerimi të Mbrojtjes së Haradin Balës,[2087] përshkrimi i kufizuar i Shalës prej dëshmitarit në përgjithësi përputhet me Haradin Balën. L06 deklaroi se Shala ishte rojë dhe ai vinte bashkë me Murrizin në dhomën ku mbahej dëshmitari dhe binte ushqim dhe ujë. Çdo tri-katër ditë Shala hapte derën në mbrëmje dhe i lejonte të burgosurit të ecnin pak.[2088] L06 dëshmoi se kur ishte në kamp, Shala e quante atë "axhë".[2089] Mirëpo asgjë në dëshminë e L06-ës nuk sugjeron për lidhje familjare midis tyre apo se ai e kishte njohur Haradin Balën para luftës. Duhet theksuar se ka dëshmi se disa ushtarë i drejtoheshin Fatmir Limajt në mënyrë të ngjashme.[2090] L06 dëshmoi se pas luftës ai dëgjoi prej njerëzve në fshatin e tij se Shala ishte Haradin Bala.[2091] Kur u pyet nga Mbrojtja, ai deklaroi se këta njerëz e mësuan identitetin e tij kur Shala doli në televizion.[2092] Gjithashtu dëshmitari e identifikoi Haradin Balën në gjyq si personin të cilin ai e njohu si Shala në Llapushnik.[2093] Sigurisht, ashtu si në lidhje me dëshmitarët e tjerë Dhoma duhet të jetë e kujdesshme për shkak të mundësisë së identifikimit të gabuar meqë u bë në sallën e gjyqit ku Haradin Bala ishte i akuzuar. Gjithashtu, L06 e kishte parë Haradin Balën në televizion. Në dëshmi nuk është zbuluar përmbajtja e programit televiziv. Ekziston mundësia e identifikimit të gabuar prej televizionit. Dhoma e pranon dëshminë e L06-ës se ai kishte parë Shalën në kamp shumë herë dhe Shala u bë shumë i njohur për atë.[2094] Dhoma pranon edhe dëshminë e tij se gjatë vajtjes për në

[2082] *Shih më sipër,* paragrafin 26.
[2083] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[2084] L06, T 1001.
[2085] L06, T 1001-1002.
[2086] Fakt i pranuar; T 5187.
[2087] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 703.
[2088] L06, T 997-998.
[2089] L06, T 1003.
[2090] *Shih më sipër,* paragrafët 591; 595.
[2091] L06, T 1003-1004.
[2092] L06, T 1094-1095.
[2093] L06, T 1006-1007.
[2094] L06, T 1106-1107.

malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998, ai e shihte Shalën shumë qartë.[2095] Dëshmitë nuk tregojnë se L06-ës iu kërkua të identifikonte Shalën prej fotografive.

615. Mbrojtja e Haradin Balës dyshon edhe në ndershmërinë ose besueshmërinë e identifikimit prej L06-ës sepse ai nuk e përmendi Shalën në një deklaratë dhënë autoriteteve serbe pas lirimit të tij në 1998. Ai përmendi ushtarë të tjerë të UÇK-së të cilët i hasi në Llapushnik.[2096] Në të vërtetë në deklaratë Shala nuk përmendet, por përmenden vetëm dy pseudonime të UÇK-së. Në fund të deklaratës janë emrat e katër individëve, të cilët L06 deklaroi se e kishin rrëmbyer fillimisht.[2097] L06 dëshmoi se ai nuk ua zbuloi autoriteteve serbe identitetet e atyre që e mbajtën të burgosur; ai nuk mund ta bënte këtë sepse ata mbanin maska.[2098] Dëshmia në lidhje me atë intervistë është mjaft e paqartë. Megjithatë, Dhoma thekson se në deklaratën e dhënë autoriteteve serbe, emrat dhe pseudonimet e UÇK-së përmenden vetëm në lidhje me lirimin e dëshmitarit nga kampi dhe rrëmbimin e tij. Shprehja e përdorur në lidhje me ngjarjet në kamp është "anëtarë të UÇK-së" pa i identifikuar ata.[2099] Rrjedhimisht Dhoma i kushton pak rëndësi mospërmendjes së emrit Shala. Megjithëse identifikimi i Haradin Balës prej L06-ës dukej se ishte i ndershëm dhe i sigurtë, për arsyet e treguara ai do të konsiderohet me kujdes.

616. Dhoma ka dëgjuar dëshminë e një të burgosuri tjetër L12, i cili u mbajt në ahur afërsisht një muaj.[2100] L12 tha se ai e pa Shalën çdo natë dhe gjithashtu gjatë ditës.[2101] Sipas dëshmisë së L12-ës Shala ishte ndoshta 56 vjeç, me fytyrë të zeshkët dhe mustaqe të zeza. Shala ishte me shtatlartësi mesatare dhe thatanik. L12 dëshmoi se Shala vishte rroba të zeza.[2102] Kur u pyet nga Mbrojtja, L12 pranoi se hera e parë kur ai dha një përshkrim të Shalës për Prokurorinë, ishte vetëm disa ditë para dëshmisë së tij. Në atë rast ai tha se nuk e kishte parë mirë Shalën. Pastaj ai e përshkroi Shalën si person të gjatë, më të gjatë se ai vetë dhe me trup të ngjeshur.[2103] Ky ndryshon nga përshkrimi i dhënë në gjyq. Sipas dëshmisë së L12-ës Shala kishte çelësat e ahurit dhe ai sillte në ahur njerëz për të rrahur L12-ën. Gjithashtu Shala dhe Murrizi u sillnin ushqim të burgosurve.[2104] Ka rëndësi të thuhet se në qershor 2002 në një takim me njerëz nga CCIU-ja, L12-ës iu tregua një fletë me

[2095] L06, T 1107.
[2096] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 712.
[2097] Prova Materiale P204.
[2098] L06, T 1032-1033.
[2099] Prova Materiale P204.
[2100] *Shih më sipër,* paragrafin 279.
[2101] L12, T 1801.
[2102] L12, T 1811-1812.
[2103] L12, T 1839-1840.
[2104] L12, T 1802.

fotografi ndër të cilat një fotografi e Haradin Balës. Ai nuk identifikoi askënd në fotografi.[2105] Meqë fleta me fotografi nuk përfshihet në prova, Dhoma nuk mund të vlerësojë nëse mosnjohja e Haradin Balës prej tij ishte për shkak të cilësisë së fotografisë, apo ngjashmërisë së pakët në fotografi. Sigurisht që i takon Prokurorisë ta provojë këtë, ashtu si edhe për të gjitha çështjet. L12 e identifikoi Haradin Balën në gjyq si njeriun të cilin ai e njohu në Llapushnik si Shala.[2106] Gjithashtu para se të vinte për të dëshmuar, ky dëshmitar kishte parë në televizion një njeri për të cilin mendoi se ishte Shala.[2107] Përsëri duhet shqyrtuar me kujdes mundësia e identifikimit të gabuar për shkak të ndikimit të sallës së gjyqit, ashtu si duhet shqyrtuar edhe mundësia e gabimit prej televizionit, edhe pse në sallën e gjyqit dëshmitari deklaroi konkretisht se në sallën e gjyqit ai kishte identifikuar njeriun të cilin në kamp e kishte njohur si Shala dhe jo për shkak se kishte parë televizionin.[2108] Duke marrë parasysh këto çështje dhe veçanërisht mosidentifikimin e Shalës prej L12-ës në fletën e fotografive dhe ndryshimet në përshkrimin e tij për Shalën, Dhoma ka rezerva të qarta mbi identifikimin në gjyq të Haradin Balës prej tij si personi të cilin në kamp ai e njohu si Shala.

617. L64, i cili ishte anëtar i UÇK-së dëshmoi se ai e vizitoi për herë të parë kamp-burgun e Llapushnikut në fillim të qershorit 1998.[2109] Ai deklaroi se takimi i tij i parë me Haradin Balën ndodhi në fillim të qershorit, në atë pjesë të Llapushnikut ku ndodhej kuzhina e UÇK-së.[2110] Sipas dëshmisë së L64-ës, Haradin Bala ndejti në Llapushnik deri në fund të korrikut, megjithëse dëshmitari nuk e pa atë në ditët e fundit të korrikut.[2111] L64 e përshkroi Haradin Balën si një njeri mbi të dyzetat, afërsisht 180 cm i gjatë dhe me mustaqe; dhëmbët i kishte jo të bardhë, pak të dëmtuar dhe shumë të ndarë.[2112] Në qershor 2003 gjatë një interviste me një hetues të Prokurorisë, L64 e përshkroi Haradin Balën me një këmbë të lënduar. L64 deklaroi se ai mund t'a ketë ngatërruar Haradin Balën me një person tjetër të quajtur Shala, emri i vërtetë i të cilit është Ruzhdi Karpuzi dhe i cili ishte lënduar në këmbën e djathtë.[2113] Gjatë intervistës L64 tha se dy Shalat mund të ngatërroheshin jo vetëm për shkak të pseudonimit, por edhe për shkak se ngjanin me shoshoqin.[2114] Mirëpo në gjyq L64 dëshmoi se këta dy njerëz të njohur si Shala nuk ngjanin. Ai shpjegoi se deklarata e tij e parë për hetuesin ndryshonte prej dëshmisë në gjyq sepse në kohën e deklaratës së tij të mëparshme, ai mendoi se Haradin Bala mund të lirohej dhe nuk kishte nevojë që

[2105] L12, T 1779-1780.
[2106] L12, T 1812-1813.
[2107] L12, T 1812-1813; 1842.
[2108] L12, T 1847-1848.
[2109] L64, T 4456.
[2110] L64, T 4445-4446.
[2111] L64, T 4446.
[2112] L64, T 4447.
[2113] L64, T 4786-4791; 4449.
[2114] L64, T 4793-4794.

dëshmitari të tregonte çfarë dinte për atë.[2115] L64 tha se kur dha atë deklaratë, ai u përpoq t'a ndihmonte Haradin Balën.[2116]

618. L64 deklaroi se Haradin Bala ishte "si farë rojë" dhe detyra e tij ishte të qëndronte te porta e shtëpisë së quajtur burg.[2117] Dëshmitari dëshmoi se ai e pa Shalën duke mbartur ushqim nga kuzhina dhe duke e çuar brenda, një ose disa herë.[2118] Sipas dëshmisë së L64-ës Shala ishte ushtar i qetë dhe me sjellje të mirë. Dëshmitari tha se ai kishte marrëdhënie të mira me Shalën.[2119] L64 dëshmoi se ai e dinte emrin e vërtetë të Shalës dhe se babai i tij ishte Selman Haradinaj.[2120] Gjatë një interviste me një hetues më 17 qershor 2003, dëshmitari e identifikoi saktësisht Haradin Balën në një fletë me fotografi.[2121] Megjithatë, ka arsye që identifikimi dhe dëshmia e L64-ës duhen trajtuar me rezervë. Veç mospërputhjeve në lidhje me këmbën dhe pamjen e përgjithshme midis deklaratës së mëparshme të dëshmitarit dhe dëshmisë së tij në gjyq, gjatë një interviste më 4 korrik 2003, L64 deklaroi se ai "nuk kishte kontakt me Shalën".[2122] Kjo bie në kundërshtim të hapët me pjesë të dëshmisë së L64-ës dhe duket se është bërë qëllimisht. Pra, duket se L64 ka qenë i gatshëm të japë deklarata jo të vërteta në lidhje me aspekte materiale, përsa i përket Haradin Balës. Gjithashtu ekzistojnë faktorë të rëndësishëm të përgjithshëm në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit të përmendur diku tjetër në këtë vendim.[2123] Si përfundim Dhoma nuk është e bindur se mund të pranojë dëshminë e këtij dëshmitari në lidhje me identifikimin e Haradin Balës pa konfirmim të pavarur.

619. Ruzhdi Karpuzi mori pjesë në lëvizjen e UÇK-së. Ai dëshmoi se e pa Haradin Balën në Llapushnik rregullisht, por e pa në një vend prej të cilit dëshmitari dhe ushtarë të tjerë vëzhgonin një postbllok serb në Komoran, midis 8 dhe 18 majit 1998. Sipas dëshmisë së Ruzhdi Karpuzit ai nuk e pa Haradin Balën më pas.[2124] Dëshmitari deklaroi se në maj 1998 pseudonimi i Haradin Balës ishte Shala.[2125] Mirëpo dëshmia e Ruzhdi Karpuzit për identifikimin e Haradin Balës ka rëndësi të kufizuar sepse bën fjalë për një periudhë më të hershme dhe nuk e lidh Haradin Balën drejtpërdrejt me kamp-burgun e Llapushnikut.

[2115] L64, T 4452.
[2116] L64, T 4904-4905.
[2117] L64, T 4446-4447.
[2118] L64, T 4447.
[2119] L64, T 4447-4449.
[2120] L64, T 4445.
[2121] L64, T 4454; Prova Materiale P172. Janë tetë fotografi bardhezi thuajse të qarta. Haradin Balaj është nr. 8.
[2122] L64, T 4771.
[2123] *Shih më sipër,* paragrafin 28.
[2124] Ruzhdi Karpuzi, T 3081-3082; 3084.
[2125] Ruzhdi Karpuzi, T 3139. Sidoqoftë më parë dëshmitari deklaroi se ai nuk e mbante mend nëse Haradin Bala kishte një pseudonim, T 3082-3084.

620. Zeqir Gashi, mjek, dëshmoi se e pa Haradin Balën në Llapushnik në qershor dhe korrik 1998. Ai deklaroi se Haradin Bala erdhi në klinikën e tij një ose dy herë për ekzaminim të përgjithshëm.[2126] Dr. Zeqir Gashi dëshmoi se ai e pa Haradin Balën edhe në kuzhinën e shtëpisë së Gëzim Gashit, një ose dy herë.[2127] Kuzhina ndodhej matanë një rrugice të ngushtë të pashtruar nga ana tjetër e oborrit në të cilin Dhoma ka nxjerrë përfundimin, se ishte ngritur kamp-burgu.[2128] Dëshmitari tha se ai e kishte njohur Haradin Balën 10-15 vjetë para luftës.[2129] Dr. Zeqir Gashi dëshmoi se pseudonimi i Haradin Balës ishte Shala dhe ai mendonte se ishte ushtar i zakonshëm. Ai e përshkroi Haradin Balën si person me shtatlartësi mesatare, midis shtatlartësisë maksimale dhe mesatare, dhe me mustaqe.[2130] Diku tjetër në këtë vendim theksohet se përshkrimi prej Dr. Zeqir Gashit i gjendjes shëndetësore të Haradin Balës përputhet me përshkrimet e disa dëshmitarëve të Mbrojtjes. Dëshmitari nuk sugjeroi se ai e kishte parë Haradin Balën në kamp-burgun e Llapushnikut, kështu që identifikimi i Haradin Balës prej tij në fshatin Llapushnik ka rëndësi të kufizuar në konteksin e analizës përkatëse, megjithëse siç do të dalë, është i rëndësishëm në shqyrtimin e një alibie të paraqitur nga Mbrojtja e Haradin Balës.

621. Dëshmitë në tërësi të ish-të burgosurve zbulojnë përputhje që bien në sy në lidhje me disa pika. Të tetë ata dëshmuan se Shala u sillte ushqim të burgosurve. Të gjithë ata, drejtpërsëdrejti ose kur përshkruanin detyrat e tij, e përmendën Shalën si rojë në kamp. Dëshmitarët dhanë vlerësime të ngjashme mbi moshën e Shalës kur dëshmuan se Shala ishte mbi 40 ose 50 vjeç. Kjo ka rëndësi më shumë se zakonisht, sepse siç zbulojnë dëshmitë, pak anëtarë të UÇK-së ishin të kësaj moshe, shumica e tyre ishin më të rinj.[2131] Të gjithë ish-të burgosurit deklaruan se Shala kishte mustaqe dhe tre prej tyre përmendën dhëmbët e tij.[2132] Përshkrimet e dhëna nga ish-të burgosurit përputhen përgjithësisht me pamjen fizike të Haradin Balës, megjithëse ndryshojnë në disa hollësi. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, Dhoma është e bindur dhe nxjerr përfundimin se në dëshmitë e tyre këta dëshmitarë, të cilët ishin të gjithë në kamp-burgun e Llapushnikut për periudha gjatë kohës në fjalë, dëshmuan për të njëjtin person, të cilin ata e njohën në kamp si Shala. Është treguar se Shala ishte pseudonimi i përdorur nga i Akuzuari Haradin Bala në Llapushnik, nga maji deri në korrik 1998.

622. Për më tepër, të tetë përdorën pseudonimin Shala kur e kishin fjalën për rojën në kamp-burgun e Llapushnikut. Sipas dëshmive, vetëm dy persona përdornin pseudonimin Shala në

[2126] Dr Zeqir Gashi, T 5621; 5654-5655.
[2127] Dr Zeqir Gashi, T 5622; 5611-5613.
[2128] *Shih më sipër,* paragrafin 6.
[2129] Dr Zeqir Gashi, T 5619-5621.
[2130] Dr Zeqir Gashi, T 5622-5623; 5663.
[2131] Prova Materiale P245, deklaratë dhe nënndarje 9.

Llapushnik në periudhën përkatëse.[2133] Mirëpo ka dhe dëshmi në lidhje me persona të tjerë me mbiemër Shala. Sipas këtyre dëshmive, disa prej tyre ishin në Llapushnik në periudha më të hershme. Jakup Krasniqi dëshmoi se në një kohë të caktuar Ferat Shala ishte në njësinë Pëllumbi me bazë në veri të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë.[2134] Dhoma ka arritur në përfundimin se kamp-burgu i Llapushnikut ndodhej në jug të asaj rruge kryesore.[2135] Sipas dëshmive, më 9 maj 1998 Haxhi Shala shkoi në Llapushnik kur ai mësoi për luftimin me forcat serbe. Kur arriti, midis të tjerëve ai takoi edhe Shaban Shalën, Nexhmi Shalën dhe Ramiz Shalën.[2136] Mirëpo dëshmitë tregojnë se Haxhi Shala nuk ndejti atë ditë në Llapushnik dhe në mbrëmje shkoi në Kleçkë.[2137] Dëshmitë nuk tregojnë se Haxhi Shala apo kushdo prej tre individëve të tjerë me mbiemrin Shala, të cilët Haxhi Shala i takoi në Llapushnik më 9 maj 1998, mbetën atje apo u kthyen në atë vend kohë më vonë. Dhoma arrin në përfundimin se asnjë prej këtyre pesë personave nuk mund të ketë qenë personi i përmendur si Shala në dëshmitë e dëshmitarëve të cilët u mbajtën në Llapushnik në periudhën që vijoi dhe mbaroi më 25 ose 26 korrik 1998. Është e pakundërshtueshme se Haradin Bala përdori pseudonimin Shala dhe ishte i pranishëm atje të paktën për një pjesë të periudhës që ka lidhje me Aktakuzën.[2138] Anëtari tjetër i UÇK-së që përdorte pseudonimin Shala është identifikuar si Ruzhdi Karpuzi.[2139] Rrjedhimisht ai është i vetmi person i cili mund të jetë marrë gabimisht nga dëshmitarët si Haradin Bala. Mirëpo ai nuk ngjan me Haradin Balën. Ai është 8 vite më i ri se Haradin Bala,[2140] 15 cm më i gjatë[2141] dhe dëshmitë nuk tregojnë se ai mbante mustaqe në 1998.[2142] Në veçanti Ruzhdi Karpuzi çalonte për shkak të një lëndimi në këmbë.[2143] Duke marrë parasysh këto tipare të Ruzhdi Karpuzit, Dhoma është e bindur se dëshmitarët-viktima dëshmitë e të cilëve sapo janë shqyrtuar, nuk e kishin fjalën për Ruzhdi Karpuzin kur dëshmuan në lidhje me ushtarin e UÇK-së të cilin ata e njihnin si Shala, Ndoshta në lidhje me këtë pikëpamje duhet tërhequr vëmendja se L64, ushtar i UÇK-së jo ish-i burgosur, e përshkroi Shalën me këmbë të lënduar. Mirëpo siç është përmendur më parë, në dëshminë e tij ky dëshmitar pranoi se në kohën që tha këtë, ai po përpiqej të ndihmonte Haradin Balën duke u orvatur qëllimisht për të krijuar ngatërresë në lidhje me dy Shalat.

[2132] L04, L10, L06.
[2133] L64, T 4451; Prova Materiale P32.
[2134] Jakup Krasniqi, T 3404.
[2135] *Shih më sipër,* paragrafin 282.
[2136] Prova Materiale P34, ff 8-9.
[2137] Prova Materiale P34, f 9.
[2138] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 832-834; 837.
[2139] L64, T 4449; Ruzhdi Karpuzi, T 3061-3062; Prova Materiale P131.
[2140] Ruzhdi Karpuzi, T 3053; Prova Materiale P08.
[2141] Fakte të pranuar; T 5187-5188.
[2142] L64, T 4794; Prova Materiale P134.
[2143] Ruzhdi Karpuzi, T 3201-3203; L64, T 4451; Elmi Sopi, T 6762-6763.

623. Për momentin Dhoma ka lënë mënjanë dëshmitë e dy dëshmitarëve të tjerë përmendur më lart, përkatësisht të L96-ës dhe L64-ës, sepse pa konfirmim të pavarur të asaj që ata kanë thënë, Dhoma mendon se nuk mund të ketë besim të mjaftueshëm në ndershmërinë dhe besueshmërinë e secilit prej këtyre dëshmitarëve. Në lidhje me dy dëshmitarët e tjerë, Ruzhdi Karpuzin dhe Dr. Zeqir Gashin, megjithëse këta dëshmitarë e identifikojnë Haradin Balën se ka qenë në Llapushnik, Ruzhdi Karpuzi thotë se ka qenë në maj 1998 dhe Dr. Zeqir Gashi thotë se ka qenë në qershor dhe korrik, për qëllimin e tanishëm dëshmitë e tyre kanë rëndësi më të kufizuar sepse asnjëri prej tyre nuk foli për ndonjë lidhje midis Haradin Balës dhe kamp-burgut. Gjithsesi secili prej tyre konfirmoi praninë e të Akuzuarit në Llapushnik, megjithëse në kohë të ndryshme, dhe në këtë pikë përputhen me dëshmi të tjera të shqyrtuara në këtë moment. Mirëpo janë edhe shtatë dëshmitarë të tjerë, gjashtë prej të cilëve e kanë identifikuar Haradin Balën në fotografi të treguara më herët, ose në gjyq, dhe të cilët e mbajnë mend atë si Shala në kamp-burg, dhe dëshmitari i shtatë Vojko Bakraçi i cili e kujton Shalën në kamp-burg, por nuk e identifikoi kur atij iu tregua një fletë me fotografi ku përfshihej edhe një fotografi e Haradin Balës në 2002.

624. Dhoma ka mendimin dhe vlerëson se veçanërisht një dëshmitar shquhet për kujdesin, ndershmërinë, zotësinë dhe besueshmërinë në lidhje me këtë si dhe shumicën e çështjeve që ai përmendi gjatë dëshmisë dhe për shkak të mundësive që ai pati në 1998 për t'a parë nga afër rojën në kamp-burg, të cilin ai e njohu si Shala. Ky dëshmitar është Ivan Bakraç. Dhoma arrin në përfundimin se ai e njohu menjëherë dhe pa mëdyshje një fotografi të personit që ai e njohu në kamp si Shala e cila ishte fotografi e të Akuzuarit Haradin Bala, kur në janar 2003 një hetues i Prokurorisë i tregoi 8 fotografi të personave të ndryshëm, por të ngjashëm. Duke shqyrtuar veçanërisht dëshminë eksperte që u paraqit në lidhje me vështirësitë e mundshme të identifikimit prej një sërë fotografish, Dhoma vlerëson se rrethanat e intervistës me hetuesin nuk çojnë në ndonjë arsye thelbësore që të pakësojë besueshmërinë e këtij identifikimi mosngurrues dhe me besim prej një sërë fotografish. Më herët në këto arsyetime, Dhoma ka nënvizuar përshkrimin gojor të Ivan Bakraçit për Shalën. Nuk është përshkrim i hollësishëm, por duke marrë parasysh mendimin e shprehur të Dhomës mbi përshtypjen e tij për konstruktin fizik të Shalës, përshkrimi i tij përgjithësisht përputhet me Haradin Balën. Karakteri i përshkrimit nuk i krijon shqetësim Dhomës për mungesën e mundshme të një kujtese të hollësishme e tillë që do të pakësonte besueshmërinë e identifikimit prej një sërë fotografish. Dhoma ka marrë parasysh se përgjithësisht Ivan Bakraçi e pa Shalën në shtëpinë në kamp-burg, më shumë se në ndonjë nga vendet jashtë shtëpisë ku mbaheshin të tjerët, kështu që ai kishte mundësi shumë më të madhe për ta këqyrur Shalën, edhe kur luajti shah me të.

625. Dhoma ka mendimin se L07 ishte dëshmitar i ndershëm dhe i sigurtë se i Akuzuari Haradin Bala ishte personi të cilin ai e njohu si komandant Shala, ose Shala në kampin e Llapushnikut në 1998. Siç është përmendur më lart, ai e kishte parë Shalën atje për një periudhë disi të kufizuar. Dhoma pranon se ai e takoi të Akuzuarin Haradin Bala në një pike për shitjen e karburantit në 1999, d.m.th. relativisht pak kohë pas ngjarjeve përkatëse, e njohu lehtësisht si Shala dhe atje vetë i Akuzuari i tha emrin e tij të saktë, Haradin Bala. Për arsyet e përmendura më herët, Dhoma nuk mendon se mospërmendja konkrete e takimit në pikën e karburantit në dy deklaratat e mëvonshme shpjegohet me një sajesë të paradokohshme apo gabim prej L07-ës. Pranohet se ai thjesht iu përgjigj pyetjeve prej hetuesve përkatës. Megjithëse përshkrimi i tij gojor për Haradin Balën është i shkurtër, ai përputhet me pamjen e të Akuzuarit. Mirëpo Dhoma nuk mund të ketë tërësisht besim vetëm në dëshminë e L07-ës në lidhje me identifikimin e të Akuzuarit, sepse L07 ka parë edhe fillimin e këtij procesi gjyqësor në televizion dhe për shkak të mundësisë së gabimit në identifikimin e një të akuzuari në sallën e gjyqit përmendur më herët.

626. Të dy, L10 edhe L06, u mbajtën të burgosur në kampin e Llapushnikut afërsisht për dy muaj. Askujt prej tyre nuk i ishte kërkuar prej hetuesve të shikonte një fletë me fotografi, por në gjyq secili prej tyre e identifikoi të Akuzuarin Haradin Bala si rojë për të burgosurit gjatë asaj kohe dhe në atë kohë njihej si Shala. Përshkrimet gojore dhënë nga secili prej tyre ndryshonin në hollësi, por përgjithësisht ishin në përputhje me pamjen e Haradin Balës, megjithëse në lidhje me shtatlartësinë njëri nga ata sugjeroi një luhatje nga 180 në 200 cm, që megjithëse është e përputhshme në kufirin e poshtëm, nuk është në kufirin e sipërm, dhe e cila zbulon vëzhgim jo të besueshëm fillestar të këtij përshkruesi ose kujtesë jo të qartë prej tij. Jo vetëm që secili prej këtyre dëshmitarëve pati mundësi ta shihte Shalën për një periudhë të konsiderueshme kohore, por L06 pati edhe një mundësi të mirë për ta këqyrur atë në udhëtimin në këmbë për në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998. Për Dhomën të dy këta dëshmitarë dukeshin të ndershëm dhe të sigurtë në identifikimin në gjyq prej tyre të të Akuzuarit Haradin Bala si Shala, të cilin e njohën në kamp-burg, por për çdo rast ky identifikim u bë në gjyq dhe secili prej këtyre dëshmitarëve kishte parë transmetim televiziv në kohën e arrestimit të Haradin Balës në lidhje me këtë proces. Gjithashtu ekziston edhe problemi familjar, përmendur më herët. Për arsyet e përmendura më parë, Dhoma nuk mund të bindet prej asnjë nga këto dy dëshmi, e marrë veças, të këtyre dëshmitarëve për identifikimin e Haradin Balës.

627. Edhe dy dëshmitarë të tjerë, L04 dhe L12, e identifikuan Haradin Balën në gjyq si rojë në kamp-burgun e Llapushnikut ku ata ishin mbajtur të burgosur secili për një periudhë afërsisht një muaj gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën. L12 bëri të ditur se ai nuk e kishte parë mirë Shalën,

kur u pyet për ndryshimet në përshkrimin gojor të Shalës. Edhe L04 dha përshkrime të Shalës të cilat ishin të ndryshme, të pakën lidhur me shtatlartësinë. Si L04 po ashtu dhe L12 kishin parë transmetim televiziv në lidhje me këtë proces në të cilin doli Haradin Bala. Gjithashtu të dy ata, L04 dhe L12 nuk kishin identifikuar fotografinë e Haradin Balës kur iu ishin treguar fletë me fotografi, ku ishte dhe fotografia e tij. Kjo ndodhi për secilin prej tyre në 2002 kur një hetues i UNMIK-ut u tregoi një fletë me fotografi. Siç është përmendur më herët asnjë fletë me fotografi nuk ekziston në prova kështu që Dhoma nuk mund të nxjerrë ndonjë përfundim në lidhje me cilësinë e fotografive të Haradin Balës që u përdorën, apo shkallën e ngjashmërisë me të Akuzuarin. Në këto rrethana Dhoma duhet të veprojë mbi supozimin e dobishëm për të Akuzuarin, se ngjashmëria ishte e mjaftueshme dhe se fotografitë kishin cilësi të mjaftueshme që mundësonte identifikimin. Rrjedhimisht mosnjohja e fotografisë së Haradin Balës prej tyre fare mire mund të tregojë se në 2002 ata kishin mendimin se asnjë prej personave të paraqitur në fotografi nuk ishte njeriu të cilin e njihnin si Shala. Kjo mosnjohje mund të jetë kushtëzuar edhe prej faktorëve të tjerë si mungesa e qartësisë dhe frika e identifikimit të gabuar të një personi të pafajshëm apo trysnia shoqërore.[2144] Dhoma nuk mund të përcaktojë arsyet faktike për mosidentifikimin për shkak të provave shumë të pakta.[2145] Duke marrë parasysh këta faktorë dhe çështjen e përmendur më herët të një problemi familjar, Dhoma duhet t'i marrë parasysh identifikimet në 2005 të L04-ës dhe L12-ës duke qenë qartësisht e vetëdijshme se secili prej tyre mund të ketë gabuar, edhe pse pranon se për çdo rast identifikimet ishin të ndershme dhe dëshmitarët ishin të sigurtë se i Akuzuari Haradin Bala ishte roja të cilin secili prej tyre e njohu në kamp-burg si Shala.

628. Vojko Bakraçi, i ati i Ivan Bakraçit, e përshkroi personin dhe detyrat e tij si rojë dhe ushtar i UÇK-së të cilin ai e njohu si Shala, kur u mbajt në Llapushnik. Po ashtu si i biri, ai e pa Shalën kryesisht në shtëpi. Pati raste që foli me Shalën. Ai dha një përshkrim të përgjithshëm që përputhej me të Akuzuarin Haradin Bala. Mirëpo, kur hetuesit e UNMIK-ut i treguan një fotografi në janar 2002, ai nuk njohu asnjë prej tetë fotografive edhe pse në njërën prej tyre ishte Haradin Bala. Më parë Dhoma ka theksuar se në provën materiale-fletë me fotografi, fytyra e Haradin Balës thuajse nuk dallohet, por në mungesë të provave në lidhje me faktin nëse prova materiale ishte kopje e mirë e asaj që iu tregua dëshmitarit, ajo nuk mund të përcaktojë nëse ky faktor mund të jetë shpjegimi për mosidentifikimin e Haradin Balës prej Vojko Bakraçit. Gjithsesi ai nuk mundi t'a identifikonte

[2144] Anargyros Kereakes, i përfshirë në procesin e identifikimit të Fatmir Limajt dhe Isak Musliut, dëshmoi se ai i informoi dëshmitarët se ai donte që ata të ishin 100% të sigurtë se personi që ata identifikonin ishte i dyshuari; T 4998-4999.

[2145] Mbrojtja e Haradin Balës sugjeroi se mund të kenë qenë më shumë mosidentifikime sesa ishin pranuar si prova; Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 896; 898. Mirëpo duke marrë parasysh dëshmitë e hetuesve të ngarkuar me

dhe nuk iu kërkua ta bënte ndonjë here tjetër. Mirëpo siç është përmendur më parë Dhoma është e bindur dhe nxjerr përfundimin se në kohën që ka lidhje me Aktakuzën, asnjë person tjetër veç Haradin Balës nuk ishte rojë në kamp-burgun e Llapushnikut, dhe ai përdori emrin ose pseudonimin Shala.

629. Siç u përmend më lart në lidhje me L10-ën, L06-ën, L04-ën dhe L12-ën, ekziston edhe çështja e lidhjeve familjare që sipas Mbrojtjes së Haradin Balës mund të cënojë besueshmërinë e dëshmive të këtyre dëshmitarëve. Siç është përmendur më pare, Dhoma nuk bindet se dëshmitë e këtyre katër dëshmitarëve janë ndikuar prej problemit midis familjes së tyre dhe familjes me të cilën Haradin Bala kishte lidhje të largët sipas Mbrojtjes së Haradin Balës. Gjithashtu Dhoma nuk është e bindur se çfarëdo diskutimi i këtyre ngjarjeve në kamp-burg midis këtyre katër dëshmitarëve, të cilët i përkasin një familjeje të gjerë, mund të ketë rëndësi në lidhje me besueshmërinë e dëshmive të tyre,[2146] apo të ketë ndikim negativ përsa i përket vlerësimit të besueshmërisë së identifikimeve përkatëse si Shala të të Akuzuarit Haradin Bala prej këtyre katër dëshmitarëve.

630. Në një rrafsh më të përgjithshëm Dhoma nënvizon se të tetë dëshmitarët-*viktima* të lartpërmendur dhanë dëshmi mbi rolin dhe veprimtaritë e rojës të cilin, secili prej tyre e njohu në Llapushnik si Shala, të cilat ndryshonin në disa pika siç mund të pritet, sepse çdo person përshkruan përvojën dhe vëzhgimet e tij, duke u bazuar në kujtesën e tanishme afërsisht 7 vjet pas ngjarjeve, por të cilat zbulojnë një praktikë të ngjashme përgjegjësish dhe veprimtarish. Gjithashtu Dhoma është e vetëdijshme se në dëshmitë e këtyre tetë dëshmitarëve veshja e Shalës ndryshonte, por Dhoma ka mendimin se kjo nuk është e papritur, sepse duket se Shala u pa nga persona të ndryshëm në kohë të ndryshme.

631. Gjatë shqyrtimit të dëshmive të këtyre tetë dëshmitarëve,[2147] Dhoma është plotësisht e vetëdijshme për mundësinë që secili prej të shtatëve që identifikoi Haradin Balën të ketë gabuar në identifikimin e tij përkatës, veçanërisht për shkak të çështjeve konkrete të përmendura më lart në lidhje me çdo dëshmitar. Megjithëse për çdo rast Dhoma duhet të mbajë parasysh me shumë kujdes mundësinë e identifikimit të gabuar, kjo nuk do të thotë patjetër se për një arsye apo një tjetër identifikimi prej një dëshmitari mund të jetë i gabuar, se identifikimi nuk ka vlerë provuese dhe nuk duhet marrë parasysh. Dhoma pranon për çdo rast ndershmërinë e shtatë dëshmitarëve identifikues,

---

identifikimet, ky pretendim duket i pabazuar. Argumentet Përmbyllëse, T 7276-7277; Anargyros Kereakes, T 4949; Prova Materiale 258, paragrafët 15 dhe 17; Prova Materiale 259, paragrafi 17.

[2146] *Shih më sipër,* paragrafët 32 dhe 35.

veçanërisht të Ivan Bakraçit dhe gjithashtu të të tetit, Vojko Bakraçit. Në rrethanat aktuale një faktor i rëndësishëm lidhur me vlerësimin e gjasës së një identifikimi të ndershëm, por të gabuar prej secilit nga këta shtatë dëshmitarë, është se gjashtë persona të tjerë, duke vepruar ndershmërisht, në kohë dhe rrethana të ndryshme e kanë identifikuar Haradin Balën si roja i UÇK-së të cilin ata e njihnin si Shala në kamp-burg gjatë periudhës në fjalë. Megjithëse asnjë prej këtyre shtatë identifikimeve, i shqyrtuar veças, nuk do ta bindte Dhomën se Shala është Haradin Bala për shkak të mundësive të ndryshme të gabimit të mundshëm përmendur më lart, duke marrë parasysh rrethanat e tanishme, Dhoma nxjerr përfundimin se të shtatë identifikimet të marrë së bashku eliminojnë mundësitë e gabimit dhe e bindin Dhomën se i Akuzuari Haradin Bala ishte në të vërtetë roja i UÇK-së i njohur si Shala në kamp-burg, ashtu si pretendohet.

632. Gjithashtu Dhoma thekson se dëshmia e ish-të burgosurit të tetë, Vojko Bakraç përputhet me këtë përfundim. Për më tepër, ashtu siç u parashtrua më lart, për shkak të problemeve të përgjithshme mbi besueshmërinë, Dhoma nuk ka mundur të pranojë dëshminë e L96-ës ose L64-ës, në mungesë të dëshmive të tjera të pavarura konfirmuese. L96 ishte i burgosur gjatë periudhës në fjalë. L64 ishte ushtar i UÇK-së. Jo vetëm që dëshmitë e L96-ës dhe L64-ës nuk janë të papajtueshme me faktin se roja në kamp-burg ishte Haradin Bala, por identifikimi i Haradin Balës nga secili prej tyre u konfirmua në mënyrë të pavarur nga identifikimet e bëra nga shtatë ish-të burgosurit e tjerë. Të paktën në lidhje me këtë pikë, Dhoma është e bindur se duhet të pranojë ndershmërinë dhe besueshmërinë e identifikimeve të veçanta të Haradin Balës prej L96-ës dhe L64-ës.

633. Gjithsesi para se të arrijë në përfundimin e prerë mbi çështjen e identifikimit, Dhoma duhet t'u kushtojë rëndësi të veçantë dy çështjeve të tjera, alibisë së paraqitur nga Mbrojtja e Haradin Balës dhe shëndetit të Haradin Balës gjatë periudhës në fjalë.

(b) Alibia e Haradin Balës

634. Mbrojtja e Haradin Balës argumenton se Haradin Bala nuk ka patur mundësi të kryejë krimet për të cilat është akuzuar në Aktakuzë sepse ai ishte i pranishëm në Llapushnik vetëm në maj 1998. Sugjerohet se afërsisht më 8 maj 1998, Haradin Bala shkoi me familjen e tij në Nekoc, prej ku shkoi në Llapushnik për t'iu bashkuar UÇK-së. Sipas parashtrimit të Mbrojtjes, Haradin Bala ndejti në Llapushnik afërsisht dy ose tri javë dhe punoi për UÇK-në në logjistikë dhe në kuzhinën e

[2147] L04, L06, L07, L10, L12, L96, Vojko dhe Ivan Bakraç.

oborrit të Gëzim Gashit. Mbrojtja e Haradin Balës pretendon se në qershor dhe korrik 1998 Haradin Bala u transferua nga Llapushniku dhe punoi në logjistikë për UÇK-në në Luzhnicë dhe bujti në shtëpinë e Avdullah Pukës.[2148]

635. Haradin Bala vendosi të mos dëshmonte nën betim, që është një e drejtë ligjore e tij dhe kundër tij nuk mund të nxirret asnjë përfundim për shkak të kësaj. Mirëpo ky vendim ka një pasojë sepse për sa kohë që argumenti për mbrojtjen e tij mbështetet në një alibi dhe gjithashtu në shëndetin e tij, nuk ekziston asnjë dëshmi nën betim që të mbështesë alibinë ose pretendimin për shëndetin në atë kohë. Në këtë rast të veçantë mungesa e dëshmisë së dhënë nën betim prej të Akuzuarit si baza ose mbështetja e këtyre dy pikave të mbrojtjes së tij, e cila është ekzaminuar me pyetje nga pala kundërshtare, çon në privimin e Mbrojtjes së Haradin Balës prej dëshmisë e cila mund të kishte qenë një bazë e sigurtë dhe bindëse për alibinë dhe për pretendimin mbi shëndetin e tij. Kurse në paraqitjen e këtyre dy argumentave Mbrojtja e Haradin Balës duhet të mbështetet në një deklaratë fillestare të dhënë pa betim dhe dëshmi të tjera jo të përputhshme, të paplota, dhe në vlerësimin përfundimtar të Dhomës, jobindëse.

636. Dëshmitari i Mbrojtjes Kadri Dugolli përshkroi ngjarjet që i paraprinë vajtjes së Haradin Balës në Llapushnik. Ai deklaroi se më 8 maj 1998 ose rreth kësaj date, Haradin Bala solli familjen e tij në Nekoc për të bujtur te familja e dëshmitarit.[2149] Dëshmitari dëshmoi se disa prej anëtarëve të familjes së Haradin Balës erdhën me traktor, të tjerët në një qerre me kuaj ose në këmbë.[2150] Sipas dëshmisë së Kadri Dugollit të nesërmen Haradin Bala shkoi në Llapushnik.[2151] Në rast se kjo dëshmi është e saktë, ajo tregon se vendi nga i cili Haradin Bala u nis për në Llapushnik më 9 maj 1998 ishte Nekoci. Mirëpo në një deklaratë fillestare pa betim, Haradin Bala deklaroi:

> "Unë banoj në Koreticën e Epërme, është në luginë në (si në origjinal) më 9 maj…pashë flakë që vinin prej Llapushnikut…Dukej sikur vinin nga oborri im…Vendosa t'u bashkohesha këtyre djemve."[2152]

Ajo çfarë thotë Haradin Bala bën të qartë se më 9 maj 1998 Haradin Bala shkoi në Llapushnik prej fshatit të tij të lindjes, Korreticë e Epërme, dhe jo nga Nekoci, siç pretendohet prej Mbrojtjes së Haradin Balës dhe siç thuhet prej Kadri Dugollit, i vetmi dëshmitar i Mbrojtjes për këtë çështje.[2153] Në Dosjen Përfundimtare të Mbrojtjes nuk përmendet kjo mospërputhje. Ekziston dëshmi tjetër në

[2148] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 831-840; 845.
[2149] Kadri Dugolli, T 7010; 7015.
[2150] Kadri Dugolli, T 7016.
[2151] Kadri Dugolli, T 7010; 7014.
[2152] Deklarata pa betim e Haradin Balës, T 6912.
[2153] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 831.

lidhje me datën e vajtjes së Haradin Balës në Llapushnik. Elmi Sopi deklaroi se Haradin Bala erdhi në Llapushnik dikur pas 9 majit 1998.[2154] Megjithëse është informacion i dorës së dytë pa burim dhe i pakonfirmuar, Dhoma gjithashtu nënvizon se Shefki Bala dëshmoi se atij iu tha se Haradin Bala mbërriti në Llapushnik pas betejës së 9 majit 1998.[2155] Elmi Sopi përmendi si datë dikur pas 9 majit 1998. Kjo nuk e mbështet pretendimin e Mbrojtjes se ai arriti më 9 maj 1998.

637. Sipas dëshmisë së Elmi Sopit, Haradin Bala ndejti në Llapushnik një kohë në maj 1998 dhe u largua pas luftimit të 29 majit 1998.[2156] Megjithëse dëshmia e tij nuk është e saktë, sipas vlerësimit të Dhomës, rezultati i dëshmisë së Elmi Sopit është se tërë koha e kaluar prej Haradin Balës në Llapushnik është afërsisht tri javë. Mirëpo në deklaratën e tij fillestare dhe pa betim, Haradin Bala deklaroi se ai ndejti në Llapushnik afërsisht dy javë, që tregon një mospërputhje tjetër midis dëshmive të kërkuara nga Mbrojtja dhe deklaratës së tij fillestare dhe pa betim para Dhomës.[2157] Sido që të jetë, Mbrojtja e Haradin Balës parashtron se Haradin Bala u largua nga Llapushniku në fund të majit 1998.[2158] Sipas dëshmisë së Elmi Sopit, një ushtar i UÇK-së, Kumanova, e nxiti Haradin Balën të shkonte me të në Luzhnicë.[2159] Në fakt, në deklaratën e tij fillestare pa betim Haradin Bala tha se ai shkoi në atë vend me Kumanovën.[2160]

638. Elmi Sopi dëshmoi se ai banonte në Llapushnik dhe gjatë periudhës në fjalë ishte anëtar i UÇK-së.[2161] Elmi Sopi thotë se nga maji deri në korrik 1998, ai shkonte çdo ditë në kuzhinën në oborrin e Gëzim Gashit.[2162] Siç është provuar ky oborr ishte përballë kamp-burgut matanë një rrugice të ngushtë.[2163] Dëshmia e tij është se ai nuk e pa Haradin Balën në oborrin e Gëzim Gashit pas fundit të majit 1998. Sipas dëshmisë së tij, shumica e ushtarëve të UÇK-së hanin në kuzhinën e atjeshme.[2164] Në rast se kjo dëshmi është e saktë, mund të sugjerohet se ishte thuajse e pamundur që Elmi Sopi të mos e ketë takuar Haradin Balën në kuzhinë, të paktën rastësisht, në qoftë se Haradin Bala do të kishte qenë në Llapushnik në qershor dhe korrik. Dhoma thekson se gjithashtu Elmi Sopi mohoi në dëshminë e tij se dinte për kamp-burgun në Llapushnik,[2165] që sipas përfundimit të Dhomës, funksionoi mu përballë oborrit të Gëzim Gashit matanë rrugëkalimit të ngushtë të

[2154] Elmi Sopi, T 6746.
[2155] Shefki Bala, T 6922, 6926.
[2156] Elmi Sopi, T 6747.
[2157] Deklarata pa betim e Haradin Balës, T 6913.
[2158] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 835.
[2159] Elmi Sopi, T 6764.
[2160] Deklarata pa betim e Haradin Balës, T 6913-6914.
[2161] Elmi Sopi, T 6758.
[2162] Elmi Sopi, T 6729-6732.
[2163] *Shih më sipër,* paragrafin 6.
[2164] Elmi Sopi, T 6733.
[2165] Elmi Sopi, T 6739.

pashtruar për më të shumtën e qershorit dhe deri më 26 korrik 1998. Sipas dëshmisë së Elmi Sopit ai nuk pati kurrë rast të shkonte në oborrin ku ishte kamp-burgu.[2166] Edhe po të jetë kështu, është e habitshme që një anëtar i UÇK-së i cili shkonte në oborrin përballë çdo ditë afërsisht për dy muaj e gjysëm, të mos dinte asgjë për ekzistencën e kamp-burgut.

639. Pretendimi i Mbrojtjes së Haradin Balës se gjatë qëndrimit të tij në Llapushnik Haradin Bala punoi për UÇK-në në logjistikë dhe në kuzhinën në oborrin e Gëzim Gashit nuk mbështetet prej dëshmive.[2167] Parashtrimi i Mbrojtjes është se më tej Haradin Bala u largua nga Llapushniku dhe punoi në logjistikën e UÇK-së në Luzhnicë. Mbrojtja e Haradin Balës mbështetet në dëshmitë e tre ish-anëtarëve të UÇK-së, Elmi Sopi, Skënder Bylykbashi dhe Avdullah Puka. Elmi Sopi deklaroi se ai e takoi Haradin Balën në mes ose në fund të gushtit 1998 në Novosellë. Sipas dëshmisë së tij Haradin Bala i tha se Bala ishte në Luzhnicë.[2168] Natyrisht që kjo ishte kohë pasi forcat e UÇK-së u detyruan ta braktisnin Llapushnikun më 25 ose 26 korrik 1998. Sipas dëshmisë së Avdullah Pukës, Haradin Bala bujti në shtëpinë e tij në Luzhnicë nga fundi i qershorit deri në fund të gushtit 1998.[2169] Avdulla Puka deklaroi se Haradin Bala i tha se ai ishte përgjegjës për logjistikën në Luzhnicë.[2170] Skënder Bylykbashi dëshmoi se ai e takoi Haradin Balën në mes të qershorit apo në mes të korrikut në Bajicë.[2171] Dëshmitari deklaroi se Haradin Bala i tha se ai punonte në depon e Luzhnicës.[2172] Edhe po të merret rasti më i mirë sikur dëshmitë të pranoheshin si të ndershme dhe të besueshme, të tre dëshmitarët dëgjuan vetëm se Haradin Balaj ndodhej në Luzhnicë. Ata nuk e dinin personalisht. E rëndësishme në dëshmitë e këtyre tre dëshmitarëve është se secili prej tyre e dëgjoi këtë nga vetë Haradin Bala. Avdullah Puka dëshmoi se ai nuk e pa Haradin Balën në Luzhnicë.[2173] Skënder Bylykbashi deklaroi se ai nuk kishte qenë asnjëherë në Luzhnicë në qershor dhe korrik 1998.[2174] Elmi Sopi nuk dëshmoi se ai e pa ndonjëherë Haradin Balën në Luzhnicë. Në lidhje me këtë pikë Mbrojtja e Haradin Balës nuk paraqiti dëshmi të tjera. Mirëpo Ruzhdi Karpuzi, dëshmitar i Prokurorisë, dëshmoi se afërsisht pas 18 majit 1998, siç tha ai, ai nuk e pa Haradin Balën në Llapushnik. Ai dëshmoi se kishte dëgjuar se Haradin Bala ishte në Luzhnicë. Burimi i këtij informacioni nuk u zbulua.[2175]

[2166] Elmi Sopi, T 6768-6769.
[2167] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 834.
[2168] Elmi Sopi, T 6747-6748.
[2169] Avdullah Puka, T 7085-7088.
[2170] Avdullah Puka, T 7090.
[2171] Skënder Bylykbashi, T 6969.
[2172] Skënder Bylykbashi, T 6971.
[2173] Avdullah Puka, T 7090.
[2174] Skënder Bylykbashi, T 6996.
[2175] Ruzhdi Karpuzi, T 3081-3082.

640. Avdullah Puka dëshmoi se Kumanova e solli Haradin Balën në shtëpinë e Avdullah Pukës në Javor në fund të qershorit 1998.[2176] Ai tha se Haradin Bala bujti në odën e asaj shtëpie deri në fund të gushtit 1998.[2177] Avdullah Puka e pranoi se Haradin Bala mund të ketë qenë larguar për dy-tri ditë gjatë bujtjes së tij në odën e Avdullah Pukës.[2178] Sipas Avdullah Pukës, në atë kohë në odë bujtnin edhe gjashtë apo shtatë ushtarë të tjerë.[2179] Oda kishte hyrje të veçantë dhe rrjedhimisht mysafirët nuk kishin nevojë të kalonin përmes shtëpisë së Avdullah Pukës.[2180] Dëshmitari deklaroi se në atë periudhë ai ishte i zënë me detyrat e tij dhe nuk i kushtoi mjaft vëmendje çfarë bënin ushtarët.[2181] Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, u bë e qartë se Avdullah Puka nuk ishte i sigurtë se kush kishte bujtur në odën e tij dhe në çfarë kohe.[2182] Gjithashtu gjatë dëshmisë së Avdullah Pukës doli se disa prej ushtarëve që ai tha se kishin bujtur në odën e tij në verën e vitit 1998, u kthyen në vjeshtë 1998.[2183] Mirëpo me përjashtim të tre rasteve, ai nuk mund t'i identifikonte ushtarët të cilët bujtën në verë dhe nuk mund të thoshte cilët u kthyen në vjeshtë.[2184] Ai nuk mbante mend nëse një ushtar, Besim Zhurda, bujti në shtëpinë e Avdullah Pukës në vjeshtë 1998, po ashtu siç bëri në verë. Për Dhomën u bë e qartë se kujtesa e tij nuk ishte e qartë se kush bujti në odën e tij në verë apo vjeshtë. Megjithkëtë Avdulla Puka e kundërshtoi vendosmërisht sugjerimin se Haradin Bala mund të ishte kthyer në vjeshtë.[2185] Dhoma nuk mund të pranonte se ky kundërshtim i vendosur ishte i bazuar në kujtesën e ndershme ose të qartë mbi praninë e Haradin Balës atje në verë dhe jo në vjeshtë. Në lidhje me këtë dëshmia e tij është jobindëse. Gjithashtu dhe sipas vlerësimit të Dhomës, e rëndësishme është se Avdullah Puka nuk i kushtoi vëmendje të vazhdueshme dhe të kujdesshme faktit se cilët ushtarë bujtnin në odën e tij apo hyrje-daljeve të tyre, apo nëse mungonin natën për ndonjë periudhë. Dhoma mendon se deklaratat e Avdullah Pukës të pranuara si prova se Haradin Bala ndejti atje nga fundi i qershorit deri në fund të gushtit dhe se në atë kohë ai nuk u largua nga oda për më shumë se tri ditë janë bërë për shkak të një zotimi të palëkundur ndaj çështjes së UÇK-së dhe nuk bazohen në kujtime faktike dhe të ndershme të këtyre dy çështjeve.

641. Skënder Bylykbashi tregoi për takimet e tij me Haradin Balën në Bajicë midis mesit të qershorit ose korrikut dhe 26 korrikut 1998 ose më vonë. Në dëshminë e tij, Haradin Bala erdhi një

[2176] Avdullah Puka, T 7085-7087.
[2177] Avdullah Puka, T 7088-7089; 7099.
[2178] Avdullah Puka, T 7101-7102.
[2179] Avdullah Puka, T 7088; 7093-7095.
[2180] Avdullah Puka, T 7088-7089.
[2181] Avdullah Puka, T 7101.
[2182] Avdullah Puka, T 7094.
[2183] Avdullah Puka, T 7095-7097.
[2184] Avdullah Puka, T 7093-7097.
[2185] Avdullah Puka, T 7095-7097.

herë në Bajicë dhe solli miell për familjen e kunatit.[2186] Kur u takuan ata biseduan për një kohë të shkurtër vetëm për disa minuta.[2187] Edhe pse Mbrojtja e Haradin Balës mbështetet në alibinë e saj në dëshminë e Skënder Bylykbashit, dëshmia e takimeve të dëshmitarit me Haradin Balën nuk i kundërshton apo dobëson dëshmitë se për periudhën në fjalë Haradin Bala ishte i pranishëm në kamp-burgun e Llapushnikut dhe kreu veprimet për të cilat akuzohet në Aktakuzë. Bajica ndodhet afërsisht vetëm 3-4 km nga Nekoci.[2188] Kadri Dugolli dëshmoi se Haradin Bala erdhi me makinë me furnizime ushqimore për familjen e tij nga Llapushniku në Nekoc në maj 1998.[2189] Në të njëjtën mënyrë ai mund të ketë vizituar familjen e tij në Bajicë nga Llapushniku në qershor ose korrik 1998. Prej dëshmive del qartë se gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën, të paktën herë pas here Haradin Bala përdorte makinë.[2190]

642. Mbrojtja e Haradin Balës gjithashtu parashtron se disa dëshmi sugjerojnë pamundësinë praktike të pranisë së vazhdueshme, së paku thuajse të përditshme të Haradin Balës në Llapushnik. Argumentohet se në periudhën qershor-korrik 1998 Haradin Bala shkoi kaq shpesh në klinikën e improvizuar të Dr. Fitim Selimit në Shalë, saqë ai nuk mund të jetë parë si rojë burgu në Llapushnik përditë ose thuajse përditë.[2191] Dr. Fitim Selimi dëshmoi se ai ishte në Shalë në periudhën nga mesi i qershorit deri më 25 ose 26 korrik 1998.[2192] Ai dëshmoi se Haradin Bala erdhi në klinikën në Shalë 10 herë ose më shumë.[2193] Shala ndodhet afërsisht 7 - 10 km nga Llapushniku[2194] dhe është pranë një rruge e cila çon në Llapushnik nëpërmjet Bajicës dhe Nekocit.[2195] Ajo rrugë mund të bëhet me makinë.[2196] Haradin Bala përdori një makinë të paktën në disa raste.[2197] Rrjedhimisht Haradin Bala mund të ketë qenë lehtësisht në kamp-burg dhe në Shalë brenda ditës.

643. Palët i kanë kushtuar mjaft vëmendje dëshmisë së Dr. Zeqir Gashit dhe në veçanti datës kur ai hapi klinikën e tij në Llapushnik. Dr. Zeqir Gashi dëshmoi se pasi u kthye nga Arllati në Llapushnik, ai hapi një klinikë të improvizuar në shtëpinë e Ferat Sopit.[2198] Në gjyq ai deklaroi se

[2186] Skënder Bylykbashi, T 6969-6971.
[2187] Skënder Bylykbashi, T 6972.
[2188] Kadri Dugolli, T 7020.
[2189] Kadri Dugolli, T 7020-7021.
[2190] Skënder Bylykbashi, T 6996.
[2191] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 844.
[2192] Dr Fitim Selimi, T 6943.
[2193] Dr Fitim Selimi, T 6946-6947.
[2194] Dr Zeqir Gashi, T 5664.
[2195] Prova Materiale P1, harta 6.
[2196] Prova Materiale P197. Një udhëtim me makinë nga Magura në Llapushnik përshkruhet duke përfshirë Bajicën, Nekocin dhe Kishnarekën.
[2197] Kadri Dugolli, T 7020-7021; Elmi Sopi, T 6764-6765; Avdullah Puka, T 7090-7091.
[2198] Dr Zeqir Gashi, T 5604.

ajo u hap dikur në fillim të qershorit 1998.[2199] Rrjedhimisht duke marrë parasysh dëshminë e Dr. Zeqir Gashit për vizitat e Haradin Balës në klinikë, kjo mund të binte ndesh me dëshmitë se Haradin Bala u largua nga Llapushniku në fund të majit 1998. Mirëpo në një intervistë me një hetues të Prokurorisë, Dr. Zeqir Gashi ofroi një variant tjetër të kohës së hapjes së klinikës.[2200] Hetuesi deklaroi se me sa i kujtohej, Dr. Zeqir Gashi kishte thënë se ai filloi me klinikën në maj ose qershor.[2201] Mirëpo hetuesi deklaroi se në atë kohë data e saktë nuk përbënte problem të veçantë dhe ai u përqëndrua në çështje të tjera.[2202] Megjithëse Mbrojtja e Haradin Balës u mundua ta pakësonte edhe forcën e dëshmisë së Dr. Zeqir Gashit në lidhje me datën e hapjes duke argumentuar se ishte ndikuar prej pyetjeve sugjeruese,[2203] Dhoma theksoi se dëshmitari dukej i sigurtë se klinika u hap në qershor 1998. Në të vërtetë ai deklaroi konkretisht se kishte bërë gabim gjatë intervistës.[2204] Gjithashtu, dëshmia e Dr. Zeqir Gashit në lidhje me ngjarjet e tjera dukej kronologjikisht e bazuar, një tregues më shumë i besueshmërisë së tij. Sipas vlerësimit të Dhomës, Dr. Zeqir Gashi kishte mendimin e vetë dhe nuk dukej se ishte i gatshëm të pranonte asnjë propozim gjatë dëshmisë që ishte kundër mendimit të tij. Rrjedhimisht Dhoma nuk mund të pranojë argumentin e Mbrojtjes se dëshmisë së tij në lidhje me datat nuk i duhet dhënë rëndësi për shkak të mënyrës së pyetjeve të bëra atij. Gjithashtu në lidhje me këtë çështje ka edhe dëshmi të tjera.

644. Ferat Sopi dëshmoi se ai filloi të punonte me Dr. Zeqir Gashin në klinikën e tij dikur nga 20-25 maj 1998, sipas vlerësimit të tij.[2205] Kjo është më herët sesa bëri të ditur Dr. Zeqir Gashi. Ferat Sopi filloi me dëshminë e Dr. Zeqir Gashit, duke thënë se ajo ishte pjesërisht e saktë.[2206] Mirëpo ai nuk qartësoi cilat pjesë të dëshmisë së Dr. Zeqir Gashit i konsideronte të pasakta, ose çfarë ndryshimi kishte midis atyre në lidhje me kohën. Dhoma nënvizon se askush prej dëshmitarëve nuk dha një datë të saktë. Ferat Sopi e bëri të qartë se periudha e tij kohore ishte hamendje. Ai ishte i sigurtë vetëm se klinika u hap në maj,[2207] që fare mirë mund të jenë edhe ditët e fundit të majit.

645. Dr. Zeqir Gashi nuk dha një datë konkrete, duke u mjaftuar të thotë se klinika filloi në fillim të qershorit 1998. Në lidhje me këtë Dr. Zeqir Gashi dukej i ndikuar prej lëvizjeve të tjera të tij. Ai dëshmoi se u kthye nga Arllati në Llapushnik pas 28 ose 29 majit 1998.[2208] Në dëshminë e tij nuk u

[2199] Dr Zeqir Gashi, T 5603-5604; 5642-5645; 5654-5655.
[2200] Argumentet Përmbyllëse, T 7466-7467.
[2201] Prova Materiale DB7, paragrafi 10.
[2202] Prova Materiale DB7, paragrafi 11.
[2203] Argumentet Përmbyllëse, T 7467-7468.
[2204] Dr Zeqir Gashi, T 5644-5645.
[2205] Ferat Sopi, T 7051-7052.
[2206] Ferat Sopi, T 7079.
[2207] Ferat Sopi, T 7052.
[2208] Dr Zeqir Gashi, T 5603-5604.

përmendën ngjarje të tjera të rëndësishme në kohën midis kthimit të tij dhe hapjes së klinikës. Prandaj ndryshimi me një ose dy ditë midis ditëve të fundit të majit ose ditëve të para të qershorit nuk ndikon në mënyrë kyçe në besueshmërinë e Dr. Zeqir Gashit. Sipas vlerësimit të Dhomës, rëndësi të ndjeshme në lidhje me këtë çështje është një provë materiale e cila është një listë kronologjike e injeksioneve të dhëna në klinikë. Ajo fillon më 31 maj 1998. Injeksionet janë numërtuar duke filluar me "1". Rrjedhimisht duket se kjo listë nuk është vazhdim i ndonjë liste tjetër. Sipas dokumentit, injeksioni i fundit u bë më 25 korrik 1998.[2209] Kjo konfirmon dëshmitë e Ferat Sopit dhe Dr. Zeqir Gashit se klinika funksionoi deri më 26 korrik 1998.[2210] Dr. Zeqir Gashi ishte i bindur se lista ishte e saktë dhe përputhej me dokumentet që u mbajtën në Llapushnik.[2211] Duke marrë parasysh dëshmitë e tjera, Dhoma bindet prej kësaj liste dhe nxjerr përfundimin se klinika e Dr. Zeqir Gashit u hap në Llapushnik më 31 maj 1998. Rrjedhimisht Haradin Bala duhet ta ketë vizituar klinikën pas kësaj date. Dhoma e nxjerr këtë përfundim me gjithë dëshminë e Elmi Sopit, që sipas mendimit të Dhomës nuk është ndjeshëm e ndryshme dhe të Ruzhdi Karpuzit dhe Avdullah Pukës dhe gjithashtu pavarësisht çfarë u tha prej Haradin Balës në deklaratën e tij fillestare pa betim.

646. Ka edhe dëshmi të tjera se Haradin Bala ishte në Llapushnik pas fundit të majit 1998. Dr. Zeqir Gashi dëshmoi se ai e takoi Haradin Balën jo vetëm në klinikë, por edhe në kuzhinën e shtëpisë së Gëzim Gashit.[2212] Mbrojtja e Haradin Balës parashtron se Haradin Bala punoi në atë kuzhinë.[2213] Mirëpo sipas dëshmisë së Elmi Sopit ajo kuzhinë për ushtarët e UÇK-së u ngrit në atë vend vetëm pasi përdorimi i një kuzhine tjetër të përbashkët diku tjetër në fshat u bë shumë i rrezikshëm për shkak të granatimeve serbe. Kjo ndodhi më 29 maj 1998.[2214] Po të pranohet kjo dëshmi, rrjedh se Dr. Zeqir Gashi e ka parë Haradin Balën në kuzhinën e oborrit të Gëzim Gashit vetëm pas 29 majit 1998.

647. Siç u theksua më lart, dëshmitë e shumicës së dëshmitarëve të Mbrojtjes së Haradin Balës jo domosdoshmërisht mohojnë provat se Haradin Bala mbeti në Llapushnik pas fundit të majit. Të vetmet dëshmi të cilat kundërshtojnë thelbësisht këto prova janë ato të Elmi Sopit dhe Avdullah Pukës dhe në një shkallë më të vogël e Ruzhdi Karpuzit. Siç nënvizohet më lart, Dhoma ka rezerva për ndershmërinë dhe besueshmërinë e dëshmisë së Avdullah Pukës. Megjithëse dëshmia e Elmi

[2209] Prova Materiale P217.
[2210] Ferat Sopi, T 7052; Dr Zeqir Gashi, T 5605.
[2211] Dr Zeqir Gashi, T 5630-5631; 5652-5653.
[2212] Dr Zeqir Gashi, T 5621-5622.
[2213] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 834.
[2214] Elmi Sopi, T 6729-6730.

Sopit në dukje ishte më bindëse për arsyet e sapodhëna, Dhoma gjykon se në lidhje me këtë çështje është e gabuar, po ashtu si ajo e Ruzhdi Karpuzit. Rezultati i nevojshëm i tërësisë së dëshmive të viktimave në kamp-burg, të cilat Dhoma i ka analizuar më herët është se Haradin Bala ishte gjithashtu në Llapushnik në qershor dhe korrik 1998. Kjo është edhe dëshmia e një anëtari të UÇK-së, L64-ës, dhe përputhet me dëshminë e Dr. Zeqir Gashit. Pasi ka shqyrtuar me kujdes forcën dhe ndikimin e këtyre dëshmive, Dhoma e konfirmon më tej përfundimin e vet se dëshmitë në lidhje me këtë çështje të Elmi Sopit dhe Ruzhdi Karpuzit janë të gabuara. Dhoma gjykon se Haradin Bala nuk u largua nga Llapushniku në fund të majit 1998 apo fill pas tij. Ai ishte i pranishëm atje edhe në qershor dhe korrik 1998, megjithëse nuk është treguar se ai ishte vazhdimisht atje gjatë asaj kohe.

648. Së fundi Mbrojtja e Haradin Balës argumenton se Haradin Bala ishte në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe rrjedhimisht i paaftë për kryerjen e krimeve me të cilat ngarkohet ne Aktakuzë. Veçanërisht pretendohet se për shkak të gjendjes së tij fizike ishte thuajse e pamundur që ai të ketë ushtruar veprimin fizik në rrahjen e pretenduar të burgosurve dhe ecjen në malet e Berishës më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date, veçanërisht në lidhje me ecjen sepse ishte gjatë verës.[2215] Dëshmitarët e Mbrojtjes së Haradin Balës dëshmuan se Haradin Bala nuk ishte mirë me shëndet që para vitit 1998.[2216] Kadri Dugolli deklaroi se Haradin Bala nuk mund të duronte diellin pa çadër.[2217] Dr Fitim Selimi dëshmoi se kur Haradin Bala erdhi në klinikën e tij në Shalë, Bala ishte përgjithësisht i dobët dhe u ankua për dhimbje në gjoks, që sipas mendimit të mjekut ishte *angina pectoris.* Haradin Bala merrte ilaçe.[2218] Dr. Fitim Selimi i rekomandoi Haradin Balës të kryente vetëm punë të lehta fizike për të shmangur stërmundimin.[2219] Dr. Zeqir Gashi dëshmoi se Haradin Bala erdhi në klinikën e tij një herë ose dy herë për kontroll. Ai u ankua për tension të lartë dhe rrahje të çrregullta të zemrës.[2220] Dr. Zeqir Gashi dëshmoi se Haradin Bala i tregoi atij ilaçet që merrte që ishte bllokues beta. Dr. Zeqir Gashi dëshmoi se ky ilaç rregullon punën e zemrës në rastet e aritmisë.[2221] Gjithashtu ka edhe faktorë kundërshtues. Edhe pse Haradin Bala vuante nga tension i lartë dhe rrahje të çrregullta të zemrës që para vitit 1998, gjithsesi ai iu bashkua UÇK-së dhe shërbeu si ushtar, para, gjatë dhe kohë pas ngjarjeve të pretenduara në Aktakuzë. Megjithëse për pjesën më të madhe të kohës së tij ai ishte i zënë me detyra më të lehta,[2222] gjatë shërbimit të tij në

[2215] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 845.
[2216] Ali Thaqi, T 7024-7026; Kadri Dugolli, T 7007-7009.
[2217] Kadri Dugolli, T 7012.
[2218] Dr Fitim Selimi, T 6949-6950.
[2219] Dr Fitim Selimi, T 6951.
[2220] Dr Zeqir Gashi, T 5621-5622.
[2221] Dr Zeqir Gashi, T 5641.
[2222] Skënder Bylykbashi, T 6975.

UÇK ai mori pjesë edhe në operacione konkrete ushtarake.[2223] Pavarësisht gjendjes së tij fizike, ky është tregues se ai, ose mundi të angazhohej në veprimtari fizike të mundimshme luftarake, ose nuk u rezervua gjithmonë ndaj kërkesave fizike të shërbimit në UÇK për shkak të gjendjes së tij fizike, ose të dyja. Përfundimi i Dhomës është se dëshmitë mbi këtë çështje nuk tregojnë se Haradin Bala nuk do të kishte mundur të merrte pjesë në veprimet me të cilat ngarkohet në Aktakuzë. Përkundrazi përfundimi i Dhomës është se ai ishte i aftë për kryerjen e veprimeve për të cilat akuzohet por duke i bërë këto ai do të kishte vepruar jo me maturi sepse dilte rreziku i një problemi më serioz me zemrën e tij. Ky rrezik mund të ketë pakësuar gatishmërinë e Haradin Balës për të marrë pjesë në veprimet më të lodhshme. Kjo do të merret parasysh gjatë shqyrtimit të dëshmive në lidhje me kryerjen e këtyre veprimeve prej Haradin Balës.

649. Pasi ka shqyrtuar veç e veç dhe së bashku dëshmitë në lidhje me nëse është provuar se i Akuzuari Haradin Bala ishte rojë e UÇK-së në kamp-burg në Llapushnik në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën veçanërisht lidhur me identifikimin prej viktimave dhe të tjerëve, alibinë dhe shëndetin e Haradin Balës dhe duke marrë parasysh të tëra rrethanat, Dhoma është e bindur dhe nxjerr përfundimin se në të vërtetë i Akuzuari Haradin Bala ishte ushtar i UÇK-së dhe rojë burgu i njohur si Shala i cili vepronte në kamp-burgun e UÇK-së në Llapushnik midis 9 majit 1998 dhe 25 ose 26 korrikut 1998. Përfundimi i Dhomës është se ai është roja i përmendur si Shala në atë kontekst në dëshmitë e tetë viktimave përmendur më herët në këtë Aktgjykim dhe viktimave dhe dëshmitarëve të tjerë. Gjithashtu Dhoma nxjerr përfundimin se ai është roja i UÇK-së i njohur si Shala i cili me një tjetër i njohur si Murrizi i çuan të burgosurit nga kamp-burgu në malet e afërta të Berishës më 25 ose 26 korrik 1998 ndërkohë që forcat serbe përparuan drejt Llapushnikut. Dëshmitë në lidhje me praninë dhe veprimet e Shalës në malet e Berishës shqyrtohen gjetiu. Haradin Bala bashkë me Murrizin dhe ndoshta me një ushtar të tretë të UÇK-së ishte njëri prej shoqëruesve të armatosur të UÇK-së në komandë të grupit të fundit të të burgosurve në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998 pasi disa të burgosur ishin liruar prej Haradin Balës dhe Murrizit, gjatë kohës kur shumë prej atyre në këtë grup të fundit u vranë.

650. Dhoma thekson veçanërisht, edhe pse është e nevojshme të përsëritet çfarë është thënë se Dhoma nuk ka dyshim të arsyeshëm që cënon ndonjë prej këtyre përfundimeve, pavarësisht mundësive për identifikim të gabuar prej viktimave dhe të tjerëve, ose prej alibisë së paraqitur prej Mbrojtjes së Haradin Balës ose prej shëndetit të Haradin Balës në periudhën në fjalë.

[2223] Elmi Sopi, T 6746-6747.

(c) Roli i Haradin Balës

(i) Pjesëmarrje në kryerjen e krimeve konkrete

651. Prokuroria parashtron se Haradin Bala mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale ku përfshihet kryerja e krimeve të ngarkuara në Aktakuzë. Konkretisht Prokuroria akuzon se ai mori pjesë në zbatimin e burgimit të civilëve serbë dhe shqiptarëve të konsideruar si bashkëpunëtorë në kamp-burgun e Llapushnikut, në marrjen e tyre në pyetje, trajtimin e egër dhe çnjerëzor, sulme fizike dhe psikologjike, tortura dhe rrahje si edhe vrasje. Gjithashtu Prokuroria akuzon se Haradin Bala planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe personalisht mori pjesë në vrasjen e dhjetë civilëve shqiptarë në malet e Berishës. Prokuroria akuzon se Haradin Bala mori pjesë në fshehjen e vrasjes së të burgosurve të kamp-burgut nëpërmjet varrosjes së kufomave dhe mori pjesë në orvatjen për mbajtjen në fshehtësi të ekzistencës së kamp-burgut.[2224]

a. Tortura, trajtim mizor dhe vrasje në kamp-burgun e Llapushnikut ose rreth tij (Pikat 4, 6 dhe 8)

652. Është provuar se kushtet e mjerueshme të burgimit të paktën në disa pjesë të kamp-burgut të Llapushnikut përbëjnë trajtim mizor. Dhoma ka nxjerrë përfundimin se ushqimi dhe uji nuk jepeshin rregullisht ose mjaftueshmërisht dhe se mjetet për fjetje dhe pastrim ishin krejt të papërshtatshme.[2225] Kushtet e burgimit ishin në një masë të madhe në varësi të veprimeve ose mosveprimeve të Haradin Balës. Ish-të burgosurit dëshmuan në mënyrë përputhëse se personi të cilin ata e njohën si Shala dhe për të cilin Dhoma nxori përfundimin se ishte Haradin Bala ishte rojë në kamp-burg. Ai kishte çelësat. Ishte Haradin Bala i cili herë pas here hapte dyert dhe u binte ushqim të burgosurve.[2226] Haradin Bala kishte kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit dhe vazhdimisht pa me sytë e tij kushtet në secilën pjesë të kamp-burgut. Herë pas here Haradin Bala hapte dyert e fllanikut, dhe Dhoma supozon, të ahurit për t'i ajrosur apo duke i lejuar të burgosurit të dilnin.[2227] Mirëpo siç është provuar ky veprim jo i vazhdueshëm bëri pak për përmirësimin e kushteve. Ishte shumë pak dhe shumë rrallë. Herë pas here në mënyrë jo të rregullt ai mbikëqyrte zbrazjen e kovave në fllanik dhe ahur të cilat shërbenin për nevojat personale të të gjithë të burgosurve.[2228] Në fillim nuk kishte madje as kovë. Mirëpo kjo nuk bëhej aq shpesh sa duhej dhe kovat tejmbusheshin dhe derdheshin. Të paktën në ahur, të burgosurit e lidhur me zinxhirë dhe ata të lidhur njëri me tjetrin nuk kishin asnjë mundësi tjetër veçse të jashtëqitnin në rrobat e tyre.

[2224] Aktakuzë, paragrafi 12.
[2225] *Shih më sipër,* paragrafët 285-289.
[2226] *Shih më sipër,* paragrafët 286-287; 621.
[2227] *Shih më sipër,* paragrafët 286-287.

Haradin Bala nuk bëri asgjë për mundësimin e kujdesit mjekësor për shumë që kishin nevojë edhe pse ai e dinte se aty afër ishte klinika.[2229] Rrjedhimisht Haradin Bala mori pjesë personalisht, nëpërmjet mosveprimeve të tij, në mbajtjen dhe zbatimin e kushteve të burgimit të cilëve iu nënshtruan të burgosurit, element material i krimit të trajtimit mizor. Meqënëse këto kushte u mbajtën për shumë javë, gjatë të cilave Haradin Bala hyri shpesh në dhomat ku mbaheshin të burgosurit dhe ndonjëherë u dha ndihmë, mosdhënia e ndihmës prej tij në raste të tjera të shumta e bind Dhomën se ai kishte synim mbajtjen e këtyre kushteve. Rrjedhimisht Dhoma përfundon se Haradin Bala bashkë me persona të tjerë kreu krimin e trajtimit mizor.

653. Në lidhje me disa prej veprimeve të keqtrajtimit dhe vrasjeve të ngarkuara në Aktakuzë, Dhoma ka nxjerrë përfundimin se janë provuar elementët e krimeve, trajtim mizor, torurë dhe vrasje si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit. Në disa prej këtyre rasteve nuk ka prova për përfshirjen e drejtpërdrejtë të Haradin Balës në kryerjen e krimit. Mirëpo dëshmitë tregojnë se Haradin Bala ndërmori veprime të cilat ishin disi të lidhura me kryerjen prej të tjerëve të këtyre krimeve.

654. Incidenti i parë lidhet me keqtrajtimin e L06-ës për të cilin Dhoma gjykoi se përbën trajtim mizor dhe torturë.[2230] Sipas dëshmisë së L10-ës, L06 u nxor nga Dhoma prej Shalës, i cili sipas përfundimit të Dhomës ishte i Akuzuari Haradin Bala dhe kur L06-ën e kthyen, ai tha se ishte rrahur. Vetë L06 deklaroi se Haradin Bala vetëm e zgjidhi nga zinxhirët ditën e mëparshme para natës kur u rrah dhe se atë e kishin nxjerrë nga dhoma dhe e kishin kthyer persona të tjerë.[2231] Dëshmitë e L06-ës dhe L10-ës ndryshojnë në lidhje me rolin e Haradin Balës. Dhoma nuk është e gatshme të parapëlqejë në këtë pikë si më të besueshme dëshminë e L10-ës sepse L06 u përfshi drejtpërsëdrejti në këtë incident. Rrjedhimisht Dhoma e bën analizën mbi bazën se i vetmi veprim që mund ta lidhë Haradin Balën me rrahjen e L06-ës ishte zgjidhja e L06-ës nga zinxhirët pak orë para keqtrajtimit. Mirëpo është mjaft e paqartë lidhja midis këtij veprimi dhe keqtrajtimit konkret. Edhe pse L06 e përmendi emrin e Shalës në kontekstin e këtij incidenti konkret të rrahjes, nuk është provuar që zgjidhja e L06-ës nga zinxhirët ishte e lidhur në ndonjë mënyrë me rrahjen e mëvonshme. Për këto arsye Prokuroria nuk ka provuar se Haradin Bala mori pjesë në ndonjë mënyrë në rrahjen e L06-ës.

[2228] *Shih më sipër,* paragrafin 286.
[2229] Siç është provuar më sipër, Haradin Bala shkoi në klinikën e Dr Zeqir Gashit e cila ndodhej në Llapushnik. *Shih më sipër,* paragrafin 648.

[2230] *Shih më sipër,* paragrafët 305-306.

655. L10 dëshmoi se ai u keqtrajtua nga Shala i identifikuar si Haradin Bala. Siç është gjykuar më herët në këtë vendim, Haradin Bala i mbështeti tytën e armës në kokë L10-ës dhe e kërcënoi.[2232] Për këtë incident është përcaktuar se përbënte veprën penale të trajtimit mizor. Është provuar pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e Haradin Balës në kryerjen e këtij krimi. Ai mund të ketë vepruar vetëm me synimin e shkaktimit të vuajtjes mendore ndaj L10-ës. Rrjedhimisht Dhoma e gjykon Haradin Balën përgjegjës për kryerjen e krimit të trajtimit mizor në këtë rast.

656. Një incident tjetër ku përfshihet Haradin Bala lidhet me keqtrajtimin e L04-ës për të cilin Dhoma gjykon se përbënte trajtim mizor.[2233] L04 deklaroi se Tamuli i tha Shalës të zgjidhte L04-ën. Siç është provuar më parë, pastaj L04-ës iu lidhën sytë, u nxor nga dhoma dhe u rrah prej individëve të cilët L04 mendoi se ishin Tamuli dhe Çerçizi.[2234] Shala kishte automatik dhe ruante derën. Mirëpo ai nuk mori pjesë personalisht në rrahjen e L04-ës.[2235] Dhoma pranon dëshminë e L04-ës mbi rrethanat e keqtrajtimit të tij. Ajo gjykon se Haradin Bala nuk i shkaktoi vuajtje fizike L04-ës. Megjithatë ai u dha ndihmë praktike kryesve të drejtpërdrejtë të veprës penale të trajtimit mizor. Ai garantoi më mirë se L04 nuk mund t'i shpëtonte rrahjes apo që rrahja të mos ndërpritej prej personave të tretë. Rrjedhimisht përfundimi i Dhomës është se pjesëmarrja e Haradin Balës kishte "ndikim thelbësor mbi kryerjen"[2236] e krimit të trajtimit mizor. Në këto rrethana Haradin Bala nuk mund të mos ketë ditur synimet e kryesve të drejtpërdrejtë. Sigurisht që ai e dinte se po kryhej një krim. Megjithatë ai qëndroi dhe në këtë mënyrë lehtësoi kryerjen. Rrjedhimisht ai është përgjegjës për ndihmë në krimin e trajtimit mizor në lidhje me L04-ën.[2237]

657. Siç është treguar më parë në këtë vendim, Shala i identifikuar prej dëshmive si Haradin Bala mori pjesë drejtpërsëdrejti në një incident tjetër lidhur me L04-ën dhe L10-ën. Haradin Bala detyroi L04-ën dhe L10-ën si edhe një individ tjetër të varrosnin kufomat e tre personave, ndër ata edhe kufomën e Agim Ademit. Dëshmitë e L04-ës dhe L10-ës në lidhje me këtë ngjarje ndryshojnë në disa hollësi. Gjithsesi ato përputhen në lidhje me pikat thelbësore se çfarë ndodhi dhe veçanërisht në lidhje me sjelljen e Haradin Balës të cilin të dy dëshmitarët e përmendën si Shala. Shala u lidhi sytë dhe i çoi me makinë në një vend ku iu kërkoi të hapnin një varr. L04, L10 dhe një individ tjetër morën një kazmë dhe një lopatë me të cilët kryen detyrën e dhënë nga Shala. Ata i varrosën të tri

---

[2231] *Shih më sipër,* paragrafin 304.
[2232] *Shih më sipër,* paragrafin 299.
[2233] *Shih më sipër,* paragrafët 311; 313.
[2234] *Shih më sipër,* paragrafin 311.
[2235] L04, T 1175-1176.
[2236] *Shih më sipër,* paragrafin 517.
[2237] *Shih* Aktgjykimin *Çelebiqi,* paragrafi 842.

kufomat në gropë.[2238] Shala i paralajmëroi se po të tregonin gjë, do të pushkatoheshin.[2239] Siç u përmend më parë, ky incident u shkaktoi vuajtje psikologjike L04-ës dhe L10-ës që sipas përfundimit të Dhomës në ato rrethana përbënte trajtim mizor. Është provuar kryerja fizike e krimit nga Haradin Bala. Haradin Bala duhet të ketë ditur për gjasën e konsiderueshme të shkaktimit të vuajtjes psikologjike si rezultat i detyrimit të L04-ës dhe L10-ës për varrosjen e kufomave të të bashkëburgosurve, duke marrë parasysh veçanërisht lëndimet e dukshme mbi kufomat dhe gjendjen e tyre. Rrjedhimisht Haradin Bala është drejtpërsëdrejti përgjegjës për kryerjen e atij krimi.

658. Janë provuar dy incidente të keqtrajtimit të L12-ës. I pari ndodhi pas ardhjes së tij në kamp-burg. Sipas përfundimit të Dhomës Haradin Bala i përmendur në dëshminë e L12-ës si Shala, e lidhi L12-ën pas murit me zinxhirë dhe e rrahu me shkop derisa L12 humbi ndjenjat. Siç është provuar, edhe pse dëshmitë nuk zbulojnë se Haradin Bala nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në veprimtari të mundimshme si për shembull rrahja e zgjatur e një personi, ka rëndësi se aftësia e tij për të bërë veprime të tilla u ndikua për keq.[2240] Mirëpo dëshmitë në lidhje me rolin e Haradin Balës në këtë incident janë përputhëse dhe bindëse. Dëshmia e L12-ës si viktima e incidentit përputhet me L04-ën, i cili e pa incidentin dhe konfirmoi kohëzgjatjen dhe rezultatin e rrahjes. Në këtë mënyrë Haradin Bala kreu fizikisht veprën penale të trajtimit mizor pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore. Rrethanat e incidentit dhe veçanërisht egërsia dhe kohëzgjatja e rrahjes e bindin Dhomën se Haradin Bala veproi me synimin për t'i shkaktuar vuajtje fizike L12-ës. Rrjedhimisht Haradin Bala është përgjegjës për kryerjen e veprës penale të trajtimit mizor në lidhje me këtë incident sipas përfundimit të Dhomës. Rasti tjetër i keqtrajtimit të L12-ës i provuar më parë në këtë vendim ishte rrahja e L12-ës në një hambar. Haradin Bala ia lidhi sytë L12-ës dhe e solli në një hambar ku ai u rrah.[2241] L12 dëshmoi se Shala ishte i pranishëm gjatë incidentit.[2242] Gjithsesi Dhoma e pranon dëshminë e L12-ës se pjesëmarrja e Haradin Balës në incident u kufizua në çuarjen e L12-ës te kryesit dhe në praninë e tij gjatë rrahjes. Dhoma gjykon se duke e çuar L12-ën në hambar dhe duke qenë i pranishëm gjatë rrahjes së tij prej të tjerëve, Haradin Bala kontribuoi në kryerjen e krimit në atë masë sa pjesëmarrja e tij të konsiderohet si ndihmë në veprën penale të kryer nga kryesit e drejtpërdrejtë. Në këto rrethana Haradin Bala duhet të ketë ditur të paktë në kohën e rrahjes, se rrahësit po kryenin një krim dhe për gjendjen e tyre mendore. Rrjedhimisht ai kishte gjendjen e nevojshme mendore kriminale për ndihmë dhe inkurajim. Siç është provuar më parë ky incident

[2238] *Shih më sipër,* paragrafët 299; 312 dhe 399-401.
[2239] L10, T 2946.
[2240] *Shih më sipër,* paragrafin 648.
[2241] *Shih më sipër,* paragrafin 316.
[2242] L12 deklaroi se Shala duhej të dinte për çfarë po flisnin individët që rrahën L12-ën sepse ai ishte atje; L12, T 1808.

përmban elementë të trajtimit mizor dhe torturës, mirëpo siç do të përmendet pak më vonë Dhoma mund të nxjerrë një përfundim vetëm në lidhje me akuzën për torturë (Pika 4).

659. Në dëshmitë lidhur me keqtrajtimin e Emin Eminit është përmendur Haradin Bala. L10 dëshmoi se Shala bashkë me dy të tjerë e nxorën Emin Eminin nga fllaniku për ta rrahur. Mirëpo për arsyet e përmendura më parë, me gjithë këtë dëshmi, nuk është e mundshme të përcaktohet identiteti i individëve të cilët e nxorën Emin Eminin nga fllaniku.[2243] Nga dëshmia nuk sugjerohet as edhe se vetë Haradin Bala e rrahu Eminin.

660. Siç është treguar, dëshmitë lidhur me keqtrajtimin dhe vdekjen e Fehmi Xhemës kanë disa mospërputhje. Konkretisht nuk është provuar nëse Haradin Bala ishte njëri prej atyre që e nxorën Fehmi Xhemën prej fllanikut dhe e kthyen atë pas rrahjes. Siç është përmendur më parë, Dhoma vlerësoi se të dy, edhe L06, edhe L10 të cilët dhanë dëshmi të ndryshme për keqtrajtimin e Fehmi Xhemës ishin dëshmitarë të ndershëm.[2244] Në mungesë të dëshmive të tjera mbi këtë çështje nuk ka arsye për parapëlqim të secilës prej këtyre dy dëshmive. Rrjedhimisht Dhoma gjykon në dobi të Haradin Balës se ai nuk mori pjesë në keqtrajtimin e Fehmi Xhemës, drejtpërdrejtë ose duke ndihmuar.

661. Në dëshmitë e L06-ës dhe L10-ës identifikohet pjesëmarrja e Haradin Balës në heqjen e kufomës së Fehmi Xhemës siç menduan ata. Të dy edhe L06 edhe L10 deklaruan se Shala dhe dy ushtarë të tjerë erdhën në fllanik për të hequr kufomën e Fehmi Xhemës.[2245] Mirëpo dëshmitë ndryshojnë në lidhje me kohën e kësaj ngjarjeje. L06 dëshmoi se Fehmi Xhema, të cilin ai e mendoi të vdekur në atë kohë, ishte në dhomë për tri ditë para se ta hiqnin.[2246] L10 deklaroi se kufoma u hoq të nesërmen e rrahjes së rëndë.[2247] Pavarësisht këtyre ndryshimeve Dhoma është e bindur se njëri prej tre ushtarëve të cilët e hoqën Fehmi Xhemën thuajse të vdekur nga fllaniku ishte Haradin Bala. Siç është treguar më parë, Fehmi Xhema u pushkatua më pas.[2248] Mirëpo dëshmitë nuk mundësojnë përcaktimin e identiteteve të atyre që pushkatuan Fehmi Xhemën. Nuk është provuar se ata ishin të njëjtët njerëz që e hoqën Fehmi Xhemën nga fllaniku për herë të fundit. Për më tepër nuk mund të përcaktohet koha e vdekjes së Fehmi Xhemës. Rrjedhimisht është e paqartë nëse synimi i heqjes së Fehmi Xhemës nga fllaniku prej tre ushtarëve, ndër ta edhe Haradin Bala, ishte

[2243] *Shih më sipër,* paragrafin 412.
[2244] *Shih më sipër,* paragrafët 327-331.
[2245] L06, T 1013; L10, T 2942.
[2246] L06, T 1013.
[2247] L10, T 2942.
[2248] *Shih* më sipër paragrafin 336.

ekzekutimi i tij i menjëhershëm. Duke marrë parasysh mungesën e provave për këto pika, Dhoma nuk është e bindur se Haradin Bala mori pjesë në pushkatimin e Fehmi Xhemës, dhe as se është provuar ndihma e tij për vrasësit.

662. Siç është përmendur më herët, Haradin Bala urdhëroi tre të burgosur, ndër të cilët L04-ën dhe L10-ën të varrosnin tri kufoma ndër të cilët edhe Agim Ademin. Mirëpo nuk ka prova se ai mori pjesë drejtpërdrejtë në vrasjen e cilitdo prej atyre treve. Prej rrethanave të provuara mund të nxirret përfundimi se Haradin Bala e dinte se Agim Ademi ishte pushkatuar. Ka dëshmi se një plagë plumbi ishte e dukshme. Si rojë burgu ai gjithashtu duhet të ketë ditur se Agim Ademi ishte mbajtur në kamp-burg. Mirëpo asgjë nuk sugjeron se Haradin Bala kishte pranuar të ndihmonte në kohën e planifikimit, përgatitjes ose kryerjes së krimit[2249] ose në lidhje me dy të burgosurit e tjerë. Edhe pse gjasa e një marrëveshjeje të tillë paraprake është e qartë, prej dëshmive gjithashtu mund të supozohet se Haradin Bala mësoi për vrasjet më pas dhe u urdhërua vetëm për heqjen e kufomave nga kamp-burgu. Dhoma gjykon se dëshmitë nuk provojnë se Haradin Bala ndihmoi në kryerjen e vrasjes së Agim Ademit ose dy të burgosurve të tjerë.

663. Siç është treguar më parë, Prokuroria sugjeroi se kufomat që L04 dhe L10 u detyruan të varrosnin së bashku me kufomën e Agim Ademit, ishin Jefta Petkoviq dhe Zvonko Marinkoviq.[2250] Më parë Dhoma ka nxjerrë përfundimin se dëshmitë nuk mbështesin pretendimin se kufoma e Jefta Petkoviqit, vrasja e të cilit është provuar, ishte njëra prej kufomave të cilat L04 dhe L10 varrosën me urdhër të Haradin Balës. Rrjedhimisht nuk është provuar asnjë lidhje midis vrasjes së Jefta Petkoviqit dhe të Akuzuarit Haradin Bala.

b. Vrasjet në malet e Berishës (Pika 10)

664. Dhoma ka nxjerrë përfundimin se Haradin Bala dhe Murrizi dhe ndoshta një ushtar i tretë i UÇK-së morën pjesë drejtpërdrejtë në pushkatimin e grupit të vogël të mbetur të të burgosurve të cilët ishin midis atyre që ata detyruan të ecnin për në malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998 dhe të cilët mbetën pas lirimit të grupit të parë.[2251] Është provuar se nëntë prej këtyre të burgosurve u ekzekutuan atë ditë në malet e Berishës. Haradin Bala mori pjesë fizikisht në elementët materialë të krimit të vrasjes bashkë me Murrizin dhe ndoshta me një ushtar të tretë të UÇK-së. Siç është

[2249] *Shih* Aktgjykimin *Blagojeviq,* paragrafi 731.
[2250] *Shih më sipër,* paragrafin 390.
[2251] *Shih më sipër,* paragrafin 454.

përmendur më parë,[2252] duke marrë parasysh rrethanat e vrasjes dhe pozicionin e viktimave, Dhoma ka përfunduar se Haradin Bala veproi me synimin për kryerjen e vrasjes gjatë pjesëmarrjes së tij në vrasjen e këtyre viktimave. Ai është përgjegjës si kryes i drejtpërdrejtë në vrasjen e nëntë të burgosurve.

(ii) Pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale

665. Në pjesët e mëparshme është provuar se individët e mbajtur në kamp-burgun e Llapushnikut u mbajtën në kushte të mjerueshme dhe disa prej tyre iu nënshtruan keqtrajtimit. Prokuroria parashtron se krimet e përmendura në Aktakuzë ishin brenda objektivit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale e cila filloi para majit 1998 dhe vazhdoi të paktën deri në gusht 1998. Prokuroria pretendon se synimi i asaj ndërmarrjeje kriminale ishte përzgjedhja e civilëve serbë dhe shqiptarëve të konsideruar bashkëpunëtorë për frikësim, burgosje, dhunë dhe vrasje.[2253]

666. Gjithsesi nuk ka prova të drejtpërdrejta që vërtetojnë ekzistencën ose shtrirjen e ndërmarrjes së pretenduar kriminale. Më së shumti, ekziston mundësia e nxjerrjes së një supozimi prej ekzistencës së kamp-burgut se ishte një projekt apo plan prej dikujt apo prej një grupi, ndoshta në UÇK për burgosjen e një numri të caktuar individësh. Për ata që janë zbuluar prej dëshmive, arsyet për burgimin e këtyre personave ndryshojnë rast pas rasti por për shumicën dërmuese të rasteve janë të paqarta ose mbeten të panjohura. Fakti se kamp-burgu funksionoi të paktën për gjashtë javë[2254] dhe mbi tridhjetë të burgosur u mbajtën atje,[2255] mund të sugjerojë se funksionimi i tij mbështetej në bashkëpunimin e një numri të caktuar personash. Në Aktakuzë identifikohen vetëm tre të Akuzuarit si pjesëmarrës në ndërmarrjen e përbashkët kriminale por vazhdohet me fjalë të përgjithshem për ushtarë dhe roje të tjerë të UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së pjesëmarrës në arrestimet e civilëve serbë dhe shqiptarëve të konsideruar bashkëpunëtorë.[2256] Dëshmitë tregojnë se në kryerjen e veprimeve kriminale të provuara në këtë vendim morën pjesë një numër njerëzish. Ishin të paktën dy roja, Haradin Bala dhe personi i njohur si Murrizi.[2257] Personi për të cilin dëshmitarët mendonin se ishte Çerçizi mori pjesë në rrahje dhe marrje në pyetje.[2258] L96 përmendi pesë apo gjashtë ushtarë të UÇK-së të cilët rrahën Shaban

[2252] *Shih më sipër,* paragrafët 461; 466; 471; 476; 482; 487; 492; 501 dhe 506.
[2253] Aktakuzë, paragrafët 7-8.
[2254] *Shih më sipër,* paragrafin 282.
[2255] *Shih më sipër,* paragrafët 243-279; 319-446.
[2256] Aktakuzë, paragrafi 9.
[2257] *Shih më sipër,* paragrafin 276.
[2258] *Shih më sipër,* paragrafin 311.

Hotin,[2259] dhe një ushtar për të cilin L96 mendonte se quhej Avdullah, i cili e shoqëronte L96-ën në nevojtore.[2260] L06 përmendi si keqtrajtues të tij Ramadan Behlulin dhe Ali Gashin.[2261] Dëshmitarët gjithashtu dëshmuan për praninë e ushtarëve të maskuar në kamp. Duke marrë parasysh llojin e dëshmive në dispozicion, për arsyet e dhëna gjetiu në këtë Aktgjykim, Dhoma nuk mund të përcaktojë identitetet e atyre që morën pjesë në funksionimin e kamp-burgut veç të Akuzuarit Haradin Bala. Nuk ekziston absolutisht asnjë dëshmi që të provojë se si apo me vendim të kujt u ngrit kamp-burgu apo se në çfarë mënyre apo me urdhër të kujt iu caktuan Haradin Balës detyrat në kamp. Megjithëse dëshmitë mund të mbështetnin një hamendje, mbi një pikëpamje të mundshme, se duhet të ketë ekzistuar një farë ndërmarrje e përbashkët kriminale e përbërë prej personash të panjohur të cilët ishin anëtarë të UÇK-së, kjo është kaq e përgjithshme saqë nuk mund të ofrojë një kategorizim të mjaftueshëm për identifikimin e pjesëmarrësve në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.[2262]

667. Në lidhje me krimet e ndryshme të kryera kundër të burgosurve të ndryshëm në kamp, në bazë të dëshmive në dispozicion nuk mund të përjashtohet se disa prej kryesve të krimeve të provuara në kamp-burg ose në lidhje me të, i kryen ato thjesht si vizitorë të cilët erdhën përkohësisht në kamp dhe gjatë pranisë së tyre atje për arsye personale si hakmarrje keqtrajtuan ose vranë armiqtë e vjetër. Është e vërtetë se "vizitorë të tillë përfitues" mund të kenë qenë edhe pjesëmarrës në ndërmarrjen e përbashkët kriminale duke kontribuar në rezultatin e përgjithshëm të kamp-burgut. Mirëpo për të provuar pjesëmarrjen e tyre, do të ishte e nevojshme të provohej se kontributi i tyre në përmbushjen e synimit të përbashkët të ndërmarrjes së pretenduar kriminale ishte thelbësor.[2263] Në rrethanat aktuale duke marrë parasysh dëshmitë në dispozicion nuk është e mundshme të nxirret përfundimi se të tëra krimet në lidhje me kamp-burgun u kryen prej pjesëmarrësve të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale. Rrjedhimisht, nuk mund të përcaktohet me siguri të mjaftueshme se kryerja e krimeve ishte parashikuar brenda ndërmarrjes së përbashkët kriminale të pretenduar.[2264]

[2259] L96, T 2312-2314.
[2260] *Shih më sipër,* paragrafët 424; L96, T 2309.
[2261] *Shih më sipër,* paragrafin 304.
[2262] *Shih* Aktgjykimin *Bërgjanin*, paragrafi 346; *Prokurorja kundër Milorad Kërnojelac*, Çështja Nr. IT-97-25, Vendim mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar për të Dytën Herë, 11 Maj 2000, paragrafët 16-17.
[2263] Vendimi i Apelit *Kvoçka*,paragrafët 97 dhe 599.
[2264] Në vendimet e veta lidhur me ndërmarrjen e përbashkët kriminale Dhoma e Apelit përmendi krimet e kryera "nga një ose më shumë [pjesëmarrës në planin e përbashkët]" dhe "anëtarë të tjerë të grupit", duke bërë kështu të qartë se vetëm krimet e kryera nga një ose më shumë pjesëmarrës në këtë ndërmarrje mund të shkaktojnë përgjegjësinë e pjesëmarrësve të tjerë; *shih,* për shembull, Vendimin e Apelit *Tadiq,*paragrafi 220; Vendimi i Apelit *Kvoçka*, paragrafi 99.

668. Gjithashtu dëshmitë lënë të hapur çështjen se gjatë kohës në fjalë disa anëtarë të UÇK-së ndaluan njerëz për arsye të tjera dhe jo për realizimin e strategjisë së UÇK-së për të lufuar bashkëpunimin me autoritetet serbe. Siç është përmendur më parë, pati për shembull raste rrëmbimesh në të cilat faktori motivues ishte hakmarrja personale e anëtarëve individualë të UÇK-së.[2265] Rrjedhimisht nuk mund të përjashtohet se në disa raste kryesit e krimeve të kryera në kamp-burg ose në lidhje me të mund të jenë nxitur prej motiveve të tilla.[2266] Kjo e rrit disi gjasën që personat pjesëmarrës në funksionimin e kampit apo "vizitorët përfitues" të kamp-burgut kryen krime për arsye personale si për shembull shpagim. Rrjedhimisht nuk mund të përcaktohet me siguri të mjaftueshme se faktikisht këto krime u kryen për realizimin e ndonjë strategjie apo plani të UÇK-së për përzgjedhjen e civilëve serbë dhe shqiptarëve të konsideruar bashkëpunëtorë.

669. Në mungesë të provave që tregojnë se një grup individësh identitetet e të cilëve së paku mund të provoheshin duke iu referuar kategorisë së tyre si grup, në kuptimin e përcaktuar në jurisprudencë, zbatuan një plan të përbashkët, dhe duke marrë parasysh mungesën e provave në lidhje me objektivin e një plani të tillë, nuk janë provuar elementët kryesorë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Argumenti i Prokurorisë është shumë i mangët në informacione faktike që do t'a bindte Dhomën jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale në të cilën Haradin Bala ishte pjesëmarrës. Rrjedhimisht, nuk ka kuptim të shqyrtohet më tej roli i Haradin Balës në kamp dhe nëse kjo mund të tregonte se ai u përfshi në një ndërmarrje të përbashkët kriminale të pretenduar. Prokuroria nuk ka vërtetuar ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale siç pretendohet.

(d) Përfundime

670. Haradin Bala është identifikuar si rojë në kamp-burg, i njohur si Shala. Ai e kreu këtë rol gjatë periudhës së ekzistencës së kamp-burgut dhe mori pjesë në kryerjen e një sërë krimesh. Haradin Bala kreu drejtpërdrejtë krimin e trajtimit mizor nëpërmjet rolit të tij në mbajtjen dhe zbatimin e kushteve të mjerueshme të burgimit në pjesë të kamp-burgut. Gjithashtu Dhoma ka nxjerrë përfundimin se duke kërcënuar me armë në kokë L10-ën, duke detyruar L04-ën dhe L10-ën për të varrosur kufomat e gjymtuara të tre të bashkëburgosurve dhe duke rrahhur L12-ën, Haradin Bala kreu përsëri krimin e trajtimit mizor. Gjithashtu është përcaktuar se Haradin Bala ndihmoi në krimin e kryerjes së torturës prej të tjerëve kundër L12-ës dhe në një rast tjetër të trajtimit mizor

[2265] *Shih më sipër,* paragrafin 216; Susanne Ringgaard Pedersen, T 3532.
[2266] Dhoma thekson se përfundimi i saj se grindja familjare e përmendur nga Mbrojtja e Haradin Balës nuk ka ndikim mbi ngjarjet në kamp-burg lidhej konkretisht dhe vetëm me atë grindje; *Shih më sipër,* paragrafin 31. Mund të kenë ekzistuar grindje të tjerë, ku të jenë përfshirë persona të tjerë dhe jo i Akuzuari Haradin Bala.

prej të tjerëve kundër L04-ës. Haradin Bala është edhe drejtpërsëdrejti përgjegjës për vrasjen e nëntë të burgosurve në malet e Berishës afër kamp-burgut.

3. Përgjegjësia e Isak Musliut

(a) A u identifikua Isak Musliu në kamp-burgun e Llapushnikut?

671. Në Aktakuzë pretendohet se nga maji deri më 26 korrik 1998 Isak Musliu, me pseudonimin Çerçizi ishte komandant (dhe në disa raste rojë burgu) i kamp-burgut të Llapushnikut, dhe mori pjesë personalisht në zbatimin e burgosjes së të burgosurve, marrjen e tyre në pyetje, vrasjen e tyre dhe trajtimin e egër dhe çnjerëzor ndaj tyre.[2267]

672. Gjatë gjyqit, disa dëshmitarë të Prokurorisë pretenduan se e identifikuan Isak Musliun në kamp-burgun e Llapushnikut në kohën që ka lidhje me Aktakuzën. Dy dëshmitarë, përkatësisht L04 dhe L10 pretenduan se identifikuan një njeri të cilin e panë me maskë si Isak Musliu. Një dëshmitar tjetër, L12 as nuk e pa Isak Musliun por vetëm dëgjoi për të kur po rrihej. Asnjë prej këtyre tre dëshmitarëve nuk mundi të identifikonte Isak Musliun kur iu treguan fletë me fotografi ku përfshihej edhe fotografia e Isak Musliut. Vetëm një dëshmitar, L96 dëshmoi se e kishte parë Isak Musliun pa maskë në kamp-burgun e Llapushnikut në kohën e ngjarjeve. L96 dëshmoi se ai e pa Isak Musliun dy herë: kur arriti në kamp-burgun e Llapushnikut dhe dy ditë më vonë kur, siç pretendon, ai u rrah nga vetë Isak Musliu. Në të dy rastet Isak Musliu ishte pa maskë. Mbrojtja e Isak Musliut argumenton se këta dëshmitarë gabuan në identifikimin e Isak Musliut në kamp-burgun e Llapushnikut dhe parashtron se Isak Musliu nuk dinte dhe as mori pjesë në ngritjen dhe funksionimin e një burgu të tillë.[2268] Isak Musliu nuk dha dëshmi në mbrojtje të tij. Natyrisht që kjo është e drejta e tij dhe prej vendimit të tij nuk mund të nxirret asnjë përfundim negativ.

673. Sipas përfundimit të Dhomës, L04 u mbajt në ahur në kamp-burgun e Llapushnikut afërsisht prej 28 qershorit deri më 25 ose 26 korrik 1998.[2269] L04 dëshmoi se gjatë burgimit të tij ai dhe të burgosur të tjerë atje u rrahën nga një njeri që thirrej Çerçiz.[2270] Çdo ditë me përjashtim të tri ditëve të fundit të burgimit të L04-ës, d.m.th. afërsisht 24-26 korrik 1998,[2271] Çerçizi i nxirrte të burgosurit

[2267] Aktakuzë, paragrafët 2 dhe 11.
[2268] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 993-994; 1036-1043.
[2269] *Shih më sipër*, paragrafi 279.
[2270] L04, T 1172-1175.
[2271] L04 dëshmoi se Çerçizi i rrihte të burgosurit çdo ditë/natë të qëndrimit të tij përveç javës së fundit. T 1173-1174. Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja dëshmitari e ndreqi deklaratën e tij dhe tha se Çerçizi nuk i rrahu të burgosurit gjatë tri ditëve të fundit të burgimit të tij. T 1271-1272.

nga ahuri, ndër të cilët edhe L04-ën dhe i rrihte.[2272] Të burgosurit ktheheshin të lënduar keqas, në disa raste nuk ktheheshin.[2273] Në një rast L04 dëshmoi se Tamuli dhe Shala erdhën në ahur, ia lidhën sytë dhe e çuan në një dhomë ku po priste Çerçizi. Ai dëshmoi se Çerçizi e hodhi në dysheme, e shkelmoi dhe ia përdrodhi krahët.[2274] L04 dëshmoi se ai ndien dhimbje edhe sot e kësaj dite në këmbën dhe krahun e djathtë prej rrahjes nga Çerçizi.[2275]

674. L04 dëshmoi se ai mësoi se Çerçizi ishte Isak Musliu prej një të bashkëburgosuri në kamp-burgun e Llapushnikut, i cili ishte nga fshati i lindjes së Çerçizit, Reçak.[2276] Është e rëndësishme të thuhet se L04 dëshmoi se ai nuk e kishte parë asnjëherë fytyrën e Isak Musliut.[2277] Përkundrazi, L04 deklaroi se gjatë tërë burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut, njeriu për të cilin ai mësoi se ishte Isak Musliu mbante gjithmonë maskë.[2278] Të vetmet tipare identifikuese për Çerçizin të dhëna prej L04-ës në gjyq ishte se ai ishte person me shtatlartësi mesatare, afërsisht 170 cm i gjatë dhe se ai mbante veshur (rregullisht) uniformë të zezë.[2279]

675. Dhoma thekson se nuk ka asnjë konfirmim për identifikimin prej L04-ës të Isak Musliut nga i burgosuri prej të cilit L04 thotë se ai mësoi se kryesi ishte Isak Musliu. Ai i burgosur megjithëse i identifikuar nga L04, nuk u thirr të dëshmonte. Rrjedhimisht nuk ka as konfirmim të dëshmisë së dorës së dytë të L04-ës se ky i burgosur e përmendi me emër Isak Musliun, as nëse kjo është e vërtetë nuk ka dëshmi për bazën e identifikimit prej atij të burgosuri, të Isak Musliut. Për më tepër L04 dëshmoi se në të gjitha rastet njeriu të cilin ai e identifikon si Çerçizi mbante maskë. Jo çuditërisht L04 nuk e identifikoi Isak Musliun në fletët e fotografive të treguara prej hetuesit të UNMIK-ut Anargyros Kereakes më 16 janar 2002. Për fotografinë e Isak Musliut e cila iu tregua ai tha se "duket i njohur si në Llapushnik por nuk [jam] i sigurtë."[2280] Gjatë dëshmisë së tij L04 nuk mundi të jepte një përshkrim të tipareve të fytyrës sepse Çerçizi mbante gjithmonë maskë dhe dha vetëm një përshkrim të kufizuar të njeriut për të cilin ai mendonte se ishte Çerçizi. Në lidhje me këtë ai thotë: "ai është me shtatlartësi mesatare, me përmasa afërsisht 1 metër e 70 cm. Kështu mund ta përshkruaj".[2281] Nuk jepet asnjë përshkrim tjetër me përjashtim të uniformës. L04 dëshmoi se gjatë burgimit të tij në Llapushnik, Çerçizi mbante uniformë të zezë. Ka dëshmi se uniforma

[2272] L04, T 1139-1140; 1172-1175.
[2273] L04, T 1173-1177, 1187.
[2274] L04, T 1175-1176.
[2275] L04, T 1206-1207.
[2276] L04, T 1173; 124341251; 1267-1268.
[2277] L04, T 1174.
[2278] L04, T 1173-1174.
[2279] L04, T 1174; 1246-1247.
[2280] L04, T 1165.
[2281] L04, T 1174.

zakonisht e përdorur prej policisë ushtarake të UÇK-së ishte e zezë.[2282] Mirëpo dëshmitë nuk çojnë në përfundimin se në kohën e burgimit të L04-ës në kamp-burgun e Llapushnikut prej 28 qershorit deri më 25 ose 26 korrik 1998, Çerçizi kishte pozitë në policinë ushtarake. Në të vërtetë dëshmitë nuk janë të qarta nëse u formua policia ushtarake e UÇK-së në rajonin në fjalë. Veç kësaj ka dëshmi se në maj 1998, shumë ushtarë të UÇK-së mbanin veshur këmisha dhe pantallona në ngjyrë të errët sepse nuk kishte uniforma të mjaftueshme për UÇK-në.[2283] Rrjedhimisht dëshmia e L04-ës nuk jep arsye të besueshme për përfundimin se Çerçizi ishte Isak Musliu ose se Isak Musliu shërbeu në kamp-burgun e Llapushnikut.

676. Dhoma është e ndërgjegjshme se L04 nuk e përmendi Çerçizin ose Isak Musliun në dy prej tri intervistave që ai u dha autoriteteve hetuese lidhur me burgimin e tij në kamp-burgun e Llapushnikut. Në intervistat që u dha hetuesve të CCIU-së të datave 16 janar dhe 13 mars 2002, L04 nuk e përmendi praninë e Isak Musliut ose Çerçizit kur përshkroi ngjarjet në kamp-burgun e Llapushnikut. Në fakt L04 e përmendi Isak Musliun në një intervistë tjetër me hetuesit më 20 mars 2002.[2284] Asnjë dokument i këtyre intervistave nuk u paraqit si provë, por L04 u pyet për përmbajtjen e këtyre intervistave në gjyq. Kur u pyet pse nuk e përmendi pjesëmarrjen e Çerçizit në kamp-burgun e Llapushnikut gjatë dy intervistave të para, L04 deklaroi se ai nuk e përmendi pasi nuk u pyet për këtë çështje.[2285] Në mungesë të provave të mjaftueshme mbi tërësinë dhe hollësitë e këtyre dy deklaratave dhe rëndësinë e lëndës së tyre, Dhoma nuk mund të ketë mendim mbi arsyeshmërinë e shpjegimit të dhënë.

677. Sipas përfundimit të Dhomës, L10 u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut prej mesit të qershorit deri më 25 ose 26 korrik 1998.[2286] Ai dëshmoi se gjatë burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut, një person i quajtur Çerçiz vinte në fllanik ku mbahej ai dhe të burgosur të tjerë dhe i keqtrajtonte të burgosurit.[2287] Gjetiu në këtë vendim, Dhoma ka shqyrtuar në hollësi dëshminë e L10-ës në lidhje me trajtimin e L06-ës dhe Fehmi Xhemës dhe gjithashtu dëshminë e L06-ës për të njëjtat incidente. Këtu Dhoma nuk do të përsërisë hollësitë e këtyre dëshmive.[2288] Në të dy rastet e përshkruara (rrahja e L06-ës dhe heqja e Fehmi Xhemës nga fllaniku), dëshmitari L10 dëshmoi se Çerçizi kishte maskë.[2289] Gjithashtu kur tregoi heqjen e Fehmi Tafës nga fllaniku, L10 dëshmoi se

[2282] Sylejman Selimi, T 2195-2196; Shukri Buja, T 4145-4147; Ramadan Behluli, T 2793-2797.
[2283] Fatmir Limaj, T 6091-6093.
[2284] L04, T 1261-1262.
[2285] L04, T 1261.
[2286] *Shih më sipër* paragrafin 279.
[2287] L10, T 2922-2927.
[2288] *Shih më sipër* paragrafët 326-338.
[2289] L10, T 2937-2939, T 3048.

ishte natë dhe se ai dhe të burgosurit e tjerë në fllanik po flinin kur dy njerëz të maskuar hynë në dhomë. Ai dëshmoi se i pa të dy njerëzit vetëm prej llampave të dorës që mbanin.[2290] Dhoma thekson se L10 dëshmoi se Çerçizi ishte i maskuar jo vetëm në dy rastet e lartpërmendura por ai mbante gjithmonë maskë dhe ai nuk e pa asnjëherë fytyrën e tij gjatë burgimit. Megjithëse ai jep një përshkrim fizik të njeriut për të cilin mendoi se ishte Çerçizi, i bëshëm, jo shumë i gjatë, me uniformë kamuflimi (jo të zezë siç tha L04) dhe me automatik, gjatë pyetjeve nga Mbrojtja ai pranoi se nuk mund ta dallonte Çerçizin prej ushtarëve të tjerë në kamp për shkak të maskës që mbante.[2291] L10 dëshmoi se e vetmja arsye për të cilën ai e identifikoi kryesin e maskuar si Çerçizi është se një ushtar tjetër për të cilin ai thotë se është Shala, iu drejtua atij si Çerçizi.[2292] Më vonë në dëshminë e tij L10 shpjegon se më pas ai mësoi se Çerçizi ishte Isak Musliu.[2293] Mirëpo ai nuk shpjegoi si dhe nga kush e mësoi emrin e vërtetë ose të plotë të Çerçizit. Në mënyrë më të papërcaktuar, L10 thotë se një herë Emin Emini i tha se "ky njeri është nga Reçaku".[2294] Rrjedhimisht L10 nuk ofron dëshmi mbi të cilën Dhoma mund të mbështetet besueshmërisht për nxjerrjen e përfundimit se njeriu në kamp-burgun e Llapushnikut për të cilin L10 thotë se ai e njihte në atë kohë si Çerçizi është faktikisht Isak Musliu.

678. Edhe L12, sipas përfundimit të Dhomës, u mbajt në kamp-burgun e Llapushnikut në verën e vitit 1998.[2295] Në ndryshim nga dëshmitarët L04 dhe L10 të cilët dëshmuan se e kishin parë Çerçizin në kamp-burg, L12 dëshmoi vetëm se ai kishte dëgjuar pseudonimin Çerçiz kur ishte i burgosur atje. Prej dëshmisë së tij duket se një herë Çerçizi u përmend prej njërit nga individët të cilët e rrahën atë gjatë burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut.[2296] Gjatë një interviste me UNMIK-un ai nuk mund ta identifikonte Isak Musliun në një fletë me fotografi që iu tregua. Fleta me fotografi përmbante një fotografi të Isak Musliut.[2297] Kur u pyet në gjyq nëse e njihte Çerçizin L12 deklaroi "Po, e kam dëgjuar si emër por nuk e di kush […] ishte".[2298] Rrjedhimisht dëshmia e L12-ës nuk ofron asnjë bazë mbi të cilën Dhoma mund të nxjerrë përfundimin se Isak Musliu ishte në kamp-burgun e Llapushnikut në kohën e ngjarjeve që kanë lidhje me Aktakuzën.

[2290] L10, T 2939.
[2291] L10, T 2950 "Pyetje. Në rregull. Dhe duke u bazuar vetëm në cilësitë fizike, kur ju nuk mund të shihnit fytyrën e tij, si mund ta dallonit Çerçizin nga ushtarët ose njerëzit e tjerë që patë? Përgjigje. Ndoshta nuk do ta dalloja sepse ai mbante maskë dhe [k]a kaluar një kohë e gjatë."
[2292] L10, T 2950-2951; 3048.
[2293] L10, T 2951.
[2294] L10, T 3048.
[2295] *Shih më sipër* paragrafin 279.
[2296] L12, T 1808-1811.
[2297] L12, T 1779-1780.
[2298] L12, T 1811.

679. L96 është i vetmi dëshmitar i cili dëshmoi se e kishte parë Isak Musliun në kamp-burgun e Llapushnikut pa maskë. Dhoma tashmë ka arritur në përfundimin se L96 është mbajtur në fllanik në kamp-burgun e Llapushnikut afërsisht një javë në korrik 1998.[2299] Gjatë dëshmisë së tij, L96 tha se ai e kishte parë dy herë Isak Musliun në kamp-burgun e Llapushnikut.

680. Ai tha se hera e parë ishte rreth 17 ose 18 korrikut 1998 kur L96 arriti fillimisht në kamp-burgun e Llapushnikut.[2300] Ai dëshmoi se Isak Musliu hyri në fllanik dhe i urdhëroi të gjithë të burgosurit të ngriheshin në këmbë dhe të jepnin emrat e tyre. L96 komentoi se ai mendoi se ishte e çuditshme që Isak Musliu pyeti për emrin e dëshmitarit sepse ata njiheshin shumë mirë.[2301] L96 tha se kur ai dha emrin e tij, Isak Musliu u kthye nga ai dhe i tha "Ku dreqin [ke] qenë[?]".[2302] L96 dëshmon se në atë rast Isak Musliu kishte mustaqe të zeza dhe kishte mjekër jo shumë të gjatë (prej një muaji), ai mbante këmishë të zezë dhe uniformë me shenjën PU (policia ushtarake). Gjithashtu ai kishte toki-voki dhe një revolver.[2303]

681. Hera e dytë kur L96 hasi Isak Musliun në kamp-burgun e Llapushnikut ishte dy ditë pas ardhjes së tij në kamp-burg.[2304] L96 dëshmoi se Isak Musliu bashkë me Murrizin dhe një ushtar tjetër me Kallashnikov hynë në dhomën ku mbahej L96 për ta rrahur.[2305] L96 përshkroi se gjatë rrahjes, Isak Musliu e rrëzoi dëshmitarin në dysheme me një lëvizje karate dhe pastaj filloi ta shkelmonte "pa e kontrolluar veten". Ai përshkruan sesi humbi ndjenjat prej rrahjes.[2306]

682. L96 dëshmoi se ai e pa Isak Musliun pa maskë në të dy rastet.[2307] Ai e njohu njeriun e përshkruar në incidente si Isak Musliu të cilin e njihte personalisht.[2308] L96 gjithashtu deklaroi se ai e dinte pseudonimin e Isak Musliut para se të çohej në kamp-burgun e Llapushnikut për të njëjtat arsye.[2309] L96 dëshmoi se ai e njihte Isak Musliun që kur ishte 12 vjeç sepse ata banonin në fshatra fqinje. [2310]Ai shpjegoi se do të kishte qenë e pamundur të mos e kishte njohur për shkak të afërsisë së fshatrave.[2311] Mirëpo nuk kishte asnjë përshkrim tjetër për lidhjen e tyre madje as edhe një takim

[2299] *Shih më sipër* paragrafët 279; 307.
[2300] L96, T 2306-2308; 2573.
[2301] L96, T 2308.
[2302] L96, T 2307-2308.
[2303] L96, T 2306.
[2304] L96, T 2322; 2329-2330; 2573.
[2305] L96, T 2329-2330; 2516.
[2306] L96, T 2330.
[2307] L96, T 2573.
[2308] L96, T 2247-2249.
[2309] L96, T 2566.
[2310] L96, T 2248-2249.
[2311] L96, T 2248-2249.

të drejtpërdrejtë. Mungesa e provave të tilla nuk e siguron Dhomën për pretendimin e L96-ës për njohjen prej fëmijërisë. Gjithashtu Dhoma nënvizon mungesën e konfirmimit të takimeve të L96-ës me Isak Muslin dhe të rrahjes së pretenduar të tij në kamp-burg prej të burgosurve të tjerë të mbajtur në fllanik. Disa dëshmitarë për të cilët Dhoma është e bindur se u mbajtën në fllanik nuk thanë asgjë për praninë e një personi me emrin Isak Musliu ose i njohur si Çerçizi në kamp-burgun e Llapushnikut. Rrjedhimisht në lidhje me këtë pikë dëshmia e L96-ës mbetet e pakonfirmuar.

683. Dëshmia e L96-ës për dy takimet me Isak Musliun kur ai ishte i burgosur në kamp-burgun e Llapushnikut (nga 17 deri më 25 ose 26 korrik) mund mjaft lehtë të mos përputhet me dëshminë se Isak Musliu ishte ndoshta nga 19 korriku deri më 24 korrik në Rahovec duke ndihmuar në operacionet e atjeshme të UÇK-së. Në lidhje me këtë Dhoma thekson se ndërsa më 1 mars 2005, Mbrojtja e Isak Musliut paraqiti një njoftim për alibi në bazë të Rregullës 67(A)(i)(a) të Rregullores ku përmendte këtë mungesë,[2312] Mbrojtja e Isak Musliut preferoi të mos thërriste dëshmitarë në gjyq. Megjithatë ka dëshmi prej ish-anëtarëve të UÇK-së të thirrur si dëshmitarë prej Prokurorisë të cilat sugjerojnë se Isak Musliu nuk ishte në Llapushnik të pakën për një pjesë të burgimit të L96-ës. Ruzhdi Karpuzi, ushtar në njësinë Çeliku 3 dëshmoi se katër apo pesë ditë para rënies së grykës së Llapushnikut, që ndodhi më 25 dhe 26 korrik 1998, Çerçizi bashkë me ushtarë të tjerë të njësisë Çeliku 3 u larguan nga Llapushniku për të ndihmuar njësi të tjera të UÇK-në në luftimin e Rahovecit.[2313] Elmi Sopi dëshmoi se e kishte parë Isak Musliun në udhëkryqin e Rahovecit më 18 ose 19 korrik 1998.[2314] Elmi Sopi dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së nga njësia Pëllumbi kishin shkuar në Rahovec në ndihmë të popullatës civile për shkak të një sulmi serb.[2315] Duke lënë mënjanë çështjet lidhur me besueshmërinë e tij, L64 dëshmoi se më 18 ose 19 korrik 1998, Çerçizi dhe ushtarë të tjerë, ndër të cilët edhe L64, shkuan në Rahovec për të ndihmuar popullatën civile për shkak të sulmit serb.[2316] Gjithashtu L64 dëshmoi se pas kthimit të tyre nga Rahoveci, Çerçizi dhe Tamuli u kthyen çdo ditë atje për të kërkuar dy ushtarë të zhdukur. L64 dëshmoi se në këtë periudhë Çerçizi nuk ishte rregullisht në Llapushnik.[2317] Megjithëse Dhoma nuk është e gatshme të pranojë nga këto dëshmi se provohet se Isak Musliu me pseudonimin Çerçizi nuk ishte në Llapushnik në periudhat kur L96 thotë se ai e pa Isak Musliun në kamp-burg dhe e pa dy herë pa maskë, gjithsesi këto dëshmi nuk mund të hidhen poshtë si të gabuara. Rrjedhimisht Dhoma ka rezervë mbi ndershmërinë ose besueshmërinë e këtij aspekti të dëshmisë së L96-ës.

[2312] Njoftimi i Alibisë së Isak Musliut, paraqitur në bazë të Rregullës 67(A)(i)(a), 1 mars 2005.
[2313] Ruzhdi Karpuzi, T 3242.
[2314] Elmi Sopi, T 6754.
[2315] Elmi Sopi, T 6753-6754.
[2316] L64, T 4533-4537.
[2317] L64, T 4540; 4549.

684. Dhoma është e ndërgjegjshme se L96 nuk e përmendi praninë e Isak Musliut me emër ose me pseudonimin Çerçizi në Llapushnik kur u intervistua prej autoriteteve serbe, ose më vonë prej hetuesve të CCIU-së në gusht 1998.[2318] Ndoshta fakti më i rëndësishëm është se L96 nuk tregoi se ishte rrahur prej Isak Musliut. Kur u pyet prej Mbrojtjes për këto mospërmendje, L96 deklaroi se megjithëse ai kishte dhënë dëshmi "të hollësishme dhe të kujdesshme" të ngjarjeve, intervista u përqëndrua në vrasjet të cilat ndodhën gjatë burgimit të tij dhe jo në rrahjet.[2319] Gjithashtu Dhoma thekson se gjatë intervistës me autoritetet serbe, L96 përmend pjesëmarrjen e Mulsi Musliut në një vrasje në kamp-burgun e Llapushnikut.[2320] Pra ky njeri i cili mbante të njëjtin mbiemër si Isak Musliu u përmend në lidhje me një vrasje. Sidoqoftë nuk u përmend as Isak Musliu dhe as pjesëmarrja e tij në ngjarje të ndryshme që ndodhën në kamp-burgun e Llapushnikut gjatë burgimit të L96-ës atje.[2321] Dhoma ka mendimin se konteksti dhe rrethanat e këtyre dy intervistave e konfirmojnë në një farë mase argumentin e Prokurorisë se intervistat ishin paraprake, të shkurtra dhe të paplota, dhe siç duket të përqëndruara mbi vrasjet që kishin ndodhur.[2322]

685. Gjithsesi L96 e kishte identifikuar Isak Musliun në një fletë me fotografi dhe e identifikoi edhe në sallën e gjyqit. Në shkurt 2002 gjatë një interviste me hetuesit e UNMIK-ut, L96-ës iu tregua një fletë me fotografi të anëtarëve të UÇK-së.[2323] Midis fotografive ishte një fotografi e Isak Musliut. L96 dëshmoi se nuk ishte e vështirë të identifikohej Isak Musliu në fotografi.[2324] Mirëpo L96 theksoi se në fotografi Isak Musliu dukej krejt i rruar kurse në kamp-burgun e Llapushnikut ai kishte mjekër dhe mustaqe.[2325] Veç sugjerimeve të bëra nga vetë L96 se ai e njihte Isak Musliun para ngjarjeve ka edhe dëshmi se para se të identifikonte fotografinë e Isak Musliut në shkurt 2002, L96-ës i ishte treguar më parë një fotografi e Isak Musliut gjatë një interviste në gusht 2001 me hetuesin e UNMIK-ut Anargyros Kereakes.[2326] Siç është përmendur më parë në këtë vendim, parja e fotografisë në gusht 2001 mund të ketë rritur mundësinë e një identifikimi të gabuar në 2002. Gjithashtu për shkak të parjes së fotografive në 2001 dhe 2002 dhe për shkak të identifikimit të të akuzuarit në mjediset e sallës së gjyqit, është e nevojshme që Dhoma të jetë mjaft e kujdesshme dhe e matur në vlerësimin e besueshmërisë së identifikimit. Kjo ngre çështjen nëse identifikimi i shkurtit 2002 u ndikua prej fotografisë që ai kishte parë në gusht 2001. Identifikimi në gjyq i Isak

[2318] L96, T 2393.
[2319] L96, T 2393; 2549-2550.
[2320] L96, T 2550.
[2321] Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafët 264-270.
[2322] Argumentet Përmbyllëse, T 7271.
[2323] L96, T 2366-2367; Prova Materiale P103.
[2324] L96, T 2369-2370; Prova Materiale P103.
[2325] L96, T 2369-2370; Prova Materiale P103.

Musliut prej L96-ës[2327] mund të ndikohet prej të njëjtëve faktorë. Gjithashtu siç është përmendur gjetiu në këtë Aktgjykim,[2328] identifikimet në gjyq duhen trajtuar me mjaft kujdes duke marrë parasysh ndikimin e mjedisit ku ata bëhen.

686. L64 dëshmoi se ai shkoi në kamp-burgun e Llapushnikut disa herë gjatë kohës që ka lidhje me këtë proces.[2329] Ai dëshmoi se Isak Musliu, i njohur edhe si Çerçizi kishte të drejtë të hynte në kamp-burg. Megjithëse ai mban mend se e pa dy ose tri herë kur hyri, ai nuk e pa kurrë në kamp-burg.[2330] Mirëpo L64 tregoi se një herë në fund të qershorit 1998, Çerçizi hyri në kamp-burg me maskë dhe e hoqi atë kur doli.[2331] Nuk ka dëshmi të tjera që konfirmojnë ose mohojnë këtë pjesë të dëshmisë së L64-ës.

687. Pra i vetmi dëshmitar i cili pretendon se e ka identifikuar Isak Musliun brenda kamp-burgut të Llapushnikut është L96. Veç problemeve të caktuara që sapo janë përmendur lidhur me dëshmitë e L96-ës dhe L64-ës në mënyrë më të përgjithësuar të dhëna në hollësi diku tjetër në këtë vendim,[2332] Dhoma nuk mund të pranojë vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmive të L64-ës dhe L96-ës pa konfirmim të pavarur të pjesëve materiale të dëshmive. Për këto arsye Dhoma nuk mund të bindet aq sa duhet se mund të pranojë dëshmitë e secilit ose të të dyve, L96-ës dhe L64-ës se Isak Musliu ishte në kamp-burgun e Llapushnikut në rrethanat përkatëse të përshkruara prej tyre.

688. Bazuar në sa më sipër, Dhoma gjykon se të gjitha akuzat se Isak Musliu mori pjesë personalisht në funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut bien. Nuk është provuar se Isak Musliu planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndryshe ndihmoi dhe inkurajoi ndonjë prej krimeve me të cilat ngarkohet në Aktakuzë.

(b) A kishte Isak Musliu pozitë komanduese dhe kontrolluese mbi ushtarët e UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut?

689. Në Aktakuzë deklarohet se në cilësinë e komandantit të UÇK-së në zonën e Llapushnikut dhe kamp-burgun e Llapushnikut,[2333] Isak Musliu ushtroi komandë dhe kontroll ligjor dhe faktik

[2326] L96, T 2557.
[2327] L96, T 2573.
[2328] *Shih më sipër* paragrafin 18.
[2329] L64, T 4444.
[2330] L64, T 4464-4465.
[2331] L64, T 4464-4465.
[2332] *Shih më sipër* paragrafët 26 dhe 28.
[2333] Aktakuzë, paragrafi 2.

mbi ushtarët e UÇK-së që vepronin në kamp-burgun e Llapushnikut dhe kishte autoritet për t'i disiplinuar dhe ndëshkuar vartësit.[2334] Mbrojtja e Isak Musliut parashtron se megjithëse është e pakundërshtueshme në gjyq se Isak Musliu ishte komandanti i njësisë Çeliku 3, është e diskutueshme nëse ai ishte komandant i përgjithshëm në Llapushnik dhe komandant në kamp-burgun e Llapushnikut. Mbrojtja e Isak Musliut parashtron se Isak Musliu si komandant i njësisë Çeliku 3 kishte komandë mbi pesë pozicionet e luftimit të Çelikut 3, por jo mbi njësitë e tjera që vepronin në fshatin Llapushnik ose rreth tij.[2335] Veçanërisht Mbrojtja argumenton se ai nuk kishte dijeni apo nuk ishte përfshirë në kamp-burgun e Llapushnikut dhe as nuk kishte komandë mbi ushtarët e UÇK-së për të cilët thuhet se vepronin atje brenda.[2336]

(i) Njësia Çeliku 3

690. L64 është i vetmi dëshmitar që dëshmoi për ngritjen e njësisë Çeliku 3. Gjithsesi dëshmitarë të tjerë konfirmuan ekzistencën e saj dhe vendndodhjen në fshatin Llapushnik gjatë kohës në fjalë. L64 dëshmoi se njësia Çeliku 3 u krijua pas sulmit të forcave serbe kundër Llapushnikut më 9 maj 1998.[2337] L64, ish-ushtar i Çelikut 3, dëshmoi se më 9 maj 1998, kur forcat serbe sulmuan Llapushnikun, të tëra njësitë e UÇK-së në atë zonë, duke përfshirë njësitë nga Kleçka dhe Likoci shkuan në Llapushnik në përpjekje për të mbrojtur popullatën civile. Ai tha se pas luftimit më 9 maj 1998, ushtarët e UÇK-së të cilët kishin marrë pjesë në luftim u mblodhën për të diskutuar ngritjen e një njësie në Llapushnik për të mbrojtur popullatën civile nga sulme të tjera serbe. Gjatë mbledhjes Fehmi Lladrovci njoftoi se njësia në Llapushnik do të quhej Çeliku.[2338] Sipas dëshmisë së L64-ës, pak ditë më vonë i Akuzuari Fatmir Limaj u tha ushtarëve se njësia do të merrte emrin Çeliku 3.[2339]

691. Për këtë dëshmi ka konfirmim në faktin se disa dëshmitarë e përcaktuan vendndodhjen e njësisë Çeliku 3 në Llapushnik në periudha pas 9 majit 1998, konkretisht në rajonin që shtrihet në jug të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë.[2340] Gjithashtu L64 dëshmoi se pas krijimit të njësisë Çeliku 3, në rajonin që ndodhet në jug të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë u formuan pesë pozicione luftimi Çeliku 3. Me përjashtim të pozicionit 1, vendndodhjet e sakta e katër pozicioneve të tjera të luftimit të Çelikut 3 përshkruhen disi në mënyrë jopërputhëse në dëshminë e L64-ës. Pozicioni 1 që ndryshe

[2334] Aktakuzë, paragrafët 14-17, 21, 25-26, 28-32.
[2335] Argumentet Përmbyllëse, T 7526.
[2336] Argumentet Përmbyllëse, T 7526.
[2337] L64, T 4355-4356.
[2338] L64, T 4353-4355.
[2339] L64, T 4353-4356, 4369.
[2340] Zona në fjalë shtrihet në anën jugore të rrugës, L64, T 4350.

njihet si Guri ose Guri i Madh ndodhej afërsisht 400 metra në jug të rrugës Pejë-Prishtinë.[2341] Në atë pozicion ka një formacion natyror guror të madh. L64 dëshmoi se fill pas krijimit të Çelikut 3 disa ushtarë ndër të cilët edhe ai, lëvizën prej pozicionit 1 në pozicionin 2 për të vëzhguar lëvizjen e forcave serbe në Komoran.[2342] Kjo sugjeron se pozicioni 2 është më afër rrugës Pejë-Prishtinë se pozicioni 1, dhe rrjedhimisht në verilindje të pozicionit të luftimit 1. Më vonë në dëshminë e tij, në ndryshim nga më parë L64 dëshmoi se pozicionet e luftimit të Çelikut 3 fillonin nga pozicioni 1 (d.m.th. "Guri") dhe vazhdonin në jug në drejtim të maleve të Berishës.[2343] Gjithashtu gjatë dëshmisë së tij L64-ës iu kërkua të identifikonte në një hartë ajrore të rajonit të Llapushnikut pesë pozicionet e luftimit të njësisë Çeliku 3. Pozicionet e identifikuara nuk ndodhen në jugperëndim të pozicionit 1 por në juglindje të pozicionit 1. Pozicionet e shënuara ndodhen në rrethinën e përgjithshme të vendndodhjes së kamp-burgut të Llapushnikut,[2344] megjithëse jo pikërisht në atë vend apo ngjitur me të.

692. Edhe i Akuzuari Fatmir Limaj dëshmoi për vendndodhjen e pozicioneve të luftimit të Çelikut 3. Ai konfirmoi se Çeliku 3 ndodhej në rajonin e Llapushnikut që shtrihet në jug të rrugës Pejë-Prishtinë.[2345] Ai tregoi në një hartë ajrore të rajonit të Llapushnikut[2346] pozicionet e luftimit të mbajtura prej njësisë Çeliku 3 deri në rënien e Llapushnikut.[2347] Pozicionet e luftimit të Çelikut 3 të treguara në hartë ndodhen në rrethinën e përgjithshme të kamp-burgut të Llapushnikut. Mirëpo kamp-burgu i Llapushnikut nuk është shënuar nën komandën e njësisë Çeliku 3.[2348] Edhe Ruzhdi Karpuzi, ish-ushtar i Çelikut 3 tregoi në një hartë ajrore të rajonit të Llapushnikut vendndodhjet e tre pozicioneve të luftimit të Çelikut 3.[2349] Krahasimi midis shënimeve në hartat ajrore[2350] tregon se pozicionet e luftimit të Çelikut 3 ndodheshin në jug të rrugës Pejë-Prishtinë, në rrethinën e përgjithshme të kamp-burgut të Llapushnikut, por jo pikërisht në kamp-burg apo ngjitur me të.

693. Sipas L64-ës në verë të vitit 1998 shtabi i Çelikut 3 u transferua në tre vende të ndryshme në fshatin Llapushnik.[2351] L64 dëshmoi se vendndodhja e parë e shtabit (prej krijimit të njësisë deri më

[2341] L64, T 4375-4380.
[2342] L64, T 4350-4352.
[2343] L64, T 4375-4380.
[2344] Prova Materiale P 170. L64, T 4378-4381.
[2345] Fatmir Limaj, T 6306-6308.Në intervistën e tij Shukri Buja shpjegon se Guri 3 ndodhej në anën veriore të rrugës së asfaltuar që ndan Llapushnikun, kurse Çeliku 3 ishte në anën tjetër. Prova Materiale P 160. Në dëshminë e tij në gjyq, Shukri Buja deklaroi se ai nuk e dinte vendndodhjen e njësive, T 3810-3811; 3791-3794.
[2346] Prova Materiale DL8.
[2347] Fatmir Limaj, T 6306-6308; Prova Materiale DL8.
[2348] Prova Materiale DL8.
[2349] Ruzhdi Karpuzi, T 3209-3212; Prova Materiale P130.
[2350] Provat Materiale P130; P170 dhe DL8.
[2351] L64, T 4378-4383.

29 maj 1998) ishte afër pozicionit të luftimit 1,[2352] dhe rrjedhimisht siç është thënë më parë afërsisht 400 metra në jug të rrugës Pejë-Prishtinë. Sipas dëshmisë së tij për shkak të granatimit të dendur më 29 maj 1998, shtabi i Çelikut 3 u desh të transferohej në shtëpinë e "Vojvodës"[2353] për disa ditë para se të transferohej në oborrin e shtëpive më larg kamp-burgut, më vonë i identifikuar si oborri i Elmi Sopit.[2354] Sipas dëshmisë së L64-ës Isak Musliu me pseudonimin Çerçizi komandanti i Çelikut 3 dhe ushtarët e tij më të afërt qëndronin në shtabin e Çelikut 3.[2355]

694. Dëshmia e Ruzhdi Karpuzit ndryshon nga ajo e L64-ës. Ruzhdi Karpuzi, një tjetër ushtar i Çelikut 3, tha se disa prej ushtarëve të Çelikut 3 ndër të cilët edhe ai, fillimisht u vendosën pranë pozicionit të luftimit 1, por pastaj u transferuan në oborrin e Gëzim Gashit deri në rënien e grykës së Llapushnikut. Ai shpjegon se ushtarët e Çelikut 3 ndejtën në atë oborr një muaj dhe se numri i ushtarëve në oborr ndryshonte vazhdimisht: "ndonjëherë ishin tre ushtarë, ndonjëherë pesë, ndonjëherë shtatë, dhe kishte raste dy".[2356] Ruzhdi Karpuzi shpjegon se arsyet e qëndrimit të pak ushtarëve atje ishte të shmangeshin viktimat në UÇK prej ndonjë sulmi të mundshëm të forcave serbe.[2357] Ruzhdi Karpuzi dëshmoi se njësitë e Çelikut 3 flinin dhe hanin atje dhe gjithashtu atje mbaheshin dokumente me të dhënat e ushtarëve. Këto dokumente përmbanin të dhënat e ushtarëve, emrat, prejardhjen dhe nëse ushtarët ishin plagosur apo vrarë.[2358] Sipas dëshmisë së tij, Ruzhdi Karpuzi dëgjonte nga oborri i Gëzim Gashit Isak Musliun me pseudonimin Çerçizi duke kënduar në odë që ndodhej matanë rrugëkalimit të ngushtë në oborrin e kamp-burgut të Llapushnikut.[2359]

695. Edhe Elmi Sopi dëshmoi në lidhje me këtë. Sipas dëshmisë së tij ushtarët e UÇK-së në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën hanin rregullisht në kuzhinën në oborrin e Gëzim Gashit. Ky oborr ndodhet nga ana tjetër e rrugicës së ngushtë e të pashtruar që e ndan atë prej kamp-burgut. Sipas dëshmisë së Elmi Sopit, pas 29 majit 1998, në shtëpinë e Gëzim Gashit u ngrit një kuzhinë. Ai dëshmoi se thuajse të gjithë ushtarët e hanin ushqimin e tyre ditor në këtë shtëpi.[2360] Elmi Sopi shpjegon se ushtarët e Çelikut 3 më parë hanin në shtëpinë e Fadil Gashit, më afër rrugës Pejë-Prishtinë por për shkak të granatimit të dendur më 29 maj, kuzhina u transferua në oborrin e Gëzim

[2352] Shënuar si Shtabi 1 në Provën Materiale P170; L64, T 4383.
[2353] Shënuar si Shtabi 2 në Provën Materiale P170; L64, T 4383.
[2354] L64, T 4380. Në të njëjtën hartë ajrore mbi të cilën ai shënoi pesë pozicionet e luftimit të Çelikut 3, L64 shënoi edhe tri vendndodhjet e shtabit të Çelikut 3, Prova Materiale P170.
[2355] L64, T 4383, 4391-4392.
[2356] Ruzhdi Karpuzi, T 3087-3088.
[2357] Ruzhdi Karpuzi, T 3092.
[2358] Ruzhdi Karpuzi, T 3091; 3244-3245.
[2359] Ruzhdi Karpuzi, T 3248-3249. Prova Materiale P128.
[2360] Elmi Sopi, T 6733; Prova Materiale DL15.

Gashit.[2361] Elmi Sopi nuk saktëson se cilët ushtarë të UÇK-së hanin në kuzhinën e Gëzim Gashit. Prej kësaj dëshmie është e qartë se ushtarët e Çelikut 3 që më parë hanin në shtëpinë e Fadil Gashit, pas 29 majit 1998 hanin në oborrin e Gëzim Gashit. Mirëpo nuk është e qartë nëse atje hanin të gjithë ushtarët e Çelikut 3, apo edhe ushtarë të njësive të tjera të UÇK-së në Llapushnik.

696. Në lidhje me numrin e ushtarëve të njësisë Çeliku 3 në verën e vitit 1998, ka pak dëshmi. Ramiz Qeriqi dëshmoi se komandanti i njësisë Çeliku 3, Isak Musliu, "mund të ketë qenë komandant i një toge prej 20 ushtarësh, jo më shumë", por më vonë në dëshminë e tij ai deklaron se në lidhje me këtë mund të mos jetë i saktë.[2362] Edhe L64 dëshmoi për këtë aspekt. Sipas dëshmisë së tij kur u formua njësia Çeliku 3 kishte vetëm 20 ushtarë. Mirëpo L64 dëshmoi se pas betejës së 29 majit 1998, ushtarët e njësisë Çeliku 3 u shtuan në numër afërsisht deri 60 ushtarë.[2363]

(ii) A kishte njësi të tjera që vepronin në Llapushnik?

697. Disa dëshmitarë dëshmuan se njësi të tjera si Lumi dhe Pëllumbi vepronin në Llapushnik në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën. Prokuroria parashtron se këto njësi vepronin në rajonin që ndodhet në veri të rrugës Pejë-Prishtinë dhe jo në jug të rrugës ku ndodhej kamp-burgu i Llapushnikut dhe ku vepronin ushtarët e Çelikut 3.[2364]

698. Ruzhdi Karpuzi, ish-ushtar në njësinë Çeliku 3, dëshmoi se në fshatin Llapushnik ishin disa njësi, përkatësisht njësitë Guri, Pëllumbi, Lumi dhe Çeliku 3.[2365] Ai dëshmoi se njësitë Pëllumbi, Guri dhe Lumi ndodheshin në veri të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë.[2366] Megjithëse ai dëshmoi se një njësi Pëllumbi ndodhej gjithashtu në jug të rrugës, ajo ishte në Kishnarekë[2367] dhe jo në Llapushnik.

699. Elmi Sopi dëshmoi se njësia Pëllumbi ishte pozicionuar përgjatë rrugës kryesore Pejë-Prishtinë, por në rajonin që ndodhej në veri të rrugës.[2368] Elmi Sopi deklaroi se Guri 3 megjithëse i pozicionuar më afër rrugës, ishte gjithashtu në rajonin në veri të rrugës kryesore.[2369]

[2361] Elmi Sopi, T 6729; Prova Materiale DL15.
[2362] Ramiz Qeriqi, T 3595.
[2363] L64, T 4375.
[2364] Argumentet Përmbyllëse, T 7269.
[2365] Ruzhdi Karpuzi, T 3078.
[2366] Ruzhdi Karpuzi, T 3079-3081; Prova Materiale P127.
[2367] Ruzhdi Karpuzi, T 3079-3081; Prova Materiale P127.
[2368] Elmi Sopi, T 6734-6735. Prova Materiale DL15.
[2369] Elmi Sopi, T 6735. Prova Materiale DL15.

700. Sylejman Selimi, komandant i zonës operative të Drenicës[2370] në kohën që ka lidhje me Aktakuzën, dëshmoi se njësitë Guri, Pëllumbi dhe Alfa ishin vendosur në anën veriore të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë.[2371] Sylejman Selimi dëshmoi se në ndryshim nga zonat e tjera, nga maji deri në korrik 1998, njësitë në anën veriore të rrugës Pejë-Prishtinë tashmë u organizuan në brigadë. Ai dinte se këto ishin njësitë Guri, Pëllumbi dhe Alfa që sipas dëshmisë së tij bënin pjesë në Brigadën 113 të komanduar prej Mujë Krasniqit.[2372]

701. Edhe L64 identifikoi njësi të tjera të UÇK-së në fshatin Llapushnik, por të pozicionuara në anën veriore të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë, përkatësisht njësitë Pëllumbi dhe Guri 3. Gjatë dëshmisë së tij, L64 dëshmoi se këto njësi ishin vendosur atje për të patrulluar rrugën.[2373] L64 deklaroi se njësia Çeliku 3 ishte e vetmja njësi e vendosur në jug të rrugës Pejë-Prishtinë.[2374] Mirëpo ai kujton se në korrik 1998, një njësi Pëllumbi u zhvendos në anën jugore afër pozicionit të luftimit 5 të njësisë Çeliku 3.[2375]

702. Me gjithë ndryshimet e dukshme të përvijuara në dëshmitë e mësipërme, Dhoma nxjerr përfundimin se njësia Çeliku 3 nuk ishte e vetmja njësi e UÇK-së e cila vepronte në afërsi të fshatit Llapushnik në kohën që ka lidhje me Aktakuzën. Në Llapushnik, në verën e vitit 1998 ishin të pranishme edhe njësitë Lumi, Pëllumbi, Guri dhe Alfa. Mirëpo dëshmitë zbulojnë se me përjashtim të një njësie Pëllumbi që ndodhej në një largësi në jug të vendndodhjes së kamp-burgut të Llapushnikut për një periudhë në korrik 1998 dhe pozicioneve të Çelikut 3 që ndodheshin në rrethinën e përgjithshme të kamp-burgut të Llapushnikut, të gjitha njësitë e tjera ndodheshin në veri të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë.

(iii) <u>A ishte Isak Musliu komandant i Çelikut 3 apo komandant i përgjithshëm i zonës së Llapushnikut?</u>

703. Dhoma ka dëgjuar dëshmi nga dëshmitarët e Prokurorisë dhe të Mbrojtjes në lidhje me pozitën udhëheqëse të Isak Musliut në njësinë Çeliku 3 që ndodhej në Llapushnik. Gjithashtu Dhoma ka dëgjuar dëshmi se Isak Musliu mund të mos ketë qenë i vetmi drejtues i njësisë Çeliku 3. Disa dëshmitarë dëshmuan se faktikisht, Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi luajti rol

[2370] *Shih më sipër* paragrafin 55.
[2371] Sylejman Selimi, T 2090-2094.
[2372] Sylejman Selimi, T 2088-2090.
[2373] L64, T 4384-4385.
[2374] L64, T 4385.
[2375] L64, T 4385-4386; Prova Materiale P170.

qendror në komandën e njësisë Çeliku 3. Në lidhje me këtë Prokuroria parashtron se Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi ishte zëvendës i Isak Musliut.[2376]

704. L64 dëshmoi se pak ditë pas formimit të njësisë Çeliku 3 më 9 maj 1998, i Akuzuari Fatmir Limaj u tha ushtarëve se udhëheqësi i tyre do të ishte Isak Musliu me pseudonimin Çerçizi.[2377] Theksohet se dëshmitari nuk e përmend Isak Musliun si "komandant të Çelikut 3" por si "personi përgjegjës për pozicionin e Llapushnikut".[2378] Sipas dëshmisë së L64-ës vendimi për emërimin e Isak Musliut shkaktoi vështirësi në lidhje me pozitën e Ymer Alushanit me pseudonimin Vogëlushi brenda njësisë së sapoformuar. Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi, kishte qenë më parë komandant i njësisë Zjarri, e cila u përfshi në njësinë Çeliku 3 në kohën e formimit të saj.[2379] L64 shpjegoi se disa ushtarë u ankuan për emërimin e Isak Musliut me pseudonimin Çerçizi sepse ata ishin anëtarësuar në njësi pikërisht sepse menduan se Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi do të ishte komandant i tyre. L64 deklaroi se Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi personalisht nuk shprehu asnjëherë pakënaqësi për emërimin e Çerçizit, në fakt ai e respektonte Çerçizin si "personi përgjegjës për pozicionin" dhe ishte gjithmonë me atë.[2380]

705. Lidhja hierarkike midis Isak Musliut me pseudonimin Çerçizi dhe Ymer Alushanit me pseudonimin Vogëlushi brenda njësisë Çeliku 3 është në disa raste e paqartë në dëshminë e L64-ës. Për shembull L64 tha se megjithëse Isak Musliu ishte drejtuesi i njësisë Çeliku 3, ai dhe Ymer Alushani ndanin përgjegjësitë. L64 dëshmoi se ushtarët në komandë të pesë pozicioneve të luftimit të Çelikut 3 i raportonin ose Çerçizit ose Vogëlushit mbi gjendjen në terren dhe lëvizjen e forcave armike.[2381] Sipas dëshmisë së tij ushtarët duhej t'i raportonin Çerçizit në qoftë se ndodhte diçka e rëndësishme gjatë ndërrimeve, por se ndonjëherë ushtarët e informonin edhe Ymer Alushanin.[2382] Kështu ndodhte edhe me rekrutimet e ushtarëve të Çelikut 3. Në lidhje me këtë L64 dëshmoi se Isak Musliu vendoste nëse do të pranoheshin rekrutët e UÇK-së, por se të tjerë shkonin drejtpërdrejtë te Ymer Alushani për t'u rekrutuar.[2383] Në ditarin e tij ose në fletoren e shënimeve[2384] në shënimin me datën 29 maj 1998, L64 ka shkruar se Çerçizi e urdhëroi atë të hapte zjarr ndaj një pjesëtari të këmbësorisë serbe i cili po i afrohej pozicionit të tyre.[2385] Më tej në po atë shënim më datën 29 maj

[2376] Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 122; Argumentet Përmbyllëse, T 7270.
[2377] L64, T 4357-4358.
[2378] L64, T 4357.
[2379] L64, T 4357-4361; 4335.
[2380] L64, T 4357-4361.
[2381] L64, T 4391.
[2382] L64, T 4388; 4391.
[2383] L64, T 4376-4378.
[2384] Prova Materiale P169, f 9.
[2385] L64, T 4371-4372; Prova Materiale P169, f 10.

1998, L64 shkruan se të dy Çerçizi dhe Vogëlushi e urdhëruan të tërhiqej prej pozicionit të tij.[2386] Në të njëjtën kohë, L64 dëshmoi se ushtarët e njësisë Çeliku 3 duhej t'i kërkonin Isak Musliut leje-udhëtimi për të vizituar familjet e tyre.[2387] Më vonë në dëshminë e tij L64 dëshmoi se Çerçizi ishte në komandë të luftimeve dhe ishte Çerçizi dhe jo Vogëlushi i cili mbante të vetmen radio të vogël të njësië Çeliku 3.[2388] Duke lënë mënjanë besueshmërinë e përgjithshme të këtij dëshmitari konkret, prej dëshmisë së mësipërme mbetet e paqartë nëse Isak Musliu ishte komandant i Çelikut 3.

706. Ruzhdi Karpuzi, ish-ushtar i Çelikut 3 dëshmoi se Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi dhe Isak Musliu me pseudonimin Çerçizi ishin që të dy komandantë të njësisë Çeliku 3 deri në vdekjen e Vogëlushit më 26 korrik 1998. Sipas dëshmisë së tij Isak Musliu u bë komandant i njësisë Çeliku 3 disa javë pas 18 majit 1998.[2389] Ai dëshmoi se Isak Musliu u zgjodh prej ushtarëve të UÇK-së si drejtuesi i një njësie që vepronte në Llapushnik.[2390] Dëshmia e Ruzhdi Karpuzit ndryshonte nga dëshmia e L64-ës në faktin se ai dëshmoi se Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi u propozoi ushtarëve të tjerë emërimin e Isak Musliut dhe më pas Isak Musliu u bë njëri nga komandantët e Çelikut 3.[2391] Sipas dëshmisë së tij një njeri i quajtur Zogi me pseudonimin Mjeshtri ishte gjithashtu në komandë të Çelikut 3 dhe konkretisht të pozicionit të luftimit 1.[2392] Kështu sipas dëshmisë së Ruzhdi Karpuzit ishin disa drejtues të njësisë Çeliku 3, Isak Musliu me pseudonimin Çerçizi, Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi dhe personi i quajtur Zogi me pseudonimin Mjeshtri.

707. Shukri Buja dëshmoi se ai nuk ishte i sigurtë kush ishte në komandë të një njësie në Llapushnik, Isak Musliu me pseudonimin Çerçizi, apo Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi.[2393] Më vonë ai shtoi se madje nuk e dinte nëse njësia për të cilën po fliste ishte njësia Çeliku 3 apo jo.[2394] Mirëpo ai dëshmoi se kur kishte punë, ai i drejtohej Ymer Alushanit me pseudonimin Vogëlushi, "njërit prej komandantëve të njësive atje".[2395] Gjithashtu u bë e qartë se dëshmia e tij për këto çështje ndryshoi nga çfarë kishte thënë në një intervistë të mëparshme në prill

[2386] Prova Materiale P169, f 10.
[2387] L64, T 4389-4390.
[2388] L64, T 4371-4372; Prova Materiale P169.
[2389] Ruzhdi Karpuzi, T 3075.
[2390] Ruzhdi Karpuzi, T 3241.
[2391] Ruzhdi Karpuzi, T 3075-3076; 3240-3241.
[2392] Ruzhdi Karpuzi, T 3243.
[2393] Shukri Buja, T 3976-3979.
[2394] Shukri Buja, T 3978.
[2395] Shukri Buja, T 3978.

2003 kur ai tha se kishte përshtypjen se Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi kishte më shumë autoritet se Isak Musliu.[2396]

708. Edhe Fatmir Limaj e përmendi pozitën drejtuese të Isak Musliut në një deklaratë pa betim që dha para Dhomës. Ai tha se Isak Musliu u bë komandant i Çelikut 3 në mes të majit 1998.[2397] Gjithsesi ai nuk tha gjë se kush e emëroi Isak Musliun komandant të njësisë Çeliku 3.[2398] Më konkretisht ai nuk tha asgjë lidhur me sugjerimin e L64-ës se vetë Fatmir Limaj e emëroi Isak Musliun komandant të njësisë.[2399] Në një intervistë me hetuesit e UNMIK-ut më 24 mars 2001, Isak Musliu deklaroi se në verën e vitit 1998, ai ishte thjesht "drejtues ekipi në zonën e Llapushnikut". Në intervistë Isak Musliu i përshkroi përgjegjësitë e tij në UÇK si më poshtë:

> Po atë muaj [maj 1998] fillova të shërbeja si ushtar i UÇK-së në luginën e Drenicës. Shërbeva si ushtar afërsisht për gjashtë javë dhe pastaj u bëra drejtues ekipi në zonën e Llapushnikut. Në ekipin tim në fillim kisha 11 ushtarë dhe më së shumti 15-16 ushtarë.
> Në gusht 1998 u bëra zëvendëskomandant i brigadës 121 të UÇK-së në zonën luftarake [të Nerodimës]. Zona luftarake [e Nerodimës] përfshin komunat e Lipjanit, Shtimes, Ferizajt dhe Kaçanikut.[2400]

709. Sylejman Selimi dëshmoi se në periudhën nga maji në korrik 1998, nuk kishte një komandant të vetëm që komandonte të gjitha njësitë Çeliku.[2401] Sipas dëshmisë së tij struktura e zonave të UÇK-së në verën e vitit 1998 ndryshonte nga zona në zonë. Në ndryshim nga njësitë në zonën operative të Drenicës, njësitë e vendosura në jug të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë, përkatësisht njësitë Çeliku nuk u organizuan në brigada dhe "nuk kishin formacione":

> ishin disa njësi, Çeliku-disa njësi të emërtuara Çeliku të cilat në atë kohë filluan të organizoheshin si njësitë në zonën time. Mirëpo në atë kohë ato ende vepronin të pavarura prej njëra-tjetrës.[2402]

710. Bislim Zyrapi, dëshmitar i Mbrojtjes dëshmoi se gjatë një vizite në Llapushnik në qershor 1998, Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi iu paraqit si komandant i njësisë së Llapushnikut.[2403]

[2396] Prova Materiale P160, f 70.
[2397] Fatmir Limaj, T 6306-6308.
[2398] Fatmir Limaj, T 5849-6582.
[2399] Fatmir Limaj, T 5849-6582.
[2400] Prova Materiale P32.
[2401] Sylejman Selimi, T 2155-2156.
[2402] Sylejman Selimi, T 2090-2091, 2100.
[2403] Bislim Zyrapi, T 6826; 6834-6835.

711. Zeqir Gashi, i cili punoi si mjek në klinikën e improvizuar në Llapushnik dëshmon ndryshe. Zeqir Gashi dëshmoi se në fund të majit 1998 ai u këshillua me Ymer Alushanin me pseudonimin Vogëlushi në lidhje me mundësinë e hapjes së një klinike në fshatin Llapushnik për t'i ofruar shërbime mjekësore popullatës civile. Sipas dëshmisë së tij Ymer Alushani me pseudonimin Vogëlushi e njohu atë me "një nga drejtuesit e UÇK-së atje me pseudonimin Çerçiz".[2404] Ai dëshmoi se ai u njoh me Çerçizin sepse "me sa më kujtohet ose siç e kuptova, Çerçizi ishte udhëheqësi i njësisë në Llapushnik."[2405] Më vonë në dëshminë e tij Zeqir Gashi shpjegoi se njësia për të cilën e kishte fjalën ishte njësia Çeliku.[2406] Kur u pyet nëse Çerçizi ishte drejtues i të gjithë ushtarëve në Llapushnik apo vetëm i disa ushtarëve në Llapushnik, Zeqir Gashi deklaroi se "sipas mendimit të tij", ai ishte drejtues i krejt njësisë në Llapushnik.[2407] Ai faktikisht shpjegoi se Çerçizi ishte personi te i cili ata shkonin kur iu nevojiteshin furnizime mjekësore për klinikën e improvizuar.[2408] Sipas dëshmisë së tij, gjithashtu Çerçizi intervistonte ushtarët që dëshironin të anëtarësoheshin në UÇK.[2409]

(iv) Përfundime

712. Dhoma ka mendimin se dëshmitë provojnë se i Akuzuari Isak Musliu me pseudonimin Çerçizi kishte pozitë drejtuese brenda njësisë Çeliku 3 në fund të majit, qershor dhe korrik të vitit 1998. Në lidhje me këtë nuk është provuar se ai kishte komandë ose udhëheqje të vetme të njësisë Çeliku 3 sepse autoriteti i tij në një farë mase mund të jetë ndarë me Ymer Alushanin me pseudonimin Vogëlushi. Gjithsesi Dhoma nxjerr përfundimin se në këtë periudhë Isak Musliu ishte në gjendje të ushtronte komandë dhe kontroll efektiv mbi forcat e UÇK-së që përfshin njësinë Çeliku 3 ose pozicionet e luftimit në fshatin Llapushnik.

713. Mirëpo mendimi i Dhomës është se dëshmitë janë të paqarta dhe nuk provojnë se Isak Musliu kishte komandë të përgjithshme ose pozitë drejtuese në lidhje me gjitha forcat e UÇK-së në fshatin Llapushnik ose në atë zonë. Në të vërtetë pjesa më e madhe e dëshmive shkon në dobi të pikëpamjes se në atë zonë ndodheshin disa njësi të UÇK-së secila me komandë të veçantë, por me një përjashtim për një kohë në korrik, jo në jug të rrugës kryesore, megjithëse ushtarët e këtyre njësive herë pas here shkonin, hanin dhe flinin në fshat në anën jugore të rrugës.

[2404] Dr Zeqir Gashi, T 5604.
[2405] Dr Zeqir Gashi, T 5604.
[2406] Dr Zeqir Gashi, T 5604-5605.
[2407] Dr Zeqir Gashi, T 5614-5615.
[2408] Dr Zeqir Gashi, T 5413-5614.

714. Megjithëse njësitë Çeliku 3 ishin pozicionuar në rrethinën e përgjithshme të kamp-burgut në fshatin Llapushnik në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën, nuk ka dëshmi të drejtpërdrejta që provojnë se njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut ose se anëtarët e njësisë Çeliku 3 kryen detyra në kamp-burg. Afërsia relative e pozicioneve të luftimit të Çelikut 3 me kamp-burgun, nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për supozimin e një lidhjeje midis njësisë Çeliku 3 dhe kamp-burgut, po kështu as largësia shumë e afërt e oborrit të Gëzim Gashit nga kamp-burgu. Megjithëse dëshmitë provojnë se njësia Çeliku 3 e kishte shtabin në oborrin e Gëzim Gashit të paktën për një pjesë të periudhës që ka lidhje me Aktakuzën, dëshmitë tregojnë se ky shtab u vendos atje për arsye të granatimit serb të vendndodhjes së mëparshme të shtabit. Gjithashtu dëshmitë tregojnë se edhe ushtarë të njësive të tjera të UÇK-së hanin në këtë oborr, të paktën herë pas here.

715. Në mungesë të ndonjë dëshmie bindëse të drejtpërdrejtë dhe duke marrë parasysh faktorët e mësipërm, dëshmitë nuk janë të mjaftueshme për të provuar se i Akuzuari Isak Musliu ishte komandant i UÇK-së për kamp-burgun në fshatin Llapushnik ose se pati pozitë drejtuese apo ushtroi kontroll mbi kamp-burg. Nuk është provuar se për kohën në fjalë Isak Musliu kishte komandë ose kontroll efektiv mbi forcat e UÇK-së që vepronin në kamp-burg. Rrjedhimisht nuk është provuar në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit se ai kishtë aftësinë materiale për parandalimin e mbajtjes së të burgosurve në kamp, marrjen e tyre në pyetje, vrasjet ose trajtimin e egër dhe çnjerëzor ushtruar ndaj tyre, apo për dhënien fund të një sjelljeje të tillë apo për ndëshkimin e përgjegjësve.

716. Më herët në këtë vendim, Dhoma gjithashtu ka shqyrtuar në hollësi tërësinë e kufizuar të dëshmive nga dëshmitarë të cilët pretendojnë se e kanë identifikuar Isak Musliun në kamp-burgun e Llapushnikut i cili ushtronte një farë autoriteti në funksionimin e kampit. Për arsyet e përmendura më parë, Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundimin se i Akuzuari Isak Musliu është identifikuar në mënyrë të besueshme si personi i cili përshkruhet në dëshmitë e tyre.[2410] Rrjedhimisht Prokuroria nuk ka provuar asnjë prej akuzave me të cilat i Akuzuari Isak Musliu ngarkohet në Aktakuzë.

[2409] Dr Zeqir Gashi, T 5615.
[2410] *Shih më sipër* paragrafët 671-688.

VII. FAJËSIA E SHUMËFISHTË

717. Çështja e fajësisë së shumëfishtë ngrihet kur, në thelb, nga e njëjta sjellje kriminale buron më shumë se një akuzë. Dhoma e Apelit ka arritur në përfundimin se për të ndëshkuar të njëjtën sjellje kriminale, fajësia e shumëfishtë mund të shpallet në bazë të dispozitave të ndryshme statutore vetëm nëse "çdo dispozitë statutore në fjalë përfshin një element të ndryshëm material që nuk është në dispozitën tjetër".[2411] Në qoftë se ky kusht nuk përmbushet në lidhje me dy shkelje penale, Dhoma duhet të shpallë fajësinë në bazë të dispozitës më të përcaktuar.[2412]

718. Për arsyet e shpjeguara më parë, Dhoma arriti në përfundimin se janë provuar elementet e veprave penale të torturës (Pika 4), të trajtimit mizor (Pika 6) dhe të vrasjes (Pika 10).

719. Në këtë çështje, çështja e fajësisë së shumëfishtë ngrihet në lidhje me veprat penale të torturës (Pika 4) dhe të trajtimit mizor (Pika 6). Baza ligjore dhe elementet e të dyja veprave penale të torturës dhe të trajtimit mizor janë analizuar më herët në këtë vendim.[2413] Të dy shkeljet kërkojnë që viktima të ketë pësuar dëmtime të rënda trupore apo mendore, dëmtimi duhet të jetë rezultati i një veprimi apo mosveprimi të të akuzuarit ose të vartësit të tij, dhe veprimi duhet të jetë kryer qellimisht. Vepra penale e torturës ka një element shtesë duke qenë se veprimi ose mosveprimi duhet të jetë kryer me një qëllim të caktuar, për shembull, për të nxjerrë informacion apo një pohim, për të ndëshkuar, frikësuar ose detyruar viktimën apo një palë të tretë, ose për të diskiminuar viktimën apo një palë të tretë, për çfarëdo arsye.[2414] Mirëpo, për veprën penale të trajtimit mizor nuk nevojitet të provohet ndonjë element që nuk nevojitet për torturën. Rrjedhimisht kur veprat penale të torturës dhe të trajtimit mizor burojnë nga e njëjta sjellje kriminale e të Akuzuarit, Dhoma do të shpallë fajësi vetëm lidhur me akuzën e torturës (Pika 4). Dhoma veproi kështu në lidhje me një rast të keqtrajtimit i cili, sipas mendimit të Dhomës, ishte edhe trajtim mizor edhe torturë. Prandaj akuza e trajtimit mizor mbetet lidhur me rastet e keqtrajtimit ku Dhoma ka vendosur se është provuar vetëm vepra penale e trajtimit mizor (Pika 6).

720. Në këtë çështje, problemi i fajësisë së shumëfishtë nuk ngrihet në lidhje me veprat penale të torturës (Pika 4) dhe të vrasjes (Pika 10) duke qenë se këto shkelje nuk bazohen mbi të njëjtën

[2411] Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 412.
[2412] Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 413.
[2413] *Shih më sipër*, paragrafët 231-240.
[2414] Vendimi i Apelit *Kunarac*, paragrafët 142, 144 në konfirmim të Vendimit të Apelit *Kunarac*, paragrafi 497. *Shih* edhe Vendimin e Apelit *Bërgjanin*, paragrafi 481, Vendimin e Apelit *Kërnojelac*, paragrafi 181.

sjellje kriminale. E njëjta gjë vlen edhe për veprat penale të trajtimit mizor (Pika 6) dhe të vrasjes (Pika 10).

721. Për arsye të shpjeguara më parë në këtë vendim, dhe duke marrë parasysh jurisprudencën për fajësinë e shumëfishtë, Dhoma do të shpallë fajësinë kundër të Akuzuarit Haradin Bala në lidhje me Pikën 4, torturë, Pikën 6, trajtim mizor, dhe Pikën 10, vrasje.

VIII. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

722. Prokuroria ka kërkuar që po të shpallet fajtor për të gjitha pikat, i Akuzuari Haradin Bala duhet të marrë një dënim me 18 vjet burgim.[2415] Ai nuk u shpall fajtor për të gjitha pikat.

723. Përcaktimi i dënimit bëhet në bazë të Nenit 24 të Statutit dhe Rregullës 101 të Rregullores. Fajtori mund të dënohet me burgim për një periudhë deri në burgim të përjetshëm.[2416] Neni 24 (2) i Statutit parashikon se në dhënien e dënimeve, Dhoma Gjyqësore duhet të mbajë parasysh faktorë të tillë si pesha e krimit dhe rrethanat personale të fajtorit.[2417] Rregulla 101 (B) kërkon që të merren parasysh faktorë rëndues dhe lehtësues si dhe praktika e përgjithshme e dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë,[2418] megjithëse faktori i fundit nuk është i detyrueshëm për Dhomën.[2419] Dhoma e Apelit ka identifikuar shpagimin dhe përfrikësimin si qëllimet kryesore të dënimit.[2420] Qëllimi i parë synon t'i japë krimit në fjalë dënimin e drejtë dhe të duhur,[2421] kurse qëllimi i fundit synon të sigurojë që dënimi i shpallur të shkurajojë të Akuzuarin dhe persona të tjerë nga kryerja e krimeve të ngjashme.[2422]

[2415] Argumente Përmbyllëse, T 7349.
[2416] Rregulla 101 e Rregullores parashikon: "(A) Fajtori mund të dënohet me burgim për një periudhë deri në burgim të përjetshëm. (B) Në përcaktimin e dënimit, Dhoma Gjyqësore do të marrë parasysh faktorët e përmendur në Nenin 24, paragrafin 2 të Statutit dhe faktorë të tillë si: (i) çdo rrethanë rënduese; (ii) çdo rrethanë lehtësuese duke përfshirë bashkëpunimin e konsiderueshëm të fajtorit me Prokurorin para ose pas gjykimit; (iii) praktikën e përgjithshme të dënimeve në gjykatat e ish-Jugosllavisë; (iv) masën deri në të cilën është kryer një dënim që i është dhënë fajtorit nga gjykata e ndonjë shteti për të njëjtën vepër penale, si përmendet në Nenin 10, paragrafin 3 të Statutit. (C) çdo periudhë gjatë së cilës fajtori u paraburgos në pritje të dorëzimit në Tribunal ose në pritje të gjykimit apo apelit do të llogaritet në kohëzgjatjen e burgimit të fajtorit."
[2417] Neni 24 i Statutit parashikon: "1. I vetmi dënim që jep Dhoma Gjyqësore është burgimi. Në përcaktimin e kushteve të burgimit, Dhomat Gjyqësore iu referohen praktikave të përgjithshme lidhur me dënimet me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë. 2. Në dhënien e dënimeve, Dhomat Gjyqësore mbajnë parasysh faktorë të tillë si pesha e krimit dhe rrethanat personale të fajtorit. 3. Përveç burgimit, Dhomat Gjyqësore mund të urdhërojnë që çdo pronë ose përfitim i siguruar me anë të sjelljes kriminale, duke përfshirë shtrëngimin, t'u kthehet pronarëve të ligjshëm."
[2418] Rregulla 101 e Rregullores.
[2419] Vendimi i Apelit *Kërstiqi*, paragrafi 260; Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafi 682, i cili i referohet Aktgjykimit *Kunarac*, paragrafi 829.
[2420] Vendimi i Apelit *Çelebiqi,* paragrafi 806; Vendimi i Apelit *Aleksovski,* paragrafi 185. Ndër qëllimet dytësore janë promovimi i vetëdijes juridike, qortimi publik, dhe rehabilitimi. *Shih* Vendimi i Apelit *Bllashkiqi,* paragrafi 678; Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 806. Megjithatë, "faji individual i të akuzuarit e kufizon masën e dënimit." *Shih* Aktgjykimin *Stakiqi*, paragrafi 899: Vendimi i Dënimit *Nikoliqi*, paragrafi 132.
[2421] Vendimi i Dënimit *Todoroviqi,* paragrafi 29: Aktgjykimi *Nikoliqi*, paragrafi 140.
[2422] Vendimi i Dënimit *Todoroviqi,* paragrafi 30.

A. Pesha e krimit

724. Pesha e krimit është një faktor me rëndësi parësore në dhënien e dënimit.[2423] Dënimi duhet të pasqyrojë peshën e qenësishme të tërësisë së sjelljes kriminale të të akuzuarit, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të çështjes si dhe mënyrën dhe masën e pjesëmarjes së të akuzuarit.[2424]

725. Në këtë çështje, Prokuroria parashtron se pesha e krimeve karakterizohet nga fakti se i Akuzuari drejtoi një kamp-burg ku të burgosurit iu nënshtruan kushteve çnjerëzore, keqtrajtimit, rrahjeve, torturave, dhe vrasjeve për një periudhë gati dymujore, dhe se e vetmja arsye për mbylljen e kamp-burgut ishte se në fund të korrikut 1998, forcat serbe pushtuan territorin ku ndodhej kamp-burgu.[2425] Mirëpo përfundimet e Dhomës që trajtojnë disa prej këtyre çështjeve e kanë hequr bazën e këtij pretendimi në disa aspekte.

726. Duhet të theksohet se i Akuzuari Haradin Bala nuk kishte pozitë komanduese në kamp. Prokuroria nuk ka mundur të vërtetojë se kush komandonte. Roli i Haradin Balës ishte rol i rojës. Megjithëse gjatë tërë periudhës së ekzistencës së kampit ai kreu këtë detyrë dhe ishte aktiv në funksionimin e përditshëm të burgut, dëshmitë tregojnë se u përfshinë edhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, në veçanti në shumë raste të keqtrajtimit më të dhunshëm të të burgosurve. Dëshmitë nuk vërtetojnë, madje as nuk sugjerojnë, se Haradin Bala ushtroi ndonjë autoritet mbi këta anëtarë të tjerë të UÇK-së, ose se ai i nxiti aktivisht që të keqtrajtonin të burgosurit. Më saktë, roli i tij ishte shpesh roli i një ndihmuesi të thjeshtë, i cili, siç duket, kryente kërkesat e të tjerëve. Nga ana tjetër, ka patur raste të identifikuara në këtë Aktgjykim, në të cilat ai mori pjesë aktivisht në keqtrajtimin fizik të të burgosurve të caktuar, qoftë si kryes qoftë si ndihmues. Këto raste përfshinë trajtim mizor me dhunë fizike të drejtpërdrejtë dhe në një rast ai ndihmoi në torturimin e një të burgosurit. Natyrisht të burgosurit ishin të pambrojtur duke qenë se ishin zënë rob dhe ishin në dorën e tij, por dëshmitë nuk tregojnë se ai motivohej ose kishte ndonjë kënaqesi perverse të veçantë nga keqtrajtimi i të burgosurve, apo se sjellja e tij ishte jashtëzakonisht sadiste. Gjithsesi nga dëshmitë del e qartë se në kamp-burg ekzistonte një kulturë dhune, për të cilën Haradin Bala ishte plotësisht në dijeni. Në fakt sjellja e tij ndihmoi në krijimin dhe në përforcimin e kësaj kulture. Ishte drejtimi i përditshëm i burgut prej tij i cili çoi në kushte të këqija dhe çnjerëzore të burgimit, veçanërisht në fllanik dhe në ahur, të përshkruara më lart në këtë Aktgjykim.

[2423] Vendimi i Apelit *Aleksovski*, paragrafi 182; Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 731; Vendimi i Apelit, *Bllashkiqi*, paragrafi 683.
[2424] Vendimi i Apelit *Furunxhija*, paragrafi 249; Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafi 683.
[2425] Argumente Përmbyllëse, T 7344.

727. Në ditën e fundit, të burgosurit e mbetur u shoqëruan nga burgu nga Haradin Bala dhe nga një tjetër. Ka mundësi të ketë qenë edhe një rojë i tretë i UÇK-së. Pasi u çuan në malet e afërta të Berishës, disa të burgosur u liruan dhe u lejuan të largoheshin. Për të tjerët u vërtetua se nëntë prej tyre u ekzekutuan nga Haradin Bala dhe nga roja ose rojat e tjerë në bashkëveprim. Të paktën një i burgosur nuk u ekzekutua, por shumica e të burgosurve të mbetur vdiqën. Ky është aspekti më i rëndë i sjelljes kriminale të Haradin Balës. Megjithatë, në bazë të dëshmive, Dhoma është e mendimit se kur Haradin Bala i çoi të burgosurit në malet, kur liroi disa prej tyre dhe kur ekzekutoi nëntë persona, ai veproi me urdhrin e një autoriteti më të lartë, identiteti i të cilit nuk është provuar nga dëshmitë. Ai nuk i vrau nëntë të burgosurit me nismën e vetë.

B. Faktorët rëndues dhe lehtësues

728 Statuti dhe Rregullorja nuk përpiqen të përkufizojnë të gjithë faktorët rëndues dhe lehtësues. Jurisprudenca ka identifikuar faktorë të tjerë të cilët Dhoma mund t'i marrë parasysh.[2426] Por këta faktorë nuk mbarojnë me kaq. Dhoma duhet të peshojë rrethanat e çdo rasti të veçantë për të identifikuar faktorët rëndues dhe lehtësues dhe për të vlerësuar peshën që duhet t'u jepet atyre.[2427]

729. Faktorë rëndues duhet të kenë lidhje të drejtëpërdrejtë me kryerjen e shkeljes,[2428] dhe duhet të vërtetohen jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.[2429] Përdorimi nga ana e të Akuzuarit i së drejtës së tij për të heshtur dhe për të mos dëshmuar nuk mund të përbëjë faktor rëndues.[2430] Faktorët lehtësues mund të merren parasysh pavarësisht nëse kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me shkeljen e pretenduar,[2431] dhe duhet të përcaktohen në bazë të tërësisë së gjasave.[2432]

730. Në këtë çështje Prokuroria pretendon se faktorë rëndues në fjalë përfshijnë synimin diskriminues; afatin kohor gjatë të cilit u krye krimi; pjesëmarrjen kriminale aktive dhe të drejtpërdrejtë; paramendimin; karakterin e dhunshëm dhe poshtërues të veprimeve dhe pambrojtshmërinë e viktimave; statusin e viktimave, moshën e tyre të re dhe numrin e tyre; pasojat e krimit mbi ta; të burgosurit civilë; karakterin e të akuzuarit (përfshirë mungesën e keqardhjes); si dhe rrethanat e krimeve në përgjithësi.[2433]

[2426] Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafët 686 dhe 696.
[2427] Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 777, 780; Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafi 685.
[2428] Aktgjykim *Kunaraci*, paragrafi 850; Aktgjykim *Stakiqi*, paragrafi 911.
[2429] Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 763; Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafi 686.
[2430] Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 783; Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafi 687.
[2431] Aktgjykim *Stakiqi*, paragrafi 920.
[2432] Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafi 697.

731. Siç u përmend më lart, Dhoma ka arritur në përfundimin se i Akuzuari Haradon Bala është penalisht përgjegjës për kryerjen e krimeve të trajtimit mizor, të torturës dhe të vrasjes së të burgosurve civilë.[2434] Statusi i të burgosurve si civilë (ose si persona që nuk morën pjesë aktive në luftime) nuk mund të merret parasysh si faktor rëndues duke qenë se përbën tashmë një element të krimeve të torturës, të trajtimit mizor dhe të vrasjes sipas Nenit 3 të Statutit. Këto krime u kryen nga i Akuzuari Haradin Bala brenda një periudhe kohore prej më pak se 2 muajsh. Përsëritja e sjelljes kriminale të Haradin Balës nuk duhet të konsiderohet si faktor rëndues në këtë çështje sepse gjatë vlerësimit të peshës së krimeve u mor parasysh numri i krimeve të kryera në periudhën kohore në fjalë. E njëjta gjë mund të thuhet lidhur me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të të Akuzuarit në krimet dhe faktorë të tjerë të përmendur (d.m.th. pambrojtshmëria e viktimave si të burgosur, karakteri i dhunshëm dhe poshtërues i veprimeve, rrethanat e krimeve në përgjithësi). Dhoma nuk dëgjoi dëshmi që do t'i lejonin të nxirrte një përfundim kundër të Akuzuarit në lidhje me aspekte të tjera të ngritura nga Prokuroria.

732. Mbrojtja e Haradin Balës ka theksuar se i Akuzuari nuk ishte njeri me ndonjë rol komandues apo autoritar në ngritjen e kampit, dhe në thelb, kreu detyra që iu caktuan si "njeri i thjeshtë".[2435] Në një deklaratë pa betim, Haradin Bala vuri në dukje se ishte babai i shtatë fëmijëve dhe se një prej fëmijve të tij kishte nevojë për kujdes te veçantë duke qenë e paralizuar.[2436] Gjithashtu dëshmitë vërtetojnë se Haradin Bala është në gjendje jo të mirë shëndetësore.[2437] Ai vuan prej vitesh nga zemra dhe tensioni.[2438] Dhoma do t'i marrë parasysh këto pika lidhur me ndonjë zbutje të dënimit. Gjithashtu ajo është e vetëdijshme se dënimi i gjatë do të krijojë vështirësi për familjen e tij, veçanërisht duke qenë se vajzës së tij i nevojitet një përkujdesje e veçantë dhe është e bindur se shqetësimi i të Akuzuarit për familjen do të bëjë që periudha e burgimit të jetë më e vështirë për atë.

733. Dhoma dëgjoi dëshmi edhe për mirëtrajtimin e disa të burgosurve në kamp-burgun e Llapushnikut nga ana e Haradin Balës.[2439] Megjithëse këto dëshmi tregojnë se ai ishte në gjendje të sillej me dashamirësi, kjo nuk e zvogëlon në mënyrë të dukshme përgjegjësinë e sjelljes së tij në raste të tjera, për të cilat do të ndëshkohet. Ndihmës së herëpashershme ofruar disa të burgosurve nuk do t'i jepet shumë peshë.

[2433] Argumente Përmbyllëse, T 7345.
[2434] *Shih më sipër*, paragrafët 652-670.
[2435] Argumente Përmbyllëse, T 7479.
[2436] Deklaratë pa betim të Haradin Balës, T 6905.
[2437] Ali Thaqi, T 7022-7026; Kadri Dugolli, T 7007-7012; Dr Fitim Selimi, T 6949-6951; Provë materiale DB6.
[2438] Ali Thaqi, T 7022-7026; Kadri Dugolli, T 7007-7012; Dr Fitim Selimi, T 6949-6951; Provë materiale DB6.
[2439] L07, T 832; L24, T 1330-1332.

C. Praktika e përgjithshme në gjykatat e ish-Jugosllavisë dhe në këtë Tribunal

734. Në përcaktimin e dënimit të duhur, Dhoma ka marrë parasysh praktikën e përgjithshme të dënimeve në ish-Jugosllavi. Megjithatë, praktika e lartpërmendur nuk është e detyrueshme për të[2440] dhe Dhoma mund të japë një dënim më të rëndë se dënimi që do të jepej sipas ligjeve përkatëse në ish-Jugosllavi.[2441] Sipas Nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, i cili ishte në fuqi në kohën e krimeve, një sërë veprimesh kriminale, ndër të cilat "vrasje, tortura dhe trajtimi çnjerëzor", "vuajtja e pamasë apo cënimi i mirëqenies trupore dhe shëndetit" të popullatës civile dënoheshin me burgim prej jo më pak se pesë vjet apo me dënim me vdekje. Nenet 38(1) dhe 38(2) të Kodit të RSFJ-së kanë lidhje gjithashtu duke qenë se parashikojnë një dënim prej 15 vjet burgim varësisht dispozitës që, nëse vepra penale bën të mundur dënimin me vdekje, atëhere gjykata mund të japë një dënim më të gjatë me 20 vjet burgim. Bazuar në sa më sipër, krimet për të cilat i Akuzuari Haradin Bala u shpall fajtor, në ish-Jugosllavi ndëshkoheshin me dënime 5-20 vjet burgim.

735. Megjithëse kjo çështje varet nga faktet e veta, në përcaktimin e dënimit të Haradin Balës, Dhoma ka marrë parasysh edhe praktikën e dënimeve në këtë Tribunal lidhur me kryerjen e krimeve në kamp-burgje ose objekte burgimi apo rreth atyre. Nga aktgjykimet e deritanishme, del e qartë se rrethanat e çështjeve ndryshojnë shumë, gjë që ndikon në dhënien e afateve të dënimeve. Çështjet kanë të bëjnë me dënime për krime të ndryshme: përgjegjësia penale e drejtpërdrejtë sipas Nenit 7(1) apo përgjegjësia eprore sipas Nenit 7(3) të Statutit, dhe në disa raste edhe krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës, por në raste të tjera vetëm një prej tyre. Kishte ndryshime të rëndësishme faktike edhe në lidhje me aspekte si numri i viktimave, kohëzgjatja e ekzistencës së kamp-burgut, dhe masa e egërsisë së shfaqur prej të akuzuarit. Krimet më të rënda në çështjet me kamp-burgje çuan në dënime të gjata. Në çështjen *Prokuroria kundër Jelisiqit*, ku u dha një dënim me 40 vjet, gjatë dhënies së dënimit Dhoma Gjyqësore theksoi "natyrën e neveritshme, shtazore dhe sadiste të sjelljes së Jelisiqit."[2442] Në çështjen *Prokuroria kundër Delaliqit e të tjerëve* gjatë dhënies së dënimit prej 15 vjetësh për Lanxhon, një rojë në kamp-burgun e Çelebiqit, Dhoma Gjyqësore

[2440] Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 813, 816; Vendimi i Apelit *Kunaraci*, paragrafi 377; Vendimi i Apelit *Jelisiqi*, paragrafët 116-117; Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafët 681-682, i cili i referohet Aktgjykimit *Kunarac*, paragrafi 829: "Megjithëse Dhoma nuk është e detyruar të zbatojë praktikën e dënimeve të ish-Jugosllavisë, kërkohet me siguri diçka më shumë se citimi i thjeshtë i dispozitave të kodit penal të ish-Jugosllavisë. Nëse ka ndryshime, duhet të sigurohet që dënimi i dhënë të shpjegohet në lidhje me praktikën e dënimeve të ish-Jugosllavisë, veçanërisht kur e drejta ndërkombëtare nuk jep udhëzim për një praktikë të caktuar dënimesh. Dhoma Gjyqësore thekson se për shkak të ndryshimeve shumë të rëndësishme thelbësore që shpesh ekzistojnë midis sistemeve shtetërore të ndjekjes penale dhe sistemit të ndjekjes penale të këtij juridiksioni, natyra, hapësira dhe shkalla e shkeljeve të trajtuara para Tribunalit Ndërkombëtar nuk e lejojnë zbatimin e vetvetishëm të praktikave të dënimeve të ish-Jugosllavisë."
[2441] Vendimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 816-817; Vendimi i Apelit *Bllashkiqi*, paragrafi 681.
[2442] Aktgjykimi *Jelisiqi*, paragrafi 130.

mori veçanërisht parasysh prirjet sadiste të shfaqura dhe natyrën e paramenduar të veprimeve të tij kriminale.[2443]

736. Dhoma trajtoi në veçanti dy çështje të cilat tregojnë akuza faktike dhe ligjore që kanë disa ngjashmëri me këtë çështje. Në çështjen *Prokuroria kundër Tadiqit,* i Akuzuari u dënua me 20 vjet burgim për kryerjen dhe për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të trajtimit mizor, të veprimeve çnjerëzore, të përndjekjeve, të torturës, të shkaktimit të qëllimshëm të vuajtjes së madhe ose të lëndimit të rëndë trupor ose të shëndetit dhe të vrasjes sipas Neneve 2, 3, dhe 5.[2444] Në çështjen *Prokuroria kundër Tadiqit e të tjerëve*, Lanxho u dënua me 15 vjet për kryerjen e krimeve të vrasjes së qëllimshme, të shkaktimit të qëllimshëm të vuajtjes se madhe apo të lëndimit të rëndë trupor ose të shëndetit sipas Nenit 2.[2445] Veprimet e kryera në rastin e fundit ishin të një natyre jashtëzakonisht të fëlliqur dhe të zvetënuar. Dhoma ka marrë parasysh edhe rrethanat dhe dënimin me 7 vjet burgim e shpallur në çështjen *Prokuroria kundër Aleksovskit*.[2446] Megjithatë, e rëndësishme është që në atë çështje nuk pati dënime për vrasje.

D. Llogaritja e kohës së paraburgimit

737. Sipas Rregullës 101(C) të Rregullores, periudha gjatë së cilës i Akuzuari ka kaluar ne paraburgim në pritje të gjykimit dhe gjatë gjykimit, llogaritet brenda kohës së dënimit. Dhoma nënvizon se Haradin Bala ndodhet në paraburgim lidhur me këtë Aktakuzë që prej 17 shkurtit 2003.

[2443] Aktgjykimi *Çelebiqi*, paragrafët 1272-1284.
[2444] Vendimi mbi Apelin e Dënimit *Tadiqi*
[2445] Aktgjykimi *Çelebiqi*; Vendimi mbi Apelin e Dënimit *Çelebiqi*.
[2446] Vendimi i Apelit *Aleksovski*.

IX. VENDIM

738. Për arsyet e lartëpërmendura, dhe pasi i ka shqyrtuar tërë dëshmitë dhe parashtrimet e palëve, Dhoma vendos si më poshtë:

739. Dhoma është e mendimit se nuk u plotësuan kërkesat jurisdiksionale për zbatueshmërinë e Nenit 5 të Statutit. Rrjedhimisht, hidhen poshtë akuzat për krime kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit, përkatësisht Pika 1 (burgim), Pika 3 (torturë), Pika 5 (veprime çnerëzore), Pika 7 (vrasje) dhe Pika 9 (vrasje).

740. Dhoma e shpall të Akuzuarin, Fatmir Limaj, **TË PAFAJSHËM** për të gjitha pikat e Aktakuzës. Sipas Rregullës 99(A) të Rregullores, Dhoma urdhëron lirimin e menjëhershëm të Fatmir Limajt prej Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara.

741. Dhoma e shpall të Akuzuarin, Haradin Bala, **FAJTOR** në bazë të Nenit 7(1) të Statutit, për këto vepra penale:

Pika 4: Torturë, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas Nenit 3 të Statutit, për ndihmë në torturimin e L12-ës;

Pika 6: Trajtim mizor, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, për keqtrajtimin prej tij personalisht të burgosurve L04, L10 dhe L12, dhe, në një rast tjeter, për ndihmë në keqtrajtimin e të burgosurit L04, dhe për rolin e tij personal në mbajtjen dhe zbatimin e kushteve çnjerëzore të burgimit në kamp-burgun e Llapushnikut;

Pika 10: Vrasje, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, për pjesëmarrjen personale në vrasjen, në malet e Berishës, të nëntë të burgosurve: Emin Emini, Ibush Hamza, Hyzri Hajrizi, Shaban Hoti, Hasan Hoxha, Safet Hysenaj, Bashkim Rashiti, Lutfi Xhemshiti dhe Shyqyri Zymeri.

Por e shpall të Akuzuarin, Haradin Bala, **TË PAFAJSHËM** për të gjitha pikat e tjera të Aktakuzës.

742. Dhoma i jep Haradin Balës një dënim të vetëm prej 13 vitesh burgim. Haradin Bala ndodhet në paraburgim që prej 17 shkurtit 2003. Sipas Rregullës 101(C) të Rregullores, koha që ka kaluar në

paraburgim deri tani do të llogaritet brenda kohës së dënimit. Sipas Rregullës 103(C) të Rregullores, Haradin Bala do të mbetet në paraburgim të Tribunalit deri në përfundimin e formaliteteve për transferimin e tij në shtetin ku do te vuajë dënimin.

743. Dhoma e shpall të Akuzuarin, Isak Musliu, **TË PAFAJSHËM** për të gjitha pikat e Aktakuzës. Sipas Rregullës 99(A) të Rregullores, Dhoma urdhëron lirimin e menjëhershëm të Isak Musliut prej Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti anglisht ka përparësi.

Sot, me datën 30 nëntor 2005.
Në Hagë
Holandë

/nënshkruar në origjinal/
Kevin Parker
Kryegjykatës

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Krister Thelin

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatëse Christine Van Den Wyngaert

[Vula e Tribunalit]

X. SHTOJCA I: GLOSAR

Akayesu Aktgjykim	*Prosecutor v. Jean-Paul Akayesu,* Case No. ICTR-96-4-T, Judgement, 2 September 1998
Aktakuza	*Prokurorja kundër Fatmir Limajt, Haradin Balës, Isak Musliut*, Lënda Nr. IT-03-66-PT, Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për të Ndryshuar Aktakuzën e Ndryshuar, 13 shkurt 2004 (Aktakuza e Ndryshuar për të Dytën Herë), bashkangjitur Mocionit të Prokurorisë për të Ndryshuar Aktakuzën e Ndryshuar, dorëzuar më 6 nëntor 2003)
Aleksovski Aktgjykim	*Prosecutor v. Zlatko Aleksovski,* Case No. IT-95-14/1-T, Judgement, 25 June 1999
Aleksovski Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Zlatko Aleksovski,* Case No. IT-95-14/1-A, Judgement, 24 March 2000
APC	Autoblindë (Armoured Personnel Carriers)
APJ	Armata Popullore Jugosllave
Argument Përmbledhës i Mbrojtjes mbi Çështje Juridiksionale të Konfliktit të Armatosur	*Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu*, Case No. IT-03-66-T. Defence Skeleton Argument on the Jurisdictional Issue of Armed Conflict, 30 August 2005
Argumente Përmbyllëse	Transkripti i seancës së kësaj çështjeje lidhur me argumentet përmbyllëse të Prokurorisë dhe të Mbrojtjes. Të gjitha faqet e përmendura në këtë Aktgjykim janë marrë nga versioni i pakorrigjuar i faqjes së zbardhur. Prandaj mund të ekzistojnë ndryshime te vogla midis faqosjes aty dhe faqosjes së transkriptit përfundimtar të bërë publik.
Bërgjanin Aktgjykim	*Prosecutor v. Radoslav Brđanin,* Case No. IT-99-36-T, Judgement, 1 September 2004
Blagojeviq Aktgjykim	*Prosecutor v. Vidoje Blagojević and Dragan Jokić,* Case No. IT-02-60-T, Judgement, 17 January 2005
Bllashkiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Tihomir Blaškić,* Case No. IT-95-14-T, Judgement, 3 March 2000
Bllashkiq Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Tihomir Blaškić,* Case No. IT-95-14-A, Judgement, 29 July 2004

CCIU	Njësia Qendrore Hetimore Kriminale (UNMIK Police Central Criminal Investigation Unit)
Çelebiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Zejnil Delalić et al,* Case No. IT-96-21-T, Judgement, 16 November 1998
Çelebiq Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Zejnil Delalić et al,* Case No. IT-96-21-A, Judgement, 20 February 2001
Çelebiq Vendimi mbi Apelin e Dënimit	*Prosecutor v. Zejnil Delalić et al,* Case No. IT-96-21-*Abis,* Judgement on Sentence Appeal, 8 April 2003
Dosje Paragjyqësore e Fatmir Limajt	*Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu,* Case No. IT-03-66-PT, Pre-Trial Brief of Fatmir Limaj, 1 June 2004
Dosje Paragjyqësore e Haradin Balës	*Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu,* Case No. IT-03-66-PT, Pre-Trial Brief of Haradin Bala Pursuant to Rule 65ter (F) of the Rules of Procedure and Evidence, 1 June 2004
Dosje Paragjyqësore e Isak Musliut	*Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu,* Case No. IT-03-66-PT, Pre-Trial Brief of Isak Musliu, 1 June 2004
Dosje Paragjyqësore e Prokurorisë	*Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu,* Case No. IT-03-66-T, Prosecutor's Notice of Filing of Pre-Trial Brief and Other Documents Pursuant to Rule 65 *ter,* 27 February 2004 and Corrigendum to Prosecution's Pre-Trial Brief, Updated Witness List and Revised Set of Rule 65ter Summaries, 30 September 2004
Dosje Përfundimtare e Mbrojtjes	*Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu,* Case No. IT-03-66-T, Defence Joint Final Brief Pursuant to Rule 86(B) (Confidential), 21 July 2005; Corrigendum to Sections 7, 8, and 12 of Defence Joint Final Brief, 25 July 2005 and Corrigendum to Sections 3, 4, 5 and 9 of Defence Joint Final Brief, 1 August 2005
Dosje Përfundimtare e Prokurorisë	*Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu,* Case No. IT-03-66-T,

	Prosecution's Final Brief (Confidential), 20 July 2005
ECMM	Misioni Monitorues i Bashkësisë Evropiane (European Community Monitoring Mission)
FARK	Forcat e Armatosura e Republikës së Kosovës
Furunxhija Aktgjykim	*Prosecutor v. Anto Furundžija,* Case No. IT-95-17/1-T, Judgement, 10 December 1998
Furunxhija Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Anto Furundžija,* Case No. IT-95-17/1-A, Judgement, 21 July 2000
Galiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Stanislav Galić,* Case No. IT-98-29, Judgement, 5 December 2003
GjPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
Jelisiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Goran Jelisić,* Case No. IT-95-10-T, Judgement, 14 December 1999
Jelisiq Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Goran Jelisić,* Case No. IT-95-10-A, Judgement, 5 July 2001
JSO	Njësia e Operacioneve të Posaçme e Ministrisë se Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë
Kamp-burgu	Kompleks shtëpish fshatare i Llapushnikut i përmendur në Provën Materiale të Prokurorisë P6 (ff. 1-18)
Kërnojelac Aktgjykim	*Prosecutor v. Milorad Krnojelac,* Case No. IT-97-25-T, Judgement, 15 March 2002
Kërnojelac Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Milorad Krnojelac,* Case No. IT-97-25-A, Judgement, 17 September 2003
Kërstiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Radislav Krstić,* Case No. IT-98-33-T, Judgement, 2 August 2001
Kërstiq Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Radislav Krstić,* Case No. IT-98-33-A, Judgement, 19 April 2004
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
KNPZH	Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (International Commission for Missing Persons, ICMP)

Konventa e Gjenevës I	Konventa e Gjenevës I për Përmirësimin e Gjendjes së të Lënduarve dhe të Sëmurëve në Forca të Armatosura në terren, më 12 gusht 1949
Konventa e Gjenevës II	Konventa e Gjenevës II për Përmirësimin e Gjendjes së Anëtarëve të Forcave të Armatosura Detare të Lënduar, të Sëmurë dhe të Shpëtuar nga Mbytja, më 12 gusht 1949
Konventa e Gjenevës III	Konventa e Gjenevës III lidhur me Trajtimin e Robërve të Luftës, më 12 gusht 1949
Konventa e Gjenevës IV	Konventa e Gjenevës IV lidhur me Mbrojtjen e Civilëve në Kohë Lufte, më 12 gusht 1949
Konventat e Gjenevës	Konventat e Gjenevës I deri IV të datës 12 gusht 1949
Kordiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Dario Kordić & Mario Čerkez,* Case No. IT-95-14/2-T, Judgement, 26 February 2001
Kordiq Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Dario Kordić & Mario Čerkez,* Case No. IT-95-14/2-A, Judgement, 17 December 2004
Kunarac Aktgjykim	*Prosecutor v. Dragoljub Kunarac et al.,* Case No. IT-96-23/1-T, Judgement, 22 February 2001
Kunarac Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Dragoljub Kunarac et al.,* Case No. IT-96-23&23/1-A, Judgement, 12 June 2002
Kupreshkiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Zoran Kupreškić et al.,* Case No. IT-95-16-T, Judgement, 14 January 2000
Kupreshkiq Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Zoran Kupreškić et al.,* Case No. IT-95-16-A, Judgement, 23 October 2001
Kvoçka Aktgjykim	*Prosecutor v. Miroslav Kvočka et al.,* Case No. IT-98-30-T, Judgement, 2 November 2001
Kvoçka Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Miroslav Kvočka et al.,* Case No. IT-98-30/1-A, Judgement, 28 February 2005

LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LPK	Lëvizja Popullore e Kosovës
LPRK	Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës
Mbrojtja	Avokatët e të Akuzuarve Fatmir Limaj, Haradin Bala dhe Isak Musliu
Mbrojtja e Fatmir Limajt	Avokatët për Fatmir Limajn
Mbrojtja e Haradin Balës	Avokatët për Haradin Balën
Mbrojtja e Isak Musliu	Avokatët për Isak Musliun
Millosheviq Vendimi Rregulla 98*bis*	*Prosecutor v Slobodan Milošević,* Case No. IT-02-54-T, Decision on Motion for Judgement of Acquittal, 16 June 2004
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë.
Naletiliq Aktgjykim	*Prosecutor v. Mladen Naletilić aka "Tuta" and Vinko Martinović aka "Štela",* Case No. 98-34-T, Judgement, 31 March 2003
Nikoliq Vendimi i Dënimit	*Prosecutor v. Dragan Nikolić,* Case No. IT-94-2-S, Sentencing Judgement, 18 December 2003
NPK	Ndërmarrje e përbashkët kriminale
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
PJP	Njësia e Posaçme Policore e Ministrisë se Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë
PPK	Partia Parlamentare e Kosovës
Prokuroria	Zyra e Prokurores së Tribunalit
PU	Policia Ushtarake
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
Rregullorja	Rregullorja e Procedurës dhe e Provave
SAJ	Njësia e Posaçme kundër Terrorit e Ministrisë se Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë

Stakiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Milomir Stakić,* Case No. IT-97-24-T, Judgement, 31 July 2003
Statuti	Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991, i themeluar nga Rezoluta 827 e Këshillit të Sigurimit
Strugar Aktgjykim	*Prosecutor v. Pavle Strugar,* Case No. IT-01-42-T, Judgement, 31 January 2005
T	Transkripti i procedurave të kësaj çështjeje. Të gjitha faqet e Transkriptit të përmendura në këtë Aktgjykim janë marrë nga versioni i pakorrigjuar i transkriptit. Prandaj mund të ekzistojnë ndryshime të vogla midis faqosjes së versionit të pakorrigjuar dhe faqosjes së transkriptit përfundimtar të bërë publik.
Tadiq Aktgjykim	*Prosecutor v. Duško Tadić aka "Dule",* Case No. IT-94-1-T, Judgement, 7 May 1997
Tadiq Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Duško Tadić aka "Dule",* Case No. IT-94-1-A, Judgement, 15 July 1999
Tadiq Vendimi mbi Apelin e Dënimit	*Prosecutor v. Duško Tadić aka "Dule",* Case No. IT-94-1-A and *IT-94-1-Abis,* Judgement in Sentencing Appeals, 26 January 2000
Tadiq Vendimi i Juridiksionit	*Prosecutor v. Duško Tadić aka "Dule",* Case No. IT-94-1-AR72, Decision on the Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction, 2 October 1995
Todoroviq Vendimi i Dënimit	Prosecutor v. Stevan Todorović, Case No. IT-95-9/1-T, Sentencing Judgement, 31 July 2001
TPNR	Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Gjenocid dhe për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës dhe për Qytetarë të Ruandës Përgjegjës për Gjenocid dhe Veprime të Tjera të Tilla të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinjë,

	midis 1 janari 1994 dhe 31 dhjetori 1994
Tribunali	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UJ	Ushtria e Jugosllavisë
UNHCR	Komisariati i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuar
UNICEF	Fondi për Fëmij të Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
Vasileviq Aktgjykim	*Prosecutor v. Mitar Vasiljević,* Case No. IT-98-32-T, Judgement, 29 November 2002
Vasileviq Vendimi i Apelit	*Prosecutor v. Mitar Vasiljević,* Case No. IT-98-32-A, Judgement, 25 February 2004

XI. SHTOJCA II DHE III: HARTA

Shtojca II: Harta e rajonit dhe e komunave përreth



Shtojca III: Harta topografike e rajonit



XII. SHTOJCA IV: HISTORIA PROCEDURALE

A. Procesi paragjyqësor

1. Aktakuza dhe paraqitja fillestare

744. Fillimisht të Akuzuarit Fatmir Limaj, Haradin Bala dhe Isak Musliu u akuzuan formalisht bashkë me një të Akuzuar të katërt, Agim Murtezi. Aktakuza, e konfirmuar nga Gjykatësi Amin El Mahdi më 27 janar 2003, u dorëzua në mirëbesim më 15 janar 2003 dhe përmban nëntë pika për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës dhe për krime kundër njerëzimit sipas Neneve 3 dhe 5 të Statutit. Veprimet dhe mosveprimet të cilat shërbejnë si bazë për aktakuzën, thuhet se ndodhën midis majit 1998 dhe korrikut 1998.

745. Tre prej të katër të Akuzuarve, d.m.th. Haradin Bala, Isak Musliu dhe Agim Murtezi, u arrestuan nga SFOR-i më 17 shkurt 2003 dhe u transferuan në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara. Më 18 shkurt 2003, Gjykatësi Amin El Mahdi pezulloi Vendimin për moszbulim materiali.[2447] Fatmir Limaj u arrestua më 18 shkurt 2003 dhe u transferua nga Kosova në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara më 3 mars 2003. Gjatë paraqitjes së parë të Haradin Balës, të Isak Musliut dhe Agim Murtezit, më 20 shkurt 2003, të tre u vetëdeklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat e ngritura kundër tyre. Gjatë paraqitjes së parë të Fatmir Limajt, më 5 mars 2003, edhe ky i fundit u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat e ngritura kundër tij.

746. Më 30 maj 2003, me Urdhrin e Kryetarit të Tribunalit, çështja iu caktua Dhomës Gjyqësore I. Më 20 shkurt 2003, si gjykatës paragjyqësor u emërua Gjykatësi Liu Daquin,[2448] mirëpo, më 23 maj 2003, pas miratimit të rezolutës 1481 (2003) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për lejimin e gjykatësve *ad litem* si Gjykatës Paragjyqësorë, si Gjykatës Paragjyqësor u emërua Gjykatësi Joaquín Martín Canivell.[2449]

2. Historia e Aktakuzës

747. Më 21 shkurt 2003, Mbrojtja e Murtezit ngriti mundësinë e një gabimi në përcaktimin e identitetit të të Akuzuarit. Më 21, 24 dhe 25 shkurt 2003, Prokuroria mori në pyetje të Akuzuarin

[2447] Vendimi i Pezullimit të Urdhrit të Moszbulimit të Materialit dorëzuar më 27 janar 2003, 18 shkurt 2003.
[2448] Urdhri për Emërimin e Gjykatësit Paragjyqësor, 20 shkurt 2003.
[2449] Urdhri për Emërimin e Gjykatësit të ri Paragjyqësor, 23 maj 2005.

Agim Murtezi sipas Rregullave 42 dhe 43 të Rregullores. Më 28 shkurt 2003, me kërkesë të Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore I e tërhoqi aktakuzën, pa paragjykim.[2450]

748. Më 7 mars 2003, në bazë të Rregullave 50 dhe 73 dhe në përputhje me Urdhrin e Dhomës Gjyqësore I, Prokuroria dorëzoi "Mocionin e Prokurorisë për Ndryshuar Aktakuzën" ku hidheshin poshtë tërë akuzat kundër Agim Murtezit dhe hoqi një viktimë të përfshirë në Shtojcën III të aktakuzës fillestare. Më 25 mars 2003, Dhoma Gjyqësore I e miratoi Mocionin e Prokurorisë.[2451]

749. Më 6 nëntor 2003, Prokuroria dorëzoi një Mocion të ri "Për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar". Dhoma Gjyqësore I e miratoi Mocionin më 12 shkurt 2004 pa paragjykim për të Akuzuarit.[2452] Aktakuza e ndryshuar shtoi edhe akuzën e përgjegjësisë penale të përbashkët sipas Nenit 7(1) të Statutit kundër të tre të akuzuarve, një akuzë për veprime çnjerëzore, si krim kundër njerëzimit, sipas Nenit 5 të Statutit në bazë të akuzave faktike të përfshira në aktakuzën fillestare, një rast vrasjeje sipas pikave ekzistuese në aktakuzën fillestare, dhe akuzen e përgjegjësisë eprore sipas Nenit 7(3) të Statutit kundër të Akuzuarit Isak Musliu.

750. Më 20 shkurt 2004, Mbrojtja e Isak Musliut kërkoi leje prej Dhomës për të apeluar kundër vendimit për lejimin e ndryshimit të Aktakuzës së Ndryshuar. Më 25 shkurt 2004, Dhoma Gjyqësore I e hodhi poshtë kërkesën.[2453]

751. Më 27 shkurt 2004, pas ndryshimit, të Akuzuarve Fatmir Limaj, Haradin Bala dhe Isak Musliu iu kërkua të deklaroheshin edhe një herë mbi akuzat. Të tre të Akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat e shtuara me ndryshimin e Aktakuzës.

752. Mbrojtja e Haradin Balës beri të njohur qëllimin e saj për të përdorur një alibi si mbrojtje të pjesshme.[2454]

[2450] Urdhri për Tërheqjen e Aktakuzës kundër Agim Murtezit dhe Urdhri për Lirimin e tij të Menjëhershëm, 28 shkurt 2003.
[2451] Vendimi për Lejimin e Ndryshimit të Aktakuzës, 25 mars 2003.
[2452] Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar, 12 shkurt 2004.
[2453] Vendimi mbi Kërkesën për Leje të Musliut për të apeluar kundër "Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për të Ndryshuar Aktakuzën e Ndryshuar", 25 shkurt 2004.
[2454] Dosja Paragjyqësore e Haradin Balës sipas Rregullës 65*ter*(F) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, 27 maj 2004, paragrafët 2-5.

3. Kërkesat për lirimin e përkohshëm

753. Më 24 qershor 2003, Mbrojtja e Fatmir Limajt dorëzoi një "Kërkesë për Lirimin e Përkohshëm të Fatmir Limajt". Më 12 shtator 2003, Dhoma Gjyqësore 1 e hodhi poshtë kërkesën e të Akuzuarit për arsye se nuk ishte e bindur se i Akuzuari do të ishte dorëzuar vullnetarisht, nëse do të kishte patur mundësi, dhe për shkak të rëndësisë së akuzave kundër të Akuzuarit dhe të mungesës së garancive nga UNMIK-u, organi dhe administrata e ligjshme e Kosoves.[2455] Më 22 shtator 2003, Mbrojtja e Fatmir Limajt dorëzoi një kërkesë për leje për të apeluar vendimin e Dhomës Gjyqësore 1 për lirimin e përkohshëm të Fatmir Limajt. Kërkesa u hodh poshtë nga Dhoma e Apelit më 31 tetor 2003.[2456]

754. Me 7 korrik 2003, Mbrojtja e Haradin Balës dorëzoi një kërkesë të ngjashme për lirimin e përkohshëm. Më 16 shtator 2003, Dhoma Gjyqësore 1 e hodhi poshtë kërkesën për shkak se nuk ishte e bindur se i Akuzuari do të paraqitej për procesin gjqësor, nëse lirohej.[2457] Mbrojtja e Haradin Balës kërkoi leje për të apeluar vendimin, por kërkesa u hodh poshtë nga Dhoma Gjyqësore 1 më 31 tetor 2003.[2458]

755. Më 6 gusht 2003, edhe Mbrojtja e Isak Musliut dorëzoi një kërkesë për lirimin e përkohshëm. Më 17 shtator 2003, Dhoma Gjyqësore 1 e hodhi poshtë kërkesën për të njëjtat arsye si për kërkesat e Fatmir Limajt dhe Haradin Balës. Edhe Mbrojtja e Isak Musliut kërkoi leje për të apeluar vendimin, por kërkesa u hodh poshtë më 31 tetor 2003.[2459]

4. Çështje që lidhen me mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve

756. Më 19 qershor 2003, Prokuroria dorëzoi Mocionin e parë të Prokurorisë për Masa Mbrojtëse lidhur me zbulimin e materialit në të cilin ajo kërkoi masa mbrojtese për gjashtë dëshmitarë kyç. Mbrojtja e Fatmir Limajt dhe e Isak Musliut kundërshtuan zbulimin e vonuar të dëshmive të gjashtë dëshmitarëvë kyç. Dhoma Gjyqësore I i hodhi poshtë argumentet e Mbrojtjes dhe miratoi kërkesën e Prokurorisë për masa mbrojtëse më 30 shtator 2003.[2460]

[2455] Vendimi mbi Lirimin e Përkohshëm të Fatmir Limajt, 12 shtator 2003.
[2456] Vendimi mbi Kërkesën e Fatmir Limajt për Lirimin e Përkohshëm, 31 tetor 2003.
[2457] Vendimi mbi Lirimin e Përkohshëm të Haradin Balës, 16 shtator 2003.
[2458] Vendimi mbi Kërkesën e Haradin Balës për Lirimin e Përkohshëm, 31 tetor 2003.
[2459] Vendimi mbi Lirimin e Përkohshëm të Isak Musliut, 31 tetor 2003.
[2460] Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse Lidhur me Zbulimin e Materialit, 30 shtator 2003.

757. Më 21 tetor 2003, Prokuroria dorëzoi një mocion të dytë në mirëbesim dhe pjesërisht *ex-parte* për masa mbrojtese lidhur me zbulimin e materialit për tetë dëshmitarëve të tjerë kyç. Dhoma Gjyqësore I miratoi mocionin e dytë të Prokurorisë më 18 dhjetor 2003.[2461]

5. Shëndeti i të Akuzuarit Haradin Bala

758. Më 1 korrik 2003, në bazë të Rregullës 74*bis*, Mbrojtja e Haradin Balës kërkoi që një kardiolog i pavarur të ekzaminonte Haradin Balën për të përcaktuar nëse gjendja e tij shëndetësore ishte e pranueshme që ai të gjykohej. Më 24 korrik 2003, Gjykatësi Paragjyqësor urdhëroi që Sekretari të emëronte një kardiolog për të kryer një ekzaminim mjekësor të të Akuzuarit.[2462] Me 9 shtator 2003, kardiologu dorëzoi raportin e tij dhe përfundoi se gjendja shëndetësore e Haradin Balës ishte e pranueshme që ai të gjykohej.

759. Si pasojë e problemeve të mëtejshme shëndetësore, Mbrojtja e Haradin Balës dorëzoi një mocion të dytë në mirëbesim "Mocioni i Haradin Balës për një Ekzaminim Mjekësor", në mënyrë që i Akuzuari të ekzaminohej edhe një herë më 9 qershor 2004 nga një kardiolog i miratuar. Dhoma Gjyqësore I e miratoi kërkesën më 28 qershor 2004.[2463] Më 28 korrik 2004, kardiologu i ri dorëzoi raportin e tij mjekësor në të cilin ai përfundoi se gjendja shëndetësore e Haradin Balës ishte e kënaqshme. Në gusht 2004, Dhoma Gjyqësore I kërkoi që Sekretaria të organizonte ekzaminime të mëtejshme të të Akuzuarit derisa të përcaktohej një diagnozë e besueshme. Ekzaminimi i mëtejshëm zbuloi se i Akuzuari Haradin Bala nuk vuante nga probleme të frymëmarrjes.

6. Fillimi i Procesit Gjyqësor

760. Më 27 shkurt 2004, Prokuroria dorëzoi Dosjen Paragjyqësore të saj. Më 28 prill 2004, Mbrojtja e Isak Musliut dorëzoi një "Kërkesë për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paragjyqësore të Mbrojtjes". Me këtë kërkesë u bashkua edhe Mbrojtja e dy të Akuzuarve të tjerë. Dhoma Gjyqësore I e zgjati afatin me dy javë me arsyetimin se vendimi u mor para afatit për dorëzimin e Dosjeve Paragjyqësore.[2464] Më 24 maj 2004 u miratua një shtyrje e mëtejshme e afatit.[2465] Të tre të Akuzuarit dorëzuan Dosjet e tyre Paragjyqësore më 1 qershor 2004.

[2461] Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse Lidhur me Zbulimin e Materialit, 18 dhjetor 2003.
[2462] Urdhri për një Ekzaminim Mjekësor të të Akuzuarit, dorëzuar në mirëbesim më 25 korrik 2003.
[2463] Urdhri për një Ekzaminim Mjekësor të të Akuzuarit Bala (në mirëbesim) 28 qershor 2004.
[2464] Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjeve Paragjyqësore dhe Urdhri për Dorëzimin e Raportëve të Ekspertëve dhe Njoftimi sipas Rregullës 94*bis*, 7 maj 2004.
[2465] Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjeve Paragjyqësore, 24 maj 2004.

761. Më 11 tetor 2004, me urdhër të Ushtruesit të Detyrës së Kryetarit të Tribunalit, çështja iu caktua Dhomës Gjyqësore II e përbërë prej Gjykatësit Kevin Parker (Kryegjykatës), Gjykatësit Krister Thelin dhe Gjykatëses Christine Van Den Wyngaert.[2466]

762. Të hënën, më 15 nëntor 2004 u zhvillua konferenca paragjyqësore. Gjatë konferencës paragjyqësore, Dhoma hodhi poshtë gojarisht kërkesën e Mbrojtjes për shtyrjen e procesit.[2467] Procesi gjyqësor kundër Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut filloi të hënën, 15 nëntor 2004.[2468]

B. Procesi gjyqësor

1. Përmbledhje

763. Shtjellimi i argumenteve të Prokurorisë filloi më 15 nëntor 2004 dhe mbaroi më 13 prill 2005. Mbrojtja e Fatmir Limajt filloi shtjellimin e argumenteve të saj më 17 maj 2005 dhe e përfundoi më 3 qershor 2005. Mbrojtja e Haradin Balës filloi më 7 qershor 2005 dhe përfundoi më 9 qershor 2005. Mbrojtja e Isak Musliut nuk thirri asnjë dëshmitar gojor përveç dëshmitarit ekspert të përbashkët të Mbrojtjes. Prokuroria thirri 30 dëshmitarë. Prokuroria dorëzoi 260 prova materiale si dëshmi. Mbrojtja e Fatmir Limajt thirri tetë dëshmitarë të mbrojtjes dhe Mbrojtja e Haradin Balës thirri shtatë dëshmitarë të mbrojtjes. Një dëshmitar ekspert u thirr si dëshmitar i përbashkët i Mbrojtjes. Në tërësi, Mbrojtja dorëzoi 44 prova materiale. Prokuroria dorëzoi 31 deklarata të tipit 92*bis*. U dorëzuan tri deklarata të tipit 92*bis* me kërkesë të Mbrojtjes së Fatmir Limajt, një deklaratë e tipit 92*bis* me kërkesë të Haradin Balës, dhe dymbëdhjetë deklarata të tipit 92*bis* me kërkesë të Mbrojtjes së Isak Musliut. Argumentet përmbyllëse u dëgjuan midis 29 gushtit dhe 1 shtatorit 2005.

2. Çështje që lidhen me dëshmitarët

764. Prokuroria dorëzoi disa mocione për mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve dhe për mbrojtjen e materialit tjetër në mirëbesim sipas Rregullës 75 të Rregullores. Dhoma miratoi kërkesën e Prokurorisë për masa mbrojtëse lidhur me trembëdhjetë dëshmitarë të Prokurorisë.

[2466] Vendimi për Caktimin e një Gjykatësi për një Çështje para Dhomës Gjyqësore , 11 tetor 2004.
[2467] Vendimi Gojor i Dhomës, 15 nëntor 2004.
[2468] Vendimi për Caktimin e Datës për Konferencën Paragjyqësore dhe për Fillimin e Procesit Gjyqësor kundër Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, 12 tetor 2004.

765. Më 11 prill 2005, Prokuroria dorëzoi një mocion për masa mbrojtëse për disa dëshmitarë, deklaratat e të cilëve ishin pranuar sipas Rregullës 92*bis*. Kërkesa u miratua nga Dhoma më 14 prill 2005.[2469]

766. Avokatët e Mbrojtjes për të tre të Akuzuarit në këtë çështje, në bazë të Rregullës 74, kërkuan një vendim me veprim të menjëhershëm, që Prokuroria të mos "përgatiste" dëshmitarë, ose një urdhër ku të lejohej prania e përfaqësuesve të Mbrojtjes gjatë seancave përgatitore, ose që Mbrojtjes t'i jepej filmim apo incizim zanor të seancave përgatitore. Dhoma e hodhi poshtë mocionin, dhe gjykoi se përgatitja ishte një procedurë e domosdoshme dhe e njohur. Dhoma arriti në përfundimin së Mbrojtja nuk kishte dorëzuar asgjë që mund t'a bindte Dhomën se nuk plotësoheshin standardet e duhura të përgatitjes.[2470]

767. Nëpërmjet vendimeve të ndryshme, Dhoma lëshoi fletëthirrje detyruese për 14 dëshmitarë.[2471]

768. Gjatë parashtrimit të argumenteve të saj, Prokuroria kërkoi që katër dëshmitarë të Prokurorisë, të gjithë ish-anëtarë të UÇK-së, të shpalleshin dëshmitarë armiqësorë. Dhoma mori një sërë vendimesh gojore lidhur me dëshmitarë armiqësorë. Dhoma hodhi poshtë kërkesën lidhur me Sylejman Selimin për arsye se, megjithëse ajo pranoi se kishte disa mospërputhje midis dëshmisë gojore të dëshmitarit dhe deklaratës së tij të mëparshme, problemet e ngritura nga Prokuroria dukeshin se nuk bënin ndonjë dallim material dhe se Dhomës nuk iu duk se ndonjë ndryshim në qëndrimin e dëshmitarit ishte motivuar nga një qëndrim armiqësor ndaj Prokurorisë.[2472] Mirëpo, Dhoma miratoi tri kërkesa të mëvonshme nga Prokuroria lidhur me Ramadan Behlulin,[2473] Ruzhdi Karpuzin[2474] dhe Shukri Bujën[2475] për arsye se kishte dallime materiale midis dëshmisë së tyre gojore dhe deklaratave të mëparshme dhe, pas shqyrtimit të shpjegimeve të dëshmitarëve për këto dallime, si edhe të sjelljes së tyre në përgjithësi, Dhoma u bind se ata nuk ishin të gatshëm të tregonin të vërtetën. Prokurorisë iu lejua të zhvillonte seancë pyetjesh me të tre dëshmitarët.

[2469] Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse lidhur me Dëshmitarë të Rregullës 92*bis*, 14 prill 2005.
[2470] Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes për Praktikën e Prokurorisë për "Përgatitjen e Dëshmitarëve", 10 dhjetor 2004.
[2471] Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për Lëshimin e Fletëthirrjeve, 2 nëntor 2004. Vendimi mbi Mocionin e Dytë të Prokurorisë për Lëshimin e Fletëthirrjeve, 15 nëntor 2004, Vendimi mbi Mocionin e Tretë të Prokurorisë për Lëshimin e Fletëthirrjeve Detyruese, 15 dhjetor 2004, Vendimi mbi Mocionin e Katërt të Prokurorisë për Lëshimin e Fletëthirrjeve Detyruese, 14 janar 2004, Vendimi mbi Mocionin e Pestë të Prokurorisë për Lëshimin e Fletëthirrjeve Detyruese, 20 janar 2004, Vendimi mbi Mocionin e Gjashtë të Prokurorisë për Lëshimin e Fletëthirrjeve Detyruese, 28 janar 2004.
[2472] Vendimi Gojor i Dhomës, 18 janar 2005.
[2473] Vendimi Gojor i Dhomës, 1 shkurt 2005.
[2474] Vendimi Gojor i Dhomës, 8 shkurt 2005.
[2475] Vendimi Gojor i Dhomës, 9 mars 2005.

3. Çështje të provave

769. Më 17 nëntor 2004, Dhoma miratoi Mocionin e dorëzuar nga Mbrojtja e Haradin Balës i cili kërkonte që të përjashtohej deklarata e të Akuzuarit Haradin Bala në një intervistë me një hetues të Zyrës së Prokurores më 17 shkurt 2003.[2476]

770. Më 1 shkurt 2005, Prokuroria dorëzoi një Mocion, sipas Rregullës 67(A)(i)(a), ku kërkohej që Dhoma të urdhëronte Mbrojtjen e Haradin Balës dhe të Isak Musliut të jepnin hollësi të ndonjë alibie të mbrojtjes brenda një periudhe shtatëditore. Më 16 shkurt 2005, Dhoma urdhëroi që Mbrojtja të informonte Prokurorinë, deri më 28 shkurt 2005, për ndonjë alibi që ajo dëshironte të përdorte si mbrojtje dhe, në një rast të tillë, të përcaktonte vendin apo vendet ku i Akuzuari pretendon se kishte qenë, emrat dhe adresat e dëshmitarëve të mundshëm, si dhe ndonjë dëshmi tjetër të përdorur.[2477] Mbrojtja e Haradin Balës dorëzoi njoftimin e saj për alibi më 28 shkurt 2005.[2478] Mbrojtja e Isak Musliut dorëzoi njoftimin e saj për alibi më 1 mars 2005.[2479]

771. Prokuroria dorëzoi një Mocion ku kërkohej pranimi, si dëshmi provuese, të videofilmimeve (me transkripte) të intervistave dhënë përfaqësuesve të Zyrës së Prokurores nga dy dëshmitarët të cilët u thirrën për të dëshmuar për Prokurorinë dhe dhanë dëshmi gojore e cila në disa aspekte të rëndësishme nuk përputhej me atë që kishin thënë më parë gjatë intervistave. Videofilmimet dhe transkriptet ishin pranuar tashmë si prova lidhur me vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve. Pasoja ishte se dëshmia gojore e dhënë nga secili dëshmitar gjatë seancës kryesore të pyetjeve ishte dukshëm më pak dobiprurëse për Prokurorinë në krahasim më intervistat e mëparshme me Zyrën e Prokurores. Të dy dëshmitarët u shpallën dëshmitarë armiqësorë dhe në këto rrethana, Dhoma miratoi Mocionin për të pranuar deklaratat e mëparshme mospërputhëse si dëshmi provuese.

772. Më 24 maj 2005, Mbrojtja dorëzoi një Mocion të Përbashkët ku kërkohej që Dhoma: (a) të vendoste se Prokuroria kishte shkelur detyrimet e saj për zbulimin e materialit sipas Rregullave 66 dhe 68, (b) të urdhëronte zbulimin e menjëhershëm të ndonjë materiali shfajësues të mbetur i cili nuk ishte bërë i njohur, (c) të përcaktonte një masë zhdëmtuese të duhur sipas Rregullës 68*bis*. Më 1 qershor 2005, Mbrojtja e Përbashkët dorëzoi edhe një mocion gojor ku u kërkua zhdëmtim për

[2476] Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes për të Përjashtuar Deklarata të Bëra nga Haradin Bala në Intervistën e 17 shkurtit 2003, 17 nëntor 2004.
[2477] Vendimi mbi Njoftimin për Alibi sipas Rregullave 54 dhe 67(A) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, 16 shkurt 2005.
[2478] Njoftimi i Alibisë së Haradin Balës sipas Rregullës 67(A)(i)(a), 28 shkurt 2005.

shkak të zbulimit me vonesë të një dokumenti tjetër nga Prokuroria. Më 7 qershor 2005, Dhoma hodhi poshtë Mocionin dhe vendosi se nuk ishte vërtetuar se kishte patur një mungesë thelbësore apo sistematike korrektësie nga ana e Prokurorisë lidhur me zbulimin e materialit. Dhoma ishte e mendimit se, kur kishte patur raste të zbulimit të vonuar të materialit, ishin marrë masa për të siguruar që Mbrojtja të mos dëmtohej materialisht.[2480]

773. Prokuroria dorëzoi një Mocion për pranimin e katër kundërdeklaratave sipas Rregullave 85 dhe 92*bis*. Me 7 korrik 2005, Dhoma e miratoi kërkesën e Prokurorisë pjesërisht, duke pranuar si kundërprova tri deklaratat e para, por jo deklaratën e katërt, duke qenë se kjo e fundit kishte lidhje me një çështje e cila mund të ishte parashikuar nga Prokuroria.[2481]

774. Më 12 korrik 2005, Mbrojtja dorëzoi një Mocion të Përbashkët për pranimin e një deklarate kundërpërgjigjëse sipas Rregullës 92*bis*. Kërkesa u hodh poshtë nga Dhoma më 18 korrik 2005, me arsyetimin se dëshmia nuk kishte vlerën e duhur provuese.[2482]

4. Lirimi i Përkohshëm

775. Mbrojtja e Fatmir Limajt dorëzoi një Mocion më 5 shtator 2005 për Lirimin e Përkohshëm të të Akuzuarit, në pritje të gjykimit ose për një periudhë më të shkurtër sipas vendimit të Dhomës.[2483] Kërkesa u hodh poshtë nga Dhoma më 26 tetor 2005 me arsyetimin se garancia e UNMIK-ut ishte e kushtëzuar dhe e kufizuar, se në atë periudhë të procesit, rreziku i mundshëm i arratisjes mund të ishte maksimal, dhe se mungonte organizimi i duhur financiar dhe i sigurisë për lëvizjen e të Akuzuarit për në Kosovë dhe nga Kosova.[2484]

[2479] Njoftimi për një Alibi të Isak Musliut sipas Rregullës 67(A)(i)(a), 1 mars 2005.
[2480] Vendimi mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Zbulimit e Vonuar apo të Paplotë të Materialit nga ana e Prokurorisë, 7 qershor 2005.
[2481] Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Kundërdeklaratave nëpërmjet Rregullës 92*bis,* 7 korrik 2005.
[2482] Vendimi mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes mbi Pranimin e Deklaratës Kundërpërgjigjëse nëpërmjet Rregullës 92*bis*, 18 korrik 2005.
[2483] Mocioni i Persëritur i Mbrojtjes për Lirimin e Përkohshëm të Fatmir Limajt, 5 shtator 2005.
[2484] Vendimi mbi Mocionin e Përsëritur të Mbrojtjes për Lirimin e Përkohshëm të Fatmir Limajt, 26 tetor 2005.